

Në frymën e librit:

Mrekullia e Megjugorjes

FËMIJA I FSHEHUR I MEGJUGORJES

Motra Emmanuel

Emri i origjinalit:

Sœur Emmanuel Maillard

L'ENFANT CACHÉ DE MEDJUGORJE

Éditions des Béatitudes

Duke përdorur shprehjen „Zoja po dëftohet...“, autorja dhe botuesi i këtij libri nuk kanë pasë për qëllim t'ë tejkalojnë gjykimin që Kisha do të jep në lidhje me besueshmërinë e dëftimeve të Nënës së Zotit në Megjugorje. Ata këtu vetëm japin mendimin e tyre dhe mendimet e dëshmitarëve mbi ngjarjet që po ndodhin në Megjugorje.

Këtë libër e botojnë me qëllim informimi dhe do t'i nënshtrohet gjykimit të Kishës posa ajo ta shpall.

Përktheu:

Gjon Kelmendi

Shtypi:

Pregatitja teknike:

Kopertina:

Jezusit Fëmijë

Voglushes Li

*Të gjithë fëmijëve të flijuar
në altarët e idhujve tanë,
sepse ata e mbartin botën.*

PARATHËNIE

Njerëzit gjithmonë kërkojnë siguri, paqe dhe lumturi. Por, janë të rrallë ata që e kuptojnë se në të vërtetë kërkojnë Zotin.

Në librin e saj të ri *Fëmija i fshehur i Megjugorjes*, motra Emmanuel jep një kontribut të çmuar për të kuptuar këtë dëshirë njerëzore. Duke shfletuar këtë libër bëhet përherë e më e qartë se ky libër në të vërtetë është udhëzues. Ai na ndihmon që të arrijmë deri tek caku – Tek fëmiu i fshehur, tek Jezusi Fëmi. Në dëftimet e Megjugorjes Ky Fëmi Hyjnor fshihet aq mirë tek Nëna e vet, sa që në shikim të parë nuk i kushtohet aspak rëndësi. Por, kushdo që gjen Nënë, gjen edhe Birin. Kështu do të jetë edhe me të gjithë ata që do të lexojnë këtë libër.

Në librin e saj paraprak *Mrekullia e Megjugorjes* (i cili për një kohë të shkurtë u përkthye në më se njëzet gjuhë), autorja i ka ngjallur porositë e Zojës. Janë të shumtë ata që kanë qenë të entuziazmuar me pasurinë shpirtërore të të nëntëdhjetave (titulli origjinal i librit është *Megjugorje les annees 90* – Megjugorje në të nëntëdhjetat) dhe me butësinë e Mbretëreshës së Paqes që buron prej atyre faqeve. Leximi i këtij libri, ka nxitur në ta dëshirën e madhe që të shkojnë në Megjugorje si shtegtarë. Pa dyshim se libri *Fëmija i fshehur i Megjugorjes* do të jetë i suksesshëm, po ashtu, në lavdinë më të madhe të Zotit.

Motra Emmanuel në këtë vepër tregon talentin e njëjtë. Duke u mbështetur në shembuj të thjeshtë, të nxjerrë nga realiteti jetësor, ajo i tregon lexuesit se si e mbinatyrshmja mund të intervenojë në jetën e çdo njeriu. Derisa lexojmë këtë vepër, jemi të zhytur në gëzim, dhe jemi të rrëmbyer nga një zjarr i ri që të nisemi drejt shenjtërisë. Fillojmë ta duam Zotin me një ngrohtësi më të madhe, na rritet dëshira që të jemi të afërt me Të, pa marrë para sysh se me çfarë vështirësish jemi të rrethuar.

Ky libër nuk është për t'u lexuar në tren. Mund të krahasohet me mozaikun, që çdo pjesë e ka të veçantë dhe të çmuar. Duke lexuar për çdo ngjarje autentike që sjell, ndjejmë se nëpërmes lutjes dhe meditimit, zemrat tona janë të mbushura me hirin që buron prej tyre.

Ky material hap në ne derën drejt Hyjnores-drejt atij vendi ku e mbinatyrshmja është e zakonshme dhe ku zbulohet se mrekullia është diçka krejt normale. Në këtë mënyrë Zoti dëshiron të na e shpall dashurinë e Tij. Lexuesi nuk duhet çuditur se autorja kohë pas kohe përkthuan ngjarjet të jashtëzakonshme dhe çudira sepse ato na e zbulojnë gjithpushtetësinë e Zotit. Të ja zësh për të madhe këtë do të thotë të mëkatosh kundër Zotit.

A thua nuk është Besëlidhja e Vjetër e vërshuar me mrekullitë e Zotit? Dhe a nuk e ka filluar Jezusi veprimtarinë e tij publike me mrekullinë në dasmën e Kanës? Mrekullitë janë pjesë përbërëse e qëllimit të tij që njerëzit t'i sjell në besim. Ato ia vërtetojnë fjalët dhe vulosin misionin Hyjnor të Tij.

As sot nuk është ndryshe. Mrekullitë na ndihmojnë të besojmë në butësinë atërore të Zotit dhe të kemi besim në të. Kështu, motra Emmanuel na tërheq kah Megjugorja.

Kur ishim së bashku në misione në Azi, Australi dhe Amerikë, e kam parë edhe vetë se sa përpiquej që shpirtërat t'i sjell tek Zoti. Gjatë kohës së ligjëratave të gjata mariane, kam parë se si u drejtohet mijëra vetëve, me entuziazëm dhe besim, duke shpërndarë porositë e Mbretëreshës së Paqes. Kam parë, pastaj, se si me zell amënor dëgjon me orë të tëra ata që ja besojnë nevojat e tyre dhe as në mesnatë nuk ishte e lodhur! Dashuria e sajë për Zojën dhe për shpirtërat ja jep forcën. E njejta dashuri e ka shtyrë që ta shkruaj *Fëmijën e fshehur* dhe me të na nxit që krejt shpresën ta lëshojmë në Zotin, sidomos në tundimet tona momentale, dhe në ato që do të vijmë.

Duke i marrë parasysh të gjitha dëftimet autentike mariane, gjatë disa dhjetvjeçarëve të fundit, me sytë e fesë shohim se Nëna e Zotit don vetëm një gjë: ta shpëtojë botën nga vetëshkatrimi. Ajo dëshiron shumë që njerëzimin ta fusë në kopshtin e ri të Edenit. Në Fatima, për shembull, Mbretëresha e rruzares shenjte e quan këtë kohë të re Triumfin e Zemrës së sajë të Pamëkat Në të njëjtën frymë, mistikja e madhe franceze Marta Robin ka folur për Rrëshajët e Reja të Dashurisë që i ka premtuar Jezusi.

Një numër i madh besimtarësh e pret këtë intervenim të Zotit, intervenimin e dashurisë së tij të mëshirshme. Kjo shpresë është e lidhur me kthimin e Zotërisë në pajtim me fjalët e Nënës së Zotit të drejtuara shenjtes Faustine: “Unë ja kam dhuruar botës Shelbuesin, kurse ti duhet t'i flasësh botës për mëshirën e Tij të madhe dhe ta pregatisësh për ardhjen e sërishme të Tij...” (Ditari i motrës Faustina Kowalska, fragmenti 635).

Ardhjes së dytë të Zotërisë do t'i paraprijë gjyqi i pashmangshëm i pastrimit, i cili do të na aftësojë për kthimin tek Zoti me tërë qenjen tonë. Zoja na vjen në ndihmë me praninë e saj, me fjalët e saj e nganjëherë edhe me lotët e saj që të na pregatisë për tundimet e brendshme dhe të jashtme. Ajo na thërret në lutjen me zemër, që të heqim dorë nga egoizmi ynë dhe që të bjmë rrëfimën e sinqertë që të pajtohemi me Zotin dhe me të afërmit tanë. Kështu jemi të forcuar në dashuri - krejtësisht të lirë nga çdo njëanshmëri në marrëdhënjet tona. Ajo po ashtu na mëson ta duam Jezusin dhe ta pranojmë me zemër të pastër.

Motra Emmanuel e ka shkruar për ne *Fëmijën e fshehur të Megjugorjes*. Ajo na ndihmon që në jetën e përditshme ta praktikojmë këtë mësim. Mos e leni pa e lexuar këtë libër. Me anë të tij do të zbulojmë se si ta plotësojmë thirrjen tonë më mirë: që të jemi vetëm dashuri.

Atë Paul Maria Sigl!¹

Romë, në festën e shën Jozefit, 20 mars 2006

¹Atë Paul Maria Sigl është bashkëthemelues dhe udhëheqës shpirtëror i bashkësisë “Familja e Marisë” në Sllovakia. Veprimtaria e tij ka qenë e lidhur ngusht me monsinjor Pavel Maria Hnilica, DI, i cili e ka shuguruar për meshtar në Fatima me 08 dhjetor 1992. Atë Paul udhëton nëpër botë, predikon në takime dhe ligjëron në tubimet mariane. Për më shumë informata shkruani në këtë adresë: Family of Mary, via Ombra 1, 64010Civitella del Tronto, Italia. E-mail: familiemarien@web.de

PËRMBLEDHJE E SHKURTË

E HISTORISË SË MEGJUGORJES

Një pasdite të mrekullueshme vere, më 24 qerrshor të vitit 1981 dy vajza nga fshati Bijakoviqi² bisedojnë gjatë një shetitje në kodrën gurore të quajtur Podbërdo mbi fshatrat e tyre. Bisedojnë si fëmijët e moshës së tyre.

Njëra prej tyre, Ivanka Ivankoviq, gjashtëmbëdhjetë vjeçe, papritmas mbi Kodër vëren një dritë, nja dyqind metra larg tyre. Sheh siluetën e ndritshme pezull mbi tokë. E shtanguar, hesht dhe zgurdullon sytë në të. Silueta merr formën e gruas së re. Atëherë Ivanka bërtiti: “Mirjana, shiko, kjo është Zoja!”. Mirjana, e sigurt se Ivanka po mahitet, madje as nuk shikon në drejtimin që i tregon shoqja.

“Lere” thotë me ironi, “çfarë Zoje, pse do të na dëftohej neve Zoja?”

Ivanka është e bindur, por nuk insiston dhe ashtu vazhdojnë shetitjen. Ju bashkohet edhe vajza e tretë. Ajo është Millka Pavloviq e cila i lut që t’i ndihmojnë rreth dhive të sajë. Shetisin një kohë pastaj kthehen në vendin e njëjtë. Në atë çast të gjitha shohin siluetën dhe bien në gjunjë.

Pikërisht atëherë andej pari kalon shoqja e tyre Vicka Ivankoviq. “Shiko kah qielli!” i thonë. Vicka tallet me ta dhe, pa shikuar drejt kodrës, heq këpucët dhe largohet duke vrapuar. Rrugës takon Ivan Dragiçeviqin, gjashtëmbëdhjetë vjeçar dhe shokun e tij Ivan Ivankoviqin. Ua përsërit fjalët e shoqeve të saj. Vendosin që së mbashku të shkojnë dhe të shohin se çfarë po ndodh. Posa arritën rrëzë kodrës edhe ata shohin siluetën, kurse Ivan Dragiçeviq, i frikësuar, vrapon në shtëpi sa më shpejt që mundet.

Të nesërmen katër prej fëmijëve ishin të nxitur që të kthehen në atë vend në kohë të njëjtë. Vicka shkon që të gjejë shokët e sajë, Marija Pavloviqin, të motrën e Millkës dhe Jakov Çolon, dhjetë vjeçar. Në këtë ditë, të dytë, të gjashtë fëmijët shohin Virgjërën e Bekuar dhe kështu u formua grupi definitiv i gjashtë vëguesve. Milka Pavloviq dhe Ivan Ivankoviq nuk ishin të nxitur që të kthehen aty dhe kurrë më nuk e panë Zojën.

Sipas dëshmisë së vëguesve, Zoja duket si gjashtëmbëdhjetë vjeçare, ka flokë të zinj dhe sy të kaltërt dhe një bukuri të papërshkrueshme. Paraqitet si Mbretëresha e paqes dhe pajtimit. Vjen që të na afrojë Zembrës së Zotit duke na treguar rrugën e Paqes. Të gjithëve na fton në shenjtëri dhe për këtë na jep disa mjete shumë të thjeshta, të përshtatshme për të gjithë.

² Krahina që i takon famullisë së Megjugorjes

Zoja i ka premtuar secilit vegues se do t'i besojë dhjetë fshehtësi. Deri tani, tre prej tyre, Ivanka, Mirjana dhe Jakovi i kanë marrë dhjetë fshehtësitë e veta dhe nuk kanë më dëftime të përditshme. E shohin Zojën një herë në vit. Vicka Marija dhe Ivani i kanë marrë nga nëntë fshehtësi dhe Zoja ju dëftohet akoma çdo ditë.

Sipas Mirjanës, secili vëgues duhet që të zgjedh meshtarin të cilit do të ja tregojë fshehtësitë e veta. Ajo e ka zgjedhur fra Petar Lubiçiq-in. Dhjetë ditë para shpalljes së fshehtësisë, vegimtari duhet që së bashku me meshtarin e zgjedhur të agjërojë në bukë dhe ujë, të shtatën ditë meshtarit i tregohet fshehtësia kurse ai, tri ditë para realizimit, duhet të ja shpall botës.

Në korrik të vitit 1981, Zoja, po ashtu, ka premtuar se në kodrën e dëftimit do të le një shenjë të përhershme, të dukshëm për të gjithë dhe të pashkatrueshme.

Çdo muaj, me datën 25 Zoja i jep Marisë porosinë dedikuar mbarë botës. Marija ia dorëzon fratit nga famullia e shën Jakobit, dhe pastaj përkthehet dhe shpallet në të gjitha gjuhët.³

Që nga viti 1987 Virgjëresha i dëftohet Mirjanës çdo muaj me datën 2 dhe së bashku me të lutet për ata që nuk besojnë. Këto dëftime tani janë të hapura për të gjithë. Nganjëherë Zoja me këtë rast i jep Mirjanës porosinë për publikun.

Prej fillimit të dëftimeve në Megjugorje kanë ardhur afro tridhjetë milion shtegtarë, duke përfshirë meshtarët, ipeshkëvinjtë dhe kardinajt.

Të gjithë vëguesit sot janë të martuar.

Ivanka Ivanković është e martuar me Rajko Elez me 28 dhjetor 1986. Kanë tre fëmijë: Kristina, Josip dhe Ivan.

Mirjana Dragičević është e martuar me Marko Soldo më 16 shtator 1989. Jetojnë në Megjugorje me dy vajzat e veta: Veronika dhe Marija.

Marija Pavlović është e martuar me Paolo Lunetti më 8 shtator 1993. Jetojnë në Monza, në Itali, me katër djemt e tyre. Ata janë: Michaele, Francesco Maria, Marco dhe Giovanni.

Jakov Čolli ka marrë Annalisa Barozzi më 11 prill 1993. Jetojnë në Megjugorje. Kanë tre fëmijë. Quhen: Arijanna Marija, David Emmanuele dhe Myriam.

Ivan Dragičević ka marrë Laureen Murphy më 23 tetor 1994 dhe të shumtën e kohës jetojnë në SHBA. Kanë tre fëmijë: Kristina Marija, Mikaela dhe Daniel.

Vicka Ivanković është martuar me Mario Mijatović më 26 janar 2002. Jetojnë në Krehin Gradac, shumë afër Megjugorjes me dy fëmijët e tyre: Marija-Sofija dhe Ante.

³www.medjugorje.hr ose www.childrenofmedjugorje.com

Të dashur fëmijë! A thua nuk i njihni shenjat e kohës? A thua nuk flisni për to? Më ndiqni. Ju thërras si nënë!” (Mirjanës më 2 prill 2006)

I

KUSH ËSHTË FËMIJA I FSHEHUR

Qerrshor 1981.

Kah ora tre pasdite dielli përvëlues u përkul kah perendimi. Në Hercegovinë të gjithë e dinë se gjatë solsticit veror është më mirë të qëndrosh në shtëpi dhe të bësh një sy gjumë se sa të luftosh me vapën.

Mirëpo, pikërisht atë ditë në shpatin e kodrës qëndronte një grua. E pazakontë. Sikur të donte të fshihte fëmijën që mbante! E kishte mbështjellë me pëlhurë ashtu si bëjnë gratë në lindje dhe i kishte mbuluar fytyrën me një vello të lehtë. Aq i vogël është. Duhet të jetë i posalindur! E gruaja? A është ajo motra e tij më e madhe apo e ëma? Duket aq e re – memzi ka pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë vjet. Disa të rinj e shikojnë të magjepsur. Nuk e njohin. Sigurisht nuk është nga fshati i tyre, edhe pse duket si vajzat e asaj ane me flokë të zinj të mrekullueshëm dhe fytyrën që rrezaton si dielli. Kohë pas kohe ngrit vellon që mbulon fytyrëzën e fëmijës, si të donte të zbulojë fshehtësinë e sajë, e freskon me tundjen e mantelit dhe e mbulon përsëri. Qëndrimi i sajë i frikon ata që e shikojnë. Pyeten: “Çka është e veçantë në atë fëmijë që sillet ashtu me të?”

Të rinjët hyjnë nën hijen e qarrit për tu mbrojtur prej diellit. Të mahnitur vazhdojnë të shikojnë pamjen që ju duket se vjen prej një bote tjetër. Dëm, gruaja e re qëndron në lartësi dhe nuk e shohin qartë fytyrën e fëmijës. Më kot ajo ju jep shenjë që t’i afrohen, meqë ata, as nuk lëvizin. Qëndrojnë si të rrënjosur, të frikësuar së tepërmi.

Në mbrëmjen e asaj dite, fëmija i fshehur, është gati i harruar. Por nëna e tij është objekt bisedash në fshat. Si kanë mundur, atë natë, vendasit e fshatit Bijakoviqi të dyshojnë edhe për një sekondë të vetme, se prej atij çasti e tutje jeta e tyre kurrë më nuk do të jetë e njëjtë? Ishte tepër vonë! Fëmija i fshehur dhe nëna e tij, tani më, kishin filluar që të ndryshojnë që nga themeli këtë fshat të vogël e të humbur hercegovas. E kaluar ishte zhdukur! Tani e tutje më i vogli i të vegjëlve do ta udhëheq këtë valle. Ai, në emrin e të cilit “do të përkulet çdo gju i atyre që janë në qiell, në tokë e në nëntokë,”⁴ do ta udhëheq së bashku me Nënëen e vet! Pikërisht Ai, prijësi ynë i vërtetë, i

⁴ Fil. 2,10

fshehur në Marinë dhe në të gjithë tabernakujt e botës, vjen në mënyrë hyjnore që t'a udhëheq botën!

Libra të panumërt janë shkruar për Nënë. Duhej shkruar libri për fëmijën, libri i cili do të shpallte praninë e tij Vepruese si në Megjugorje, ashtu edhe jashtë sajë.⁵

Gjashtë muaj pas dëftimit të parë në Podbërdo, Jezusi Fëmijë ju dëftua përsëri vëguesve. Kësaj rralle ishte i mbështjellur me vellon e artë të Nënës së vet. Ishte Krishtlindja! Në mbrëmje më 25 dhjetor 1981, përfundimisht, të rinjtë shikuan Zotin-Fëmijë faqe-faqas, kurse ai, Zot, ishte vetëm disa orësh! Çka bënte Ai? Luante kukaçefas me vellon e Nënës së vet! E dinte se vëguesit duhej të qeshnin. Ishin aq të shtangur dhe të ngathët para Hyjnore.

Njeriu i të sotmes – i shqetësuar, i brengosur dhe i sëmurë - duhet që të luaj me Jezusin-Fëmijë që të shërohet. Duhet të luaj me Zotin që të ngjallet. Që t'i mposhtim forcat e së keqes që na shkatrojnë nga brenda dhe i kërcënohen botës sonë, na duhet arma e cila nuk është prej kësaj bote. Na duhet Jezusi-Fëmijë.

Për shembull, viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar në një qytet të madh evropian, sektet satanike u shumuan aq shpejt sa që pushteti vendor vendosi që të krijojnë njësitet kundërsatanike. Për këtë qëllim duhej emruar një njeri jashtëzakonisht i shkathët dhe i aftë që të çrrënjosë sektet një nga një. Gjetën njeriun e duhur dhe të besueshëm i cili kishte përvojë të njohur në punë të tilla dhe atij ia besuan detyrën. I gjithë tregimi duket i bukur, por realiteti zbulojë diçka krejt tjetër. Zyrtari i zgjedhur ishte njëri nga satanistët e rangut më të lartë!

Po, na duhet arma që nuk është prej kësaj bote, që ta mundim të Keqin, sepse ai edhe pak kohë ka pushtet.⁶ Fëmija i Pafajshëm na duhet për rrenimin e mbretërisë satanike. Zoti gjithmonë ka mëshirë për të pafajshmen që i kundërvihet të keqes, dhe Ai e di pse.

Në këtë libër që lexohet hap pas hapi, përpiqem që të ju siguroj, të dashur lexues, mjetet e thjeshta që do të ju ndihmojnë që të përjetoni diçka nga Jezusi-Fëmi. Këtu do të gjeni imazhe të ndryshme të pasuruara me dëshmi dhe me fakte konkrete. Kam shpresë që secili prej jush do të gjejë çelsat për jetën e tij dhe ushqim për shpirtin.

Ja disa shembuj:

⁵ Nuk është rastësi se Zoja është dëftuar më 24 qershor, në festën e shën Gjoni Pagzuesit i cili i ka udhëzuar drejt Jezusit të fshehur në zemrat e njerëzve! Në të vërtetë Maria vjen si paraardhëse që të pregatisë njerëzit për ardhjen e dytë të Krishtit. Ai gjest me të cilin ajo zbulon dhe mbulon fytyrën e Fëmijës na zbulon qëllimin e vizitave të sajë: Fëmijën e fshehur të ja zbulojë syve tanë të verbër!

⁶ I Gjn 5,19

*Nëse një ditë do të gjëndemi në burg për shkak të Jezusit dhe nëse do të jemi shumë të dobët që të kujtojmë lutjet tona, ekziston çelsi në kapitullin e 14 me titull: “Gjuha e panjohur”.

*Nëse një ditë do të na mungojë ushqimi, ekziston reçetë e mirë në kapitullin 75 me titull: “Zoti që shumon”

*Nëse një ditë nuk do të ketë para në botë, kapitulli 78 me titull: “Depot e provanisë së Zotit” do të ju tregojë rrugëdaljen.

*Nëse një ditë nuk do të ketë më barëra, mund t’i kërkonit në vendin e përshtatshëm në kapitullin 52 të titulluar: “Shen Jozefi i mirë”

*Nëse një ditë do të na vërshojnë valët e së keqes, shpresën mund ta gjeni në kapitullin 70 me titull: “Operacioni Jerihon”.

*Nëse një ditë do të na përfshin frika nga vdekja, ngushllimin mund ta gjeni në kapitullin 50 me titull: “Qielli në pëllëmbë të dorës”.

*Nëse na kaplon frika nga e ardhmja, rruga e sigurt është e shpjeguar në kapitullin 20 me titull: “Rruzarja ose Sovjetikët”

*Nëse një ditë do ta keni të vështirë të falni, zgjedhja është e përshkruar në kapitullin 46 me titull: “Gjetja e Fëmijës”.

*Nëse një ditë dëshprimi e kaplon zemrën tonë, kahja e lëvizjes që është e vërtetuar përshkruhet në kapitullin 76: “Marta Robin – engjëlli kundër vetëvrasjes”.

Disa nga dëshmitë e paraqitura në këtë libër nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me Megjugorjen, por i kam zgjedhur me të njëjtin kriter. Ato na zbulojnë fuqinë misterioze të Krishtit dhe na ndihmojnë që të hyjmë në bashkësi më të thellë me Të. Sepse Fëmija i fshehur i Megjugorjes është në të vërtetë, në çdo gjë, Pafajsia Hyjnore pavarësisht nga mënyra se si paraqitet. Ai është Zoti i Gjithpushtetshëm që gjithmonë ka qenë, gjithmonë është dhe gjithmonë do të jetë Fëmi.

“Të dashur fëmijë! Thirrni emërin e Birit tim. Pranoni Atë në zemrën tuaj. Vetëm në Emërin e Birit tim do të përjetoni lumturinë e vërtetë dhe paqen e vërtetë në zemrën tuaj. Vetëm në atë mënyrë do ta njihni dashurinë e Zotit dhe do ta shpërndani më tej. Ju thërras që të jeni apostujt e mi.” (Mirjanës, më 18 mars 2000)

2

SYTË E KALTËRT TË VERONIKËS

Margate, Afrikë e Jugut, më 9 gusht 1998.

Veronika nuk mundi të flinte. Pyeste veten a thua zjarri i jashtëzakonshëm që e digjte në shpirt do ta mbante zgjuar deri në mëngjes. I shoqi, Aleksi, fatmirësisht, tani më flinte me një gjumë të thellë. Veronika fillojë që spontanisht t’i lutej Jezusit. Në të vërtetë fillojë që sinqerisht të bisedojë me të në zemrën e vet. Nuk përdorte lutjet e shkruara, por ato që vetë i vinin në gojë. Madje edhe kur shqiptonte “Ati ynë” e bënte me aq intenzitet sa dukej se vetë e kishte menduar!

Akoma ishte errsirë kur Veronika vendosi që të ngritet dhe të shkojë në dhomën e ditës. Zgjedhi kolltukun e vet të preferuar përballë kryqit. Duke pushuar, i lejojë zemrës që të sundojë lirisht. Çdo gëzim dhe çdo lot ja paraqiti Jezusit që ishte dëshmitari i vetëm i jetës së sajë intime. Veronika e donte Jezusin mbi të gjitha. Gëzimi i sajë më i madh ishte që të ja dorëzojë të gjitha punët ditore, të gjithë njerëzit e dashur, këtë ose atë situatë dhe pastaj e pyeste: “Jezus, çka mendon për këtë situatë? Jezus, si mund të ndihmoj me këtë situatë?”

Nuk mendonte për kohën dhe nuk dinte se sa kohë ishte lutur kur për një çast e përfshiu diçka e jashtëzakonshme. Ndjeu se fytyra po i digjej. Në vizion pa dritën e shkëlqyeshme – çdo sekondë bëhej më e shkëlqyeshme. Pyetej: “Çka po ndodh?”

E verbët krejtësisht

Veronika ka lindur në Afrikën Jugore në një familje të vyeshme dhe të rreptë katolike me tetë fëmijë. Çdo mëngjes, mbarë familja shkonte në meshën shenjte në kishën e famullisë dhe çdo mbrëmje në lutjen e mbrëmjes. Dhe çka është më e rëndësishme, së bashku lusnin rruzaren. Të djeleve merrnin pjesë në meshën afrikane ku dukej se vallëzimi ritmik dhe këngët e frymzuara, ndalnin rrjedhën e kohës. Askush në familje nuk fliste për përsheptërinë. Ajo mënyrë jetese ishte i zakonshëm në shtëpinë e tyre, si ushqimi, gjumi apo puna. Megjithatë, Veronika është dashur që nga fëmijëria të bartë ktyqin e rëndë - ndarja e retinës i kishte përfshirë te dy sytë, dhe ishte gadi e

verbër krejtësisht. Si fëmijë nuk shihte fare me syrin e majtë, kurse me të djathtin, botën e shihte si nëpër një vello të errët.

Veronika ishte zyrtare banke deri në vitin 1956, kur u martua me Aleksin, drejtorin financiar të një firme të madhe që shiste rroba. Patën katër fëmijë. Aleksin ishte për të si engjëlli që kishte zbritur prej qiellit! Një mik i dërguar prej Zotit që të jetë me të dhe ta ruaj si një pasuri të vlefshme! Aleksin i takonte atij lloji burrash, që grave të tyre dinë të ju ofrojnë atë dashuri të qetë dhe të butë që nxjerrin vetë nga zemra e Zotit. Veronika u verbua plotësisht në vitin 1977. Por, se çfarë bukurie rrezatonte akoma!

Emri që askush nuk dinte ta shqiptojë!

Atë natë mbi Veronikën ndriçojë një dritë e fortë. Pas një çasti frike kur zemra e sajë fillojë të rrahë në mënyrë të pakontrolluar, kuptojë se para sajë qëndron njeriu dhe ai është Jezusi! A ishte dëftim apo vizion, nuk ishte me rëndësi. Mund ta shihte mirë. Ishte i tëri në dritë. Veronika nuk ishte e vetëdijshme për asgjë tjetër përveç pranisë së tij. Duart i kishte drejt sajë. Ai tha: “Eja! Ngritu dhe lutu me mua!”

Jezusi i tregojë një fshat të vogël të rrethuar me kodra. Shikojë kishën me dy këmbanare me kryq në majë, tri dritare në arkada. Jezusi e çojë brenda sajë ku pa disa dritare me vitrazhe. Njëri prej tyre, që paraqiste Lajmërimin e Zojës, e preku thellë. Veronika ishte e habitur me ato që pa. Deri në vitin 1977, me Aleksin kishte vizituar Izraelin, Lourdin e Fatimen. Por ky vend ju duk ndryshe.

“Jezus, nuk e njoh këtë vend!” i tha. Jezusi, qeshi dhe, duke e shikuar i tha: “Megjugorje! Atje do ta jap dritën dhe do ta tregoj rrugën!”. Pataj u zhduk ashtu sikurse u paraqit.

Duke u përpjekur që të kuptojë atë që i kishte ndodhur, Veronika përsëri u gjend në terr. Deri sa ishte e vërshuar e gjitha me ndjenja, Aleksin ju bashkua në lutje. E gjeti të përbotur, por shpejt e kuptojë se ishin lot gëzimi! E shikojë me butësi dhe e pyeti: “A je mirë?”

“Aleks, Jezusi më foli. Më tha se duhet të shkojmë në Megjugorje, të jemi me të dhe të lutemi. Më tha se atje do të ma japë dritën dhe do të më tregojë rrugën.”

“Çka?” klithi Aleksin. “Megjugorje?”. Aleksin kërkojë që ta përsëriste atë emër.

Ajo ndjeu një huti në zërin e tij, por vetëm mundi të përsëriste: “Megjugorje”.

Kërkojë prej sajë që emrin ta përsëriste edhe dy herë, zgurdullojë sytë në të pastaj në duart e veta, duke kërkuar shpjegim dhe duke menduar për emrin e çuditshëm. As që e mirrin me mend se ku

mund të jetë ai vend. I hutuar, Aleks i mori lapsin dhe kërkoi prej Veronikës përshkrimin e saktë. Vizatoi fshatin dhe kishën ashtu si e përshkroi ajo.

Gjatë disa ditëve të ardhshme, i vizituan të gjitha agjencitë turistike që mundën të gjejnë në afërsi. Secila prej tyre dinte më pak se tjetra. Emri i çuditshëm ishte enigmë për ta, dhe nuk e kishin as idenë e përafërt se ku mund të jetë. Ky emër, gadi i pashqiptueshëm, nuk ishte i paraqitur në asnjë hartë, dhe nuk e përmendnin as broshurat turistike. Aleks i përjetonte dështim pas dështimi deri sa pas dy javësh nuk i thirri një mik. Zërin e kishte përplot me entuziazëm: “Pikërisht jam kthyer nga një shtegtim i jashtëzakonshëm! Isha në fshatin e vogël në Bosnje dhe Hercegovinë ku Zoja u dëftohet disa fëmijëve. Duhet që të shkoni atje, është shumë bukur! Vendi quhet Megjugorje.”

Aleksit, sa nuk ju zu fryma. “Megjugorje?”

Ua shpjegojë se si mirren vizat. Pasi që kaluan një mal me probleme administrative, Aleks i dhe Veronika më në fund morën vizat dhe u nisën me aeroplan për në Kroaci. Kishin vetëm një qëllim: që të plotësojnë atë që Jezusi kishte kërkuar nga Veronika.

Kur arritën në Megjugorje, huazuan një makinë dhe filluan që të hulumtojnë fshatin. Aleks i përmbahej prej fjalëve, i përqendruar plotësisht në ambientin e ri. Papritmas klithi: “Veronika, ky është vendi! Arritëm! Kisha, dy këmbanare, kodra e madhe me kryq në majë. Ndjej si ta njihja këtë vend, është ai që ke përshkruar!”

Në makinë silleshin si dy fëmijë të shqetësuar. Çdo detal ngjallej në shpirtin e Veronikës derisa Aleks i përshkruante fshatin. Lejonte që çdo pjesëz të zhytej thellë në zemrën e sajë. Çdo pamje e re ishte vërtetim i vizionit, ishte si një puthje e Jezusit dhënë shpirtit të sajë. Jezusi i sajë i dashur nuk e kishte mashtruar! Dy ditë shetiti gjithandej nëpër Megjugorje e mbështetur në krahun e Aleksit dhe muar pjesë në të gjitha programet që ofronte famullia. Të mahnitur dëgjonin dëshminë e Mira Ostojiq-it tek e cila banonin. Ata ishin njerëzit që jetonin, me gjith zemër, porositë e Zojës.

Ditën e tretë të shtegtimimit Mira i çojë të vizitojnë Vickën, njërin nga vëgueset e cila në atë kohë u fliste shtegtarëve nga mbarë bota. Aleks i përpiquej që të mbrojë Veronikën nga turma që shtyhej pranë shkallëve të vogla ku fliste Vicka. Por ishin si të burgosur nga turma, as majtas as djathtas nuk mund të lëviznin. Kur Vicka arriti dhe fillojë të lutej, të gjithë sytë ishin të drejtuar në të. Shtatshkurtërit çoheshin në majë të gishtave dhe shtrembëronin qafën me shpresë se do ta shihnin për një çast.

Aleks i përshpëriste Veronikës pamjen në pika të shkurta. Por u ndal për një çast. Diçka e papritur po ndodhte:

“Veronika, Vicka po të shikon! Po të buzëqesh!”

“Më buzëqesh mua? O, sikur të mund ta shihja!”

“Po zbret nga shkallët. Po të shikon! Po vjen drejt nesh!”

“O Aleks, sikur të mund ta shihja edhe unë! Do të ishte shumë mirë!” përsëriti.

Papritmas, ndjeu dorën në sytë e sajë. E shtangur nga çudia, e gjithë qenja e sajë dëgjonte zërin e mrrekullueshëm që lutej në gjuhë të pazakontë. Ishte zëri i njëjtë që fliste para disa çastesh. Ishte Vicka. Ajo zbriti shkallët që të lutej për të, për sytë e sajë të bukur të kaltërt.

E gjithë turma, pa frymë, pyetej se çka do të ndodh në vazhdim. Pas një lutje të gjatë, Vicka largojë duart prej syve të Veronikës dhe ajo ndjeu se si jeta po kthehet në syrin e sajë të djathtë.

“Unë shoh!” klithi

Vicka vetëm u përkul, e puthi dhe buzëqeshi. “Çfarë buzëqeshje” mendojë Veronika, tepër e lumtur dhe plot me Shpirt Shenjt! Fytyra e Vickës ishte gjëja e parë që Veronika pa. Por kjo zgjati shkurt sepse Vicka e përqafojë Veronikën me aso butësie që Veronika kujtojë se po prek një copë qielli. Një pjesë të vogël të zemrës së Marisë që rrjedhte nëpër shërbëtoren e sajë të vogël, Vickën. Aleks i qante prej gëzimit.

Sa i bukur ishte kthimi për në kishë pastaj, pasi që me vite kishte mbajtur Veronikën për dore kudo që kishin shkuar! Lajmi për kthimin e shikimit të Veronikës u hap si zjarri në një ditë vere kur fryn erë. Atë mbrëmje pas meshe, atë Sllavko e thirri Veronikën që të vijë në foltore dhe të lusë Magnifikat para kishës së mbushur plot.⁷ Sa e përshtatshme ishte që u zgjodh Veronika – ajo vetë u bë Magnifikat i gjallë. Papra falënderonte Zotin që i lejojë të shohë përsëri. Ajo fare nuk kishte pritur një shërim të tillë! Por Jezusi kurrë nuk jep shërim fizik nëse nuk ka prekur, në njëfarë mënyre, krejt qenien. Të gjitha dhuratat e tij janë të drejtuara drejt shërimit më të madh që ekziston: shërimit të shpirtit që mbetet për amshim.

Në zemër, Veronika mendonte pandërpre për fjalët që kishte dëgjuar atë mbrëmje në Margate: “Atje do të jap dritën dhe do të tregoj rrugën!”

Të tregoj rrugën?

Pas shërimit të syrit, Aleksit dhe Veronikës ju hap shteg i ri. Për t’ju falenderuar Zotit, ju përveshën punës për shërimin e të gjitha zemrave të thyera të Afrikës së Jugut që ende nuk e njihnin dashurinë e Tij. Të njëjtin vit i kam lutur që të bashkëpunojnë me ne, që të jenë antena e “Fëmijëve të Megjugorjes” në mes të Afrikës. Por nuk e kam paraparë efektin e mahnitshëm që ata do të kenë në vendin e vet. Rezultatet e tyre ishin jashtë çdo pritjeje! Pa asnjë pregaditje paraprake misionare, me mjetet e kufizuara lokale dhe shumë net pa gjumë, u dhanë me mish e me shpirt që të shpallin atë që e kishte ndërruar jetën e tyre. Duke ju falënderuar atyre, porositë e

⁷ Tregimi për shërimin e Veronikës është publikuar në revistën “Gls Mira” (Zagreb, më 1999).

Megjugorjes kanë hyrë në mijëra familje, kanë shpëtuar jetëra, ngjallur fenë e cila fikej ose vdiste, ngjallur shpresën dhe mbjellur gëzimin gjithandej!

Apostujt e kohëve të fundit

Zoja në Megjugorje i ka profetët e sajë të vegjël. Gjatë shtatëmbëdhjetë viteve të mia në shërbimin e sajë kam vërejtur, tek të gjithë ata, cilësi të ngjashme që nuk mund të mohohen: janë të përvuajt dhe të thjeshtë, plotësisht të lirë nga mendimi publik dhe mendojnë gjithmonë për Fjalën e Zotit dhe Porositë e Zojës. Asnjë gur në të cilin merret në thua nuk mund t'i ndal dhe, për çudi, duket se janë të udhëhequr nga brenda në lidhje me atë që duhet të lutën. Rezultat i kësaj është se u dëgjohen gadi të gjitha qëllimet që i sjellin para Zotërisë! Kjo është armata e vogël e Zojës, “njësitet speciale të sajë që infiltrohen gjithandej. Derisa “të mëdhenjëve” të kësaj bote u duhet të kërkojnë prej “të mëdhenjëve” të tjerë për ta t'i lëvizin gjërat, këta profetë të vegjël nuk brengosen për asgjë. Ata, thjesht, ecin me engjëjt dhe dyert u hapen në mënyrë të mrrekullueshme!⁸

⁸Këta apostuj të Zojës na përkujtojnë në “Apostujt e kohëve të fundit” të cilët i ka përshkruar shen Ludeviti Maria Montfort në librin e tij profetik – Analizë mbi përshpirtërinë e vërtetë ndaj Tejetshenjtërisë Virgjër Mari. Ja, në vazhdim, tri pjesë:

(54)“Ata do të jenë të vegjël dhe të varfër në sytë e botës, të ulët para të tjerëve si thembra; të gjithë do t'i shkelin dhe shtypin ashtu si i ndodh thembrës nga pjesët tjera të trupit. Por do të jenë të pasur me hiret e Zotit, të cilët Maria do t'ua japë me shumicë; do të jenë të mëdhenj dhe të lartësuar në shenjtëri para Zotit dhe do të tejkalojnë çdo krijesë me zellin e tyre të zjarrtë. Ndihma e Zotit do ti mbështesë aq shumë sa që me thembrën e tyre – me përvuajtërinë e tyre – së bashku me Marinë do të ja shtypin kokën djallit, kurse Jezusit do t'i sigurojnë fitoren e lavdishme.

(58) “Ata do të jenë apostujt e vërtetë të kohëve të fundit të cilëve Zotëria do t'ua japë gojtarinë dhe pushtetin të bëjnë mrrekulli dhe që t'i grabisin pranë e lavdishme armiçëve të tyre. Do të flejnë pa flori dhe pa argjend, dhe çka është më e rëndësishme, pa brengën e ankthshme pranë meshtarëve të tjerë, njerëzve të kishës dhe klerikëve, intermedios kleros; megjithatë do t'i kenë krahët e pëllumbeshës të flakëruar me argjend që të fluturojnë, me qëllimin e pastër të lavdisë së Zotit dhe të shpëtimit të shpirtave, atje ku i thërret Shpirti Shenjt, prandaj në vendet ku do të predikojnë do të lënë pas vetes vetëm floririn e dashurisë, që është plotësimi i gjith ligjit.”

(59)“Përfundimisht e dimë se ata do të jenë nxënësit e vërtetë të Krishtit, të cilët do ta trashëgojnë varfërinë, përvuajtërinë,urrejtjen e botës dhe dashurinë e tij; do t' predikojnë rrugën e ngushtë të Zotit me të vërtetën e pastër, sipas Ungjillit, dhe jo sipas parimeve të botës, dhe nuk do të shqetësohen fare, askend nuk do ta shikojnë në fytyrë, dhe sdo ta kursejnë, ta dëgjojnë ose t'i frigohen asnjë vdekatar, sado pushtet të ketë ai. Në gojën e vet do të kenë shpatën dytehëshe të fjalës së Zotit; në shpindë do të bartin flamurin e përgjakur të Kryqit, në dorë të djathtë kryqin e rruzaren në të majtën; Emrat e shenjtë të Jezusit dhe të Marisë në zemrën e vet, kurse pastërtinë dhe përvuajtërinë e Jezusit në të gjitha sjelljet e veta.

Ja të tillë do të jenë ata njerëz të mëdhenj që do të vijnë, që Maria do t'i ngrisë, me urdhërin e Ghithpushtetshmit, që të shpërndajnë Mbretërinë e tij mbi mbretëritë e të pafeve, idhujtarëve dhe feshtrembërve. Por kur do të jetë kjo dhe si?...Vet Zoti e di këtë.”

Dielli nuk perendon kurrë pa e treguar Veronika ndonjë anekdotë, si të ishte e lidhur me qiellin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Shesh thotë: Zoti e ka bërë këtë ose atë për këtë ose atë person, në këtë ose atë situatë”. Kur sheh ndonjë meshtar i cili nuk e ka kuptuar seriozisht thirrjen e vet, i bëhet menjëherë nënë shpirtërore. Nuk pushon “së tërhequri për mënge” Zotin dhe të gjithë shenjtërit e tij deri sa meshtari nuk thyhet, pendohet për mëkatet e veta dhe nuk kthehet në rrugë, përsëri.

Nëse sheh djaloshin në depresion, drogë ose imoralitet, zotëria i përshpërit shkakun e fatkeqësisë. Djaloshi menjëherë bëhet i adoptuari i sajë. Me butësi e bart me vete në zemrën e sajë dhe lutet për të si Moisiu në mal ose si profetët që kurrë nuk e lënë Zotin rehat. Pataj bisedon pak me djaloshin i cili në fund kthehet në jetë! Veronika di të prekë Zotin në zemër, kjo është fshehtësia e sajë!

Sytë e Veronikës janë si dy gur të çmueshëm, me ngjyrë të kaltërt më të kthjellët madje se deti mesdhe nën diellin e qerrshorit.⁹ Pse Jezusi e shëroi vetëm syrin e sajë të djathtë? Sigurisht nga mëshira! Një ditë Veronika ma ka besuar se më me dëshirë do të ishte e verbër se sa të shohë sepse të parit mund të jetë burim i një shqetësimi të madh për zemrën! Sot ka aq shumë gjëra të shëmtuara rreth nesh! Supozoj se Jezusi e ka marrë parasysht këtë: syrin e majtë e ka mbajtur për vete ashtu që Veronika përbrenda të mund të mendojë për Të dhe nga Ai të nxjerr fuqinë. Syrin tjetër e ka shëruar që me Veronikën të ndajë vuajtjen e kësaj bote në mënyrë që ajo të mund të ja paraqesë Zotit.

⁹ Shiko fotografinë

“Të dashur fëmijë! ... Nëse nuk luteni, nuk do ta zbuloni dashurinë time, as planet që Zoti ka me këtë famulli dhe me secilin individ. Lutuni që djalli të mos ju tërheqë me krenarinë e vet dhe me forcën e vet të rrejshme. Unë jam me ju dhe dëshiroj të më besoni se ju dua.

Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime!” (më 25 nëntor 1987).

3

KTHEJANI MBRETIT KURORËN!

Mikja ime Catherine luftonte në zemrën e vet. Irlandezja gjashtëdhjetë vjeçare, nënë e dy fëmijëve, gjyshe dhe shpresë e famullisë së sajë, ka kohë që e ka lënë veten në udhëheqjen e Shpirtit Shenjt. Por personaliteti i sajë ishte aq i fortë sa që, nganjëherë, shkaktonte që t’i shmang udhëzimet e Zotit. Pa marrë parasysh të gjitha! Hyjnorja është shpesh në kundërshtim me rrugët tona njerëzore, dhe Zoti nuk mund të ndërrohet.

Zoti nganjëherë i fliste Catherine-s natën, nëpërmes të endërrave. Një natë prej netëve edhe pse llogariste në gjumë të mirë, porosia që pranojë bëri që t’i shtangohet lukthi. Ishte mesi i verës dhe ishte marrë vesh që të shkojë për një pushim treditör në përtëritjen shpirtërore ku merrnin pjesë edhe shumë meshtar nga ipeshkëvia. Kishte nevojë për qetësim, por Zotëria i besojë, tani, një detyrë shumë delikate, madje edhe të pakëndëshme!

E thirri udhëheqësen e sajë shpirtërore, motrën e nderit, Marinën dhe i tregojë: “Zotëria më ka zgjuar mbrëmë në ora tre pas mesnate. Ai më tha: ‘Shko e gjej Atë Simonin në ipeshkëvi dhe thuaj që ta heq kurorën prej kokës dhe le të ja kthej Mbretit, që të mos e humb shkëlqimin!’ si t’ja të bëj?”

“Duhet të shkosh dhe t’i thuash!” ia kthejë ajo

Atë Simoni ishte rregulltar dhe njerëzit në qytet e rrespektonin mendimin e tij. Catherine mendonte. Ashtu e brengosur, ju desht shumë kohë që t’i shqyrëtojë të gjitha mundësitë para se të vendoste: “Jo nuk do t’i them! Kush jam unë që të ja përcjell porosinë meshtarit?”

Disa net më vonë Zotëria e zgjojë përsëri: “A nuk kam kërkuar prej teje që të shkosh te Atë Simoni dhe t’i thuash që ta heq kurorën prej kokës dhe të ja kthejë Mbretit, që të mos e humb shkëlqimin!?”

Catherinë e thirri motrën Marinë përsëri dhe kërkoi këshillë. Përgjegja e sajë ishte i njejte:

“Ashtu vepro!”

“Nuk mundem. Si mund të ja them këtë? Edhe ashtu nuk do të më besojë!”

“Do të shohim a do të besojë apo jo. Gjithsesi duhet që të shkosh!”

Disa net më vonë Zotëria e zgjojë për të tretën herë Catherine-n në ora tre të mëngjesit. Kësaj rralle zëri ishte më këmbëngulës: “Kur të kërkoj prej teje që të shkosh, duhet të shkosh! Nëse nuk do, do të dërgoj dikend tjetër.”

Kështu Catherine vendosi që, përfundimisht, të shkojë. E thirri Atë Simonin dhe caktojë terminin për rrëfim atë mbrëmje. “Diçka nuk është në rregull?” e pyeti ai.

“Është shumë me rëndësi. Do të ju them kur të rrëfej mëkatet” – u përgjigj pa shpjegime të tjera.

U takua me Atë Simonin në sakristi dhe u rrëfye. Pataj ja përcolli porosinë, natyrisht, pa gabime. “Ja! Këtë ka kërkuar Zotëria prej meje që t’ua them. Kam frikë se nuk do të më besoni, por ja, ua thash dhe tani bëni si të doni.”

Pas një jave disa miq i kishin treguar se kishin qenë në meshë për festën e Krishtit Mbret dhe Atë Simoni kishte vënë atë kurorën e mrekullueshme! Gjithashtu i thanë se Atë Simoni tani ishte njeri tjetër. Njerëzit flisnin se duhet të ketë përjetuar ndonjë takim të fuqishëm me Zotin sepse ishte bërë më i butë dhe më i përshtatshëm, por edhe meshën e kremtonte ndryshe.

Në janar, motra Marina e thirri Catherine-n: Nuk do ta besosh”, i tha “Atë Simoni ra i vdekur në altar posa e dha shenjën e paqes!”

Vdekja e tij e hershme tërhoqi vemendjen e ipeshkëvisë. Një mëngjes, pak ditë pas varrimit, Catherine hyri në kishë dhe aty gjeti Bennie duke pastruar dyshemenë. U përshendetën dhe biseduan si mikeshat të vjetra: “Se çfarë humbje për ipeshkëvinë,” tha Bennie, “Pikërisht kur ndryshojë aq shumë. A e ke vërejtur?”

“Sigurisht!”, ia kthejë.

Catherine e donte shumë Bennie-n. Ishte gruaja më e përvuajt në qytet, gjithmonë e gatshme që të ju sherbejë të gjithëve. Ishte e thjeshtë dhe e dlië si burimi.

“Catherine,” pëshpëriti, “do të të them diçka por është fshehtësi.”

“Ma thuaj, Nuk do t’i tregoj askujt!”

Pasi u bind se askush nuk po i dëgjonte, Bennie tha: “Verën e kaluar dëgjova një zë në zemër i cili më tha: “Shko, gjej Atë Simonin dhe thuaj që ta heq kurorën prej kokës dhe të ja kthejë Mbretit, që të mos e humb shkëlqimin” E dija se po më flet Jezusi...”

E befasuar por e kujdesshme që të mos zbulohet, Catherine e pyeti: “Dhe çka ndodhi?”

Unë i thash; “Kurrresi!” Isha e frikësuar për vdekje! Thash: Kush? Unë? Të bëj diçka të tillë? Ti Jezus e di se unë nuk mund ta bëj këtë. Ai është meshtar e shiko kush jam unë! Jo, Jezus, më vjen keq, por duhet të gjes dikend tjetër!” Atëherë shkova te udhëheqësi i grupit karizmatik të lutjes, vetëm të shoh se çka do të thotë ai, por nuk më besojë.”

“E çka ndodhi pastaj? A të pyeti Jezusi përsëri?”

“Jo, si duket, ka gjetë dikend tjetër...”

“Të dashur fëmijë! ...Dëshiroj t’ju afroj sa më afër Jezusit dhe zemrës së plagosur të tij, në mënyrë që ta kuptoni dashurinë e tij të pamasë, e cila është flijuar për secilin prej jush. Prandaj, fëmijë të dashur, lutuni që prej zemrave tuaja të rrjedhë burimi i dashurisë drejt çdo qenieje njerëzore, drejt atij që ju urren dhe atij që ju përbuz. Kështu me dashurinë e Jezusit, do të ngadhënjëni mbi këtë mjerim në këtë botë të helmuar, e cila është pa shpresë për ata që nuk e njohin Jezusin. Ju faleminderit për të gjitha sakrificat dhe lutjet. Lutuni, që t’ju ndihmoj edhe më shumë. Kam nevojë për lutjet tuaja.

Ju faleminderit që ju përgjigjet thirrjes sime. (më 25 nëntor 1991)

4

FATI IM NË PLANETE?

Indi, vjeshtë 1972

Më shikojë ashpër. Majen e mjekrrës së hirtë e kishte të lidhur me një llastëk të zi ashtu si ishte zakon në kuartet e mbipopulluara të Delhit. Ishte shtator. Monsunet kishin kaluar dhe ajri nuk ishte aq i nxehtë. Nga dhoma, që shihte në rrugën e vogël e të ngushtë, mund të dëgjoheshin zërat e fëmijëve që luanin dhe jehona e thundrave. Shprehte qëndrimin indeferent të shenjtërve përkundër lopëve të uritura që zvarriteshin ngadalë në rrugë së bashku me shantit. Ndenjur ulur në lotus-pozitë, mbi çarshafët që pa dyshim para shumë vitesh kanë qenë të bardhë, fliste me një zë monoton si të lexonte ndonjë dokument të mërzitshëm administrativ. Megjithatë, dokumenti që mbante në dorë ishte *Libri i jetës sime!*

Kisha bërë një kontratë me Zotin

Si “katolike e mirë” e kohës së vet, ungjijjt i kam njohur mirë, letrat pak më dobët, e Besëlidhjen e vjetër edhe më dobët. Për mua ishte një ide e panjohur që në jetën time të plotësoj planin që Zoti ka për mua. Për më keq, nuk kishte asnjë mundësi që ajo ide të depërtojë deri në zemrën time, sepse, në mënyrë të pavetëdijshme kisha krijuar antitrupa të fuqishëm kundër sajë. Që prej moshës shtatëmbëdhjetë vjeçare konsideroja se është më së miri që për mua duhet të vendos vetë dhe të shkoj në kahjen që e zgjedh vetë. Mendoja se jeta ime do të shndërrohet në mundim dhe do të fundosem në depresion të thellë nëse Zotit i lejoj që ta drejtojë atë.

Pse mendoja në këtë mënyrë? Më dukej se përmendja e “vullnetit të Zotit” është i lidhur gjithmonë me katasrofë personale ose natyrore e cila posa ka ndodhur. Njerëzit thonë: “O, sa gjë e pikllueshme, pa i mbushur të tridhjetat, mbeti e vejë me fëmi të vogël...por, ky ishte vullneti i Zotit për të” ose “Të lutemi për këtë njeri të dashur që vuan nga sëmundja e pashërueshme dhe i

ka mbetur edhe dy muaj jetë. Të lutemi për të që të ketë guximin t'i thotë 'po', meqë ky është vullneti i Zotit për të" ose "Sa dëm që ky fëmi ka lindur i hendikepuar, nuk mund të shohë as të dëgjojë. Se çfarë kryqi për prindërit e tij! Por ky është vullneti i Zotit dhe atyre u duhet që ta pranojnë!" Nuk mund ta duroja "vullnetin e Zotit"! Mendoj se gjatë gjithë fëmijërisë sime nuk kam dëgjuar asgjë që kishte ndonjë lidhje në mes të *lumturisë* dhe vullnetit të Zotit.

Nëse dy vetë janë të dashuruar dhe notojnë në lumturi, pse nuk flasim për planin e mrekullueshëm të Zotit për ta? Pse duhet të presim që t'i godas katastrofa para se të përmendim vullnetin e Zotit?

Në moshën njëzet vjeçare, në mes të territ dhe të vuajtjes, hulumtoja për thirrjen time. Pse jam në këtë tokë? Apsolutisht nuk kisha asnjë ide! Natyrisht, më fascinonte madhështia e krishtenizmit, kurse personi i Jezu Krishtit ma mundësonte që të imagjinoj dimensionet e paskajshme dhe potencialin për lumturi të jashtëzakonshme. Por nuk isha e zonja që të shoh se si konkretisht këtë ta lidhi me jetën time studentore ose si ta lidhi veten me atë shkëlqim në të cilin kisha vetëm disa shikime afatshkurtëra, me shkëlqimin, vërtetë, më real se vetë dielli, por ende të pakuptueshëm për zemrën time të mbyllur e të bllokuar në natën e errët.

Kënaqesha me tregimet jetësore të apostujve dhe të krishterëve të parë, që përshkruhen në Veprat e apostujve. Feja e tyre ka mundur t'i lëkund malet dhe ata kanë mundur të deklarojnë pa frikë: "...Shpirtit Shenjt dhe ne..."¹⁰ sepse fuqia e gjallë e Shpirtit Shenjt ju ndihmonte në çdo situatë. Nëpër duart e tyre ndodhnin mrekulli. Natyrisht, edhe ata kohë pas kohe kalonin nëpër tundime, por vështirësitë i kalonin me gëzim që në fund të ngadhnjente dashuria. Derisa i lexoja këto rrëfime, në mes të territ tim, ndjeja se si një dritëz vibronte në thellësitë e zemrës sime. Dëshiroja të jem si apostujt! Sikur, për herë të parë u lidha me jetën për të cilën jam krijuar këmbë e kokë. Aventyrë, dashuri, pasion, gëzim, çfaqje e preکشme e qiellit! Po! E dua pikërisht këtë! Kështu, me këto fjalë, i ofrova Zotit kontratë, me shpresë se do ta trondis dhe motivoj.

"Zotëri, ku i ke apostujt sot! Ku janë ata, dëshmitarët e rinj të mbushur me ty që rreth vetes t'i mbledhin të tjerët si bletët në koshere me shpresë që njerëzit vetëm me preکشjen e hijes së tyre do të shërohen? Ku është ai 'Filip' të cilin Shpirti Shenjt e ka çuar që të ungjillëzojë dhe pagëzojë paganin vetëm pse ka kaluar pranë tij? Ku është ai 'Pjetër' fjalët e të cilit i kanë sjellë në Fe miliona Hebrenj? Ku është ai 'Pal' i cili me fjalimet e veta ju ka dhënë 'superdozë' të Shpirtit Shenjt paganëve të padijshëm?! Zotëri, kjo është jeta që dëshiroj me zjarr dhe të preکشtoj se se atë ditë kur ti të mi tregojsh apostujt e tillë, do t'i lë të gjitha dhe do të shkoj pas tyre!"

Por, Zoti ka oraret e veta dhe ndoshta është dashur ta shijoj mjerimin tim para se të isha e zonja t'i hapem planit të tij.

¹⁰ Vap 15,28

Libri i jetës sime në sanskrishte

Kur, një pasdite shtatori të vitit 1972 arrita në shtëpinë e atij hindusi, nuk e kisha idenë se si do të ndikojë ai takim në mua. Ministri i shtetit Punjab ma sugjeroi me ndergjegje, duke më thënë: “Nëse doni që të bashkëpunoni mirë me ministrinë e tregëtisë dhe të importoni prodhimet tona artizanale në Francë, duhet të vërtetohet se a është ai aranzhman vërtetë i shkruar në librin tuaj astrologjik. Përndryshe, projekti nuk do të ketë sukses, dhe mund ta harrojmë atë punë. Në pjesën e vjetër të Delhit kam një mik shumë të çmuar i cili ka punuar në shtëpinë e bardhë për kryetarin e SHBA, por edhe për zonjën Indira Gandhi. Ka dhurata të jashtëzakonshme, dhe sikurse, ndoshta, e dini shumë udhëheqës ndërkombëtarë kërkojnë këshillat e astrologëve indian që të udhëheqin më mirë me shtetet e tyre.”

Plani im ishte që të importoj në Paris veprat e mrekullueshme artistike dhe artizanale të prodhuara në Indi. Atëherë i kisha 24 vjet. Duhej që të merrja vendim profesional dhe isha e mashtruar duke pritur leximin e hartës natale.

Kështu pranova, kurse vetë ministri me përcolli deri në shtëpinë e astrologut indian. Ende nuk kisha shkelur si duhet në shtëpinë e tij kur më pyeti për datën, kohën dhe vendin e lindjes. Pastaj në një copë letre, vizatoi disa simbole të pazakonshme që nuk i përngjanin asnjë harte astrologjike të cilat i kisha parë në Europë. (Kur banoja në konvikt në moshën 15 vjeçare u futa në praktikën e astrologjisë dhe të ouija pllakave. Disa nga shoqet e mija të klasës nuk e bënë asnjë hap në jetë, para se të konsultoheshin me yjet apo tarot letrat, ose pa i pyetur shpirtërat që çfaqeshin me rastin e seancave tona me ouija pllakë. Natyrisht, as prindërit tanë as motrat tona të nderit, të asaj shkollë të mirë konvikto-re katolike nuk dinin se çka ndodhte fshehtas në kohën tonë të lirë.)

Ai nuk buzëqeshi, kurse unë ndjeva një dashakeqësi të pazakontë¹¹ Entuziazmi im naiv që më kishte nxitur për t’u konsultuar me të u zhduk shpejt dhe brenga ime u rrit. E muar letrën dhe u ngrit. “Kthehem shpejt”, më tha. “Po shkoj të marr librin e jetës Suaj nga biblioteka. E kam ditur se do të vini. Do t’ua lexoj. *Ai është libri i jetës suaj.*”

Fillimisht e shikova me dyshim objektin e pazakontë antik, pastaj ministrin tim duke pyetur: “Libri i jetës sime?”

“Po, “ tundi kokën.

¹¹Ajo urrejtje ishte vërtetë reale. Lexoni Hyrjen në librin e Malachi Martin – Hostage to the Devil (Pengu i Djallit); Harper, San Francisko 1992.; “Thelbi i adhurimit të djallit është urrejtja, sepse tani kryeengjëlli i rrëzuar mishëron urrejtje të plotë ndaj ekzistencës si e tillë. Urrejtjen ndaj jetës, dashurisë, bukurisë, lumturisë - ndaj çdo gjëje që e bën ekzistencën, të mirën më të madhe.”

Pastaj, prej teksteve sanskrishte fillojë të vizatojë shiritin kohor të ngjarjeve më të rëndësishme të jetës sime të deritashme, që nga lindja, vit pas viti. Foli për pozitën ekonomike dhe shoqërore të familjes sime, rendin e lindjes së vëllëzërve dhe motrave të mia, dhe statusin ekonomik të gjyshit tim. Foli edhe për sëmundjet e fëmijërisë sime (për të cilat unë në atë kohë as nuk e dija se i kisha kaluar), nivelin e arritur të arsimimit, koeficientin tim të inteligjencës, jetën time emocionale dhe hulumtimin tim shpirtëror. I përshkroi edhe disa persona të rëndësishëm që kishin luajtur rrol të dukshëm në jetën time. Atëherë arriti te viti i 24 i jetës sime. Duke folur, fjalët e tij shndërroheshin në profeci të ardhmërisë sime. Për shembull, duhej që të pasurohesha shumë dhe të jetoja në një qytet në bregdet.

Ndjeja një shqetësim në rritje. Prej tij rrezatonte një shikim depërtues, i ftohte, metalik. Më parë do të mund të thuhej që kishte një shëmti të krijuar nga urrejtja në sytë e tij. Fliste për çastet intime të jetës sime si të diktonte ekuacionet matematikore. Shpjegoi çdo element, çdo ngjarje në jetën time në varësi të pozitës dhe të lëvizjes së yjëve.

“Keni zgjedhur këtë ose atë drejtim në studimet Tuaja, për shkak se Marsi i afrohej Jupiterit. Pastaj në një periudhë tjetër, kur Saturni lëvizte në atë kahje, dhe Arusha e madhe ishte në atë pozitë, ka shkaktuar që në atë çast të ju tërheqte një person i këtillë ose i atillë.”

Thënë shkurt, ai astrolog profesional më shtyri të pranoj se rrjedha e jetës sime varet nga pozita e yjëve dhe planeleve. Kur arriti deri te viti im i tridhjetë, duke i përshkruar gjashtë vitet e ardhshme të jetës sime, u ndal dhe tha: “Këtu përfundon pjesa e parë. Po shkoj në bibliotekë për të marrë pjesën e dytë të Jetës sate.”

Këtu u mbush kupa. Duke shfrytëzuar ndërprerjen, vendosa të ngritem dhe të iki.

“Jo” i thash. “Kjo do të më mjaftojë. Nuk dua të di pjesën e mbetur të jetës. Ju falemnderit, po shkoj!”

Ministri ishte i befasuar me vendimin tim dhe i murmuriti diçka mikut të tij mbi të huajt që nuk dinë t’i vlerësojnë pasurinë e kulturës hinduse.

Kur dola prej shtëpisë dielli ishte në zenit. Depërtoja nëpër tollovinë e rrugës, kurse tronditja nga drita e fortë e diellit, shpejt më detyrojë që të kthehem në realitet. Por e ndjeja se nuk jam si përpara. Sa do që përpiqesha ta bind veten se ajo që kisha përjetuar nuk është asgjë, duke I thënë vetes: “harroje, nuk është me rëndësi”, djehesha gjithnjë e më e shqetësuar, kurse paqa u zhduk krejtësisht nga zemra ime. Ai njeri më kishte vaksinuar me një dozë suptile helmi dhe tani në mua ishte paraqitur ankthi. Kur, më në fund u bashkovë me shokët në New Delhi, që i kisha si familje të dytë, shpërtheva në lot, as miqësia e tyre, as fjalët ngushëlluese të tyre nuk ndihmuan që të nxjerr atë shigjetë helmuese nga zemra ime e shporruar.

Pse isha aq e thyer? Ndonse takimi ishte i shkurtë, *ai njeri më bëri jetime. E kisha humbur Atin tim Qiellor*. Para kësaj, besoja në Të. Ai ishte Krijuesi im, Burimi im, Rrënja ime, Prejardhja ime.

Besoja se më ka krijuar nga dashuria. Besoja se e mbante botën në duar dhe se dashuria do të ngadhënjë. E dija se vendi im është në Të. Pastaj, ai astrolog brilant më bindi se asgjë prej këtyre nuk ishte e vërtetë dhe se jeta ime është rezultat pavarësor i ngjarjeve planetare. E pashë veten të varur nga planetet - për të cilat nuk dija asgjë - nga ato objekte të pa arritshme, të mëdha, të ftofta e të largëta. Ndjehesha si akull. Astrologu, në mënyrë precize i kishte përmendur ngjarjet e rëndësishme të jetës sime duke i lidhur me planetet dhe me yjet. Si mundet, atëherë, ardhmëria ime të formësohet nga zemra ime e lirë? Ai njeri më kishte vënë zgjedhën e cila më revoltonte dhe më frigonte. Nuk e doja por nuk kisha zgjedhje. U bëra e burgosur e fatit.

Kur u ktheva në Francë, përsëri fillova me aktivitetet e mia por, pak nga pak, prej ditës në ditë, ndjeja se si gjendja ime e brendëshme po keqsohej. Përpara kisha një natyrë goxha pozitive, por tani, kanceri i fshehur e brendte shpresën time. Simptomat e pazakonta filluan të dalin në sipërfaqë. Për shembull, natën zgjohesha dhe thoja fjalë urrejtjeje kundër këtij ose atij personi, pa asnjë arsye. E humba oreksin dhe u dobësova në trup. Por më e keqja e të gjithave ishte vuajtja e pa përshkrueshme që ma coptonte zemrën. Në heshtjen e vdekur të natës, ajo dhëmbje u bë e padurueshme. Pas nëntë muajsh jetese në atë vrimë të zezë, kalova vijën që ndan jetën nga vdekja dhe mendimi për vetëvrasje m'u bë opsion.

Pas orës pesë nuk do të jem më

Një ditë qerrshori të vitit 1973 motra ime Marie Pia erdhi të më vizitojë. Sado që u përpoqa t'i fsheh ndjenjat e mia prej sajë, ajo e kuptonte gjëndjen time të tmerrshme dhe më tha: "Emmanuelle, nesër janë Rrëshajët. Eja me mua, kam gjetur një grup të jashtëzakonshëm lutjeje. Do të kenë takim për të festuar Shpirtin Shenjt! Eja. Shpirti Shenjt do të bëjë diçka për ty!"

"Shpirti Shenjt i yti është shumë i mirë, por ai nuk mund të bëjë asgjë për mua!" Motra u largua e shqetësuar por munda të përshkruaj saktësisht vendin ku duhej mbajtur takimi i lutjes.

Ajo natë ishte ferr i vërtetë. E ndjeja se nga brenda diçka po më shqyente dhe thërmonte. Në mëngjes, nuk munda më të ballafaqohem me jetën. Mendimi se po mbijetoj prej orës në orë m'u bë i padurueshëm. E pa aftë për të jetuar, i drejtova Zotit lutjen time të fundit. Ishte e shkurtë por e vërtetë: "Zotëria im, shih, as një ditë më nuk do të jetoj. Pra, po të them, para orës pesë do të vdes. Po ta tërheq vërejtjen, mori fund!"

Kur u ngrita, në vend se të sillem pa cak nëpër banesë, vendosa të dal dhe të kërkoj motrën time. Me të arritur tek Rruga e Shelbimit në kuartin e 16 të Parisit, takova nja tridhjetë vetë që dukeshin si të kishin ardhur prej një bote tjetër. Maria Pia kishte të drejtë. Ai grup ishte fantastik. Gëzimi i tyre, liria e tyre, dashuria e tyre e ngrohtë, të qeshurit e tyre! Aty për aty më shndëriti mendimi: "Ja ku janë!" Po, këtu janë të krishterët e parë, ata apostujt të cilët kam dëshiruar kaq gjatë për t'i parë faqe faqas!

Por, ishte shumë vonë! I shikova si në film. Në mes nesh ishte një humnerë e pakapërcyeshme. Edhe ashtu isha në anën tjetër, në këtë luginë të vdekjes shpirtërore, ku asnjë dorë shpëtimtare nuk mund të më arrinte. Tani më e kisha nënshkruar urdhëresën për ekzekutimin e dënimit me vdekje dhe ndjehesha e bmyllur përbrenda. E dija se do ta përfundoja jetën time në ora pesë. Kurse ata gjëndeshin në dritë. Mrekulli!

Si klysh ndiqja motrën time dhe më nuk mund të frenoja prroin e lotëve. E panë të gjithë, por nuk mund të bëja asgjë. Luteshin si engjëjt, dhe mendimi me të cilin reagoja ishte negativ dhe si jehonë kthehej prapa në çdo fjali lavdërimi të tyre. “Zotëri, e gjithë jeta jonë nuk mjafton për të të lavdëruar!” – thonin me gëzim të madh.

Kurse unë përgjigjesha me mendime: “Ka zgjatur mjaft, jeta ime!”

“Ecja drejt vdekjes”

Pas dreke pasojë takimi tjetër në të cilin të gjithë luteshin spontanisht. Ishte ora tre e gjysëm. Afrohej fundi im. I kisha thënë Zotit – në ora pesë. E mbushur me dëshprim gjithpërfshirës, qëndroja në mes të grupit si robot dhe nuk i kushtoja vëmendje lutjeve të tyre.

Rreth orës katër arriti edhe një grua e cila ju bashkua grupit. Ishte vonuar shumë duke humbur pjesën më të madhe të programit. Quhej Andrée Thomae. Nuk e vërejta por në mesin e tridhjetë katolikëve që atë ditë morën pjesë në lutje, ajo ishte e vetmja protestante. Posa arriti fillojë të lëkundej në karrige. E dinte se diçka nuk është në rregull me një person në dhomë. Zotëria e kishte shndëritur, dhe e ndjente për detyrë që këtë t’ua shpalle të gjithëve, përkundër frikës se do të jetë e përqeshur, për shkak të porosisë e cila i ishte dhënë që ta thotë me zë. Nuk ishte e sigurt se a do ta pranohet grupi atë që Zotëria i kishte bërë me dije.

E rraskapitur si e pa fat, me kokën poshtë, papritmas dëgjova zërin prej grupit i cili më nxori nga gropa e zezë. Në mes të lutjeve të mrekullueshme, fjalët e sajë më goditën si rrufeja! Toni i zërit ishte dramatik. Andrée nuk mund të duronte më dhe me autoritet proklamoi atë që Zotëria i kishte zbuluar:

“Vëllëzër e motra, në mesin tonë është personi që shkon drejt vdekjes së vet. Ai person i ka lejuar Armikut që ta mashtrtojë dhe ka bërë atë që Zotërisë, kurrsesi, nuk i pëlqen. Ka praktikuar thirrjen e shpirtërave nga pllaka ouija dhe parashikimin e ardhmërisë dhe djalli e ka lidhur. Por Krishti ka fuqinë që ta nxjerr nga duart e Armikut dhe ta kthejë në jetë. Le të lajmërohet dhe do të lutemi për të në emër të Jezusit.”

Të tubuarit ishin të shokuar. Kurse mua, zemra më rrihte me forcë me që fjalët e para të porosisë ishin: “Personi i cili shkon drejt vdekjes së vet”. Dukej qartë se ishte fjala për mua!. Pyetësja: “A thua Zotëria i ka treguar kësaj gruaje që kurrë s’e kam parë, gjëndjen e shpirtit tim?” Dhe çka mendon me: “*ka bërë atë që Zotërisë, kurrsesi, nuk i pëlqen*”?

Tani ishte rralla ime që të lëkundem në karrigë. Në vete ndjeja nevojë të madhe që të vrapoj drejt asaj gruaje dhe memzi prisja që të përfundojë koha e lutjes! Ishte ora katër e gjysëm kur u këndua kënga e fundit dhe po atë çast vrapova drejt asaj gruaje që nuk e kisha njohur kurrë.

“Zonjë, keni folur për personin që shkon drejt vdekjes.” Si lajmëtari autentik i Zotit, Andrée më përshëndeti hapur dhe pa njerzillëk të tepërt. Aty për aty, kalojë në atë që ishte e rëndësishme. Si apostull, ishte e vetëdijshme se situata nuk është në duart e sajë dhe se bëhet fjalë për jetën e çmueshme.

O, ju jeni personi! Mirë, ejani këtu. Çka keni bërë? Keni shkuar në taborrin e armikut! Keni shkuar te astrologët dhe parashikuesit e fatit, apo jo? Dhe keni marrë në pyetje shpirtërat e të vdekurve! Keni praktikuar thirrjen e shpirtërave me anë të ouija pllakës!”

“Po, e kam bërë qysh në moshën e adoleshencës me shoqet e mia. Nuk e kam ditur se...”

“Por kjo është e shkruar në Bibël! Zoti i ka tërhequr vërejtjen popullit të vet shpesh herë. Të gjitha këto janë të neveritshme para syve të tij! – A besoni në Krishtin?”

“Po, unë jam e krishterë.”

“Mirë, prisni këtu, do t’i thërras edhe dy-tre persona që të luten për ju. Nuk dua që të lutem vetëm. Krishti ka thënë: ‘Sepse, ku janë dy ose tre vetë të bashkuar në emrin tim, aty jam edhe unë, midis tyre.’”¹²

Jezusi ka pushtetin që të shkëpusë varësitë tua

Ishte qerrshor. Më çojë në kopshtin të mrekullueshëm me lule, të Motrave të shëlbimit. Aty ishte një bangë. Duke parë se si isha e rraskapitur, më tha që të ulem, por ajo vazhdojë të qendrojë së bashku me shokët e sajë të cilët më kishin rrethuar. U gjenda në një situatë të pabesueshme dhe e gjithë kjo u bë edhe më e çuditshme kur papritmas filluan të këndojnë në gjuhë! Pyetësha se çka më gjeti që të lëshohesha në duart e atyre njerëzve të krisur!

Andrée me dorë mjeshtërore udhëhiqte procesin dhe më bëri pyetje për besimin që duhej të tregonte se a është e mundur fitorja: “Ke hyrë në kthetrat e Armikut. Ai të ka lidhur dhe të mundon. Qëllimi i tij është të të vrasë. Por Jezusi e ka mundur në Kryq. A beson se edhe sot Ai ka pushtetin që të zgjidh prangat tua, ashtu që të jesh e lirë për të ecur në dritë?”

¹² Mt 18,20

Isha e hutuar nga kjo pyetje. E shikova Andrée-në, atë grua aq të thjeshtë, në dukje të parë e varfër, e cila pothuaj kishte më shumë se njëqind kilogram, por kishte fenë e fëmiut, e gatshme që t'ua ndërrojë vend maleve. Kisha 25 vjet, dhe për të parën herë dëgjoja se dikush kështu flet për Jezusin. Për Jezusin i cili mund të bënte diçka të mirë për mua? E pikërisht tani, sot? Pikërisht ashtu si shkruan në ungjijt?

“Po, besoj” Zëri im ishte i dobët, sepse në të vërtetë do doja të besoj më shumë se sa besoja realisht.

“Mirë! Do të themi lutjen e lirimit. Demonët që i ke pranuar në jetën tënde do të ndiqen me fuqinë e Emrit të Jezusit.”

Në atë kohë nuk e kisha idenë se çfarë kuptimi kishin ato fjalë-të gjitha ishin të reja. E mendoja zemrën time si dhomë në të cilën kisha lejuar që të hyjnë shkatruesit dhe se ata do të vihen në ikje posa të dëgjojnë emrin Jezus.

“Andrée, madje edhe nëse më liron Jezusi, më me dëshirë do të vdisja sepse demonët i kanë shkaktuar aq shumë dëm zemrës sime. Nuk mund ta duroj më këtë vuajtje.”

Por, Andrée nuk mundej aq lehtë. Ishte ungjillëzuese me përvojë! “Nëse beson se Jezusi ka pushtet që të dëbojë demonët që të kanë dëmtuar, a nuk do të besosh se ka pushtetin edhe të të shërojë?”

Fjalët e sajë më ndihmuan që të zbuloj edhe një aspekt të karakterit të Jezusit. Se mund të më shërojë? Dhe pikërisht tani? E gjithë ajo që dija për Të, ishte e mjerë. Për mua Ai ishte definitivisht Shpëtimtar, por Shpëtimtar që ka shpëtuar mbarë njerëzimin në të kaluarën, por jo personalisht i pranishëm afër meje sot. Papritmas fillojë t'i përngjajë Jezusit nga ungjijt, atij që e ka liruar Samaritanen, dhe atij që e ka shëruar të verbërin në kohë të caktuar dhe vend të caktuar. Ai ishte Shpëtimtari im personal i cili vërtetë ishte i gjallë pikërisht atë ditë!

“Po, besoj se mund të më shërojë!”

“Dhe, a pranon që të ndërpresësh gjithë ato neveri? Duhet të jesh e kujdesshme! Sepse, nëse do të përsëritësh diçka të tillë, gjendja do të keqsohej edhe më shumë!¹³ Dëgjo...” Fillojë të lexojë Ligjin e përtërirë, kapitullin e tetëmbëdhjetë, rreshtat 9-14.

“Kur të kesh hyrë në tokën që Zoti, Hyji yt, mendon të ta japë, ruhu e mos të pëlqejnë punët e poshtira të atyre popujve. As të mos gjendet ndokush ndër ju që ta bëjë të kalojë djali ose vajza e tij nëpër zjarr, që të merret me shorti, me shqyrtim resh, me këqyrje shpatullash, që të bëjë magji, që të shitojë, që të thërrasë shpirtërat e të vdekurve, ose xhindet, ose të kërkojë të vërtetën prej të vdekurve; sepse të gjitha këto i urren Zoti dhe për shkak të këtyre paudhësive Zoti ata do t'i

¹³ Mt 12,43-46

dëbojë para teje. Ji i përsosur dhe i patëmetë me Zotin, Hyjin tënd. Popujt, tokën e të cilëve do ta bësh pronë, i dëgjojnë shortarët e falltarët. Kurse, ti ke qenë i mësuar ndryshe prej Zotit, Hyjit tënd.”

Vazhdojë të shpjegojë çdo rresht. Ishte aq e drejtpërdrejtë dhe e qartë. Memzi kishte fjalë të mjaftueshme për t’u shprehur, por kur bëhej fjalë për urtinë e Zotit, posedonte inteligjencë shpirtërore që të befasonte.

“Mund të llogarisësh në mua”, i thash. “Nuk do ta bëj dy herë të njëjtin gabim!”

Nuk kishte kohë për të humbur. Andrée dhe shokët e sajë filluan të lëvdojnë Zotin me gëzim dhe fe. Pataj Andrée tha lutjen e fuqishme ndërmjetësuese për mëkatëren çfarë isha unë. Ajo ju urdhërojë demonëve (të cilët një nga një i quajti me emër) që të largohen prej meje. Shkëputi lidhjen me mallkimin të cilin ma kishte imponuar astrologu hindus në Delhi që më shkatrronte pa mëshirë. Në fund, pas lavdërimit dhe bekimit shtesë - heshtje. U krye.

“Ja, kemi përfunduar,” tha. “mund t’i bashkohesh grupit për meshë, por vazhdo të lavdërosh Zotërinë dhe vendosu nën Gjakun e Tij të Paçmueshëm. Të duhet mbrojtja e tij!”

Nuk do ta harroj kurrë atë çast kur u ngrita prej bankës. Gjatë lutjes nuk u dridha, nuk shpreha kurrfarë emocionesh, asgjë. Por posa u ngrita, kuptova se vuajtja ime ishte zhdukur! Tërë kohën mbaja dorën në zemër, përsëri dhe përsëri, si dikush që kërkon kuletën ose syzet. Vuajtja ime - ishte zhdukur! Jezusi vërtetë kishte ardhur. Vërtetë e kishte kryer punën e tij si Shpëtimtar dhe përsëri ma kishte dhënë jetën!

Shikova orën. Akrepat tregonin saktësisht orën pesë.

Kisha caktuar takimin me Vdekjen pikërisht në pesë pas dite, por kur erdhi ajo kohë, erdhi Zoti i gjallë, e jo Vdekja. Duart e Jetës pranuan ekzistimin tim të shkatrruar e të mjerë. Pranë vetes ndjeja Bariun e Mirë. Ai zbriti në hendekun tim të ndyrë dhe më nxori prej andej duke marrë mbi vete plagët e mia të vdekjes në trupin e tij. E ndjeja se si jeta e tij ndikon në mua si rrëke gëzimi. E gjithë qenia ime notonte në gëzimin e rilindjes!

Jezusi, miku im ma i madh

Atë mbrënje ja dorëzova jetën time Zotit me fjalët: “Zotëri, pata planifikuar që sot të vdes. Por ti e more mbi vete vdekjen time dhe ma dhe jetën tënde. Prandaj pjesa e mbetur e jetës sime të takon ty. Merre!”

Gjatë meshës qeshja prej gëzimit! Në fund, bariu i grupit tonë i thirri disa prej nesh që të dalim përpara për të pranuar derdhjen e Shpirtit Shenjt. Një grup i vogël lutej për secilin. Krejt çka

mund të bëja ishte që të përseris se e gjithë jeta ime është për Të. Nën duart e bekuara të të mrekullueshëmve vëllëzër dhe motra, ja hapa zemrën Shpirtit Shenjt. Ai e preku vendin e sëmurë në mua, vendin ku ishte verbëria ime shpirtërore. Më përshkoi një dritë depërtuese, e qartë si kristali: Vullneti i Zotit është jeta, jeta ime personale mund të sjellte vetëm vdekje. Kjo ishte e pa shmangshme!

Nëse para kësaj nuk kisha besim në vullnetin e Zotit dhe nëse druhesha prej tij thua se është një ortek fatkeqësie, këtu mu duk se ai është diçka krejt e kundërt. Do t'i gëzohem dhe do ta kërkoj me krejt qenien time, sepse vullneti i tij është Jeta ime! Atë mbrëmje fitova frikën shenjte, frikën nga mospërmbushja e vullnetit të Zotit. Shpirti Shenjt ma hapi qasjen visarit të tij, m'i dha shtatë dhuratat e tij. Sidomos atë që e quajmë "frikë shenjte e Zotit." Është fjala për frikën që të mos e knaqim atë që e duam!

Atë natë fjeta si e posalindura në zemrën e së ëmës dhe prej asaj dite për mua fillojë jeta e re. Lumturia ime ishte aq e madhe sa shetisja me motoçikletën time rrugëve të Parisit dhe kërceja në ndenjese prej gëzimit. Jezusi u bë miku im më i mirë dhe me Të këshillohesha për çdo gjë sepse më printe në çdo vendim që duhej të merrja.

Pastrimi radikal i brendëshëm

Shpesh e vizitoja Andrée-në, e cila kujdesej për lirimimin dhe ungjillëzimin e njerëzve nga kuartet më të vërfëra të Parisit, sidomos për prostitutat. Me Paul-in, bashkëshortin e sajë, i takonte kishës shumë të gjallë Pentakostale, kurse që të dy dëshironin që të futeshin në mesin e katolikëve nga dëshira e sinqertë që të jenë "të bashkuar në Krishtin." Jetonin në një banesë aq të vogël sa Andrée memzi mund të sillej në kuzhinë. Por për mua ishte si një kënd parajse! Ajo e njihte aq mirë Biblën. Për çdo situatë do të citonte ndonjë rresht prej Biblës: Krishti ka thënë...Pali ka thënë...Moisiu ka thënë', dhe shndriste zemrën time me rreze drite prej Biblës. Shpirti im atëherë ishte i kënaqur, kurse zemra e mbushur me atë fishekzar. Largohesha e mbushur me gëzim, e aftë që të ju ndërroj vend maleve.

Pak kohë pas "lirimit" tim ma shpjegojë se çka në të vërtetë më kishte ndodhur në Indi me atë astrologun. Gjithmonë më befasonte me njohjen e gjërave. A thua si ka mundur ai ta lexojë të kaluarën time në librin e vjetër? Prej nga në bibliotekën e tij të gjendet libri i jetës sime?

"Ke lejuar që të të mashtrojë Armiku," më tha Andrée. "Tërë kohën të ka gënjer, kurse ti, nuk ke qenë në gjendje ta vëresh këtë sepse nuk e ke njohur shumë mirë Fjalën e Zotit! Megjithatë, Zoti ua ka tërhequr vërejtjen njerëzve të vet!" Pataj më ndihmojë të kuptoj kapitullin kyç në Bibël. Ligji i përtërirë kapitulli 18 flet për profetët. Ndonse isha katolike, atë kapitull nuk e kisha lexuar kurrë as nuk e kisha dëgjuar në meshë.

“Shiko”, tha “për shkak të padijenisë sate ke shkuar te Armiku, ke shkuar në taborrin e tij dhe ke anuar kah neveritë e tij. Ai i ka shfrytëzuar ato, të të lidh! Astrologu ka qenë instrumenti i tij.¹⁴ E kishte lehtë me ty sepse ishe e hapur për gënjeshtër. Nuk është dashur të jesh aq naive! Sa njerëzit shkojnë tek fallxhorët, astrologët, pastaj bëhen opsisiv, depresiv dhe anojnë kah vetëvrasja!¹⁵ Libri që ka mbajtur në dorë ka qenë ndihmesë për profecitë e tij. Informatat i ka marrë prej djallit duke u shtirë se po lexon. Ska se si, se do të besosh se një hindus e ka shkruar librin e jetës sate në sanskrishte para një mijë vitesh, apo jo? Por djalli e njeh të kaluarën. Ai është engjull. Kjo është e lehtë për të! Ai nuk e din ardhmërinë tënde por është inteligjent dhe mund të imagjinojë dhe hamendësojë në mënyrë inteligjente në bazë të të kaluarës dhe të tashmes sate.”

“Ato që të ka thënë ishin gënjeshtër. Fjala e tij është fjalë vdekjeje e cila çon në vdekje. Plani i tij ishte të të vrasë nga brenda. Me fjalën e vet ai të ka mallkuar dhe më nuk ke qenë e lirë. Vetë Krishti të ka liruar nga prangat tua kur e kemi thirrë mbi ty, Emrin e tij Shenjt dhe Gjakun e Tij të Paçmueshëm. Krishti ka fjalët e Jetës së Pasosur, dhe nëse e ruan Fjalën e tij, ai banon në ty. Nëse përsëri të paraqiten në mendime gënjeshtër e atij fallxhori që të të pengojnë ose të nxisin

¹⁴ Shumë njerëz hyjnë në botën okulte duke dashur të dinë të ardhmen e tyre. Në mesin e praktikave të këqia që japin premtime të rrejshme në lidhje me këtë është astrologjia, leximi prej shuplakës, të qiturit fall me tarot letra, ouija pllaka ose sfera e kristaltë. Disa kërkojnë bashkësi me të vdekurit nëpërmes të seancave. Kurse disa të tjerë provojnë të praktikojnë “magjinë e zez” nëpërmes të magjive, vudu ose ritualeve satanike duke përfshirë këtu edhe “meshën e zezë”. Dhe derisa rreziqet shpirtërore gjatë ushtrimit të disa praktikave janë të qarta, në disa të tjera nuk janë, sikurse është rasti me rreziqet e mundshme shpirtërore për katolikët të cilët praktikojnë yogë-n. Shiko artikullin e Joel S. Peter me titull “Yoga & Christianity” (Joga dhe krishtërimi) në revistën New Oxford Review (shkurt 2006).

Për dallim prej praktikave okulte tradicionale, filozofitë dhe praktikat e reja karakteristike për “New Age”, me të cilat jemi të rrethuar sot, janë brengë e madhe për Vatikanin. Lexoni studimin e përbashkët që kanë publikuar dy këshilla papnorë – për kulturë dhe dialog ndërjetar me titull Jezus Christ, the Bearer of the water of life: A Christian Reflection on the New Age. (Jezu Krishti bartës i ujit të gjallë: Reflektim i krishterë për New Age) – (web faqja e Vatikanit: www.vatican.va)

Në mesin e pikave karakteristike të New Age janë:

- 1.) besim i madh i jepet meditimit të entiteteve të ndryshme shpirtërore;
- 2.) qeniet njerëzore janë të afta të ngriten deri te sferat e larta e të padukshme dhe të kontrollojnë jetën e tyre pas vdekjes.
- 3.) konsiderohet se ekziston ‘dija e amshuar’ që paraprin dhe është superior ndaj të gjitha religjioneve dhe kulturave.

Ata që praktikojnë filozofinë e New Age përpiqen që të harmonizohen sipas shpirtit universal ose të lëshohen në ‘udhëtimin astral’ nëpërmes të praktikave çfarë janë meditimi transcendental, channeling, engram, krisalet ose “vorbullat” në natyrë. Shtesa e këtij studimi përmban bibliografinë dhe fjalorin e terminologjisë.

¹⁵ Kishte të drejtë. Asnjë nga parashikimet e astrologut nuk u realizua pasi që Andrée ndërpreu lidhjen e cila më mbante të burgosur. Thënë shkurt, gënjeshtari kryesor vërtetë gënjente, kurse Shpëtimtari im kishte plan shumë më të mirë!

ankthin, refuzoi dhe dhe shpall me forcë se i takon Krishtit. Lavdëro Emrin e Tejetshenjtë Jezus dhe mbulohu me Gjakun e Tij të Paçmueshëm. Armiku do të vihet në ikje.”

Me Andrée-jën zbulimet e mia për pushtetin e Krishtit dhe për demonologjinë ishin në një farë mënyre eksperimentale. Më vonë, me një shikim të ri, lexova Ungjillin dhe jetën e shenjtërve. Tani isha e zonja që t’i prek, që t’i njoh në jetën e përditshme. Jezusi u bë real!

Ditën e lirimit tim, bisedova me Andrée-jën dhe me Paul-in për vllaun tim Bruno, i cili poashtu vuante, nga ankthi vdekjeprurës, sepse ashtu si unë, kishte bredhur shtegut të gabuar dhe kishte bërë marrina. Ajo u pajtua se do të lutet dhe kujdeset për të. Pastaj me motrën time Marie Pia përpilova planin në dy faza: së pari, motra ime do t’i shkruaj një letër me të cilën do ta informojë se i ka zbuluar njerëzit që luten si të krishterët e parë, dhe se do të jetë i mahnitur kur t’i takojë. Pataj do të duhej të veprojmë unë. Posa ai ta marrë letrën, papritmas do ta thërras dhe do t’i tregoj të njëjtën gjë, dhe se jeta ime kishte marrë një kthesë në të mirë drejt lumturisë së plotë. Dhe, pati sukses! I ballafaquar me mundësinë që të përjetojë diçka të mirë, vëllau im e pranoi ofertën pa asnjë rezistencë. Të nesërmen e njoftuam Brunon me Andrée-jën dhe me Paul-in. Vëllau im përjetojë atë ditë kthim të rrënjësishëm, u bë besnik ndaj Krishtit me gjith zemër dhe qysh atëherë nuk e braktisi më. Gjithashtu pati dobi nga pastrimi i rrënjësishëm i brendëshëm, duke iu falenderuar kujdesit të mirë të Andrée-së. Edhe ai e kuptojë se Jezusi është Shpëtimtari i vërtetë! Aty e tutje, ne të tre, morëm mbi vete brengën për pjesën tjetër të familjes. Zotëria i shpërbleu me begati iniciativat tona, si të kthyer të ri, duke zgjidhur nyjet, një nga një... ato nyjet e vjetra familjare, aq thellë të rrënjësura, që është vështirë të qiten në dritë dhe të zgjidhen.

Qemë të shpëtuar me mëshirën e Zotit. Pasi që e shijuam frytin e hidhur të territ dhe ishim në prag të vdekjes, sot falënderojmë Atë i cili na çon prej vdekjes në jetë - nëpërmes të Gjakut të Tij të derdhur në Kryq.*

*Lexoni librin: Ransomed From Darknes, The New Age, Christian Faith and the Battle for Souls (Të shpërblyerit nga terri, New Age, feja e krishterë dhe beteja për shpirtërat) i autores Moire Noonan, e cila është marrë me shumë New Age praktika prej shamanizmit deri te reiki, prej telepatisë deri te hipnoterapia, por më vonë kaloi në katolicizëm, pjesërisht duke iu falenderuar përvojave të sajë në Megjugorje. North Bay Books 2005, US\$ 15. Linku për shkarkimin e librit nëpërmes të web faqes [www.Amazon.com](http://www.amazon.com/Ransomed-Darknes-Christian-Faith-Battle/dp/0972520074): <http://www.amazon.com/Ransomed-Darknes-Christian-Faith-Battle/dp/0972520074>

„Të dashur fëmijë! Hapni zemrat tuaja dhe lejoni Jezusit që të ju prijë. Për shumë njerëz kjo duket e vështirë, megjithatë kjo është aq e lehtë! Nuk duhet të keni frikë sepse e dini se Jezusi, kurrë, nuk do të heq dorë prej jush dhe e dini se ju prin drejt shpëtimit.“ (11. gusht 1986.)

5

FËMIJA DO TË JU PRIJË

Si luante Jezusi, kur ishte fëmijë? Disa mistik na tregojnë se Jezusi Fëmijë vinte për të luajtur me ta kur ishin të vegjël, dhe ata mendonin, atëherë, se edhe të tjerët mund ta shohin. Kështu ishte me Georgette Faniel¹⁶, e cila prej moshës së sajë pesë vjeçare ka kaluar me Të, orë dhe ditë të tëra. Ungjillëzimi i fëmijëve me anë të fëmijëve është njëri prej aspekteve më spektakulare nga lëmia e mistikës. Ato, në të vërtetë, janë paraqitje të shkurtëra, por për nga thellësia e tyre janë të denja për etërit kishtar, dhe është shumë më lehtë të kuptohen.

Nuk mund të mos citoj këtu disa biseda të çmuara në mes të Jezusit Fëmijë dhe katërmbëdhjetë vjeçarit Van nga Vijetnami.¹⁷

Van: „Jezus, Kur ishe në tokë, a ke ngrënë peshk? A je ushqyer ashtu si unë?“

Jezusi: „Natyrisht se jam ushqyer ashtu si ti. Nganjëherë kam ngrënë mish, nganjëherë peshk, nganjëherë perime, por Maria dinte të përgatiste vërtetë ushqime të mira; të cilat fare nuk ishin si këto që han ti!“

Van: „A mund t'i thuash Marisë që të më mësojë, ashtu që edhe unë të pregatis ushqime të shijshme, kur të më duhet të ziej? Por, si qëndron puna me ty, Jezus, ti a di të ziesh?“

Jezusi: „Po, di. Kur isha i vogël, gjithmonë isha pranë nënës sime, sepse e doja shumë. Kur isha pranë sajë, qëllimi im ishte, gjithmonë, t'i ndihmoj që t'i kuptojë gjërat hyjnore. Maria më donte shumë, dhe unë, zakonisht, dija që t'i bëj të gjitha që i bënte ajo.“

¹⁶ Lexoni kapitullin „Histori i një shpirti tjetër“ në librin „Mrekullia e Megjugorjes“, faqe. 81

¹⁷ Fragmente nga libri „L'Amour me connaît“, Le Sarmant Fayard, Paris. Msgr. Nguyen Van Thuan drejton çështjen për shpalljen e Vanit të lumturuar. Shikoni Oeuvres complètes de Marcel Van, dhe Quel est ton secret, petit Van?, St Paul/Les Amis de Van, Versailles, Marie Michel, Van ou l' enfant aux mains vides, Jubilé Sarmant, 1999. Informata për Van-in mund të kërkonin në adresat e internetit: m-a-j@wanadoo.fr i amisdevan@aol.com; marcelvan.canalblog.com. ose me telefon: +33-148-56-22-88.

Van: „Jezus i vogël, ka kohë që dëshiroj të të pyes diçka. Të lutem m'u përgjigj, a bën? Njerëzit thonë se kur ke qenë i vogël, ti kurrë nuk ke qeshur as nuk ke qarë, se ke qenë i urtë, edhe kur ke qenë i uritur dhe se ke pranuar që Virgjëra Tejet e Shenjtë të bëjë me ty çka të dojë...A është e vërtetë kjo?“

Jezusi: „Para së gjithash, Vani im i vogël, duhet të kuptosh se unë sipas natyrës hyjnore jam personi i dytë i Trinisë Shenjte, prandaj jam një me Atin dhe Shpirtin Shenjt. Por si qenie njerëzore, i kam pasë të gjitha dobësitë e fëmijës së vogël. I vetmi dallim ishte se unë nuk kisha asnjë papërsosmëri, kurse ti ke. Nuk i zgjedhja ushqimet dhe nuk isha i pagdhundur si ti. Nganjëherë qaja, por posa më ngushllonte Maria, kuptoja menjëherë. Pos kësaj, sikur fëmija të mos qeshej kurrë, do të zhdukej gëzimi në familjen e tij. Në atë kohë sillesha si çdo fëmijë. Nëse dikush prej të afërmëve më sillte ndonjë ëmbëlsirë, e merrja me gëzim dhe e haja me knaqësi.

Jezusi: „Ati qiellor kurrë nuk ka lejuar që familja ime të vuaj nga uria ose etja, madje as për një vakt të vetëm. Kurse Maria ka ditur të planifikojë, për më tepër, ajo mbështetej në Atin e saj të vërtetë në qiej. Me mua sillej si nënë, por me Atin Zot, zemra e sajë ishte e hapur si zemra e fëmijës. Nëse i mungonte diçka, ajo vetëm kthente shikimin kah qielli dhe, thjeshtë dhe sinqerisht luste Zotin Atë. Besimi dhe sinqeriteti i sajë ishin aq të dashura për Zotin, sa që Maria merrte çdo gjë që kërkonte, ashtu si të ka thënë vetë ajo. Për shembull, kur nuk kishte miell për bukë, ajo thjeshtë i drejtohej Atit të sajë dhe thoshte: 'Atë, sot voglushi yt dhe fëmijët tu, janë në nevojë!' Pataj thoshte në mënyrë më precize: 'Ata janë pa miell, kripë' e kështu me rrallë. Dhe ajo rrinte e qetë si zakonisht. Ati qiellor nuk priste asnjë çast të plotësojë lutjen e sajë. Por Ai e bënte këtë në mënyrë shumë të natyrshme, pa kurrfarë mrekullishë spektakolare.“

Van: „Jezus i vogël, A ke bartur ndonjëherë sandale?“

Jezusi: „Po, por ato nuk dukeshin si sandalet tani. Ishin shumë të ngjashme me ato që bartin fshatarët vietnamez sot. Sandalet e mia nuk ishin të zbukuruara, ishin të thjeshta. Ashtu ishte edhe veshja ime.“

Van: „Jezus, më jep hirin që të gjitha gabimet e mia dhe shprehitë e këqia të digjen në zjarrin e dashurisë sate. Jezusi im i dashur, më jep hirin që të gjitha mëkatet e mia të digjen në dashurinë tënde, madje edhe ato që akoma s'i kam bërë.“

Jezusi: „Vëllau im i vogël, së pari duhet të pranosh të gjitha pakënaqësitë që i vendos në rrugën tënde. Kjo do të më pëlqejë më shumë se të kishe agjëruar njëqind vjet. Po të duroshe edhe vdekjen në kryq, ashtu si unë, nuk do të ishte më mirë se vuajtja që të jap këtu, të ta mësoj dëgjuesën. Mënyra më e mirë e vdekjes në vete, është dëgjesa.“

Jezusi: „Duke ju falenderuar Marisë shpirtërat mund të bashkohen me dashurinë time në mënyrë intime de të vazhdueshme. Miku im i vogël, kurrë mos e harro këtë: duaje nënën time ashtu si të dua unë ty.

Për shpirtërat që më duan duhet menduar si për ajrin e freskët i cili mundëson që dashuria ime të frymojë dhe të jetojë në këtë botë. Nëse ky ajër i pastër nuk do të ekzistonte në këtë botë, dashuria ime nuk do të mund të banonte aty, dhe bota do të ngulfatej,“

Jezusi Fëmi, së bashku me të ëmën, hap pas hapi i afrohen Vanit.

Van: „Nënë, a nuk do të vinit më shpejt sikur ta merrje ngrykë?“

Maria: „E vërtetë, por Jezusit të vogël nuk i pengon që t'i bëjë disa hapa nga dashuria për ty.“

Van: „Më thuaj, Jezus, a ka filluar Mretëria jote e dashurisë të shpërndahet në mbarë botën?“

Jezusi: „Po, kurse pika fillestare e asaj rritje është Franca. Motra jote Tereze¹⁸ është apostull universal për të gjithë apostujt tjerë të dashurisë sime. Pikërisht nga atje ka filluar të shpërndajë Mbretërinë time të dashurisë e cila vazhdon të rritet edhe më tej. Kurse ti Van, derisa shkruan atë që të them, edhe ti i kontribuon kësaj vepre, ashtu si të kam thënë më parë. Ka edhe shumë apostuj të tjerë të cilët ti s'i njeh. Edhe ata punojnë në fshehtësi të madhe, vazhdimisht njëri pas tjetrit, që të vendoset sundimi i dashurisë sime në botë.“

Jezusi: „Më dëgjo me kujdes, Van. Unë të dua shumë. Sidomos i dua fëmijët. Jam shumë i kënaqur që mund të jem mik i tyre. Nëse duan të më gjejnë, është shumë thjeshtë. Vetëm le të shikojnë mënyrën e tyre të sjelljes dhe menjëherë do të më gjejnë në vete. Tani më, u kam premtuar fëmijëve Mbretërinë qiellore pa kushte. Nëse do të kërkoja prej tyre që të agjërojnë, apo të ju imponoja dicitlinë ose sakrifica, si do të arrinin në qiell fëmijët e posalindur të cilët vdesin pas pagëzimit? Van, Dashuria e mëshirshme ka siguruar për fëmijët diçka të jashtëzakonshme. Ata nuk duhet të bëjnë asgjë tjetër përveç ta pranojnë atë. Bota, para syve të mi i vret shpirtërat fëminorë, kurse unë, çka mund të bëj? Van, a më ke dëgjuar me kujdes? Fëmijët duhet ndarë nga terri i botës. Mjera ti, o botë! Sikur fëmijët tu të mos ishin këtu si bartës të mirësisë hyjnore, me drejtësinë hyjnore do të ishe shkatërruar.“

Jezusi: „Van, çdo gjë më pëlqen te fëmijët: fjala, qeshja, madje edhe loti në çastin e pikllimit – të gjitha më gëzojnë. Por fatkeqsisht, Van, duket se tani fëmijët me sjelljet e tyre dëshirojnë të garojnë me të rriturit.“

Van: „Ti flet shumë, Jezus. Gjuha jote kurrë nuk pushon. Qysh kur nuk ke heshtur? Nuk më ke lënë as të lutem në qetësi. Atëherë, si mund të më tërheqësh vërejtjen për të gjitha të metat e mia? Mirë, po shkoj të ja them Marisë këtë. Do t'i them se kurrë s'pushon së foluri, pa...“

¹⁸ Është fjala për Terezën e Krishtit Fëmi e cila, po ashtu, personalisht e ka mësuar Van-in.

Jezusi: „Për çka e ke fjalën, Van? Ke harruar, nuk ishte moti, më se dy muaj nuk ta këm thënë asnjë fjalë, dhe me sy të përplotur je ankuar te Maria, e nganjëherë edhe te motra Tereze...

Isus: „Van, a më do? Pse qeshe mbrëmë kur mendove për atë se si kam qarë në grazhd? Kur u linda u gjeta në situatë të njëjtë si çdo i posalindur tjetër. Vuajta nga të ftohtit dhe nga pikëllimi. Sikur të ishe ti në atë çast atje, të bisedoje me mua, ndoshta nuk do të kisha qarë. Sikur të mund të dëgjoja disa fjalë dashurie, si tani, jam i sigurt se do të harroja të ftohtit.“

Ja prijësi ynë!

Pak kush e ka vërejtur dhuratën që Zoja na ka sjellë në agimin e mileniumit të tretë. Natyrisht, të gjithë miqt e Megjugorjes kanë pritur ndonjë fjalë udhërrëfyese e cila do të na tregonte se si të jetojmë, në mënyrën më të mirë të mundshme, në këtë kapitull të ri të historisë. E kemi ditur se do të na pajis me mjetin e vërtetë për të qenë të aftë të kërcejmë në të panjohurën. Dhe ajo nuk na ka zhgënjyer! Ditën e njëjtë kur Papa Pali II. inauguroi vitin e madh Jubilar duke hapur dyert e bronzta të kishës së Shën Pjetrit në Romë, Zoja u dëftua në Megjugorje, e veshur në flori, sipas vëguesve, duke rrezatuar me gëzimin i cili nuk mund të përshkruhet. Duke bartur Jezusin ngrykë, na luti që ta vëmë në vendin e parë në jetën tonë. Por kjo nuk është e gjitha. Ajo na udhëzoi në Të si në *prijësin*, si në atë që do të na prij në rrugën e shpëtimit.

A do të jetë vërtetë fëmija *prijësi ynë*? A mund të jetë fëmija, ai i cili do të ecë para nesh dhe të na prijë rrugës së sigurt, të na mbrojë dhe të sigurojë ushqimin për ne? A do të luftojë voglushi për ne?

Po, pikërisht! Kjo është saktësisht ajo që ka menduar Nëna jonë. Nuk ka gabim këtu – kjo ishte porosi e qartë.

Sipas profecive që kanë lajmëruar lindjen dhe identitetin e Mesisë, Isaia ka patur vizion që „atyre do t'u prijë fëmija“.¹⁹ Në hebraishte ky rresht biblik vërtetë do të thotë „fëmi i vogël“ (*na' ar qaton*). Në rreshtat në vazhdim Isaia përshkruan fëmijën që luan mbi vrimën e shlligës²⁰, kurse aty, ai quhet me fjalën *Yonek* që do të thotë foshnje në gji, që ushqehet me gjirin e nënës.

¹⁹ Iz 11,6

²⁰ Iz 11,8

Ky është Bariu ynë, Prijësi që na e paraqet Zoja për mileniumin e tretë! Ndoshta akoma nuk e kemi marrë seriozisht kuptimin e fjalëve të Jezusit: „Lëni fëmijët të vijnë tek unë e mos i ndaloni; sepse atyre u përket Mbretëria e Hyut!“²¹ Cilat janë cilësitë e fëmijës për shkak të të cilave Zoti ashtu „shkrihet“? Secili prej nesh duhet të gjejë përgjigjen në këtë pyetje. Sa më takon mua mendoj se është pafajsia. Zotin e prek aq thellë pafajsia e fëmijës sa që ai thjesht, verbërisht, derdh krejt çka ka – krejt çka Ai është.

Çfarë shpirti amnor na tregon Zoja! Atë fëmi të posalindur që ajo e bart për ne, në pragun e mijëvjeçarit të tretë, me aq gëzim që derdhet – kjo është pafajsia par excellence. Ai është vërtetë prijës çfarë na duhet sepse ashtu si valët e oqeanit që rrahin shkëmbin, valët e të keqes rrahin pafajsinë e shkëmbit.

Ai luan me shlligat tona. Për gjeneratën tonë që ka frikë të pranojë jetën, për shoqërinë tonë që vret me mijëra fëmijë, duhet fëmija që të na shërojë. Jezusi Fëmi merr detyrën që të shërojë gjeneratat tona. Ashtu si shprehim mirëseardhjen Jezusit Fëmi në duart e Marisë, ashtu i shprehim mirëseardhjen edhe shëruesit tonë. Ai është aq i vogël – vetëm Ai mund të rrëshqasë në humnerat e tmerrshme të botës sonë të patenzonë që të përzejë të gjitha refuzimet e jetës dhe të injektojë gëzimin e tij të amshuar. Nuk mund të kuptohen të gjitha mrekullitë, shërimet dhe lirimet që Jezusi Fëmi bën kur të pranohet dhe të përqafohet. Ky fëmi është dinamit!

²¹ Mk 10, 14-15

„Të dashur fëmijë! Kjo është kohë hireshe. Fëmijëz, sot në mënyrë të veçantë, së bashku me Jezusin e vogël, që e mbaj ngrykë, ju jap mundësinë të përcaktoheni për paqe. Nëpërmes të „Posë“ suaj për paqë dhe përcaktimit për Zotin, ju hapet mundësi e re për paqe. Fëmijëz, vetëm kështu, kjo kohë-ky shekull do të jetë për ju kohë paqeje dhe mirëqenjeje. Prandaj, veni Jezusin e posalindur në vend të parë në jetën tuaj dhe Ai do të ju prijë rrugës së shpëtimit. Ju falemnderit se ju përgjigjët thirrjes sime.“ (25. dhjetor 1999.)

6

JEZUSI FËMIJË, ZOTI IM, FËMIJA IM!

Në fillim të viti 2000, e vizitova Denverin në shtetin Collorado të Amerikës. Në ligjëratën Mariane i luta të pranishmit të qëndrojnë disa minuta në qetësi të thellë dhe të koncentruar, duke i ftuar që nga duart e Marisë të pranojnë Jezusin Fëmijë në duart e veta. Natyrisht, ideja ime ishte që të hap zemrat e tyre për ardhjen e Fëmijës. Me këtë ata kanë mundur ta imagjinojnë trupin e tij të vockël në duart e veta, ta mbështesin në zemër dhe të ja tregojnë dashurinë e vet.

Valery, grua dyzetvjeçare, më tregoi atë që ka përjetuar në atë meditim të shkurtër:

„Kur motra Emmanuel erdhi në famullinë tonë, fliste për Krishtin dhe për atë se si mund të ja shprehim mirëseardhjen si fëmijë. Më befasoni ajo ide e re, sepse gjithmonë kam menduar për Krishtin si për të rritur. Poashtu e kisha menduar në kryq si Jezusin e kryqëzuar. Motra i ftoi të pranishmit që të mbyllin sytë dhe të imagjinojnë se e mbajnë fort Jezusin Fëmijë mbështetur në zemër dhe t'i flasin. Të gjithë besimtarët e pranishëm ishin të prekur me këtë përvojë.“

„Para tridhjetë vitesh kisha 16 vjet dhe isha shtatzënë. Edhe pse kurrsesi nuk e isha ndërmend që ta mbaj fëmijën, megjithatë, vendosa që ta lind me dëshirën që ta jap në adoptim. Disa vite më vonë u martova por nuk munda më të kem fëmijë. Ai djalë ishte fëmija im i vetëm, kurse unë e kisha refuzuar! Qysh atëherë jeta ime u shndërrua në kotësi. Ndjeja zbrastësi në zemër që kurrë nuk pushonte së gjakderdhuri!

„Kur e mbajta Jezusin Fëmijë, ashtu si kërkoi motra atë ditë, Ai u bë real për mua. Ai nuk ishte më në kryq, por në duart e mia. Ishim të lidhur ashtu si është e lidhur nëna me fëmijën e vet që e mban ngrykë. Atëherë më vërshoi një tjetër ndjenjë derisa E mbaja. Papritmas ndjeva peshën e trupit të tij! Ai më lejoi që ta mbaj dhe kjo më la pa frymë. Munda ta adhuroj pa folur asnjë fjalë. Por kjo nuk ishte e tëra!“

„Derisa mbaja Jezusin Fëmijë, përsëri ndjeva dhëmbjen për shkak të ndarjes nga biri im. Dhëmbja më kaploi dhe fillova të qaj. Po, ndjeja peshën e Jezusit të Vogël por gjithashtu ndjeja trupin e djalit tim Peter-it se si e mbaj në duar. Vetëm dy herë e kisha mbajtur si foshnje. Kjo

ishite liruese për mua. Kalova nëpër procesin e shërimit të thellë, shërimit të zbrastësisë së brendëshme. Jezusi po e mbushte atë.“

„Më duhet të ju them, poashtu, se jam takuar me birin tim, përsëri, kur i kishte 19 vjet. Ai është tani tridhjetë vjeçar dhe vuan për shkak të braktisjes. Motra foli për vuajtjen dhe pasojat që duron fëmija nëse nuk ka përjetuar se dikush e mban ngrykë dhe e përqafton me ngrohtësi. Derisa lëkundja andej këndej Jezusin Fëmijë dhe birin tim, ndjeja se shërimi shpirtëror që po ndodhte në mua, po ndodhte edhe në birin tim Peter-in.“

„Më vonë, pas lutjes i telefonova djalit që t'i them, se e kisha takuar dhe mbajtur ngrykë Jezusin Fëmijë. Më dëgjoi me kujdes dhe kur e kreuva, thjeshtë pëshpëriti: 'Nënë, të dua!' Kurrë nuk më kishte thënë më parë. Kjo duhet të ketë qenë shërim shpirtëror!“

„Shumë kohë më parë lusja tërë rruzaren. Por e ndërpreva më vonë. Tani fillova përsëri. Frymëzimi Marian, mënyra në të cilën ajo më flet në zemër gjatë misereve të rruzares, më çon nëpër përvojën e gjith asaj që ajo ka përjetuar në ato ditë. Tani e gjithë kjo është në mua. Ajo edhe tani punon në atë proces shërues! E di se Zoti vepron në jetën tonë nëpërmes të sajë. I jam aq mirënjohëse! Se çfarë shërimi është ky – me gëzim, të përshëndesësh Jezusin si fëmijë!“

Kur, një vit më vonë, bisedova me Valery, ajo kishte lulëzuar si grua. Jezusi Fëmijë kishte larguar prej zemrës së sajë humbjen e madhe dhe kishte përtërirë identitetin e sajë si grua. I ishte kthyer dinjiteti i nënës.

Kam parë se si po mbyllet dritarja

Një herë tjetër, kur po përfundoja ligjëratën mbi Jezusin Fëmijë, për shtegtarët në Megjugorje, më erdhi një grua duke qarë. Aq shumë e kishin dominuar emocionet sa memzi fliste dhe u mundua shumë për të dëshmuar.

„Së shpejti do t'i mbush të gjashtëdhjetat. U martova e re por nuk munda të kem fëmijë. Kjo ma shkatërroi jetën. Bashkëshorti nuk donte të adoptojmë fëmijë. Përkundër të gjitha vështirësive, unë shpresoja për fëmijën. Ashtu si kalonin vitet shihja se si po më mbyllet dritarja, dhe me këtë edhe mundësia që të kem fëmijë, dhe më në fund ajo dritare u zhduk. Motër, nuk mund ta imagjinoni sa kam vuajtur! Por sot, sot (e mbytur në lot, iu desht të ndalej që të marrë frymë), sot e kam fituar fëmijën tim! Ju lutem, më besoni! Do ta kem shumë kujdes!“

Kjo grua, plot shpresë, e kuptoi porosinë dhe e aplikojë menjëherë. Jezusi Fëmijë, e përdori vuajtjen e sajë që të gdhend për vete grazhdin e vogël në rrëzë të zemrës së sajë e të rehatohet aty.

Fëmija i fshehur i Megjugorjes dëshiron të banojë në jetën tonë dhe kërkon grazhdin e vogël ku do të pushojë. Mirëpo, si në Betlehem, shumica nuk e thërret! Njerëzit nuk kanë kohë ose vend për të. Megjithatë, Ai nuk është kërkues. Krejt çka i duhet është pak sanë ose kashtë që të vijë e të

pushojë në ne. Në të njëjtën kohë ai dëshiron që të rrisë numrin e banesave e tij prandaj e tërheq secila zemër dhe secili nga familja jonë. Ai ëndërron që sa më shumë njerëz ta mbështjellin në çdo kënd të kësaj bote, madje edhe në vendet më të neveritshme, sepse dëshiron me zjarr që atje të mbjell shpëtimin dhe paqen e vet. A do të ishte e mundur kjo, sikur Shpëtimtari të mos kishte dëshirë të zjarrtë të na shpëtoi?

Fëmija dhe profesori univerzitar

Gjestet fëminore të Jezusit, nganjëherë, janë vërtetë befasuese. Ja shembulli. Meshtari i cili kishte vizituar Megjugorjen më tregoi se Jezusin Fëmijë nuk e kishte as në qoshe të mendjes. Pasi që ishte profesor univerzitar kishte punë më të rëndësishme që e okuponin! Megjithatë, përjetoi, vërtetë diçka të veçantë kur u ftua që ta marrë ngrykë Jezusin Fëmijë, në një prej takimeve tona:

„Kur mendova se po marr Jezusin Fëmijë në duar, papritmas u hutova dhe u turpërova. Mendova: 'Ç'të bëj unë me Të?' Isha i shqetësuar. Vërtetë nuk dija se si të lirohem nga kjo! Pas një beteje qesharake prej disa minutash në vete, ndjeva dorën e vogël të fëmijes që më miklonte në qafë. U ktheva të shoh se kush është – askush! Në atë moment zemra fillojë të më shkrihet dhe menjëherë kuptova se çka po ndodh. Më vërshojë një valë e madhe butësie, që në jetën time kurrë nuk e kisha ndjerë. Prekja e fëmijës zgjati vetëm disa sekonda, por për mua kjo ishte pikë kthese – nuk isha më i njëjtë. Jezusi i vogël tani është përherë me mua, dhe prania e tij më zbut përbrenda. Duhet të them se, vërtetë, kjo më nevojitej!“

Terapeuti i cili nuk u frigohet sëmundjeve tona

Brenga për shëndetin tonë që praktikon Jezusi Fëmijë i vogël, terapeut, ka përparësi të madhe. Ajo vepron pa vërejtur, si mrekulli. Kur kemi probleme shëndetësore dhe vendosim që të konsultohemi me mjekun, duhet të caktojmë takimin dhe nganjëherë të presim një amshim të tërë. Problemin tonë duhet ta përshkruajm më së miri që mundemi, duhet të kalojmë ekzaminimet, të shpenzojmë para, të marrim barëra, të durojmë efektet anësore dhe në fund të shpresojmë se të gjitha këto do të sjellin fryt të mirë dhe shëndet më të mirë.

Me Jezusin Fëmijë, është diçka krejt tjetër. Ai i dorëzohet përqaqimit tonë, dhe për asnjë çast nuk ka frikë nga sëmundja që kemi. Ai është tepër i vogël për këtë. Besimi i pakusht i Tij në ne, nxjerr valë të panjohura të dashurisë nga thellësia e qenies sonë. Fëmija vjen dhe na liron nga sëmundja më e thellë dhe na shëron ashtu që me vetë praninë e tij i drejtohet asaj që është më e mira në ne. Ose thjesht vjen dhe luan me ne. Pasi është tepër i vogël për të folur, ai luan dhe ashtu komunikon me ne. Sa muret dhe bllokadat janë rrenuar! Sa gurët janë rrokullisur prej varreve tona në këtë mënyrë! Kur vështirësitë e ekzistencës sonë, zënë në kurth zemrat tona, na shtypin dhe na ngulfasin, sa liruese është kur je në gjendje që të qeshësh për gjëra të vogla me Fëmijën!

Kur Fëmija i fshehur i Megjugorjes më në fund ua zbuloi fytyrën gjashtë vëguesve, ai luajti me ta! Maria na dëshmon se si ka qeshur me ta, ka luajtur kukaçefas me mantelin e Nënës së vet: „Ishim të tendosur, të ngurtë dhe të largët,“ thotë ajo. „Ai dëshironte që të shlirohemi.“ Vëguesit nuk e kishin idenë se si Zoti mund të jetë aq i thjeshtë, aq i afërt. Vicka na tregon se si nganjëherë, për Krishtlindje, ai i hap sytë dhe i çuditet çdo personi të pranishëm në dhomën e sajë, sikur e zbulon botën, Ai, Krijuesi i të gjitha sendeve!

Nëna Yvonne-Aimée de Malestroit, mistikja franceze, tregon se një mbrëmje, kur kthehej në dhomë, gjeti Jezusin Fëmijë të rehatuar në shtratin e sajë që luante me shallin që kishte marrë nga dollapi, dhe e shikonte këtë me sytë vezullues të hajnit të vogël²². Vetëm për disa çaste në qetësi, në këtë skenë Fëmija shëroi plagët e zemrës të kësaj motre, që i kishte marrë në sulmin e Armikut. Pushoi pushtimi që kishte shtypur shpirtin e sajë. Me një buzëqeshje, Fëmija fshiu gjithë pikëllimin dhe përtëriu në të shijen e qiellit!

Ky është Prijësi ynë! A jemi të lumtur me politikanët tanë? Me kryetarët tanë? Me gjykatësit tanë? Me shefat tanë, ose me këdo qoftë që thotë se sundon me botën tonë moderne? Sa herë që bëj këtë pyetje, njerëzit ofshajnë dhe thonë: 'JO!' Atëherë çka? Ne kemi Mbretin tonë dhe *Prijësin* në Jezusin Fëmijë të cilin na e jep Zoja. Fytyra e Tij nuk paraqitet në TV-ekranet tona dhe nuk e dëgjojmë zërin e Tij nga Cd-të. Nuk e shohim duke shetitur lart e poshtë nëpër avenutë e qyteteve tona të mëdha ulur në automobil. Nuk gjëndet në faqet e para të gazetave tona ditore. Megjithatë, ai premtun se do të ju prij atyre që i kanë dhënë vendin e parë në jetë, nëpërmes të Nënës së Tij, nëpërmes të kushtimit. Kjo ecje ekziston në thellësinë e fshehur të zemrës sonë, pa kurrfarë nevojë për publicitet, dhe kurrë nuk do të na çojë në drejtim të gabuar sepse Jezusi është *Prijësi* i vetëm i cili ka derdhur për ne gjakun e vet, i Vetmi që e mban fjalën.

²² Fra Paul Labutte : „Yvonne-Aimée e Jezusit,“ De Guibert, Francë

„Të dashur fëmijë! ... Ju thërras që të hapeni dhe jetoni sipas shembullit të shenjtërve. Nëna Kishë i ka zgjedhur ata që të jenë nxitje për jetën tuaj të përditshme..“ (25. tetor 1994.)

7

PATËR PIO NË MEĐUGORJE?

Chicago, tetor 2000.

Motra Briega McKenna²³ ishte mysafire në vikendin e madh marian që e kishte organizuar Kathleen Long. Pasi që isha në listën e folësve, ekipi im i vogël amerikan u paraqit me kamerat e veta, duke shpresuar se me motrën Briega do të bëjë disa emisione televizive mbi Međugorjen. Pas intervistës motra Briega fillojë të lutet për mua. Menjëherë pati një vizion preciz dhe më tha: „Po shoh shtëpinë tënde në Megjugorje dhe dikë që po ecë aty.“ Pak e brengosur, ngrita kokën, sepse, normalisht, shtëpia është e mbyllur kur nuk jemi aty. Pyetësja se kush mund të jetë. Por, motra Briega vazhdoi: „Ai është Patër Pio. Bart Jezusin e vogël në duar dhe ta dorëzon.“ Motra Briega nuk e dinte se ne e kishim quajtur shtëpinë Betlehem dhe se Jezusi Fëmijë mbretëronte aty si Mbreti ynë i dashur!

Denis Nolan ishte i befasuar dhe i detyruar për një betejë të brendëshme urgjente kur dëgjoji se motra Briega flet për Patër Pion në atë mënyrë. Duhej që të rishqyrtojë disa nga idetë e tij për Patër Pion. Para disa muajsh Denis kishte kërkuar prej meje që ta fshehi fotografinë e Patër Pios në fund të sirtarit. Tha se nuk i pëlqente ai. Kishte frikë nga vetullat e tij të trasha dhe të lakuara. Vizioni i motrës Briega e preku dhe ai menjëherë e pranoi Patër Pion si njërin nga „mbështetësit tonë qiellorë“ aktiv!

Ditën tjetër pas atij takimi në Chicago, shkuam në universitetin Notre Dame në Indiana, ku duhej bërë xhirimin e kasetës mbi Jezusin Fëmijë. E lutëm Patër Pion që të kujdeset për atë xhirim, sepse ishim kurrështarë ta shohim në veprim, dhe ky ishte rasti i parë i tillë. E pranoj se isha pakëz nervoze sepse para një muaji kisha provuar një herë, pa sukses, të bëj xhirimin mbi këtë temë. Nuk kishte shukurim! Prandaj ishte e nevojshme ndihma e fortë e Patër Pios, sidomos për këtë temë kaq delikate dhe të madhe. Në çastin e fundit kuptuam se nuk mund të hyjmë në sallën e rezervuar paraprakisht në univerzitet. Ishte e mbyllur për shkak të pushimeve vjeshtore. Heqja dorë nga projekti, nuk vinte në konsiderim, sepse një grup studentësh priste me padurim që të

²³ Motra Briega McKenna është motër nderi Irlandeze e rendit të Klarisave këmbëzbathura. Udhëheq shërbesën e ungjillëzimit dhe lutjeve për shërim në mbarë motën, sidomos për meshtarët. Kontakt: www.sisterbriega.com.

mësonte diçka për Jezusin Fëmijë. Ata kishin ardhur atë mbrëmje për atë qëllim! Kështu, ne u tubuam në një rreth të vogël si ekipi i futbollit i cili planifikon sulmin tjetër, dhe filluam ta thërrasim qiellin në ndihmë. Sigurisht, Patër Pio do të vijë të na shpëtoi. Motra Briega e kishte parë „duke shetituar në shtëpinë time me Jezusin Fëmijë!“ Me besim e lutnim për ndihmë, por duhej të jetë i shpejtë dhe i fortë.

Erdhi një student, u ndal dhe më fiksoi me shikim. Me sy të zgurdulluar dhe plotësisht i befasuar klithi: „Motër, po ju jeni këtu! Nuk mund të besoj! Mbrëmë kam ëndërruar se keni ardhur në shtëpinë time që të ligjëroni. Mendova se jam çmenduar sepse isha i sigurt se jeni në Megjugorje. Nuk mund të besoj se vërtetë jeni këtu në Notre Dame!“ Kur dëgjoji se nuk mund të gjejmë vend për ligjëratë, ai na thirri të gjithëve në shtëpinë e tij. Dhe kështu, qemë të shpëtuar në momentin e duhur. Faleminderit, Patër Pio!

Kur arritëm para shtëpisë së tij, të gjithë u ndalëm të hutuar! Ajo thirrej „Shtëpia e Patër Pios!“! Dhe gjëja e parë që pamë kur u futëm brenda, ishte busti, e qëlloni, i Patër Pios! Ishte e qartë se ai po ana priste. Dukej sikur thoshte: „Ejani, mos keni frikë. Ua kam hapur derën! Do të ju ndihmoj!“

Në qetësi përfunduam xhirimin. Patër Pio e mbajti fjalën. Është mirë të mbështetesh në të sa i takon projekteve të Megjugorjes! Duket se ky kapucin i përvuajtur, mik besnik i shën Franës, këtë famulli e ka pikë të dobët – famulli françeskane, që e kishte zgjedhur Nëna e Zotit!²⁴

²⁴ Ata që dëshirojnë ta nderojnë Patër Pion në Megjugorje, mund ta bëjnë këtë në ndërtesën e famullisë pas kishës së shën. Jakobit, ku gjendet busti i bronzit të tij.

„Të dashur fëmijë! ... Zoti është vetë paqa, prandaj afrohuni atij me lutjen tuaj personale, pastaj jetoni paqen në zemër dhe ashtu paqa do të rrjedh nga zemra juaj në mbarë botën. Mos flisni për paqen por bëni paqen.“ (25. shkurt 1991.)

8

SË PARI, PAQA NË ZEMRËN TIME

Michael-in! – e njihja dhjetë vjet dhe kisha kaluar me të, orë të tëra në studion tonë të zërit. Deri në vitin 2005 punonte si muzicent dhe redaktor muzike për organizimin e 'Children of Medjugorje' (Fëmijët e Megjugorjes), degë e organizatës 'Les Enfants de Medjugorje'²⁵ për teritorin anglishtfolës. Michael është person shumë karizmatik! Me fenë e tij për provaninë Hyjnore ka merituar admirimin e familjes dhe të shokëve të tij. Madje besoj se Michael prej Qiellit ka marrë disa gjëra të cilat as vetë Zoti nuk ka planifikuar të ja japë! Në fund të fundit, a nuk ka thënë Jezusi: „Prandaj po ju them: çkado që të kërkoni me lutje, besoni se e morët, e do ta fitoni me siguri!“²⁶ Në çdo situatë, Michael jeton i gëzuar. Njëherë i tha së ëmës, Cathy: „Ti dhe babai sigurisht më keni ngjizur në çastin e lumturisë, dhe sigurisht më ke bartur me gëzim sepse unë jam gjithmonë i lumtur!“

Michael, kohë pas kohe viziton Megjugorjen dhe çdo herë ajo i jep nxitje të re për jetën e tij shpirtërore, por edhe për jetën shpirtërore të familjes së tij.²⁷ Michael ka edhe fshehtësitë e tij. Sa herë që lutet te varri i atë Sllavkos ose në kodrën e dëftimit, gjithmonë kthehet me buzëqeshje në fytyrë. Mund të shihet se Zoti e ka pasuruar me dritë të re të cilën menjëherë do ta aplikojë në jetën e përditshme. Pastaj do të ja përcjell së shoqes dhe fëmijëve dhe kjo dhuratë e re e Zotit nuk do të mbetet pasive.

Gjatë pushimeve pranverore të Univerzitetit Notre Dame në vitin 2003., erdhi në Megjugorje duke luftuar kundër dyshimeve. Ishte i vërshuar dhe i paralizuar me brenga të shumta. Luste Zotin që të ja mbajë kokën mbi ujë. Ato pak ditë beteje, të bërë nën mantelin e Zojës, shënuan kthesën në jetën e Michael-it. Besoj se ajo që ka fituar, është çelsi i provanisë për ata që janë të okupuar kronikisht me brenga, ashtu siç është shumica prej nesh! Michael ma dërgoi këtë tregim në një letër, disa muaj pas udhëtimit të tij në Megjugorje:

²⁵ Organizata „Children of Medjugorje“ tani gjendet në Denver. Numri i telefonit: 877-647-6335. (877-MIR-MEDJ) E-mail: pray@childrenofmedjugorje.com. Adresa postare: P.O. Box 18430, Denver, CO 80218-0430, USA

²⁶ Mk 11,24

²⁷ Michael dhe e shoqja Annie kanë katër fëmijë dhe shpresojnë se do të kenë edhe të tjerë!

South Bend, vjeshtë, 2003.

„Shtegtimi im në Megjugorje, marsin e kaluar, e ndërroi jetën time. Që në fillim, Zoja më tha se duhet të lutem për të fituar paqen në shpirt. Atëherë kuptova se edhe pse jam lutur më parë, edhe pse kam besuar dhe pranuar bekime e shumë mrekulli, ende nuk e kisha paqen e brendëshme. E kisha të vështirë të lutem me dashuri dhe ta jetoj atë që flas. Pra, në kohën e mbetur të shtegtimit, i lashë të gjitha qëllimet personale me një anë, dhe u luta të fitoj paqen e zemrës. Kjo më ndihmojë që lutja të rrjedh më lehtë. Nuk ishte e nevojshme që të mundohesha duke menduar për fjalët që do të them.“

„Pas kthimit në SHBA, u përpoqa që t'i përmbahem asaj që kisha mësuar në Megjugorje. Por të gjitha brengat ditore filluan përsëri të paraqiten në lutjet e mia. Përsëri isha i shqetësuar dhe vëreja se po lutesha edhe për gjërat tjera e jo vetëm për paqe. Pyesja veten: 'Ç'ë bëj me këtë ose me atë?' Lutja ime bëhej përherë e më e rëndë - po e humbisja përsëri paqen e brendëshme! Dy muaj më vonë, bashkëshortja ime pranoi sakramentin e përforcimit. Gjatë meshës përjetuam mbushje të jashtzakonshme me Shpirtit Shenjt. Në një mënyrë shumë të veçantë, ky hir ia hapi zemrën time Jezusit i cili më foli shumë qartë. Ndjeva se po më shikonte drejt në sy që të sigurojë vëmendjen time, ashtu që lutjet e mia të ngathta të mos pengojnë.“

„Ai shpjegojë: 'Michael, detyra jote e vetme në lutje është që të kërkosh paqen në zemër. Unë do të kujdesem për të gjitha gjërat tjera për të cilat brengosesh. Nëse vepron kështu, do të bëhesh instrument me të cilin unë do të sjell paqen në botë. Tani e tutje, lutu vetëm për paqe në zemër, ashtu si të ka mësuar Nëna Ime në Megjugorje.'²⁸ Unë do të kujdesem për të gjitha të tjerat.'“

„Të nesërmen, nëna ime na foli se si nganjëherë jemi të thirrur të lutemi për qëllime të veçanta. Na tregojë ngjarjen e një motre nderi, së cilës Jezusi i kishte folur për gjërat shpirtërore. Kishte kërkuar prej sajë, që të lutet për qëllime të tjera në vend se të lutej për familjen. Pas një viti lutjeje, me dëgjësë, ashtu si kishte kërkuar Jezusi, ajo kishte vërejtur se si bekime të jashtzakonshme po zbrisnin mbi familjen e sajë. Vetëm sepse kishte hequr dorë prej qëllimeve të sajë dhe ishte lutur për atë që kishte kërkuar Jezusi. Duke dëgjuar këtë, e pashë qartë seriozitetin e fjalëve që m'i kishte drejtuar Jezusi, Jeta ime e lutjes u ndryshua. Edhe pse, nganjëherë, paqa në mua çrregullohet, shpesh mund ta kthej dhe ta ruaj në zemër sepse lutem vetëm për paqe dhe për asgjë tjetër. Zoti e bekoji me begati, çdo gjë që më parë e ngarkonte jetën time.“
Michael përpiket të ndjek atë rrugë – vetëm prania e tij është ngushllim për shumë njerëz.

Zoja na mëson se detyra jonë është që të luemi me të, për paqe – por kjo nuk do të thotë shumë nëse nuk lutemi me disponimin e duhur! Porosia e sajë ishte, që nga fillimi i dëftimeve: së pari duhet të bindemi vetë se jemi në paqen e Zotit (se posedojmë *shalom*, plotësinë) dhe nuk lutemi

²⁸ „të dashur fëmijë, m'i dorëzoni problemet dhe brengat tuaja. Kështu zemra juaj do të jetë e lirë për lutje. Dhe lutuni për qëllimet e mia.“ (grupit të lutjes në dimrin e vitit 1990).

nga frustrimi ose frika. Brenga primare për të tjera gjëra, përveç paqes, është lajthitje, sepse Zoti i sheh të gjitha në provaninë e tij.

Vicka flet

Në kohën kur era e luftës akoma ndjehej në ajër, e pyeta Vickën se si mund të ruhet paqa.

Ajo më tha: „Zoja kurrë nuk ka folur për luftën. Këtu ishte luftë (1992– 1995), por Zoja kurrë nuk më ka dhënë asnjë porosi për ardhjen e asaj lufte. Por, ishte e dukshme në fytyrën e sajë, në qëndrimin e sajë, dhe në mënyrën se si paraqitej. Bartëte shumë dhëmbje, Dhe, pak nga pak, lufta erdhi. Asnjë herë nuk na ka friguar me fjalët se do të shpërthejë lufta, dhe kurrë nuk ka thënë se do duhej të përgatitemi për të, në këtë ose atë mënyrë. Por, para luftës na ka thënë, sa e sa herë, (ashtu si bën edhe tani) se luftërat mund të ndalen me agjërim dhe me lutje. Domethënë, duhet t'i evitojmë ato luftëra me agjërimet dhe lutjet tona!“

Pastaj e pyeta Vickën: „*Vicka, a ke mësuar ti në shkollën e Zojës se si të fitosh paqen e vërtetë, mendoj paqen e Zotit, përkundër paqës njerëzore?*“

Vicka u përgjigj: „Zoja na ka mësuar se puna e parë që duhet të bëjmë është që të lirojmë zemrën nga çdo gjë negative – ta pastrojmë nga çdo njollë negativiteti. Pastaj duhet ta lusim për hirin e paqes. Kur e lus Zojën që të më dhurojë paqen dhe kthjelltësinë e vërtetë, nëse e kërkoj me zemër, ajo ma jep atë. Vetëm duhet të kërkojmë. Sa herë që kërkojmë - duhet të kërkojmë, me besim dhe dashuri! Por, poashtu duhet të kërkojmë ndryshimin e vetëvetes! Paqa nuk vjen vetëm pse përdorim fjalën 'paqe'. Shiko, sa njerëz, sot, thonë: 'Unë dëshiroj paqe, unë dëshiroj paqe!' Këto janë vetëm fjalë. Duhet të themi: 'Unë dëshiroj që të ndërrohem! Unë dëshiroj që ta pastroj zemrën time!' Vetëm atëherë, pas këtij pastrimi të brendshëm, do të vijë paqa në zemrat tona.“

„Të dashur fëmijë! Zoti më dërgon te ju nga dashuria, që të ju ndihmoj të kuptoni, se pa Të nuk ka ardhmëri as gëzim, e mbi të gjitha nuk ka shpëtim të përjetshëm. Fëmijëz, ju ftoj që të heqni dorë prej mëkatit dhe të luteni në çdo kohë që në lutje të mund ta njihni kuptimin e jetës suaj.“ (25. prill 1997.)

9

FJALËT E URTA TË FRA SLAVKOS

„Të dashur fëmijë! Sot kur qielli është afër jush, në mënyrë të posaçme, ju ftoj në lutje që nëpërmes lutjes ta vendosni Zotin në vend të parë. Fëmijëz, sot jam afër jush dhe bekoj secilin me bekimin tim amënor që të keni forcë dhe dashuri për të gjithë njerëzit që i takoni në jetën tuaj tokësore dhe të mund të jepni dashurinë e Zotit. Gëzohem me ju dhe dëshiroj të ju them se vëllau juaj Slavko lindi në Qiell dhe ndërmjetëson për ju. Ju falemnderit që ju përgjigjët thirrjes sime.“ (25. nëntor 2000.)

A e njihni njeriun për të cilin Zoja me kaq guxim i flet mbarë botës? Me këtë porosi Zoja ka dëshiruar që ta nderojë apostullin e vet. A nuk u angazhua ai, papushim, për Zojën para tërë botës? A nuk tha Jezusi: „Unë po ju them: kushdo të dëshmojë para njerëzve se është imi, edhe Biri i njeriut do ta dëshmojë se është i tiji para engjëjve të Hyjit. E ai që të më bjerë mohit para njerëzve, edhe atij do t'i bihet mohit para engjëjve të Hyjit.“²⁹

Këtë porosi Zoja e ka dhënë më 25. Nëntor, vetëm një ditë pas vdekjes së fra Slavko Barbariq-it. Nuk do ta harroj kurrë atë çast kur ne, një grup përkthyesish, lexuam porosinë që veguesja Maria e kishte pranuar, para se të shpërndahej në botë. Sytë e Marisë ishin të skuqura prej lotëve, por qeshte derisa përsëriste: „Slavko në qiell! Slavko në qiell!“ Pos Gjon Palit II., Zoja në porositë e sajë zyrtare kurrë nuk ka përmendur me emër dikë tjetër, por e bëri këtë për birin e vet Slavko! Janë të rrallë të vdekurit që kanë pranuar këso „shpallje të lindjes në qiell“ të dërguar miliona miqëve vetëm brenda disa orëve!

Pse e kursen energjinë tënde?

Më lejoni t'ju tregoj disa fjalë të fra Slavko-s të cilat aq mirë e përshkruajnë personalitetin e tij, vullnetin e tij, por edhe humorin e tij. Në vitin 1987. Shoqja jonë Kate pregatitej që me të, të ngjitej shkallëve të shtëpisë së famullisë, kur ai u ndal në fund të shkallëve të dëgjojë se çka po flisnin disa amerikane të moshuara, goxha të trasha. Në dukje i argëtuar, e pyeti Kate se a kishte dëgjuar se për çka po flisnin ato gra. „Jo, atë, nuk ua vura veshin“, ia kthei kjo.

²⁹ Lk 12,8-9

„E pra, secila prej tyre ua shpjegonte te tjerave se si ta ruajnë fuqinë e tyre fizike! Njëra i lan rrobat në atë mënyrë që përdor vetëm një sasi të caktuar të forcës, tjetra zien në këtë mënyrë, e treta bën pazarin në atë mënyrë etj. Garonin që të shohin se cila mund të harxhojë më pak energji. Pastaj shtoi me çapënkllëk: 'A thua ç'do të bëjnë me gjithë atë energji kur të shtrihen në varr?!' Shih, kur unë të vdes, edhe po të më vendosin në presë dhe të më shtypin sa të duan, kam shpresë se nuk do të mund të nxjerrin asnjë pikë energjie!“

Ngjiti shkallët duke kapërcyer nga katër sosh përnjëherë dhe duke kthyer kokën pas më pyeti:
„Po ti?“

Kjo është pyetja e duhur për secilin prej nesh!

Pak humor për agjërimin

Fra Slavko ishte ekspert për agjërim. Askush në fshat nuk agjëronte si ai, dhe u ndihmonte të tjerëve që të agjërojnë. Sa më takon mua, pasojat e rënda të hepatitit viral nuk më lejonin që të agjëroj. Pas shtatë vitësh të kaluara në Megjugorje dhe shumë përpjekjesh pa sukses, iu ankova Zojës: „Nënë, ti më dërgon në botë që të shpërndaj porositë tua dhe nuk më jep hirin që të mund të agjëroj? Si mund t'u flas fëmijëve të tu për agjërimin kur nuk e jetoj vetë? Nuk dua të jem hipokrite. Nëse dëshiron që të jem apostulli yt duhet të ma japësh këtë hir!“

Zoja u përgjigj shpejt dhe kështu një të premtë të bukur nëntori fitova hirin që të mund të agjëroj. Nuk ndjeva asnjë pasojë negative nga agjërimi në bukë e ujë. Beteja ishte e fituar, përfundimisht! Në naivitetin tim, një muaj më vonë, ja shpreha fra Slavko-s gëzimin: „Atë, atë, qëllojani se çka ka ndodhur? Kam fituar hirin e agjërimin! Kështu pra – tani edhe unë mund të agjëroj!“

Më lëshoi një shikim mbi syzet e tij dhe tha: „Motra Emmanuel! Kur Zoja kërkon diçka, ti, domethënë, së pari kërkon hirin që të mund ta bësh atë? Lere....!“

Përbiva pshtymën që të mund të kuptoj këtë dozë humorit „slavko-iane“, megjithatë kisha nevojë që sadopak të arsyetohem: „Por, unë jam përpjekur shtatë vjet! Sa herë që provova të agjëroj, isha e rraskapitur, pa forcë dhe moral, e shtrirë në shtrat ose ulur. Nuk isha në gjendje të qëndroja në këmbë. Mbetesha pa frymë sa që nuk mund të flisja!“ Fra Slavko-s i shndëritën sytë dhe klithi plot gëzim: „Nuk mund të flisje? Kjo është vërtetë interesante! Më ke dhënë një ide të shkëlqyer. Do t'i këshilloj burrat që ti detyrojnë gratë të agjërojnë. Kështu do të ketë më shumë paqe në familje!“

Që të dy shpërthyem në të qeshur...

A e dini si e humbim paqen?

Fra Slavko nuk fliste përmendësh, por përcillte dijen e vet të fituar me përvojë personale dhe nga betejat personale shpirtërore. Në vizitën e tij të fundit bashkësisë Cenacolo, fra Slavko iu drejtua djelmohave, ish vartësve nga droga të cilët i konsideronte fëmijë të vet. Ju jepte më të mirën prej vetes. Të gjithë ata djelmohave vuanin shumë nga mungesa e paqes në familjet e tyre. Fra Slavko iu tha: „A e dini kur e humbim paqen? Kur fillojmë të shikojmë vetëm një anë të një personi – anën të cilën nuk e duam – duke mos shikuar personin si tërësi. Atëherë kritikizmi hyn në zemrën tonë. I harrojmë të gjitha të tjerat. Duke u fokusuar në vetëm një gjë që na pengon, verbohemi. Madje edhe nëse ajo e metë, shprehi e keqe ose mëkat është real, për shkak të fiksimit në të, humbim nga shikimi bukurinë e jetës të atij personi, atyre gjërave që i ka bërë më parë, atyre që ka dhënë, që ka duruar, etj. Mbyllemi në vetëdijen e kufizuar dhe krejtësisht të shtrembëruar për atë person sepse jemi burgosur nga një gjë e vogël.“

„Dhe kështu humbim falenderimin! Kurse pa falënderim, nuk mund të kemi paqe. Falenderimi hap derën e paqes. Nëse dikush vjen në shtëpinë tuaj dhe nëse për të nuk keni asgjë tjetër pos lavdërimit dhe fjalëve të falenderimit për të gjitha që ai ka bërë dhe të gjitha përpjekjeve të tij, do të përmbahet për t'ua zënë për të madhe për çkado qoftë. Me këtë keni ndërtuar rrugën drejt paqes dhe pajtimit! Në marrëdhënjet tona ndërnjerëzore, mund të na shqetësojë një cilësi karakteri e personit tjetër, e cila na duket e pakapërcyeshme! Pse nuk mund ta kapërcejmë? Sepse e kemi kufizuar shikimin tonë! Kur të na ndodh kjo do duhej të themi: 'O, jam në rrugë për të shkatërruar paqen!' “

„Duhet të marrim një vendim themelor – që gjithmonë të jemi mirënjohës dhe të kemi sy të mprehtë e të aftë të shohim atë që të tjerët bëjnë për ne, madje edhe atë që Zoti bën për ne, nëpërmes tyre. A më pengon shiu sot? Falemnderit Zotit, shiu i sotëm i pengon planet e mia, por ndoshta Zoti e jep që të pregatisë tokën e cila do të na ushqejë verën e ardhëshme. Duhet ta zgjeroj shikimin tim dhe t'i lejoj hirit që të veprojë atje ku duhet. Me falenderimin tim, gjithmonë, do të kthehet edhe paqa ime e brendëshme.“

Shumë perëndime të diellit

Nga fundi i vitit 2000., Zotëria më dha një shenjë të jashtëzakonshme. Duke parë se si po afrohet përfundimi i vitit të Jubileut të Madh, vendosa të vizitoj fra Slavko-n. Mendova se do të ishte mirë që njëri tjetrit të ja falim të gjitha konfliktet dhe keqkuptimet e vogla të cilat, ndoshta, e kanë dëmtuar miqësinë tonë dhe kështu, të mund të shfrytëzojmë gjith hirin që Jubileu kishte ofruar. Duhej vetëm që të caktoj takimin.

Kur merret një vendim i tillë, para se të perendojë dielli, duhet bërë diçka. Gabova dhe lejova që të ndodhin disa perëndime të diellit. Mirëpo, një natë fitova një shëndritje, dhe së bashku me të, edhe një kuptim të papritur, Ëndërrova se po rrija pranë një tavoline ku bëheshin disa biseda të gëzuara. Fra Slavko rrinte përballë meje. Në mesin e të gjithë mysafirëve, pikërisht fytyra e tij u shndërrua dhe shkëlqeu me gëzim qiellor. E shikoja e fascinuar, me bukurinë dhe dashurë që

rrezatonte prej tij. Edhe ai më shikonte thua se donte të më përcillte atë gëzim të madh që buronte prej tij. U zgjova e vërsuar me këtë shkëlqim qiellor sa që thash me zë: „Të tillë do të duhej të ishim gjithmonë njëri me tjetrin!”

Të nesërmen, fra Slavko vdiq...

Falenderoj Zotin se e ka ditur qëllimin tim dhe se, me këtë takim, më ka lejuar që të ndjej parashijen e hirit dhe të lavdisë së tij.

Disa njerëz janë të pikëlluar për shkak të zbratësisë që atë Slavko ka lënë pas vetes në Megjugorje dhe sikur thonë: „Është tepër vonë tani, e lëshova rastin që ta njoh atë meshtar të jashtëzakonshëm!“ Por, çka do të bënte fra Slavko në këtë situatë? Kishte zakon të thoshte: „Kam fituar një hir të veçantë: kur përfundon dita, unë e harroj.“ Kurrë nuk ankohej për të kaluarën dhe nuk kishte frikë nga ardhmëria. Jetonte të tashmen.

Një ditë, një shtegtare e pakujdeshme i tha fra Slavko-s: „Atë, do të duhej, vërtetë, që të pushoni tani!“ Shpesh, këto lloj vërejtjesh, e frustronin, dhe ai ia bëri me dorë: „Do të pushoj në Qiell!“

Tani dëshiroj të mahitem me të nga kjo anë e perdes dhe ngajëherë i them: „Slavko, vërtetë, a pushon tani?“ Sepse, që nga vdekja e tij, kurrë nuk ishte kaq aktiv! Jo, ai nuk e la Megjugorjen. Dera e tij është e hapur non-stop tani, njëzet e katër orë në ditë. Nuk ka më rrallë në pritje! Shenjtërit në qiell, me çdo person, sillen si të ishte i vetmi në botë.

Vuante në heshtje

Prej nga gjithë ajo forcë ndërmjetësuese e tij? Pse aq shpejt pas vdekjes në tokë lindi në qiell?

Fra Slavko vuante në heshtje dhe shumë rrallë lejonte që edhe shenja më e vogël e asaj vuajtje të jetë e dukshme nga ana e jashtme, madje edhe me miqtë e tij më të afërt. Para fundit, shpesh e vizitonte Marinë sepse e kishte si të familjes. Maria i dinte vuajtjet e tmerrshme që duronte. Për fra Slavko-n biseda me Marinë ishte si ta linte barrën e vet te këmbët e Zojës dhe ta lëshonte në kujdesin e saj amënor.

Disa muaj para se të „lindëte në qiell“, gjatë një bisede të lirë, i tha Denis Nolanit: „Unë jam i kryqëzuar!“

Megjithate, gjatë ditëve të tij të fundit në Megjugorje, nuk pushonte së predikuari për falenderimin ndaj Zotit. Në mëngjesin e vdekjes së tij, derisa kremtonte meshën e tij të fundit, u tha një grupi shtegëtarësh gjerman: „Gjithmonë ankohemi! Do të donim të jemi diku tjetër, në një tjetër kohë, për shembull në kohën e Jezusit. Ashtu, do ta donim më shumë, do ta prekni, do të besoni në Të... Por të jemi të sigurt se Zoti e ka zgjedhur më të mirën për ne. Dhe po të ekzistonte ndonjë epokë ose ndonjë vend që do të ishte më e mirë për ne, ai do të na vendoste atje, sepse ai mund ta bënte këtë.“

„Të dashur fëmijë! Sot dua të ju them që të luteni para çdo pune dhe me lutje ta përfundoni punën tuaj. Nëse veproni ashtu, Zoti do të bekojë ju dhe punën tuaj. Këto ditë luteni pak, kurse punoni shumë. Prandaj lutuni! (5. korrik 1984.)

10

GRABITJA E THIRRJES

Të verbuar nga xhelozia

Një ditë fra Slavko foli se si njeriu mund t'i bëjë dëm veprës së Zotit, dhe të mos jetë i vetëdijshëm për këtë. Më duket se e dëgjoj duke thënë: „Kur prej Zotit fitojmë dhuratën që të bëjmë diçka të mirë për të tjerët dhe kur fillojmë ta praktikojmë atë dhuratë, tundohemi që të lidhemi për së tepërmi për veprat tona. Për shembull, kemi një apostullim, bashkësi, qendër ose veprimtari karitative që vërtetë është e frymëzuar prej Zotit, por papritmas vërejmë se dhuratë të ngjashme ka fituar edhe dikush tjetër, prandaj edhe ata bëjnë vepra të mira. Madje vërejmë se ai person është më i suksesshëm se ne në atë punë, dhe fillojmë të ndjehemi keq. Lejojmë të na vërshojë xhelozia. Kjo fillon të na mendojë dhe në fund përfundon si sëmundje e vërtetë. Në vend se të gëzohemi për shkak të të mirës që po bëhet, pikëllohem dhe frustrohemi se ajo e mirë nuk po rrjedh prej veprave tona. Çështjen e zmadhojmë aq shumë sa tjetrin fillojmë ta përjetojmë si kërcnim personal deri në atë masë sa dëshirojmë ta shkatërrojmë veprën e tij. Fillojmë të flasim keq për të dhe në mënyrë negative komentojmë apostullimin e tij, sikurse duam të theksojmë se ne jemi ai person i cili bën vepra të mira. Për shka të kësaj mund ta humbim paqen deri në atë shkallë, sa nuk jemi më në gjendje të bëjmë veprat e mira për të cilat jemi thirrur.“

„Ja pra, pranë të gjitha qëllimeve tona të mira dhe rezultateve të shkëlqyera që kemi arritur, në fund dëmtojmë veprën e Zotit dhe e pikëllojmë Atë! Si ta evitojmë këtë? Duke kërkuar vetëm Zotin dhe lavdinë e tij në të gjitha punët që bëjmë pa përzier interesat tona personale. Duke pranuar se me sa lehtësi i përvetësojmë dhuratat e Zotit dhe duke i rrëfyer ato. Duke mos u lidhur me veprat tona dhe frytet që sjellin ato sepse ato fryte nuk na takojnë neve. Me qëllimin që të menjanojmë prishjen e veprës së mirë, ta shqyrtojmë zemrën tonë dhe të provojmë a është vërtetë e lirë, e lirë t'i lejojë Zotit që t'i marrë aktivitetet tona në çdo çast nëse është vullneti shenjt i Tij.“

Në misionet e tij në mbarë botën, fra Slavko ka parë shumë raste të tilla në grupet mariane. E dinte se çka fliste në ligjëratat e tij. Por ishte njeri i heshtjes. Ruante në zemrën e vet shumë fshehtësi mbi luftërat dhe shtërngatat që kishin përfshirë fëmijët e Zojës. I kujtonte në lutjet e veta, në mengjes, kur shkonte në kodër dhe ndërmjetësonte për të gjithë. Për fat, të gjitha ato qëllime janë varrosur bashkë me të. Është mirë të qëndrojmë zgjuar në mënyrë që ta pastrojmë mënyrën me të cilën i shërbejmë Zotit.

Jezusi ia ka thënë këto fjalë të mrekullueshme shenjtes Mechtilda: „Të gjithë ata që i respektojnë dhuratat që ua jap të tjerëve, do të fitojnë të njëjtat meritime dhe të njëjtën lavdi. Nëse një nuse është më e bukur se tjetra, kjo mund të jetë e bukur si ajo nëse i afrohet me zemër plot dashuri.”³⁰

Të verbuar me arbitraritet

Vicka është e palëkundur kur është fjala për planet e Zojës për botën, kurse Zoja është e palëkundur kur është fjala për dëshirat e Atit. Duket se në zemrat tona, nganjëherë mungon kjo qendrueshmëri, sikurse mungon edhe virtyti i frikës shenjte të Zotit në të cilën ajo bazohet.

Vicka nganjëherë merr udhëzime prej Zojës për bashkësi të reja, sidomos për ato në Brazil ku ato po lulëzojnë me shumicë. Njëra prej tyre quhet "Aleanza Misericordia". Edhe pse e re kjo bashkësi ka realizuar rezultate të shkëlqyera në mesin e fëmijëve dhe të rinjve të rrugës të lënë pa përkujdesje. Themeluesi i sajë është meshtari fra Antonello, nga Italia. I paisur mirë me dhurata shpirtërore të nevojshme për kryerjen e misionit të tillë, fra Antonello një pjesë të madhe të inspirimit e merr nga Megjugorja. Me një vërshim të paparaparë të Provanisë së Zotit e njohu Vickën, e cila, në befasinë e tij të madhe, donte ta takonte sa më parë. Ajo fillojë t'i flasë për bashkësinë e tij, para se ai ta hapte gojën! Në të vërtetë, Zoja, me rastin e një paraqitjeje, i kishte dhënë Vickës porosinë për meshtarin.

Me lejen e fra Antonell-it, dua të theksoj këtu një nga pikat themelore të kësaj porosie. E ulur në karrige, në dhomën e dëftimit, në shtëpinë e saj të kaltërt, i tha: "Zoja më ka thënë të ju them se ajo veprimtari mirëbërëse është vullneti i Atit që është në qiell. Ai e do këtë. "

Frati u përgjigj pak me dyshim: „A nuk ua thua këtë të gjithëve të cilët të pyesin për mendim kur duan të fillojnë një punë karitative?”

Pak e befasuar, Vicka vazhdoi: „Jo, Zoja më ka thënë t'ua them këtë dhe këtë që thash është pikërisht për ju! Zoja ju ka porositur se duhet të veproni vetëm kur bashkësia të vërejë se është vullneti i Atit Qiellor, dhe jo kur ndonjëri prej jush dëshiron të bëjë diçka dhe thotë se është vullneti i Zotit. Zoja më ka thënë të ju them se ka shumë bashkësi që lindin nga vullneti i vërtetë i Atit, vërtetë prej Zotit. Por, fatkeqësisht, njerëzit shumë shpesh marrin kontrollin mbi punët dhe nuk lënë hapësirë që të veprojnë Ati Qiellor. Bëjnë aq shumë punë sa nuk kanë më kohë që ta pyesin Atit për udhëheqje dhe të lutën që të njohin a janë vendimet e tyre në harmoni me planin e Zotit. Për këtë arsye Zoti i braktis ato projekte. Ato pushojnë së përparuari, dhe në fund vdesin fare. Në lidhje me ju këto janë vepra që Zoti i dëshiron dhe Zoja i bekon."

³⁰ Shenjtja Mechtilda nga Hackeborn, Gjermani shekulli 13.

Zoja nuk mund të ishte më e qartë! Askush nuk duhet të mendojë se është imun nga këto devijime sepse djalli është i tërbuar për çdo gjë që vjen prej Atit dhe do të bëjë ç'mos që t'i mashtrorë ata që duan të dëgjojnë dhe të veprojnë në harmoni me udhëzimet që marrin në lutje.

Ç'do të bëhej me Kishën nëse Gjon Pali i II. të mos ishte, para së gjithash, lutës i madh, dëgjues i madh dhe i varfër në shpirt, vazhdimisht i vetëdijshëm se anija të cilën drejton, nuk i takon atij? I stërngarkuar me punë, ai dinte ta ruaj atë të rëndësishmen: lidhjen personale, intime me Trininë Shenjte. Miqët e tij, për shembull, tregojnë se kur arrinin diku, pas një rruge rraskapitëse, nikoqirët u ofronin darkë para gjumit. Të gjithë uleshin pranë tavolinës por njëri mungonte: ishte ky Gjon Pali i II.! E kërkonin gjithandej dhe në fund e gjenin në kapelë të gjunjësuar para një ndalese të udhës së Kryqit. „Ah, sot është e premtë!“ – kujtoheshin. Kanë vërejtur se asnjë të premtë, Papa nuk shkon në shtrat pa e lutur udhën e Kryqit! „Aty nxjerr forcën,“ thoshte. Atë mbrëmje, pas lutjen, kishte ardhur përsëri para miqëve, i forcuar dukshëm, që të ju dëshirojë natë të mirë.

„Të dashur fëmijë!... Le të jetë rrëfimi shenjt akti i parë i kthimit, dhe pastaj, fëmijë të dashur, përcaktohuni për shenjtëri...“ (25. Nëntor 1998.)

11

KAFETERI APO KISHË?

Dublin, Irlandë viti 1998.

Lynn ishte e lodhur pamasë dhe nuk mund të qëndronte edhe për shumë kohë. Martesa ja zinte frymën dhe vuante si martire. I shoqi ishte alkoholist. I provoi të gjitha që të shëroi varësinë e tij, por kot. I dukej se më nuk mund të drejtonte situatën. Nuk pushonte së luturi Zojën që ta ndërpriste atë tragjedi, por asgjë nuk ndodhte. Kishte arritur në fund!

Papritmas, një mbrëmje, e vizitojë shoqja dhe i tha: „Lynn, pse nuk shkon me Leon në Međugorje? Do ta shohësh, Zoja do të bëjë diçka për ju. Atje fitohen hire të pabesueshme!“

Në zemrën e sajë u duk një fije shprese dhe vendosi të shkojë në Megjugorje edhe pse kjo do të thoshte se, në atë udhëtim duhet të shpenzoi ato pak kursime që kishte. Bisedoi me Leon në lidhje me këtë, por ai e refuzoi atë propozim në mënyrë kategorike. Nuk kuptonte pse duhet shkuar në Megjugorje kur i pëlqen shumë më tepër të jetë në kafene se sa në kishë? Por, Lynn nuk hiqte dorë. Vendosi që kurrsesi të mos shkante pa të. I propozoi një marrëveshje të pazakontë: „OK, Leo, shkojmë së bashku! Unë do të shkoj në kishë, e ti shko në kafene... kafene në Megjugorje!“ E bindi, me sukses, dhe shkuan! Lynn në Megjugorje e luste Zojën që një ditë burri i sajë të jetë me të në kishë, i kthyer, në fe.

Të tretën ditë, në mbrëmje, shumë vonë, Leo dual prej kafenesë dhe fillojë të bredhë nëpër Megjugorje, krejt i humbur. Në atë kohë të natës nuk kishte njeri që ta pyeste për drejtimin... Më në fund takoi njerin që shkante lartë-poshtë, sikur priste dikë. „Hej! Jam i humbur!“ klithi Leo.

„Ç'janë këto?“

„Këto? Këto janë rrëfyesëto.“

„Rëfyesëto? Po ju? Çfarë bëni ju këtu?“

„Unë jam meshtar. Meshtar pranë rrëfyesëtores, kuptoni?“

„Po, në të vërtetë, supozoj... supozoj se është shenjë se do duhej, uh, do duhej të rrëfhem?“

Leo u rrëfye për të parën herë pas fëmijërisë së vet dhe Gjaku i Krishtit rrjedhi mbi shpirtin e vlefshëm të atij njeriu aq shumë të vetëdijshëm për padenjësinë e tij para Zotit.

Tri vjet më vonë, saktësisht në vitin 2001., në shenjë mirënjohjeje, u kthyen në Megjugorje. Pas faljes së mëkateve atë natë, Leo nuk piu më asnjë pikë alkoholi!

Ajo që në Megjugorje mahnit aq shumë është liria mbretërore me të cilën vepron Maria. Pa marrë parasysh se çfarë do të ndodh, ajo është me ne, duke shpërndarë dhuratat e sajë qiellore të gjithë atyre që e vizitojnë. Nëse botohet ndonjë libër me qëllimin që të shkatërrojë Megjugorjen, kjo fare nuk i pengon brengës së sajë amënore me të cilën na shëron dhe ngushëllon! Nëse një ditë lexon në ndonjë revistë se nuk qenka paraqitur kurrë në Megjugorje, pa u hamendur Ajo vjen të njëjtën mbrëmje që të lutet me Ivanin, Marinë dhe Vickën.³¹

Nëse dëgjon prej dikujt se „duhet të jetë i kujdesshëm me shenjat“, vazhdon të jetë e dëgjueshme Birit të sajë i cili na e ka dhënë për Nënë. Ajo e di se nënë e vërtetë, para së gjithash, është zemra që jep shenja dashurie, dhe ajo, pastaj, shton mbi të! Ajo e di se i Keqi ngulfat botën me shenjat e vdekjes, të pranishme gjithandej. A thua ajo mund ta linte pa ndihmë këdo që do gjëndeje në situatë aq të rrezikshme?

Një mbrëmje, një voglushe tetëvjeçare e kishte parë te kryqi i Kaltërt në kohën që i dëftohej Ivanit. Pse pikërisht ajo? Liria e një mbretëreshe! Me mijëra të tjerë nuk e panë atë mbrëmje. Pse? Liria e një mbretëreshe! Në të dy rastet, Maria bën mirë dhe plotëson nevojat e çdo personi veç e veç. Jam mirënjohëse Nënës sonë Kishë që na ka lejuar lirinë të besojmë se Maria dëftohet në Megjugorje. Po, besoj se Maria këtu lejon që ta prekim dhe se këtu bën vepra të jashtëzakonshme.

E dashur Zojë, vazhdo të dëftohesh edhe shumë kohë! Ti ke thënë: „*Me çdo ardhje timen, përherë e më shumë, zgjërohet bretëria e Zemrës sime të Pamëkat, kurse djalli humb një pjesë të pushtetit të tij.*“

Edhe sa Leo-ve të tjerë u duhet ndihma jote? Të përbej që të vazhdosh të dëftohesh deri në triumfin e Zemrës sate të Pamëkat!

³¹ Duhet të dijmë të qeshim në mes të valëve të sulmit mbi Megjugorjen. Këtu na ndihmon një lexues me këto fjalë: „Pasi që nuk ka pasojë pa shkak, janë dy hipoteza: ose një rrenë e organizuar i ka çuar me mijëra njerëz në kthim (që paraqet probleme serioze teologjike dhe metafizike), ose kthimet mund t'i përshkruhen disa veprave të panjohura me prejardhje Hyjnore të cilat krejt rastësisht ndodhin pikërisht kur ka filluar mashtrimi i madh!“ Si tha humoristi Alphonse Allais: „Shakespeare nuk ka ekzistuar kurrë. Veprat që i përshkruhen atij, në të vërtetë i ka shkruar mashtruesi i cili rastësisht quhej pikërisht Shakespeare.“

„Të dashur fëmijë! Njerëzit duhet të thirren në rrëfim çdo muaj, sidomos në të shtunden e parë. Akoma nuk kam folur këtu në lidhje me këtë. I thërras njerëzit në rrëfim të shpeshtë. Do t' ju jap edhe disa porosi konkrete për kohën e tanishme. Pritni me durim se koha nuk ka ardhë ende. Bëni ashtu si u kam thënë. Shumë njerëz nuk i përmbahen kësaj. Rrëfimi mujor do të jetë ilaç për Kishën në Perendim. Këtë porosi duhet përcjellur në Perendim.“ (6. gusht 1982.)

12

JAM PA MËKAT, NUK KAM ÇFARË TË RRËFEJ

Disa persona kanë dhuratë antenat e veçanta shpirtërore. Kjo dhuratë vepron tek ta gjatë ditës, por nganjëherë i zgjon, madje, edhe natën. Kathleen Long është një rast i tillë, e cila vazhdimisht lufton me provokimet e Shpirtit Shenjt. Kathleen më ftoi të mbaj ligjëratë në konferencën Mariane në Chicago. Akoma dëgjoj në vete historinë e gjatë të cilën ma tregoi një natë para konferencës, derisa rrinim rehatshëm në dhomën e sajë të ngrënies. Akoma këndellej nga ngjarjet shokuese të cilat ishin renditur në jetën e sajë, ditëve të fundit... Kathleen është irlandeze stabile, me një mendje të shëndoshë. Gjithmonë flet drejt nga zemra. Kurse gjaku irlandez që qarkullon në venat e sajë, bën që ajo të jetë një aventuriere që asgjë s'mund ta ndal, pos vetë Zotit! Problemet e shumta shëndetësore dhe dramat familjare lanë gjurmë në zemrën e sajë, por nga kjo argjilë e dashur dhe e qëndrueshme Zotëria ka formësuar apostullin dhe profetin e vet. Shtëpia e vogël e Kathleen-ës frymon me lutje dhe me praninë e engjijve. Dhe kjo nuk është çudi sepse njëra nga dhomat – pikërisht ajo në të cilën kam fjetur natën pas bisedës sonë - është dhoma e vëguesit Jakov Çolo, i cili banon aty gjatë misionëve të tij në SHBA. Në atë dhomë Zoja i është dëftuar disa herë!

Kështu, atë mbrëmje me sy të përlotur më foli për maratonën e saj shpirtërore nëpër të cilën kishte kaluar dy-tri javët e fundit. Edhe kësaj here Shpirti Shenjt, pa paralajmërim i dha detyrë urgjente. „Jetoj në SHBA³², por atdheu im është Irlanda. Kohë pas kohe shkoj atje të vizitoj familjen. Kështu bëra edhe muajin e kaluar. Posa u ktheva në SHBA, shkova në seminarin treditor në shtetin federal të Gjorgjisë që të përsosem në informatikë. Natën e parë u zgjova në ora tre të mëngjesit dhe dëgjova: „Dëshiroj që të kthehesh në shtëpi!“ U përgjigja: „Nuk mundem, Zotëri! Posa u ktheva prej andej!“ Por, Ai vazhdoi: „Duhet të kthehesh! Menjëherë!“

Kathleen nuk mund të flinte më. Ideja për t'u kthyer në Irlandë i dukej pa kuptim. Tha me zë: „Pas një kohe të gjatë isha pikërisht atje, dhe mendoj të shkoj në qerrshor.“ Priti deri në ora shtatë të mëngjesit dhe u ngrit, pas katër orësh lufte të brendshme. Dhe para se ta prekte dyshe-menë me

³² E frymëzuar në Megjurgorje Kathleen në vitin 1990. themeloi Qendrën për Paqe. Nuk ka të ardhura fikse as ndihmën e dikujt, që i mundëson Mëshirës Hyjnore të veproi pa u penguar. Siç tha Shën Pali: „Sepse, kur jam i ligshhtë - atëherë jam i fortë.“ (2 Kor 12,10)

këmbë, në zemrën e sajë e dinte se i duhet të kthehet në Irlandë. Para kafjallit lajmëroi asistenten e sajë Cloe: „Më duhet të shkoj prap në Irlandë, Më duhet!

„Çfarë!? Posa u këtheve nga Irlanda!“ ja kthei Cloe, e shokuar. „Nuk mund të pres. Të lutem më blej biletën nga Atlanta në Çikago, e prej andej do të gjëndem disi me ndonjë fluturim për Dublin.“

Kathleen nga Chicago thirri familjen e sajë në Irlandë. I thanë se atje është çdo gjë në rregull! Kaloi edhe një natë. I thirri përsëri të shtunden në mëngjes. Nuk kishte asgjë për t'u shqetësuar, prandaj shkoi në meshë. Në çstin e shdërrimit ndjeu zërin këmbëngulës: „Duhet të kthehesh menjëherë në shtëpi!“

Mirëpo, nga ana tjetër e Atlantikut, e motra Barbara i tha se e kishte humbur arësyen: „Pse don të vish në shtëpi? Mos u bëj qesharake! Do të vish në qerrshor, do presim motin e bukur, do dalim dhe do kënaqemi!“

Të nesërmen Kathleen fluturoi për Irlandë dhe u paraqit para derës së Barbarës. I ra ziles.

„Çfarë bën këtu?!“ i tha Barbara e shqetësuar.

„Ja... Arrita dhe kjo është e gjitha. Vetëm doja të bindem se të gjithë janë mirë... Meqë ra fjala, në ç'kohë është mesha nesër?“

„Pusho një herë! S'është e thënë të shkosh në meshë...“

Motra e Kathleen, në të vërtetë, një kohë të gjatë nuk shkante në kishë, prandaj ishte pakëz e ndjeshme në çështjen e fesë.

Të nesërmen Kathleen shkoi në meshën e mëngjesit dhe kapi meshtarin: „Atë John, a mund të vish në shtëpinë tonë të vizitosh motrën time?“

„Pse don që ta vizitoj?“

„O... a nuk mund të vish, ashtu si pa obligim? Mund t'i jepnit vajimin e të sëmurëve. Vuan nga një formë e rrezikshme gripi. Edhe do të mund ta rrëfenit? Mund të thoni se ju kam ftuar për kafe ose diçka të ngjashme, në rregull?“

„Në rregull, do të provoj, por e njoh Barbarën dhe do ta ketë shumë të dyshimtë nëse paraqitem vetëm ashtu sa për t'i thënë 'mirë dita!'“ Kaluan dy ditë...Meshtari akoma nuk erdhi. Kathleen përsëri provoi ta bind që të vij duke pasur parasysh vajimn për të sëmuret dhe rrëfimin.

„Por pse është kaq me rëndësi!? - pyeti. „Dhe si mund ta bëj gjith këtë?“

U ulën dhe provuan që ta qetësojnë shoqi-shoqin. „Atë John, mos u brengosni çfarë do të thoni kur të vini. Vetëm ejani, e Zotëria do të kujdeset për të tjerat. Kjo është e sigurt. Jam e sigurt se vetë Zotëria kujdeset për këtë.“

Atë John më në fund erdhi. „O, Barbara, mirë dita! Si je? Erdha të vizitoj motrën tënde Kathleen. Dëgjova se u kthye nga Amerika! Atëherë iu kthye Kathleen: „Përshendetje, Kathleen. U ktheve për ndonjë arsye të veçantë?“

„Vetëm doja të kaloj një javë me familjen... Në të vërtetë, është shumë bukur këtu të shkosh në kishë dhe të lutesh para Të Shenjërueshmit!“

„A dini, atë John,“ e ndërpreu Barbara, „motra ime është një nga ata besimtar të krisur që mendojnë se e kanë shpikur fenë.“

„Vërtetë? Por si është e mundur? A nuk ju ka lindur e njëjta nënë?“

„Natyrisht se po,“ vazhdoi Kathleen. „Atë John, pasi që jeni këtu, a mund t'i jepni motrës sime vajin e të sëmurëve? Posa e kaloi një grip të rëndë.“

Duke u kthyer kah Barbara, atë John pyeti: „A do të dëshiroje?“

Barbara i luti të ja shpjegojnë se çfarë është „vaji i të sëmurëve.“

„Mirë atëherë, nëse do të më forcoi dhe nëse do të më ruaj që të mos sëmurem përsëri prej gripit... pse jo!!“

Pra, atë John i dha vajin e të sëmurëve, dhe Kathleen propozoi lirshëm: „Meqë jeni këtu, atë John, pse nuk do ta rrëfenit?“

Kjo nuk i shpëtoi Barbarës. Ngriu në vend. „Nuk kam çfarë të rrëfej. Nuk kam mëkat! Nuk dal nga shtëpia, askujt s'i bëj keq. Vetëm kujdesem për familjen!“ Mirëpo, megjithatë u rrëfye, duke ju falenderuar bashkëpunimit të shkathtë të atë John. Më vonë ia pranoi Kathleen-ës se trembëdhjetë vite nuk e kishte kaluar pragun e kishës. I shoqi, as që kishte shkuar ndonjëherë në kishë, dhe Barbara në fund i kishte pranuar qendrimet e tija ateiste. Është shumë më lehtë të lejojmë që gjërat të na rrëshqasin nga duart! Nuk ka më meshë, nuk ka më rrëfime!

Pasi që Barbara i mori sakramentet, Kathleen ndjeu një paqe të thellë në zemër dhe u kthye në SHBA po atë javë. Tri ditë pas kthimit, e thirrën nga Irlanda. Ishte mbrëmja në prag të mërkurës së Përhime. E motra, papritmas, kishte pasë atak në zemër dhe kishte vdekur në gjumë. I kishte gjashtëdhjetë e nëntë vjet dhe ishte nënë e tetë fëmijëve.

Kathleen e kishte pyetur nganjëherë: „Barbara, si mund të flesh, e kurrë të mos shkosh në rrëfim? Po nëse Zotëria të merr në mes të natës!“. „Nuk mendoj kurrë për këtë...“ Barbara gjithmonë jepte të njejten përgjigje.

Rrëfimi i Faustines

Para disa dekadash në Poloni, një shenjte e madhe ishte infektuar me tuberkuloz. Atë që ajo ka përjetuar mund të na e plotësoi shëndritjen e sakramentit të madh të mëshirës. Motra e nderit Faustina Kowalska për shkak të sëmundjes nuk mund të shkonte në rrëfim për tri javë dhe në pendesë i qante mëkatet e sajë dhe kalonte nëpër tundime të caktuara. Por, fatmirësisht, kështu e përshkruan atë periudhë:

„Sot pasdite erdhi at Andrasz dhe u ul që të më rrëfejë. Në fillim nuk tha snjë fjalë. U gëzova shumë sepse kisha dëshirë të madhe të rrëfehëm. Si zakonisht, ja zbulova shpirtin tim. Ai m'u përgjigj në çdo imtësi. Ndjehesha jashtëzakonisht e lumtur, që mund t'i them të gjitha. Për pendesë më caktoi Litanitë e Emrit Tejet të Shenjtë të Jezusit. Posa desha të ja paraqes vështirësitë që i kisha kur i lus ato litani, ai u ngrit dhe më dha zgjidhjen. Papritmas doli prej fytyrës së tij një dritë e madhe dhe pashë se ai nuk ishte atë Andrasz, por Jezusi. Veshja e tij ishte e bardhë si bora dhe u Ai u zhduk menjëherë. Fillimisht isha pak e shqetësuar, por pastaj erdhi një paqe e çuditshme në shpirtin tim. Vëreja se Jezusi rrëfen plotësisht si rrëfyesit tjerë. Por zemra ime gjatë kohës së këtij rrëfimi ishte e përshkuar me diçka të veçantë. Nuk munda të kuptoj, në fillim se çfarë domethenje kishte kjo.“³³

Pasi që Jezusi e ka zgjedhur motrën Faustinë si „sekretaren e mëshirës së Tij“, ja zbuloi atë që ndjenjat tona nuk e kapin kur e marrim sakramentit dhe atë që Ai vetë ndjen në atë çast. Motra Faustinë me proklamimet e sajë të përshkruara në Ditar, na mundëson edhe neve që në njëfarë mënyre të depërtojmë pas perdes dhe na fut në mendimet Hyjnore, ndjenjat e Tij, dëshirat dhe dhëmbjet e tij të cilat shpesh na ikin. Por, se çfarë gëzimi do të ishte të zhytesh në ato pasuri, thellë në brendësinë e Zotit. Ai vetë e dëshiron këtë: të na lejojë të futemi në të dhe ta zbulojmë. Ja njëra prej pjesëve më të bukura mbi rrëfimin, e parë nga Zemra e Jezusit...

„Sot më tha Zotëria: 'Bijë, Kur vjen në rrëfimin shenjt, burimin e mëshirës Sime, në shpirtin tënd vazhdimisht prej burimit të Zembrës Sime rrjedh gjaku dhe uji që shenjtërojnë zemrën tënde. Sa herë që shkon në rrëfimin shenjt zhytu krejtësisht me besim të madh në mëshirën Time, që të mund të derdh në shpirtin tënd plotësinë e mëshirës Sime. Kur vjen në rrëfim, dije se Unë Vetët ë pres në rrëfyesëtore. Jam fshehur në meshtarin, por në shpirt veproj Unë Vetë. Aty mjerimi i shpirtit takon Zotin e mëshirës. U thuaj shpirtërave se nga ky burim mëshire mund të nxjerrin vetëm me enën e besimit. Nëse besimi i tyre është i madh, zemërgjërësia Ime është e pakufishme. Lumenj të hireve të mia vërshojnë shpirtrat e përvuajt. Kryelartët janë gjithmonë në varfëri dhe mjerim, sepse hiri Im largohet prej tyre, dhe shkon te shpirtërat e përvuajt.“³⁴

³³ Ditari i motrës Faustinë §817

³⁴ Ditari i motrës Faustin §1602. Papa Gjon Pali i Madh, deri sa ishte kardinal i Krakovës, i nxorri nga harresa dhe i qiti në dritë shkrimet e motrës Faustinë të cilat gabimisht ishin të anashkaluara dhe të harruara me vite. Tani është koha për leximin e sërishëm të atyre shkrimeve të cilat, së bashku me porositë e Megjugorjes janë ushqim provanik, i derguar prej Qiellit, kësaj gjenerate të humbur e të uritur për Zotin. Vetë Jezusi i ka shpallur motrës Faustinë: „Në Besëlidhjen e vjetër popullit tim i kam dërguar profetë me rrufe dhe bubullimë. Sot të dërgoj mbarë njerëzimit me

mëshirën Time. Nuk do ta dënoj njerëzimin e plagosur por dua ta shëroj, ta mbështes në Zemrën time të mëshirshme. Me dënime shërbehem kur më detyrojnë. Dora ime nuk e merr me dëshirë shpatën e drejtësisë. Para ditës së drejtësisë, dërgoj ditën e mëshirës.“ (Ditari §1588)

„**Të dashur fëmijë!** ...*Ju thërras që të gjithë të përcaktoheni për Zotin dhe prej ditës në ditë të zbuloni vullnetin e tij në lutje. Dëshiroj të ju thërras, të dashur fëmijë, në kthim të plotë që në zemrat tuaja të jetë gëzimi!*“ (25. qerrshor 1990.)

13

EJANI TA VIZITIJMË ATË PLAKË TË ÇMENDUR!

Në familjen tonë Maillard ishim gjashtë fëmijë. Kur isha vajzë e vogël, prindërit e mi, çdo verë, e ftonin, si musafir, çiftin bashkëshortor i cili na gëzonte gjithmonë. Ne fëmijët i quanim me emra nderi „xhaxhi Jean dhe tezja Sonia.“ Ai ishte shembull i përsosur i filozofit, i ndarë nga jeta reale³⁵. Citonte kapituj të tërë të Aristotelit, por ishte krejt i paaftë ta ziej një ve të rëndomtë për veten. Ajo ishte piktoresh nga Danimarka dhe së bashku kishin krijuar çiftin më të pazakontë që mund të omagjinohej. Së paku, ne fëmijëve, na dukej ashtu.

Ato ditë kënaqeshim shumë me tregimet e xhaxhit Jean. Duhej që vetëm pak ta nxisnim - „Na thuaj tregimin për ...“ – dhe ai menjëherë fillonte të tregonte me një precizitet të mahnitshëm fjalë për fjalë, shprehje pas shprehjeje, me të njëjtën rrallitje, të njëjtin tregim që na kishte treguar herën e kaluar! Nuk i pengonte fare (meqë as nuk kujtohej) se të gjitha tregimet e tij, tani më, i kishim dëgjuar. „Tregimeve moralizuese“ të cilat përcillnin shugurimin e pamohueshëm të Shpirtit Shenjt, ishin njëkohësisht edhe mahi – gjithmonë katër të njëjtat.

Çdo verë njëri prej nesh ishte i obliguar ta luste: „Xhaxhi Jean, xhaxhi Jean, na trego mahinë!“ Shqyeshim së qeshuri, sepse ai, me një ton të posaçëm zëri, që vëllëzërit e mi dinin ta imitojnë me aq shkathësi, i tregonte përsëri të katër mahitë, me të njëjtën renditje, duke qeshur si fëmijë deri sa karriga në të cilën ishte ulur tundej fuqishëm. Babai im na shkelte syrin, kurse nëna frenonte të qeshurit që ishte shenjë të pushonim dhe se e kemi tepruar. Të jem e sinqertë, mahitë e zhaxhit Jean ishin të vjetruara pakëz, në të vërtetë jo edhe aq qesharake, por ne e donim gjith atë rutinë.

Që nga viti 1940. Jean dhe Sonia vizitonin shtëpinë e Marte Robin³⁶. Rregullisht, gjatë kohës së ushtrimeve shpirtërore në *Foyer de Charité* ose në raste të tjera, bisedonin gjërësisht. Përvoja e

³⁵Nxënës i msgr. Guyke dhe teologut të madh atë Garrigou Lagrange, OP. Jean Daujat poashtu është shoqëruar me Jacques Maritain.

³⁶ Marthe Robin (1902-1981), mistikja e madhe franceze. Me atë Georges Finet themeloi Foyer de Charité. E-mail: foyer.de.charite@fdc-chateauneuf.com. Pasqyrën mbi jetën e sajë mund ta gjeni në librin e atë Raymond Peyret: „Marthe Robin: Kryqi dhe Gëzimi“ (Alba House 1983)

parë e Sonies me Marthen ishte pozitive, por një leksion i vështirë i përvuajtërisë. Lufta e parë botërore, posa kishte përfunduar, kurse ajo ishte paraqitur për ushtrime shpirtërore në qendrën e Martes. *Foyer* pikërisht hapej në vendin e stërmunduar nga lufta. Pjesmarrësit mund të bisedonin me Marten vetëm disa minuta në shtëpinë e sajë fshatareske në „La Plaine“ (zonë menjëherë mbi Châteauneuf-de-Galaure). Atë Finet, bashkëthemelues i Qendrës për ushtrime shpirtërore, ja paraqiste njerëzit një nga një ose dy nga dy në atë dhomë të vogël, të errët si shpellë, ku, e mbërthyer për shtrati, jetonte Marta.

Me rastin e vizitës së parë Martes, Jean dhe ajo u prezentuan dhe ndërruan përshendetjet e zakonshme. Përnjëherë Marta pyeti: „Zonja Daujat, a keni fjetur mirë mbrëmë?“ Sonia u përgjigj: „O, po Marta, falemnderit për pyetjen! Kam fjetur shumë mirë!“

„Pse më thoni se keni fjetur mirë, nëse nuk keni fjetur fare? Tërë natën e keni kaluar me dhëmbje në shpindë, duke u sjellur dhe kërcyer në shtrat e duke thënë: 'çfarë dysheku i tmerrshëm! Çfarë hosteli i mjerë është ky!'“

Heshtje. „Mirë, ...“ foli qetë Sonia, gjithmonë e sjellshme.

„Më premtoni, ju lutem, se do të kërkonti zonjushën Diane në *Foyer* dhe do ta lusni t'ua ndërrojë dyshekun. Kujdesuni që t'ua japë një shumë të mirë. Juve ju duhet i mirë. Juve ju duhet pushim!“ U dëshmuua se ajo ngjarje ishte fillimi i një miqësie të gjatë dhe të thellë!

Treshja nga Lyoni

Shumë vite më vonë diçka krejt e ndryshme ndodhi në Châteauneuf. Xhaxhi Jean na e thoshte atë tregim i mbushur me entuziazmin dhe nderimin e thellë të filozofit që e ka ndriçuar provania Hyjnore.

Një ditë prej ditësh, në një kafene të njohur të pjeses së vjetër të Lyonit, pranë tavolinës me shishen e verës rrinte një djalosh me dy dashnore. Ambienti ishte pa identitet, kurse biseda pothuajse nuk kishte. Një mërzi e paskajshme e kishte kapluar atë treshe. I kishin provuar të gjitha, i kishin bërë përsëri dhe përsëri të gjitha mëkatet e mundëshme, i kishin shijuar të gjitha dhe më në fund ju munguan idetë. Çfarë do të mund të imagjinonin për të sjellur pak risi në jetërat e tyre?

„Kam një ide!“ klithi djaloshi, dhe sytë i shkëlqyen me atë entuziazmin shpirtlig. „Pse të mos shkojmë të gjithë së bashku e të vizitojmë atë plakë të çmendur?“

„Cilën plakë të çmendur?“ pyeti njëra prej tyre.

„E di, atë marroçen nga Châteauneufa, ajo që gjithmonë është e mbyllur në errësirë!“

„A, ti mendon në 'mistiken'? Njerëzit thonë se i ka stigmat.“

„Merre me mend! Vë bast se është mashtrim për të fituar para!“

„Ideja më pëlqen!“- shtoi tjetra – „por na duhet një plan i mirë. Nuk është lehtë ta takosh.“

„Mos u brengos, e njoh dikë i cili ka qenë atje. Plani është i thjeshtë: do të paraqitemi në ushtrimet shpirtërore, të nesërmen do ta na pyesin se cili do të shkojë te Marta. Do të regjistrohemi dhe natyrisht, do të aktrojmë si tipa 'të devotshëm'!...“

„Kjo nuk do të jetë problem!“

„...dhe do të themi se kemi një pyetje të rëndësishme për të dhe se duhet ta takojmë të gjithë së bashku. Dhe kur të jemi në dhomën e sajë, do të argëtohemi duke e përqeshur, duke e fyer dhe sharë në mënyrat më të shëmtuara, mënyrat më të shëmtuara që i ka dëgjuar ndonjë herë! Nuk do të na harrojë deri në fund të jetës! Pastaj, natyrisht do të lajmërojmë shtypin!“ I gëzoheshin paraprakisht poshtërsisë që kishin ndërmend të bënin.

Tri javë më vonë, tre horrat tanë shtreshin si pëllumba. Në qetësi drekonin së bashku me pjesëmarrësit e tjerë të ushtrimeve shpirtërore në Châteauneuf-de-Galaure, kur i thirrën emrat e tyre: „Është rralla juaj që të vizitoni Martën. Pritni te dera e hyrjes në ora tre. Atë Finet do të ju vozis me makinë deri atje.“

Mirëpo, nuk ishin të vetëdijshëm për një detaj të rëndësishëm lidhur me rregullat e Foyer. Marta gjithmonë donte, që paraprakisht, të shihte listën e njerëzve që donin ta vizitonin. Në disa raste ua bënte të ditur se dëshira për vizitë nuk mund të realizohet, psh. Rasti i gazetarit i cili kishte fshehur aparatën fotografik ose i shakaxhiut që donte të dëmtoi reputacionin e Qendrës. Për secilin mysafir lutej veçanërisht.

Treshja jonë nga Lyon-i arriti në pritoren e Marte-s. Rrinin para stufës së druve që ishte e zbrazët, derisa ora e vjetër shënonte sekondat dhe minutat. Atmosfera ishte disi ndryshe. Nuk ishin aq të sigurt në vete si në kafenenë e Lyon-it, por ... pa brenga, plani i tyre ishte i përkryer! Duhet të ketë sukses!

Një grua doli prej dhomës së Marte-s me sy të përbotur... „Ejani, ngutuni, është rralla juaj!“ i thirri atë Finet dhe ngadalë i shtyri në dhomën e errët duke ndriçuar me një llambë vendin se ku duhet të uleshin.

Para se të kuptonin se ku gjënden, madje para se të gjenin karriget, Marta ju drejtua: „Filloni të qeshni! Është e gjitha që meritoj!“

Qetësi vdekjeje në dhomë. Treshja jonë ishte pa fjalë. Kishin kaluar vetëm disa sekonda kurse u dukej se janë aty tërë amshimin.

„Por Zonjë, ne“

„Thuani, thuani, mos keni frikë, mi thuani të gjitha që e mendojnë shpirtin tuaj, unë e di se çfarë mëkatore jam, unë e meritoj atë!“

Njeriu, i habitur me shkandullin e çastit, përpiqet të mbushet frymë dhe flet me zë drithërues:
„Por Zonjë, ne nuk duam të themi asgjë, nuk kemi ardhur për të përqeshur...”

„Po. Kujtoni atë mbrëmje, me 4 mars, në kafenenë e njohur të pjesës së vjetër të Lyon-it! Duke menduar se cili është veprimi i rrallës, vendosët të vizitoni 'marroçen nga Châteauneuf,' që ta përqeshni...”

Treshja mbeti pa fjalë. Frika u hyri në palcë dhe mbetën të shokuar. As nuk mund të mendonin më, përkulin kokën të topitur dhe pa zë... Të gjitha ishin gabim, humbën, nuk e kishin ditur... Dhe pastaj ngadalë mendjemadhësinë e tyre e zëvendësojë hapja e butë dhe e ndjeshme e zemrave të tyre. Dhe Marta vazhdon të flasë me ta, duke shpëtuar situatën.

Djaloshi dhe dy dashnoret e tij dëgjojnë Martën më se një. Dashuria e sajë e pakufishme ndaj të gjitha gjallesave ngadalë i përfiton dhe nuk përpiqen më që të fshehin. Duket se ajo i di të gjitha për ta, por ajo që i çudit më tepër është se u duket se i do ashtu si janë, ashtu si do nëna. Duket, madje se ajo e shikon veten si më pak të vlefshme se ata. I nderon pa masë dhe u tregon shkëlqimin e planit të Zotit për jetërat e tyre si të krishterë. Duket se fare nuk e merr parasysh faktin se jetërat e tyre të deritashme nuk janë të përgatitura të dëgjojnë fjalë aq të pastra aq të ngritura! Ajo shpjegon për bukurinë e jetës së atyre që e duan Zotin dhe për shkëlqimin e shpirtit të bashkuar thellë me Jezusin. Janë të magjepsur me entuziazmin e sajë.

Atë ditë, në fermën e vogël e të parëndësishme La Drome, dashuria ngadhnjen mbi urrejtjen. Dhe kur të tre miqët tanë dolën nga shtëpia e Martës, derisa veriu i ftohtë dhe i ashpër u rrahte fytyrën, ishin të shndërruar, të hutuar nga gëzimi. Duket se kishin udhëtuar shumë, shumë larg, në një botë tjetër.

Frytet e këtij takimi: një rregulltar dhe dy motra nderi.

„**Të dashur fëmijë!** Sot ju thërras që t'i hapeni lutjes. Le të ju bëhet lutja gëzim. Përtërijeni lutjen në familjet tuaja dhe krijoni bashkësi lutjeje dhe ashtu do të ndjeni gëzim në lutje dhe në bashkësi. Të gjithë ata që luten dhe janë anëtarë të bashkësive të lutjeve, zemrën e kanë të hapur për vullnetin e Zotit dhe dëshmojnë me gëzim dashurinë e Zotit. (25. shtator 2000.)

14

GJUHA E PANJOHUR

Atë mbrëmje, si edhe të enjteve të tjera, kripta e Shën Sulpic-it në Paris ishte e mbushur plot. Pierre Goursat, themelues i *Bashkësisë së lutjes Emmanuel*, në mënyrë gjeniale e kishte zgjedhur atë pikë strategjike në zemër të lagjes Latine për takimin e anëtarëve të bashkësisë së lutjes e cila rritej vazhdimisht. Ishte më 1975., kurse prej vitit 1973., Parisi ishte dëshmitar i ndërhyrjes së jashtëzakonshme me titull „Përtëritja karizmatike“. Udhëheqësi Pierre, më bëri vendin në anën e tij të majtë që të mund të mbaj një fjalim të shkurtër gjatë lutjes. Në të djathtë ishte Suzanne, e cila duhet të mbante gjërat nën kontroll (sepse takimi ishte i hapur për të gjithë) dhe të lexonte diçka nga Bibla gjatë lutjes.

Në takim erdhën edhe dy të panjohur dhe u ulën. Njëri ishte i veshur me të zeza. Askush nuk u kushtojë kujdes sepse lutjet kishin filluar dhe gëzimi jehonte në kriptë me lavdërime dhe me këngë. Pastaj erdhi koha për lutjet spontane dhe koha e heshtjes për të dëgjuar Shpirtin Shenjt. Papritur më përfshiu një ndjenjë shumë e fortë. Ndjeva se diçka ishte vendosur në zemrën time, por nuk e kisha idenë se çfarë ishte ajo. Ishte e qartë se nuk ishte vetëm për mua, por për të gjithë. Fillova të djersitesha dhe zemra më rrihte fort: e dija se duhet ta përcjell porosinë, por nuk e dija se çfarë duhet të them. E kuptova se duhet ta hapja gojën dhe të flas, por për shkak të turpimit tim, prita disa çaste. Ndjeja se nuk do të qetësohem derisa nuk e përcjell porosinë. Në raste të tilla, më së vështiri është të thuhet tingulli i parë - fillimin e fjalës së parë - sepse pastaj Shpirti Shenjt vazhdon. Atë mbrëmje prej gojës sime doli kënga në gjuhë të panjohur. Tubimin e përfshiu një heshtje e thellë. Pierre u kthye kah unë dhe më pyeti: „A e kupton atë që këndove?“

„Jo... por ndjeva praninë e fuqishme të Marisë.“

Disa minuta më vonë foli Suzanne. Ajo foli, poashtu, në gjuhë të panjohur. Edhe një herë tubimin e përfshiu një heshtje e thellë. Çuditërisht askush nuk i shpjegojë këto dy porosi. Sa dëm! Shën Palit, apostullit të madh, kjo nuk do t'i pëlqente. Ai mendonte se i gjithë tubimi duhet t'i kuptojë fjalët e thëna në gjuhë sepse ashtu ato mund të edukojnë të pranishmit³⁷

³⁷ 1 Kor 14, 13-28

Një orë më vonë lutja përfundojë. U përshëndetëm ngrohtë dhe pak nga pak kripta u zbraz. Edhe unë isha gati të nisem kur mu afrua një njeri. Ky ishte ai me rroba të zeza, që kurrë më parë nuk e kisha takuar, dhe këtu ishte për të parën herë.

„Zonjushë, ku kini mësuar të flisni gjuhën siriano-aramike?“

„Oh, më falni? Siriane...?“ – unë qesha, por ai ishte serioz.

„Ju folët në mënyrë të përsosur gjuhën siriano-aramike. Ku e keni mësuar?“

„Atë,“ thash, ende duke qeshur, (kujtova se ishte rregulltar) „kurrë nuk e kam mësuar dhe as që e kam ditur se ekziston!“

„Mosni, zonjushë. Kënduat në atë gjuhë para më pak se një ore dhe, më duhet të them, me theks të përkryer. Ajo gjuhë ka një tingull që asnjë European nuk mund ta thotë si duhet, kurse ju e bëtë në mënyrë perfekte. Dhe mbi të gjitha, evituat një gabim gramatikor shumë subtil në fillim të fjalisë suaj.“

„Ah, kuptoj... Mendoni gjatë lutjes?“

„Po.“

„Ajo ishte kënga në gjuhë. Kur dikush këndon në gjuhë, ai, nuk mund të kuptojë gjithmonë atë që këndon.“

„Ju nuk e kini kuptuar domethënien e fjalëve tuaja?“

„Jo, asnjë fjalë! Mirëpo, unë vërtetë e kam ndjerë praninë e Nënës së Zotit, por kjo ishte vetëm ndjenjë.“

„Zonjushë, më lejoni edhe disa minuta. Unë e di goxha mirë gjuhën siriano-aramike, dhe shpesh lutem në atë gjuhë. Ajo që më ka goditur ishte se kënga juaj ishte lutje e drejtuar Marisë.“

„Oh, Po ju e paskeni kuptuar? Atëherë mund të më thoni se çfarë kam kënduar?“

„Po, i keni drejtuar përshëndetje dhe lavdërime Nënës së të gjithë njerëzve të Zotit. Fjalët tuaja ishin shumë të ngjashme me Të falemi Mari, por keni shtuar disa lavdërime që janë ndryshe nga ato klasiket 'hirpote' dhe e 'bekuar je mbi të gjitha gratë'.“

Pastaj nxori një copë letër, prej çantës së dorës, dhe filloi të shkruaj këngën duke përdorur alfabetin gjegjës. Isha e lumtur kur kuptova se në këngë bekohej Zoja dhe se dëshira e sajë ishte që unë ta kuptoj këtë.

Ishte e qartë se atë mbrëmje nuk do të shkoja së shpejti në shtëpi. Pashë se si ai rregulltar e grabiti Suzanne-n që të bisedoi edhe me të, sepse ajo përcolli porosinë tjetër në gjuhë.

Ai ishte atë Louis Leloir, prift benediktin, profesor i gjuhëve semite në universitetin e Louvain-it në Belgjikë, i cili rastësisht ishte njëri nga ekspertët më të mëdhenj të gjuhës siriano-aramike. Në të vërtetë ai e fliste rrjedhshëm.³⁸ Kur vinte në Paris, shpesh banonte te mikut e tij, atë Jean-Marie. Ai prift dinte për takimet tona të lutjes dhe i vlerësonte, duke konsideruar se në to lulëzojnë dhuratat e Shpirtit Shenjt. Kishte vërejtur frytet e mira të kthimit te besimtarët e famullisë së tij. Atë Leloir nuk ishte entuziast si atë Jean-Marie. Madje edhe kishte deklaruar se „ajo është një marrëzi e cila mund t'i mashtroi njerëzit“. Ai ia zinte për të madhe atë. Jean-Marie-së se e kishte lejuar veten të mashtrohej nga ajo marrëzi.

Shpjegonte se lotët e pendesës, sipas etërve të shkretëtirës, janë karizma më e madhe. Ato çojnë te pendesa dhe kthimi i sinqertë. Dhe e këshillonte atë Jean-Marie-në se „për shpirtin do të ishte një gjë e pamenduar mirë, të dëshiroi karizma të tjera pos dhuratës së lotëve. Është dhurata më e çmuar e Shpirtit Shenjt dhe të gjithë do duhej ta dëshirojnë. Të gjitha të tjerat të ashtuquajtura karizma vetëm sa i hutojnë, dhe i largojnë njerëzit prej asaj që është e rëndësishme. Ti vërtetë do duhej të luftoje me këtë - e gjithë ajo lëvizje e re është një katastrofë e vërtetë!“

P. Jean-Marie qendronte i qetë. E dinte se si do të arrinte pikën e dobët të mikut të tij: „Ti je profesor! Si mund të refuzosh diçka pa e pasë hulumtuar paraprakisht? Eja me mua sonte në kishën e shën. Sulpici-t! Edhe Jezusi u tha nxënësve: 'Ejani e shihni!'“³⁹ Së pari duhet të shohësh, të dëgjosh dhe të prekësh.“

Kështu, duke kontrolluar natyrën e tij refuzuese, atë Leloir shkoi me mikun. Arriti te kriptat e shën. Sulpici-t. Goditja e parë ishte kënga në gjuhë, por erdhi një goditje edhe më e rëndë me porosinë e thënë nga Suzann-a. Ajo përcolli në gjuhën e vjetër hebraike, një vizion shumë të frymëzuar të priftërisë në sytë e Zotit. Dhe, e gjithë kjo ndodhi kur, atë Leloir duhej që në një revistë të specializuar të shkruante një artikull mbi priftërinë. Luftonte duke u përpjekur që të gjente diçka që i mungonte për të përfunduar artikullin. I lutej Shpirtit Shenjt t'i dërgojë ndihmë sepse e bllokonte çështja që kishte të bënte me dy format e priftërisë, priftëria ministeriale dhe priftëria mbretërore laike.

Sa u befasua kur dëgjoi informatën më të shndëritur lidhur me këtë, në gjuhën hebraike! Kurse informatën e përcolli një Franceze e re e cila nuk fliste ndonjë gjuhë tjetër! Artikulli i tij ishte i

³⁸ Ai e ka përshkruar këtë ngjarje dhe takimin tonë në Prais në librin e vet „Communion“, në gjuhën frenge, botuar nga rendi Benediktin

³⁹ Gjn 1,38-39

gatshëm, me përgjegjen të dërguar prej qiellit! Vlen të vërehet prekja e Shpirtit Shenjt përplot humor: Suzanne nuk foli as në gjuhë hungareze as kineze; për më tepër, ajo foli në gjuhën e vjetër hebraike, në gjuhën, të cilën vetëm atë Leloir ishte në gjendje ta kuptojë dhe ta mbaj mend prej të gjithë atyre që ishin të tubuar në atë tubim të përshtirshëm!⁴⁰

Së shpejti, u miqësua shumë. Qysh atëherë atë Leloir e ndërroi kahjen. Ai tani i shpall këto shenja të Shpirtit me të njëjtin intensitet që i përçmonte në të kaluarën. Kurse Shpirti Shenjt nuk e braktisi. Një ditë pas ngjarjes në Shën. Sulpici-n, atë Leloir shkoi në Londër që të mbajë një ligjëratë në takimin ekumenik. Atje e shokoi një vëlla protestant, anglez. Në mes të lutjes, e dëgjoji se si këndonte në gjuhë, në gjuhë të përsosur të vjetër latine. Ai këndoi një formë litanie Zojës! Zoti ka rrugët e veta të ekumenizmit!

Pasuria për kohërat e reja

Shpirti Shenjt është para nesh, dhe lutja e tij në ne, plot gëzim, i tejkalon kufijt e dijes sonë dhe ngurtësinë e psikës sonë të lënduar. Dhe kështu ndodh që pikërisht ata që janë me arsimim më të ulët, ata që kanë dije më të pakta mbi fenë, mund të ngriten te Zoti në lutje dhe madje t'i përcjellin porosi ndonjë personi për të cilin nuk dijnë asgjë. Gjuhët janë një shenjë e prekshme e kësaj dhe kjo është e përshtirshme shumë mirë në Veprat e apostujve.⁴¹

Më duket se kjo dhuratë, më e vogla në familjen e karizmave, duhet të zhvillohet në përgatitjen tonë për kohërat e Reja. Lutja në gjuhë riformëson harmoninë e brendshme të njeriut dhe e ndërton atë. Nëse ai kalon nëpër fazat kur e ka humbur drejtimin, nëse më nuk di se çfarë të thotë, çfarë të mendojë, çfarë të lutet, atëherë vjen dhurata e gjuhëve ta shpëtojë nga pamundësia e tij. Nëse të gjitha i ka harruar për shkak të të shokuarit fizik dhe moral, ose ia kanë shpërlarë trurin, ai akoma e ka këtë murmuritje të pakuptueshme, këtë bulëzim hyjnor. Ai di të lutet nga brendia e qenies së vet, së bashku me Mikun e jashtëzakonshëm që e posedon shpirti i tij, me Mikun i cili i kujton të gjitha dhe i cili e kompenzon dobësinë e tij. Se çfarë ngushëllimi sjell kjo!

Zoja në Megjugorje u është dëftuar vëguesve në mënyrën e komunikimit e cila në qiell ekziston në mes të Zotit dhe të lumturve, dhe shkon drejtpërdrejt nga njëri te shpirti tjetër. Fjalët tona të varfëra njerëzore, me gjith barrën frustruese të moskuptimit, hapin rrugën për kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të përsosur të porosisë që këmbehet. Atje, çdo gjë është e ekspozuar shkëlqimit të dritës hyjnore. Sikurse shën Tereza nga Lisieux (Lulja e vogël) kishte zakon të thoshte: „Çdo

⁴⁰ Dikush do të mund të dyshonte në këtë ngjarje sikur të mos ishte fakt se atë Louis Leloir është profesor i njohur në botë, i famshëm për precizitetin e tij shkencor në analizimin e gjuhëve të vjetra. Miqtë dhe kolegët e tij e kanë dëgjuar se si e ka treguar shumë herë këtë ngjarje. Poashtu, ata kanë vërejtur edhe ndryshimin e habitshëm të qendrimit të tij ndaj përtëritjes karizmatike franceze pas ngjarjes në kriptën e shën. Sulpici-t.

⁴¹ “Të gjithë u mbushën me Shpirtin Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë të ndryshme, ashtu si Shpirti Shenjt i shndriste të shpreheshin.” (Vap 2,4).

gjë do të thuhet me një shikim.“ Lutja në gjuhë është një mënyrë me të cilën i afrohem këtij realiteti. Të dëshirosh qiellin, të lejosh që Shpirti i Dashurisë të lutet në ne, është vërtetë një dhuratë e madhe!

„Të dashur fëmijë! Mos keni frikë, sepse jam me ju edhe kur mendoni se nuk ka rrugëdalje dhe se djalli ka ngadhnjyer. Unë ju sjell paqen.“ (25. korrik 1988.)

15

ENDACAKU NGA CHÂTEAUNEUF

Andrée dhe Paul Thomae shpesh më tërhiqnin vërejtjen për shkak të lidhjes sime me Zojën. Si pentakostal të vërtetë dhe besnik, nuk ndjeheshin mirë kur më dëgjonin se e thirrja në lutje. Në jetën e tyre nuk ekzistonte fare dimension i marian, prandaj lutesha për ta, me zjarr, që të mundën një ditë të shijojnë gëzimin duke e marrë „me vete në shtëpi“ Nënë Qiellore. Lutesha që t'i ofrojnë Zojës mirëseardhjen, dhe që zemra të ju zgjërohen me dhuratën e madhe që Jezusi e ka ofruar prej Kryqit.

Në atë kohë Marta Robin⁴² ishte në vitet e fundit të jetës së sajë në këtë tokë. Jetonte në shtëpi në Châteauneuf-de-Galaure. Atë Finet zakonisht fliste për Zojën i përshkuar me aq hir sa që ishte gadi e pamundur që vijuesit e seminarit të mos i kushtohen për pjesën e mbetur të jetës. Marta i kishte besuar Atë Finet-it aq shumë informata të rëndësishme mbi Zojën tonë! Çdo javë Zoja e vizitonte Marthe-n që ta mbështesë dhe trimërojë, para se ajo, të enjten në mbrëmje, të hynte në Mundimin e Krishtit.

Dhe kështu i sugjerova Andrée-së që të provoi diçka. „Para se Marisë të ja mbyllësh derën plotësisht,“ i thashë, „pse nuk do ta studjonte pak më mirë këtë çështje me disa njerëz që janë shumë të afërt me Zotin, dhe të cilët çdo vit i kthejnë Krishtit me qindra besimtarë të vakët dhe jobesimtarë?“

Kaluan disa vite para se të vendoste.

⁴² Marta Robin stigmatja franceze. Në Romë është hapur procesi për beatifikimin e sajë. Jezusi e kishte lutur që në të Të jetonte mundimin e tij. Ajo ka pranuar. Më shumë se 50 vjet, çdo të enjte, Jezusi e pyeste se a mund ta jetojë mundimin e vet në të. Ajo përgjigjej „po“ dhe hynte në ekstazën e dhëmbëshme deri të shtunden në mbrëmje. Gjendej në Jerusalem dhe shikonte Jezusin dhe mundimin e tij, por edhe vetë jetonte mundimet e njëjta nëpër të cilat Ai kalonte. Përshkrimet e papublikuara të mundimit, që ajo ka lënë, janë shumë të ngjashme me ato që ka dhënë e lumturuara Anne Catherine Emmerich (motër nderi dhe stigmate gjermane e cila ka vdekur më 1824). Përshkrimet e sajë do të publikohen pas beatifikimit.

Dhe kështu erdhi dita kur Paul dhe Andrée voziteshin në Renault-in e tyre të vogël, rrugëve dytësore të Francës, duke u lëshuar luginës së Rhone-s. E dinin se nuk kishte kohë për të humbur. Nuk guxonin të vonoheshin në Châteauneuf, duhej të ishin atje të hënën në mbrëmje për fillimin e seminarit pesëditor.⁴³ Nuk kishin mundësi të paguanin çmimin e autostradës së bukur në mes të Paris-it i Marseille-it. Në buzë të fshatit pranë rrugës qendronte një pesëdhjetëvjeçar. Ishte i veshur me rroba varfanjaku, me flokë të çrregullt. U bëri me dorë që të ndalojnë. Për Paul-in dhe Andrée-në ishte e qartë se çfarë duhet të bëjnë. Si të krishterë nuk u shkonte nëpër mend që ta lënë në rrugë vëllaun në nevojë. Njeriu hyri në makinë, me një disponim të zymtë, me dhëmbje. Kur e pyetën se ku shkonte, nuk ishte krejtësisht i sigurt. Vetëm dinte të kërkonte „pak diell në jug...“

„A e njeh Jezusin?“ E pyeti Paul-i.

„Paj...“ u përgjigj.

Filluan bisedën vëllazërore. Duke vërejtur se destinimi i tij ishte goxha i mjegulluar, Andrée i ofroi që ta marrin me vete në seminar. E pranoi ofertën pa vullnet. Andrée nuk dinte asgjë në lidhje me rregullat e rrepta që kanë të bëjnë me pranim në seminarin në Châteauneuf. Ajo dinte vetëm për „konventat“ e mëdha që protestantat organizojnë – një karizmë krejt e ndryshme!

Vonë, në mbrëmje arritën në Châteauneuf . Të tre miqtë morën programin e seminarit dhe gjetën dhomat e tyre. Kur lexuan programin, Paul dhe Andrée u pikëlluan. Nuk përmendej „takimi karizmatik i lutjes“ në ato pesë ditë të cilat, me që ra fjala, ishin të ngjeshura mirë. „Nuk duhet të brengosemi,“ mendonin, „do të ja shtojmë ne .“ E planifikuan takimin menjëherë të nesërmen në mëngjes, para se të fillojë programi i përbashkët.

Pas një nate goxha të shkurtër, fshehurazi u takuan në njërin nga dhomat derisa rrezet e para të diellit çfaqeshin në qiell. Paul dhe Andrée filluan të bekojnë dhe të lavdërojnë Zotin me gjithë zemër, duke e falenderuar paraprakisht për të gjitha huret të cilat i kishte përgatitë për ta na këtë vend shenjt, edhe pse u dukej disi i huaj. Por njeriu, i hutuar, nuk bëzënte. Gjatë lutjes, si ndodh shpesh, Andrée tha disa fjali në gjuhë. Porosia ishte e pakuptueshme. Për të ishte fare normale. Kishte besim në Zotërinë se do ta zbulonte kuptimin, nëse dëshiron. Vazhduan ta lavdërojnë.

Papritur, njeriu filloi të qajë. Nuk mund t'i mbante më lotët. Në fund u thye: „Andrée, ti flet polonisht?“

„Jo! Pse? Kam folur në polonisht?“

⁴³ Para se të hapte Qendrën për ushtrime shpirtërore, atë Finet planifikonte të mbante seminare treditore. „Jo,“ i tha Marta, „askush nuk e ndërron shpirtin për tri ditë. Seminarët shpirtëror duhet të zgjasin pesë ditë.“

„Po! Në të vërtetë, kjo është më tepër dialekt. Ky është dialekti i fshatit tim të lindjes në Poloni.“

Andrée u rrënoqeth. Sikur ta godaste rrufeja. Priste se çfarë do të pasojë. Por njeriu ngulfatej, memzi fliste ndonjë fjalë. Shoku ishte tepër i madh.

„Ky ishte dialekti yt?“ Pyeti Andrée. „Ti, atëherë e ke kuptuar këtë porosi në gjuhë?“

Endacaku kurrë nuk do ta harroi atë mëngjes. Miqësia e pazakontë që treguan Paul dhe Andrée - thjeshtësia e tyre, varfëria në gjëra dhe në shprehje, fituan besimin e tij. I huaji hapi zemrën dhe i ftoi në jetën e tij plot vuajtje, gabime dhe hidhërime, në ekzistencën e tij të mjerë dhe të shkatërruar. Atëherë, ua zbuloi fshehtësinë e tij:

„Isha meshtar. Por e braktisa para shumë vitesh. Unë jam mëkatar ... mëkatar i shkretë. I humba të gjitha. Një kohë të gjatë bredhi pa asnjë kuptim. Por sot... Andrée, ti nuk isha ajo që fliste! Ti nuk mund t'i dije të gjitha këto për mua, të gjithë ata persona dhe gjëra nga jeta ime... Fole në dialektin tim si të ishe dikush prej nesh, njëra nga fshati im, pa asnjë theks të gabuar! Por – ishte Jezusi që fliste. Foli ashtu si do t'i fliste meshtarit. Ai tha se më fal dhe se dëshiron të më kthejë në jetë, dëshiron që t'i kthehem sepse dashuria e tij kurrë nuk më ka braktisur. Ai thotë se unë jam akoma meshtar, se akoma i duhem, më thërret ta marr për dore, që përsëri të mund të jetojmë së bashku... Unë i duhem...“

Paul dhe Andrée qanin në heshtje. Ishin pa fjalë dhe jashtëzakonisht të lumtur. A nuk është thirrja e vetme e tyre që Krishtit të ja kthejnë shpirtërat?

Atë mëngjes në Châteauneuf, në mënyrë të pazakontë, para meshe ndodhi shndërrimi i shenjës së paqës. Dy laikë i dhanë shenjën e paqës meshtarit! Shenja të ujitura me lotë!

Personi që kujdesej për seminarin, në mënyrë të butë, ua tërhoqi vërejtjen pse ata vetë i kishin shtuar diçka programit të zakonshëm – ai nuk dinte asgjë për ngjarjen karizmatike e cila sapo kishte ndodhur – dhe i luti që në qetësinë më të thellë t'i zënë vendet së bashku me pjesëmarrësit tjerë të seminarit, Sa i takon Marte-s, themelueses së bashkësisë Foyer, bartëses së vogël të stigmave, e cila lutej dhe i paraqiste vuajtjet e sajë për meshtarët dhe mëkatarët, nuk e di a thua krejt ngjarjen e kishte parë në shpirt – ndoshta po – por mund ta marr me mend gëzimin e sajë të madh kur ka kuptuar për kthimin, të krahasueshëm me kthimin e Shën Palit në rrugën për në Damask! E marr me mend se ka qeshur me mendimin se Zoti, me dëshirën që ta kthejë meshtarin dhe birin e vet, i kishte zgjedhur dy pentakostal në takimin e fshehtë!

Ah, ekumenizmi nga Lart...

„Të dashur fëmijë! Thirrja ime që t'i jetësoni porositë që ua jap është e përditshme, sidomos fëmijë, sepse dua t'ju afrojmë zemrës së Jezusit. Fëmijëz, prandaj ju thërras sot në lutjen e kushtimit Jezusit, Birit tim të dashur, që secila zemër juaja të jetë e tij. Pastaj ju thërras në kushtimin Zemrës sime të Pamëkat. Dëshiroj që të kushtoheni personalisht, si familjet ashtu edhe famullitë, ashtu që çdo gjë t'i takojë Zotit nëpër duart e mia. Prandaj, fëmijëz të dashur, lutuni që të kuptoni madhësitinë e kësaj porositë që ua jap. Nuk dëshiroj asgjë për vete, por çdo gjë për shpëtimin e shpirtërave tuaj. Djalli është i fortë, prandaj fëmijëz, me lutje të qëndrueshme shtrëngonju fort rreth zemrës sime amënore. Ju falemnderit që ju prgjigjët thirrjes sime!“ (25. tetor 1988.)

16

KUSHTIMI NË TOKËN E MAFISË

Nuk është e vërtetë se të gjithë njerëzit në Sicili i takojnë mafisë! Pos kësaj, siç thotë shën Pali: „Kur u shumëzua mëkati, shumë më i bëgatshëm u bë hiri.“⁴⁴ Duket se atje, në disa dhjetëvjeçarët e fundit ka fryrë një erë e fortë e përtëritjes shpirtërore në katolikët:

Siracusa, 27. tetor 2001.

Një turmë e madhe prej afër njëzetë mijë vetësh ishte tubuar në manifestimin e jashtëzakonshëm. Ishte ftuar vëguesja Marija Pavloviq-Lunetti. Bashkësitë e lutjes së Marisë, Mbretëreshës së Paqës, me shumë kujdes e kishin planifikuar këtë iniciativë. Në të vërtetë, para ditës „D“ me mijëra Sicilianë kanë lutur nëntëshin dhe kanë agjëruar. U janë mbajtur edhe katekeza. Së bashku me Marinë, ishte i pranishëm edhe atë James Manjackal nga India, i njohur mirë në Europë për predikimet e tij dhe shërbesën e shërimit. Guvernatori, z. Salvatore Cuffaro, i cili poashtu ishte i pranishëm, ia kushtoi mbarë ishullin Zemrës së Pamëkat të Marisë. Gjatë aktit të kushtimit, katër herë duartrokitjet e turmës i ndërprejnë fjalën. Duke parë praninë e pandërprerë gjashtëmbëdhjetë vjeçare të Italianëve në Megjugorje, lehtë mund ta imagjinioj atë situatë! Shumë prej tyre qanin.

Pas aktit të kushtimit, Zoja iu dëftua Marisë në ora 17.30, njëzet minuta para meshës shenjte, si zakonisht. Gjatë dëftimit, Zoja dukej shumë e lumtur. Ajo u falenderua njerëzve të tubuar dhe u dha këtë porosi: „Nuk do të pendoheni për atë që keni bërë sot, as fëmijët tuaj dhe as fëmijët e fëmijëve tuaj!“ Kur u largua, Zoja e bekoi mbarë turmën me shenjën e kryqit.

⁴⁴ Rom 5,20

Qysh atëherë për çdo tetor organizohet tubim i madh për lutjen në Siracuzë që të përsëritet akti i kushtimit. Akti i parë i kushtimit solli një ngjarje të jashtëzakonshme.

Cetina, Sicilianja pesëdhjetëetrevjeçare, nënë e katër fëmijëve, që nga fëmijëria e kishte dhuratën e profecisë. Që të kuptoni nivelin e sajë shpirtërorë, ua them se ati i sajë shpirtëror është Matteo Lagrua, personalitet shumë i nderuar në Kishë, i cili është shpirtërori i dy kardinajve.

Më 5 nëntor të vitit 2002., rreth mesnate, derisa luste rruzaren, Cetina kishte vizionin e ujdhesës, në të cilin ishte një qytet. Shihnte edhe një gisht të madh që tregonte në të. Shihnte edhe Zojën të veshur me të bardha. Shikonte atë gisht dhe e shtynte tutje drejt detit që të mos jetë më i drejtuar në qytet. Të nesërmen më 6. shtator, ndodhi një tërmet i fortë. Epiqendra e tij ishte në det, saktësisht në nivelin e Palermos. Qyteti memzi e ndjeu. Dridhja ishte aq e fortë (5.6 sipas shkallës së Richter-it) sa që do ta shkatërronte qytetin plotësisht, sikur të ndodhte nën qytet. Atë Matteo tha se Jezusi ishte i mëshirshëm ndaj Sicilisë dhe se ai qytet ishte kursyer për shkak të ndërmjetësimin të Marisë. Kryetari Coffe deklaroi në TV kanalën e njohur nacional Rai 3: „Falënderoj Zojën që e ka shpëtuar Sicilinë nga tërmeti.“ Deklarata e tij u përcoll nëpërmes të Radio Marisë në mbarë Italinë.

Të mos e harrojmë këtë. Para se të paraqitej në Megjugorje, Zoja kishte dhënë të njëjtë porosi në Fatima, në Portugali, duke lutur që të ja kushtojmë Zemrës së Sajë të Pamëkat dhe Zemrës Tejet të Shenjtë të Jezusit jo vetëm njerëzit, por edhe familjet dhe famullitë, madje edhe popujt! Portugalia ishte i vetmi shtet që e bëri këtë si komb, dhe çfarë fryte të bukura solli! Portugalia ishte e kursyer gjatë gjithë luftës së dytë botërore! Kur trupat e Hitlerit ishin të gatshme për invazionin në Portugali, të krishterët e lutën me zjarr Zojën e Fatimes. Dhe ndodhi që ato trupa morën urdhërin nga Gjermania: *Kthehuni prapa!*

Ishte kjo më 1942., dhe armata gjermane nuk u kthye kurrë më që të kërcënoi Potugalinë. Maria kujdestaronte mbi pronën e sajë!

Gjon Pali II. dhe kushtimi i botës

Nuk është nevoja të shkruhet mbi kushtimin personal Marisë, që e ka bërë Papa i ndjerë Gjon Palit II. Ai e ka personifikuar *Totus Tuus*: kurrë nuk ka pushuar së ecuri me të, me ndihmën e sajë dhe në të.⁴⁵

⁴⁵ Në librin e tij „Të kapërcehet pragu i shpresës“ ka shkruar: „Totus Tuus. Kjo fjali nuk është vetëm shprehje devocioni, ose thjesht shprehje fetare. Është diçka më shumë... Po falë shën Luis Monfort-it (Louis de Monfort), filllova ta kuptoja se devocioni i vërtetë për Nënë e Zotit është në të vërtetë devocion kristocentrik, dhe është i rrënjësor shumë thellë në Misterin e Trinisë së Shenjtë të Zotit, si dhe në misteret e Mishërimit dhe Shëlbimit... Kjo formë më e pjekur e devocionit për Nënë e Zotit më ka mbetur e gjallë gjatë gjithë këtyre viteve, duke u shprehur në enciklikat *Redemptoris Mater* dhe *Mulieris Dignitatem*“. *faqe. 235*

Më 13. maj të vitit 1981., në Sheshin e shën Pjetrit, me rastin e tentimit të vrasjes i cili gadi i kushtoi me jetë, Ati i Shenjtë pati një përvojë të rëndësishme dhe vendimtare. Kuptoi se Maria, si Nënë e tij, ishte meritore se ai kishte shpëtuar! Trembëdhjetë vjet më vonë, në konferencën ipeshkvnore italiane, të mbajtur në kishën e Shën Marisë së Madhe, deklaroi: „Ishte dora amënore që e ka devijuar plumbin... dhe ka penguar që papa të kaloi pragun e vdekjes.“

Gjon Pali II. shkoi edhe më larg në kuptimin se ky atentat, në të vërtetë, për të ishte hir! Monsinjon Dziwisz, i cili ishte pranë tij në rrugën për në klinikën Gemelli, ka zbuluar se fjalët që Ati i Shenjtë i kishte thënë gjatë vozitjes ishin: „Mari, nëna ime. Mari, eja! Mari, eja!“⁴⁶

Duke shqyrtuar faktin se atentati ka ndodhur më 13. maj, në përvjetorin e Zojës Fatime, Gjon Pali II. shfytëzoi rastin e shërimit të tij për të medituuar mbi porosinë e Fatimes. Kërkoj që t'i sjellin nga arkivi çdo gjë në lidhje me ato dëftime, duke përfshirë edhe tekstin e fshehtësisë së tretë misterioze e cila akoma nuk ishte zbuluar, në mënyrë që të shohë kërkesat e Zojës. Pikërisht në klinikën Gemelli e ka menduar projektin e përgjigjes në kërkesat e sajë që duhej plotësuar pa shtyrje të mëtejshme.

Kisha si tërësi akoma nuk e kishte plotësuar kërkesën e Marisë për kushtimin e Rusisë dhe mbarë botës Zemrës së Sajë të Pamëkat. Kjo gjë kërkonte pranimin dhe pjesëmarrjen e të gjithë ipeshkëvijve. Papa punoi në këtë projekt me zjarrin e atij që e ka evituar vdekjen. Ai mundi të ndejë nevojën urgjente për aktin e kushtimit që do t'i sillte mirëqenje mbarë botës. Përkundër të gjitha pengesave, organizoi çdo gjë, dhe për më pak se tri vite nga tentimi i vrasjes, më në fund, nën udhëheqjen e tij ndodhi kjo ngjarje unike në histori. Maria kishte të drejtë: kjo punë mjeshtërore kërkonte dikë si Gjon Pali II., njeri i jashtëzakonshëm i cili më vonë ishte i nderuar me faktin se në funeralin e tij u tubuan udhëheqësit e shteteve!

Së bashku me të gjithë ipeshkëvijtë, ia kushtoi mbarë botën Zemrës së Pamëkat të Marisë, ku ishte e përfshirë edhe Rusia, pasi që monsinjon Pavel Hnilica ishte atë ditë në Moskë.⁴⁷ Vëguesja e Fatimes, Lucija, e cila atëherë ishte gjallë, deklaroi se Qielli e ka pranuar atë kushtim.

Gjon Pali II. e përsëriti aktin e kushtimit në vitin Shenjt, më 8 tetor 2000. Në praninë e tetëdhjetë kardinajve dhe njëmijë e pesëqind ipeshkëvijve. Marisë ia kushtoi mbarë botën. Deri në çastin e vdekjes së tij në vitin 2005., kurrë nuk ka pushuar së thirruri besimtaët që të ecin me sytë dhe zemrën e Marisë. I ka nxitur që të jenë me të, luftëtarët e lutjes për të cilët kjo gjeneratë e munduar ka aq nevojë, dhe që me të dhe në të, të ndërtojnë civilizimin e Dashurisë.

⁴⁶ Një muaj më vonë Zoja u dëftua në Megjugorje. A është kjo një ko incidencë e zakonshme?

⁴⁷ Shiko kapitullin „Në 'Pravda' ishte e vërteta!“ në librin „Mrekullia e Megjugorjes“

Dora e vogël e Age Bojaxhiut

Monsinjor Pavel Hnilica tha se më 1988., e kishte pyetur Nënë Tereze nga Kalkuta:
„Apostullimi yt me të varfërit është aq i suksesshëm! Ku është fshehtësia?“

Pa kurrfarë ngurrimi ishte përgjigjur se ai hir kishte ardhur nëpërmes të së ëmës. Kur i kishte shtatë-tetë vjet, me të ëmën përdore kishin shkuar në një shetitje të gjatë në një park jashtë fshatit. Pasi që nuk e dinte rrugën, Agëja e vogël do të mund të frigohej se do të humbiste, por dora e së ëmës i jepte një ndjenjë të thellë të sigurisë. Kishte lejuar që ajo ta udhëhiqte me dëgjuesë të përsosur. Atëherë nëna e sajë ishte ndaluar në rrugë dhe i kishte thënë: „Bija ime, ashtu si e ke vënë sot dorën tënde në t'imen, të lutem që gjatë gjithë jetës sate, ta vësh në doren e Nënës Qiellore, Virgjërës Tejet të Shenjtë Mari. Me të do të jesh e sigurt gjithmonë se nuk do të humbasësh, dhe kurrë nuk do të shkosh rrugës së gabuar. Kurr mos e lësho dorën e Zojës!“

„Atë Pavel,“ tha Nëna Terezë, „gjithmonë e kam mbajtur këtë këshillë të nënës sime, dhe kjo është fshehtësia ime! Deri sot, që i kam afër tetëdhjetë vjet, nuk jam penduar për këtë!“

Në të vërtetë, a thua në dorën e Nënës Terezë, që arrin deri tek të varfërit më të varfër, nuk e shohim dorën e Nënës së Zotit e cila u bashkohet fëmijëve të sajë në vështirësi. Çfarë do të bënte e vogla Age Bojaxhiu pa këtë dorë amënore?

Lutjet e kushtimit të dhëna nga lart

Në ndërkohë, kjo dorë amënore ka grabitur shumë të rinj. Ka kërkuar prej të gjithëve që të kushtohen. Por çkafit t'i kushtohen? Jetës religjioze? Jo domosdoshmërisht! Në çfarëdo statusi jetësor që të jenë, çfarëdo zgjedhje që të kenë për ardhmërinë dhe vendin e tyre në shoqëri, Maria i përkujton, para së gjithash në dhuratën e madhe që kanë marrë, prej Zotit, me pagëzim. Ajo u ka hapur rrugën që të jenë çfarë janë të gjithë të pagëzuarit nga brenda: meshtar, profet dhe mret!

Për të ju ndihmuar të rinjëve që të zhyten në Dashurinë e Vërtetë dhe të jetojnë në të, Nëna e Lume u ka dhënë tri lutje kushtimi nëpërmes të Jelena Vasil e cila ka dhuratën e të folurit të brendëshëm, lokucionit. Secili prej nesh mund t'i bëjë të vetat, Nëna jonë i ka krijuar për ne, ato kanë ardhur nga lartë! (nëntor 1983.)

LUTJA E KUSHTIMIT ZEMRËS SË KRISHTIT

O Jezus, e dimë se Ti ishe i butë

dhe se për ne e ke dhënë zemrën tënde.

Ajo është e kurorëzuar me kurorë therrash

dhe me mëkatet tona.

E dimë se edhe sot e kësaj dite lutesh
që të mos shkatërrohem.
Jezus, na kujto kur të mëkatojmë.
Nëpër zemrën tënde Tejet Shenjte,
bëj që të gjithë të duhem.
Le të zhduket urrejtja mes njerëzve.
Na e trego dashurinë tënde.
Ne Të duam të gjithë dhe dëshirojmë
që të na ruash nga mëkati
me Zemrën Tënde baritore.
Hyr në çdo zemër, Jezus!
Trokit, trokit në zemrat tona.
Jij i qendrueshëm dhe i palodhur!
Ne jemi të mbyllur, sepse akoma
nuk e kemi kuptuar mirë dashurinë Tënde
Trokit vazhdimisht dhe bëj,
o Jezus i mirë, që Ta hapim zemrën,
Së paku kur kujtojmë mundimin Tënd
të hequr për ne. Amen

LUTJA E KUSHTIMIT ZEMRËS SË MARISË

O Zemër Tejet e Pastër e Marisë, përplot mirësi,
tregona dashurinë tënde.
Flaka e zemrës Sate, O Mari, le të zbresë mbi të gjithë njerëzit.
Ne të duam pamasë.
Ngul në zemrat tona dashurinë e vërtetë që të kemi mall për ty.

O Mari, zemër butë dhe e përvujtë, na kujto kur të mëkatojmë.

Ti e di se të gjithë njerëzit mëkatojnë.

O bëj që nëpër Zemrën tënde tejet të pastër Amënore,
të shëronemi prej çdo sëmundjeje shpirtërore.

O bëj që të mund të shikojmë gjithmonë mirësinë e Zemrës sate amënore
dhe që nëpër flakën e dashurisë sate të kthehemi. Amen

LUTJA E KUSHTIMIT

NËNËS SË MIRËSISË,

DASHURISË DHE MËSHIRËS

O Nëna ime, Nëna e mirësisë, dashurisë dhe mëshirës,
të dua pamasë dhe të kushtohem.

Nëpër mirësinë, dashurinë dhe mëshirën tënde më shpëto.

Unë dëshiroj të jem i yti (e jotja).

Të dua pamasë, dhe dëshiroj të më ruash.

Të lus nga zemra, Nëna e mirësisë,
më jep mirësinë tënde, që me të t'ja arrij parrizit.

Të lutem për dashurinë tënde të paskajshme të më japësh hiret,
që të mund t'i dua të gjithë ashtu si ti e ka dashur Jezu Krishtin.

Dhe të lutem për hirin që të mund të jem e mëshirshme ndaj teje.

Të kushtohem plotësisht dhe dëshiroj që të jesh me mua në çdo hap.

Sepse ti je plot hire.

Dhe dëshiroj që kurrë të mos i harroj.

Dhe nëse i humb, të lutem që të m'i kthesh. Amen.

„Të dashur fëmijë! Sot dua të ju mbështjell të gjithëve me mantelin tim dhe të ju çoj drejt rrugës së këthimit. Të dashur fëmijë, jepjani Zotërisë të gjithë të kaluarën tuaj, të gjithë të keqen që është shtresuar në zemrat tuaja. Dëshiroj që secili prej jush të jetë i lumtur, kurse me mëkat askush nuk mund të jetë. Prandaj, të dashur fëmijë, lutuni dhe në lutje do të njihni rrugën e re të lumturisë. Lumturia do të jetë e dukshme në zemrat tuaja dhe ashtu do të jeni dëshmitar të gëzueshëm të asaj që dëshirojmë, nga secili prej jush, unë dhe Biri im. Unë ju bekoj. Ju falemnderit që i jeni përgjegjur thirrjes sime!“ (25. shkurt 1987.)

17

VICKA NË SHKALLËT E SAJË

Kushtimi i mbarë vendit është diçka vërtetë e mrekullueshme, por ai nënkupton se ekzistojnë njerëzit të cilët janë kushtuar vetë...

Në Megjugorje Zoja i ka formësuar vetë personat që i janë kushtuar, edhe pse ajo i mban të fshehura mirë disa nga instrumentet e saja, të tjerëve iu lejon të bëjnë dritë si fener deti në qendrën e këtij fashti. Një nga instrumentet e saja është vëguesja Vicka! Në mënyrën e sajë të veçantë kjo zonjë mishëron suksesin e rëndësishëm të shkollës së Marisë, atë që Zoja i ka thënë bashkësisë së lutjes: „Kur do të flisni, njerëzit do ta njohin zërin tim.“

Duke jetuar si besimtare e thjeshtë e cila është e martuar dhe ka fëmijë, Vicka e kryen rrolin e vet të laikut në Kishë. Atë rrol e theksojnë shumë Gjon Pali II. dhe Benedikti XVI., dhe ai rrol është shumë profetik për gjeneratën tonë.

Rrallë kush nga laikët i kushtohet Zotit dhe Marisë ashtu nga thellësia e zemrës. Vicka gëzohet që atyre u ofron gëzim. Pa farë dyshimi ajo ka zgjedhur rrugën e vërtetë, sepse gëzimi i rritet për çdo ditë të jetës. Jeta e sajë është e rëndë në shumë aspekte – shpesh herë ka qenë në buzë të vdekjes! Por të gjitha që i ndodhin ajo i shndërron në dhurata që ia paraqet të dashurve të sajë - Jezusit dhe Marisë. Ajo i „paketon“ bashkë pikëllimet dhe gëzimet dhe me falënderim ia paraqet Jezusit. Kjo është mënyra se si ajo është e aftë t'ua përcjell Qiellin atyre që i afrohen. A thua se jeta e personit të kushtuar nuk përbëhet nga parashija e Qiellit që t'ju mundësohet të tjerëve që ta shijojnë? Falenderoj Zotërinë se aq shpesh kam marrë atë hir...

Një mengjes në ora tetë duhej ta takoja Vickën. Kur arrita, pashë një grup polakësh në oborr. Më dha shenjë që të pres pak: „Do të shihemi së shpejti, pasi që të bisedoj me këta,“ më tha. Kështu, fillova të lutem dhe prita që grupi të shkojë, duke u përpjekur të largoj nga vehtja mendimin për punën e madhe që më priste kur të kthehem në shtëpi. Kurse kjo zgjaste dhe zgjaste. Sa herë që

Vicka bekonte disa njerëz, vinte një grup tjetër. Kaluan tridhjetë, pesëdhjetë, shtatëdhjetë minuta...Në fund e humba shpresën dhe u ngrita që të shkoj.

Në atë çast Zoja më kapi për qafore dhe më foli në zemër. Nuk pata vizion ose një porosi që dëgjohej. Do thoja se ishte një komunikim i brendëshëm i cili do të mund të përkthehej si: „Rri aty dhe shiko shërbëtoren time Vickën. Më pëlqen mënyra si vepron ajo. Zemra e sajë është plotësisht në atë që bën. Shiko se si me mirëseardhje pranon çdo person që i vjen, me gëzim dhe dashuri. Shiko duresën e sajë. Ajo vepron ashtu si e kam mësuar, ashtu si do të bëja edhe unë vetë. Por ti, edhe ti bën ashtu!“

Në të njëjtin çast u zhduk nga unë mungesa e durimit. Shikoja me sytë e zemrës, skenën që ndodhte para meje dy orët e fundit. Atë ditë e kuptova pak më mirë hirin e vërtetë të Megjugorjes dhe sa kemi nevojë të shërohemi nga mënyra jonë, e tepruar njerëzore, e të qenurit efikas. Çfarë na duhet që të sjellim frytin hyjnor, frytin që mbetet. Maria është ajo që kultivon frytet e oazës së sajë të paqes dhe ajo në mënyrë të veçantë kujdeset për ato lloje që mësojnë dhe dëgjojnë vullnetin e sajë. Ato lloje janë të kushtuarit e vërtetë: ata asgjë nuk bëjnë pa të, kurse Jezusi dëshiron t'ju afrohet që të mbledh frytet e tyre.

„Të dashur fëmijë! Edhe sot ju thërras në lutje. Vetëm me lutje dhe agjërime mund të ndalet lufta. Prandaj, të dashur fëmijë të mi, lutuni dhe dëshmoni me jetën tuaj, se jeni të mitë dhe se mua më takoni, sepse djalli dëshiron në këto ditë të turbullta të mashtrisë sa më shumë shpirtëra. Prandaj ju thërras që të përcaktoheni për Zotin dhe Ai do të ju mbrojë dhe do të ju tregojë se çfarë duhet të bëni dhe cilës rrugë të shkoni. I thërras të gjithë ata që më kanë thënë „PO“, le ta përsërisin kushtimin birit tim Jezusit dhe Zemrës së Tij, edhe mua, që të mund të ju përdorim me shumë si mjet paqeje në këtë botë të trazuar.“ (25. prill 1992.)

18

POSA KALOVA ANDEJ

Një vend i vogël në Irlandë, 4. maj 2003.

Ishte rreth mesnate, kurse Inge akoma s'ishte këthyer në shtëpi. Shtrëngata sa vinte e forcohej. Shiu përplasej furishëm në dritaret. „A do të pushojë njëherë kjo fortunë?“ pyetej Mechthild. Ecte me nervozizëm nëpër kuzhinë. „Nuk është dashur ta lejoj të dalë në këtë mot të tmerrshëm,“ mondoi. Papritur cingërroi zilja.

„Kjo sigurisht nuk është Inge, ajo e ka çelsin!“ Provojë të ndalojë vërrshimin e frikës dhe shkoi të hapë derën. Era ju përplas për fytyrë. Dy njerëz të hutuar qëndronin në derë, me letër në dorë. Ishin me uniformë, Mechthild e kuptojë. Ndjeu zërat e mbytur të dy meshkujve si në ëndërr. Njëri nga policët donte të fliste me „anëtarin e familjes“. Mechthild mblodhi gjithë guximin e sajë dhe i ftojë të ulen.

„Çfarë po ndodh? Është fjala për Inge? Inge Braun?“ „... Po ajo është ime bijë.“

Pastaj ajo dëgjojë fjalët që ia shpuan zemrën. Njëri prej policëve fliste për ndeshjen.

„Sipas gjase makina e bijës suaj rrëshqiti nga rruga“, tha. E luti Mechthild të shkojë me ta dhe identifikojë trupin, por mendimet e Mechthild sishin diku më larg; humbën në gjithësi e cila nuk i takon kësaj bote, gjithësinë e cila ka shijen e amshimit. Mechthild iu bashkua së bijës në misterin e banesës së sajë më të re. Dëgjoji veten duke bërë disa pyetje, në mënyrë automatike: „Ku? Sa është larg prej kryqrrugës? Ku është trupi?“ „...Do të vij me ju!“

E hutuar, Mechthild ndoqi policët, akoma duke provuar të bind veten: „Nuk është e mundur! Të lutem, Zotëri, bëj që të zgjohem dhe të kuptoj se kjo është vetëm ankth nate! Inge është mirë dhe së shpejti do të vijë te dera, e zëshme plot me gazin e sajë të zakonshëm!“ Por fjalët e policëve, si të depërtonin nëpër një vel, e detyronin të pranonte realitetin.

Të lutem t'i shpëtosh

Mechthild ishte nga Gjermania me prejardhje. E kishte kaluar dozën e vet të vuajtjes në jetë. E ëma kishte qenë e rreptë me të, kurse anëtarët mashkullorë të familjes e kishin keqtrajtuar që nga mosha e re. Si fëmijë, edhe pse nuk i shte pagëzuar, vraponte te truporja e Zojës posa e shihte. Përvoja mistike? Jo, por butësia e kësaj Zonje ishin ilaç për zemrën e sajë që pikonte gjak. Derisa qëndronte pranë sajë, në mënyrë misterioze, Mechthild mund të pushonte para se të takohej përsëri me botën.

„Maria e mësonte fshehtas“, do të deklaronte më vonë.

Kur i kishte pesëmbëdhjetë vjet, nuk mundi të durojë më keqtrajtimin seksual, dhe kishte provuar të vetëvritej. Pak kohë më vonë, Mechthild u martua e re dhe shkoi në Irlandë, duke shpresuar se do të ikë nga e kaluara e sajë e shkatërruar. Fatkeqësisht i shoqi u bë alkoholist, ashtu si edhe njerku i sajë. Sa tunel i errët! Tundimi që të mbidozohet me barëra, kurrë nuk ishte larg mendimeve të sajë.

Lindi tre fëmijë. Si e rritur vendosi të pagëzohet në fenë katolike. Fatmirësisht, pas përgatitjes së mirë, arriti dita e pagëzimit të sajë. Atëherë jeta ju ndërrua krejtësisht – ishte e gëzuar se përfundimisht e kishte Jezusin. Fëmijët i edukojë në fenë katolike.

Inge, më e vogla, që nga dita e parë ishte fëmijë i vështirë. Ishte shumë e lidhur për të atin alkoholist prandaj e goditi keq ndarja e prindërve. I kishte tetë vjet kur i ati u largua nga shtëpia, pa asnjë paralajmërim ose shpresë se do të kthehet. Inge kurrë më nuk e pa babanë. Shpesh hidhërimin e vet e drejtonte kah e ëma, me vrazhdësinë që nganjëherë kalonte në dhunë. Derisa zemra i pikonte gjak për shkak të krizave të tilla Mechthild vazhdimisht e luste Zojën që ta bënte nënë më të mirë.

Më 2001. Shkoi në Megjugorje dhe atje vendosi që fëmijët të ja kushtoi Zembrës Tejetshenjte të Jezusit dhe Zembrës së Pamëkat të Marisë. Zojës ia besojë kujdesin për fëmijët e sajë, duke e lutur që të jetë nëna e tyre prej Qiellit dhe që t'i ruaj nga lart. Mechthild do të ecte dorë për dore me Nënë e Zotit, mikeshën e sajë të amshuar.

„Po t'i dorëzoj. Prej tani të takojnë ty! E gjitha që kërkoj nga ti është që të shpëtojnë. Madje edhe nëse zgjedhin rrugën e gabuar, të lutem të ia kthesh Birit tënd“, tha.

Ishte një ditë shumë e gëzuar për Mechthild! E përfshiu një ndjenjë e thellë e paqës, si të ishte shkarkuar një barrë e rëndë që deri atëherë e kishte në shpindë. E ndjente në zemër se oferta e sajë ishte pranuar atje „Lart“.

Zojës i doli shumë punë sepse jeta e Inge mori teposhtën e rrezikshme: droga, alkoholi, daljet e vona... Me të ëmën kishte një raport ferri. Kur u këthye nga Megjugorja, Mechthild e luti një nga shoqet e Inge që të bisedojë me të dhe t'i ndihmojë të kuptojë se sjellja e sajë nuk ishte e shëndoshë. Të njëjtën natë Inge i shkroi një letër të mrekullueshme, E donte thellë të ëmën dhe e

luste ta fal për të gjithë dhëmbjen që i kishte shkaktuar. Zemra e sajë e plagosur, në të vërtetë, me dëshpërim, kërkonte dashuri, por në vende krejt të gabuara! Prej asajë ditë fillojë biseda në mes të Inge dhe së ëmës.

„Inge,“ i tha Mechthild, „nëse do të jetosh me ne, duhet të ndërrosh! Do të vendosim rregulla. Duhet të vish në shtëpi para mesnate, por, poashtu të më ndihmosh në shtëpi.“⁴⁸ Atëherë fillojë të rregullohej raporti në mes të Mechthild dhe së bijës. Është e vërtetë se Mechthild e donte përherë e më shumë: kritikën e vazhdueshme nuk ishin metoda e vartetë. Zoja, nëpërmes të lutjes, e kishte mësuar Mechthild, se nuk mund t'i edukojë fëmijët e sajë ashtu si ka qenë e edukuar ajo – me dhunë! Në vend që t'u shkaktonte dhëmbje, është më mirë që të merren në dorë.

Dashuria ime, tani shko te Jezusi!

Shtrëngata po qetësohej. Mechthild iu falënderua policëve dhe hyri në makinë të vet. Në repartin e kujdesit intenziv u takua përsëri me trupin aq të vlefshëm që e kishte lindur, ushqyer dhe dashur – me atë trup që kishte vetëm 17 vjet! Inge akoma merrte frymë, por vështirë. Ishte fundi. Koma e sajë ishte shumë e thellë për të shpresuar në këthim. Në vërshimin e lotëve, Mechthild para Inge zbrazti zemrën, duke e mbajtur për dore. „Te lutem, Inge, më fal për çastet kur nuk kam qenë nënë e mirë! Aq shumë të dua! Nuk do të të harroj kurrë! Nëse do të shkosh te Jezusi, të lutem, shko! Mos u brengos për ne, do të jemi mirë! Ti, dashuria ime, vetëm shko dhe qëndro me Jezusin! Ai po vjen të të marrë, Ai të thërret. Mos ki frikë! Po shkon aq papritmas, me 17 vjet, dashuria ime... Të dua, Inge. Shko në paqe!“

Si qiriu, Inge, u shua ngadalë në përqaftimin e së ëmës. Mechthild ndjeu se si shpata po ja shqyen barkun. Si mund të durojë njeriu kaq shumë? „O, Zot, bëj që të vdes me fëmijun tim, nuk mund ta bart këtë!“ I klithi Zotit, duke e lutur që të mos lejonte të fundosej. Një rreze e vogël drite u paraqit thellë, thellë në të. E dinte se Inge është „në rregull“. E puthi në ballë dhe me butësi e vuri dorën në të sajën. Ishte e sigurt se në çastin e fatkeqësisë Zoja kishte ardhur ta marrë! Zemra e sajë i ishte kushtuar Zemrës së sajë të Pamëkat!

„Nënë e Shenjtë, ti je me të, apo jo? Po vjen ta marrësh me vete, apo jo?“ bërtiti.

Ditën e varrimit, meshtari kapucin i cili duhej të kremtonte meshën për Inge e thirri Mechthild. Kishte një porosi urgjente për të: „Mechthild, posa dëgjova se, natën kur Inge vdiq, atë Richard kalonte pranë vendit të fatkeqësisë. Mi tregoi të gjitha. Era ishte e pabesueshme! Kishte parë fatkeqësinë që sapo kishte ndodhur dhe kishte parkuar automobilin në afërsi, në rast se dikush është i lënduar ose madje pranë vdekjes dhe ka nevojë për meshtar. Me vete kishte vajin shenjt për sakramentin e vajimit të të sëmurëve. Kishte shkuar pranë automobilit. Djaloshi që kishte

⁴⁸ Në porosinë që ka përcjellë Ivani, Zoja ka thënë për familjet: „Prindërit duhet të kufizojnë lirinë e fëmijëve të vet.“

vozitur as nuk ishte grithur. Por një vajzë shumë e re ishte e lënduar. Akoma merrte frymë. E kishte pyetur se a dëshiron që prej Jezusit të marrë faljen e mëkateve. Nuk mund të fliste, por akoma ishte e vetëdijshme. Atë Richard i kishte dhënë vajimin e të sëmurëve. Më tha se kishte qenë e qetë. Pastaj kishte rënë në koma dhe... e kishin çuar në spital. Mechthild, kjo vajzë e re ishte Inge jote!“

Një shok elektrik kaloi nëpër Mechthild. Ishte e vërshuar nga gëzimi. Forca e jetës e përfshiu në çast mbarë trupin dhe shpirtin e sajë. Se çfarë lajmesh fantastike! Inge kishte marrë sakramentet! Nëna e Zotit e kishte mbajtur premtimin nga kontrata e dy nënave! Mechthild kishte pritur deri në varrim që të dëgjojë këtë shenjë të Nënës së Zotit, të dëgjojë se ajo kishte qenë atje, në vendin e fatkeqësisë! E kishte dërguar apostullin e sajë që ta zbukuroi Inge para Zotit, para se ajo vetë të vinte ta priste! Mechthild e dinte se kjo është e vërtetë. Kishte pasë të drejtë se kishte vazhduar të besojë, përkundër të gjitha dëshmimeve se Inge kishte vdekur pa sakramente!

Ajo përqafton ata që unë i përqaftoj

Në vitin 2003., një muaj pas vdekjes së Inge, Mechthild u kthye në Megjugorje. I ra ziles dhe u ul me ne pranë tavolinës sonë modeste të kuzhinës. Zemra e sajë ishte shkrirë. Se çfarë drite e butë në shikimin e sajë! Na tregojë për këthimin e sajë, për kushtimin e fëmijëve të sajë, dhe çfarë është më e rëndësishme, për muajt e fundit me Inge.

„Në vitin 2001. Inge më pyeti se çfarë dëshiroj për kërshtëndella. 'Nuk dua asgjë për kërshtëndella', iu përgjigja! 'E gjitha që dua është që të shkosh në rrëfim.' Mendova se do të hidhërohet, por për befasinë time, u përgjigj: 'OK, por jo te atë Gabrijeli.'“

„Inge, mund të shkosh te cili meshtar të duash! Është një meshtar i ri në kishën e shën Sofisë. Mund të shkosh te ai nëse do. Mbaje në mend se të gjitha që meshtari i dëgjon në rrëfim janë të fshehta dhe të besueshme, prandaj mos u brengos, nuk do të më thotë sagjë. E luta atë meshtar të na vijë në shtëpi. E thirri Inge në shtetije dhe shkuan në natyrë. Një orë e gjysmë më vonë, i pash duke u kthyer, Inge shkëlqente.“

„Por, dhurata më e bukur që kam pranuar ishte kur i njëjti meshtar u këthye dhe më tregoi se e kishte goditur rëndë lajmi për fatkeqësinë e Inge. Më tha: 'Mechthild, meshtarët nuk mund të flasin për rrëfimet që dëgjojnë. Mirëpo, ka diçka që mund t'ua them: gjithmonë i hërroj rrëfimet që dëgjoj, por rrëfimin e Inge nuk do të mund ta harroj! Ajo kaloi nëpër gjithë jetën e sajë, duke filluar nga çasti që i kujtohej se kishte mëkatuar të parën herë.'“

„Të dish se ka bërë një rrëfim të tillë, për mua ishte mrekulli dhe ishte dhurrata më e bukur që kisha mundur ta marr për kërshtëndella! Inge e kushtova na vitin 2001. Dhe prej atëherë isha e liruar prej të gjitha brengave të mëdha lidhur me të. E lash në duar të nënës së sajë Qiellore dhe në duar të Zotit dhe ata së bashku janë kujdesur për të. Për çudi, një muaj para fatkeqësisë, Inge

fillojë të ndërrohet në mënyrë dramatike. Fillojë të përmirësojë jetën e vet! Për shembull, gjithmonë e mbante premtimin se do të jetë në shtrat para mesnate, kujdesej të flasë mirë dhe të jetë në dispozicionin e të tjerëve. Ishte e hapur!“

„Atë mbrëmje që ndodhi fatkeqësia, ndodhi një mrekulli! Kur doli prej shtëpisë më tha për herë të parë në jetë: 'Nënë, të dua!' U përgjigja në mënyrë sipërfaqësore, pa e ngritur shikimin: 'Edhe unë ty.'“

„U këthye, e kaloi pragun dhe shumë seriozisht më tha: 'Por, nënë, kjo është serioze. Vërtetë të dua! Këto ishin fjalët e sajë të fundit. Ishte shikimi i sajë i fundit.'“

„Burri im, natyrisht, nuk ishte me ne në kishë me rastin e varrimit. Por atë Brian kishte vërejtur një njeri i cili qëndronte jashtë dhe qante si fëmijë. Pa e ditur se kush është, meshtari u afrua dhe e pyeti: 'Jeni anëtar i familjes?' Njeriu ishte aq i vërsuar nga ndjenjat sa që nuk mundi as të përgjigjej. Atë Brian e pyeti: 'A je babai i Inge?' Ai pohoi me kokë.“

„E falënderoj Zotin se e ka zgjedhur atë Brian për këtë takim të shkurtë por të fuqishëm. Edhe këtu munda ta shoh dorën e Zotit. Ish burri im u zhduk dhe nuk munda ta shoh kurrë më. Në mbrëmje pas varrimit, të gjith miqtë e Inge erdhën në shtëpinë tonë. Në kuzhinën time të ngushtë bisedonin për të. Më bombardonin me pyetje: nuk mund të kuptonin se si Inge ishte ndërruar për një kohë aq të shkurtë.“

„Si i keni ndihmuar që të ndërrohet aq shumë?“ - pyesnin.⁴⁹

„Nëpërmes tyre e njoha bijën time! U kishte folur për Zotin dhe u kishte treguar pjesën e sajë më të mirë. Deri tani nuk mund t'i numërojmë të gjitha bekimet që kanë dalur nga vdekja e Inge! Kjo është e pabesueshme! Këta të rinj e lusin për ndihmë; ajo është si mike e tyre në Qiell, mik në pozitë të lartë që për ta mund të arrijë shumë hire. Ajo është e gjallë!“

„Qysh se ja kam kushtuar fëmijët Zojës kam vërejtur se zemrën time e tërheqin të rinjët. Një ditë një vajzë 17 vjeçare erdhi në shtëpinë time dhe tha: 'Mechthild, a mund të ju pyes diçka? Ju më mbani në duart tuaja në mënyrë shumë të veçantë. Vërtetë ndjej se Zoja më përqafton nëpërmes jush. Si e shpjegoni këtë?'“

„Përgjegjja është e thjeshtë“, i thashë, „Gjithmonë e lus Zojën që të shfrytëzojë duart e mia, dhe në realitet, Zoja i përqafton ata që unë i përqaftoj.“

„Kur i kam kushtuar fëmijët nuk kam ditur se çfarë kam bërë. Nuk kam kuptuar. Por një gjë më bën shumë përshtypje: kur Zotëria e ka marrë Inge te vetja, ka marrë vetëm atë që i takon atij. Ajo kurrë nuk ka qenë e imja. Ai ma ka besuar këtë fëmijë, këtë pasuri të madhe, vetëm për një

⁴⁹ Mistikja e madhe franceze Marta Robin thoshte: „Kur Zotëria është i gatshëm të thërrasë dikë tek vetja, Ai e përgatit ashtu që ai as nuk është i vetëdijshëm për këtë“

kohë. Ky mendim më jep një paqe të thellë! Atëherë shpesh i them Zotërisë: 'Të falemnderit, Zotëri, që ma ke dhënë Inge. Të falemnderit për gjithë kohën që kam këluar me të!'

„Një javë para fatkeqësisë isha në Megjugorje. Besoj se Zoja që atëherë e kishte planin: donte të më përgatiste për atë ngjarje. Ajo e di çfarë do të thotë të humbësh fëmijën! Por kohë pas kohe më vjen të këlthas: 'Zotëri, zbutë këtë dhëmbje!' Pamja që më jep ngushëllimin më të madh, është pamja e Krishtit duke përqaftuar Kryqin. „Sepse kur përqaftoj kryqin, Ai përqafton mua!“

„Të dashur fëmijë! Gëzohuni me mua! Zemra ime është e gëzuar për shkak të Jezusit, që sot dëshiroj t'ua jap. Dëshiroj, të dashur fëmijë, që secili prej jush të ja hap zemrën Jezusit, kurse unë ua jap me dashuri, të dashur fëmijë, që ai të ju ndryshojë, të ju mësojë dhe të ju ruaj. Sot në mënyrë të veçantë lutem për secilin prej jush dhe ju paraqes Zotit, që ai të dëftohet në ju. Ju thërras në lutje të singertë me zemër, që secila lutje e juaja të jetë takim me Zotin. Në punën tuaj dhe në jetën e përditshme vendosni Zotin në vend të parë.“ (25. dhjetor 1987.)

19

I VIZITOVA TË GJITHË TEMPËJT NË SINGAPOR

Po e braktisja Singaporin dhe disi ndjehesha keq në xemër. May dhe unë u nisëm drejt aeroportit. Misioni im sapo përfundojë pas dymbëdhjetë ditësh intenzive në Malejzi. May insistonte të më vozit dhe isha e lumtur që munda t'i kaloj me të orët e mia të fundit në Azi.

May është kineze nga Singapori. Fytyra e sajë rrezaton me dritë e thjeshtësi. Zemra e sajë e pastër e bën person – siç thoshte Jezusi për Natanaelin – në të cilin nuk ka dredhi⁵⁰. Posa mbetëm vetëm në makinë, May fillojë tregimin shumë të prekshëm mbi kthimin e sajë. Falemnderit Zotit se unë nuk vozitja – lotët do ta fshihnin rrugën prej syve të mi!

„Me prejardhje jam kineze, si edhe burri im. Kemi dy fëmijë. Si kinez, kemi vazhduar kultin e të parëve. Zoti ishte i rëndësishëm në jetën tonë. Nuk dinim asgjë për krishtërimin pos disa kishash të cilat i shihnim kalimthi në Singapor.“

„Një ditë, burri im, edhe pse shumë i ri, u sëmur rëndë. Më kapi ankthi dhe mu kthye mbapsht çdo gjë. E dija se ishte sëmundje vdekjeprurëse. E kuptova se s'mund të bëj asgjë dhe e shikoja se si po vuan derisa dobësohej vazhdimisht. Në fund vdiq. Nuk mund ta duroja dhëmbjen që ndjeja përbrenda. I thash vetes se ndoshta ekziston realiteti shpirtëror i cili do të mund të më ndihmonte të kuptoj domethënjen e jetës njerëzore dhe të më ndihmonte që të nxjerrem nga dëshpërimi. Atëherë vendosa t'i vizitoj të gjithë tempujt në Singapor: budiste, hinduiste, taoiste. Në secilin prej këtyre tempujve, pa marrë parasysh se me sa zjarr lutesha dhe qaja para zotërave, vuajtja ime mbetej e njëjtë - e padurueshme.“

„Atëherë vendosa të provoj të krishterët. Më kishin thënë se kanë një tempull shumë të mirë. Shkova atje. Quhej 'Kisha e nëntëshes'. Njerëzit tuboheshin atje vazhdimisht për të lutur nëntëshen e orës shenjte dhe nëntëshen Zembrës së Pamëkat të Marisë. Atje të çuam para disa

⁵⁰ Gjn 1,47

ditësh. Derisa qëndroja në kishë, dëgjova fjalinë që nuk e kuptova mirë, por ajo u shartua thellë në zemrën time, dhe nuk pata kurrfarë vështirësie ta mbaja mend, dhe e përsërisja shpesh. Kjo fjali ishte: O Jezusi im, na i fal mëkatet tona dhe shpëtona prej flakës së ferrit. Çoji në qiell të gjithë shpirtërat, por sidomos ata që kanë më shumë nevojë për mëshirën tënde.⁵¹

„Kur e dëgjova këtë, paqa që nuk e njihja kurrë më parë, e përfshiu zemrën time dhe e kuptova qartë se ato fjalë janë të vërteta, reale dhe se duhet të kthehem drejt tyre si drejt fanarit të detit në furtunë. Nuk e kisha idenë mbi kuptimin e tyre, por e dija se janë të vërteta. Atëherë e luta një katolike të më sqarojë se çfarë kuptimi kanë ato fjalë. Fjalët e sajë e vërtetuan ndjenjën time, më gëzuan shumë dhe më ofruan një paqë të thellë. Atë ditë emri Jezus hyri në zemrën time. Vërtetë e takova Jezu Krishtin. Përfundimisht arrita te Zoti i Gjallë!“

„Prej asaj dite fillova të flas me të, duke i besuar plotësisht, ashtu si dikush bisedon me mikun më të mirë. Kërkoja të më mësojnë mbi Krishtin kurse gëzimi im rritej vazhdimisht. Tani që e kam gjetur Krishtin, kam një visar të jashtëzakonshëm. Askush s'është si ai. Çdo ditë, çdo orë, falënderoj Zotin, se ma ka zbuluar Birin e vet dhe se më ka shpëtuar nëpërmes tij.“

„Jam pagëzuar vitin e kaluar. I kam pagëzuar edhe fëmijët. E dua shumë edhe Nënë e Jezusit. Ajo më ndihmon t'i rris fëmijët! Nuk mund të besoj se aq gjatë kam jetuar pa Jezusin dhe Marinë. Ata janë bërë çdo gjë në jetën time.“

Për May, si edhe për të gjithë që Jezusit i thonë sinqerisht, „Ty të kam çdo gjë në jetë“, jeta shndërrohet në aventurë të mrekullueshme! Kush tjetër pos Jezusit do të mund të plotësonte zemrën e kësaj kinezeje dhe ta bëjë të këndojë: „Ti vajin ma ktheve në valle.“⁵²

⁵¹ Lutja të cilën engjëlli ua përcolli vëguesve të Fatimes më 1917. godine

⁵² Ps 30,12

„Të dashur fëmijë! Sot ju thërras që të filloni, sidomos tani, me lutjen kundër djallit. Djalli dëshiron të veprojë më shumë tani kur e din se ka ndikim. Të dashur fëmijë, ngjeshuni me paisjen e betejës dhe me rruzare në dorë mundeni!“ (8. gusht 1985.)

20

RRUZARJA APO SOVJETIKËT?

Ka shumë raste në histori në të cilat rruzarja ka vepruar fuqishëm. Te gjithë e kanë të njohur triumfin e sajë më 1571 në betejën te Lepanti, në të cilën është ndaluar tentimi i Turqëve që të pushtojnë Europën.⁵³ Ja edhe një shembull, më afër nesh në kuptimin kohor:

Pas luftës së Dytë botërore (1940-1945), Austrija ishte e ndarë në katër zona okupuese, kurse Sovjetikët mbanin pjesën lindore të vendit. Kryeqyteti i Austrisë, Viena, poashtu ishte i ndarë në katër sektorë. Kaluan tri vite nën kontrollin tiranik sovjetik. Austriakët këtë nuk mund ta duronin më. Por ç'mund të bënin 7 milion Austriak kundër 220 milion armiqësh! Atë Peter Pavlicek, meshtar françeskan, u kujtua për fitoren te Letanti, ku raporti i forcave ishte 1 me 3, dhe megjithatë Turqit ishin mundur me anë të procesionit dhe lutjes së rruzares shenjte, organizuar nga papa Pio V.

Më 1948. fra Pavlicek filloi operacionin e quajtur lufta Kryqëtare me anë të rruzares dhe pendesës.⁵⁴ Kërkoi që dhjetë përqind të Austriakëve të obligohet se do të lusë rruzaren çdo ditë për largimin e Sovjetikëve, dhe 500.000 vetë pranuan. Gjatë shtatë viteve lutën rruzaren. Ajo u bë madje ngjarje botërore. Më 1955., pasi që Sovjetikët nën okupim mbanin një pjesë të Austrisë, 60.000 besimtarë katolikë marshuan rrugëve të Vienës duke u lutur, ku morën pjesë edhe disa anëtarë të qeverisë! Këta anëtarë, në të njëjtën kohë ishin të angazhuar në bisedat me okupatorin për ta liruar vendin e vet.

Bisedat përfunduan me marrëveshje shtetërore me të cilin ishte paraparë që të gjitha forcat e okupatorit duhet ta lëshojnë vendin. Ishte ky një rast unikal në histori pas luftës së Dytë botërore! Marrëveshja u nënshkrua më 25. Maj 1955. Duke u kthyer nga bisedat e fundit në Moskë, kancelari i austrisë Julius Raab deklaroi: „Zoti erdhi të na shpëtoi!“

⁵³ Shikon, për shembull, tekstin „Mary and Moslems“(Maria dhe myslimanët) në web faqen: www.catholic.org/featured/sheen.php?ID=1311.

⁵⁴ Kërkoni: The Most Holy Rosary of the Blessed Virgin Mary (Rruzarja më e shenjtë e Virgjërës së Bekuar Mari), në web faqen: www.opusangelorum.org/Formation/Holyrosary.html.

Sovjetikët e lëshuan vendin pa derdhur asnjë pikë gjaku (që na përkujton në fitoret e Jean d'Arc, në të cilat, poashtu nuk ishte derdhë gjak). As politikanët as strategët ushtarak nuk ishin në gjendje ta shpjegojnë çka i detyrojë Sovjetikët të vendosin për t'u tërhjekur nga ky vend, i cili për ta ishte shumë i dëshiruar në aspektin strategjik. Austria është derë drejt perëndimit dhe ka një tokë pjellore.

Tërheqja Sovjetike do të mbetet enigmë për botën tokësore. Por, atë A. William nga Austria ka marrë në vitin 1962., përgjigje nga Tereza Neumann⁵⁵, stigmatës së njohur gjermane, tre muaj para vdekjes së sajë. „E vërteta është,“ e ka informuar ajo, „se kjo ka ndodhur për shkak të rruzares që kanë lutur Austriakët!“

Rruzarja në Austri ishte më e sukseshme në lirim të vendit nga okupimi sovjetik se sa ishin luftëtarët hungarez për liri. Atje 25.000 të pafajshëm humbën jetën. Rruzarja është më efikase se arma njerëzore! A s'është më mirë të lutet rruzarja se sa të llogaritet në politikanët të cilët gjithmonë nuk janë të besueshëm? A nuk është, poashtu urgjente të pengohet përzierja e Armikut në familjet tona, vendet tona, botën tonë? Nëse është dashur 500.000 Austriak të lusin rruzaren shtatë vjet që përfundimisht të përzënë Sovjetikët prej vendit të tyre, sa Amerikan duhen sot që ta përtërinë vendin e vet dhe t'i lejojnë Mbretëreshës së Paqës ta realizoi planin e vet për paqe!

Më pëlqen kjo pamje shumë e thjeshtë: Kur merrni rruzaren prej xhepit për t'u lutur, merrni me mend se në të vërtetë kenë marrë dorën e Marisë. Atëherë, mos e lëshoni tërë ditën, dhe ajo do të ju prij!

⁵⁵ Një biografi e mirë e mistikes dhe stigmatës Terese Neumann: A Light Shone in the Darkness (Drita shndëriti në errësirë) e autores Doreen Mary Rossman (Queenship Publishing, Goleta, CA)

„Të dashur fëmijë! Do të ishte mirë të hiqni dorë nga televizioni, sepse pas shikimit të disa gjërave jeni të shqetësuar dhe nuk mund të luteni.“ (8. dhjetor 1981.)

21

KUTIA QË KRIJON ZBRAZTËSI

Laurence, dyzetvjeçare, është shumë aktive në Holandë. Shtegtare e Megjugorjes, që ecë me Zotin si të ishin një person dhe nuk mendon në dhëmbjen e vet kur punon për Zojën. Përvoja e sajë personale është shembull se si duhet të përdoret liria!

„Ka 15 vjet që nuk shikoj televizion. Por para katër muajsh u parapagova në televizionin kabllor lokal. Qëllimi ishte që t'i përcjell ngjarjet e mëdha që ndodhin në botë. Pas katër muajsh, hoqa dorë përsëri, e bindur se kam bërë mirë. Pse? Sepse konstatova se po zbrazem kur në mbrëmje shikoj televizion. Madje edhe nëse shikoja lajmet për pak kohë, ashtu që të mund të lutesha për atë që kam parë, nuk shkonte – isha e shqetësuar në lutje. Çdo herë ndodhte e njëjta gjë: shikoja televizorin një orë dhe pastaj nuk isha në gjendje të lutesha, sepse zemra ime forcohej dhe në mua diçka ndahej prej Zotit, ndahej prej qendrës sime. Nuk mund të lutesha për ngjarjet për të cilat dëgjoja në lajme sepse shpirti im ishte i shqetësuar.“

„Kështu, pyesja veten se çfarë po ndodh. Dhe, e gjeta përgjigjen: Kur shikoja televizorin, në mua hynte shpirti i botës. Në çastin kur kyçja televizorin, unë, me vullnetin tim kyçesha në shpirtin e kësaj bote. I thoja me vetëdijë 'po'. Së shpejti ai shpirt fillonte të brente brendinë time, të brente lidhjen time me Zotin, dhe unë bëhesha përherë e më e zbrazët.“

„Kur vendosa të lirohem nga televizori, menjëherë, të nesërmen e realizova këtë. Posa dërgoja një letër, në zemrën time hynte gëzimi. Ndjeva se jam e zhytur në dritë dhe se Qielli pajtohet me vendimin tim. Kështu i thash Marisë: 'Pasi që më nuk i shikoj lajmet, këtë orë do të ja kushtoj lutjes së rruzares.'“

„Prej asajë dite, çdo mbrëmje lus gjithë rruzaren dhe mund të them se nuk humb kohë fare – dhe sigurisht, kam humbur kohën dhe shpirtin tim kur shikoja televizorin. Dhe, me që lus rruzaren, në mua lindi një dëshirë e madhe për agjërime. Mund ta shohë, qartë, këtë: kur personi është i disiplinuar në një aspekt, ai merr forcën për rritje dhe bëhet serioz edhe në aspektet tjera të jetës së vet. Lutja e rruzares, në mbrëmje, më ka dhënë forcë dhe hapësirë për agjërime në bukë dhe ujë, si na mëson Nëna Mari.“

„Nuk dua të gjeneralizoj – kjo është vetëm mënyra ime që ta vendos Zotin në vend të parë në jetë. Sa i takon televizorit, munda të kuptoj se është vullneti i Zotit që ta lë menjëherë! Nëse dikush shikon televizion, më duket se është i nevojshëm një kujdes i madh që të mbrohet nga i Keqi. Ai është goxha aktiv në disa programe!“

Evitoni televizorin...

Përvoja e Laurence perputhet në mënyrë të përsosur me porosinë që Zoja i ka dhënë bashkësisë së lutjes në Megjugorje. Ajo tha: „Heqni dorë prej të gjitha pasioneve dhe të gjitha dëshirave të trazuar. Evitoni televizorin, sidomos programet ateiste, sportin e tepruar, knaqësinë e paarsyeshme në ushqim dhe pijë, alkohol dhe duhan.“ (Pika e parë në Rregullat e jetës të dhëna Jelena Vasil-it, më 16. qershor 1983.)

Maria kërkon prej nesh që të mos shikojmë televizor nëntë ditë para festave të mëdha si Pashkët Rrëshajët dhe Krishtlindja. Ajo dëshiron që, ashtu si tek Hebrenjtë, familja të tubohet rreth Biblës dhe të bisedojnë në lidhje me tekstet që kanë të bëjnë me atë festë.

Mirëpo, Zoja nuk e ka ndaluar televizorin. Ajo nuk ka kërkuar ta përjashtojmë televizorin nga shtëpia. Si Nënë, ajo e di se kjo do të ishte tepër e vështirë për disa bij të sajë. (Për ata që vuajnë nga depresioni ose vetmia tepër e madhe, televizioni është mënyra e vetme që të dëgjojnë qenje të tjera njerëzore!) Pos kësajë, ka programe që janë të bukura; është në dorën tonë që këto programe të shumohen!

Për sa i takon ditëve të agjërimit, Zoja ka thënë:

„Nëse nuk keni forcë të agjëroni në bukë e ujë, mund të heqni dorë prej gjërave të tjera. Do të ishte mirë të hiqni dorë nga televizori, sepse pas disa programeve jeni të shqetësuar dhe të paaftë për t'u lutur...“ (dhjetor 1981.)

„Kur shikoni programe televizive, kokat tuaja janë të mbushura me lajme dhe pastaj në zemrat tuaja nuk ka vend për mua.“ (17. prill 1986.)

Laurence shtoi: „Në mbrëmje, pavarësisht sa është ora, lutem në qetësi një orë para se të shkoj në shtrat. Dhe pikërisht në atë kohë në mua hyn një gëzim i madh dhe rregullohet çdo gjë.

Natyrisht, është me rëndësi të kemi një kontakt me njerëzit tjerë që të rritemi në jetën shpirtërore, por, kuptoj se kjo për mua është e mundur vetëm pasi që në lutje zhytem në praninë e Zotit. Së pari lutja, pastaj vijnë të tjerat! Konkretisht, nëse duhet të zgjedh në mes të lutjes dhe bisedës me një person tjetër, prioritet i jap lutjes. Kështu, fitoj një liri të brendëshme, të domosdoshme për të më udhëhequr Shpirti Shenjt. Ai më tregon se a duhet ta kontaktoj dikënd apo jo.“

Sa vite kam humbur me televizor të kyçur?

Sonia, nga Bostoni në shtetin Massachusetts, ka dhjetë fëmijë. „Gjithmonë e kisha të kyçur televizorin. Kjo ishte automatike. Pas kthimit tim, kuptova në zemrën time se Jezusi më thërret ta çkyç. Ishte i vështirë ai vendim për mua. Por, së shpejti e kuptova se Jezusi po më flet, se ai më prin në të gjitha detalet e jetës sime të përditshme! Kështu, mendova: 'Sa vite i kam humbur me televizor të kyçur, deri sa Jezusi priste, tërë kohën, që të pushojë ajo zhurmë dhe të mund të flasë me mua! Ah, sikur ta kisha ditur këtë!'“

Collete (nga SHBA) ka shkruar: „Para pesëmbëdhjetë vitesh kemi vendosur që për shkak të fëmijëve nuk do të kemi televizor në shtëpi. Kishim ekran dhe mund të shikonim DVD-të dhe kasetat, dhe kjo ishte e gjitha. Kjo, vërtetë e pastron shumë atmosferën! Sidomos në SHBA, ku ka aq shumë kanale dhe aq shumë programe budallaqe. Të jesh pa televizor është sikur të heqësh dorë prej duhanit ose alkoholit. Papritmas ndjehesh i pastër, i lehtë dhe i lirë! dhe kjo të jep kohë për gjërat të tjera! Kohë për shetitje, lexim, lutje...“

Si Nënë, Maria kërkon mënyra të na shtie në bashkësi më Zotin dhe me të afërmit tanë! Si Mbretëreshë, ajo dëshiron të sundojë me mjetet tona të komunikimit! Nëse shërbehemi me këto mjete pa pushim, kjo gjë shkatërron, ndryshon ose madje pengon bashkësinë e vërtetë.

„Të dashur fëmijë! Sonte jam veçanërisht e kënaqur që ju shoh. Sonte dëshiroj të ju lus që të m'i dorëzoni problemet dhe vështirësitë, që të mund të luteni me më shumë liri dhe gëzim, ashtu që lutja juaj të bëhet lutje me zemër. Prandaj dëshiroj të ju lus që në lutje t'i largoni vështirësitë tuaja, dhe unë do të lutem për ju. Të dashur fëmijë, më duhen lutjet tuaja.“ (11. maj 1990.)

22

KUSH E KA MËSUAR TË LUTET ATË PION?

Ishte më 1896., në krahinën e ashpër Avellino, në Itali. Francesco i vogël, i cili ende nuk i kishte mbushur dhjetë vjet, gjithmonë merrte pjesë në shërbesat fetare që shënonin jetën e vëllëzërve të krishterë në bashkësinë e tyre të vyeshme fshatare. Kërkonte vetminë për të lutur rruzaren dhe për të biseduar me Zotin. Kishte dëshirë të flinte në natyrë. Kur kishte re falënderonte tezen Daria për mikpritjen, e cila kishte për të në zemër një vend të posaçëm dhe në pronën e sajë kishte gjithmonë dhomën e përgatitur për të. Streha e tij më e dashur ishte një dru i madh, në hijen e të cilit kalonte orë të gjata në meditim. Ai e parapa betejën e vështirë kundër të Keqit i cili sapo kishte filluar me sulmet në Francesco-n e vogël. Zoti kishte fascinuar shpirtin e Francesco-s së vogël, e zjarri i tij i jashtëzakonshëm, që atëherë u kishte penguar fuqive të territ.

Në festën e Shën. Pelegrinit (mrekullibërësit të madh, shëruesit dhe mbrojtësit të të sëmurëve prej kancerit dhe sëmundjeve të lëkurës) i ati kishte vendosur ta çojë në qytezën e quajtur Atavilla Iripina. Së bashku me kremtimin e festës, fshatarët, atë ditë, mbajtën panairin e madh të bagëtisë. Babai i Francesco-s së vogël, Grazio, vendosi të shkoi atje që për familjen të blejë një kalë për punë. Djaloshi ishte aq i gëzuar sa që tërë natën nuk mbylli sy. Të nesërmen, heret në mëngjes, ai dhe i ati, në gomarin e familjes, u nisën për në Iripina. Para tyre ishte rrugë e gjatë. Arritën në orët e paradites dhe gjetën vend në kishën e mbushur përplot.

Kishin ardhur besimtarë nga mbarë krahina. Si shenjë dashurie tregonin devotshmërinë ndaj shenjtit të tyre të dashur, me lëvizje shumë shprehëse gadi dramatike! Çonin duart kah qielli, qanin, qeshnin dhe luteshin. Atëherë, me klithje të zëshme, binin në gjuhë, me qëllimin që të bënin për vete disi vërejtjen e shenjtit. Disa i kishin sjellur qirinj gjigatë të stolisur me lara ngjyrash të ndritshme. Të tjerët i kishin sjellur lule, apo zemra të kadifenjta të qendisura me flori. Kjo shprehje popullore e devotshmërisë ishte edhe prekëse, edhe e zëshme, edhe e larmishme. Të gjithë ishin ngjeshur rreth altarit, ku ishte ekspozuar portreti i shenjtit. Fatmirësisht, në këtë kakofoni, shen. Pelegrini kishte gjetur edhe shumë të tjerë me zemër të sinqertë, të cilët ia besonin lutjet për vështirësitë e veta, për dhëmbjet, për shpresat dhe dëshirat.

Një grua e varfër, e veshur me zhele, që dukej qartë se ishte e mposhtur nga mjerimi i kësaj bote, filloi që shenjtiti ti mbajë një fjalim me zë. Fillimisht nën zhelet e saja fshihte, kurse pastaj e qiti

në dritë një fëmijë të vogël. Ishte i palëvizshëm dhe i deformuar. Posa fillojë t'i bërtasë shenjtit, turma, e kapur në befasi me atë shëmtim, u qetësua dhe i lejoi nënën që ta zbraz zemrën e vet të mjerë.

Atëherë gruaja me voglushin, u shty përpara dhe filloi lutjen të cilën deri atë çast askush dhe askurrë s'e kishte dëgjuar. Shërbehej me shprehje të vrazhta por pitoreske, karakteristike për të folmen e Avellin-os. Haptas filloi të zbraz zemrimin e sajë ndaj shenjtit, duke e fajsuar me fjalë të rënda:

„Tërë jetën të kam nderuar. Kurrë nuk e kam harruar asnjë festë tënden! Shpesh, me dashuri, të kam sjellë lule, të kam sjellë dhurata dhe gjithmonë kam shpresuar në ndihmën tënde! Gjithmonë, në fshat; kam folur mirë për ty, dhe ja si më ke falënderuar! Ti e di se jetoj e vetmuar dhe se nuk kam para, dhe tani jam këtu me fëmiun krejtësisht të deformuar! Si do të kujdesem për të? Nuk brengosesh? Ti e sheh mirë se nuk jam e aftë të kujdesem për këtë fëmi! A do të shkosh ti të lypësh në rrugë që t'i ndihmosh? Çfarë shenjt i je ti?!“

Bërtiste përherë e më shumë, kurse fjalët i kishte të ndërprera me dënesje. Në fund pasoi kulminacioni: „Ti e ke mirë! Ti ke çdo gjë! Ti je në Qiell! Të gjitha janë të lehta për ty! Nëse ti e quan shenjtëri që t'i lësh njerëzit që vuajnë, të mbahen vetë, atëherë jam e zemëruar! Ti krekosesh në kornizën tënde për fotografi, por nëse dikush e ka zemrën të thyer nga pikëllimi, nuk luan as gishtin t'i ndihmosh! Mirë, shumë falenderit! Na jep shembull të mrekullueshëm mëshire! Sa lutjet që t'i kam drejtuar... isha aq e marrë, është dashur ta ruaj fuqinë! E gjitha që ti ishe në gjendje të bësh, ishte të më japësh fëmiun e deformuar krejtësisht... Atëherë, çfarë do të më thuash tani? Ndoshta pret nga unë që të këthehem në fshat dhe të të këndojs falënderime? Mendo edhe një herë!“

Heshtje varri. Askush nuk mori guximin të thotë një fjalë. Njerëzit pyeteshin se a duhet të ndjehen të turpëruar për shkak të gruas, apo për shkak të Shën Pelegrinit të mjerë, të cilin, pa dyshim, askush më parë nuk e kishte fyer kështu. Francesco pyetej se ç'do të ndodh tani. Kjo gjë nuk mund të merrte fund vetëm kështu!

Nëna ishte e dërmuar. Çirrej, qante, përgjakej! Në zbrazjen e fundit të paturpësisë dhe fesë, ngjiti shkallët deri te altari i Shën Pelegrinit.

Në këtë rrëmujë, Francesco i vogël i thithte të gjitha, shikonte dhe me gjithë fuqinë lutej për këtë nënë të mjerë dhe të rraskapitur. Por, i ati e tërhoqi për dore me forcë:

„Eja, është koha të shkojmë!“

„Jo, prit babi, prit edhe pak!“

Francesco u ngurtësua si plumb. Babai e kuptoi se nuk ka mënyrë që Francesco të lëshoi pe. Dhe si do të bënte këtë, kur çthurja zhvillohej para syve të tyre. Para altarit gruaja filloi t'i heqë zhelet prej voglshit mundimqar dhe si hostje e ngriti para fotografisë së shenjtit që t'i tregoi se nuk

mahitej. E lëshoi ngadalë mbi altar, duke thënë: „Ja, merre! Mbaje, por ma këthe të shëruar!“ Atëherë u largua, e vendosur që të fitojë drejtësinë. Në kishë mbretëroi heshtje e shurdhët. Mund të dëgjohej edhe miza.

„Eja, Francesco, duhet ta gjejmë atë kalë!“ – i pëshpëriti i ati, Grazio.

„Jo, babi, më lejo të rri edhe pak!“

Francesco as nuk lëvizi. Vendosi të shohë se çfarë do të ndodhë. Gruaja rrinte aty dhe priste, dhe njerëzit si njerëzit, përsëri filluan të flasin dhe së shpejti në kishë mbretëroi zhurma e zakonshme e festës.

Papritur Francesco i vogël zgurdulloi sytë. Po ndodhte mrekullia! Dëgjoheshin psherëtimat e nderimit të thellë prej gojëve të shtegtarëve të habitur të cilët shikonin se si fëmiju i imët dhe i deformuar, filloi ngadalë të kthehet anash. Ai fëmijë i cili ishte deri në atë çast pa jetë, si bimëz përpiquej të ngritej me duart e tij të vockla dhe me gjunjët. Gjymtyrët e tij u ndreqën dhe fituan dukje normale. Turma u trondit dhe në mbarë kishën jehuan klithjet e ngazëllimit. Grazio, që turma e njerëzve e shtynte sa majtas, djathtas, më kot mudohej të dalë prej kishës. Atë e shtyri brënda vala e shtegtarëve të rinj të cilët edhe vetë donin të hyjnë dhe të shohin se ç'po ndodh. Në atë çast u dëgjuan këmbanat e kishës, si është zakoni lokal, sa herë që ndodhte ndonjë mrekulli e shën Pelegrinit.

Të gjithë në kishë ishin dëshmitarë se fëmiju u shërua definitivisht. Gjymtyrët e tij tani kishin gjatësi të njëjtë. Shën Pelegrini i madh, i dashur dhe i nderuar, para syve të tyre bëri mrekullinë e re. I prekur deri në fund të shpirtit, Francesco i vogël kurrë nuk u shërua nga ky shok. Ai më vonë do të bëhet Padre Pio i madh, ndërmjetësues i jashtëzakonshëm, i ngjashëm me Krishtin madje edhe në trupin e vet. Më vonë, personave të afërt dhe të dashur do t'ua flasë për Shën Pelegrinin dhe do të përshkruaj ndikimin e madh që ai shenjt bëri në jetën e tij të lutjes. Dhe gjithmonë do të shtoi duke nënvizuar: „Atë ditë mësova se si duhet të lutem!“⁵⁶

⁵⁶ Në mesin e më të afërmëve të tij ishte Domenico Labellante, mik i besueshëm në dymbëdhjetë vitet e fundit të jetës së Padre Pios. Vetë p. Domenico ma ka vërtetuar këtë ngjarje kur, në korrikun e vitit 2003., u takuam në San Giovanni Rotonda. Shumë herë ai, e kishte dëgjuar Padre Pion se si e tregonte këtë ngjarje. Kishte dëshirë të fliste mbi shembullin e shkëlqyeshëm të fesë së kësaj gruaje.

„Të dashur fëmijë! Ju jeni përgjegjës për porositë. Këtu është burimi i hirit, kurse ju jeni, të dashur fëmijë, enët që i bartin dhuratat. Prandaj, të dashur fëmijë, ju thërras që punën tuaj ta bëni me përgjegjësi. Secili do të përgjigjet sipas masës së vet. Të dashur fëmijë, ju thërras që dhuratat t'ua jepni të tjerëve me dashuri, dhe jo ti mbani për vete.“ (8. maj 1986.)

23

A KE MENDUAR NDONJËHERË TË BËHESH MESHTAR?

Prilli i vitit 2001.

Në pansionin „Ružica“ ishin gjashtëdhjetë shtegtarë kanadez që nguteshin drejt dhomës e ngrënjes. Atë mbrëmje i priste embëlsira për lamtumirë, kurse u morën vesh që secili të tregoi se çfarë hiresh ka marrë gjatë shtegtimit. Disa janë shëruar, të tjetrit kanë fituar dritën për rrugën e tyre në jetë. Secili priste mbrëmjen e bukur të përbashkët! Të nesërmen do të kthehen prapa me aeroplan në krahinat veriperendimore të Kanadasë, në pjesët më të ftohta të Kanadasë. Qëndrimi i tyre në Megjugorje kishte përfunduar dhe nuk donin të lëshonin asgjë, pa marrë pjesë!

Larry, prijësi i grupit, dukej i kënaqur. Ishte një grup solid, pa probleme të mëdha dhe pa befasi të pakëndshme. E tërë java ishte e pasur me takime dhe me lutje, me sakramente dhe dhe bekime të shumta. Zoja kishte vepruar në shumë zemra. Por qetësia e Larry-t u prish. Erdhi një njeri dhe i pëshpëriti se do të dëshironte të përdorë mikrofonin sepse duhet t'i lajmërojë grupit diçka të rëndësishme. Ishte ky Denisi, një njeri goxha diskret të cilin Larry, sinqerisht, memzi e kishte vërejtur gjatë gjith atyre tetë ditëve.

Larry shikonte lartë-poshtë, duke fshehur me vështirësi mërzinë që i shkaktoi. Të gjitha i kishte oragnizuar tashmë, dhe kishte frikë nga të papariturat. Por njeriu dukej normal, i barazpeshuar dhe i vendosur. Larry e ndjeu se do të duhej të ja plotësoi dëshirën, edhe pse pyetej: „Çfarë duhet të jetë aq e rëndësishme që ai ka për të thënë?“ E pyeti: „Po mirë, për çfarë bëhet fjalë?“

„Mos u brengosni,“ u përgjigj Denis. „Çdo gjë është në rregull! Unë jam ipeshkëv nga Yellowknif. Dua që grupi ta dijë se kush jam dhe dua t'i them disa gjëra lidhur me shtegtimin.“

Larry-t ju mor fryma për një çast dhe mbeti pa fjalë nga befasia. Filloi të dridhet dhe faqet iu skuqën pakëz nga hutia. „Po!“ tha, duke u përpjekur të buzëqesh. „Natyrisht! Do të paralajmëroj se keni të thoni diçka... kjo është shumë bukur!“

Denisi shkoi me Larry-n te mikrofonin, i gëzuar dhe i qetë. „Kemi një mysafir të veçantë“ tha Larry. „Më lejoni t'ua paraqes!“

„Jungjatjeta! Unë jam ipeshkëv Denis Croteau, OMI, nga ipeshkëvia Mackenzie në Kanadanë veriore. Rezidenca ime është në Yellowknife, Northwest Territories. Do të dëshiroja...”

Grupi ishte i gatshëm për çdo gjë, por jo për këtë risi të papritur! Pasi një eksplozim gëzimi. Duartrokitje e fuqishme. Disa qeshnin, kurse të tjerët qanin të përfshirë nga emocionet. Larry, poashtu duartrokiste si të tjerët, por tërë kohën i kalonte në mendime, duke u friguar nga pak, secilin prej fjalimeve të veta, të gjitha qëndrimet e tij ndaj Denis-it. Në grup e kishin pasë ipeshkëvin e këtë nuk e kishin ditur fare!

Ipeshkëvi Denis Croteau nuk lejoi të shqetësohet. E shpjegoi përse kishte vendosur të vinte incognito:

„Erdha në Megjugorje si msgr. Pavel Hnilica. Kur u kthye nga Rusia, në mars të vitit 1984., u takua me papën Gjon Palin II. Papa e kishte pyetur: 'Pavel, a ke qenë në Megjugorje?' 'Jo, Shkëlqësi.' Ishte përgjigjur. Papa kishte ngulmuar: 'Pse nuk ke qenë?' 'Vatikanin më ka këshilluar të mos shkoj.' Papa kishte bërë një gjest të vogël që donte të thoshte, në rregull – harroje Vatikanin! Atëherë ati i Shenjtë kishte vazhduar: 'Shko incognito, këthehu dhe më trego se çfarë ke parë.'“

„Jetoj në Yellowknife, në provincën Northwest Territories,“ vazhdoi ipeshkëvi Croteau.
„Qëndrova në distancë dhe nuk u shoqërova me grupin nga frika që të mos zbulohet identiteti im i vërtetë ashtu si thuhet me fjalorin e „spiunëve“ Pse? Do të thoni. Ka dy arsye për këtë:

E para, më kanë thënë se meshtarët që vijnë në Megjugorje trajtohen në mënyrë të veçantë. E mbi të gjitha, ata rrijnë në kishë rreth altarit dhe në të vërtetë nuk janë pjesë e turmës. Prej tyre kërkohet të punojnë, të rrëfejnë, të bekojnë gjërat etj. Kam dëshiruar të vij në Megjugorje si shtegtarë i thjeshtë. Kam dëshiruar ta shijoj në tërësi shtegtimin si një katolik i thjeshtë i pagëzuar, pa trajtim të privilegjuar. Nuk kam dashur ta përjetoj Megjugorjen nga altari por nga banga. Kjo është më lehtë të thuhet se sa të bëhet! Të jetosh tërë javën me grupin prej gjashtëdhjetë shtegtarësh dhe të mos thuash asgjë për vete, për atë se kush je dhe si fiton për jetesë! Kjo nuk është detyrë e vogël, madje as për ipeshkëvin! Mund të them se, në të vërtetë, është dy herë më e vështirë!“

„Me vështirësi u kam bërë bisht pyetjeve të cimerit tim Edmond-it, që të mos gënjej, kur më pyeste se kush jam dhe me se merrem. Kisha frikë pozitive karshi sakramentit të rrëfimit. Një ditë biseda u zhvillua kështu:

Ed: 'Denis, me se merresh në jetë?'

Ipeshkëvi: 'Punoj në kishë, në arsimin katolik.'

Ed: 'Ah, jep mësim në shkollën katolike?'

Ipeshkëvi: 'Jo, punoj në nivelin ipeshkëvnor.'

Këto pyetje më kanë dhënë mjaft kohë që ta orjentoj bisedën drejt temave më pak të rrezikshme. Të nesërmen Edmond-i u këthye prap në temë:

Ed: 'Jeton me familje?'

Ipeshkëvi: 'Jo, s'kam familje.'

Ed: 'Domethënë, nuk je i martuar?'

Ipeshkëvi: 'Jo.'

Ed: 'A ke menduar ndonjëherë të bëhesh meshtar?'

Ipeshkëvi: 'E din si është, pas koncilit të Dytë të Vatikanit, laikëve u janë ofruar shumë mundësi për të shërbyer në Kishë. S'është e thënë të bëhen meshtar ose motra nderi.'

Kjo dukej si ecje akrobatike në telin e tendosur. Pas kësaj jave në Megjugorje, jam i bindur se do të mund të punoja për KGB!“

„Shkaku tjetër pse kam ardhë në Megjugorje ishte që të shoh se çfarë po ndodh këtu dhe a do të jetë në rregull t'i lejoj miqtë të organizojnë shtegtim për njerëzit nga ipeshkëvia ime. Që ta shoh këtë, është dashur ta përjetoj Megjugorjen si shtegtarë i thjeshtë. Erdha, pashë dhe kuptova se Megjugorja është ajo që pohon se është!“

„Erdha nën 'presion'. Motra ime e vogël, Micheline, vazhdimisht më furnizonte me informata, me libra, artikuj. Ajo është një grua e re, shumë e vendosur. Në fund e bëri të veten.“

„Për më shumë se dyzet vjet jam meshtar misionar në veriun e Kanadasë. Kryesisht punoj me njerëzit e fisit indian Dene dhe me Eskimezët. Ata janë shumë të devotshëm ndaj Marisë. Devotshmëria e tyre më e dashur është lutja e rruzares. Sikur të vinin në Megjugorje, ata do të ishin si në qiell! Do të forcoheshin, feja e tyre do të përtërihej, do të ndjeheshin si peshku në ujë dhe do ta pranonin Megjugorjen.“

„Dhe në fund, më lejoni, të ju them se sa e çmoj këtë përvojë. Ishte shumë, shumë shpirtërore. Tani e kuptoj për se njerëzit që njëherë vijnë këtu, duan që përsëri të kthehen. Është diçka e veçantë. Unikale. E kuptoj se kam mundur të flas më shumë, por e kam bërë atë që kam dashur. Duhet paguar çmimi për çdo gjë që duam. Tani shpresoj se një ditë, të gjithë do të jemi në të njëjtin aeroplani, se i njëjti autobus do të na vozisë në Megjugorje, ku kemi lënë një pjesë të zemrës sonë.“

Një vit më vonë, monsinjor Croteau u kthye në Megjugorje si ipeshkëv, me një grup nga regjioni i tij. E motra Micheline kishte organizuar shtegtimin, kësaj rradhe. Në fund të vizitës së dytë, dëshmoi sa vijon: „Ajo që më ka prekur ishte devotshmëria, feja, dëshmitë. Kemi parë njerëz që luten, njerëz që besojnë, njerëz që jetojnë përvojën e krishterë të fesë dhe të dashurisë. Ata njerëz digjen në flakën e fesë. Kjo është e mrekullueshme! Kam provuar gjëra të ndryshme në

ipeshkëvinë time me qëllim që të ndërroj besimtarët, pasi që jetojmë në shoqërinë e cila nuk funksionon. Kam shpenzuar me mijëra e mijëra dollarë në takime dhe në punëtori. Dhe me gjithë ato të holla të shpenzuara, nuk kam arritë as dhjetë përqind të asaj që arrihet këtu me një shtegtim. Dhe kështu, unë jam personi i cili nga zemra do të ju preferoi shtegtimin në Megjugorje!“

„Për mua ngjarja më e rëndësishme ishte rrëfimi. Për meshtarin, është vendi më i mirë ku mund të dihet dhe të zbulohet, me të vërtetë, se çfarë ndodh në Megjugorje. Nuk mund ta marr me mend se meshtari i cili vjen këtu dhe rrëfen një orë, njëkohësisht të mos bindet në plotësi se në Megjugorje vepron vetë Qielli. Me gishtin tonë mund të prekim veprimin e Marisë dhe të Zotit duke dëgjuar njerëzit dhe mënyrën se si ata ndërrohen. Disa vijnë këtu si njerëz të mirë por shkojnë prej këndeje si të krishterë shumë më të mirë. Të tjerë vijnë këtu si mëkatarë (duke e ditur këtë apo jo). Por në çastin kur largohen, e dinë se kanë qenë mëkatarë, se janë të shpëtuar dhe se ju janë falur mëkatet. Këto, më së pari i përjeton meshtari. Nëse dikush do të më thoshte se djalli vepron në Megjugorje, unë do t'i përgjigjesha: 'Po, ai qenka një djall i mjerë! Nuk mendoj se i takon ferrit, është e qartë se punon për Qiellin! Mendoj se duhet të promovohet për Qiell!“

„Të dashur fëmijë! Në mënyrë të posaçme, sonte dëshiroj t'i thërras të gjithë prindërit e botës të gjejnë kohë për fëmijët e vet dhe për familjet e veta. Le të ju ofrojnë dashuri fëmijëve të vet dhe dhe le të jetë ajo dashuri prindërore dhe amënore.“ (31.korrik 1989.)

24

VETËVRASJET TË SHTUNDEN MBRËMA

Nevoja për adhurim është aq e fuqishme në zemrën e njeriut, sa që askush nuk mund t'i rezistojë. Nuk ka ateistë të vërtetë ose jobesimtarë⁵⁷. Ekzistojnë vetëm njerëz që u kthehen zotrave të rremë. Pasi ende nuk e kanë përjetuar dashurinë e Zotit të Gjallë, ata e kërkojnë Zotin e Vërtetë në vend tjetër. Secili ka potencialin e vet për adhurim, thellë në brendi, të cilin e orienton diku. Nëse nuk i përkulet Zotit të Gjallë, atëherë adhurimi i tij do të drejtohet në ndonjë qenie njerëzore, ndonjë aktivitet ose gjë, dhe kjo është tragjedia e idhujtarisë e cila heret ose vonë çon në dëshpërim.

Të gjithë jemi të etur. Kemi etje për jetën, të duam dhe të jemi të dashur, kemi etje për lumturinë që nuk do të zhduket. Nëse do të pijmë jetën drejtpërdrejt nga burimi i amshuar në Zemrën e Zotit, gjithmonë do të kemi lumturinë, madje edhe në shtigjet kaotike të ekzistencës sonë njerëzore. Në anën tjetër, nëse u drejtohem cisternave të dobëta e të vogla të jetës për të shuar etjen, ato heret ose vonë do të thahen. Atëherë edhe ne do të thahemi, do të hidhërohemi dhe do të vdesim prej etjes.

Miqët e mi, psikiatra, kanë vënë re trendin e përgjithshëm në Francë: numri më i madh i vetëvrasjeve ndodh nga e shtundja mbrëma deri të dielen në mëngjes. Ekippet e ndihmës së shpejtë janë të përgatitura goxha mirë për këtë fenomen të cilin e quajnë „virusi i natës së shtunë“. Ky është prodhim i Perendimit, në të cilin materializmi i ka arritur kufijt e skajshëm. Këtu vepron virusi i cili sulmon njerëzit më të dobët dhe më të lëndueshëm: rininë tonë. Kjo është arsyeja për të cilën Zoja ka ardhë në Megjugorje! Zemra e sajë amënore nuk mund të durojë vuajtjet e tmerrshme të këtyre të rinjëve, që janë të thyer nga dëshpërimi dhe të cilët më me dëshirë do të vdisnin se sa të ballafaqoheshin me zbratësinë e brendëshme. Ajo ka për ta çelsat me të cilët mund t'i nxjerr prej burgut të tyre. Janë të panumërt ata që Zoja i ka shpëtuar nëpërmes të ndërmarrjes së sajë në Megjugorje!

⁵⁷Zoja nuk e përdor fjalën „jobesimtar“. Më me dëshirë përdor shprehjen: „ata të cilët nuk e kanë njoftë dashurinë e Zotit.“

Ende më kujtohet çifti i cili m'u afrua një ditë në parkingun pranë kishës dhe më pyeti me frikë:
„Ju lutem, motër, a mund të luteni për birin tonë Markun?“

„Po, natyrisht!“, thashë, duke parë dhëmbjen e thellë në sytë e tyre. Para se të largoheshin vendosa t'i pyes: „A ka ndonjë problem? A është i sëmurë?“

Mbretëroi heshtja. Pas një qetësie të gjatë, burri i murmuriti së shoqes: “Hajde, tregoi. Unë nuk mundem.”

„Pra, motër, javën e kaluar burri im shkoi në tavan për të kërkuar diçka dhe atje e gjeti birin tonë. Ai ishte varë!“

Përjetova šok si goditje zjarri dhe nuk munda të them asgjë. Mbeta krejt pa fjalë. Papritmas pash para vetes dy zemra, të ndara në pjesë. Kot u përpoqa t'i mbaj lotët.

Pastaj shtoi: „Motër erdhëm këtu menjëherë pas varrimit. Nuk mundëm të shkojmë në shtëpi. E kemi dashur shumë. Secilën herë i kemi thënë rishtas: 'Mark, ajo vajzë nuk është për ty, ajo do të të lër ashtu si i ka lënë të tjerët para teje!' Por nuk deshi të na dëgjoj. Kemi mundur të shohim se ishte dashuruar fort dhe se ndjenja ishte më e fortë se ai. Kur nuk u pajtuan më, filloi të marrë drogë. Dhe motër... “

„Motër,“ e ndërpreu babai, „a mund të na thoni ku është ai? A është tani i lumtur? Si mun ta dimë këtë?“

U larguan prej parkingut. Prej meje nuk dëgjuan asnjë fjalë. Zemra nuk më linte të flas. Por deri sa mbaja duart e tyre me të miat, nuk mund t'i mbaja lotët. E dija se ata e ndjejnë se i kam dëgjuar dhe i kam kuptuar. Fatmirësisht, të nesërmen i pashë në kishë.

Kurrë më!

Kjo është klithja që ia drejtojmë Qiellit kur të tjerët na besohen në këtë mënyrë. Dhe klithja jonë e vogël është vetëm jehonë e zbehtë e zemrës së Nënës sonë e cila sheh se si fëmijët e sajë vdesin për shka të zbratësisë. Ajo ka ardhur për të ndaluar masakrën! Ka ardhur të vendosë në zemrat tona Fëmijën e fshehur që e ka mbajtur në prehër në Betlehem. Të vetmin i cili mund të na plotësojë, më tepër se sa ne, në fshehtësi, mund të dëshirojmë.

Marku i ri vdiq shumë heret. Edhe ai ka mundur ta marrë këtë dhuratë të madhe nga Maria dhe të shpëtoi!⁵⁸ Por për të rinjët tjerë „të tipit të Markut“, që tani ballafaqohen me humnerën ka ende kohë! Ende mund të veprohet! Maria na jep çelsin me këto fjalë: „*Fëmijëz të dashur, vendosni Zotin në vend të parë në jetën tuaj dhe me të do të jeni në rrugë të sigurt.*“ (Porosia në festivalin e të rinjëve, 1996.)

2. gusht 2005., në mes të Mladifest-it, Zoja erdhi që me Mirjanën të lutet për „jobesimtarët“, ashtu si çdo muaj. Me mijëra të rinj nga të gjitha vendet kishin ardhur që të përshëndesin nënën e tyre, që ta lusin dhe të pranojnë bekimin e sajë. Porosia që pranuan pas dëftimit ishte shokuese! Situata që përshkruan ajo është shumë reale. Nuk mund ta mohojmë as ta zvogëlojmë! Do të ishte mirë që kjo porosi të mësohej përmendësh dhe të lutet Shpirti Shenjt për hirin që ai ta bëjë rentgenin e zemrave tona. Me rrezet e tij hyjnore, le ta zbuloi përmbajtjen vërtetë të zemrave tona. Ashtu do të mundemi t'i shqyrtojmë edhe një herë zgjedhjet tona! Do të vendosim të marrim në zemrat tona Dashurinë e Vërtetë dhe jo të rreme, Dritën e Vërtetë e jo shkëlqimin e rremë të botës që na vezullon vazhdimisht para sysh.

Maria tha: „*Të dashur fëmijë, vij te ju me duar të hapura, që të mund të ju përfshij të gjithëve me mantelin tim. Por këtë nuk mund ta bëj derisa zemrat tuaja janë përplot me shkëlqim të rremë dhe idhuj të rremë. Pastroni zemrat tuaja dhe lejonu engjujve tuaj të këndojnë në to. Atëherë do të mund t'ju marr nën mantelin tim dhe të ju jap Birin tim, paqen e vërtetë dhe gëzimin. Mos e shtyni për më vonë, fëmijët e mi! Ju falemnderit.*“ (Porosia Mirjanës, 2. gusht 2005.)

Nën dritën e numrit përherë e më të madh të vetëvrasjeve në mesin e të rinjëve dhe helmimit të përgjithshëm të shoqërisë sonë, më 2. janar 2006., thirrja e Zojës ishte edhe më e dhimbshme. Në porosinë dhënë Mirjanës ajo thotë: „*Fëmijët e mi! Biri im ka lindur! Ai është me ju. Çka ju pengon në zemrat tuaja që ta pranoni? Çka është e rrejshme aty/? Pastroni zemrat tuaja me lutje dhe agjërim. Njiheni Birin tim dhe pranoheni. Ai, i vetmi mund të ju japë paqen e vërtetë. Ai është rruga drejt jetës së pasosur. Biri im! Ju falemnderit.*“

⁵⁸ Në Amsterdam më 1954., Zoja i ka kërkuar vëgueses Ida që të lutet dhe të ja sugjerojë edhe të tjerëve të lusin lutjen që ia ka dhënë. Duke marrë parasysh numrin në rritje të vetëvrasjeve (më shumë se një për orë, në Francë), vlen të mbahet në mend. Është fjala për lutjen e Zojës së të gjithë popujve: „Zotëri Jezu Krisht, Bir i Atit, dërgoje tani Shpirtin tënd në tokë. Bën që Shpirti Shenjt të banojë në zemrat e të gjithë popujve që të jenë të ruajtur nga prishja, fatkeqësia dhe lufta. Le të jetë Zoja e të gjithë popujve, Virgjëra e Lume Mari, mbrojtësja jonë.“ Me lejen e Kishës, në Harlem, 31. janar 1996.

„Të dashur fëmijë! Mësoni fëmijët tuaj, sepse nëse nuk do të jeni shembull për ta, do ta humbin fenë.“ (25. gusht 1989.)

25

PAULINE!

Ishte tetëmbëdhjetë vjeçe dhe ende nuk ishte e pagëzuar.

„Para se të vija në Megjugorje, vërtetë kisha rënë në fund. Prindërit e mi janë ateistë. U shkurorëzuan kur isha nëntë vjeçe. Pas kësaj, i lejova vetes të përfshihem prej të gjitha të këqijave të shoqërisë. Në moshën trembëdhjetëvjeçare fillova të marr drogë. Familja ime e shkatërruar, ngadalë më solli në gjendje frike dhe mbylljeje në vete. Si zombi lëvizja pa ndjenja, pa shikim, pa jetë. 'Zbraztësirë' – është fjala e cila shumë mirë e përshkruan gjendjen time të brendëshme. U lëshova në 'knaqësitë trupore' dhe u fundosa edhe më thellë. Kërkova shpëtim në punë. Verën e kaluar provova të bëj vetëvrasje, dhe kur u zgjova në spital, kuptova se, në të vërtetë, jeta është e tmerrshme. Nuk kisha rrugëdalje, nuk kisha ardhmëri.“

„Kam një shoqe katolike, Alice. Jeta e sajë u ndërrua kur u kthye nga Megjugorja dhe sa herë më fliste për Marinë, ndjeja se në mua po hyn drita. Kah fundi i qerrshorit më thirri: 'Pauline, po shkoj në Megjugorje dhe i kam rezervuar tri vende – njëri është për ty. Do vish me mua!“

„Ishte shok për mua, sepse ndjeva se fjalët e sajë janë thirrje. Pranova menjëherë. Mirëpo, punoja si statiste gjatë verës në xhirimin e në filmi dhe atë nuk mund ta ndërpreja. Por, as të holla për udhëtim nuk kisha. Dhe kështu e pyeta babain, pa shumë shpresë, sepse moti më kishte thënë se nuk do të më ndihmojë më, me të holla. Dhe, ndodhi mrekullia mbi mrekullitë. Menjëherë pranoi të japë gjysmën e shumës. Nëna ma dha gjysmën tjetër. Pranova edhe një shenjë tjetër. Studioja filmike më lajmëroi se do të ketë ndërprerje dhjetë ditore në xhirimin e filmit, pikërisht në kohën kur duhej udhëtuar për Megjugorje!“

„Arrita në Megjugorje ditën e fundit të Mladifest-it. Shkova në adhurimin e mbrëmjes, dhe pastaj u ngjitëm në kodrën Krizhevac, në meshën e mëngjesit. Ishte festa e Shndërrimit. Deri sa ngjitesha, përpiquesha ta përjetoj atë kohë me Zotin, por nuk mund të koncentrohesh në lutje. Vetëm zbraztësi ndjeja. Kur arrita në majë, ecja me shpejtësi sa andej-këndeje, dhe nuk mund të qetësohesh në një vend. Ndjehesha tepër e ndrydhur përbrenda. Përfundimisht e braktisa meshën, para fundit, dhe e vetmuar u lëshova kodrës teposhtë. Ndjeja sikur rreth zemrës kam një pancir të rëndë. Më ngulfaste dhe bllokonte rrugën te Zoti. E dëshiroja Zotin por nuk mund t'i afrohesha.“

„Nuk isha e pagëzuar dhe në atë çast e kuptova rëndësinë e pagëzimit.“

„Një djalosh nga regjioni im, Pierick, më tha. 'Pauline, duhet të shkosh në rrëfim!'“

„Kishte të drejtë. Por ideja që meshtarit të ja them të gjitha mëkatet e mia, më tronditi krejtësisht. Mund t'i shihja të gjitha gabimet e mia dhe mendoja: 'Si do të ja them këtë? Po këtë? Kjo është e tmerrshme, nuk mund ta bëj!' Por, megjithatë e bëra. Ishte rrëfimi im i parë, dhe nuk e dija se personi duhet të jetë i pagëzuar për të marrë sakramentin! Qysh në fillim, meshtari, si duket, e vërejti plagën e madhe në mua dhe më dha zgjedhjen. Më tha që të marr Marinë për nënën time dhe të bëhem përsëri si fëmijë i vogël në krahërorin e sajë. Si duket, në rrëfimin tim, ai nuk e kishte me rëndësi numrimin e mëkateve të mia, por që të më dëshirojë mirëseardhjen në Zembrën e Zotit e cila më priste dhe vuante me mua.“

„Gjatë rrëfimit dhe bekimit që pasoi, u zhduk zbrastësia e cila ishte në brendinë time! Qaja nga gëzimi. Qeshja! Sikur e gjithë e keqja që kishte zënë vënd në mua, doli jashtë. Ndjeja se po më braktiste e gjithë ajo papastërti. Pas kësaj, gëzimi hynte në zembrën time çdo ditë e më tepër dhe më në fund mund të lutesha me zemër! Tani zgjohem heret çdo mëngjes dhe lutem. Për të parën herë kam përvojën se jam e plotësuar. Mund ta ndjej Zotin që më shëron.“

„Në Megjugorje plagët e mia të hapura u mbushën me dashurinë që ma dha Zotëria ynë nëpërmes të Marisë. E di se rruga do të jetë e gjatë dhe e rëndë. 'Bëhu e fortë dhe qëndro!' – këto fjalë më kthehen vazhdimisht. Tani e di se për mua është e pamundur ta shoh jetën pa Trininë Shenjte. Aty është e vërteta. Sa bukur është të jesh i lumtur!“

Pauline përgatitet për pagëzim. Të ja besojmë Pauline, Zojës, si edhe me mijëra të rinj që vuajnë sot, ashtu si ka vuajtur ajo para se ta takonte Zotin.

Uji i gjallë për mijëra të rinj!

Motra Briega McKenna ma ka treguar këtë ngjarje të rëndësishme: në maj të vitit 1981., kishte takuar meshtarin fra Tomislav Vlasiq⁵⁹ nga Jugosllavia e atëhershme. Ai kishte kërkuar që kjo të lutej për famullinë dhe për vendin e tij. Ishte një kohë goxha e vështirë, kur pushteti luftonte fort kundër Kishës. Pasi që ai ishte përgjegjës për të rinjtë e Hercegovinës, ishte shumë i pikëlluar kur

⁵⁹Gjithsesi është e nevojshme të thuhet se fra Tomislav Vlasiq si famullitar ka pasë rolin e tij në historinë e Megjugorjes. Por, Vatikani më 2008. E ka suspenduar. Duhet ditur se nuk ka pasë kurrfarë lidhje zyrtare në mes të fra Vlasiqit dhe famullisë së Megjugorjes që nga viti 1987., kur në mësimet e fra Vlasiqit filluan të vërehen gabimet teologjike. Fra Vlasiq së bashku me Agnes Heuspel, një grua nga Gjermania, themeloi bashkësinë në Megjugorje. Më vonë e çvendosi në Itali. Pak nga pak, si duket u verbua në dallimin e shpirtave, dhe nuk ishte më ai bariu që u printe deleve por delet i prinin bariut. Për të 'lokucionet e brendëshme' të asaj gruaje e cila pretendonte se i ka, së shpejti u bënë gur në të cilin merret në thua dhe, pasi që nuk deshti të heqë dorë as nga lokucionet e sajë as nga bashkësia (pavarësisht nga vërejtjet e këmbëngulëse të vëllëzërve të tij meshtarë), kjo e solli ngadalë deri te tragjedia e tij si meshtar. Kjo është edhe një vërejtje se i Keqi nuk fle!

shihte se si komunistët, nëpërmes të premtimeve mashtruese, tërheqin shumë të rinj katolikë dhe i sjellin në situatë që të regjistrohen në parti. Këta të rinj, atëherë e braktisnin Kishën dhe i bashkoheshin Partisë.

Posa motra Briega filloi të lutet mbi të, i tha se ka vizion të qartë të kishës. Nuk e dinte se ku është ajo kishë. Kishte dy këmbanare. Përbrenda shihte një altar të thjeshtë. Fra Tomislavi rrinte në kishë në vendin e koncelebruesit kryesor, kurse prej altarit rridhnin përrenjë uji. Motra e dinte në shpirt se ai është Uji i Gjallë! Uji dilte prej dere, duke mbuluar mbarë krahinën. Shihte të rinjë nga të gjitha vendet se si vinin në atë kishë dhe pijnë me dëshirë atë ujë, duke shfrytëzuar duart e tyre të bashkuara si gotë. Ishin të shndërruar, rrezatonin me gëzim! Atëherë ata të rinj u kthyen në shtëpiat e tyre, në vendet e ndryshme prej të cilave kishin ardhur dhe atje filluan të sjellin shokët e vet në kishë. Motra pa mijëra të rinj! Sa më shumë që pinin dhe shuanin etjen e tyre, aq më shumë thirrnin të tjerë të rinj që t'u bashkohen për të pirë atë Ujë të Gjallë!

Fra Tomislavi u ngushëllua nga ky vizion. U kthye në shtëpi i mbushur me shpresë. Ai atëherë as nuk parandjente se kisha të cilën motra Briega e kishte përshkruar është pikërisht kisha e famullisë së tij në Megjugorje! Edhe më pak e priste se një muaj më vonë, më 25. qershor, Zoja do të dëftohet në Megjugorje, duke zgjedhur gjashtë fëmijë si dëshmitarë të sajë!

Tani, për çdo verë në Megjugorje tubohen me mijëra të rinj. Shumë shpesh përjetojnë kthime dhe gjejnë kuptimin e jetës së tyre.

„Të dashur fëmijë! Sonje, në mënyrë të posaçme ju thërras që të luteni për fëmijët e palindur. Veçanërisht lutuni për nënat që me vetëdije i vrasin fëmijët e tyre. Të dashur fëmijë, jam e pikëlluar sepse vriten aq shumë fëmijë. Lutuni që në botë të ketë sa më pak raste të tilla.“ (21. korrik 1982.)

26

BUTËSIA FËMINORE

Të varfër dhe të talentuar

Adami ishte njëri prej nxënësve më të mirë në klasën e tretë. Dukej se çdo gjë i shkonte lehtë. Një ditë mësuesja u tha nxënësve se do t'ua zgjatë pushimin pasi që ta kenë zgjidhur detyrën e matematikës! E gjithë klasa ishte e shqetësuar dhe nxënësit nguteshin për ta kryer detyrën. Por, Freddie i vogël ngecte. Merrte barëra të forta për të ndaluar ngërçat, për shkak të të cilëve punonte shumë ngadalë. Për të nuk do të ketë pushim atë ditë...

Adami, i cili sapo kishte përfunduar detyrën, u ngrit dhe u nis drejt bangës së Freddie për t'i ndihmuar. E trimëronte Freddie-n dhe me duresë priste që ta përfundojë detyrën. Mësuesja ndjente se si në fyt i bëhej gogëlushja derisa shikonte këtë tetëvjeçar se si e bën këtë me plot mëshirë dhe ndijesi. Ishte dëshmitare e mëshirës në veprim.

Kjo është ngjarje e vërtetë e cila ndodhi në mars të vitit 2001., – fëmijët janë mësues të mirë! Adami nuk lejoi që Freddie të priste gjatë për ndihmën e tij

Zoja na thotë: *„Të jeni të mëshirshëm nga zemra. Bëni vepra të mira dhe mos lejoni që njerëzit të ju presin tepër gjatë.“*⁶⁰ (Mirjanës, 18. mars 2001.)

Mikey i vocërr

Michael dhe Annie (SHBA) kanë tre fëmijë, dhe që prej kurorëzimit të tyre jetojnë në shkollën e Zojës. Çfaqin gëzimin i cili prek të gjithë që takohen me ta. Djali i tyre i vogël Mikey është katër vjeç. Daja i tij Joseph-i (i cili ka nëntë vjet!) një ditë i ka treguar tregimin:

⁶⁰ Në mënyrë të ngjashme m. Faustina na nxit që, jo vetëm të lutemi për Mëshirën Hyjnore, por që ta jetojmë atë. Jezusi i ka thënë: „Prej teje kërkoj vepra mëshire, të cilat duhet të dalin nga dashuria jote ndaj Meje.... T'i jap tri mundësi për çfaqjen e mëshirës ndaj të afërmit: e para – vepra; e dyta – fjala; e treta – lutja. Në këto tri nivele qëndron plotësia e mëshirës.“ (Ditari i m. Faustine, 742)

Pula e vogël kuqloshe gjeti një kokërr gruri dhe i pyeti të gjitha kafshët tjera: „Kush do të më ndihmoi ta mbjell këtë kokërr gruri?“ Askush nuk u përgjigj. „Në rregull, do ta mbjell vetë!“ „Kush do të më ndihmoi ta ujis grurin?“ Askush nuk u përgjigj. „Në rregull, do ta ujis vetë!“ „Kush do të më ndihmoi ta korr grurin?“ Ska përgjigje. „Po ta bluaj grurin?“ Përsëri s'ka përgjigje. Dhe kështu me rrallë, deri sa erdhi koha për të ngrënë bukën. Tani, natyrisht, të gjitha shtazët donin të ndihmojnë në ngrënje! Por pula e vogël kuqloshe tha: „E, nuk bën! Askush nuk më ndihmoi ta kultivoj grurin, prandaj zogjët e mi dhe unë do ta hamë bukën vetë!“

Këtu Mikey i vogël, papritmas e ndërpreu treguesin: „Sikur pula e vogël kuqloshe të ishte Jezusi, ajo megjithate do të ma jepte bukën e vet!“

Ruaje shpirtin tim, Jezus!

Në SHBA jeton një familje shumë e lidhur e cila lutet së bashku çdo mbrëmje, ashtu si na thërret Zoja. Fëmijët janë mësuar t'i dëgjojnë prindërit se si flasin për Jezusin si për mikun më të mirë të familjes – Bariun e mirë të cilit i janë drejtuar gjithmonë. Colin është njëri prej gjashtë djemve të tyre, kurse Cathy, e ëma, na ka treguar për këtë shenjë të mbojtjes së Zotit mbi ta.

Një mbrëmje, derisa përgatiste trevjeçarin Colin për në shtrat, ai i tha, „Mami, gjatë natës dëgjoj zërin që më thotë: 'Colin, shpirti yt do të shkojë në ferr!' “

„O, Colin,“ u përgjigj, „lute Jezusin dhe Ai do të kujdeset për ty!“

„Jam lutur“, tha ai, „dhe Jezusi më ka thënë se si duhet të përgjigjem.“ Cathy e pyeti atëherë se çfarë i ka thënë Jezusi. Colin u përgjegj: „Jezusi më tha: 'Coline, kur e dëgjon këtë, thuaj, Jezus, ruaje shpirtin tim.' “...Nëse Hyu na përkrah, kush do të jetë kundër nesh?⁶¹

Ajo më buzëqeshi

Atë Tony më foli për ardhjen e vëguesit Ivan në Irlandë, në famullinë e tij të shën Katarinës në Newry në marsin e vitit 1995.. Atë ditë, para meshe Ivani pati dëftim, në praninë e dy mijë vetëve të tubuar në lutje.

Të nesërmen voglushja dymbëdhjetëvjeçare Elena i tha mësueses: „Dje në kishë kam qenë në dy meshë!“

⁶¹ Rom 8,31

„Vërtetë?“ pyeti mësuesja e befashuar.

„Po!“ u përgjigj vogëlushja. Elena, e cila ishte mentalisht e hendikepuar dhe mendonte si pesëvjeçare, mendonte se lutja para dëftimit ishte meshë. Ja se çka i tha, në pafajsinë e vet, mësueses:

„Në meshën e parë erdhi Zoja e Lurdit dhe foli më një njeri. Nuk munda të dëgjoj se çfarë i tha, por më buzëqeshi,“ (Elena flet për Zojën e Lurdit sepse ajo ka qenë në Lourdes me të atin i cili çdo vit shkon, si vullnetarë, si bartës i vigut për të sëmurë. Kështu 'Zoja e Lurdit' ishte i vetmi emër që ajo dinte për Marinë.)

Mësuesja i informoi prindërit e Elenës për këtë bisedë, kurse ata e pyetën të bijën se çfarë kishte ndodhur. Dëgjuan të njëjtin tregim, fjalë për fjalë. Kur e pyetën se si dukej Zoja. Elena u përgjigj: „Zoja e Lurdit kishte fustan të kaltërt në të hirtë, kurse në kokë kishte diçka të bardhë. Ia kam parë flokët. Më buzëqeshte. Pas sajë ishin disa drita me ngjyra, si dritat në bredhin e Krishtlindjes. E gjitha shkëlqente shumë kurse pas sajë rrjedhte diçka si ujë.“

Meshtari dominikan e njihte këtë familje dhe kishte mundësi që personalisht ta pyes voglushen. Atë që mori prej sajë, ishte i njëjti tregim që kishin dëgjuar mësuesja dhe prindërit. Nuk shtoi as nuk lëshoi asnjë fjalë. Meshtari ma shpjegoi se dritat për të cilat flet Elena, si duket janë yjë të zbukurojnë kokën e Marisë në Megjugorje.

Fryti më i bukur i kësaj ngjarje mund të shihet në Elenën. Prej asaj dite, qëndrimi i sajë ka ndryshuar në mënyrë drastike. Tani shndërit nga gëzimi dhe është shumë më e hapur. A nuk është mrekulli që në mesin e dy mijë vetëve të pranishëm, Zoja e ka lejuar fëmiun e hendikepuar që ta shohë? Se çfarë shembulli të bukur na ka dhënë Maria duke treguar një kujdes të tillë ndaj jetës së vogël dhe të çmueshme të cilën bota e sotme do ta injoronte aq shpejt!⁶²

Mos keni frikë të keni fëmijë!

I njoh mirë disa çifta bashkëshortorë italian. Rita, njëra prej grave, pikërisht ajo që prej Megjugorjes në Civitavecchi⁶³ ka sjellë truporen e famshme e cila katërbëdhjetë herë ka qarë me lotë gjaku. E bija, pjesëtare e bashkësisë Famiglia di Maria në Romë, më tregojë tregimin në vijim:

⁶² Pas rrëfimit, Jezusi i ka dhënë m. Faustinë këto fjalë: „Pasi që je fëmijë, mbetesh në Zemrën Time. Më shumë më pëlqen thjeshtësia jote se sa flitë. „ (*Ditari i m. Faustinë, 1617*)

⁶³ Në Civitavecchi (afër Romës), më 1997., truporja e vogël e Zojës, i sjellë nga Megjugorja, katërbëdhjetë herë ka qarë me lot gjaku. Herën e fundit ka qarë në duart e msgr. Girolamo Griloo, ipeshkëvit lokal. Jezusi ka kërkuar që të lexojmë shenjat e kohës.

Në gushtin e vitit 1984., Zoja u tha vëguesve me rastin e dëftimit: „Keni aq pak fëmijë! Të kini fëmijë! Mos keni frikë të keni fëmijë. Para se të bëhen fëmijët tuaj, ata janë fëmijët e mi. Kushtojani Zemrës sime të Pamëkat.“

Njëra prej katër grave të pranishme, mikja ime Rita ishte në të dyzetat dhe i kishte pesë fëmijë. Gruaja tjetër, gjinekologe, shumë kohë provonte të kidhte fëmijë, por kot. E treta ishte sterile, kurse e katërta me intervenimin njerëzor ishte sterilizuar përgjithmonë. U muarën porosinë, dhe ajo që është e jashtëzakonshme është se, që të tria të cilat nuk ishin të sterilizuara me dorë njerëzore, mbetën shtatzëna, në Megjugorje, me rastin e shtegtimit të tyre më 1984., Që të tria patën mjaft probleme me shtatzënitë, dhe të shumtën e kohës duhej të ishin në shtrat, por lindën tri foshnje, të gjalla dhe të shëndosha, kurse tani janë gëzimi i prindërve të tyre.

Masakra e të pafajshëmve....

Megjugorje, më 1985.

Dëftimet e përditshme të Mirjanës tanimë kishin përfunduar. Prej atëherë kishte dëftime një herë në vit, më 18. Mars. Ngjarja e ardhshme duhet të ketë ndodhur, sipas gjase, në kohën e njëres nga ato dëftime. Adriana, mike e madhe e Megjugorjes, ishte e pranishme në dëftimin në dhomën e vogël në shtëpinë e Mirjanës, së bashku me disa të tjerë. Kur Mirjana, e gjitha e dërmuar, doli nga ekstaza, miqtë e mi pyetën se çfarë ka ndodhur. Mirjana, në fytyrë kishte shprehjen që tregonte shqetësimin dhe shokun. Zoja i kishte folur për misteret, dhe Mirjana iu kishte thënë se kishte qenë dëshmitare e disa sçenave shumë të dhëmbëshme ku kishin pësuar madje edhe fëmijët.⁶⁴ Në një sçenë të tillë, ku fëmijët ishin viktima të dramës, Mirjana e ka pyetur Zojën: „Por Zoti është i mirë, si mund të lejoi të ndodhin gjëra të tilla?“ Zoja i ka shpjeguar se nuk i ka bërë Ai ato gjëra, por njeriu i cili nuk e dëgjon Zotin. Pastaj ka shtuar diçka shumë të rëndësishme „Sot në Kishë, si edhe para dy mijë vitesh në Betlehem, vazhdon masakra e të pafajshëmve. Kjo fli është e lidhur me flinë e Jezusit të kryqëzuar.“

Prej gojës së fëmijëve

Ja margaritarët e mbledhur nga faqet e fletoreve të fëmijëve të cilët ia kanë paraqitur Zojës lutjet dhe flitë:

Lutjet e tyre:

⁶⁴Jelena, veguese me zemër, poashtu ka parë disa sçena të vështira. Disa vëgues me vështirësi i kanë dëgjuar disa nga misteret dhe Zoja iu ka thënë se Zotëria iu ka dhuruar hirin që të harrojnë, dmth disa gjëra që i kanë mësuar, të jenë të fshehura në kujtesën e tyre që të mund të jetojnë me një jetë normale, dhe në të njëjtën kohë t'i bartin ato.

„Lutu për ata që kurrë nuk janë të gëzuar.“ (Silouane, 9)

„Zotëri, shfrytëzoje lutjen time për njeriun i cili pin më së shumti.“ (Pierre, 9)

„Bën që të vij në qiell, por edhe motra ime edhe nëna ime edhe babi im edhe qeni im edhe ketri im edhe ketri i motrës sime dhe bën që t'i dua të gjithë - përveç djallit.“ (Dana, 7)

„Zot i dashur, nuk mund të pres kungimin tim të Parë që të marr Ty“ (Myriam, 10)

„Lutja ime — kokrra e madhe e rruzares.“ (Jo, 7)

Flitë e tyre:

„Të pastroj të vjellat e maces sime në vend se t'i lë prindërit ta bëjnë këtë. E hëngra tostin e djegur në vend se t'i lë të tjerët ta hanë.“ (Marie-Reine, 12)

„Kam ecur gjashtë mile për ndërprerjen e aborteve.“ (John, 10, nga SHBA)

„E gjeta një monedhë dhe ia dhash zonjës së varfër.“ (Myriam, 10)

Inspirimet e tyre:

Kur isha në Argjentinë, shoqja ma tregoi këtë tregim: „I shpjegova gjashtëvjeçares sime, Magdalenës, se unë dhe burri im, si prindërit e sajë, nuk jemi edhe krijuesit e sajë. I thash se Zoti është i vetmi burim jete dhe se Ai e ka vënë në duart tona që t'i ndihmojë për të jetuar dhe për t'u rritur në shenjtëri në këtë botë. Ne jemi diçka si instrumentet e Zotit për jetën e sajë.“

Dy ditë më vonë, e dëgjova se si të gjitha këto ia shpjegonte kusheririt me moshë të njëjtë. Në fund doli se: „Pai, e din, Roberto, po ta them, ata vërtetë nuk janë prindërit e tu. Zoti dhe Maria janë prindërit e tu të vërtetë. Prindërit e tu dhe prindërit e mi, ata janë vetëm si dado!“

„Të dashur fëmijë! Ju thërras që të përcaktoheni për Zotin dhe ai do të ju mbrojë e tregojë se çfarë duhet të bëni dhe cilës rrugë të shkoni. I thërras të gjithë ata që më kanë thënë „po“, le ta përtërijnë kushtimin Birit tim Jezusit dhe Zembrës së Tij, edhe mua, që të mund të ju përdorim më shumë si mjet paqeje në këtë botë të trazuar. Megjithatë është shenjë për të gjithë ju dhe thirrje për t'u lutur, por edhe t'i realizoni ditët e mëshirës që ju jep Zoti. Prandaj, fëmijë të dashur, pranoni me seriozitet thirrjen për lutje. Unë jam me ju dhe vuajtja juaj është vuajtja ime. Ju falenderoj që ju përgjigjet thirrjes sime!“ (25. prill 1992.)

27

FJALËT E VICKËS PLOT URTI

Vlera e vuajtjes

Derisa shkruaja këtë kapitull, vëguesja Vicka kishte dhëmbje të mëdha. Me javë të tëra rrinte e shtrirë në shtrat. Nuk mund të lëvizte ose të takohej me shtegtarët. Një ditë u përkul që të marrë diçka, dhe pasi u drejtua shpejt, e shtrembërojë kurrizin dhe shkaktoi herninë e dy disqeve. Vuante shumë. Përndryshe ishte e palodhshme në vizitat që u bënte të sëmurëve, i ngushllonte dhe me ta ndante dashurinë e Jezusit dhe të Marisë. Por tani bënte edhe më shumë – ndante me ta dhëmbjen nga shtrati i sëmundjes së sajë. Lutej më shumë se kurdoherë.

Në të tetëdhjetat Vicka vuante nga dhëmbja fizike akute. Zoja shpesh e mësonte mbi vlerën e fshehur të vuajtjes, e cila i paraqitet Zotit. „Shumë pak njerëz e kuptojnë vlerën e madhe të vuajtjes.“ thoshte Vicka. „Vetëm, sikur, ta dinin se sa shumë hire mund të meritojnë për vete dhe për të tjerët.“

Është e vërtetë se materializmi ynë perëndimor nuk na përgatit ta pranojmë në këtë mënyrë. Më me dëshirë e refuzojmë ose e kundërshtojmë vuajtjen. Vicka dëshironte t'ua përcjell shtegtarëve këto fjalë të Marisë: „Të dashur fëmijë, Kur keni dhëmbje ju thoni: 'Pse unë? Pse kjo nuk i ndodhi dikujt tjetër?' Dhe atëherë mendoni se Jezusi dhe unë jemi larg prej jush. Të dashur fëmijë, nuk do të duhej të flisni ashtu. Jezusi dhe unë jemi gjithmonë afër jush! Në vend të kësaj, hapni zemrat tuaja dhe do të kuptoni se sa ju duam, në të vërtetë. Të dashur fëmijë, kur jeni të sëmurë thuani Zotit: 'Zotëri, të falenderoj për dhuratën që ma jep.' “

Nga përvoja personale Vicka e di se vuajtja e cila bartet në këtë mënyrë bëhet „rrugë gëzimi“.

Vicka: Nuk ka marrëveshje për punën e Tij

Chrissey punon me ne më shumë se pesë vjet. Është miqësuar me vëguesit dhe nganjëherë u bën pyetje interesante.

Pyetja: „Si vendos se ku do të shkosh në misione? A bëhet kjo në bazë të thirrjes që merr?“

Vicka: „Sikurse që e di, njerëzit vazhdimisht na thërrasin që t'i vizitojmë. Ditë e natë pranojmë thirrje të tilla! Por, është me rëndësi të mendosh në zemër: 'Çfrë i duhet Zojës në këtë moment, çfarë kërkon ajo prej meje?' Pranoj shumë thirrje prej vendeve të cilat qëndrojnë mirë materialisht dhe do të mund të kaloja gjithë kohën time në Amerikë ose Itali. Por unë, poashtu, duhet të dëgjoj edhe ata që nuk kanë asgjë, njerëzit në vendet të cilat ballafaqohen me vështirësi të mëdha. Dhe i them vetes: 'Do të përgjigjem kur Zoja të më vendos shenjën në zemër!' Pres në qetësi, dhe në mënyrë të sigurt, ajo më tregon kohën e duhur, vendin e duhur dhe mënyrën në të cilën dëshiron t'i shpërndaj porosinë e sajë. Kur vjen shenja, e di. Mund ta ndjej, është e qartë. Madje edhe nëse shokët më bindin të shkoj atje ku jetojnë ata, këtë nuk guxoj ta marr para sysh sepse shoqëria nuk ka asgjë me misionet. Misionet janë diçka tjetër. Nuk mund të përcaktoheni që të shkoni në udhëtim vetëm për t'i kënaqur shokët. Duhet të silleni ashtu si ju flet zemra në lutje, dhe t'i përmbaheni asaj. Duhet të jeni të fortë. Është me rëndësi që, edhe më tutje, të lëvizni në paqe dhe në mënyrë që Zoti ta tregon në zemër.“

Këto fjalë të Vickës mund t'i ndihmojnë secilit që ka dëshirë të zjarrtë të jetë instrument në planet e Zojës. Në të vërtetë, kur ballafaqohemi me konfliktin, ose presionin në përpjekjet grupore rreth misionëve, ushtrimeve shpirtërore ose ndonjë aktiviteti tjetër, është bekim i madh të mund të ndash qëllimin e njëjtë dhe bashkarisht të thuhet: "Të shkojmë, të lutemi tani, dhe të hapim zemrat e të pranojmë atë që Zoti na ka përgatitur!“ Si të vehesh në dispozicion të Jezusit dhe të Marisë dhe të kuptosh se cilat janë planet e tyre – dhe të mos heqësh dorë nga planet vetanake? Kur me të vërtetë, kërkojmë së pari Zotin, ne vetëm kujdesemi që ta kënaqim atë. Kjo është e qartë. Të gjithë ne e kemi përjetuar faktin se Zoti i bekon përpjekjet e atyre të cilët nuk bëjnë kompromis në mes të punës së Tij dhe prioriteteve të tjera.“

Vicka: Shembull i shpresës në Zotin

Gjatë dimrit fshati është i qetë. Ka pak shtegtarë. Kështu pronarët e dyqaneve dhe vëguesit kalojnë më shumë kohë rreth vatrës me familjet e tyre. Kah fundi i majit në Megjugorje erdhi Kinezja Yvonne që të kaloi një kohë në Bashkësinë e Lumturive. Thoshte se për vëguesit, sigurisht, është lehtë ta njohin vullnetin e Zotit. „Meqë çdo ditë e shohin Zojën, ata e dinë se si të mbeten në rrugën e duhur. Por, ne të tjerët, si mund ta dijmë se çfarë don Zoti prej nesh në jetë dhe si mund të jemi të sigurt se jemi në rregull?“

E pyetëm Vickën që ta sqarojë këtë pakëz. Ajo e priti me ngrohtësi këtë shtegtare nga Kina. Vicka rrezatonte me një lumturi të madhe dhe me dashuri qiellore sa që dukej se e ka çelsin magjik për paqe. Në të vërtetë, ajo e ka tërhequr një vijë të drejtë që çon kah lumturia, por këtu nuk ka asgjë magjike! Vicka kështu iu përgjigj Yvonne-s:

Vicka: „Njerëzit të cilët e konsiderojnë veten të mençur dhe inteligjent i bëjnë gjërat sipas planeve të tyre dhe nuk brengosen për planet e Zotit. Ata gabojnë për shkak të mendjemadhësisë së tyre. U duhet të ballafaqohen me vështirësi të shumta në realizimin e projekteve të veta. E njëjta gjë iu ndodh edhe kur kërkojnë Zotin.“

Yvonne: „Sa më takon mua, unë ndjek planet e mia, ndoshta nga mendjemadhësia, por gjithashtu se dua të di se çfarë do të ndodhë, hap pas hapi.“

Vicka: „Ka shumë njerëz që flasin se duan të kryejn vullnetin e Zotit. Por në realitet, kur vjen çasti i zgjedhjes së rrugës, ata zgjedhin atë që u pëlqen më shumë dhe çfarë është më e këndshme për ta. Nuk është e mundur të ndjekësh vullnetin e Zotit vetëm nganjëherë e kohën tjetër të ndjekësh ndjenjat tua! Shumë njerëz thonë: 'Zotëri, ma trego rrugën', por në të vërtetë, në zemër nuk kanë vendosur, me forcë që ta vënë Zotin në vendin e parë. Ata zgjedhin edhe më tutje, luajn me Të dhe kurrë nuk gjejnë paqe. Pas një kohe gjenden në pikën e vdekur, dhe në fund vuajnë shumë. Atëherë kthehen te Zoti dhe i bërtasin: 'Zotëri, pse lejove të më ndodh kjo?' Fatkeqsisht, këta njerëz i kanë krijuar vetë problemet! Por Zoti është i mëshirshëm. Nëse e ndiqni, ai i rregullon të gjitha për ju. Kur me forcë përcaktoheni se dëshironi të realizoni planin e Zotit për jetën tuaj, Zoti e sheh vullnetin tuaj të mirë dhe ua ofron të gjitha. Zoti është i gatshëm të japë gjithmonë! Dhe nëse bëni zgjedhje të gabuar, Ai është gjithmonë i gatshëm të ju merr në duart e veta dhe të ju ngushëllojë. Por, nëse për shkak të zgjedhjes suaj të gabuar duhet të ktheheni në pikën fillestare, do të shihni se sa kohë keni humbur! Nuk ka kohë për të humbur! E gjitha që duhet të bësh është të lusësh Zotin për të gjitha që të duhen dhe atëherë të hapësh që të mund të pranosh huret e tij. Shumë njerëz nuk e lusin Zotin për hire. Zoti mund të gjendet në zemrën e secilit. Të gjithë në njëfarë mënyre e dinë se Zoti ekziston, por disa e shmangin mendimin për të dhe refuzojnë të pranojnë se Ai ekziston.“

Yvonne: „A nuk është në rregull të ndjekësh ndjenjat tua? A nuk vijnë ato prej Zotit?“

Vicka: „Së pari duhet të mendosh në vullnetin e Zotit nëse dëshiron të ndjesh paqen e Zemrës dhe sigurinë e brendshme. Nuk mund të ndjehesh mirë nëse ke frikë në zemër. Nuk mund t'u besosh ndjenjave tua nëse nuk je në harmoni të brendshme. Dëshiro së pari të duash dhe të jesh e lumtur me veten. Kur diçka vjen prej Zotit, atëherë ndjen gëzim të madh, paqe të madhe dhe harmoni. Kur ndjen frikë, konfuzion dhe mundim, ato vijnë nga Armiku. Nëse ndërmarrja jote është vullneti i Zotit, do të kesh probleme, sigurisht, por ai do ta rrafshoi rrugën. Kur kryen vullnetin e Zotit ai të jep gjithçka të duhet. Problemet dhe pengesat zhduken.“

Yvonne: „Ty të duket e lehtë kjo!“

Vicka: „Mos ushqe pritje të mëdha. Bëni hapat një nga një. Asgjë nuk ndodh brenda natës! Zakonisht pjesa më e vështirë është fillimi. Duhet të fillosh ngadalë që të mund ta kuptosh dhe ta dëgjosh vullnetin e Zotit. Prej ditës në ditë mëso të dëgjosh vullnetin e Zotit. Do të vëresh se hiri i Zotit vepron në ty. Do ta pranosh hirin e Zotit vetëm kur të fillosh të kryejsh vullnetin e Tij. Nganjëherë Ai dëshiron të na provojë dhe të shohë se sa, në të vërtetë, duam ta kryejm vullnetin e tij. Zoti dëshiron që të zgjedhësh vetë. Nganjëherë do të luftosh me atë që të tërheq dhe me mundësi të tjera. Zoti i jep secilit prej nesh dhuratë të madhe – vullnetin e lirë. Ai dëshiron që të shërbehesh me lirinë tënde dhe të zgjedhësh. Zoti nuk dëshiron të na detyrojë asgjë. Nganjëherë

do të gabojmë në zgjedhje, por ai është i mëshirshëm – ai edhe e di këtë. Gjithmonë do të na ndihmojë nëse sinqerisht përpiqemi ta ndjekim.“

Yvonne: „Si do të ja bëjmë me ndjenjat që na ndjekin?“

Vicka: „Asgjë mos ki frikë – refuzoi ndjenjat dhe dorëzoja Zotit. Nuk do të jesh në gjendje të lutesh nëse i lejon ndjenjat të hyjnë në brenditë tua. Djalli gjithmonë dëshiron të fusë pshtjellim në zemrën tonë. Të jesh gjithmonë e vetëdijshme për praninë e djallit dhe ndikimie e tij, dhe kurrë mos i lejo të veprojë në zemrën tënde! Ai dëshiron të fusë frikë dhe brenga dhe të të shqetësoi në të gjitha mënyrat. Thjesht, të gjitha këto dorëzoja Zotit dhe prano paqen e tij. Shumica e njerëzve nuk e kanë idenë sa shumë dëshiron Zoti të na japë dhe sa na do! Nuk ka asnjë shkak për frikë!“

Çfarë bëra të ju ndihmoj?

Pas kurorëzimit të sajë, Vicka e mbajti premtimin se do të mbetet në „vendin“ e vet dhe do të ju flasë shtegtarëve. E rregulloi orarin ashtu që të ju flasë çdo të dytën ditë në „shtëpinë e kaltërt“, në shtëpinë e vjetër të prindërve. Prej andej ajo dërgon porositë që nga viti 1981., me entuziazmin dhe dashurinë e njëjtë si ditën e parë!

Në pauzën në mes të grupeve të shtegtarëve, të cilave u fliste, para „shtëpisë së kaltërt“, e pyeta për valën e gjykimeve kundër ipeshkëvijve amerikanë. Vicka deklaroi se „secili prej nesh e ka ndërgjegjen e vet, dhe më e rëndësishmja është të ndiqet ndërgjegja personale, të jesh besnik Zotit dhe njerëzve. Nëse dëgjoj se ipeshkvi është i akuzuar për këtë apo atë, kush jam unë ta gjykoj ndërgjegjen e tij? Jo, unë nuk do ta gjykoj, por do të kontrolloj ndërgjegjen time dhe do të pyetem: 'Me vite Zoja na thërret të lutemi për meshtarët, ipeshkvijtë dhe atin e Shenjtë. Çfarë kam bërë të ju ndihmoj? A jam lutur me gjithë zemër për ta?' Kjo është pyetja e vërtetë! Zoti i sheh të tjerat. Sa më takon mua, unë duhet të ndihmoj, sa më mirë që mundem, dhe mos të humb kohë me komente për meshtarët. Janë thënë shumë fjalë por pak lutje!“

Atëherë e pyeta unë: „Po ti, Vicka, si lutesh me zemër? Çfarë mund të ju thuash atyre që thonë: 'Unë nuk mund të lutem me zemër, nuk mund ta hap zemrën?'“

Vicka: „Secili prej nesh duhet të provojë! Përvoja ime është përvoja ime. Unë lutem në mënyrën time, ashtu si më ka mësuar Zotëria. Lutja është për mua gëzim sepse ajo është përgjegja ime Zotit. Kam vendosur t'i përgjigjem Zotit! Ata që thonë se nuk mundem - ajo është për shak të frikës që të ndërrohen nga brenda. Por, në të vërtetë, Zotëria i pret. Ai pret atë çast kur ata, thjesht, do të thonë: 'Zotëri, bën me mua çfarë të duash!' Por para së gjithash duhet të besoj se Zoti më do. Unë e di se Zoti më do dhe kështu i dorëzohem krejtësisht. Dhe atëherë, kur ia hap zemrën, ai më lëviz përpara. Secila lutje lutet ndryshe. Unë lutem në një mënyrë, ti në një tjetër. Kjo vlen për secilin prej nesh. Ajo që është me rëndësi është të lutemi me zemër, që të dëshirojmë të lutemi me zemër. Sa herë që dëshirojmë, Zoti është gjithmonë aty, i gatshëm të na japë!“

„Të dashur fëmijë! Agjërimi më i mirë është me bukë dhe ujë. Me agjërim dhe me lutje mund të ndalen edhe luftërat dhe të evitohen ligjet natyrore. Lëmosha nuk mund ta zëvendësoi agjërimin. Ata që nuk mund të agjërojnë, ndonjëherë mund ta zëvendësojnë me lutje, lëmoshë dhe rrëfim. Të gjithë, pos të sëmurëve janë të thirrur të agjërojnë.“ (21. korrik 1981.)

28

E TMERRONTE MENDIMI PËR AGJËRIM

Në Bashkësinë time të Lumturive, vëllau Jean-Michel kishte probleme me agjërim. Problemi mund të cilsohej si organik, që të gjithë mund ta dëshmojmë. Çështjen nuk e lehtësonte fakti se ai jetonte në Megjurgje ku flitet vazhdimisht për agjërimin. Zoja në porositë e saja shpesh na përkujton në agjërim. Jean-Michel do të na flasë vetë për këtë:

„Dy ditë të vitit të cilave iu frigohesha më së shumti ishin e Mërkura e perhime dhe e Premtja e madhe sepse ato janë ditët në të cilat Kisha kërkon agjërim, kurse unë me këtë kisha probleme të mëdha. Përkundër kësaj, u paraqita në ushtrimet shpirtërore pesëditore të lutjes dhe agjërimit, sepse e dija se për shkak të disa arsyeve më duhen. Intimisht shpresoja se do të më thonë: 'Na vjen keq, por nuk ka më vend!' Por nuk ndodhi ashtu.“

„Si afrohej fillimi i ushtrimeve ashtu rritej ankthi im, dhe kur erdhi dita 'D', isha në gjendjen e panikës së skajshme. Sikur dikush të më thonte të mos shkoj, me gëzim dhe me dëgjesë do të bindesha. Por askush nuk më tha. Isha në aso gjendje sa e dëgjova këshillën e një shtegtari dhe shkova të lutem në varrin e fra Slavko-s. E luta që të më vijë në ndihmë. I thash: 'Ti je i vetmi përgjegjës për këto ushtrime shpirtërore, ti i ke formësuar, bëj diçka!' “

„Ditën e parë të ushtrimeve shpirtërore vendosa të bindem dhe ta kap hirin e çastit. Doja të bëj çdo gjë që kërkohej pa u tërhequr. Sikur ta dija se do të agjërojmë pesë ditë, do të kisha plasur aty për aty. Por ai mendim nuk më erdhi në kokë për asnjë çast. Ishte hir mbi hire! Atëherë u ngjita në Kodrën e dëftimit, Podbrdo, dhe atje i shkrova një letër Zojës. Ia shpjegova të gjitha brengat dhe problemet. Ia lash aty të gjitha, kështu që nuk kaisha nevojë të mendoj për to gjatë ushtrimeve shpirtërore. I thash se ia paraqes një javë lutje dhe agjërim për qëllimet e saja – këmbim i duhur! Isha i hutuar kur pashë se si çdo gjë po shkonte mirë, pa asnjë vështirësi, dhe për asnjë çast nuk mendova në problemet materiale - në gjatësinë e ushtrimeve shpirtërore ose sa vështirë është të agjërosh. Kur përfunduan ushtrimet shpirtërore, isha i lumtur sepse në kohën e meditimit munda të thellohem më mirë në misteret e rruzares. Poashtu, munda ta përjetoj më intenzivisht meshën shenjte, sikur të hyja në dhomat e ndryshme të një kështjelle të bukur, si thoshte predikuesi.“

„Poashtu jam mirënjohës për shërimin trupor që ndodhi krejt papritmas. Vuaja nga hidrokela, gjendje e trashëguar që shkakton grumbullimin e gjakut me qelb në zonën gjenitale, që më detyronte të urinoj shpesh. Më parë duhej të kem kujdes për sasinë e lëngjeve që marr kur shkoja në udhëtim të gjatë, si edhe para se të dilja nga shtëpia. Ky hendikep, vërtetë ishte i pakëndshëm. Që nga fillimi i ushtrimeve shpirtërore na kërkonin të mbërtyhim bukën derisa bëhej si lëng dhe në çdo vakt të pijmë dy-tre filxhana çaj bimësh. Isha shumë i kujdesshëm në përmbajtjen e të gjitha udhëzimeve për të menjanuar kokëdhëmbjen, të pshtjellët ose problemet tjera, deri në atë masë sa që nuk mendoja për pasojat që për mua mund të ketë konsumimi e asajë sasive të madhe lëngjesh. Ditën e parë i piva gjshtë filxhana të mëdhenj çaj bimësh dhe nuk ndodhi asgjë e keqe. Këtë as që e vëreja atëherë. Ditën tjetër e kuptova se kisha shkuar në banjë vetëm dy herë. I befasuar, i përsërita të gjitha dhe përsëri çdo gjë ishte normale. Erdha në përfundim se nuk kam më probleme me hidrokelen. Kur përfunduan ushtrimet shpirtërore, u nguta të pij një gotë verë dhe një filxhan kafe. Efeki anësor, përndryshe drastik, nuk ndodhi. Çdo gjë ishte normale. Prej asaj ditë nuk kisha më probleme. Falenderoj Zojën për këtë shërim të papritur.“

„Atëherë i thashë vetes: 'Sikur ta kisha ditur këtë, qysh moti do të kisha shkuar në këto ushtrime shpirtërore!'“⁶⁵

Zoti nuk na detyron

Një ditë e pyeta Vickën se çka të ju them njerëzve që hamenden për të agjëruar, atyre që këtë e kanë të vështirë. Ajo më tha „Çdo gjë që bëjmë pa zemër është vështirë! Madje është më mirë të mos e bëjmë. Nëse them: 'Mirë, sot e kam vërtetë vështirë, kokën e kam konfuze, jam e uritur,' atëherë është më mirë të mos agjërosh, sepse. Duhet ta ndjesh vetë në zemër kur dhe si të përgjigjesh në kërkesën e Zojës. Atëherë përgjigju me gjithë zemër!“

„Zoja dëshiron që t'i përgjigjemi nga zemra, por nëse nuk ke aso zemre, është më mirë që mos ta bësh. Zoti nuk na detyron. Nëse them: 'Kam kokëdhëmbje, më sillet në kokë,' janë arsytetime, kupton, arsytetime në të cilat nuk do të duhej të përgjigjem. Zoja dëshiron që agjërimi të na e pastron zemrën. Kjo është më e rëndësishmja tek agjërimi! Ajo kërkon të agjërosh me bukë e ujë të mërkurën dhe të premten. E vetmja mënyrë që të agjërosh mirë është të vendosësh të agjërosh. Nëse është vullneti i fortë çdo gjë është e mundur! Njësoj është me evitimin e mëkatit. Agjërimi do të më pastroi nga mëkatet e mia dhe nga të gjitha që më mendojnë. Prandaj Marisë i pëlqen agjërimi aq shumë. Nëse unë sot agjëroj me bukë e ujë dhe menjëherë pastaj kam shumë mendime të këqia, e lëndoj dikë ose sillem keq, do të ishte më mirë të mos agjëroj. Së pari duhet ta çrrënjos të keqen para se ta bëj hapin e ri.“

⁶⁵ Lexoni librin, Č. S. Emmanuel Maillard: “Ozdravljenje kroz post” botuar nga Teovizija, Zagreb

Dy margaritar të vlefshëm

Këto janë këshillat që i ka dhënë Jezusi motrës Faustinë kur i ka treguar se si dëshiron të jetojnë motrat e kongregatës së sajë: „Caku yt dhe i shoqeve tua le të jetë bashkimi me Mua në dashuri aq sa është vërtetë e mundur... Po ti besoj dy margaritarë, që i kam për zemër: shpirtrat e meshtarëve dhe të rregulltarëve. Për ta do të lutesh veçanërisht. Forca e tyre do të jetë në sakrificat tuaja. Lutjet, agjërimet, sakrificat, puna dhe të gjitha vuajtjet do t'i bashkosh me lutjen Time, agjërimin, sakrificën punën dhe vuajtjen. Atëherë ata do të kenë forcë para Atit Tim.“⁶⁶

⁶⁶ Ditari i motrës Faustinë §531

RECETAT PËR AGJËRIM

Nga ana prktike, kualiteti i bukës që përdoret për të agjëruar dallon shumë. Më së miri është të zgjidhet buka e fortë dhe e ushqyeshme. Nëse nuk mund ta gjeni të tillë në shitore, mund ta përgatisni edhe vetë. Kur të agjërohet është me rëndësi të pihet shumë ujë, për t'u evituar kokëdhëmbja. Zoja nuk e ka specifikuar se a duhet të jetë uji i i nxehtë apo i ftohtë. Nuk ka folur për ato detaje. Prandaj, lidhur me këtë, secili mund të vendos vetë lirisht, me zemër dhe sipas gjëndjes së shëndetit personal. Poashtu, është shumë me rëndësi, që në ditët e agjërimit të lutet më shumë, që të jemi të qendrueshëm në përpjekjet tona.

Recetë për bukën e agjërimit

Në një kilogram miell të shtohen me rrallë:

¾ l ujë të vakët (rreth 37° C)

1 lugë kafeje sheqer

1 pako tharm bukë

Të përziejhet mirë, pastaj shtohet:

2 lugë supe vaj, 1 lugë supe kripë, 1 lugë fqolla tërshëre

Përgatitja:

Të përziejhen të gjitha. Mund të shtohet pak miell nëse brumi është shumë i butë. Brumi lehet së paku dy orë (ose tërë natën) në vend të ngrohtë, në temperaturë konstante (jo më të vogël se 25° C); mund të mbulohet me një leckë të lagët. Brumi (me trashësi 4 cm) të qitet në kallëpe të lyera mirë me vaj. Të lehet edhe nja 30 min të qendrojë. Të futet në furrë me temperaturë 160° C dhe të piqet rreth 50 deri 60 minuta. Kualiteti i bukës varet, në masë të madhe, nga kualiteti i miellit të përdorur. Mund të përziejhet mielli inebral dhe i bardhë.

Recetë për bukët e vogla të thekrës

1 kg miell të bardhë

1 kg miell thekre integrale

1 lugë supe vaj bimësh

pak më shumë se 1 l ujë

me maje të thikës pak miell galete dhe pak kripë

1 lugë çaji sheqer

1 pako tharm

Përgatitja:

Të përzihet tharmi, një lugë supe miell dhe një lugë çaji sheqer. Të shtohen, pastaj, dy filxhana ujë të ngrohtë, që tharmi të fryhet. Të përzihen përbërësit tjerë, të shtohet tharmi dhe teprica e ujit. Të gatuhet brumi kompakt dhe i lëmuet, pastaj të ndahet në 20 deri 25 pjesë. Të formësohen në toptha. Të mbulohen me leckë të lagur dhe të futen në frigorifer (mund të qëndrojnë dy-tri ditë). Para pjekjes të shtrihen në bukë të vogla si pizza. Të piqen në furrë në temperaturë maksimale. Bukët të shërbehen të nxehta, sepse kur të ftohen e humbin shijen dhe teksturën.

Recetë për bukë angleze

250 g miell i bardhë gruri

250 g miell integral

1 lugë çaji kripë

30 g tharm të freskët

60 g gjalpë

1 filxhan ujë

1 lugë çaji lëng limoni

Përgatitja:

Të përzihet mielli, kripa, uji dhe lëngu i limonit. Të shtohet gjalpa, pastaj tharmi. Të lehet për t'u fryrë 60 deri 90 minuta. Të gatuhet brumi dhe të paloset 4 ose 5 herë, të shtypet me duar dhe të ngritet nga poshtë që të futet ajri në të. Të formësohet brumi si top, të rrafshohet lehtë nga lart. Të lehet për t'u fryrë 30 deri 45 minuta varësisht nga temperatura e kthinës.

Të nxehet furra në 170 °C. Të lyhet sipërfaqja me qumësht ose me një vezë të tundur (me furçë), të hidhet miell, sipërfaqja të pritët ashtu që prerjet më shumë të zgjërohen kah sakjet. Brumi të vendoset në letër të yndyrshme dhe të piqet 20 deri 30 minuta, varësisht nga furra.

„Të dashur fëmijë! Ju thërras në zgjedhje. Zoti ju ka dhënë vullnetin e lirë që të zgjedhni jetën ose vdekjen. Dëgjoni me zemër porosinë e mia që të mësoni se çfarë duhet të bëni dhe si do ta gjeni rrugën drejt jetës. Fëmijët e mi, pa Zotin nuk mund të bëni asgjë, këtë mos e harroni për asnjë çast.“ (18. mars 2003.)

30

SA KUSHTON SARI YT?

Nëna Terezë ka mujtë me pak fjalë të thjeshta të ndryshojë njerëzit plotësisht. Çdo ditë, nga disa orë të kaluara para Sakramentit Tejetshenjt të Altarit e kanë mbushur shpirtin e sajë me Fjalën e Zotit (përkundër faktit të periudhës së gjatë të thatësisë shpirtërore). Ajo Fjalë, gjatë tërë ditës derdhej mbi njerëzit që e rrethonin.

Një ditë prej ditësh, një indiane shumë e pasur erdhi të vizitojë Nënë. Ishte zbukuruar me stoli të çmueshme dhe e veshur me një sari të mrekullueshëm. Gruan e pushtoi drita që rrezatonte prej Nënës. E dëshiroi atë dritë! Singerisht dëshiroi t'i afrohet Zotit. Pa ditur si ta shpreh etjen e sajë, i ofrojë të holla Nënës Terezë. Nëna iu përgjegj se paraja nuk është më e rëndësishmja që mund të japë, por zemra. Zemra është ajo që duhet ndërruar!

Nëna e pyeti: „Sa vlen Sari që keni veshur?“ Gruaja mendoi dhe i tregoi se sa kushtonte. Tepër shumë! „Atëherë,“ vazhdoi Nëna, „Herën tjetër kur të vini në vizitë, provoni të veshni një sari jo kaq të shtrenjtë.“

„Kjo është e gjitha?“ – pyeti gruaja e befasuar. Duke lexuar jetëshkrimin e shenjtërve, priste se ajo do t'i kërkojë që të bëjë kthesë rrënjësore në jetën e sajë. Ndryshimi në standardin e sarit, asaj gruajë iu duk imtësi, edhe pse krenaria iu lëndua. Megjithatë, iu përmbajt asajë këshille dhe, kur erdhi herën tjetër, ishte veshur më thjeshtë.

Me atë akt të parëndësishëm, e hapi zemrën e Zotit. Hiri i Tij hyri dhe pak nga pak e bënte për vete duke ndryshuar lëmitë tjera të jetës së sajë. Kur shkoi te Nëna Terezë e veshur me sari më pak të stolitur, Nëna, në befasinë e sajë, i tha përsëri të njëjtën gjë: „Kur të vini herën tjetër, veshni një sari më të thjeshtë.“ I njëjti veprim ndodhi edhe disa herë, derisa Nëna Terezë nuk insistoi të veshë sarin më të lirë se të sajë!

Shenjtërit e mëdhenj mësojnë gjëra të vogla! Shenjtëria ecë me hapa të vegjël. Në të vërtetë, duke mësuar ato leksione që përsëriten, gruaja përjetonte kthim të madh tek Nëna Terzë dhe më vonë u bë instrument i mrekullueshëm i Zotit në Kalkutë.

Nëna Terezë kishte sy depërtues për të kuptuar se çfarë ka në zemrat e njerëzve. Gruaja nuk do të kishte mundur të durojë sikur kjo të kishte provuar t'i impononte ndryshimin rrënjësor. Do hiqte dorë pas vështirësisë së parë dhe do të humbte betejën, e dekurajuar. Por, urtia e kësaj mënyre të

thjeshtë, ajo përpjekja e vogël shesë, i mundësoi të bëjë përparim në jetë, sipas kapacitetit të dashurisë së sajë në atë çast. Shpirti i sajë ishte si lulja që dëshiron diellin dhe që hapet me shpejtësinë natyrore të lulëzimit të sajë. Lulja që detyrohet të lulëzoj shpejt, nuk zgjat shumë.

Zoja na thërret në kthimin e zemrës me hapa të thjeshtë:

Cilën shprehi timen ta ndryshoj? Pai, duke filluar sot, do të bëj diçka që kurrë më parë nuk e kam bërë!

- Të themi, atë kryq të mbuluar me pluhur e të lënë pas dore, a s'do të mund ta merrja sot, ta pastroj, ta puth e ta var duke vënë pranë tij pak lule? Çdo mëngjes t'i drejtoj disa fjalë por, ashtu, me dashuri.

- Banknotën prej 10 € ta vendos në kutinë postare për nënën që është në vështirësi. Ajo nuk do të dijë se dhurata i vjen prej meje! Çdo ditë do t'i jap diçka dikujt.

- Shiu bie rrëke, kurse unë duhet të dal me punë. Në vend se të nynykas, do të them: „Të falemnderit Zot për bekimin e shiut!“ Dhe, që tani e tutje, do ta bekoj Zotin për pengesën e parë e cila më paraqitet në mëngjes.

- A do të mund t'i telefonoja dajës së moshuar, të cilit i ka vdekur gruaja, dhe t'i shprehja pak ngrohtësi? Tani e tutje, do të sillem me të si me mikun dhe nuk do ta injoroj.

- Shpenzoj shumë kohë me televizorin ose duke lexuar revista të padobishme. Në vend të kësaj do të lutem për ata që po japin shpirt dhe që kanë frikë, që të jenë në gjendje t'i lëshohen mëshirës së Zotit, dhe do t'ua dërgoj engjëllin tim rojtar.

- Rrugës për në punë, do t'i bekoj njerëzit që vozisin pranë meje (ose janë ulur pranë meje, në tren, autobus ose makinë) dhe do t'ia besoj jetërat e tyre Nënës së Zotit.

- Kur t'i ftoj në drekë fëmijët ose nipat, do t'ju flas për Jezusin nga ungjilli, dhe do t'ju ndihmoj të gjejnë mënyra konkrete për ta ndjekur Jezusin gjatë asajë dite.

- Çdo mbrëmje do të lexoj nga një psalm para gjumit dhe do ta mësoj përmendësh rreshtin i cili më ka prekur më së shumti.

Ka diçka që më fascinon shumë dhe që është lidhur me kompjuterët. Kur shkruani tekst, mjafton ndërrimi i vetëm një fjale që të gjitha të tjerat të lëvizin në vendin e ri. Harmonia e tekstit ruhet vetëm nëse ajo fjalë mbetet aty përgjithmonë. Por asnjëra fjalë nuk është më në të njëjtin vend. Pikërisht kjo ndodh në jetën shpirtërore. Nëse vendos t'i ndërroj shprehitë vetëm në një lëmi, të gjitha të tjerat do të ndryshojnë në zemrën time. Pak diell që do të futet brenda, do të prek çdo aspekt të jetës dhe flaka e dashurisë do të zgjërohet prej njërit te tjetri. Drita do të fitojë në të gjitha aspektet!

„Të dashur fëmijë! Ju lutem që prej sot të pranoni rrugën e shenjtërisë. Ju dua, prandaj dëshiroj të jeni të shenjtë. Nuk dëshiroj që djalli të ju pengojë në këtë rrugë. Të dashur fëmijë, lutuni dhe pranoni të gjitha që Zoti ju ofron në rrugën që është e hidhur. Por gjithashtu, ai që nisat asaj rrugë, Zoti i zbulon çdo ëmbëlsi dhe ai do t'i përgjigjet secilës thirrje të Zotit. Mos ua vëni veshin gjërave të vogla. Kërkoni Qiellin. Ju falemnderit që ju përgjigjet thirrjes sime!“ (25. korrik 1987.)

31

SONTE DO TË VDESËSH

Atë Jacques u zgjua në një mëngjes me bindjen se do të vdesë atë mbrëmje. Ndjenja ishte aq e fuqishme sa që kur u zgjua, i tronditur filloj të rregullojë punët e veta. Filloi me lutje, bëri një rrënim serioz të ndërgjegjes dhe me atë rast mendoi: „Ky është rrëmimi i fundit i ndërgjegjes sime. Është mirë ta bëj si duhet!“ Duke u penduar thellë për secilin mëkat, i kishte të gjitha që i duheshin për rrëfim të mirë. Shpirtin e vet ia besoi mëshirës së pafund të Zotit, duke ju dorëzuar plotësisht.

Atëherë i tha vetit: „Ajo që është me rëndësi në çastin e vdekjes është dashuria dhe mëshira që kemi në zemër.“ Kështu u takua me secilin anëtar të Bashkësisë. Kërkoi falje për çdo të keqe që ka bërë, për çdo fyerje ose mëkat eventual. E bëri këtë me sinjeritet dhe gëzim, në paqe dhe dashuri. Atë ditë, me dashuri të madhe i pranoi të gjitha punët e tij në Bashkësi, duke harruar veten dhe duke u kujdesur vetëm për lavdinë e Zotit dhe shërbimin vëllëzërve dhe motrave të veta. Mendonte: „Meqë është dita ime e fundit, do të ishte mirë të ju mbetem në kujtesë të mirë.“

Si zakonisht, shkoi në kapelë për orën e tij të adhurimit. Gjatë gjithë orës u përpoq si kurrë më parë që shpirtin e vet ta bashkoi me Jezusin. Pastaj tërë zemrën e vet e vuri në kremtimin e meshës, të cilën e tha më ngadalë se zakonisht, duke theksuar çdo frazë dhe çdo lutje sikur shikonte Jezusin para vehtes. Iste marrosur nga dashuria për Jezusin. E dinte se kjo është mesha e tij e fundit. Me gjith zemër e falënderoi Jezusin për dhuratën e madhe të rregulltarisë dhe e çmoi më shumë thellësinë e asaj dhurate.

Mbrëmja afrohej dhe ai dëshironte që çdo minutë që i kishte mbetur ta kalonte duke ecur dorë për dorë me Jezusin dhe Marinë, së cilës ja kishte kushtuar meshtarinë e tij. Disa herë iu desht të luftonte me sulmet e frikës se se nuk ishte i denjë – se i kishte lëshuar gjithë ato hire ose se nuk kishte kryer këtë apo atë detyrë. Por, sa më shumë që mjerimi i tij vinte ta ngulfasë, aq më shumë e hidhte në humnerën e Mëshirës së paskajshme Hyjnore. Kjo është ajo furrë zjarri për të cilën

shën Tereza ka thënë: „Sikur t'i kisha bërë të gjitha mëkatet e mundëshme, edhe atëherë do të besoja sepse e di se të gjitha mëkatet janë vetëm një pikë uji në këtë furrë të zjarrtë.“⁶⁷

Ra nata. Shkoi në shtrat në kohën zakonshme dhe fjeti. Në mëngjes ishte i befasuar se ende ishte në tokë. A thua Zotëria ka harruar të vijë ta marrë? Jo, kjo nuk është e mundur – Zotëria kurrë nuk harron, askend dhe asgjë. Atëherë Jacques kuptoi se Zotëria sigurisht kishte pasë tjetër plan me të. Duke lejuar të mendoj se po i afrohet vdekja, vetëm ka dashur që ta mësoi diçka:

Shiko se me sa pasion u lute dje!

Shiko se si e mbushe çdo minutë të ditës me gjithë dashurinë që zemra jote mund të jepte!

Shiko si më pe në çdo vëlla ose motër dhe si më shërbeve me gjithë zemër!

Shiko se sa thellë e jetove meshën shenjte dhe Flinë!

Shiko se si u pendua zemra jote kur Mi paraqite të gjitha mëkatet dhe me sa besim ju dorëzove plotësisht Mëshirës sime!

Shiko me sa zemërgjërësi e shpërndave pasurinë tënde, duke u kujdesur që më të nevojshmit të marrin më të mirën!

Shiko se me sa mirënjohje në zemër i shqyrtove dhuratat dhe huret që i ke marrë nga Unë gjatë jetës sate, sidomos hirin që më ke njohur në mënyrë intime dhe je bërë meshtari Im!

Shiko se me sa seriozitet u përpoqe ti kryesh punët e kohës, sidomos ato që aq gjatë i kishe lënë pas dore, të cilat do të mund të bëheshin pengesa për ata që i ke afër!

Shiko, më në fund, se sa shpejt, në sytë e tu, u fundos vlera e gjërave materiale dhe brengave njerëzore, kur ballafaqohesh me çastin tënd të fundit dhe si e pe veten të varfër dhe të xhveshur, pa strehë tjetër pos Meje, Krijuesin dhe Zotin tënd!

Zoti kërkoi nga Jacques që çdo ditë të jetoj ashtu; e tillë ishte rruga e tij drejt shenjtërisë.

Për shpirtin tonë është shumë mirë që së paku një ditë në vit ta kemi një „provë të përgjithshme“ të vdekjes personale. Këtë ide ma dhe atë Jacques nga Bashkësia jonë....

⁶⁷ Biseda e fundit me nënën Agnès, më 6. Qersor të vitit 1897.

Në rrugë drejt fenerit të detit

I lumturi Charles de Foucauld⁶⁸ përpiqej të jetonte sikur atë mbrëmje do ta merrte Zotëria tek Vehtja. Si marinari i cili e drejton anijen e vet drejt fenerit të detit i cili do të ja tregojë rrugën drejt limanit, duke luftuar përballë erërave dhe gjithë asaj që do të mund të ja ndërronte drejtimin. Ky lloj shpirti gjithmonë përpiqet që kicin e anijes ta ketë të drejtuar kah drita e Krishtit, pa shmangje. Kujdeset që ta përcaktoi kursin e duhur për pjesën e fundit të udhëtimit që do ta sjell në limanin e shtëpisë së vërtetë: në Qiell.

Kjo mënyrë sjelljeje i ka ndërtuar shenjtërit, dhe mundet që edhe ne të na bëjë shenjtër. Ekziston një test shumë i lehtë, i cili mund të na tregojë se a posedon shpirti ynë këtë qëndrim. Le të mendojmë në lidhje me vendimet tona të fundit. Për shembull: unë jam e re. E tërë jeta është para meje dhe unë duhet të vendos se cilën rrugë duhet ta zgjedh. Ta zëmë se vendos të bëhem mjeke. Mirëpo në mbrëmjen e ditës së parë në shkollën e mjeksisë Zotëria më thërret në shtëpi. Të njëjtin çast do të gjëndem nën rrezet-x të Shpirtit Shenjt dhe e tërë jeta ime do të më kaloi para syshë si film i paraqitur me anë të projektorit të së vërtetës së Zotit. A do të jem krenare apo e turpëruar për këtë?

Natyrisht që Zotëria nuk pret që në dhomën tonë të vendosim arkën, ashtu si kanë bërë disa etër të shkretëtirës, që të fokusohemi në cakun tonë të fundit dhe në shtëpinë e vërtetë. Sot, në kohën e psikologjisë sonë të brishtë kjo, ka të ngjarë, do të shkaktonte trauma të thella psikologjike, dhe psikiatrat do të bëheshin më të pasur. Jo, Zotëria tani ka rrugë më të mirë për ne: Ai na ka dhënë Nënë e vet e cila na përkujton në Megjugorje: „*Të dashur fëmijë, mos e harroni shtëpinë tuaj të vërtetë, në Qiell!*“

Ose: „*Fëmijëz! Mos harroni se jeta juaj është kalimtare si lulja pranverore e cila është e mrekullueshme sot, por nesër nuk dihet më për të.*“⁶⁹

„*Të dashur fëmijë, Mos ua vëni veshin gjërave të vogla. Kërkoni Qiellin.*“⁷⁰

Grupet e lutjes, në Megjugorje ose kudo tjetër, janë përgjegje e Zotërisë për kohën tonë. Në ato enë të mrekullueshme, Shpirti Shenjt na përkujton vazhdimisht, disave nëpërmes të disa të tjerëve, për bukurinë e mrekullueshme të dhuratës së jetës dhe për shkëlqimin e fatit tonë në amshim.

⁶⁸ Beatifikimin e ka bërë papa Benedikti XVI. në bazilikën e shën. Pjetrit, më 13. Nëntor të vitit 2005. Jeta e tij ka frymëzuar themelimin e dy rendeve: Vëllëzërit e vegjël të Jezusit dhe Motrat e vogla të Jezusit.

⁶⁹ Porosia më 25. mars 1988..

⁷⁰ Porosia më 25. korrik 1987..

Sikur t'i kisha në ndërgjegjen time mëkatet e mbarë botës

Në ditarin e sajë, motra Faustina dëshmon për përvojën e vet, jo shumë të ndryshme nga ajo e atë Jacques, përvojë e cila shumë lehtë mund të jetë e jona:

„Gjatë meditimit mbi vdekjen, e luta Zotërinë që zemrën time ta përshkoi me ato ndjenja të cilat do t'i kem në çastin e vdekjes. Në brendinë time dëgjova mëshirën e Zotit që më thotë se kam bërë atë që ishte në mundësitë e mia prandaj le të jem e ngushëlluar. Në shpirtin tim u zgjua një falenderim aq i madh për Zotin sa fillova të qaj prej gëzimit si fëmi i vogël...

Të nesërmen në mëngjes përgaditesha për kungimin Shenjt, dhe lutja për veten lutjet e atyre që janë në prag të vdekjes. Atëherë i dëgjova fjalët vijuese: *„Ashtu si je e bashkuar me mua në jetë, do të jesh edhe në çastin e vdekjes.“* Pas këtyre fjalëve u zgjua në shpirtin tim një besim aq i madh në mirësinë e Zotit, sa që nuk do të dyshoja në mirësinë e Zotit edhe sikur t'i kisha në ndërgjegjen time mëkatet e mbarë botës dhe të gjithë shpirtrave të mallkuar. Pa menduar do të hudhesha në humnerën e mëshirës së Zotit, e cila është e hapur gjithmonë për ne. Me zemër të thërmuar do t'i bija te këmbët dhe do t'i dorëzohesha vullnetit të tij shenjt që është vetëm mëshirë e pastër.

Jezusi im, Jeta e shpirtit tim, Shpërblyesi im, i Fejuari im i ëmbël dhe njëkohsisht gjyqtari im. Ti e di se në orët e mia të fundit nuk mund të mbështetem në meritat e mia, por vetëm në mëshirën Tënde.⁷¹

⁷¹ *Ditari i motrës Faustine §§1551-53.*

„Të dashur fëmijë! Edhe një herë ju lus me zemër, që të luteni sepse me lutjet tuaja do të ju ndihmoni jobesimtarëve të cilët nuk e kanë hirin që ta përjetojnë Zotin në zemër me fe të gjallë.“

(18. mars 1989.)

32

ÇFARË TË BËJ TANI?

Para se ta shkruaja *Mrekullinë e Megjugorjes* „u mora vesh“ me Zojën.

I thashë: „Si duket ti e dëshiron këtë libër. Në rregull, do ta shkruaj. Por ti e di mirë se sa vështirë është të jesh i mbyllur me shkrimet tua, pa pasë mundësi të takohesh me shtegtarët që trokasin në derë. Prandaj, si kompensim kërkoj dy gjëra. E para, që të kujdesesh për temat dhe tregimet mbi të cilat do të shkruaj në kapitujt e ndryshëm (sepse është e vetmja mënyrë të depërtohet në zemër) E dyta, ta shfrytëzosh këtë libër për jobesimtarët. Të lutem, venjau në dorë. Më Siguro se, duke e lexuar, do ta humbin paqën e rrejshme që ua ofron bota, se do të fillojnë ta kërkojnë të vërtetën dhe se nuk do ta gjejnë paqen në shpirt deri sa ta gjejnë Zotin. Dhe, të lutem, më jep një shenjë – më trego disa jobesimtarë të cilët e kanë gjetur Zotin duke lexuar këtë libër.“

Isha e sigurt se do ta preki zemrën e sajë amënore pasi që gjithmonë nëpërmes të Mirjanës kërkon që në lutjet tona ti vëmë në vendin e parë jobesimtarët. Dhe ja, posa u botua libri e turbulloi ujin! Ja njëri nga tregimet e para që arriti tek unë, dhe sigurisht nuk është i fundit.

Një grua pesëdhjetëvjeçare më ndaloi kur dilja nga mesha në Megjugorje. „Motër, më duhet të bisedoj me Ju. Ju jeni e vetmja që mund të më ndihmoi!“ (Kjo qasje, aq e zakonshme, zakonisht më nevrikos, meqë unë, definitivisht, nuk jam mbretëresha e gjykimit)

„Në të vërtetë, motër,“ vazhdoi ajo, „këtu jam për shkak të librit Tuaj! Vajza ime ma dhuroi për Krishtlindje, Por posa e pashë se ka të bëjë me fenë, e vendosa në sirtar pa e hapur fare. Nuk dija asgjë për Zotin, por të jem e singertë, Ai ishte i fundit në mendjen time. Vajza ime është besimtare e madhe. Kjo nuk ishte hera e parë që provonte të ma imponoi fenë e sajë... Nuk e di pse por, një ditë e gjeta librin dhe fillova ta lexoj. Nuk mund të ndalesha! Gjithë ato tregime – për hir të Zotit, motër, nuk mund të besoja! E lexova librin prej kopertinës në kopertinë brenda një nate. E përbiva të gjithën njëherësh. Por pastaj, nuk ndjehesha mirë në brendinë time, e humba qetësinë. Nuk kisha më asnjë çast paqe. Mendoja për të vazhdimisht dhe kurrsesi nuk mund të qetësohesha.“

„Imagjinoni – madje as nuk besoja në Zotin, edhe më pak në Virgjërën Mari, kurse lexova librin i cili më fliste jo vetëm se Ai ekziston por, vërtetë, edhe vepron. Motër, kjo ishte sikur të kishte eksploduar bomba. As nuk mund të flija. U turbullua çdo gjë në mua dhe mendova,: 'ose kjo

motër flet të vërtetën dhe unë kam qenë tërë jetën në rrugë të gabuar, ose ajo është e marrë, kurse unë jam në rrugë të drejtë.' “

„Por ky lloj mendimi nuk më çonte askund. Sa do që përpiqesha të bindem se jeni e marrë, diçka më fliste se ato tregime janë të vërteta dhe se ky libër më flet të vërtetën. Nga ne të dyja, ajo që ishte e marrë isha unë! Pyetësja rishtas dhe rishtas se a duhet të filloj jetën time krejtësisht nga fillimi. Motër, nuk e keni idenë sa kam vuajtur, kisha qenë aq e sëmurë përbrenda, e zënë në kurthë. U bëra agresive, nuk mund të haja as të flija më. Pas disa ditë shqetësimesh dhe mundimesh të tilla isha aq e lodhur sa mu desht të qendroj në shtrat.“

„Mendimet më shkatrronin, kërkoja përgjigje të qartë, dhe nuk merrja guximin ta thërrisja vajzën që të mos dukem marroqe! U kujtova të bëj një provë dhe të shoh se cila nga ne është e marrë. I thash vetes: 'Motra gjithmonë flet për lutjen. Thotë se ajo vërtetë ndihmon, se jell paqe dhe bën mrekulli. Mirë pra, të shohim se a do të veproi tek unë! Do të bëj pikërisht ashtu si thotë në libër, do të ndjek udhëzimet e sajë dhe do të lutem disa ditë. Do të shoh se a flet të vërtetën.' “

„Problemi ishte, motër, se unë nuk dija si të lutem. Kurrë në jetë nuk jam lutur. Çfarë mund të bëja? Isha tepër e sëmurë që të mundohem edhe me këtë pyetje shtesë, prandaj sillësia thjeshtë sikur Zoti, vërtetë, të ekzistonte. Ju drejtova dhe ja dorëzova krejt barrën time. O, se çfarë ka dëgjuar Ai atë ditë! Nuk fsheha asgjë! Dhe në fund i thashë: 'Ja, nëse vërtetë ekziston, të shohim se a do të bësh diçka në lidhje me këtë!' “

„Nuk do të besosh, motër, por Ai u përgjigj! Në çfarë mënyre se! Zemra mu mbush me paqe, me paqen të cilën nuk mund ta imagjinoja, çfarë nuk e kisha ndjerë më parë, ishte kjo diçka krejt e re. Ndjeva se krejt qenia ime po ripërtëritet. Motër, nuk mund të gjej fjalë. A mund ta merrni me mend gëzimin dhe bafasinë që ndjeja? Vazhdova t'i drejtohem dhe sa më shumë që flisja, aq më tepër përgjigjej, duke më mbuluar me gëzim e lumturi. Atëherë fitova dhuratën e fesë. Pikërisht atëherë e ndjeva praninë e Zotit!“

„Kur fillova përsëri të ha dhe të fle, e thirra vajzën dhe i thashë: 'E kam lexuar librin që ma ke dhënë. Se çfarë shoku! Kuptova se të gjitha ato që ti beson, janë të vërteta. Ke të drejtë, Zoti ekziston! Por, çfarë të bëj tani? Unë s'di asgjë, nuk di prej nga t'ja filloj.' “

Vajza mi dha dy këshilla: „Lexo Biblën dhe shko në Megjugorje sa më parë. Atje do të kuptosh thelbin e të gjithave, kurse motra Emmanuel do të të tregoi se çfarë duhet të bësh.“

„Dhe ja ku jam, motër. Këtu jam. Çfarë të bëj tani?“

Zojë e dashur, të falemnderit – e pranova shenjën tënde! Në mënyrë aq të butë e ke plotësuar „marrëveshjen“ tonë – dhe me aq shumë humor!

“Të dashur fëmijë! Secilin nga ju e kam thirrë personalisht këtu, sepse më duheni për të shpërndarë porosinë e mia në mbarë botën” (23. gusht 1983.)

33

FTESA E MREKULLUESHME

Gjatë një misioni në një fshat të largët polak, më ftuan që t'ua përcjell porosinë e Zojës një grupi të rinjesh, prej tetëmbëdhjetë deri njëzet vjeç. Ishin të etur që të mësojnë sa më tepër mbi Megjugorjen dhe gëzimi i tyre rritej me çdo porosi të Zojës që bashkëndaja me ta. I entuziazmonte çdo shikim i ri mbi ngjarjet e Megjugorjes. Por, m'u thye zemra kur i dëgjova duke thënë: “Sa keq se kurrë nuk do të mund të shkojmë atje.” Si mund të sigurohej pasaporta, bileta e aeroplanit dhe shpenzimet tjera kur, në atë kohë, ishte problem i përditshëm sigurimi i usqimit adekuat? Të shkosh në Megjugorje? – Ishte ëndërr e perealizueshme!

Pa menduar, i dëgjova fjalët që më dolën: “Natyrisht se do të shkoni! Në Megjugorje është Nëna e Zotit ajo që dërgon ftesat! A nuk jeni ju fëmijët e sajë? Ajo do të kujdeset për të gjitha, të jeni të sigurt!” Fëmijët më shikuan si t'i kisha goditur në kokë. “Vetëm bisedoni me të sinqerisht ashtu si do të bisedonit me nënën time. Zgjoni ndjenjat e sajë. Për shembull: ‘Nënë, ti i ke ftuar me miliona fëmijë të tu që të ndërrojnë jetën e tyre. Po unë? Pse mua nuk më ke ftuar? A më ke harruar? A mendon se mua nuk më duhet kthimi? Të lutem, më fto edhe mua!, dhe me që je nëna ime, do të kujdesesh edhe për pjesën e parave, apo jo? Praraprakisht të falenderoj!’ Kështu bisedoni me të dhe zemra e sajë sigurisht do të preket. Por, mbani në mend, e gjitha varet prej asaj se a besoni ju plotësisht në dashurinë e sajë ndaj jush. Në rregull? ”

Nuk u desht të presin shumë për rezultate. Verën e ardhshme i gjeta në shkallët e kishës së shën. Jakobit! Secili prej tyre memzi priste të më tregonte se çfarë ka ndodhur: si i kanë siguruar paratë, vizën etj.

Secili tregim ishte i veçantë. Zoja kishte përdorur imagjinatën e sajë që të prek zemrën e secilit. Miqtë e mi të rinj polakë fluturonin nga gëzimi!

Është e vërtetë. Në Megjugorje është Nëna e Zotit ajo që dërgon ftesat! Dhe me që ajo është Nëna e të gjithë njerëzve, atje do të mund të shihni spektrin e të gjitha racave, popujve dhe gjuhëve, stileve dhe mënyrave të jetesës nga mbarë bota duke u tubuar në meshën e mbrëmjes. Të gjithë ata njerëz rrinë njëri pranë tjetrit dhe nuk kuptojnë asgjë përveç përshëndetjeve të përzemërta. Në mesin e atyre mysafirëve shumica e pranojnë se kanë qenë të kapur në befasi. “Ishte më e fortë se unë,” thonë. “Diçka më tërhiqte në Megjugorje! Erdha dje, dhe sinqerisht, nuk e kam idenë pse

jam këtu!” Përgjegjja është e qartë. Nëse ti nuk e di pse je këtu, mos u brengos, Zoja e di. Vetëm liroju dhe do ta marrësh vesh. Do të largohesh nga Megjugorja si person tjetër!

Rrojtoria e Zojës sonë

Denis Nolan dëshmon: „Më kujtohet, para shumë vitesh, pas ligjëratës që mbajta mbi dëftimet e Zojës Sonë në Megjugorje, tek unë erdhi Sam Belardinella. ‘Ju e keni lehtë të flisni!’ - tha. ‘Unë jam vetëm rrojtari i varfër. Nuk fitoj as për të paguar tatimin. Ku t’i marr të hollat e biletës së aeroplanit për Megjugorje?’

‘Sam, vetëm lute Zojën,’ u përgjegjja, ‘dhe nëse ajo nuk ta siguron biletën, vetë Jezusi do të ta japë, sepse do të jetë shumë i lumtur që dikush i kushton kujdes!’“

„Dy javë më vonë, Sam më vizitoi me një shprehje të hutuar në fytyrë. Në dorë mbante letrën e Mark Bavaro-s. Mark Bavaro është futbollist që luan për New York Giants, kurse Sam e kishte qethur kur kishte luajtur për Notre Dame. Në letër Mark shkruante se shoqja e tij Suzie dhe ai kishin dashur të shkojnë në Megjugorje por, me që Suzie është shtatzënë, nuk mundën. Në pliko kishte futur dy rruzaret e tyre dhe porosinë ‘Sam, a mund të na kryesh një shërbim? Unë, natyrisht, do të kuptoj nëse përgjegjja jote do të jetë negative. Në pliko kam futur çekun prej \$ 2,000. A do të mund të shkosh ti me shoqen tënde në Megjugorje dhe të ja dërgosh rruzaret tona Zojës për t’i bekuar?’ ”

“Pas kthimit nga Megjugorja, Sam, në rrojtoren e tij vendosi truporen e Zojës së Bekuar dhe nuk u lejonte myshterinjëve kurrfarë mahishë ose komentesh të papërshtatshme. Prej asajë ditë rrojtoria e tij u bë e njohur si 'Rrojtoria e Zojës Sonë!’“ Sam kishte pranuar se para shkuarjes në Megjugorje gjithmonë zgjidhte në mes të dy gjërave – lëshimit të pëllumbave të fluturojnë ose shkuarjes në meshën e së dieles. Gjithmonë, më me dëshirë lëshonte pëllumbat. Por rrugët e tij u ndërruan plotësisht. Kaluan më se pesëmbëdhjetë vjet nga udhëtimi në Megjugorje, dhe jo vetëm që Sam shkon në meshë çdo të diel, por ministron rregullisht çdo mëngjes në meshën në 6.45!”

Zoja jonë i njeh të gjithë mysafirët e sajë!

Papritur, më 24. qershor 1982., në habinë e madhe të vendësve, në fshatin e vogël Megjugorje u vërsul një turmë njerëzish. Zoja kishte zgjedhur 25. Qershorin për të festuar përvjetorin e dëftimeve dhe lajmi u përhap gjithandej. Atë ditë, për të parën herë Rushka Pavloviq, motra më e madhe e Marisë, pa një numër të huajsh në mesin e Kroatëve. Madje edhe njerëz nga bota „e lirë“, Gjermania, Italia, Austria, Franca dhe Amerika, kishin ardhur t’i përkulen Zojës. Rushka ishte aq e mrekulluar me ta, sa provoi që me kokën e vet të llogarisë numrin e saktë të vizitorëve. Dhe, që kjo ngjarje të ler përshtypje sa më të thellë, i erdhi idea që ta pyes motrën: „Pse nuk e pyet Zojën sa njerëz kanë ardhur në përvjetor?”

Po atë natë Maria ia bëri këtë pyetje Zojës dhe për habinë e sajë, Zojës iu desht më pak se një sekondë që të përgjigjet. E qetë sikur dikush të thoshte se sa është ora, u përgjigj pa hamendje, “Kanë ardhur 8 482 vetë.”¹⁷²

Shumica e njerëzve do ta klasifikonte këtë anekdotë në dosjen e ngjarjeve Banale. Përkundrazi, unë e shoh si porosi për të gjitha nënat, por poashtu edhe për të gjithë neve. Sepse, ashtu si Maria dëshiron të na përkujtoi, secili që vjen në shtegtim në Megjugorje, vjen me ftesën e Zojës. Natyrisht, duhen përgatitjet e caktuara që rrugëtimi të realizohet, por qofshim të vetëdijshëm apo jo, është fakt se ardhja e dikujt në Megjugorje është pasojë e drejtpërdrejtë e thirrjes personale të Nënës Qiellore.

Me fjalë të tjera, Zoja është shumë e vetëdijshme se cilin prej fëmijëve të vet e ka ftuar. Ajo e din secilin me emër, e din pse i ka ftuar dhe çfarë ka përgatitur për secilin prej tyre. Ajo, poashtu e di se kush nuk është përgjigjur në ftesën e sajë! A mund t'i imagjinojmë vetëm për një moment ndjenjat e zemrës së sajë amënore kur grupi të arrijë në Megjugorje? Se çfarë gëzimi është për të kur mund të ju ndajë dhuratat qiellore të gjithëve të cilët i janë përgjigjur ftesës së sajë! Dhe sa e pikëlluar duhet të jetë kur i duhet përsëri t'i kthei prapa disa dhurata. Vërtetë, disa nga mysafirët e sajë shtiren si të shurdhër dhe janë të regjistruar si të zhdukur prej Oazës së Sajë të Paqes.

Rushka qeshej me gëzim kur më tregonte tregimin për pyetjen drejtuar Zojës më 24. qerrshor 1982.. Dukej si vogëlushe krenare që kishte pasë sukses në diçka! Por, kam frikë se ndoshta e prisha entuziazmin e sajë kur e pyeta, “A i ka treguar Marisë se sa mysafir të ftuar nuk kanë ardhur?”

⁷² Rushka, më vonë nuk mund të kujtonte numrin e saktë, por ne flasim për idenë.

„Të dashur fëmijë! Lëshoni brengat tuaja në dorë të Jezusit. Ja çka thotë ai në Ungjill: E kush prej jush me gjithë përpjekjet shqetësuese që të bëjë, është i zoti që ta gjasë sado pak jetën e vet?... Kërkoni, pra, më së pari Mbretërinë dhe drejtësinë e tij e të gjitha këto do të ju jepen si shtesë! (30. tetor 1983.)

34

LLOGARITË LEGJENDARE TË FLORENCËS

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve Florence de Gardelle fitoi një reputacion të fortë në mesin e shtegtarëve të Provansës (në Francë) ku kishte lindur, si dhe në mesin e familjeve të fshatit të vogël Sivriq, afër Megjugorjes, ku vendoseshin shtegtarët e sajë. Të gjithë pajtoheshin në një gjë: ishte e jashtëzakonshme! Mund të mbante të tensionuar me orë të tëra një ushtri duke përshkruar mrekullitë që Zoja i kishte bërë në jetën e sajë.

Kur isha një ditë me të, e pyeta për anën praktike dhe finansiare të shtegtimeve të sajë në Megjugorje. Në të vërtetë unë kisha vërejtur se shpesh merrte me vete disa njerëz të varfër që nuk e paguanin udhëtimin.

„Si e bën këtë?“ e pyeta.

„Zoja i paguan llogaritë!“ u përgjigj.

„Mirë, por...“

„Secilën herë ndryshe dhe, secilën herë më befason. A të kujtohet porosia e vitit 1983., kur tha: 'Secilin veç e veç unë vetë e kam ftuar këtu.'? Dhe: 'Askush nuk vjen në shtegtim në Megjugorje pa thirrjen time.' Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit personalisht jam bindur se sa është kjo e vërtetë! Nëse ne përgjigjemi në thirrjen e sajë, Maria të gjitha do t'i organizoi vetë. Ajo vetëm kërkon atë 'Po'-në e vogël. Dhe posa e merr atë 'po', menjanon të gjitha pengesat: mungesën e parave, mungesën e kohës, armiqtësinë e kusherinjëve, etj.“

„Cila ngjarje e tillë të ka bërë përshtypje më të madhe?“

„Kurrë nuk do ta harroj shtegëtimin tonë në shkurtin e vitit 1996. Atëherë, vërtetë, Ajo tregoi se çfarë mund të bëjë! Tetë vite kemi sjellur këtu disa të rinj pa pagesë, nga bashkësia që e njihim mirë të cilën e udhëhiqte një meshtar. Ata ishin të kyçur në një program ku mësonin shkathtësitë e ndërtimitarisë, që i formësonte edhe shpirtërisht. Më 1996., atë Jean më tha se do të dëshironte të thërriste disa miq nga bashkësia e tij, dhe filluan të më arrijnë formularët për paraqitje me shenimin: 'Udhëtimi i ofruar nga atë Jean.'

„U tubuan dhjetë, njëzet, tridhjetë formular. E thirra atë Jean për t'i treguar se së shpejti do ta kemi përplot një autobus! 'S'ka problem, Florence; me detajet do të mirremi pas udhëtimit. Mos u brengos!'

„I thash: 'Në rregull.' Por... formularët grumbulloheshin: dyzet, pesëdhjetë. E thirra përsëri dhe i thash: 'Atë, a nuk mendon se është mjaft? U mbushën dy autobusë. Në secilin prej tyre ka nga 38 ulëse. Nëse i marrim parasysh shpenzimet e transportit, të banimit...'

'Mos u brengos, Florence,' tha. 'Është shumë me rëndësi që secili prej atyre të rinjëve të shkoj! Këte e ndjej fuqishëm!'

„Në fund i pata 66 regjistrime, dhe vetëm dy prej tyre mund t'i paguanin shpenzimet e udhëtimit. Iu drejtova Zojës: 'Dëgjo, ky organizim shtegëtimi nuk është i imi por i yti. Ti i ke ftuar! Madje edhe nëse disa prej tyre janë të nxitur prej të tjerëve që të vijnë me ne, nuk mund ta braktisësh meshtarin tënd i cili ka aq dëshirë t'i sjell të gjithë këta të rinj tek ti! Pra ky duhet të jetë problemi yt, jo imi!'“

„Sido që të jetë, u nisëm me pesë autobusë! Gjatë udhëtimit zakonisht lëshonim video kasete të zgjedhura me kujdes që të përgatishim zemrat tona. Njëra prej tyre ishte dëshmia e atë Verlinde mbi rreziqet e okultizmit dhe gjithë atyre që janë lidhur me të, si shërimet e rrejshme, shfrytëzimi i lavjerrësit, yoga, meditimi transcendent, religjionet lindore, etj. Posa fillova të lëshoj kasetën dëgjuam një zhurmë të tmerrshme. U ndalëm të kontrollojmë autobusin dhe pamë se një rrotë ishte shtrembëruar plotësisht, edhe pse autobusi nuk pati aksident. Shkova në tjetrin autobus dhe posa e lëshova kasetën u shpua goma! U drejtova tek autobusi i tretë duke menduar se sa shumë hire na prisnin!'“

„Derisa ktheheshim në shtëpi nëpër Kroaci, një autobus u prish vetvetiu në rrugë të hapur. Mekaniku tha se prishja nuk mund të evitohet. Prandaj shtegëtarët u sistemuan në katër autobusët tjerë. U befasova se autobusi i pestë nuk ishte plot kur u nisëm nga Nice. Por kur i sistemua shtegtarët në rrugën për në shtëpi, çdo gjë ishte në rregull. Nuk kishte asnjë vend të lirë. Zoja i kishte llogaritur të gjitha me saktësi. Natyrisht, disa prej nesh e kaluan natën zgjuar sepse nuk kishte vende të lira, por të gjithë u kthyem në shtëpi!'“

Zoti i preku thellë të rinjët gjatë shtegëtimit të tyre dhe secili syresh, ndau me të tjerët gëzimin nëpërmes të mikrofonit.

Do të jeni dëshmitarë të atyre shenjave

„Kur erdhi koha të paguheshin llogaritë na priti një befasi e vërtetë! Duke iu falënderuar donatorëve, të cilët, padyshim, i kishte nxitur Nana e Bekuar, mundëm të paguajm secilën llogari pa shkuar në minus. Duhet të them se krejt në fillim të atyre shtegëtimeve i thashë Zojës: 'Nëse do të më duhet të huazoj ndonjëherë, do ta kuptoj si shenjë prej teje se duhet të heq dorë dhe do ta ndërpres menjëherë!' Asnjëherë për pesëmbëdhjetë vjet nuk kemi shkuar në minus. Prej dyqind

vetëve që i dërguam në atë shtegëtim, vetëm shtatëdhjetë i paguan shpenzimet e veta. Të tjerët dhanë aq sa mundën.“

„Le t'i bekoi Zoti me begati ata të cilët gjatë gjithë këtyre viteve me aq shumë dashuri i kanë dërguar dhuratat dhe donacionet e tyre! Le të iu kthehet njëqindfish! Duke iu falenderuar atyre mundëm t'i çojmë të gjithë ata njerëz!“⁷³

„Të dashur fëmijë... vetëm me dorëzimin e mrendëshëm të plotë, do ta njihni dashurinë e Zotit dhe shenjat e kohës në të cilën jetoni. Do të jeni dëshmitar të atyre shenjave dhe do të flisni për to. Dua të ju përgatis për këtë.“ (Porosia Mirjanës më 18. mars 2006.)

⁷³ Më 2003., Florence-s iu desht të ndërpresë sjelljen e shtegëtarëve në Megjugorje kur i shoqi Bernard u sëmur rëndë. Florence kuptoi se tani e ka vendin pranë burrit. Ajo nxjerr forcën prej zemrës së Marisë nën Kryq. Fatmirësisht, autobusët nga Nice ende vijnë nën drejtimin e një bariu tjetër. Shiko në www.msvie.com

„Të dashur fëmijë! Sot, si Nëna juaj, dua të ju tërheq vërejtjen se djalli don që të shkatërroi çdo gjë në ju: por lutjet tuaja do të pengojnë suksesin e tij. Kur t'i keni mbushur të gjitha vendet e zbrazta me lutje, djalli nuk do të mund të hyjë në shpirtin tuaj. Lutuni, të dashur fëmijë, dhe unë do të lutem që ta mundni djallin. Le të jetë kjo kohë në të cilën secili prej nesh do të pranoi dhe do t'ju ofroi të tjerëve paqe.“ (21. mars 1988.)

35

PAQA JUAJ DO TË RRJEDH SI LUM

Megjugorje, qerrshor 1992.

Ishte luftë në mes të Serbëve dhe të Kroatëve. Oborri i Vickës ishte i braktisur. Asnjë shtegtar nuk merrte guximin të hynte në fshatin e vogël të rrethuar me forcat armike. Lufta kishte fshirë nga faqja e dheut shumë fshatra dhe një numër të madh të banorëve në Bosnje dhe Hercegovinë, por Vicka ishte më aktive se kurrë më parë. Dëgjova, një ditë, se kishte shkuar nëpër Bijakoviç (fshati i sajë) dhe shatrat e afërta që të kurajonte ushtarët, të lutej me ta, t'i bekonte dhe të ngriste moralin e tyre. Asgjë nuk mund të trondiste gëzimin e sajë. – gëzim, i cili me siguri do të hyjë në legjendat e Megjugorjes. Një mëngjes u ndala para shtëpisë së sajë, shikova në atë fytyrë, gjithmonë të qeshur, dhe i bëra këtë pyetje provokative:

„Vicka, a nuk ke frikë? Të gjithë vëllezërit i ke në luftë – a nuk ke frikë për ta? A ke dëgjuar se çfarë u kanë bërë fshatrave në anën tjetër të Neretvës? Kanë djegur çdo gjë, njerëzve u kanë prerë fytyrën, bagëtinë i kanë vrrarë... Vetëm pesë kilometra nga këtu. A nuk je e brengosur për prindërit?“

Më shikoi në sy dhe u përgjigj pa fije hezitimi: „Motra Emmanuel, kur e ke Zotin në Zemër“, tha, duke rrahur kraharorin me duart e saja të mira fshatare, „kur ke paqen e Zotit në zemër, çfarë mund të të frigojë?“

Ende e kam para sysh shikimin e sajë në atë mëngjes. Flaka e butë e lumturisë shëndriste nga tërë qenia e sajë në mes të kaosit që nuk mund të përshkruhet. Me qindra libra të shkruara mbi paqen e Zotit nuk do të mund të më mësonin më shumë se ato fjalë që dolën nga zemra e sajë e pastër!

Paqa që mbush zbrastësinë tonë

Të shkojmë për një çast në Jerusalem. Afër Kalvarit, në kopshtin që kufizohet me gurthyesin, varri i të Kryqëzuarit është i zbrazët! Guri është i larguar anash, kurse Jezusi qëndron atje duke rrezatuar me dritë dhe lavdi! Më fascinon bukuria e Tij: nuk është prej kësaj bote. Edhe unë e dëshiroj atë bukuri. Më duhet ta kem. Si Maria Magdalenë ditën e ngjalljes, nga thellësia ime del

forca dhe më nxit ta përqafoj Jezusin. Pos demonëve që kanë zgjedhur ta urrejnë për amshim, askush tjetër nuk mund të shohë bukurinë e Jezusit, e mos të ketë dëshirë ta përqafoi.

Më thërret me emër dhe më përshëndet: „Paqa me ty!“

Posa e munda mëkatin dhe vdekjen. E munda vdekjen *time* dhe më ofron lirinë e vet me gëzim të përvuajt dhe të pamasë. Kjo është e parezistueshme! Megjithatë, sado që përpiqem t'i hapem asaj paqe, sado që dëshiroj ta rrëmbej me çdo pjesëz të qenies sime, jam e bllokuar! Mund të pranoj vetëm një grimcë shumë të vogël! Duket se teprica refuzohet nga unë dhe i kthehet Jezusit. A është zemra ime e paarritshme?

Po, zemrat tona janë të paarritshme! Gjatë vitesh i kemi bërë të paarritshme për paqen, ashtu që tani refuzojnë jo vetëm shiun e lehtë por edhe depërtimin e furishëm të rrebeshit e të furtunës që ofrojnë mëshirën e Jezusit!

Sa herë që jemi në meshë gjëndemi në praninë e të njëjtit Jezus të gjallë e të adhurar i cili i ka folur Marisë Magdalenë në kopësht në ditën e ngjalljes. I njëjti Jezus vjen në altar me fjalët që i thotë meshtari, i cili në atë çast ashtu si Krishti përjeton Mundimin e tij, Vdekjen e tij dhe Ngjalljen e tij; asgjë më pak se kaq! Kur meshtari thotë: „Paqa e Zotit qoftë me të gjithë ju!“ është vetë Jezusi i cili më flet mua personalisht. Por, ku është në atë çast zemra ime? Ku ka humbur? Pse, kur dal prej kishe përsëri luftoj me të njëjtat konflikte, me të njëjtat strese të brendëshme, nëse Jezusi i ngjallur ma ka dhënë krejt paqen e vet! Ja, përsëri jam e mbyllur krejtësisht. Pse?

Atë ditë Jezusi në kopësht tha „*Šalom!*“ Në çdo meshë ai përsëri ma ofron të njëjtin *šalom*. Unë do të dëshiroja të di çfarë përmban ajo porosi! Në të vërtetë, *šalom* e Jezusit nuk ka shumë lidhje me konceptin e „paqes“ që ka ndërtuar bota jonë. *Šalom* nuk është mungesë konflikti. Nuk është ajo ndjenja e këndshme e lehtësimit kur ikin armiqtë; ose kur më në fund ndalon era e cila na bie në fytyrë, dhe qetësohen valët luftarake të furtunave tona. Jo, kjo nuk ka lidhje me *šalom*. Këto gjëra na sjellin ndjenjën e paqes e cila mund të marrë fund në çdo çast! Ky *šalom* është diçka krejt tjetër: „*Po ju lë paqen, po ju jap paqen time!*; *Nuk po jua jap siç e jep bota.*“⁷⁴

Kuptimi i parë i fjalës *šalom* është „tërësi“ ose „plotësi.“ Nëse jam e plotë brenda vetes, e tërë dhe e plotë, atëherë kam *šalom*. Nëse hyj në motel për të zënë dhomën dhe receptionisti më thotë: „Më vjen keq, nuk kemi dhomë të lirë,“ atëherë mund të them se ai motel ka *šalom*. Nuk ka dhomë të pazënë; nuk ka zbratësi. E kundërta e *šalom* nuk është *luftë*, por *zbratësi* ose *asgjë* (edhe pse, luftat ndodhin për shkak të zbratësisë). Kur engjëlli Gabrijel i tha Marisë „Hirplote,“ deklaroi se ajo ka *šalom* të përkryer; nuk kishte vend në të që nuk e kishte zënë Zoti.

⁷⁴ Gjoni 14,27

Dy mijë vjet më vonë, duke u dëftuar në Megjugorje, „Nëna dhe Mbretëresha e paqes“ na flet: „Të dashur fëmijë, keni zbraktësi në vete! Mos e mbani atë zbraktësi, sepse djalli bredh duke dashur që ta mbush. Të dashur fëmijë, mbusheni atë zbraktësi me lutje.“

Mbretëresha e paqes vjen në Megjugorje për të na shëruar nga zbraktësia jonë! Ajo e di se sa shumë zbraktësi e mundon zemrën njerëzore. Pse në kohët e fundit aq shumë të rinj marrin drogë ose alkohol? Pse disa i ndërrojnë partnerët, duke sakrifikuar dhuratën më të çmueshme të seksualitetit të vet në altarin e perverzionit? Pse i mbushin veshët me muzikën shurdhuese e cila vetëdijen e tyre të hutuar e hedh në botën e imagjinatës? Përgjigja është e qartë: nuk mund ta durojnë mundimin që ju shkakton zbraktësia e brendëshme dhe janë të gatshëm të rrëmbejnë çfarëdoqoftë – diçka që do të ju ndihmoi që së paku për një moment të harrojnë se janë të zbraktët! Se nuk kanë shpresë, se nuk kanë dashuri, se nuk kanë cak në ardhmëri, dhe se janë të robëruar në materializëm pa dalje të dukshme. Kush nuk do të rrëmbente çfarëdo dalje të mundshme, madje edhe nëse shkruan në të „Kujdes – mund të jetë vdekjeprurëse!“ Kur duhet të zgjedhin në mes të mundimit që shkakton zbraktësia dhe vdekjes disa prej tyre zgjedhin vdekjen.

Atyre duhet thënë se Nëna e Zotit vjen në Megjugorje pikësepari për shkak të të rinjëve. I zgjodhi gjashtë të rinj nga fshati që t'i shëroi nga zbraktësia. Ua zbuloi se Krijuesi, për t'i shëruar, u ka ofruar dhuratë shumë të madhe: Vetëveten! „Mos harroni, të dashur fëmijë, se Zoti ju jep krejt vetëveten.“

Shën Toma i Akuitit ka shpikur një formulë të shkëlqyeshme: Ne jemi „capax Dei“ ose „të aftë për të njohur Zotin.“ Krijuesi na ka bërë të tillë që të mund ta njohim, Atë – Zotin në madhësinë e vet! Sa hutues është shpirti i njeriut – sa e paarritshme është thellësia e tij!

Shprehja Hebraike „i krijoi në përgjasimin e vet“ vështirë mund të përkthehet saktësisht. Më shumë ka të bëjë me *formën* se sa me *dukjen*: ne kemi „formën“ e Zotit, „kallëpin“ e tij. Por, me çfarë ne zgjedhim që t'i mbushim enët e pamasa të zemrës sonë? Me një knaqësi të vogël këtu, me një knaqësi të vogël atje? Me një kënaqje kalimtare pas të cilës ndjehemi të zbraktët dhe të anktshëm? Qielli është kuptimi ynë dhe, dëshira jonë e domosdoshme është që të jemi të plotësuar në tërësi!

Si të kalohet nga ankthi në *shalom*

Ja shembulli që do të paraqesë qëndrimin e disa njerëzve:

„Unë jam *katolik i mirë*. Çdo të diele shkoj në meshë, por nuk kam paqe! Edhe më keq, më torturon mendimi se do të sëmurem. Po plakem, dhe më së shumti e urrej sëmurdjen. Nuk dua të sëmurem! Mendimi në dhëmbjen më është dëbus, nuk dua që të vuaj ose të jem i robëruar në shtrat, nuk dua ta humb punën time ose të ndjehem i poshtëruar sepse të tjerët duhet të kujdesen

për nevojat e mia. Prandaj, çdo muaj shkoj te mjeku që të sigurohem se trupi im nuk do të më befasoi!“

Ky njeri, i cili është, *si duket*, katolik i mirë, në të vërtetë është një pagan i përsosur i cili nuk e njeh Zotin dhe vuan nga zbrastësia. Nuk kujton ditën e pagëzimit kur u bë fëmijë i Zotit – dhe trashëgimtar i Zotit. Atë ditë ai trashëgoi pasuri të paskajshme: pasi u bë pjestar i familjes së Zotit, të gjitha që i përkasin Zotit, i përkasin edhe atij. Por, edhe të gjitha që ai i posedon, poashtu i përkasin Zotit. Trupi i tij i përket Zotit. Prandaj, nëse trupi i tij i përket Zotit, i kujt është problemi kur të sëmuret? I Zotit!

Por miku ynë nuk e jeton pagëzimin e vet. Ai në mënyrë të pavetëdijshme i ka ndërprerë lidhjet e tij me familjen, dhe ka kërkuar t'i kthehet kapari. Fatin e tij e mban në duar të veta, duke e shtrënguar sa më shumë që mundet. Kur thotë: „Ky është trupi im, shëndeti im, jeta ime, unë urdhëroj këtu...“, ai në të vërtetë, pa menduar, e shtyn Zotin jashtë jetës së vet dhe kështu krijon zbrastësinë e vet personale. Zoti, në përvuajtërinë e vet, nuk imponohet atje ku nuk është i ftuar. Kurse miku ynë i ka treguar derën: „Zotëri, kjo është jeta ime, shëndeti im, dhe të lutem të mos përzihesh!“ Pikërisht këtu qëndron kurtha. Është e pavetëdijshme prandaj shumë më efikase. Miku ynë kujton se jeta e tij është e sigurt sepse e ka marrë në dorë të vet, derisa ndodh diçka krejt e kundërt: ai zbraz vetëveten. Zoti nuk është i mirëseardhur në shtëpinë e tij, dhe me që atje ku nuk ka Zot nuk ka as dritë, miku ynë i ka hapur derën territ. Qëllojani kush është në terr? Kush e don terrin për të vepruar, pasi që ka frikë se drita do t'i zbuloi veprat e tij? E dimë se kush!⁷⁵

Mashtruesi dhe shenjterit e tij e kanë hyrjen e tyre private dhe janë tejet të lumtur kur shohin se është e mbushur me atë zbrastësi të madhe dhe të zezë. As nuk kanë mundur ta marrin me mend ndonjë vend më të mirë për veprimtarinë e vet. Do të vazhdojnë, që nga brenda, ta gërryejnë atë njeri të mjerë, do ta brejnë pa mëshirë dhe miku ynë do të çuditet pse ndjehet i rraskapitur. Fillon të ndjehet i shqetësuar. Ankthi që ndjen në lukth fillon të injektoi frikën në zemër. Që të harrojë ankthin, fillon të kërkojë dëfrimin, por nuk është krejt i pavetëdijshëm. E din se kur të mbarojnë dëfrimet do t'i duhet të kthehet në zemër e cila për shkak të mungesës së dashurisë është bërë si një hotel i lirë.

Jemi në fazën vendimtare në të cilën gjëndet një numër i madh njerëzish sot, që rezulton me pasurimin e paimagjinueshëm të „profetizuesëve“ e ardhmërisë si dhe të industrisë farmaceutike e cila shet antidepressivë. Të shohim se çfarë na thotë Mbretëresha e paqes:

„Të dashur fëmijë, Ju ftoj në dorëzim të plotë Zotit! Lutuni, fëmijë, që djalli të mos ju luhatë si degët në erë. Bëhuni të fortë në Zotin. Të mos jeni të ankhshëm dhe të brengosur. Zoti do të ju ndihmoi dhe do t'ua tregoi rrugën...“ (Porosia më 25. qerrshor 1988.)

75 „E gjykimi është ky: Drita erdhi në botë, por njerëzit më tepër deshën errësirën se dritën, sepse veprat i kishin të këqija. Vërtet, kushdo që bën të keqen, e urren dritën dhe nuk del në dritë që të mos i zbulohen veprat e tij, kurse ai që e vë në zbatim të vërtetën, ai del në dritë që të dalë ballafaqë se veprat e tij u bënë siç thotë Hyji.“ (Gjoni 3,19-21)

Dorëzimi i plotë është mënyra e vetme me të cilën miku ynë, ndonjëherë, mund të gjejë paqen. Ashtu si të gjitha zgjedhjet që ofrojnë Jezusi dhe Nëna e tij, edhe kjo është e thjeshtë dhe kërkuese. Në vend që të kontrolloi në tërësi shëndetin dhe jetën materiale të tij, miku ynë duhet t'i lëshoi të gjitha dhe të dorëzohet në dorë të Zotit. Prosesi mund të kuptohet lehtë, fëmija e din se çfarë do të thotë t'i japësh diçka babit. Por, poashtu është kërkuese, sepse miku ynë duhet të ndërroi qëndrimin e vet dhe të thotë: „Zotëri, me që jam i pagëzuar edhe të takoj ty, trupi im është i yti. Bën me të çfarë të duash. Sa më takon mua, qëllimi i jetës sime është të lëvdoj ty. Nëse do të lëvdohesh nëpërmes të shëndetit tim atëherë më bën të shëndoshë. Por, nëse ke plane të tjera për mua, nëse do të shfrytëzosh ndonjë sëmundje për të më pastruar, atëherë, Zotëri le të bëhet vullneti yt, sepse si do që të jetë, ajo që është e rëndësishme për mua është të të lëvdoj ty!“

Me këtë qëndrim, vërtetë të krishterë në zemër (që është marri totale për jobesimtarin), miku ynë bëhet i lirë. Nuk jeton më në gjendje përherë të ndryshueshme. Ai është mbi të! Tani që e ka ftuar Zotërinë që ta zbatoj planin e vet Hyjnor me të, Jezusi mund ta uisë hapësirën e pamasë të zemrës së tij të hapur. Kurse Ai është aq i kënaqur me ftesën, sa që dëshiron ta mbush deri në grykë. Dhe kështu *shalom* tani banon në zemrën e mikut tonë i cili mund të kënaqet në paqen e tij – paqen e vërtetë!

Të shohim tani shembullin e një katoliku të mirë i cili i ka „të gjitha që i duhen“ – pos paqes (në vend të së cilës gjëndet ankthi i paprekshëm që nuk mund të hiqet qafe). Kur u pasurua shumë shkoi në pension duke menduar: „Mrekulli! Jam i pasur, kam shtëpi të bukur, automobil të ri – prej tani do të kënaqem me të gjitha këto. Të gjitha këto i fitova vetë; kurrë asgjë nuk mora falas, kurrë asgjë nuk vodha. Të gjitha i fitova me këto dy duar në dyzet vitet e shkuara, dhe tani këto janë të miat dhe mund të bëj me to çfarë të më dojë qejfi.“⁷⁶

Çfarë të thuhet këtu më tepër? Ai në mënyrë të pavetëdijshme e ka lënë Jezusin anash, sikur t'i thoshte: „Zotëri, unë kujdesem vetë për punën time, prandaj të lus që të mos përzihesh aty!“ Ai vetë e ka krijuar zbrastësinë në zemër, si në shembullin paraprak, sepse Jezusi sheh se aty nuk ka asgjë për të.

Megjithatë, rruga e bukur që çon në paqe do të hapet para këtij njeriu nëse ndërton mendje dhe fillon të lutet: „Jezus, kam lajme të mira për ty! Shiko të gjitha këto që i kam? Ti mund të bësh me to çfarë të duash! Çfarëdo që të vendosësh të bësh me gjërat që kam, do të jem i kënaqur, sepse gëzimi im është të të lavdëroj në çdo gjë. Nëse do ta shumosh pasurinë time, vetëm vazhdo! Por nëse don ta shpenzosh për nevojat dhe projektet tua, merr çfarë të të duhet, prej tani kjo është llogaria jonë e përbashkët, unë do t'i nënshkruaj të gjitha çeqet tua!“

Lumi i paqes do ta vërshoi zemrën e këtij njeriu, sepse Jezusi i ringjallur e ka pranuar ftesën e tij të ngrohtë, dhe Ai do të derdh në të dritën, gëzimin dhe dashurinë e tij. Ky njeri tani është i lirë,

⁷⁶ Luka 12,15-21

ai nuk u frigohet më lajmeve të këqia, sepse ka filluar t'i besoi Zotit! Paqen e vet e nxjerr nga burimi.

Ekziston edhe një lloj posedimi vrasës që vret paqen e zemrës, diçka që gradualisht e zhvillojmë ndaj atyre që i duam, zakonisht ndaj fëmijëve tanë. Është aq lehtë të harrohet plani i Hyjnor që Krijuesi i tyre ka për ta dhe të pengohen veprat e Tij duke bartur mbi ta idetë dhe pritjet tona: “Ai është biri im, ai bart emrin tim, unë kam paguar arsimimin e tij...!”

A do të ndryshoi paqa jonë varësisht nga zgjedhjet e tij në jetë, të mira ose të këqia? Natyrisht se jo! Kushtimi i fëmijës Zotit ose Nënës së Zotit që nga ngjizja e tij na liron, sepse kjo na liron nga barra që ja ngarkojmë vetes kur zëmë vëndin e Zotit në jetën e fëmijëve tanë.

Madje edhe në çastet e dhëmbjes, që janë të pashmangëshme në raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve, *shallom-i* ynë do të mbetet i qëndrueshëm dhe i paluhatshtëm nëse fatin e fëmijëve tanë e kemi lënë në dorë të Zotit: „Zotëri, këtu është fëmiju që ma ke dhënë të kujdesem për të. Ti je Krijuesi i tij, Bariu i tij dhe Shpëtimtari i tij. E ke vendosur në familjen tonë që t'i ndihmojmë të rritet në harmoni me thirrjen tënde dhe të bëhet ai që ti ke caktuar për amshim. Zotëri, më ndihmo që të jem i vetëdijshëm dhe plot dashuri, ta plotësoj detyrën time ndaj tij, që të jepem plotësisht dhe të bëj atë që është në mundësinë time për t'i ndihmuar ta gjejë rrugën e vet kah shenjtëria.⁷⁷ Le të më ndihmoi Shpirti yt Shenjt që ta formësoj. Bën me të ashtu si kërkon vullneti yt shenjt, Zotëri, sepse ky fëmi është fëmiju yt, ai të takon ty. Unë ta ofroj dhe ta kushtoj me besim të plotë.“

Kur të bëhet ky kushtim, fillojmë të ndjejmë lirinë e plotë dhe motra i sajë binjake, paqa, fillon të mbush zemrën tonë. Do të mund të numronim shumë shembuj: qëndrimi ynë ndaj punës, ardhmërisë, vetes, të tjerëve, ndaj kulturës sonë, madje edhe ndaj mëkateve tona. Për çfarëdo që të bëhet fjalë, rezultati do të jetë gjithmonë i njëjtë: sa më shumë që përpiqem t'i kontrolloj gjërat aq më tepër humbi paqen, dhe sa më shumë ia dorëzoj Zotit, aq më shumë fitoj paqe.

Çdo ditë në meshë Jezusi qëndron para meje në madhësinë e ringjalljes së vet, duke u djegur nga dëshira që të mbush zbrastësitë e zemrës sime me vetëveten! Shikimi i Tij plot dashuri depërton në thellësitë e qenies sime të brendëshme dhe gjen të gjitha dyert e ndryra dhe të mbyllura me shul, ato lëmi të jetës sime në të cilat Ai nuk ka mundur kurrë të hyjë sepse kurrë nuk e kam ftuar. Ai i don me dëshirën më të thellë. A do të mbeten ato të paarrtshme për Të? Apo do t'ia dorëzoj çelsat? A do të refuzohet edhe një herë sot *shallomi* i tij nga muret e

⁷⁷ „Të dashur fëmijë! Gëzohem për të gjithë ju që jeni në rrugën e shenjtërisë dhe ju lutem, ndihmoni me dëshminë tuaj atyre që nuk dijnë të jetojnë si shenjtër. Prandaj, të dashur fëmijë, le të jetë familja juaj vend ku lind shenjtëria. Ndihmohuni të gjithëve të jetojnë si shenjtër, e sidomos familjes suaj. Ju falemnderit që i jeni përgjigjur thirrjes sime!“ (Porosia më 24. korrik 1986.)

strehimoreve të mia të mbyllura, apo do ta njoh çastin e ardhjes së tij dhe do t'i hapem lavdisë së të Ringjallurit?⁷⁸

Zemrimi që vështirë mund të largohet

Ekziston një strehimore e errët dhe e kobshme e mbyllur në fund të zemrës së njeriut e cila kryesisht refuzon çfarëdo qasje të të Ringjallurit. Në thellësitë e kësaj shpelle janë të fshehura enë të shumta madhësishë të ndryshme prej të cilave, pa u vërejtur, shpërndahen gazra helmues në të gjitha drejtimet. Çfarë ka në to? Zemrimi ynë! Do të ishte e arsyeshme të përdoren dyer të çelikut nëse pas tyre do të gjëndeshin shishe vere të shtrenjtë, që ruhen për festa të posaçme – por zemrimi? Pse është i mbyllur aq fort?

Është në natyrën e zemrimit që të largohet me vështirësi. Ashtu si ato njollat e vështira që i kundërvihen çdo lloj detergjenti, zemrimi i bashkuar me paturpësinë i kundërvihet të gjitha përpjekjeve tona. Secili prej nesh mund të ketë dëgjuar ndonjë kusheri, në shtratin e vdekjes: „Të gjithë i kam falur, por jo *filan fistekun*. Kurrë nuk do ta fal për atë që i ka bërë bijës sime, kurrë!“

Ah, ajo strehimorja e mbyllur atje thellë... kush do të ngadhnjejë mbi të ndonjëherë? Ende më jehojnë në veshë fjalët e atë Daniel Ange nga njëra prej predikimeve të tij: „Të falësh nuk është vështirë...“ Atëherë shikoi për një çast reagimin e bashkësisë, dhe shtoi: „...është e pamundur!“

Nëse Jezusit, për të na ofruar *paqen e vet*, iu desht të marrë mbi vete tërbimin që ishte mbi kokat tona, nëse iu desht të vdesë në kryq, ai, i cili është burimi i jetës, që të ngadhnjente mbi mëkatin tonë, madje edhe mbi ndyrësitë më të skajshme, kjo është për shkak se paqa e tij nuk ka prejardhje njerëzore. Ky është hiri të cilin mund ta japë vetëm Zoti, dhuratë mbinatyrore të cilën asnjë njeri nuk mund ta prodhoi ose ta shesë. Madje edhe nëse jap shëndetin tim dhe të hollat e mia Zotit, së bashku me krejt ardhmërinë dhe me të gjitha që i kam për zemër, derisa të ndjej zemrim ndaj vëllaut tim, *shallom-i* i Jezusit do të refuzohet nga unë dhe nuk do të ketë rast të hyjë. Nganjëherë nuk jam e vetëdijshme se nga ai zemrim kam krijuar një nga margaritarët e mi më të shtrenjtë. Jam e lidhur aq fort për të sikur të ishte dora ose këmba ime, ushqehem me të si të ishte ushqimi themelor i jetës sime. E në të vërtetë nuk është asgjë tjetër pos helm i cili më shkatrron!

Jezusi i Ringjallur e dëshiron me zjarr edhe këtë helm. Ai pret dhe dëgjon edhe rënkimin më të dobët nga buzët e mia që të më liroi prej tij.

„Zotëri, merre këtë zemrim! Po ta dorëzoj! Të lutem, eja dhe largoje - më dhemb shumë. Plotësisht është barikaduar përbrenda. Rrjedh gjak dhe nuk mund ta prek! Jezus, ti ke pirë

⁷⁸ „Të dashur fëmijë, hapni zemrat tuaja birit tim Jezusit: lejoni të hyjë!“ (Porosia Mirjanës, më 18. mars 1991.)

uthullën prej shpuzës të cilën ta ka afruar ushtari te buzët derisa ishe në kryq, eja dhe pi uthullën e zemrimit tim. Falja jote le të rrjedh nëpër mua. Nuk kam mëshirë për të gjithë – të lutem, eja dhe më jep mëshirë.“

Atë Georges Finet, i cili së bashku me Marta Robin themeloi Foyers de Charité, thoshte: „Nëse nuk mund të falim mund të *dëshirojmë të falim*. Të duash të falësh është falje. Nëse madje nuk mund të dëshirojmë të falim mund të *dëshirojmë të kemi dëshirë të falim*. Të dëshirosh të kesh dëshirë të falësh është falje!“

Me zemrën e tij dhuruese, pafundsisht të madhe, Zoti pret shenjën e vullnetit të mirë nga ana jonë që të mund të derdh mbi ne mëshirën e tij. Ai që ka kërkuar dhe shpëtuar të gjithë që ishin të humbur ndërron çdo gjë me mëshirën e tij shndërruese – madje edhe zemrimin tonë më të hidhur nën guaskën e çeliktë e shndërron në erë të këndëshme. Ai ka ardhur për të sëmuret dhe mëkatarët. E kjo do të thotë se jam në listën e tij! Ai ka ardhur, dhe ka demontuar bravat e shpellës sime të ndyrë dhe ka larguar zemrimin tim. Mund ta ngris kokën dhe ta shikoj në sy Shpëtimtarin tim të mrekullueshëm dhe të shkëlqyer kur thotë: „Le të jetë *shalom-i* im me ty!“

Vicka është dhuratë e madhe e paqes

Disa shtegtarë nuk hezituan t'i bëjnë Vickës këto pyetje:

Pyetje: „Prej nga vjen kjo paqe dhe ky gëzim që ke? A është sepse e sheh Zojën e Bekuar Mari?“

Vicka: „Nuk është aq me rëndësi të shohësh Zojën sa është të ndjesh praninë e sajë të brendëshme. Ajo që është më e rëndësishme është që vërtetë të bësh atë që ajo na thotë në porosinë e sajë. Zoti më ka dhënë dhuratën e madhe të paqes. Nuk kam fjalë me të cilat do ta shprehja falenderimin tim. Ky është hir i cili vjen me dërgimin e Zojës sonë si *Mbretëresha e paqes*. Paqa rritet në mua prej ditës në ditë sepse e kam dëshiruar, sepse ende e dëshiroj dhe, lutem për të çdo ditë.“

Pyetje: „Ku është misteri i buzëqeshjes sate të vazhdueshme dhe i gëzimit tënd?“

Vicka: „Buzëqeshjes dhe gëzimit tim? Asgjë nuk do të dëshiroja më tepër se sa të plotësoi dëshirat e Zojës sonë. Unë jam shërbëtorja e sajë. I kam falë jetën time dhe jam e gatshme të bëj çdo gjë që ajo kërkon prej meje. Ky është burimi i gëzimit tim. Aq shumë do të dëshiroja që të gjithë të ndjeheshin si unë dhe ta pranojnë hirin e përcjelljes së dashurisë që Zoja ka për secilin prej nesh. E di se Zoja dëshiron që ne të përcjellim praninë e sajë tek të tjerët duke treguar se ajo është në mesin tonë. E di se çdo ditë do të takoj shtegtarët nga mbarë bota të cilët vuajnë në mënyra të ndryshme dhe të cilët janë larg prej Zotit. Është hir i madh të mund t'i ngushëllosh, prandaj nuk mund të jem e pikëlluar! Çdo mëngjes, posa zgjohem, lutem në këtë mënyrë: „*Ja ku jam Zojë, bën me mua si të duash!*“

Nuk mund të kemi paqe dhe s'mund të jemi të qetë nëse u lejojmë problemeve tona që të nxjerrin më të mirën nga ne. Fatkeqësisht, sa shumë janë njerëzit nën stres të cilët lejojnë të thehen nga gjërat e vogla, krejtësisht të parëndësishme. Ata të cilët nuk kanë paqe do të duhej të ndajnë pak kohë për ta kaluar me shpirtin e vet. Do të duhej, poashtu, të bisedojnë me Zotin, t'i ndajnë me Të ato gjëra që i nevrikosin dhe të kërkojnë që t'i liroi nga ajo barrë.

Njëherë kur të gjejnë paqen e vërtetë, nuk do të mund ta humbin aq lehtë. Nganjëherë më vijnë njerëz që nuk dijnë asgjë për Zotin. Vërej, me pikëllim, se shumica prej tyre e kanë mbyllur zemrën për Zotin. Gëzimi im më i madh është t'i pranoj, sepse atëherë mund të përcjell tek ta dashurinë e Zotit i cili është për secilin prej nesh Baba i afërt. Pak nga pak, këta njerëz fillojnë të dëshirojnë praninë e tij në vete dhe rreth vetes.

“Të dashur fëmijë! Bekoni (me bekim të veçantë) madje edhe ata që nuk besojnë. Mund t’ua jepni prej zemrës këtë bekim që t’ju ndihmoni në kthimin e tyre. Bekoni të gjithë që i takoni. Ju jap një hir të veçantë dhe dëshiroj t’ua jepni të tjerëve.” (29. nëntor 1988.)

36

BEKIMI NË HEKURUDHËN NËNTOKËSORE

Nuk mund të presim që secili të vijë në Megjugorje. Prandaj Zoja ka shpikur disa forma shumë të mira, që me zemrën e sajë amënore, t’i prek ata që kurrë nuk do të mund të vijnë. E para, janë porosinë e sajë të cilat përkthehen në të gjitha gjuhët dhe dërgohen me internet me datën 25 të çdo muaji, si ushqim shpirtëror I miliona njerëzve. Pastaj, janë misionet e vëguesve, sidomos të atyre që edhe më tutje kanë dëftime ditore (Maria, Ivani dhe Vicka) sepse Zoja i viziton kudo që shkojnë. Ata nuk kufizohen vetëm në Megjugorje. Nëpërmes të këtyre udhëtimeve ndërkombëtare të vëguesve, Zoja shkon në të gjitha vendet e botës. dhe për disa njerëz ai është takimi i parë me Qiellin!

Më kujtohet ngjarja në Shtëpinë familjare të lutjes, të vogël e të bukur në Craig Lodgeu në Skoci ku më thirri themeluesi, Calum MacFarlane, që të flas për Megjugorjen jo shumë kohë pas vizitës së Marisë. Afër fshatit gjendet Dalmaly, shemjtërorja e vjetër Mariane. Me gjenerata njerëzit nga Skocia ia kanë mësyre atij vendi që të luten dhe t’ia hapin zemrën Nënës së tyre qiellore. Marija Pavloviq pati idenë që në pasditën e vonë në atë vend të bekuar të lusë rruzaren. Mbretëresha e paqes iu dëftua si zakonisht në ora 18.40. Shoqja më tha më vonë: „Kurrë në shenjtërore nuk ka pasur dëftime, por, prej se Maria ishte këtu, në mënyrë diskrete është pasuruar me vizitën e Zojës dhe njerëzit janë më të gatshëm të vijnë.“

Në fillim të dëftimeve Zoja iu tha vëguesve: “Do të dëftohem në çdo shtëpi nëse është e nevojshme!” Prej atëherë shumë shtëpia në të gjitha kontinentet e botës nëpërmes të pranisë së vëguesve janë kënaqur me vizitat e sajë amënore. Në vitin 1988. Zoja zbuloi „bekimin e veçantë amënor“ të sajë i cili që atëherë shtrihet në mesin e besimtarëve. Ajo, nëpërmes të këtij bekimi, mundi të takohet me shumë fëmijë të sajë gjithandej nëpër botë, sepse ata që pranojnë atë bekim e shtrijnë më tutje. Ne bëhemi duart e sajë të shtrira dhe bartës të paqës në masën në të cilën përcjellim këtë bekim.⁷⁹

⁷⁹ Që ta kuptoni më mirë „bekimin e veçantë amënor“ dhe prejardhjen e tij, lexoni në librin „Mrekullia e Megjugorjes“ kapitujt: *Krijesat e tezes, Bekimi i heshtur, Satanisti në kodër, Kafeteritë në Como*

Posa e pranova këtë bekim, në të nëntëdhjetat e hershme në Krizhevac, me rastin e dëftimit që pati Maria (Pavllloviq), Zoja më dha disa shenja që të trimërohesh për ta shpërndarë lirisht. Nuk do ta harroj kurrë shenjën e parë. Një mbrëmje kisha në Megjugorje ishte përplot dhe që të tri kalimet në mes të bangave ishin të mbushura me njerëz. Ishin aq të ngjeshur sa kujtoja se as edhe një të vetëm nuk do ta zinte më në mesin e tyre. Qëndroja në gjysmën e kalimit të mesit, e shtypur, por e lumtur se isha pjesë e kësaj mase njerëzish prej të katër anëve të botës. Papritur ndjeva një lëvizje pas meje. Një njeri përpiquej t'i afrohej altarit, duke përparuar nga një centimetër dhe duke u përpjekur që të mos e shtyjë askë. Kur u afrua pranë meje dhe kur shikova fytyrën dhe figurën e tij, e pashë dukjen e varfërisë. E kisha të qartë se ai njeri për një kohë nuk kishte ngrënë si duhet. Dukej aq i vetmuar. Shikimi dhe dukja e tij ishin një kombinim dhëmbeje dhe i drite, drite të dikujt i cili është mësuar të vuaj me Jezusin dhe i cili tregonte shenjat e lavdisë së Tij.

Në atë çast zemra ime derdhte gjak për të dhe pyetesh se a do të mund t'i ndihmoja disi. Njeriu vazhdonte të lëvizte përpara. Kaloj pranë meje me sytë e ngulur në altar i cili, si duket, e tërhiqte. Pasi që i kaloj disa metra, më erdhi mendimi që t'i jap „bekimin e veçantë amënor“. Duhej të isha e koncentruar në meshë por nuk isha në gjendje. I mbylla sytë dhe me tërë qenien ia përcolla bekimin, duke thirrur mbi të, gjithë pasurinë nga thellësia zemrës së Marisë. Kur i hapa sytë, njeriu ishte ndalur dhe disa çaste qëndroi pa lëvizur. Pastaj u kthye dhe me shikim fillojë të kaloj mbi fytyrat e njerëzve pas tij, duke kërkuar dikë. Kur shikimi e tij erdhi tek unë, më buëqeshi nga shpirti dhe tha: “O, të falenderit, motër!” Pastaj me butësinë e njëjtë vazhdoi rrugën e tij drejt altarit dhe u zhduk nga horizonti im.

Prej asaj dite, Zoja ka arritur shumë në zemrën time! Tani, kur udhëtoj me tren ose aeroplan, organizohem ashtu që sa më shumë që është e mundur ta ndaj bekimin e veçantë amënor. Në terminalët e mëdhenj ndërkombëtar, psh., asistentja ime dhe unë, ose dikush tjetër me të cilin udhëtoj, i ndajmë hapësirat të cilat duhet t'i mbulojmë: „Në rregull, ti merr anën e djathë, kurse unë do ta marr të majtën!“ Atëherë, ngadalë fillojmë të bekojmë sa më shumë njerëz që të mundemi, duke filluar nga fëmijët. Kur na shohin se si ecim ngadalë, disa njerëz mund të mendojnë se nuk jemi mirë në mend, por kush mërzitët për këtë? Kjo nuk do të na ndaloj!

Si e merr guximin të më bekosh!

Pak kohë pas ngjarjes në kishën e shën. Jakobit, shoqja ime Karen nga SHBA më tregoi se çfarë i kishte ngjarë në Romë kur në stacionin hekurudhor nëntokësor priste trenin në vijën Termini-Vittorio Emmanuel:

“Një mbrëmje në vitin 1991., para mesnate prisja trenin e fundit. Stacioni ishte përplot njerëz pas mbylljes së teatrit, kafeterive, restoranteve, diskotekave dhe vendeve të ngjashme në atë pjesë të qytetit plot vrazhtësi. Treni duhet të vinte për një dhjetë minuta, prandaj, si zakonisht, fillova t'i bekoj njerëzit që me mua prisnin në stacion. Një nga një. Qëndroja në njërin skaj dhe vërejtn

ma tërhoqi një person në skajin tjetër të stacionit. Dukej si mishërim i mjerimit, skelet njeriu – mentalisht e çrregulluar ose planece, apo që të dyja bashkë. Fytyra e saj e shtrembëruar ishte dukja e së keqes. Fillova të lutem për të, duke lutur Zotin që ti japë bekimin e tij në mënyrë të veçantë. Saktësisht i thashë këto fjalë: ‘Zotëri, eja te ajo nëpërmes të bekimit të veçantë amënor të Nënës sonë.’”

“Posa përfundova me formësimin e këtyre fjalëve në mendjen time kur ajo grua para të gjithëve filloi të çirret duke bërëtitur nga ana tjetër e platformës: ‘Si e merr guximin të më bekosh!’ Pastaj kërcëu dhe filloi vrapimin e marrë nëpër platformë, duke treguar në mua dhe duke u kërcnuar: ‘Mjaft më! Pusho të më bekosh!’ Dukej si luan i tërbuar, i gatshëm për të shqyer plaçkën. Mbeta e qetë dhe vazhdova ta bekoj duke përsëritur të njëjtat fjalë.”

“Disa njerëz rreth meje më pyetën: ‘A e njihni këtë grua? Pse do të ju sulmoi?’”

“‘Mos u brengosni, lereni’, u përgjigja. ‘do të jetë në rregull!’”

“Ishte një platformë e gjatë por gruaja, lëvizte shpejt përkundër faktit se disa njerëz përpiqeshin ta ndalonin. Të gjithë njerëzit, në këtë dhe në platformën tjetër përballë, shikonin në të dhe pyeteshin se çfarë do të ndodh. Pashë se disa prej tyre ishin të tmerruar. Derisa afrohej, pështynte, mallkonte dhe ulërinte në mua si ujku i uritur në mes të natës. Nuk e di se çfarë do të më ndodhte po të mos më kishte ruajtur Zoja. Së paku pesë vetë më erdhën në ndihmë dhe u përpoqën të qetësojnë situatën, por forca e sajë ishte më e madhe se ajo njerëzore.”

“E dija se Zoti donte ta prekte me mëshirën e vet dhe, përkundër të gjithave, e përfundova bekimin, duke artikuluar fjalët një nga një. Kur e përfundova bekimin, tërbimi i sajë u qetësua dhe skena në mënyrë të jashtëzakonshme u kthye në normale. Dukej se ndodhi një lirim i thellë. Kur erdhi treni duke mbushur stacionin me zhurmën e tij, gruaja hyri në vagonin më të afërm dhe u ul sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Fytyra i ishte shndërruar. Tërbimi i kishte lëshuar vendin paqes. U ula në të njëjtin vagon dhe u shikuam si të ishim mikështa. Kur zbrita në stacionin tim, ajo vazhdoi – dhe kurrë më nuk e pashë.”⁸⁰

Besoj se Zoja atë mbrëmje e fitoi edhe një betejë të madhe me anën e bekimit të sajë amënor! Iu desht, që me çdo çmim, ta shtrëngoje atë fëmi të shkretë në zemrën e sajë amënore.

⁸⁰ Zakonisht njerëzit, që kanë qenë nën pushtetin e djallit, sëmuren kur lutemi për ta. Ndjenjat e tyre janë të shkaktuara nga ajo që armiku (zotëria i tyre) ndjen me rastin e takimit me Krishtin i cili e ka mundur në Kryq. Ata njerëz, shpesh, e njohin personin i cili lutet për ta, sepse djalli që i kontrollon ua tërheq vërejtjen.

“Edhe sonte, të dashur fëmijë, ju jam mirënjohës se jeni këtu. Adhuroni papushim Sakramentin Tejetshenjt të Altarit. Unë jam gjithmonë e pranishme kur besimtarët janë në adhurim. Atëherë fitohen hire të posaçme. ” (15. mars 1984.)

37

FEDERICO: FËMIU KATËRVJEÇAR DHE GJASHTË TUMORËT

Milano, nëntor 2004.

E copëtuat nga pikëllimi dhe ankthi, Sabina nuk dinte më se kah t'ia mbante. Tumorët e trurit së shpejti do të ja marrin Frederiko-n e sajë! Disa seri të rrezatimeve rraskapitëse dhe kimioterapive nuk ndërruan asgjë. Nga gjashtë tumorët malinj vetëm tre mund të operohen. Çdo përpjekje e mënjanimi të tyre me siguri do të shkaktonte lëndime të papërmirësueshme të trurit. Ekipi më i mirë i doktorëve të Institutit onkologjik të Milanos e përcillte rastin me kujdes. Nga perspektiva mjeksore nuk kishte shpresë.

Djaloshi ishte vetëm katër vjeç dhe dukej se po vyshket. Por edhe pse vuante nuk lejonte që shpirti t'i dobësohet. Në mes të epizodave të dhëmbjes i thoshte së ëmës me butësi dhe shikim të qartë: „Nënë, mos u mërzit, do të bëhet mirë!“ Sabina atëherë vraponte në banjo, i vetmi vend i sigurt ku mund të lejonte që të mbizotërojnë lotët dhe sulmet e dëshpërimit.

Sabina nuk ishte më besimtare dhe përpiquej që të qëndronte larg Kishës. Si do të thoshte Zoja, nuk e njihte dashurinë e Zotit. Ndërsa shoqja e sajë Laura, ishte anëtare e grupit të zjarrtë të lutjes në Milano. E muar Frederico-n në zemër, e vendosi në mbrojtje shpirtërore dhe filloi aksionin e lutjes për të. Nëntë ditë rrjesht njëri prej anëtarëve të grupit kalonte një orë para Sakramentit Tejetshenjt të Altarit, duke lutur Jezusin që ta shëroi dhe të sjell paqen në zemrën e së ëmës, e cila poashtu ishte e plagosur për shkak të shkurorëzimit nga i shoqi.

Në fund të nëntëshes, sëmundja përparonte pa mëshirë. Anëtarët e grupit të lutjes pyeteshin se a thua Jezusi ka të tjera plane me Frederico-n, të cilat plane, ndoshta, nuk e përfshijnë shërimin. Laura nuk ishte e dekurajuar. Kishte një plan tjetër: Meshtari misionar italian me shërbim në Brazil, atë Antonello¹⁸¹ qëndronte rastësisht disa ditë në Milano dhe organizoi meshën e shërimit në kishën e shën Ndout. Laura e ftoi Sabinën të vijë në meshë dhe të sjell voglushin. Sabina

⁸¹ Atë Antonello Cadeddu së bashku me atë Enrico Porcuo, ka themeluar në Brazil bashkësinë Lidhja e mëshirës. Web faqja: www.misericordia.com.br

ngurronte. Nuk mund të pranonte idenë e shkuarjes në kishë. Përfundimisht pranoi përkundër ndjenjave të sajë. Nuk kishte kurrfarë iluzionesh të mëdha. Nëse nuk e motivonin feja dhe shpresa, e motivonte dëshpërimi! “Çfarë mund të humb?”, mendonte. “Nëse nuk ndihmon, supozoj se, nuk dëmton.”

Që nga fillimi i meshës të dy meshtarë ishin simpatik për Sabinën. Përcillnin gëzimin dhe dukeshin të thjesht dhe të afrueshëm. Federico ishte i strukur në përqaftimin e sajë. Flente me një sy të mbyllur. Me syrin tjetër shikonte meshtarin i cili e bënte të qesh gjatë predikimit. Kur bashkësia qeshte, Federico qeshte edhe më shumë, megjithse nuk e dinte pse! Si në Megjugorje, atë Antonello pas meshë e ekspozoi Sakramentin Tejetshenjt të Altarit, duke udhëhequr bashkësinë në adhurim. Pastaj mori ostensorin dhe e barti në procesion nëpër kishën e mbushur përplot. Sytë e Federico-s e përcillnin meshtarin. Ai nuk mund të kuptonte pse sillej gjithandej dhe u tregonte njerëzve atë diell të mrekullueshëm floriri. Atë Antonello nuk ngutej, duke bekuar çdo pjesë të bashkësisë. Luste Jezusin që të prek çdo zemër dhe trup që ishte i pranishëm aty, pikërisht ashtu si bënte para dy mijë vitesh në mes të turmës që shtyhej rreth Tij. Kur iu afrua Sabinës, e vërejti voglushin në përqaftimin e nënës, të dobët dhe pa flokë. U afrua, e bekoj fëmion dhe vuri ostensorin në ballin e tij.

Sabina nuk do ta harroi kurrë atë çast. Nuk kuptonte asgjë nga ato që po ndodhnin. Federico u rrëzua sikur ta godiste rrufeja. I shtrirë në dysheme. Në panik u përkuq që ta ngrisë vogëlushin. Por kur ia futi dorën nën kokë, kuptoi se ai po flinte i qetë. Vendosi që ta lër të flej edhe më tutje gjatë kohës së adhurimit.

Pas një kohe, kur procesioni përfundoi, atë Antonello filloi këngën që këndohet në fund të adhurimit. Djaloshi u zgjua, hapi sytë dhe tha: “Nënë, ai meshtar është qesharak! Më djeg aty ku më ka prekur! Nënë, kam zjarr në kokë!”

Sabina në fillim nuk u kushtoi kujdes fjalëve të fëmion, por filloi të mendoj kur ai përsëriti të njëjtën gjë disa herë gjatë natës dhe të nesërmen: “Nënë, më digjet koka! Kam zjarr në kokë!” Sabina u frigua. Federico e trimëronte duke thënë, “Nuk dhemb, vetëm është e çuditshme.”

Së shpejti caktoi vizitën në Institut. I bënë fotografitë e reja. Radiologu studjonte fotografitë, duke lëvizur syzet disa herë. U kthye drejt Sabinës. Ajo vërejti se ishte plotësisht i zbehtë në fytyrë! Sabina përgatitej për më të keqen.

“Sabina, çfarë keni bërë? Kush e ka operuar birin tuaj?”

“Doktor, ai nuk ka qenë në operacion.”

“Sabina! Fëmion ka pasë operacion, kjo është e qartë!”

“Doktor, të betohem...”

“Ejani, shikoni! Shikoni vetë!”

Fotografitë tregonin qartë se të gjashtë tumorët ishin zhdukur! Por jo pa gjurmë. Atje ku gjëndej secili tumor ishte një vrragë e dukshme me gjurmët e të qepurit, duke vërtetuar kështu se është operuar nga një kirurg shumë i shkathët. Madje ishin mënjeluar edhe tre tumorët për të cilët ishte konstatuar se nuk mund të operohen për shkak të indit tepër të butë i cili nuk do të mund të përballonte qepjen.

Brenda disa sekondash, Sabina kujtoi edhe një herë fjalët e Frederiko-s të thëna gjatë 48 orëve të fundit, pas bekimit të meshtarit: „Nënë, koka po më digjet! Kam zjarr në kokë!” Më në fund e kishte të qartë. Doktorët mund të mendojnë çfarë të duan! Sa i takon asajë, s'ka dyshim. Kirurgu ishte Jezusi. Krijuesi i sajë ishte më i mrekullueshmi i të gjithë kirurgëve!

Sot Federico është gjashtë vjeç. Luan, vrapon, kërcen. Bën gabimet që i bëjnë shumica e djelmoshave të moshës së tij. Është në formë të plotë. Jezusi e kishte prekur prej hostes së vet të vogël e të bardhë në mesin e „diellit të floririt“. Sa i takon Sabinës, lotët e sajë të pikëllimit u ndërruan me lotët e gëzimit!

“E kam ndjerë Jezusin e gjallë”, thotë. “E kam ndjerë se është me ne dhe që e shëroi birin tim. Tani, falenderoj Zotin çdo ditë për Federico-n të cilit i është këthyer e gjithë forca. Është plot gëzim dhe jetë! Çdo ditë shikon qiellin dhe me duart e tij të vockla i dërgon të puthura Jezusit, si të kishin qenë gjithmonë miqtë më të mirë! Jezusi është miku i tij më i mirë. Edhe unë e falenderoj Jezusin, Zotit Atë dhe Shpirtit Shenjt për durimin e pafund që kishin me mua. Lejuan të ndodh ky tundim i dhëmbëshëm që përfundimisht të kuptoj se Ata janë pranë nesh dhe se *ne* jemi Kisha! E kemi për detyrë që njerëzimin ta mbajmë të bashkuar në Dashurinë e Zotit!”

“Të dashur fëmijë! E ftoj secilin prej jush që të miqësohet me engjëllin e tij rojtës. Kërkoni prej tij që të ju ndihmoi.” (Marisë, nëntor 1987.)

38

ENGJËJT E BETLEHEMIT

Engjëjt nuk kanë punë sa duhet! Njerëzit, miqët e tyre, as nuk mund ta marrin me mend se sa të mira dëshirojnë të ju sjellin engjëjt. Nganjëherë, në situata problematike, u lutem me zjarr dhe e befasuar nga favorët e marra, i premtoj vetes se në të ardhmen do t'i angazhoj edhe më shumë në jetën e përditshme.

Një ditë duhej të flisja për Megjugorjen në një kishë ku priteshin rreth dy mijë vetë. Ndjenjat e mia ishin një përzierje në mes të gëzimit për shkak të përcjelljes së porosive të Zojës dhe një frike të caktuar para atij publiku për të cilin e dija se rrallë qeshet në tentativat e mia që të jem argëtuese. Isha e brengosur se do ta humb entuziazmin qysh në pesë minutat e para dhe se do të ndjehem në siklet pastaj.

Atëherë m'u kujtuan engjëjt dhe më erdhi ideja që të thërras në ndihmë korin e engjujve të Betlehemit. Çdo gjë që është e lidhur me ta ishte përsosmërisht e përshtatshme për situatën time: Vetë numri i tyre, gëzimi dhe fakti se kanë qenë bartës të lajmeve të mira. Prandaj ju propozova këtë: „E dini situatën prandaj ju lutem që të qëndroni pranë çdo personi dhe ta mbushni kishën. Largoni çdo ngarkesë! Gjatë fjalës sime sjellni gëzimin me shumicë ashtu që klima të jetë e lehtë dhe porosinë të arrijnë drejt e në zemër të çdo personi.“

Disa përshtatje të mikrofonit dhe ia fillova. Se çfarë befasie ishte të shohësh se si papritmas gëzimi i shndëriti të gjitha fytyrat. Çfarë trimërimi! Por, befasia ime u dyfishua, kur filluan të qeshin edhe pse nuk kisha thënë asgjë qesharake. Pas njëzet minutash i gjithë tubimi qeshej aq shumë dhe gëzimi ishte aq i pranishëm sa m'u desht t'i pëshpëris një grupi të vogël engjujsh: „Të dashur engjuj, në rregull është, shpërndani frymën e vërtetë të gëzimit dhe ju falemnderit! Por... Nëse ata vazhdojnë të qeshin kështu, unë nuk do të mund të vazhdoj! Ju lutem, a mund t'i qetësoni pak që të ju përcjell porosinë në një atmosferë më të qetë?“

Ishte një mbrëmje për ta mbajtur mend, engjëjt më habitën edhe një herë. Qielli na ofron një çels të mrekullueshëm në rastet kur atmosfera është e rëndë. Lutni engjëjt e Betlehemit. Më besoni, kanë një ndjenjë të këndshme humori. Mos u lejoni të jenë të papunë.

Protestantja Sylvie

Duke folur për engjëjt, kisha rastin t'i provoj në një vend të dashur për zemrat e tyre ku kisha hirin të jetoj me Bashkësinë time më shumë se tri vjet – në Nazaret. Në fillim, ne, katër motra ishim të vendosura në një shtëpi të vogël tri dhomëshe ku përjetova disa nga çastet më të bukura të jetës sime. Ishte një jetë e fshehur, e përshtatshme për çfaqjen e miqëve tanë të padukshëm.

Me ne ishte edhe Sylvie, motër me të kaluar protestante. Me që para pak kohësh ishte këthyer në katolicizëm, në jetën e vet ende nuk e kishte kyçur gjithë pasurinë e fesë sonë. Për shembull, kurrsesi ajo nuk mund t'u lutej engjëjve. “Protestantët nuk u drejtojnë lutje engjujve”, thoshte. Faktikisht ajo dyshonte në vlefshmërinë e asaj praktike.

Derisa unë flisja për avanturat që kisha pasur me engjëllin tim rojtës, duke theksuar se sa ndihmë kisha marrë prej tij, Sylvie merrej me dyshimet e saja. Me që hetimet e saja bëheshin përherë e më kritike, vendosi që, një herë e mirë, të marrë përgjigje. Dhe kështu një ditë bëri një eksperiment. Fshehurazi i drejtoi engjëllit tim rojtës këtë kërkesë: „Nëse vërtetë je aq i fortë si pohon motra Emanuel, atëherë shko e thuaj diçka në emrin tim. Nëse shoh se e ka kuptuar porosinë tënde, atëherë do të besoj se vërtetë është e mundur të lutësh engjëjt. ” (Porosia ishte kritika të cilin nuk merrte guximin të ma thoshte me fjalë.)

Ashtu ishte lutur në mëngjes para se të shkoja në spitalin italian ku punoja gjysmën e kohës së punës. U takuam përsëri në kohën e drekës. Më kujtohet si të ishte dje. E hapa derën dhe para se të përshëndesja motrat thashë: “Nuk do t'ia qëllosh kurrë se çfarë më tha Zotëria sot në mëngjes në spital! ”

“Çfarë tha?”

“Më tha...” Dhe këtu përsërita fjalë për fjalë porosinë që Sylvie i kishte dhënë engjëllit tim rojtës!

Ajo atëherë nuk e zbuloi „eksperimentin e fshehtë” që kishte bërë me mua, por pas një kohe kuptova se u lutet engjëjve me zjarrin tipik për protestantët e dikurshëm. Ishte e lumtur që aq shumë e kishte rritur numrin e miqëve në Mbretërinë e Qiellit! Vetëm pas një viti ishte në gjendje që të ma shpjegoj tërë tregimin! Atë ditë ajo përjetoi një shok të fortë dhe prej atëherë u bë njëra prej punëdhënëseve më të mira të engjujve që njoh!

Prit, vërtetë do të befasohesh!

Pas një kohe Sylvie dhe unë ishim të ftuara që të dëshmojmë në kuvendin e klarisave pranë Nazaretit. Motrat kishin ftuar të gjithë bëmirsit e tyre, miqët dhe anëtarët e familjeve, në hajatin kryesor. Kur arritëm, pamë se njerëzit, tanimë, kishin ardhur dhe po bisedonin me zë të lartë. Sylvie më shikoi, e befasuar.

Si do ta përcjellim porosinë tonë në këtë atmosferë? Askush s'ishte i përgatitur! Zemrat nuk hapen në atë kakofoni! Atëherë Sylvie qeshi me çapkenllëk dhe më pëshpëriti në vesh : “Prit, vërtetë do të befashesh!” Pastaj më ftoi në këndin e dhomës. Atje, me shpindë të këthyer kah turma, me gëzim të dukshëm, ma besoi planin e sajë.

“Muret janë nga betoni, që nuk është mirë për akustikën, madje edhe nëse provojmë t'i qetësojmë njerëzit. Armikun duhet sulmuar nga lart dhe duhet kërkuar pak ndihmë qiellore.“ E zgjaste përshkrimin e planit të vet të shkëlqyer për të ma zvogëluar durimin. “Ja, pra, plani. Do të mbajmë mbledhjen e engjëjve. Do të kërkojmë prej engjëjve rojtës të të gjithë njerëzve këtu që të bisedojnë me të mbrojturit e tyre dhe t'i qetësojnë. Në rregull?”

“Ide e shkëlqyer!” u përgjigja e entuziazmuar.

Dhe kështu, me sy të mbyllur, të zhytura në uratë të shkurtë por të zjarrtë, fshehtasi, i lutëm engjëjt që të sjellin qetësinë. Efekti ishte i mahnitshëm. Kaluan vetëm disa sekonda dhe e gjithë zhurma, pa ndonjë arësye të dukshme heshti, e hapësirën e mbuloi një qetësi e përkryer. Mund të dëgjoje rënjen e gjilpërës në tokë. Akush më nuk kishte diçka për të thënë, të gjitha grupet e vogla u shpërndanë natyrshëm dhe të gjithë, në mënyrë të përvuajt, morën një qëndrim kujdesi. Sylvie dhe unë mbetëm pa fjalë. Ishim të hutuara me shpejtësinë me të cilën na u dëgjuan lutjet.

“Ju falemnderit, të dashur engjuj! Tani mund të flasim për Zotin!”

Dhe atë ditë, gjaku protestant i Sylvie muar një injekcion të mirë të fesë katolike!

Ah, për pak të harroj! Sylvie është artiste shumë e talentuar. Arti i sajë lulëzoi kur ishim në Nazaret, ku mësoi të punoi ikonat. Nëse sot shikoni pikturat e sajë, afreskat dhe tapisëritë, në to do të gjeni engjëjt, engjëjt dhe prap engjëjt. Kjo ishte për t'u prituri: engjëjt tani e njohin shumë mirë; e dinë përmendësh adresën e sajë sepse e kanë vizituar atje shpesh herë!

“Të dashur fëmijë! I falenderoj të gjithë që këtë vit kanë ardhur këtu në një numër kaq të madh përkundër borës, akullit dhe motit të lig që ti luten Jezusit. Vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në vuajtjet e juaja. Ju e dini mirë se kur miku ju kërkon diçka ju ia jepni. Është njësoj me Jezusin. Kur luteni pa pushim dhe vini përkundër lodhjes, çfarëdo të kërkonit prej Tij, ua jep.”

(1. dhjetor 1983.)

39

KATASTROFA ME TRËNDAFILAT

Krahasimi

Ishte e shtunë. Elaine priste vëllezërit dhe motrat që të vijnë nga të katër anët e Francës në festimin e ditëlindjes së nënës së tyre. Donin ta befasonin si kurrë më parë dhe ta llastojnë me dashurinë e tyre. Elaine ishte e ngarkuar për lulet. Kishte vërejtur se e ëma i kishte pikë të dobët trëndafilat, sidomos ato me ngjyrë të verdhë të ndritshme, që vështirë gjëndeshin. E dinte se ku duhet shkuar sepse e kishte vërejtur shitoren e luleve që kishte pikërisht atë që kjo kërkonte. Natyrisht se trëndafilat e tillë të veçantë ishin shumë të shtrenjtë, por Elaine nuk donte të rrudhte dorën!

Zemra i kërcente nga gëzimi kur mendonte se do ta bënte nënën të lumtur. Kjo mbrëmje do ta gëzonte zemrën e nënës së sajë e cila kishte punuar gjithë ato vite, për fëmijët e sajë, pa asnjë vërejtje.

Elaine mori çelsat e makinës dhe iku jashtë 'për të tregtuar'. Nëna nuk dyshonte asgjë. Për fat të keq, karburatori ishte prishur dhe makina duk mund të lëvizte. Elaine nuk kishte zgjedhje pos të shkonte me autobus që kërkonte kohë dy herë më shumë. Kur më në fund arriti në qendrën tregtare luksoze në mes të Parisit, u drejtua kah shitorja e sajë e dashur e luleve ku gjeti mbishkrimin: „E mbyllur për shkak të regjistrimit vjetor“! Mendimi se po i rrenohen planet bëri që të ndjejë goglushen në fyt. Mendonte: “Ku do të mund t'i gjeja ato trëndafila të bukur? Nuk kishte kohë për të humbur!”

U ngut drejt rrugës Rivoli drejt një dyqani tjetër, të furnizuar mirë, por ishte tepër vonë! Një hotel posa i kishte zbrazur të gjitha rezervat e tij! Elaine filloi të ndjejë dobësinë, por nuk dorëzohej. Mbeti vetëm një shpresë e vogël. U kujtua për një shitore tjetër, pranë stacionit të sajë të autobusit e cila gjithmonë kishte trëndafila të freskët. Natyrisht, nuk ishin trëndafilat që ajo kërkonte, por duke u afruar, pa se kishin trëndafila ngjyrë fildishi, që do të ishte mjaft mirë. Nëna e sajë mbushte 81., vjet të jetës dhe bleu 18 trëndafila. Po ashtu në tortë do të duhej të ishin 18 qirinj sepse fëmijët ishin marrë vesh që t'i ndërrojnë numrat dhe ta bëjnë festën në temën e numrit “18” dhe me këtë ta përkujtojnë në rininë e sajë.

Elaine dual prej shitores me trëndafilat e mbështjellur me një letër të kaltër, të bukur me yje. Frustrimi i sajë i brendëshëm u qetësua. Derisa shkonte drejt stacionit të autobvuseve, u lshua një shtrëngatë mbi qytetin, dhe një rrebesh shiu i papritur, për një çast e shndërroi në një macë të shkretë të lagur!. Për sa i përket tufës së luleve, letra u fry dhe u ngjit për trëndafilat. Ishte një pamje e dhimbëshme!

Në autobus disponimi i Elaine ra fare poshtë, por nuk u dekurajua. Në stacionin e ardhshëm në autobus hynë tri herë më shumë udhëtarë se zakonisht dhe të gjithë ndjeheshin si sardelet në konservë. Për më keq, një grua e madhe, që qëndronte pranë Elaine, e humbi drejtpeshimin në një kthesë dhe me gjithë peshën ra mbi tufën! Çfarë katastrofe! Gjysma e tyre u prish. Lulet u lakuan. “Çfarë të bëj tani?”, pyetej Elaine. “Po afrohet koha e darkës dhe vëllezërit e motrat e mia ka të ngjarë se më presin në shtëpi! Më duhet të këthehem sa më parë. Por si mund të shkoj në shtëpi me këtë katastrofë në duar?”

Pikëllimi ia kaploi zemrën. Donte ta bënte të lumtur nënën, por e gjitha që mund të ofronte ishin shtatë-tetë trëndafila të bardhë – madje jo të verdhë – të ciët i shpëtuan masakrës! Elaine e deprimuar zbriti nga autobusi. Duhej të kalonte edhe disa qindra metra deri në shtëpi. Ngutej nëpër trotuar pranë një pellgu uji të turbullt të mbledhur pas rrebeshit, mbi një pusëtë të mbyllur. Si të mos ishte e gjitha kjo e mjaftueshme, ndihma e shpejtë, në shpejtësi të plotë, me sirenë e drita sinjalizuese të ndezura, duke dalur nga këthesa, kaloi pikërisht mbi pellgun! E stërpiku nga koka tek thembrat! Kjo ishte, vërtetë, kremi mbi tortë! I erdhi që të bërtasë. Lulet dukeshin si të kishin rënë në komë të thellë! Ngjyra e tyre u shndërrua në të hirtë të ndotur me vaj motorri dhe me materje qeni që nuk duhet përmendur. Zemrën e kishte të thyer. Mendoi: “A thua nënës sonte nuk do t'i mbetet asnjë lule?”

Derisa provonte të shpëtonte atë që kishte mbetur nga trëndafilat, gjeti një e cila kishte mbijetuar të gjitha fatëkeqësitë dhe traumat e aventurës së sajë epike. Sa shumë ishte gëzuar befasisë që i përgatiste së ëmës me tufën e mrekullueshme! Pyetej se çfarë do të jetë argëtimi pas këso lloj dite.

Kavana

Gjuha Hebraike ka një fjalë madhështore - *kavana* – që mund të përkthehet si „qëllimi i zemrës“. Ai që në lutje ka *kavana* për Zotin, vërtetë lutet. Ai që aktin e vet të mëshirës e bën me *kavana*, vërtetë vepron nga dashuria. Zoti shikon zemrën, dhe jo në prshtypjen e suksesit. “Unë, Zoti, shqyrtoj zemrën, sprovovj veshkat.”⁸² Ai i di dëshirat më të thella që na motivojnë dhe kjo është e gjitha që i intereson. Në krahasimin me trëndafilat, Elaine është e mbushur me dëshirën e madhe që ta kënaq nënën sepse e do dhe bën çfarë është në mundësinë e sajë që t'ia plotësoi atë dëshirë. Ka *kavana* të mirë– e ka drejtuar timonin e zemrës së sajë në drejtimin e dashurisë dhe qëndron me guxim përkundër pengesave në rrugë. Bota shikon rezultatet, efikasitetin, suksesin dhe

⁸² Jer 17,10

profitin. Gjykuar sipas dukjes së tufës së sajë, Elaine dështoi! Por në sytë e Zotit, ato lule janë shumë më të bukura se ato që ka ëndërruar se do të ia sjell nënës. Për më tepër, kjo bukuri do të jetojë gjithmonë sepse dashuria kurrë nuk vdes. Dashuria e vërtetë jep fryt i cili jeton gjithmonë. Njësoj është edhe me lutjen. Të lutësh me zemër do të thotë të bësh atë që Elaine ka bërë. Deshti të dojë dhe mori vendim që të dojë duke ofruar dhuratën. Atëherë investoi kohën, të hollat, vlerësimet, zemrën dhe gjithë forcën e vet njerëzore që të ketë sukses. E ballafaquar me fatkeqësi, qëndroi pa u dëshpëruar. Mundi që të heqë dorë disa herë nga projekti i sajë, por *kavana* e sajë ishte më e fortë. Busolla e sajë nuk u lëkund. Të dashurosh do të thotë të duash të dashurosh dhe të vazhdosh të dashurosh kur duket se çdo gjë po shkatërrohet. Të lutesh do të thotë të duash të lutesh. Kjo do të thotë të vazhdosh të lutesh me çdo çmim, sidomos kur sulmet e erërave të kundërta, të brendshme dhe të jashtme, përpiqen që mundin tënd ta redukojnë në zero.

Kur ishte fëmi, Virgjëra Mari i ka dëgjuar rabinët duke komentuar Torën dhe duke cituar Etërit e fesë. Mund ta marrim me mend se si gëlltit çdo fjalë e cila do të mund ta mësoi se si ta njohë Zotin, rrugët e tij dhe atë që zemra e tij pret nga populli i vet, Izraeli. Është e jashtëzakonshme të shohësh se si disa prej porosive të Marisë nga Megjugorja përsërisin mësimet sekulare të Talmudit ose të disa librave të tjerë tradicionale si Mishna!

Në ndërkohë Zoja ka vendosur programin priorësh të lutjeve të cilit françeskanët i përmbahen me kujdes. Programi përmban një orë lutje të rruzares, pas të cilës vazhdojnë litanitë e Virgjërës Mari dhe himni Shpirtit Shenjt. Pastaj një orë për meshën dhe një orë falenderimi Jezusit. Qëllimi i kësaj ore të fundit është që të evitohet ndërprerja e shpejtë e *kavana*-s pas kulminacionit të të gjitha lutjeve: bashkimit intim të shpirtërave tanë me Zotin tonë në Eukaristi. Hasidim-ët e parë (që konsiderohen ‘karizmatikët’ e parë të Hebrejve në shek. 15.) kishin praktikë shumë të ngjajshme. Prisnin një orë para lutjeve dhe një orë pas tyre që të siguronin se kanë arritur *kavana*-n, dhe që të jenë të sigurtë se lutjen do ta përfundojnë duke e zgjatur qëllimin zemrës drejt Zotit. Maimonides, rabini i famshëm hebre ka thënë “meqë lutja pa *kavana* nuk është lutje, ai që lutet pa *kavana* duhet të lutet përsëri me *kavana*. Ai që është i shqetësuar, i zhytur në brenga ose dikush që posa është këthyer nga rruga, nuk do duhej të lutet deri sa të jetë në gjendje të përqëndrohet që është kusht për *kavana*. *Kavana* e vërtetë nënkupton se personi është i lirë nga çdo mendim i jashtëm dhe plotësisht i vetëdijshëm se është në praninë e Zotit.” (Yad. Tefillah 4:15,6). Shulhan Arukh (shqiptohet ‘shulran arur’) pohon më tutje se “lutja më e shkurtë me *kavana* vlen shumë më tepër se shumë lutje pa *kavana*” (OH 1:4).

Zoja na thotë që „*të lejojmë që lutja të na dalë nga zemra*“ “*Është më mirë të thuhet një Ati ynë me zemër se njëqind pa zemër.*” Por, njeriu modern e ka të vështirë ta mbledh zemrën dhe ta unifikoi, e të mos lejoj të përzihen brengat njerëzore. Kemi një zemër “palagaqesh” që kërcejnë gjithandej të shpërndara! Falemnderit Zotit se *kavana* nuk nënkupton mungesën totale të

shqetësimi – që e kishin edhe shenjtërit tanë më të mëdhenj.⁸³ Në vend të kësajë ajo nënkupton lirinë e caktuar në raport me të dhe dëshirën e sinqertë për lutje, pavarësisht nga çmimi.⁸⁴

⁸³ Pjesa në vazhdim nga Ditari i motrës Faustina Kowalska është ilustrim i mirë për *kavana*, madje edhe në mes të thatësisë së ndjenjave: “E enjte. Sot, edhe pse shumë e lodhur vendosa të mbaj orën Shenjte. Nuk mund të lutesha, nuk mund të rrija në gjunj, poashtu, por qëndrova plot një orë në lutje dhe u lidha në shpirt me ata shpirtëra të cilët në mënyrë më të përsosur lavdërojnë Zotin. Kur u bë një orë, papritur pashë Jezusin. Ai më shikoi thellë me një mirësi të papërshkrueshme dhe tha: ‘*Lutja jote më është shumë e dashur*’. – Pas atyre fjalëve erdhi në shpirtin tim një fuqi e çuditshme dhe gëzim shpirtëror. Prania e Zotit e përshkoi deri në fund shpirtin tim. O, çfarë ndodh me shpirtin i cili takohet sy më sy me Zotërinë, asnjë pendë nuk e ka përshkruar as nuk do ta përshkruaj...” (Ditari §691.)

⁸⁴ Vëguesi Ivan kështu i ka përgjegjur shtegtarit i cili e ka pyetur si të lutësh me zemër: “Lutjen duhet filluar me hapin e duhur. Kur thërrisni dikë me telefon, duhet të ngritni receptorin, të prisni tingullin, të zgjidhni numrin, etj. Përndryshe asgjë nuk do të ndodh. Është njësoj biseda me Zotin. Duhet të kalojmë të gjithë hapat e domosdoshëm që zemrën ta sjellim në gjendjen e duhur për thirrje dhe dëgjësë, e pastaj edhe në gjendjen e kujdesit ndaj pranisë së Zotit.”

„Të dashur fëmijë! Sot shikoj zemrat tuaja dhe duke i shikuar, zemra ime shtrëngohet nga dhëmbja. Fëmijët e mi! Kërkoj prej jush dashuri të pakushte dhe të pastër ndaj Zotit. Do ta dini se jeni në rrugë të duhur kur me trup të jeni në tokë kurse me shpirt gjithmonë me Zotin. Nëpërmes të asaj dashurie të pakushte dhe të pastër në çdo njeri do të shihni Birin tim. Do të ndjeni bashkësi në Zotin. Unë, si nënë, do të jem e lumtur sepse do t'i kem zemrat tuaja të shenjta dhe të bashkuara. Fëmijët e mi, do ta kem shpëtimin tuaj. Ju falemnderit!“ (Mirjanës, 2. Gusht 2007.)

40

NUK KE KOHË PËR LUTJE?

Fra Jozo Zovko në vitin 2006., në kuvendin në Shiroki Brijeg pranoi një grup shtegtarësh amerikanë dhe me atë rast ju tha:

„Në familjet tuaja është shkretëtirë. Nuk ka ujë. Keni të drejtat e njeriut. Keni vende pune, shumë prej jush janë të pasur, por nuk keni bekimin e Zotit. Pse familjet tuaja janë të thyera shpirtërisht, pse vuajnë? Sepse nuk ka gëzim. Prej nga kjo shkretëtirë, pse thatësira e madhe?“

Dhe vazhdoi: „Shkretëtira ka lindur atë çast kur keni thënë se nuk keni kohë për lutje, prandaj drita në familjet tuaja është fikur!“

Vetëm sikur ta shihnit orarin tim!

Shpesh dëgjoj se si flasin njerëzit: „Po, motër, pajtohem se lutja është e rëndësishme, por ne e kemi aq ta vështirë të gjejmë kohën për lutjen e përbashkët. Të gjithë jemi nën presion të vazhdueshëm.“

Ja si do të na përgjigjej fra Slavko ynë: „Më parë do të mund të thuhej se kemi të bëjmë me dashurinë! Kur duam, gjejmë mënyra, kur nuk duam, gjejmë arsytimit!“

Kur flasim për lutjen, gjithmonë më kujtohet atë Michel, meshtar i famullisë së madhe parisienne. Kur erdhi një herë në Megjugorje në shtegtim, më pyeti se cilat porosi të veçanta ka dhënë Zoja për meshtarët. Ia thashë disa duke shtuar: „Zoja poashtu kërkon nga meshtarët që t'i jetojnë të gjitha porositë e sajë, sidomos atë të rruzares së përditshme.“

„Të gjithë meshtarët le t'i lusin të tri misteret çdo ditë,“ tha. Por atë Michel kundërshtoi menjëherë: „Motër, si mund të kërkosh nga unë diçka të tillë! Nuk mundem! Është e pamundur! Vetëm sikur ta shihnit orarin tim!“

“Atë, unë nuk e kërkoj këtë prej jush. Nëna e Zotit e kërkon!”

„E pamundur!“- vërtetoi. „Mirë, atë, ndoshta inë jam gabim. Ndoshta Zoja ka thënë, në të vërtetë: „Të gjithë meshtarët le t'i lusin të tri mistert çdo ditë, përveç atë Michel sepse është shumë i zënë!“

Memzi buzëqeshi pak, e me qëllimin që t'i ndihmoja propozova: „Në rregull, atë, kam një ide! Pse nuk provoni dy-tri javë? Megjithatë, këtë ua thotë Nëna e Zotit, Nëna juaj. Shpresoj se nuk do ta injoroni apo jo? Pra, para se ta refuzoni lutjen e sajë, së paku provoni! Vetëm kur të shihni se jeta po u bëhet e padurueshme, mendoni përsëri.“

Atë Michel premtoi se do të provoi. Dy vjet më vonë e takova përsëri në Megjugorje me një grup shtegtarësh. E pyeta, pak me frikë: „Përhëndetje, atë! Si shkon me rruzaren?“

Duke rrezatuar nga gëzimi, ngriti pëlqerët dhe tha: „Funksionon!“ Unë ia këtheva: „Fantastike! Më thoni diçka më shumë!”

“Pra, motër, unë iu përmbajta marrëveshjes sonë. Posa u këtheva në Paris, e gjeta kohën për rruzare. Mbrëmjen e parë ndjeva një paqe të pazakontë. Një ditë më pas, jo vetëm që isha i qetë por, papritur, pata kohë edhe për të lexuar diçka para gjumit. Ditën e tretë ndjeva të njëjtën paqe dhe kisha aq kohë sa munda të kryej edhe punë të tjera. Si kalonin ditët, u binda se vërtetë, Zoja po më prin duke mi hapur të gjitha dyert dhe duke më përgatitur për kryerjen e punës sime. Nuk isha më i vetmuar, me mua ishte përcjellësja mrekullibërëse që punonte me mua dhe e cila më udhëhiqte. Tani ndjej paqe të thellë, dhe pjestarët e famullisë nuk i lë më pas dore si dikur. Në thelb, tani, jam meshtar shumë më i lumtur.“

Atë Michel nuk është përjashtim. Kur njeriu përfundon se nuk ka kohë për lutje, llogarit gabimisht! Pse? Kur Zoja na sheh të bashkuar në lutje duke marrë hire, zemra e sajë amënore kërcen nga gëzimi. Për këtë shkak, ajo na e këthen duke ecur para nesh dhe duke na i hapur dyert të cilat duhet të na hapen. Drejton mendimet dhe zgjedhjet tona dhe ndihmon që të evitojmë shumë gabime. Thjesht, na ndihmon që të kursejmë kohën, dhe kjo është shumë më tepër se koha që shpenzojmë në lutje!

Prandaj, nëse ende keni guximin të më thoni se nuk keni kohë për lutje në familjet tuaja, mos u befasoni me përgjegjen time: „Nëse nuk keni kohë për lutje, lutuni, dhe do të keni kohë!“

„Të dashur fëmijë! Lutuni, sepse në lutje secili prej jush do të mund të arrijë dashurinë e plotë.“
(25. tetor 1987.)

41

TRI NIVELE TË LUTJES

Vendin tim të vogël, privat, e kam zgjedhur në barë, pas shkurre, jo larg nga kryqi i drunjtë në Kodrën e dëftimit përballë pllakës së bronzit që paraqet lindjen e Jezusit. Kryqi në atë vend paraqet atë që veguesja Maria ka parë më 26. qershor të vitit 1981. Ishte dita e tretë e fillimit të dëftimeve në Megjugorje. Kur Maria, pas dëftimit të Zojës, në ora 18.40, u nis për në shtëpi, Zoja ju dëftua për të dytën herë, vetëm asaj. Sipas dëshmisë së Marisë, Zoja qëndroi para kryqit të drunjtë duke qarë. Lotët i rridhnin nëpër faqe dhe fustan dhe zhdukeshin në takim me tokën. Zoja tha: *„Paqja e botës është në rrezik.“*⁸⁵

Strehimorja ime e vogël ishte e larguar nga ai kryq aq sa mund të gjuhet guri, sepse, si e ka shpjeguar Maria, vendi i vërtetë i dëftimit nuk ishte në shtegun e sotëm.⁸⁶

Kështu, çdo herë kur më duhet që vetëm të bisedoj me Nënë time Qiellore, vij këtu, në mes të gurëve dhe manaferrave sepse ajo e ka vizituar këtë vend dhe e ka ujitur me lotët e sajë.

Një ditë më lajmëruan se do të më duhet të mbaj një ligjëratë në konferencën Mariane në SHBA . Zoja na ka mësuar aq shumë për lutjen! Nuk dija se cilin margaritar të zgjedhja nga arka e madhe e porosive! Si do të mund t'i njoh, saktësisht, nevojat e brendshme të njerëzve të cilët kurrë nuk i kisha takuar? E ballafaquar me këtë problem, u nisa drejt kodrës që ta pyes Nënë time Qiellore. E strukur në mes të gurëve të strehimores sime të vogël dhe e bekuar me erën e fortë të zhumbicës së egër (*Thymus serpyllum*) ia hapa zemrën dhe thashë: „Do t'ua përcjell çfarëdo që të më frymëzosh t'u them. Topi është në anën tënde të terrenit, e dashur Nënë!“

Nuk pata fjalë të brendshme, vizion as dëftim. Në të vërtetë, as nuk kam pasur ndonjëherë. (Po ruhem për në Qiell!) Por ajo që në shpirti më erdhi ishte një farë lloj qasjeje që nuk jam në gjendje ta përshkruaj, por disi fillova të kuptoj një pjesë të vogël të „*Lutuni, lutuni, lutuni.*“ të sajë. Kjo ishte përgjigja amënore e Nënës për konferencën.

Kuptova se ekzistojnë tri nivele të thellësisë së lutjes. Detyra ime ishte që t'i ftoj dëgjuesit të zbulojnë më të thellin nga ato nivele. Me fjalë të tjera, duhej të zbulonin të gjitha mundësitë e

⁸⁵ „Paqa e botës është në rrezik! Paqe, paqe, paqe dhe vetëm paqe! Paqa duhet të mbretërojë në mes njerëzve dhe në mes të qiellit dhe njerëzve! Që të jetë kjo e mundur, duhet të besoni, të luteni, agjëroni dhe të rrëfëheni!“

⁸⁶ Maria atëherë nuk kthehej në shtëpi me të tjerët sepse shtëpia e sajë ishte mu në rrëzë të kodrës. Atë ditë ajo kishte shfrytëzuar një shkurtores.

lutjes së tyre dhe të fillojnë ta jetojnë atë, me shpresë se një ditë do ta prekin dhe do ta arrijnë nivelin më të lartë të shenjtërisë që Zoti ia ka dedikuar secilit prej nesh.

Pastaj, kuptova se në zemrën amënore të Marisë zhvillohet një dramë, saktësisht, një tragjedi. Ajo, qartë, sheh nivelin e shenjtërisë sonë si edhe mbushullimin e bukurisë që Zoti na ka dedikuar. Kur marrim vendime të cilat e kufizojnë shenjtërinë tonë (shpesh herë nga mosdija), Nëna jonë Qiellore është e pikëlluar sepse sheh se si kjo na ndalon në nivelin fillestar.

Fjalët e Sajë „*Lutni, lutuni, lutuni!*” na sjellin në mendje fjalët e Jezusit prej kryqit “*Gjithçka u krye*” sepse edhe ajo, si Jezusi, dëshiron plotësinë. Ajo nuk i lë gjërat të pakryera dhe nuk është e kënaqur vetëm me nivelin fillestar të lutjes madje as me të dytin. Ajo i dëshiron që të tri nivelet – në tërësi. Si Nënë e jona, ajo për ne dëshiron të njëjtën masë si për veten e sajë. Dëshiron të na çojë në vendin të cilin as që mund ta marrim me mend. Sikur ta kishim idenë, sikur të mund ta imagjinonim se çfarë bukurie na pret, do të ishim jashtë vetes nga gëzimi! Pse aq shpesh Ajo përsërit thirrjen e sajë për lutje? Pse kurrë nuk heziton ta përsërisë thirrjen e sajë „*Lutni, lutuni, lutuni!*”, nganjëherë nga dy muaj pandërprerë, përkundër të gjithëve që e urrejnë atë përsëritje? Kjo, për arsye se nuk i frikohet përqeshjen së tyre! “*Të dashur fëmijë, në lutje do të arrini dashurinë e përsosur.*” Këtë dëshiron ajo prej nesh dhe nuk do të kursejë asgjë kur është fjala për lumturinë tonë.⁸⁷

Niveli i parë i lutjes

Në nivelin e parë të lutjes kemi refuzuar ateizmin tonë dhe plogështinë shpirtërore. Besojmë në Një Zot të gjithëpushtetshëm plot dashuri dhe jemi të lumtur se e kemi Zotin e tillë. Kur kemi probleme, kur vuajmë ose jemi në vështirësi, kur kemi nevojë të madhe për diçka, duam që t'i lutemi. Nganjëherë lutja jonë vërtetë mund të jetë e zjarrtë:

„Zotëri, të lutem, më shëro!”

„Zotëri, të lutem, bën që ky person të mos më shkaktoi dhembje më tej!”

„Zotëri, më nxjerr nga kjo situatë e mjerë. Më ndihmo të gjej punë!”

„Zotëri, më ndihmo të gjej shpirtin e ngjashëm!”

Sa sinqerisht dhe me zjarr lutemi! Dhe kjo është mirë sepse Zoti, Ati ynë dëshiron që me Të t'i ndajmë nevojat tona. Nëse lutja na dëgjohej, jemi të kënaqur dhe ndoshta e lëmë Zotin anash deri

⁸⁷ Një njeri nga Parisi më tha njëherë: „Unë nuk besoj në dëftimet e Megjugorjes. Porositë përsëriten tepër shpesh!” E pyeta: „Kur ishe fëmijë, sa herë i është dashur nënës sate të të thotë: 'Mos e fut gishtin në hundë?'” U përgjigj: „O, pa numër!” „Dhe kur ka pushuar të të thotë?” e pyeta. „Kur nuk e kam futur më!” „E shikon...” Kur vërtetë të fillojmë të lutemi, nuk do t'i duhet të na thotë më!

sa të paraqitet nevoja tjetër. Por shumë shpesh, nëse nuk marrim çfarë dëshirojmë, ndjehemi keq dhe shqyrtojmë çdo gjë, nganjëherë deri në atë pikë sa heqim dorë prej atij Zotit që nuk na dëgjon“.

Në nivelin e parë të lutjes, qëndrimi im ndaj Zotit është njëkahor. Lutja ime është monolog: me kujdes ia shpjegoj Zotit se çfarë pres prej tij, pse kërkesa ime është e arsyeshme dhe sa të mira do të rrjedhin nga kjo. Me fjalë të tjera kërkoj prej Zotit që t'i shërben planeve të mia! Madje edhe nëse plani im duket se është më e mira gjë në botë (shërimi, sukcesi në provim, zgjedhja e konfliktit, etj.) megjithatë, ai është plani *im*. E zhvilloj, sinqerisht, në bazë të asaj që vërej se është e domosdoshme.

Shumë të krishterë mbesin në nivelin e parë të lutjes gjatë tërë jetës. Kurrë nuk e tejkalojnë lutjen e monologut e cila është aq kufizuese. Nuk e arrijnë gëzimin që ofron shkëmbimi i sinqertë në mes të zemrave. Sa dëm!

Si mund të kalojmë në nivelin tjetër?

Niveli i dytë i lutjes

Niveli i dytë i lutjes na vendos në raport të duhur me Zotin. Që të mund ta arrijmë, vetëm duhet ta dëshirojmë! Zoti na ofrohet vetë. Është puna jonë që T'i lejojmë të na dhurohet dhe shfaqet. Këtu rrolin kryesor e luan liria⁸⁸. Faktikisht, Zoti vepron në ne në harmoni me atë që i lejojmë të bëjë. Pasi kemi kërkuar që t'i plotësoi dëshirat tona (niveli i parë), vie koha kur pyetemi: „Po Zoti, çfarë mendon për këtë? Ai është i gjallë, ka zemër, si ndjehet Ai në lidhje me të gjitha këto? Po nëse mendimet e Tia janë të ndryshme nga të miat?“

Në këtë moment lutja dhe jeta jonë mund të kthehen kryengulthi. Para nesh është zgjedhja: mund t'i hapim zemrat tona dhe të dëgjojmë se çfarë ka Zoti të thotë për jetën tonë (dhe të përgatitemi të veprojmë në harmoni me të), ose mund të mbyllemi dhe të largohemi prej Tij nga frika prej qëndrimit të kundërt!

Që të kalojmë në nivelin e dytë, duhet të marrim qëndrim të palëkundur që zemrën ta kalojmë në gjendje të dëgjesës dhe të bëjmë, krejt çfarë është e mundur që të jemi në harmoni me të rrahurat e zemrës së Zotit⁸⁹. Si rojtarë, do të dëgjojmë pëshpëritjen e qetë të Jezusit në heshtjen e zemrave

⁸⁸ „Të dashur fëmijë, Zoti i ka dhënë secilit lirinë. Unë, në përvujtërinë time, përkulem para lirisë që ua ka dhuruar Zoti!“

⁸⁹ Jezusi i ka thënë motrës Faustinë: „Sikur shpirtrat të donin të dëgjonin zërin Tim, kur flas në thellësinë e zemrave të tyre, ata për një kohë të shkurtër do të arrinin deri në kulmin e shenjtërisë.“ (Ditari, § 584)

tona. Zoti është Fjalë. Ai pret në këtë shprehje të vullnetit të mirë që të na shfaqet. Fillon pak nga pak dhe ngadalë e rritë masën duke e harmonizuar me aftësinë tonë që ta pranojmë.

Kështu shpirti zbulon horizonte të paimagjinueshme dhe mund të filloi rrugëtimin e tij të ngadalë në shtegun e shenjtërisë. Cili është fjalëkalimi i fshehtë për këtë etapë? Vetë Jezusi na ka pëshpëritur në Ungjill: „O Atë, le të bëhet, jo vullnesa ime, por vullnesa jote!“ (Fjalëkalimi është i fshehtë, jo sepse duhet të mbesë i panjohur por për shkak se ai funksionon, vetëm kur thuhet në fshehtësinë e zemrës sime). Ky fjalëkalim më jep qasje të vërtetë tek të gjitha pasuritë e Zotit tim. Në të mrekulluarit e gjithëmbarshtëm shkoj nga njëra befasi tek tjetra, sepse mund ta prek Zotin tim dhe ta shijoj mirësinë e tij. Tani zbuloj se sa janë më të mira rrugët e Tij se të mijat dhe sa i drejtë ishte vendimi që t'i dorëzohem krejtësisht. Tani kuptoj se si dikur, kur varesha nga logjika ime, me gjykimet dhe planet e mia, pa e ditur, i kam mohuar vetes lirinë e madhe të brendëshme.

Që kur fatin tim e dorëzova në duart e dikujt tjetër, zbulova një lloj paqeje krejtësisht të ndryshme. Ky „dikush tjetër“ është Miku im më i mirë. Ky „dikush tjetër“ është Vetë Dashuria dhe me Të jam e sigurt. Përpara, kur si bonjake mund të llogarisja vetëm në veten time, më duhej që ta mbaj fort timonin e barkës sime të vogël dhe vetë të ballafaqohem me stuhitë e jetës. Por tani, timonin ia kam dorëzuar Atit tim dhe zemra ime është në paqe. Se çfarë lehtësimi! Më mahnit mënyra se si Ai sillet ndaj të gjithë erërave dhe valëve, ndaj të gjithë elementeve të kësaj bote. Kurrë nuk do të mund ta zbuloja këtë e vetmuar! Kjo është vërtetë hyjnore!

Tani, vetëm ulem në gjurin e Tij dhe, ne së bashku gjejmë zgjidhjen si dy miqtë më të mirë. Në këtë dashuri intime Ai më formëson dhe më mëson, më ushqen me urtinë e vet, më korrigjon dhe më përsos, me një fjalë Ai e riformëson identitetin Tim të vërtetë: „*Ky është Biri im i dashur, të cilin e kam për zemër!*“⁹⁰

Ky fjalëkalim i fshehtë nuk pushon kurrë së qenuri frytdhënës, dhe fryti është shenjtëria. Një ditë Jezusi i tha shenjtës Faustinë:

„Fëmija im, le të jetë parimi yt: Kurrë të mos mbështetesh në njerëz. Ti do të realizoje shumë gjëra po të mbështetesh në vullnetin tim dhe të thoshe: Jo si dua unë, por si është vullneti Yt o Zot. Dije se këto fjalë të thëna nga thellësia e zemrës, e sjellin shpirtin për një çast në kulmin e shenjtërisë. Ky shpirt, veçanërisht, Më pëlqen. Ai më sjell kënaqësi të madhe. Ky shpirt e mbush qiellin me erën e mirë të virtytit të tij. Megjithatë dije se, për forcën që ke për bartjen e vuajtjes, mund t'i falënderosh marrjes së shpeshtë të kungimit Shenjt. Prandaj, eja shpesh në këtë burim mëshire dhe nxjerr me enën e besimit atë që të duhet.“ (Ditari § 1487)

Se çfarë lajmi i mrekullueshëm! Kulmi i shenjtërisë? Kush nuk do ta dëshironte, që me këso premtimesh të kaloi në nivelin e dytë të lutjes?

⁹⁰ Mt 3,17

Natyrisht, ekziston pengesa që duhet kaluar para se të arrihet ai nivel. Dhe kjo është njëra prej më të vështirave: frika! Frika nga lëshimi i timonit, frika nga e panjohura, frika nga mendimi i të tjerëve („Çfarë do të thonë njerëzit?“) dhe shumë frika të tjera, që të gjitha pjellë e fantazisë sonë („Çfarë nëse Zoti kërkon... Tmerr, kurrë nuk do të mund ta bëja këtë!“), dhe përfundimisht: frika nga vuajtja.

Një ditë në Sarajevë Mirjana priste dëftimin e Zojës ashtu si çdo ditë, rreth orës 18.40. Mirëpo, atë ditë, në atë kohë nuk ju dëftua Zoja por një njeri i ri dhe shumë tërheqës. Ai i tha: „Mirjana, nuk do të duhej të ndjekësh Zojën! Kjo do të të shkaktoi shumë pakënaqësi dhe vuajtje. Më mirë më ndiq mua.“

Me të dëgjuar këtë, Mirjana kundërshtoi.

„Jo!“ – u përgjigj.

Me të dëgjuar „jo“, djaloshti ulëriti dhe u zhduk. Ishte djalli! Edhe pse ishte shndërruar në një djalosh shumë tërheqës me qëllim për ta mashtruar, Mirjana kishte vërejtur se bebëzat e syve i kishte të kuqe...⁹¹

Me qëllimin që ta fusë në grackë, djalli kishte zgjedhur helmin më të fortë nga dollapi i tij – një helm shumë të rafinuar, i cili shpesh është efektiv sepse godit plagët e zemrave tona: „Nëse shkon me Zotin, Ai do të të dërgoi vuajtje dhe tundime dhe gjithmonë do të jesh fatkeqe! Por nëse vjen me mua, do të jesh e lumtur në dashuri.“

Se çfarë mashtrimi! Kush mund të jetë i lumtur në jetë me dashurinë e inspiruar nga djalli – qenie e cila nuk ka asnjë miligram dashurie në vete? Ai është rrenacak dhe baba i rrenës. Fatkeqësisht, shumë të krishterë e përpijnë atë rrenë, pa e vërejtur se djalli e ka futur në ta frikën e tij.

Djalli e ka frikë Zotin dhe dëshiron të na infektoj me virusin e tij. Ai ua imponon mendjeve tona fotografinë e Zotit i cili sjell fatkeqësi! Por e vërteta është krejt e kundërt: Zoti është burimi i lumturisë sime të vërtetë, lumturisë që nuk mashtron. Djalli, nëse e dëgjojmë, do të na tërhjek në fatkeqësi.⁹² Nëse e kemi frikë Zotin dhe vullnetin e Tij, kjo është për shkak se në vete mbartim akoma mbeturinat e asaj rrene. Rrenci i Madh është ai i cili na çon në mosbesim ndaj Zotit.

⁹¹ Mirjana ishte e tmerruar, por Zoja ju dëftua atëherë dhe e ngushëlloi: „Më vjen keq Mirjana, që mu desht ta lejoj këtë, por ti duhet ta dijs se djalli ekziston. Njëherë ka ardhur para fronit të Zotit dhe ka kërkuar leje që ta tundoi Kishën. Zoti e ka lejuar që ta tundoi për një shekull. Ky shekull iu dorëzua fuqisë së të keqes, por kur ndodhin fshehtësitë të cilat i ke pranuar, fuqia e tij do të jetë e zhdukur. Qysh tani po i zvogëlohet fuqia, por ai po bëhet më agresiv. Djalli po shkatërron kurorat, bën që disa meshtar të jen kundër disa të tjerëve, nxit ngujime dhe vrasje. Duhet që të mbroheni me agjërim dhe lutje, sidomos me lutje të përbashkët. Bartni me vete sende të bekuara, mbajini në shtëpi dhe përtërijeni përdorimin e ujit të bekuar.“

⁹² Nëna Yvonne-Aimee de Malestroit ka thënë: „Njerëzit nuk i frikohen djallit sa duhet. Sikur ta shihnin sa është i shëmtuar, nuk do të mëkatonin më!“ (Nga libri Yvonne Aimee de Jesus, Fr. Labutte, Guibert Editor, Francë).

Nëse vetëdijesohem për këtë rrenë kjo më ndihmon që të heq dorë prej sajë dhe ta hedh në furrën e zjarrtë të zemrës së Krishtit. Frika zhduket posa të largohet rrena. Kështu shkoj nga frikësimi deri tek „frika“, deri tek ai virtyti i mrekullueshëm i „frikës së Zotit“ që rrjedh nga dashuria dhe nëpërmes të së cilës Shpirti Shenjt bën që të frikohem se nuk kam dashuri të mjaftueshme!

Shenjë e prekshme e nivelit të dytë të lutjes është paqja. Jemi të rrënjëzuar në paqen që askush nuk mund të na e luhatë. Kjo është dhuratë e Zotit. Lumturia jonë më nuk varet nga kjo botë, por nga Zoti i cili ka vendosur të na japë paqen e Tij.⁹³ Bartim, pra, një fryt të madh, sepse ajo paqe rrjedh prej zemrës sonë si lum.⁹⁴

A mund të shkojmë më tutje? A mund të ekzistoi edhe një nivel lutjeje?

Niveli i tretë i lutjes

Nivelin e tretë të lutjes mund ta dëshirojmë por nuk mund ta arrijmë me vullnetin tonë. Zoti e ndan sipas vullnetit të tij. Pasi që të kemi kërkuar vullnetin e Zotit dhe pasi që ta kemi pranuar me gjithë zemër⁹⁵, vie koha kur jemi të pjekur që hirin më të madh të gjitha hireve: identifikimin me Krishtin.⁹⁶ Si thoshte Shën Pali: „Jetoj, por jo unë, në mua jeton Krishti.“⁹⁷ Ky është si një

⁹³ “Të dashur fëmijë! Sot ju thërras që të përcaktoheni për Zotin, sepse largimi prej Zotit është fryt i shqetësimit në zemrat tuaja. Zoti është vetë paqa, prandaj afrohuni atij me lutjet tuaja personale, e pastaj jetoni paqen në zemrën tuaj dhe ashtu, paqja prej zemrës suaj do të rrjedh si lum në mbarë botën. Mos flisni për paqen, por bëni paqen. Unë bekoj secilin prej jush dhe secilin vendim të mire tuajin. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime!” (porosia më 25. shkurt 1991.)

⁹⁴ I lumturi Charles de Foucauld e ka shprehur këtë qëndrim të zemrës në mënyrë të mrekullueshme në lutjen e tij të famshme:

„Atë, lëshohem në duar të tua; bën me mua çfarë të duash.
Çfarëdo që të bësh, të falënderoj. Jam gati për çdo gjë. Pranoj çdo gjë.
Vetëm le të bëhet vullneti Yt në mua dhe në të gjitha krijesat.
Nuk dua asgjë më tepër se kaq, Zotëri. Në duar të tua e dorëzohet shpirtin tim;
ta paraqes me tërë dashurinë e zemrës sime, sepse të dua, Zotëri,
dhe kështu më duhet të dhurohem, të dorëzohem në duart tua,
pa u përmbajt dhe me besim të paskajshëm, sepse ti je Ati im.“

⁹⁵ Shën Maksimilijan Kolbe kishte formulën e mrekullueshme e cila e paraqiste këtë: [v=V (bashkimi i vullneteve)]

⁹⁶ „O, Krishti im i dashur, dashuria e kryqëzuar, dëshiroj të jem nusja e zemrës sate, dëshiroj të të mbuloj me lavdi, dëshiroj të të dua... deri në vdekje! Por e ndjej dobësinë time dhe të lutem 'më mbështjell me vetveten', që të mund ta njëjtësoj shpirtin tim me të gjitha lëvizjet e shpirtit tënd, më vërsho, më pushto, më ndërro me veten ashtu që jeta ime të jetë shprehje e Jetës sate. Eja në mua si i Adhuruar, si Rindërtues, si Shpëtimtar.“ (Shën. Elizabeta e Trinisë Tejetshenjte)

⁹⁷ Gal 2,20

zëvendësim. Në të vërtetë, ky person shpirt digjet me një dashuri të zjarrtë ndaj Krishtit dhe ndaj vëllezërve sa që Jezusi e viziton në një mënyrë misterioze dhe i dhuron zemrën e vet. Pasoja më e prekshme e këtij intervenimi hyjnor, që quhet transverberim, është se personi jeton me jetën e Krishtit, mendon mendimet e Tij⁹⁸, duron vuajtjet e Tij, gëzohet me gëzimet e Tij dhe digjet me dëshirat e Tij hyjnore.

Njoh disa persona që kanë arritur këtë nivel lutjeje, por për shkak të diskrecionit nuk mund t'i emërojmë. Mistikja e madhe franceze Filiola ka jetuar në një bashkim aq sublim me Krishtin sa i ka parë të gjitha keqtrajtimet e fshehura kundër Krishtit në Eukaristi. Për shkak të kësaj ajo ka përjetuar agoni, të brendshme, të tmerrshme. Ka mundur, megjithatë, në të njëjtën kohë të parashohë edhe „Kishën e Dritës“ dhe apostujt e sajë të Zjarrit të cilët Jezusi ia ka paraqitur si fitimtar të mëdhenj (pas një periudhe të pastrimit të Kishës, sidomos në Francë). Këto vizione e kanë ngritur Filiolën në një admirim të lumtur.⁹⁹

Kur i shikojmë personat e tillë mund të kuptojmë, deri diku, ndjenjat e Jezusit!

Për shembull, kur njerëzit tubohen dhe në dukje të parë çdo gjë është në rregull, atmosfera është e mirë, këta persona mund të zhyten në agoni të brendshme. Pse? Çfarë ju ndodh? Mund ta ndiejnë,

⁹⁸ Shën Faustina ishte e brengosur se do të mund ta trdhëtonte Krishtin në shkrimet e sajë mbi Mëshirën. Por Jezusi e ka trimëruar dhe ka kërkuar që të vazhdoi të shkruaj duke i thënë: „Bija ime, qetësohu, bën atë që të urdhëroj. Mendimet tua janë të njëjtësuar me të Miat. Shkruaj ashtu si të vjen në mendje. Ti je sekretarja e mëshirës Sime.“ (Ditari, §1605)

⁹⁹ Filiola (1888 – 1876) ishte një franceze e thjeshtë që e përbuzte bota sikurse edhe i shoqi. Në një frëngjishte jo të mirë ka treguar pjesë nga jeta e sajë e theksuar mistike. Derisa në kishë mahnitej para fotografisë së Jezusit i cili Shën. Margareta Marisë Alacoque ia tregon Zemrën e Tij Tejetshenjte, ishte e prekur thellë: „Jezusi ma hapi zemrën e Tij krejtësisht e ma dha Dashurinë e Tij e cila nuk më braktisi gjatë 45 viteve. Vërtetë, para asaj fotografie, zemra ime foli në brendinë time: 'O, sa do të dëshiroja të dua si Shën Marija Margareta!' Në të njëjtin çast, Jezusi preku zemrën time dhe më dha dashurinë e Tij. Më herët, gjithmonë, kërkoja dashurinë e vërtetë, dhe nuk munda ta gjej në zemrat e njerëzve. Isha aq e etur për dashurinë e vërtetë dhe vetëm Jezusi mund të kënaqte zemrën time. Ashtu edhe ndodhi! O, Atë, si do të mund t'ua shpjegoj këtë? Kjo është sikur Jezusi të ketë mbjellë në mua zemrën e Tij të gjallë. Zemra ime është e njëjtësuar me të Tijën dhe e Tija është e njëjtësuar me timen, si të ishte vetëm një zemër. Atë, nuk e kuptoj mirë si mund të jetë kjo. Kjo është sikur Jezusi të ketë lejuar që Zemra e Tij të flasë në timen dhe dëshiron që të shkruaj atë që zemra e Jezusit më frymëzon, atë që Ai dëshiron dhe atë që Ai dëshiron të më shpall. Kështu unë i flas gjërat nëpër zemrën e Jezusit. Ai ma shpall realitetin e thellësisë së gjërave në dritë të vërtetë, madje edhe ato më të fshehurat. Zemra e Jezusit dëshiron të flasë në botë para se të jetë vonë.“ Më vonë shkruante: „E ndjeva se jam e vërsuar me dashuri e cila ishte më e fortë, më e thellë, më intensive. Jezusi lejoi që ta shoh, në brendi, dhe e hapi krejtësisht zemrën e Tij për mua. E shikoja dhe ishte sikur e nxori Zemrën e Vet nga kraharori dhe e vendosi në zemrën time. Atëherë më vërshoi Dashuria, ajo e vërteta. Atëherë kuptova se ajo ishte si të ma kishte dhënë Jezusi Gjithësinë. Gjithësinë hyjnore. Nuk kam fjalë për këtë. Është tepër e madhe për mua. Por e ndjej Zemrën e Jezusit në zemrën time.“ (Filiola, Rruga e dritës; Tequi, fq. 43).

përnjëherë, se aty është i pranishëm njeriu në mëkat mortar, i cili përkundër buzëqeshjeve të përzemërta, është në rrugën për të qenë i humbur...

Dhe e kundërta, mund të bëhen shumë të lumtur pa ndonjë shkak të dukshëm. Falë zemrës së Jezusit, që troket në ta, janë të vetëdijshëm për fitoren e madhe të hirit e realizuar (në dikë që është i pranishëm). Për Jezusin, këta njerëz janë “njerëzimi i ri”¹⁰⁰. Ata ia kanë dorëzuar mbarë qenien e tyre si banesë ku Ai mund të jetojë përsëri misterin e vet.

Niveli i tretë i lutjes ka të bëjë me lutjen personale të Krishtit në shpirtin njerëzor. Nuk ka nevojë të thuhet se kjo lutje dëgjohet gjithmonë sepse është e harmonizuar në mënyrë të përsosur me vullnetin e Zotit. Ajo arrin çdo gjë!

Shenjë e prekshme se dikush ka hyrë në këtë nivel të lutjes së zjarrtë është se asnjë lloj vuajtjeje nuk është më shqetësuese, por e kundërta, bëhet gëzim. Natyrisht, ky gëzim nuk ka asnjë lidhje me prirjen ndaj vuajtjes sepse kjo do të ishte perverse (mazohiste), por me faktin se paraqitja e sajë Krishtit, e ka shndërruar në burim shëlbimi. Personi i tillë nuk e shikon më vuajtjen e vet, por gëzohet thellësisht, në bashkësi me zemrën e Shëlbuesit, nga mendimi se nëpërmes të asaj vuajtjeje disa shpirtra do të kalojnë nga vdekja në jetë.

Një ditë, në fillim të viteve të 80 nëna e Vickës kishte fërguar patate për familjen e sajë të madhe. Pastaj kishte shkuar para shtëpisë së tyre të kaltër në Bijakoviqi, për të derdhur vajin e përdorur. Duke bartur enën e madhe me vaj të nxehtë, nuk kishte vërejtur se rreth Vickës po luanin fëmijët. Papritmas vrapoi drejt sajë një vogëlushe pesëvjeçare dhe nga ky shkak ajo humbi drejtpeshimin. Vicka, duke parë se në shpinën e vogëlushes do të derdhet vaji i nxehtë, kërcëu dhe me shpejtësinë e rrufesë e shtyri atë. U gjend në vendin e sajë, nën enë. Vaji i valë u derdh mbi të dhe mori djegie të rënda në fytyrë!

Në atë kohë nuk bëhej fjalë për ndihmën e shpejtë. Nuk kishte telefon, ambulancë lokale as makinë të ndihmës së shpejtë, dhe as para me të cilat do të paguhej shërbimi i tyre. Pas një kohe e gjetën dikë i cili do ta transportonte Vickën, me makinë, në spitalin e Mostarit. E motra, Ana, kishte qenë tërë kohën me të dhe i kujtohet se gjatë udhëtimit, përkundër dhembjeve të mëdha, Vicka përsëriste pandërprerë: „Të faleminderit Jezus, Të faleminderit Jezus!“ që e kishte kursyer mbesën e tyre të vogël. Vicka nuk i kishte mbushur as njëzet vjet dhe ishte shëmtuar! Me djegiet e shkallës së tretë, do të mbetej ashtu tërë jetën, megjithatë përsëriste: „Të faleminderit!“ (Më vonë lutja e Zojës e shëroi fytyrën e Vickës pa lënë asnjë gjurmë nga djegiet.)

¹⁰⁰ Shprehje që me dëshirë e përdorte shën Elizabeta e Trinisë Tejetshenjte.

Si është e mundur kjo? Kjo është fshehtësia e Vickës. Një kohë para fatkeqësisë, Zoja ju kishte folur veguesve mbi mëkatarët e mëdhenj dhe për lotët e gjakut që Ajo derdh duke shikuar se si ata shpirtra humben. Atëherë i ka pyetur, ashtu si barinjte e vegjël në Fatima: „Kush dëshiron të flijohet për shpëtimin e mëkatarëve?“ Vicka është lajmëruar vullnetarisht menjëherë. Atëherë Zoja i ka treguar se çfarë frytësh të pabesueshme mund të sjell vuajtja që i paraqitet Jezusit. Zoja ka thënë se „janë shumë pak njerëz që e kanë kuptuar vlerën e madhe të vuajtjes e cila i paraqitet Jezusit.“

Posa Vicka kuptoi se shumë njerëz mund të shpëtohen nëse ia paraqesim Zotit vështirësitë dhe vuajtjet tona, filloi, me gjithë zemër ta aplikoi në jetë. Kështu, për të, gëzimi i shpëtimit i tejkalonte dhembjet të cilat ja sillnin kryqet jetësore.

Vicka u kthye nga Roma më 1. Shtator të vitit 2000., pas një operacioni të rëndë i cili i la vrragën prej 10 centimetrash në qafë, në pjesën e mollëzës së Adamit. E pyeta: „Shpresoj se në operacion nuk kishe shumë dhembje?“

Sytë e sajë më bënë me dije se në zemër kishte festë. Një gëzim i pazakontë dilte prej sajë. „Motra Emmanuel“, u përgjigj, „aq e dua Jezusin sa gjithmonë kërkoj rastin t’i dhuroj diçka. Prandaj kur kemi ndonjë vuajtje që mund të ja ofrojmë, ne jemi të lumtur! Vetë fakti që kemi rast t’i ofrojmë diçka që na kushton, është dhuratë e madhe për ne.“

„Ke të drejtë“, thashë, „por, si ishte në spital?“

„Para operacionit kirurgu më tërhoqi vërejtjen dhe më tha: 'Vicka, do të jem i sinqertë. Ky operacion nuk është i thjeshtë. Telat e zërit janë organ i ndjeshëm dhe nuk jam i sigurt se do të mund të flisni pastaj. Prandaj do të ju mbaj për dore kur të zgjoheni, e ju provoni të më thoni ndonjë fjalë. Atëherë do ta dimë a do të mund të flisni apo jo. ‘“

„Kur isha në tavolinën e operacionit, i thash Jezusit: 'Jezus! Ti s’do të ma marrësh zërin! Ti e di se më duhet t’i përcjell porositë! Si do të përgjigjem në pyetjet e shtegtarëve nëse ma merr zërin?' Atëherë u shtriva nën dritat e operacionit dhe kuptova sa jam qesharake! Po nëse Jezusi ka dashur të ma marrë zërin? Nëse ka kërkuar flijim prej meje, a do ta refuzoja? Natyrisht se jo! Nëse i duhet zëri im, le ta marrë! A jam aq e lidhur me zërin tim? Atëherë i thashë: 'I ëmbli Jezus, nëse e do zërin tim, merre, ta jap me gjithë zemër!' Motra Emmanuel, shiko sa lehtë shqetësohemi në një çast të tillë emotiv siç është operacioni! Kur u zgjova dhe i hapa sytë, pashë mjekun pranë meje. Më pyeti, 'Tutto bene?' (Çdo gjë në rregull?) Iu përgjigja: 'Tutto bene!' E kisha zërin!“

Njerëzit që e kanë arritur nivelin e tretë të lutjes, janë njerëzit më të lumtur në botë, siç e kam thënë më parë. Ata „e kanë Jezusin“ në atë masë në të cilën mund ta ketë dikush në tokë para shikimit të lumtur të Zotit. Kështu, vijnë te kulmi i jetës së krishterë, ku shpirti, i pastruar nga

çdo interes personal, shndërrohet në hostie të gjallë, dhe ia paraqet vazhdimisht lutjen e zjarrtë Zotit! Ata i kthejnë mijëra zemra Krishtit. Ata janë „bashkëshelbues“¹⁰¹.

Kur Maria në Megjugorje na thotë: „Lutuni, lutuni, lutuni“, ajo na tregon me këtë se çdo shpirt është i thirrur të njohë thellësitë e bashkimit me Zotin që i ofrojnë këto tri nivele lutjesh. Natyrisht, Virgjëra e Lumtur Mari, paraqet të arriturën më të përsosur të këtij njëjtësimi me Krishtin. Në disa fjalë në vazhdim, Zoja ia ka besuar Shën Brigitës së Suedisë, rolin e sajë si e Fejuar, i cili rol, i realizuar deri në plotësi, e ka bërë Atë, bashkëshelbuesen më të pastër¹⁰²: „Adami dhe Eva e shitën botën për frytet e pemës. Biri im dhe unë e shpërblyem me një Zemër. Vuajtja e Tij ishte vuajtja ime sepse Zemra e Tij ishte Zemra ime.“

Si është e mundur që aq pak të krishterë e arrijnë nivelin e tretë të lutjes? Njëri përtej shkaqeve të mundshme është mosdija. Le të jetë ky kapitull, për shumë prej tyre, mjet i hapjes së horizonteve të reja!

Sot media, u ofron gjeneratave të reja dhe të vjetra mënyrat më efikase dhe më të lehta që me shpirt të fundosen në vdekje. Ato janë rrugët më të shpejta të rënies në humnerë dhe njerëzit shkojnë drejt tyre me turma të tëra. Me mijëra vetëvrasje, me miliona njerëz vuajnë nga sëmundjet psikike. Por kush e mëson njeriun modern që në Krijuesin dhe Shëlbuesin e vet mund të gjejë burimin e pabesueshëm të lumturisë? Kush e ka guximin ta gjunjëzojë botën?

Maria e Megjugorjes, të faleminderit! Ti po e bën pikërisht këtë!

¹⁰¹ Ne kemi vetëm një Shëlbues, Krishtin. Mirëpo, në misterin e Kishës dhe të bashkësisë së Shenjtërve, jemi gjymtyrët e trupit të Tij dhe mundemi, pra, të marrim pjesë në veprën e Shëlbimit.

¹⁰² Më 6. tetor 1991., me rastin e 600 vjetorit të kanunizimit të sajë Gjon Pali II tha: „Shën Brigita e mori Marinë për model. E quajti E Ngjizur Pamëkat, Zoja e Pikëlluar dhe Bashkëshelbuese, duke ngritur kështu rolin e pashoq të Marisë në historinë e shëlbimit dhe në jetën e popullit të krishterë “ Këtu mund të gjenden tri elemente karakteristike për Zemrën e identifikuar me Krishtin: pastërtia, pjesëmarrja në vuajtje dhe bashkëpunimi efektiv në shpëtimin e njerëzimit.

„Të dashur fëmijë! E dua secilin prej jush aq sa e dua edhe Birin tim Jezusin.“ (pa datë)

42

BUTËSIA E MARISË

Sa mahnitëse janë huret dhe bekimet që jepen në Megjugorje! Ajo që më bën më shumë përshtypje janë frytet e pranuar nga mbështetja në Zojën nëpërmes të bisedës së përzemërt, si fëmija që shpreh afërsinë e madhe me të ëmën. Shumë shtegtarë i braktisin përshpirtëritë e veta mekanike dhe të mërzitshme, për të hyrë në takimin e zemrave që Zoja zgjon, sidomos, në Megjugorje. Është bukur të shohësh aq shumë shtegtarë që vijnë me fytyra të tendosura dhe të ngarkuar – që largohen nga Megjugorja me një buzëqeshje të gjerë dhe të shkujdesur! Ata kanë gjetur shpirtin e ngjashëm në Nënë e tyre! Marisë i pëlqen kur i flasim sinqerisht dhe kur presim shumë prej sajë. Ajo i jep rast që të veproji si nënë.

Në misionin në Rumani më 1999, isha e bekuar me rastin e papritur që të takoj kardinalin Alexandru Tode, martirin e fesë, i cili gjatë kohës së regjimit komunist kishte kaluar shumë vite në burg. Për shkak të dëmtimit të trurit, të shkaktuar nga pika në tru, nuk ishte në gjendje të fliste më, përveç kur luste rruzaren! Nëse dikush do të fillonte Ati ynë, ai vazhdonte pa u hamendur.

Para se t'i rrënohej shëndeti, kishte dëshirë të tregonte tregimin për ditën kur, gjatë qëndrimit në qelinë e errët dhe të ndytë, vdiste nga uria si shumë shokë të tij. E dinte se, nëse nuk ndryshohet diçka, nuk do të rezistoi gjatë. Kishte mjaft arsye të shëndoshë që të mos sillet si bonjak, dhe disa herë e kishte tërhequr për manteli Nënë e vet. Saktësisht e dinte se çfarë duhet të thotë që ta prekë, dhe i kishte folur me rreptësi: “Nënë! A nuk sheh se unë këtu po vdes nga uria! Nuk mërzitesh për këtë? Nëse do të kem rastin që të predikoj përsëri, sigurisht nuk do të mund të marr për shembull si kam bërë në të kaluarën! Unë jam fëmija yt, dhe ti më len të vdes nga uria!”

Pak më vonë, atë mëngjes, u dëgjua shuli i dritares së tij të ushqimit, që nuk ishte dëgjuar për më se dy ditë. Ishte mrekulli! Në enën e tij të ushqimit kishte mish! Jo vetëm për drekë, por edhe për darkë, madje edhe për të nesërmen. Fatkeqësisht, të gjitha enët e ushqimit duhej kthyer në mbrëmje, kurse Alexandru nuk mund ta hante të gjithë mishin. Pa dëshirë ia kthejë rojtarit atë që kishte mbetur, kurse ai, për çudi, i tha se mund ta ruaj deri nesër. Nuk është kurrë tepër vonë që, nga fundi i shpirtit, ta thërrasim në ndihmë Nënë tonë.

Përqafimi i Marisë

Në ditëlindjen e sajë, më 3 shtator, Vicka i fton në mbrëmje të gjithë miqtë e sajë. Është rast për të që t'i qerasë ata që e duan. Në vitin 2000., para se të martohej, mora pjesë në njëren nga festat e sajë të ditëlindjes. Pas darkës së pasur dhe këngëve tradicionale, e pyeta se a e ka bërë Zoja të njëjtën gjë, për ditëlindjen e sajë, si zakonisht. Fytyra iu ndriçua nga një buzëqeshje që flet shumë.

„Po, natyrisht! Më puthi si çdo vit.“

„Si të puthi?“

„Si gjithë të tjerët (pra, si të gjitha kroatet, jo si Amerikanet, Zvicranet ose Japonezet. Ja këtu është puthja në të dy faqet, duke ma mbajtur dorën).“

Atëherë Vicka përshkroi në mënyrë të prekshme si i kishte kaluar muaji i fundit: „Kur më afrohet ditëlindja dhe e di se Zoja do të më puth, filloj të numëroj ditët. Edhe një muaj, pastaj edhe njëzetepesë ditë dhe së shpejti vetëm edhe dhjetë ditë. Çdo mëngjes posa të zgjohem, së pari mendoj për atë çast. Ashtu si afrohet dita ashtu rritet gëzimi im! Kur, më në fund arrin mëngjesi i ditëlindjes sime, gëzimi im gufon dhe filloj të numëroj orët! Nuk mund ta përshkruaj atë gëzim. Nuk ekzistojnë fjalët me të cilat do të mund të përshkruhej! Ajo nuk është puthje e thjeshtë! Zemra ime përmbysset dhe frikohem se nuk do të mund të duroj atë gëzim dhe paqe.“

„E pastaj ?“ – e pyeta, duke menduar për dëftimin që e kishte pasur më herët atë ditë.

„Atëherë më falënderoi. Më tha: ‘Vicka, të faleminderit që i pranon shtegtarët dhe që ua jep porosinë e mia.’ Pastaj unë e falënderova! Për dhuratën e jetës, për dhuratën e familjes sime, shtëpinë tonë dhe mundësinë që t’i pranojmë dhe të ju ndihmojmë gjithë atyre njerëzve që vijnë këtu-për të gjitha! Atëherë ajo e falënderoi Zotin për jetën time të shërbimit dhe që më ka krijuar. Vetëm falënderuam njëra tjetrën!“

Sinqerisht, mendoj se kurrë në jetën time nuk e kam parë dikë aq të lumtur për ditëlindje si ishte Vicka.

Gjithashtu besoj se Zoja, si Nënë jona, i vjen secilit prej nesh, në mënyrë të qetë, dhe na jep puthjen për ditëlindjen tonë. Secili që e pranon në zemrën e vet, i lejon në mënyrë të posaçme që të derdh dashurinë e sajë amënore të paskajshme dhe të pakuptueshme¹⁰³.

¹⁰³ Me rastin e një vizite në Dublin Ivani iu tha njerëzve: „Sikur ta shihnit Zojën vetëm për një sekondë – e përsëris - sikur ta shihnit Zojën vetëm për një sekondë, bota nuk do të ishte më tërheqëse për ju. Më duhet të lutem çdo ditë që të mund të pajtohem me faktin se jetoj në këtë botë.“ (Ka raportuar atë. John Chisholm që ishte i pranishëm.) Ivani tha diçka të ngjashme me rastin e vizitës së dytë në Irlandë, kur një grua e pyeti: „Ivan, ti ke vajzën trevjeçare. Sikur Zoja do të ftonte të shkoje me të, nëse do të doje, çfarë do t’i përgjigjeshe?“ Ivani, pa u hamundur, u përgjigj: „Do ta lija vajzën, menjëherë, sepse shumë më tepër do të mund të bëja për të prej qiellit se sa në tokë!“

“Të dashur fëmijë! Nëse doni me gjithë zemër, do të merrni shumë. Nëse urreni, do të humbni shumë. Dashuria krijon gjëra të mrekullueshme. Sa më shumë dashuri që të keni në vete, më shumë do të mund t’i doni të tjerët rreth vetes. Prandaj do të duheshit që pandërprerë ta lusni Jezusin tua mbush zemrat me dashuri.” (Porosia Jelena Vasilit më 12. prill 1987.)

43

DIAMANTI I PAPËRPUNUAR

Njëra prej zotësive të Jezusit e cila më magjeps më së shumti është aftësia e tij e shndërrimit. Kur i bie diçka në dorë, pavarësisht se sa është e denjë për përbuzje, Ai gjithmonë gjen mënyrë që atë ta shndërroi në diçka të mirë. Madje edhe mëkatet tona mund të bëhen si parfum nëse ia dorëzojmë me pendim të sinqertë¹⁰⁴. Vrasja e Jezusit në Kryq, që është mëkati më i madh të cilin njeriu e ka bërë në mbarë historinë, u bë shkak i shpëtimit tonë! Nëse jemi, pra, në Krishtin, çfarë e keqe mund të na dëmtoi?

Kjo është e lehtë të thuhet, por jo aq e lehtë të bëhet kur ballafaqohemi me situatat konkrete të përditshmërisë. Jezusi, disa herë ma ka tërhequr vërejtjen në këtë që vazhdon:

Nuk mund ta duroj padrejtësinë. Ky është një reaksion alergjik shumë i vjetër i rrënjosur thellë në fëmijërinë time. E bekoj shëmbëlltyrën nga ungjilli mbi egjrën që armiku e mbjell në grunajë, sepse në atë situatë, unë do të isha, ashtu edhe si shërbëtorët, që deshën të shkojnë menjëherë dhe ta nxjerrin me rrënjë gjithë egjrën¹⁰⁵. Ndjej të njëjtin padurim dhe të njëjtin tërbim – por ata i ndaloj Jezusi sepse ajo duhet të jetë puna e engjëjve kur të vijë koha e korrjes. Duke më dhënë shembullin se si i ka ndaluar shërbëtorët, Jezusi nuk kërkon që ta përpjij tërbimin tim kur shoh padrejtësinë, as të kërcëlloj me dhëmbë, por më tregon se si nëpër Të ta zbuloj mënyrën më hyjnore dhe më efikase për të fituar drejtësinë e vërtetë. Më duhet ta pranoj se mënyra ime vetëm sa do ti vështirësonte gjërat!

Delphine, person mjaft i afërt me Bashkësinë time, u soll në mënyrë të padrejtë me ne. Ajo e shfrytëzoi Bashkësinë në të gjitha nivelet me një pakujdesi të dukshme. Për shembull, vinte, ushqehet dhe flinte, pa thënë kurrë një fjalë falënderimi. Enët e veta të palara i vinte mbi të tjerat në lavaman dhe ulej dhe shikonte të tjerë duke i larë. Problemi ishte jashtë kontrollit, i dukshëm qartë dhe nuk mund të arsyetohej. Për më tepër, përsëritej çdo ditë. Meqë ajo ishte kah fundi i viteve të dhimbshme të adoleshencës, vendosa të pres pakëz para se të ndërhyj me shpresën se sytë do ti hapen vetë. Por asgjë nuk ndërrohej dhe alergjia ime në padrejtësinë, shpesh ma sillte në mendje atë situatë. Ndjeja presion që ta ndërpres dhe shkëpus lidhjen që kishte me ne, me

¹⁰⁴ Referenca në Shën. Katarinën e Sijenës - Bisedat

¹⁰⁵ Mt 13,24-30

butësi por e vendosur. Vazhdimisht i përsërisja në kokë fjalët që do ti përdor kur do të bisedoj me të. Ishin të logjikshme, të qarta dhe të drejta! Dhe ato fjalë e kënaqnin nevojën time për drejtësi me kriteret e mia personale njerëzore.

Por, një ditë, në kohën e meshës, derisa dëgjoja predikimin në kroatishte, Zotëria më solli në kujtesë situatën nëpër të cilën kisha kaluar në vitet e mia të adoleshencës. U ndjeva aq e turpëruar! E pashë veten në situatë të njëjtë si Delphine! Si shumë të rinj të tjerë të cilët marrin çdo gjë të gatshme, duke shfrytëzuar mirësinë e prindërve të mi dhe shumë të tjerëve. Disa skena dhe fjalë të caktuara, që i kisha harruar më parë, tani më kalonin nëpër kokë dhe fillova ta ndjej dhembjen të cilën në atë kohë ia kisha shkaktuar familjes sime me atë sjellje të panjerëzishme.

Brenda këtyre disa minutash të vërtete – kësaj here, të vërtete Hyjnore – beteja ime e brendshme me Delphine ishte e shndërruar. Fillova të shikoj në të si në një dhuratë nga Zoti, si në engjëll që Profania ma ka dërguar nga dashuria dhe mëshira, në mënyrë që unë tani ta shfaq mëshirën e cila më ka qenë shfaqur mua në të kaluarën – mëshirën që nuk e kam merituar. Me fjalë të tjera, kjo ferrë për shkak të së cilës jam ankuar gjithmonë u bë puthje e mëshirës në zemrën time, nga Ai i cili më do aq shumë sa që vdiq për mua.

Prej asaj dite vendosa t'i shërbej dhe t'i ndihmoj Delphine, përkundër sjelljes së sajë. Dhe - o befas! – menjëherë të nesërmen Delphine, vendosi, papritmas, të ndryshoi sjelljen e sajë dhe vështirësia u zhduk, pa qenë e nevojshme që unë të bëj diçka.

Jezusi e arriti qëllimin e vet në zemrën time. Nuk deshi që në jetën time ta lër atë gurë në të cilin merret në thua!

Në atë vend u shfaq diamanti i Tij!

“Të dashur fëmijë! Akti i parë i kthimit, për ju, le të jetë rrëfimi shenjt, e pastaj, fëmijë të dashur, përcaktohuni për shenjtëri. Le të filloi sot e jo nesër kthimi juaj dhe vendimi për shenjtëri. Unë ju thërras të gjithëve, fëmijë, në rrugën e shpëtimit dhe dëshiroj të ju tregoj rrugën drejt parrizit. Prandaj, fëmijë, bëhuni të mijtë dhe përcaktohuni për shenjtëri.” (më 25. nëntor 1998.)

44

FSHEHTËSIA E RRËFIMIT

Atë Emiliano Tardif dëshironte që predikimet e tij t’i pasuronte me tregime nga jeta e përditshme. Sidomos kishte dëshirë të tregonte se çfarë kishte ndodhur në fshatin e vogël në Kanada, në mes të një miku të tij i cili kishte qenë meshtar dhe një gruaje nga famullia e tij.

Ajo grua pohonte se kishte pranuar disa shpallje nga vetë Jezusi. I shkruante ato dhe ia dorëzonte meshtarit. Kurse ky, i tubonte besnikërisht në sirtarin e tij, pa i lexuar fare sepse nuk besonte asnjë fjalë nga ato që thoshte ajo. Të folur të brendshëm? Vizion? Dëftim? Të gjitha këto nuk i besonte! Vizitat e asaj gruaje e irritonin përherë e më tepër. Grumbulli i porosive sa vinte e rritej sa që mezi e hapte sirtarin. Prandaj vendosi që t’i djeg të gjitha ato letra. Mirëpo, pikërisht kur desh i t’i hedh në zjarr u frikua nga Zotëria dhe mendoi: „Në të vërtetë, kurrë nuk dihet!“ Kështu vendosi që të kërkoj shenjë: „Zotëri, nëse vërtetë i flet kësaj gruaje, atëherë, të lutem, zbuloja të gjitha mëkatet e mia. Thuaj që t’i shkruaj dhe le të ma sjell porosinë.“

Të nesërmen ra zilja. Ishte e njëjta zonjë. Pohoi se posa e kishte pranuar porosinë nga Jezusi, pikërisht për të, dhe se Jezusi i kishte kërkuar prej saj që të ia sillte meshtarit. Meshtarit i erdhi keq për llojin e shenjës që kishte kërkuar duke kuptuar se mund të ishte e pakëndshme për të!

„Atë“, tha grua. „Jezusi më dërgoi të ju them se Ai nuk mund të mi tregoi mëkatet tua. I ke rrëfyer, prandaj Atij nuk i kujtohen më!“

Shumë katolikë, shpejt, do të shëroheshin nga frika prej Zotit sikur ta dinin këtë veti ngushëlluese të Tij. Jezusi ka amnezi kur bëhet fjalë për mëkatet e rrëfyera. Zoti nuk shtihet se i ka harruar mëkatet tona – kjo do ta bënte Atë një shakaxhi i cili na thotë: „Çdo gjë është në rregull“, derisa, në anën tjetër, fshehtas ruan arkivat për të na dënuar ditën e fundit. Zoti aq i harron mëkatet tona sa kërkon nga Kisha dhe meshtarët që t’i harrojnë edhe ata, prandaj edhe ekziston „fshehtësia e rrëfimit.“

Një ditë në Megjugorje Zoja na ka mësuar një gjë të mrekullueshme. Filloi t’i mësoi veguesit mbi përbërësit kryesor të jetës së krishterë. Maria e tregon shpesh këtë tregim, dhe disa njerëz nga fshati që unë i njoh, po ashtu, e kanë vërtetuar.

Ndodhi në verën e vitit 1981., kur kah fundi i qershorit policia komuniste ua ndaloi njerëzve që të shkojnë në Podbrdo. Zoja kërkoj nga veguesit që të tubohen rreth orës 22 në vendin e quajtur Jurino polje, në rrëzë të kodrës. Atë mbrëmje, rreth veguesve, ishin tubuar nja pesëdhjetë vetë që të lusin rruzaren para dëftimit. Atëherë Zoja tha diçka të pazakontë – se të pranishmit mund të afroreshin dhe ta prekin. Kërkoj nga veguesit që t’i marrin për dore, një nga një, dhe t’i afrojnë te Ajo meqë vetëm ata mund ta shihnin.

Njerëzit ishin shumë të lumtur se mund ta preknin Zojën e tyre, por veguesit panë shumë shpejt se në fustanin e sajë po paraqiteshin njolla. Filluan të qajnë dhe pyeteshin se pse po ndodhte kjo gjë. (Ata panë se pasi që disa njerëz e preknin Zojën, në fustanin e sajë mbeteshin njolla, por jo pse duart i kishin të palara, por nga ndonjë arsye tjetër.) Zoja ua shpjegoi:

„Këto janë mëkatet e atyre që më kanë prekur.“

Veguesit mundën të shohin qartë se cili kishte lënë cilën njollë dhe për shkak të cilit mëkat! Prandaj u zemëruan shumë dhe Marisë i kujtohet se kishte menduar atëherë: „Do ta mbaj mënd këtë dhe do ta kem para sysh.“

Mirëpo, pas dëftimit veguesit nuk mund të kujtonin më mëkatet që kishin parë, sikur Zotëria të kishte dashur që, nëpërmjet kësaj përvoje, tu japë shenjë mbi fshehtësinë e rrëfimit.

Mbrëmjen e njëjtë Zoja i ftoi të gjithë që të shkojnë në rrëfim së paku një herë në muaj sepse: „nuk ka njeri mbi tokë“, tha, „që nuk ka nevojë për rrëfim mujor.“ Të nesërmen shkuan të takojnë meshtarin e tyre, fra Jozon, që „të pastrojnë zemrat“ nëpërmes sakramentit të pendimit dhe që të ndryshojnë atë që është dashur të ndryshojnë në jetën e tyre.

Draga Ivanković kujtohet se, duke prekur Zojën, ndjeu diçka si rrymë që i kaloi nëpër tërë trupin. Ishte diçka shumë e fuqishme dhe intime që nuk mund të përshkruhet me fjalë. Po ashtu i kujtohet se gjatë kohës së dëftimit, disa grupe kroatësh të cilët kishin qenë për vizitë në Megjugorje, por që nuk ishin të vetëdijshëm për atë që kishte ndodhur, shkonin rrugës dhe nga shprehia e keqe, duke biseduar, shanin. Ishte tronditur shumë për shkak të kontrastit në mes të pastërtisë së madhe të Zojës dhe gjuhës së atyre njerëzve, dhe kishte kuptuar më mirë tmerrin e mëkatit.

Mendoj se gjëja më e rëndësishme në kujtimet e kësaj zonje është se: nuk e ka përlyer fustanin e Marisë mëkatit në kuptimin e përgjithshëm, por vetëm ato mëkate të cilat nuk kanë qenë rrëfyer, për shkak të të cilave njerëzit ende nuk janë penduar. Kjo është kështu sepse për Zotin mëkatet e rrëfyera nuk ekzistojnë më. Sa mësim i thellë për ne!

Më vonë Zoja tha: „Të dashur fëmijë, ju lutem jepjani Zotërisë të gjithë të kaluarën tuaj, të gjithë të keqen që është shtresuar në zemrat tuaja.“¹⁰⁶

A e dëshiroj ndihmën e Zotit? A dua që Ai „të shohë dhe të kujdeset“? A dua që të jem pjesë e Provanisë hyjnore të Tij?

Zoja thërret edhe sot në kthimin e zemrave tona, që të lirohemi nga mëkatit që njollos fustanin e sajë, por edhe botën gjithashtu. Falja në sakramentit e Pajtit¹⁰⁷ është vepër e Zotit dhe është më e madhe se krijimi i qiellit dhe i tokës!¹⁰⁸

¹⁰⁶ Porosia më 25. shkurt 1987.

¹⁰⁷ Shiko Katekizmin e kishës Katolike §§ 1455-58, 1468-70 (rrëfimi individual i mëkateve)

¹⁰⁸ Shkrimi i fundit i kardinal Ratzinger-it (Papa Benedikti XVI) mbi rrëfimin individual.

“Të dashur fëmijë! Sot ju lus që të pushoni së përgojuari dhe të luteni për bashkimin e famullisë. Sepse unë dhe Biri im kemi plan të veçantë me këtë famulli. Ju faleminderit që i jeni përgjigjur thirrjes sime!” (12. prill 1984.)

45

KËMBËT E GJATA TË FRA SLLAVKOS

„A ju pëlqen vendi afër dritares apo afër korridorit?“

Fra Sllavko Barbariq kishte përfunduar misionin në Amerikën Jugore dhe po përgatitej për fluturimin e gjatë në shtëpi. „S’ka rëndësi a gjendet afër dritares apo afër korridorit, por nëse keni një vend ku mund t’i shtrij këmbët, do të ishte shkëlqyeshëm. I kam këmbët e gjata dhe gjithmonë më shtangen kur udhëtoj me aeroplan!“

„Natyrisht, do të kujdesem për këtë! Urdhëroni biletën tuaj. Do të niseni nga dalja 4 pas njëzet minutash.“

Punëtorja e arkës e njohu fra Sllavkon. Ia dorëzoi biletën me një buzëqeshje. Kur hyri në Boeing, fra Sllavko kërkoi vendin dhe zbuloi, me befasi të madhe, se punëtorja sharmante e arkës e kishte qerasur me një ulëse në klasën e parë! Ai mund t’i shtrinte këmbët në mënyrë komode, të rehatohej dhe të punonte në librin e tij të ri.

Kur u kthye në Megjugorje nuk mund t’i evitonte pyetjet e zakonshme: „Si ishte në mision? Po udhëtimi?“ Fra Sllavko u tregonte, me mahi, se si ishte shtrirë në klasën parë si mbret.

Pikërisht në atë çast, veshi i një zonje në kalim e kishte kapur fundin e fjalisë së tij. Ai vesh ishte i lidhur me trurin i cili shpejt e informoi zemrën. Por, ajo zemër në njëfarë mase kishte qenë e sëmurë. Fillojë të prodhojë vrer në sasi të madhe sa që edhe fytyra i ishte e zhytur në të: sytë iu turbulluan, goja iu rrudh. Sa i takon gjuhës, e shkreta ishte më e helmuara nga të gjitha. Së pari shpërndante pëshpërime, por pak nga pak, ashtu si afroreshin veshët tjerë, bëhej përherë e më e zëshme: „I mjeri Shën Franë! Sigurisht rrotullohet në varr! Merreni me mend, më i varfëri prej të varfërve shikon se si vëllezërit e tij blejnë për vete ulëse në klasën e parë! Dhe me para të kujt, do të pyeteshim! Këtu, pra, po shkuakan paratë e shtegtarëve! Kjo është tragjike!“

Atë ditë, thuaja, pa e ngritur as gishtin e vogël, djalli arriti triumf të madh në Megjugorje. Padiësi tinëzar vetëm përdori kurthin e vjetër, tanimë të vjetruar nga gjithë ai përdorim, por i cili ka sukses gati gjithmonë.

Si mund të ketë sukses një kurth kaq i mjerë? Thjeshtë!

Vetëm vendosni një zemër të sëmurë nga hidhërimi dhe frustrimi në kontakt me një qenie drite. Qenia e dritës e shqetëson dhe zemra dashakeqe dëshiron të shkatërroi dritën e tij. Kjo qenie drite do të shprehet lirshëm, pa dyshim, në thjeshtësinë vëllazërore.

Zemra e sëmurë atëherë do të nxjerr një element nga të folurit e tij dhe, pa e marrë parasysh kontekstin (pjesa më e rëndësishme e cila injorohet), do ta izolojë atë element dhe do ta trajtojë në mënyrë të veçantë. Pastaj atë element do ta zhysë në helmin që ka prodhuar xhelozia e tij dhe rezultati: ai element bëhet për të skandal, fyerje, neveri. Pas kësaj goja e tij fillon të pështyjë të gjithë këtë, me disa shtesa dramatike të bashkangjitura, duke arritur te veshët e curruar rreth vetes. Lajmi menjëherë merret, shtrembërohet dhe forcohet. Shpërndahet shpejt duke iu falënderuar vreshtit tokësor. Fillon puna e gjuhëve dhe për 24 orë i gjithë fshati është i infektuar.

Si mund ta evitojmë këtë kurth? Para së gjithash duke punuar me zemrën. Por jo me zemrën e komshiut por me timen!

A tajit zemra ime vrer? A përqendrohen mendimet e mia në të këqijat rreth meje? Nëse po, kjo është sepse i kam lejuar Armikut që të mbjell farën e keqe, dhe mua më duhet ta njoh menjëherë: ta quaj farën e keqe “vrer” dhe ta shpall se ai vrer nuk ka të bëjë me mua. Ai është një gjë e huaj e denjë për t’u përbuzur, element korroziv i cili do të brejë nga brenda. Nuk vjen në konsiderim që t’i ofroj mikpritje!

Thirreni Jezusin në ndihmë, kërkoni prej Tij që nga zemra juaj të largoi përbërësit korroziv dhe shpallni me vendosmëri: “Zotëri, unë e refuzoj këtë!”

Plehrat i hidhni në shportën e plehrave. Por, meqë nuk ekziston shportë plehrash për helmet e padukshme, mund të përdorni një tjetër metodë: lëreni ato në rrëzë të Kryqit të Jezusit, nën shikimin dashamirës të Marisë. Atje Gjaku hyjnor rrjedh mbushulli, kurse ai Gjak ka fuqi mahnitëse. Madje dhe mëkatën e shndërron në element pozitiv!

Motra e vogël arabe e karmelit, e lumja Miriam nga Betlehemi i ka ftuar, me gëzim, mëkatarët që të mos kenë frikë nga mëkatet e veta. Ajo, në të vërtetë, i ka nxitur që mëkatet e tyre t’i vendosin para Jezusit, ashtu si vendosim plehun rreth trungut të pemës. Plehu bëhet element i çuditshëm prej të cilit druri bëhet më frytdhënës. Në këtë mënyrë Jezusi të keqen e kthen në të mirë. Mjafton që të Ia dorëzojmë atë të keqe.

Pasi që plehun ta kemi lënë në vend të sigurt, mbetet të bëjmë sa vijon:

- * Të merret një dezinfektues i mirë që ofrojnë sakramenti i pajtimit dhe i eukaristisë.
- * Të konstatohet se cilat pjesë janë të infektuara me helm dhe t’i paraqiten Nënës së Zotit ashtu që Ajo të mund të përdorë barin amënor dhe t’i pastroi.

* Të bëhet vaksinimi. Meqë nuk ka vaksinues magjik ose të përhershëm, si në mjekësi, mund t'i kushtohemi Zemrës së Pamëkat të Marisë dhe Zemrës Tejetshenjte të Jezusit. Duke jetuar këto kushtime me gjithë zemër, ne jemi vendosur nën mbrojtjen hyjnore.

Një ditë Jezusi i ka dhënë motrës Faustinë një çelës të mirë me të cilin do të mbrohet nga i Keqi: të mos merremi me atë që nuk ka të bëjë me ne në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ajo shkroi: „Zotëria më tha: 'Ty nuk duhet të të interesojë si sillen të tjerët. Ti vepro ashtu si të urdhëroj unë. Ti duhet të jesh gjithmonë, me mëshirë dhe dashuri, fotografia Ime e gjallë... Të jesh gjithmonë e mëshirshme, sidomos ndaj mëkatarëve.'“ (Ditari, §1446)

Kush ishte ajo shenjte e panjohur?

Edhe një mistike e madhe franceze e kohës sonë, nëna Yvonne-Aimée de Malestroit, shpesh ka ditur të mahnitë me mëshirën e sajë.

Udhëheqësi i sajë shpirtëror, atë Labutte, ka rrëfyer se si një ditë e kishte lutur që t'i bënte shoqëri për vizitë një gruaje të sëmurë rëndë, zonjës Fulgence, së cilës i ishte amputuar këmba pak kohë më parë dhe i kanosej operacioni tjetër i mundshëm. Këto tundime i kishin ndodhur në mes të vuajtjes morale që e kishte futur atë në kryengritje dhe dëshpërim. Vrazhdësia e sajë i pikëllonte të gjithë. Duke njohur shenjtërinë e madhe dhe karizmat e pabesueshme të nënës Yvonne-Aimée, atë Labutte fshehurazi shpresonte se ajo, nëpërmes të bisedës së mirë shpirtërore do të mund ta disponojë atë person të sëmurë dhe ashtu t'i mundësojë të përgatitet për të vdekur në paqe. Kur arriti, nëna Yvonne-Aimée u përkul drejt gruas së sëmurë, e shikoj me vëmendje të thellë dhe i foli me butësi. Gruaja përpinte nga shikimi i nënës Yvonne-Aimée dhe kur nëna u ngrit të largohet e luti që të rrinte edhe pak. Por, nënës i duhej të shkonte.

Kur dolën, atë Labutte i shpjegoi nënës Yvonne-Aimée se si ajo grua është e vështirë. Ai ishte, sinqerisht, shumë i dëshpëruar që nëna Yvonne-Aimée e reduktoi bisedën në banalitet duke mos thënë asgjë për Zotin, duke mos i prekur fare temat nxitëse, duke i bërë asaj pyetje të thjeshta: „Po vuani? Shumë? Sa kohë?“ Shkurt, ajo nuk tha asgjë shpirtërore, që ishte e kundërta e asaj që ai shpresonte. Por nëna Yvonne-Aimée i ndërpreu mendimet e tij dhe tha: „O, sa e mirë është, ajo krijesë e mjerë! Derisa më fliste, e pashë gjithë jetën e sajë.“

Të nesërmen atë Labutte e vizitoi përsëri gruan e sëmurë dhe e gjeti të ndryshuar plotësisht. Madje ajo e pyeti: „Kush ishte ajo shenjte e panjohur që ma keni sjellë? Nuk më tha asgjë të pazakontë, por derisa më shikonte, e pashë gjithë jetën time se si më kalonte para sysh. Menjëherë kuptova se Zoti është i mirë dhe i mëshirshëm që më kishte lejuar këtë vuajtje. Isha në rrugën e shkatërrimit, dhe këto vuajtje ma kanë shpëtuar shpirtin!“

Vizita e shkurtë e nënës Yvonne-Aimée zonjës Fulgence ishte e mjaftueshme që t'i përmirësojë mendimet e sajë dhe ta aftësoi që me falënderim dhe me gëzim t'i përfundoi ditët e sajë në lutje.

Kur zemra është e zhytur në mëshirën e Jezusit, Ai në atë qenie e drejton vet shikimin e Zojës. Nuk ndalon në të keqen evidente, por depërton nëpër hijet që e rrethojnë personin dhe bashkohet me pjesët më intime të shpirtit të tij dhe atje takon butësinë e paskajshme që pushon në zemrën e çdo personi.¹⁰⁹

Pushoni së përgojuari!

Disa muaj para se të na braktiste, fra Sllavko Barbariq¹¹⁰ propozoi një mënyrë të reagimit, praktike dhe efikase, kur të merret vesh se ka ndodhur e keqja.

Atë Sllavko jo vetëm që ishte apostull i Jezusit, rrëfyes dhe psikoterapeut profesional, por kishte edhe aftësinë e shtjellimit të shpirtit njerëzor dhe sjelljeve jo të shëndosha që ai mund të manifestonte. Thoshte: „Kur shohim se ka ndodhur e keqja ose kur dëgjojmë se filani është sjellë keq, ne shpejt thërrasim miqtë tanë: 'Eja se kam një tregim për ty. Nuk do t' u besosh veshëve!' Shpenzojmë shumë kohë në ritregimin e asaj të keqeje dhe në këmbimin e komenteve të ndryshme. “

„Mirëpo, është një qëndrim më i mirë kur ballafaqohemi me të keqen dhe vuajtjen. Thirrni miqtë dhe u thoni: 'Kam tregimin për ty në lidhje me filanin. Mund të vish por do të ta rrëfej vetëm nëse do ta lusësh me mua gjithë rruzaren për atë person ose nëse me mua agjëron për të!' Do të shihni se shumë nga miqtë tuaj nuk do të jenë më të interesuar që ta dëgjojnë tregimin! Numri i dëgjuesve tuaj do të zvogëlohet dukshëm! Por duke iu falënderuar atyre që pranojnë lutjen dhe agjërimin, do ta ndërroni situatën e keqe në diçka pozitive dhe do të bëni diçka të mirë. Do të shmangni shumë fjalë të zbrazëta që ushqejnë kureshtjen dhe lëndojnë dashurinë.“

Kjo është një mënyrë e sigurt që të punojmë në kthimin tonë dhe të shkojmë kah shenjtëria. Të faleminderit, fra Sllavko!

¹⁰⁹ „Të dashur fëmijë, sikur të mund të shihnit butësinë që gjendet në zemrën e çdo njeriu, do t' i donit ashtu si i dua unë, të mirët dhe të këqijtë.“ (Porosia grupit të lutjes në Megjugorje)

¹¹⁰ Fra Sllavko Barbariq, françeskan i njohur, erdhi në Megjugorje më 1982., një vit pas fillimit të dëftimeve. Atij iu besuan shtegtarët. Vdiq më 24. Nëntor të vitit 2000.

“Të dashur fëmijë! Sot ju ftoj për dashuri, që i kushtohet dhe është e pëlqyeshme ndaj Zotit. Fëmijëz, dashuria pranon çdo gjë, çdo gjë të fortë dhe të hidhur, për Jezusin që është dashuri. Prandaj, fëmijë të dashur, lutni Zotin të ju vijë në ndihmë, por jo sipas dëshirave tuaja, por sipas dashurisë së Tij. Dorëzohuni Zotit, që ai të mund të ju shëroi, ngushëlloi dhe të ju fal të gjitha ato që në ju janë pengesë në rrugën e dashurisë. Zoti mund të formëson jetën tuaj dhe ju do të rriteni në dashuri. Lavdëroni Zotin, fëmijë, me himne dashurie, që dashuria e Zotit të mund të rritet prej ditës në ditë deri në plotësinë e vet. Ju faleminderit që i jeni përgjigjur thirrjes sime!” (25. nëntor 1998.)

46

GJETJA E FËMIUT

Kur i Keqi kupton se përkundër përpjekjeve të tij nuk është në gjendje të helmoi ndonjë shpirt, të zgjedhur prej Zotit për mision të veçantë, ai shfrytëzon metodën e vjetër aq sa edhe bota: ai sulmon fort, personin më të afërt të tij¹¹¹, ose ndonjë person tjetër të afërt:

Për mbretin David, ishte Absalomi, djali i tij;

Për Jezusin, ishte Juda, njëri prej të dymbëdhjetëve;

Për Shën Franën e Asizit, ishte i vëllau Ilia;

Për Shën Serafim Sarovskin, ishte i vëllau Ivani;

Për Shën Bernardën Soubirous, ishte motra e sajë superiore;

Për motrën Faustinë Kowalska, ishte motra medicinale e sajë;

Për Atë Pion, ishte arkipeshëvi i tij;

Për Filiolën, i shoqi;

Për Marta Robin, komshiu...

Fillimisht të gjithë njerëzit dukeshin „normal“ dhe kanë mundur të mbeten të tillë edhe më tutje. Çfarë e motivoi atë ndryshim dhe atë urrejtje ndaj këtyre „të zgjedhurve të Zotit“? Pse ata përndjekës kanë filluar t’i shohin shenjtërit si caqe në të cilat do t’i lirojnë epsheet e tyre destruktive? Çfarë lloj verbësie i kaploi ata?

¹¹¹ Gjashtë veguesit e Megjugorjes nuk janë përjashtim nga kjo rregull!

Vetëm Zoti mund t'i shqyrtoi zemrat dhe mendjet, dhe fatmirësisht, kjo nuk është puna jonë! Të mjerët na nëse fillojmë të gjykojmë sepse atëherë edhe veten ia nënshtrojmë gjykimit! Jezusi tha: „Mos gjykoni, që të mos gjykoheni!“¹¹² Në të vërtetë asnjëri nga shenjtërit e përmendur më lart nuk është hakmarrë ndaj atyre njerëzve dashakëqij. E kanë pranuar kryqin e vet, janë lutur, kanë falur dhe kanë falur përsëri, e mbi të gjitha i kanë dashur.

Absalomi provoi të rrëzoi nga fronti të atin, mbretin David, ta marrë pushtetin dhe ta vrasë.¹¹³ Mirëpo, ai vdiq i pari duke kalëruar mushkën. Sa lotët i derdhi Davidi i pikëlluar kur i dhanë lajmin mbi vdekjen e Absalomit! Davidi e donte të birin me gjithë zemër, me dashuri që i kundërshtonte agresivitetit, armiqësisë dhe urrejtjes!

Pos shembujve të shenjtërve, ekzistojnë edhe libra të shkëlqyer mbi jetën shpirtërore të cilat na mësojnë se edhe ne, do të gjykohemi në bazë të dashurisë, në gjyqin e fundit. Kjo, pa dyshim, është e qartë. Ato, po ashtu, theksojnë se niveli i dashurisë së vërtetë tek një person matet me dashurinë që ai ka për armiqtë, ata të cilët ja dëshirojnë dhe ata të cilët ja shkaktojnë të keqen. Në këtë lëmi kemi arsye të frikohemi! Megjithatë, pas meditimit nën dritën e Biblës, duhet t'i nënshtrohemi kësaj të vërtete të mrekullueshme. Sepse, kur i duam ata që na duan dhe na nderojnë, ata që janë të mirë me ne, mund të mashtrohemi në lidhje me veten tonë dhe në lidhje me zemrat tona. Të duash në këtë mënyrë kërkon vetëm ndjenjë natyrore, së paku një kohë të caktuar. Mirëpo, të duash ata që na shkaktojnë dhembje, kërkon dashurinë që del nga dashuria hyjnore – vetëm dashuria e natyrës hyjnore e mundëson këtë. Atje ku dashuria njerëzore shpenzohet dhe zhduket, në vend të sajë vjen dashuria hyjnore dhe me ndihmën e hirit mund të bëjë atë që vetë trupi nuk mundet. Kjo dashuri hyjnore është lloji i dashurisë për të cilën flitet këtu dhe e cila do të jetë e rëndësishme për ne në ditën e gjyqit.

Bota merret vetëm me ndjenja, kurse ndjenjat vijnë e shkojnë. Dobësohen dhe ndryshohen në vallen e ngatrrueshmërisë së gjithëmbarshme. Ngatërrueshmëria bëhet përherë e më e dhimbshme. Por nxënësit e Krishtit ushtrojnë dashurinë derisa nuk e japin jetën e vet ashtu si Zotëria i tyre. Kjo kërkon shumë kohë dhe lutje.

Misteri i shenjtërve është në dhembshurinë e tyre. Larg nga vlerësimi dhe gjykimi i personit pranë tyre i cili papritur shndërrohet në luan ulëritës, ose më saktë në „shërbëtorin e djallit“ i cili i mundon, ata në atë person shohin fëmijën ashtu si ishte dikur. Nuk i lejojnë vetes që të jenë të okupuar nga e keqja e cila vepron kundër tyre. Para së gjithash mendojnë në shpirtin e atij fëmije të shkatërruar nga armiku i pakursyer në vrazhdësi. Dhe qajnë për atë shpirt të dashur për Zotin.

Kjo është çudi: vlerësimi negativ zhduket në takim me dhembshurinë. Gjykimi rrënohet para valëve të dhembjes që e përfshijnë nxënësin e vërtetë. Prandaj nxënësi angazhohet për armikun e tij; vazhdimisht angazhohet për të sepse i dhimbset dhe sa më shumë që angazhohet më shumë e do.

¹¹² Mt 7,1

¹¹³ 2 Sam 15-18

Të shohësh në armikun tënd më të madh shpirtin e pikëlluar dhe të lënduar të fëmijës së vogël, të fëmijës i cili është në rrezik sepse gjendet në tharkun e ujkut që është djalli – ky është çelësi i dhembshurisë së shenjtërve. Kjo është rruga deri në fitoren mbi vetveten dhe mbi natyrën e tyre e cila – si natyra e të gjithë njerëzve – më me dëshirë do t’i çonte në hakmarrje.

Është e mundur të gesh fëmijën në armikun tënd. Në shkollën e sajë të dashurisë, Zoja nuk i ka kursyer të rinjtë nga Megjugorja nga praktikimi i ushtrimeve të caktuara shpirtërore në të cilat ata kanë mësuar pikërisht këtë. Me javë të tëra u është dashur të kalojnë kohën me armiqtë e tyre më të mëdhenj (ose së paku me anëtarin e grupit i cili nuk u ka pëlqyer). Duke vepruar kështu, ata kanë mësuar se si ta njohin, të shohin se cilat janë nevojat dhe vështirësitë e tij, t’i ndihmojnë në një mijë mënyra dhe të luten për qëllimet e tij duke zbuluar ëndrrat e tij. Shkurt, kanë mësuar të duan në mënyrë hyjnore! Pak nga pak, antagonizmi u shndërrua në profesion dhe pastaj në dashuri të vërtetë.

Në Megjugorje kisha rastin që të përjetoj diçka të bukur në shkollën e Zojës. Një person nga fshati me vite më shkaktonte dhembje. Nuk e di se sa herë e kam rrëfyer që kam gjykuar gabimisht për të. Sado që jam lutur dhe përpjekur t’i numëroj kualitetet e tij, mëkatoja duke gjykuar për të gati gjithherë që merrja prej tij të goditurën tjetër. Kështu ishte deri në ditën kur e njoftova rastësisht personin i cili e njihte mirë atë njeri dhe familjen e tij gjatë fëmijërisë së tij.

Më foli për ngjarjet shumë të dhimbshme që kishte kaluar ai djalosh nga komunistët dhe se si familja e tij kishte vuajtur nga uria, ankthi dhe padrejtësia. Nuk më kurseu nga asnjë detaj. Shtoi se ato dhembje, fshehtazi, kanë mbetur në zemrën e këtij njeriu dhe, sipas gjase, gjakderdhja do të ndërpritet vetëm në qiell. Zemra më kërcëu kur e dëgjova këtë dhe qëndrimi im ndaj këtij „armiku“ u ndërrua plotësisht. Në mënyrë krejt të thjeshtë, dashuria hyri në zemrën time. Sa i takon gjykimit negativ për të, e njëjta dashuri, menjëherë rregulloi çdo gjë!

Atëherë kuptova pse Nëna e Bekuar aq shumë insiston që t’i duam të gjithë njerëzit, të mirët dhe të këqijtë, ashtu si ajo i do.¹¹⁴ A s’është dashuria e sajë amënore? Madje edhe nëse do t’i kishte pasur para sysh krimet më të rënda të fëmijës, ai nuk do të ishte asgjë më pak fëmija i sajë dhe ajo do të gjente gjithmonë mënyrë që ta kuptoi, ndoshta edhe ta arsyetoi. Se shpreson në të përkundër të gjithave dhe shkurt: që ta dojë pakufi. Zemra e nënës mund të arrijë edhe të pamundurën. Ajo ka forcë fenomenale!

Të gesh fëmijën në personin tjetër kërkon udhëtimin në sferat që kanë formuar atë person dhe takimin me të, në pafajësinë e tij të hershme. Cila zemër nuk do të shkrihej në takim me pafajësinë e fëmijës? Sa u takon të tjerave, të gjitha gabimeve që ndoshta kanë ndodhur në moshën e rritur, le të ia dorëzojmë Zotit, ëndrra e vetme e të cilit është të bëjë vepra Shpëtimtari!

¹¹⁴ „Dëshiroj që t’i doni të gjithë me dashurinë time: të mirët dhe të këqijtë. Vetëm ashtu dashuria do të ngadhënjejë në botë.” (Porosia më 25. maj 1988.)

“Të dashur fëmijë! Dëshiroj që mesha shenjte të jetë dhuratë e përditshme për ju. Merrni pjesë në të dhe dëshironi që të filloi. Në meshë Jezusi iu dhuron vetveten. “ (30. mars 1984.)

47

SCOTT, OSE SHOK TERAPIA

Megjugorje, tetor 1999.

Scotti erdhi pa dëshirë në Megjugorje.¹¹⁵ Si protestant i mirë, i futur në midisin më ortodoks katolik, kishte të drejtë të protestonte! Paraprakisht e kishte njoftuar, Terezën, të shoqen që ishte katolike, se nuk do të rrinte me grupin, por do të vizitonte Mostarin, Dubrovnikun dhe vendet tjera në rrethinë. Me fjalë tjera, do të ketë një pushim më “normal”! Scotti drejtonte firmën e madhe të informatikës në Angli dhe kishte nevojë për pushim. I tha vetes: „Do t’ua lë dëftimet katolikëve. Në fund secili të veten!“ Mirëpo, e mahnitën kodrat e Megjugorjes dhe vendosi që disa ditë, në fillim, të jetë fotografi dhe kameramani i gjithë grupit.

Nëpërmes të shoqërimit të përditshëm, bisedat në mes të anëtarëve të grupit sa vinin e bëheshin më të gjalla. Pak nga pak u krijuan miqësi dhe mbretëronte atmosferë gëzimi. Ditën e katërt Scotti filloi bisedën me atë Fredin i cili i pëlqente shumë:

„Deri tani rezultati është dy me dy.“

„Ç’do të thuash me këtë, Scott?“ pyeti atë Fredi.

„Kur ishte kungimi, dhe unë u afrova me duart e kryqëzuara në kraharor, dy meshtar më bekuan, kurse dy të tjerë më anashkaluan pa bekim.¹¹⁶ Supozoj se këta dy të fundit nuk u ndalën, sepse hostet që i mbanin do duhej t’i kthenin në tabernakull, dhe pastaj të më bekonin.“

Duke marrë pjesë në dëshpërimin e Scottit, atë Fredi e shfrytëzoi rastin që ta pyes mbi kuptimin e eukaristisë për të. „Për mua“, u përgjigj Scotti, „hostja është simbol i cili më mundëson që publikisht ta pranoj Jezusin. Nuk është trupi i vërtetë i Krishtit.“ Shpjegoi se para se të martohej me Terezën, e kishte studiuar me kujdes fenë katolike. E vetmja gjë që kurrsesi nuk kishte mundur ta pranonte ishte besimi në praninë e vërtetë të Jezusit në eukaristi.

¹¹⁵ Scott Black është nga vendi Hastings, në krahinën Sussex, në Angli. Shikoni faqet me fotografi.

¹¹⁶ Meqë Scott ishte protestant dhe nuk besonte në praninë e vërtetë në Eukaristi, sipas rregullave të Kishës nuk mund të kungohet. Por me duart të kryqëzuara mbi kraharor i jep shenjë meshtarit se dëshiron të pranoi bekimin meshtarak.

Atë Fredi e provokoi: „Lexoni kapitullin e gjashtë të ungjillit sipas Gjonit i cili flet mbi Bukën e Jetës dhe luteni Jezusin që të ju ndihmoi ta kuptoni.“ Scotti provoi të ndjek këto këshilla. Shkoi në kapelën e adhurimit për t’u lutur, por asgjë nuk ndodhi... Nuk pranoi kurrfarë ndriçimi nga lart.

Të nesërmen Scotti kuptoi se, në të vërtetë, nuk dëshiron të largohet nga Megjugorja. Donte të rrinte me Terezën dhe të vazhdonte të kultivonte miqësitë e mira me anëtarët e grupit, që ndjente se i përkiste.

Kur e vizituan kapelën në Oazën e paqes ku është i ekspozuar Sakramenti i Tejetshenjtë i Altarit, atë Fredi sugjeroi që të gjithë të qëndrojnë të koncentruar në heshtje që të mund të hyjnë më thellë në lutje dhe të kalojnë një kohë me Jezusin. Por, në atë vend, i shtypur nga prapa, Scotti gjatë disa minutave të para u ballafaqua me një dukuri të pazakontë. Përpiquej me gjithë forcën ta luste Zotërinë Jezus, por të vetmet fjalë që i vinin ish in ato nga rruzarja: „Shenjta Mari, Nëna e Hyjit, lutu për ne mëkatarët, tash e në fill të vdekjes.“

Këto fjalë, papritur dolën në sipërfaqen e trurit të tij me një rrjedhë të ngadalshme e të qetë por ngultas, duke mos lënë vend për fjalë tjera! Truri nuk i punonte. Ku ishin lutjet të cilat ja drejtonte Jezusit? I dukej se dikush tjetër lutet në të me ato fjalë që kurrë më parë nuk ishin të tijat! Për më tepër, ditët e mëparshme, kur grupi luste rruzaren së bashku, Scotti me vetëdije rrinte më larg.

Ishte një situatë e jashtëzakonshme. Të gjithë katolikët adhurorin Jezusin, kurse protestanti i vetëm në grup i lutej Marisë! Qielli i ka çastet e tij të humorit...!

Pastaj erdhi koha për meshë në kishën e Shën Jakobit. Scotti u ul në bankën pranë Terezës në anën e djathtë të kishës. Kur erdhi koha e kungimit shenjt, koncelebrantët e shumtë u nisën nga altari drejt popullit, secili duke bartur tabernakullin, dhe filluan të ndajnë kungimin shenjt besimtarëve që qëndronin në korridoret në mes të bankave.

Edhe Scotti u ngrit dhe priste pranë Terezës me duar të kryqëzuara mbi kraharor. Tereza e mori kungimin dhe meshtari në mënyrë automatike e mori hosten tjetër, dhe duke mos shikuar në Scottin, e ngriti drejt tij. Kur pa se duart e tij janë të kryqëzuara, nuk u ndal për ta bekuar, por hosten ia dha personit pranë tij. Scotti u kthye në vend të vet dhe u gjunjësua që të lutet.

Ishte i dëshpëruar dhe gati i ofenduar. U kthye kah Tereza dhe tha: „A e pe?“

„Po...“

Atmosfera ishte e rëndë. Por edhe dy meshtar u nisën nëpër korridorin e tyre dhe Scotti e pyeti Terezën: „Të provoj edhe një herë?“

„Po, po!“

Scotti u ngrit dhe meshtari i parë ia vuri duart mbi kokë dhe i dha bekimin e sinqertë, nga zemra. Scotti u kthye dhe u gjunjëzua përsëri, por meshtari tjetër, që ishte atë Fredi, iu afrua dhe shumë ngadalë e bekoj Scottin me hostie duke bërë shenjën e kryqit.

Në atë çast Scotti filloi të dridhet. Ishte i habitur sepse njeriu që kishte ardhur ta bekoj, njeriu të cilin ai e njihte dhe me të cilin i kishte kaluar gjashtë ditë, u shndërrua pikërisht para syve të tij. Scotti tani shikonte Jezusin, e jo Fredin! Ishte Jezusi ai që iu afrua dhe e bekoj me shenjën e kryqit! Ishte Jezusi që e mbante dhe i ofronte hosten!

I shtanguar, Scotti e mori hosten dhe mbeti pa fjalë i vërshuar nga ndjenjat. U kthye në vend të vet, mbuloi fytyrën me duar dhe filloi të qajë qetë. Njerëzit afër tij shikonin se si i ngrihen shpatullat, por askush as nuk mendonte se ai kishte përjetuar një përvojë aq të jashtëzakonshme. Vetëm ai e kishte parë, vetëm ai e dinte. Kur mesha përfundoi, doli prej kishë duke u mbështetur në Terezën, e cila edhe pse nuk dinte se çfarë kishte ndodhur, e dinte se Zoti në njëfarë mënyre e kishte prekur të shoqin. U ulën në bankën para kishë. I kaploi një heshtje e thellë. Scotti nuk mund të thoshte asnjë fjalë dhe Tereza, duke respektuar këtë, priste me durim, edhe pse zemra i rrihte me shpejtësi.

Kaluan ulur nja dhjetë minuta të mirë nën diellin e butë të tetorit. Grupi u shpërnda. Duke parë se kanë mjaft kohë, Scotti provoi të flasë, por nuk mund të përfundonte fjalinë pa shpërthyer në vaj. Iu desh edhe mjaft kohë derisa mundi të flasë. Kur, më në fund, Tereza e dëgjoi fshehtësinë e Scottit, u trondit thellë dhe atëherë kuptoi pse, edhe ajo kishte ndjerë shugurim të fortë në çastin e bekimit dhe, pse edhe ajo vetë nuk kishte mundur ti ndalë lotët.

Atë mbrëmje, kur zakonisht fillonin bisedën rreth tavolinës, Tereza i pëshpëriti Scottit që të dëshmoi përvojën e vet të tjerëve, por ai kundërshtonte. „Nuk do të më besojnë“, tha. Mirëpo, të nesërmen, ditën e fundit të shtegtimi, Scotti shkoi vetë në Kodrën e dëftimit. U përmbys para kryqit dhe e luti Zojën për udhëheqje – që t’i tregonte se çfarë të bëjë dhe çfarë të thotë për dëftimin e Jezusit që iu dhurua në kishë.¹¹⁷

Vetëm në aeroportin e Dubrovnikut, vendosi që para atë Fredit ta hap zemrën, por ishte nervoz. Natyra pragmatike e Scottit i pengonte që ta zbuloi një fshehtësi të tillë, sidomos para një burri tjetër. Pyetej se si do të reagoi ai. A do ta konsideronte atë Fredi „ëndërrimtar“?

Kur e dëgjoi fshehtësinë, atë Fredi lëshoi shikimin për tokë, dhe duke menduar thellë, shkurtimisht mbështeti mjekrën në dorën e djathtë. E pastaj, papritmas, si të ndizej drita, ngiti dorën lart dhe klithi: „Çfarë mëshire! Çfarë bekimi keni pranuar! Ruajeni dhe ndajeni me të tjerët! Për mua është privilegj se isha vegël e Zotit për këtë mëshire!“

Meshtari vuri duart mbi krahët e tij dhe për disa çaste u lut në heshtje. Dhe atëherë, me një buzëqeshje të dashur e të butë i tha: „Dhe tani, a e shihni se personi në kungimin shenjt vërtetë e pranon Trupin e Krishtit, dhe jo vetëm një simbol?“

¹¹⁷ Në atë kohë kryqi i metaltë nuk ishte ndërruar ende me truporen e Zojës e cila, sot, qëndron atje.

Pas kthimit në Angli, Scotti dhe Tereza u takuan me miqtë dhe Scotti filloi të dëshmoi me guxim. Të gjithë atyre që donin të dëgjonin u tregonte për fshehtësinë e vet. Kush nuk do t'i besonte? Aq shumë u ndërrua vetëm për disa ditë! Jeta e tij kurrë më nuk do të jetë e njëjtë.

„Sa herë i mbyll sytë“, tha, „shoh fytyrën e Jezusit, fytyrën plot dashuri dhe mëshirë. Kjo është shumë prekëse! Të gjithë ne shikojmë, në shtëpi, fotografitë e Jezusit dhe të Marisë. Por, sa prej nesh e kuptojnë se edhe Jezusi dhe Maria na shikojnë neve?“

„Disa njerëz janë pyetur: 'Pse ti? Ti as nuk ishe katolik!' Nuk kam përgjigje në këtë pyetje. Por, nëse më është dhënë ky vizion si përkujtues atyre që e marrin kungimin shenjt, se në hoste vërtetë pranojnë Krishtin, atëherë porosia është përcjellë!“

Që nga 10. tetori 1999., asaj dite të bekuar të vizionit në Megjugorje, Scotti nuk kishte përvoja tjera, të tilla, shpirtërore. Si edhe të gjithë të tjerët, e lut Zotin që ta udhëheq, derisa në jetën e përditshme ec me Jezusin.

Më 9. Shtator të vitit 2000. Scotti u pranua në Kishën katolike.¹¹⁸

¹¹⁸ Momentalisht gjendet në krye të këshillit Pastoral të kishës së Shëlbuesit shenjt në Hastings, ku kryen punë të shkëlqyer. Falë faktit se është i talentuar në informatikë, shfrytëzon çdo rast që të shpërndajë porositë e Megjugorjes.

“T dashur fëmijë! Sot ju thërras të dashuroheni në Sakramentin Tejetshenjt të Altarit. Adhuroni atë, fëmijë, në famullitë tuaja dhe ashtu do të jeni të bashkuar me mbarë botën. Jezusi do të bëhet miku juaj dhe nuk do të flisni për të si për dikë që posa e keni njoftuar. Bashkësia me të do të jetë gëzimi juaj dhe do të jeni dëshmitarët e dashurisë së Jezusit, që ai e ka për çdo krijesë. Fëmijë, kur e adhuroni Jezusin jeni edhe afër meje. Ju faleminderit që iu përgjigjët thirrjes sime!” (25. shtator 1995.)

48

WEB FAQJA PËR ADHURUESIT

Megjugorje dërgon kolonizuesit, kurse Anne Marie Collins, mikja tridhjetëvjeçare nga Irlanda është njëra nga to. Lumturia e sajë lindi në Megjugorje.

Si adoleshente shkonte më meshë nga shprehia, këshillohej me shortar dhe, si thoshte Zoja për shumë të rinj, „kërkonte lumturinë në vendet në të cilat, në të vërtetë, ajo humbet.“

Jepte mësim në shkollën Montessori, kurse familja e sajë mbante një dyqan me mall të përzier i cili nuk shkonte bash mirë. Prandaj bënë një marrëveshje me Zojën. Nëse iu ndihmon ta shesin mallin, të gjithë do të shkojnë në Megjugorje. Zoja u tregua si afariste e shkëlqyer sepse vetëm pas tri javësh i takoi me blerësin. Kështu familja Collins më 25. Gusht të vitit 1999., arriti në Megjugorje. Atëherë fillon tregimi për Anne Marie.

Ditën e parë, në meshën angleze, i gjithë predikimi ishte për shortarët dhe astrologët. Anne Marie rrinte në buzë të ulëses, e prekur thellë. Kishte përshtypjen se predikimi i drejtohej pikërisht asaj dhe se meshtari i drejtohej në mënyrë direkte.

Prandaj vendosi të shkoi tek ai, në rrëfim. Se çfarë rrëfimi mbresëlënës ishte ai! I rrëfejë shkuarjet e saja të shpeshta tek shortari dhe duke dalë nga rrëfyestorja, në zemër e kuptoi se nuk është në shenjën e Luanit, si e kishin nxitur të mendonte deri atëherë. Në vend të kësaj ishte e shënuar me shenjën e Jezu Krishtit! E kaploi një ndjenjë e fuqishme lirie.

Atë javë ndjeu një afërsi të pabesueshme me Zojën. Sikur në Podbërdo dhe Krizhevac ecin së bashku, duke u mbajtur për dore! Mbrëmjen, para se të ktheheshin në Irlandë, Anne Marie përjetoi diçka të veçantë me Zojën. Derisa qëndronte me të ëmën jashtë kisha, lutej së bashku me famullinë duke shikuar kokërrat e rruzares së sajë. Papritmas, sikur dikush ia ngriti kokën. Kur

shikoi lart, e pa Zojën se si e shikon me buzëqeshje. Anne Marie tha se kurrë nuk do të mund të harroi buzëqeshjen në fytyrën e Zojës! Nuk e tha asnjë fjalë por buzëqeshja e sajë i tha të gjitha. Se çfarë dashurie kishte në atë buzëqeshje! Buzëqeshte sikur në atë çast donte ta përqafonte me forcë. Ishte aq e bukur! Prej atij çasti për Anne Marie jeta ndryshoi krejtësisht. Kishte arritur pikën nga e cila nuk ka më kthim prapa.

Kur u kthye në Irlandë, Anne Marie e thirri menjëherë të fejuarin e sajë dhe i tregoi se kishte kaluar një javë të mrekullueshme. Ndau me të përvojën e sajë të pabesueshme, por ai vetëm lëkundte kokën. S’i besonte! Edhe gjërat mes tyre filluan të ndryshojnë. Raporti i tyre nuk ishte më i njëjtë. E luste Zojën: „Nëse do që ta ndërpres këtë lidhje mos lejo të më thyhet zemra.“ Pastaj i tha atij: „Nuk mundem më kështu. Mendoj se nuk je ai që Zoja do për mua.“ Edhe ai u vetëdijesua se nuk janë njëri për tjetrin. Kur e shkëputën lidhjen, Anne Marie ndjeu se si barra iu hoq nga shpatullat.

Para së gjithash, Zoja nxiti në Anne Marie dëshirën për meshën shenjte dhe ajo filloi ta ndjek. Po ashtu iu bashkua grupit të lutjes. Pastaj gradualisht filloi të dëshiroi adhurimin eukaristik. Zoja vepron me aq shumë takt! E dinte se Anne Marie duhet ta ushqejë me lugë sepse ende nuk ishte e gatshme për ushqim të fortë.

Në vitin 2004., kur Gjon Pali II. shpalli Vitin eukaristik, Anne Marie vendosi me disa miq të bëjë diçka të veçantë. Zoja iu kishte dhënë dhuratën e adhurimit kur ishin në shtegtim në Megjugorje. Kishte bërë që të kuptojnë fuqishëm se Biri i sajë vërtetë është i pranishëm në Sakramentin Tejetshenjti dhe të kenë vetëm një qëllim: ta rrethojnë Jezusin me sa më shumë adhurues!¹¹⁹ Atëherë në zemrat e tyre lindi ideja e cila do t’i ndihmonte Jezusit eukaristik që ta drejtoi thirrjen e tij në të gjitha drejtimet dhe që të sjell adhuruesit më të vetmuar potencial të tij. Kjo ishte më e lehtë të thuhet se sa të bëhet: të punosh web faqen ku secili, pavarësisht ku gjendet në Irlandë, do të mund të mësonte se ku dhe kur e thërret Jezusi që të vij. Duke shikuar web faqen, do të mund të mësonin se ku mbahet adhurimi – në cilën kishë dhe në cilën kohë. Informata pastaj do të mund të përcillej më tej duke rritur efektin. Anne Marie me grupin e saj iu përvesh punës me

¹¹⁹ Motra Faustinë ka parë atë që ne nuk shohim. Ajo ka shkruar kështu për adhurimin e paharrueshëm: O "Orë Shenjte. – E Enjte. Gjatë orës sime të lutjes Jezusi më lejoi të shoh sallën e darkës së Fundit dhe të përjetoj të gjitha ato që kanë ndodhur atje. Më së thelli isha e pushtuar me çastin kur Jezusi para shndërrimit i ngriti sytë drejt qiellit dhe hyri në bisedën misterioze me Atin e Tij. Atë çast do ta njoh si duhet vetëm në amshim. Sytë e Tij ishin si dy gaca zjarri, fytyra e ndezur, e bardhë si bora, e gjitha plot lavdi, shpirti i Tij në një dëshirë të madhe. Në çastin e shndërrimit u qetësua dashuria e plotësuar. – Flia ishte e realizuar në plotësinë e vet. Tani duhej plotësuar vetëm ceremonia e jashtme e vdekjes – të kryerit e jashtëm. Thelbësorja ndodhi në sallën e darkës së Fundit. Gjatë gjithë jetës sime nuk kam pasur aq njohje të thella të këtij misteri, si gjatë kësaj ore të adhurimit. O, sa shumë dëshiroj që mbarë bota ta njohë këtë mister të pafund." (*Ditari*, § 684)

zjarrin e atyre që kanë gjetur visarin në arë dhe donin ta blejnë atë arë. I gjetën numrat e telefonave të të gjitha famullive, të të gjithë meshtarëve, të kapelave dhe të shenjtoreve tjera, në Irlandë, dhe i thirrën. Të gjesht numrat është një gjë kurse një gjë tjetër është të kesh punë me sekretaret telefonike dhe të të duhet të thërrasësh përsëri! Fatmirësisht, adhuresve nuk u mungonte duresa dhe qëndrueshmëria, sidomos, sepse nga shumica e meshtarëve morën reaksione pozitive. Disa meshtarë ishin të ngazëllyer se nga Anne Marie dhe shokëve të sajë kishin marrë një mbështetje provanie për shërbesën e tyre. Përfundimisht do të mund të realizonin ëndrrën e cila deri tani dukej e pamundur. Ëndrra mbi fillimin e adhurimit të pandërprerë eukaristik në kishën ose kapelën e tyre!¹²⁰

Zemra e Anne Marie ishte e vërshuar me gëzim pas çdo fitoreje të re. Jezusi do të jetë i dashur përherë e më shumë. Do të mund të shpërndante veprën e vet hyjnore në sa më shumë zemra. Gradualisht do ta ndez flakën e tij në qetësinë e atyre orëve të shenjta. Do të mund të bënte për vete qytete e fshatra dhe të përtërinte mantelin e Kishës së Vet nga brenda, në agoninë e dashurisë.

Anne Marie gjeti punë në një argjendari për gjysmën e orarit të punës që i ofronte liri të plotë. Kohë e sajë e kalonte në mes të Megjugorjes dhe Dublinit. Kishte nevojë të tërhiqej për shumë kohë në Megjugorje, nën mantelin e Zojës, në qetësinë e lutjes, që të mund të përtërihej para kthimit në arenë. Ishte kjo një betejë e vështirë – të bësh këtë punë të rëndësishme që djalli nuk mund ta duronte. Por kjo ishte e pritshme sepse me secilën fitore të saj Ane Marie ia merrte pasuesit atij!¹²¹

Një ditë, kah fundi i qëndrimit të gjatë në Megjugorje, Anne Marie filloi të ndjehet keq. Pas kthimit në Dublin, përfundoi në spital. U diagnostikua me sëmundjen e Addisonit, sëmundje serioze që i sulmon gjëndrat mbiveshkore dhe kërkon trajtim të dhimbshëm mjekësor. Me dozat ditore të kortizonit, Anne Marie shpesh ishte e raskapitur, madje edhe kur nuk punonte asgjë. Nëse nuk ndodh edhe një mrekulli e dinte se do të mbetej e hendikepuar deri në fund të jetës.¹²²

¹²⁰ Ky është shembull nga Shtetet e Bashkuara mbi forcën e adhurimit të pandërprerë. Në arkiveshkinë e Indianapolisit, msgr. Buechlein ka kërkuar nga të gjitha famullitë që të mbajnë orën e Shenjtë një herë në muaj që të mund të fitohen nga Zotëria thirrje meshtarak dhe rregulltare. Nga 152 famulli të arkiveshkinës, vetëm 17 i është përgjigjur thirrjes dhe ka organizuar Orën e Shenjtë mujore. Kjo ndodhi në vitin 2004. Pas një viti, në fillim të vjeshtës, 17 kandidatë kanë hyrë në seminar! Atë Rick Eldred, shtegtar besnik i Megjugorjes, është meshtar i famullisë së Shën Vinkut në këtë arkiveshëvi në Indianapolis. Deklaroi se gjërat zhvillohen mirë që atëherë. “Vërtetë besojmë se thirrjet, adhurimi dhe Orët Shenjte janë të lidhura mes veti. Arkiveshëvi shpreson që t’i ketë 50 seminaristë, momentalisht i ka 30. Po ashtu është hapur edhe qendra informative.”

¹²¹ Është fenomenale të shohësh se si numri i vetëvrasjeve dhe i fatkeqësive zvogëlohet në vendet ku hapet kapela e adhurimit.

¹²² Sëmundja e Addisonit e mori në vitin 1906., të lumen Elizabetë të Trinisë Tejetshenjte. Vdiq pas shumë vuajtjesh, në moshën 26 vjeçare. Në atë kohë nuk kishte bar i cili do ta shpëtonte.

Gëzimi i ëmbël i takimit të parë me Virgjërën Mari tani u shndërrua në një tjetër lloj gëzimi. Jezusi e thirri nxënësen e tij të vogël që të shkoi me Të më tutje, në rrugën e njohur vetëm Atij – në shtegun misterioz të shtruar me ferra dhe insekte të tmerrshme. Anne Marie mësoi mbi bashkësinë e plotë me Zotin. Në këtë udhë kryqi, ku secila orë sjellë dozën e sajë të vuajtjes, Zoja e mësoi si ta dojë Zotin ashtu si Ai dëshiron ta duam: ta duam vetë Atë, në thjeshtësi dhe me gjithë zemër. Pak nga pak, mrekullia ndodhi në jetën e Anne Marie – një mrekulli më e rëndësishme se mund të ishte çfarëdo shërimi fizik. Udhë e saj e Kryqit u bë udhë gëzimi, udhë me mbushulli frytësh. Anne Marie shkëlqente si kurrë më parë. I solli adhurues Jezusit të saj të dashur nëpër projektin e internetit. Shkëlqyeshëm!¹²³ Por tani këtu ishte edhe shtesa. Fytyra e saj u bë si ostensor i gjallë! Jezusi ishte gjithandej kudo që shkonte. Njerëzit e pyesnin: „Si mund të jesh aq e lumtur me atë sëmundje kaq të rëndë?”

Pyetja e befasonte dhe më gëzim e zbulonte burimin e lumturisë: “Kur jam para Sakramentit Tejetshenj, Jezusi më jep hirin që ta bart këtë kryq dhe të vazhdoj me jetën e përditshme. Nuk do të kisha forcë për këtë sëmundje po të mos e kisha Jezusin. Pa praninë e Jezusit, unë jam asgjë. Të gjithë forcën e marr në adhurim.”

Lutja e adhurimit

“O Zoti im, Trinia të cilën adhuroj,
më ndihmo që krejtësisht ta harroj veten dhe të jem në ty,
e palëvizshme dhe e qetë, si të ishte shpirti im në amshim.

Asgjë që mos e shqetësoi paqen time,
dhe mos lejo të ndahem prej Teje,
o, i Pandryshueshmi im,
por çdo minutë le të më çojë më tutje,

¹²³ Kjo faqe interneti po bën mrekulli. Nuk kalon asnjë ditë, që shfrytëzuesit të mos dëshmojnë për huret që janë marrë dhe që vullnetarët të mos e shtojnë numrin e adhuruesve: www.watchonehour.com

në thellësitë e Sakramentit Tënd.

Qetësoje shpirtin tim; krijo prej tij qiellin Tënd,
banesën Tënde të dashur dhe vend pushimi.

Mos lejo që ndonjëherë të lë të vetmuar,
por që gjithmonë të jem e pranishme,
krejtësisht e zgjuar në fenë time, e gjitha në adhurim,
krejtësisht e dorëzuar veprimit Tënd krijues.”

(E Lumtura Elizabeta e Trinisë Tejetshenjte)

“Të dashur fëmijë! Gëzohem me ju dhe në këtë kohë hires ju thërras në përtëritje shpirtërore. Lutuni, fëmijëz, që në ju të banojë Shpirti Shenjt në plotësi, që të mund të dëshmoni me gëzim të gjithë atyre që janë larg nga feja. Sidomos, fëmijëz, lutuni për dhuratat e Shpirtit Shenjt, që në frymën e dashurisë, për çdo ditë dhe në çdo situatë, të jeni më afër vëllait njeri dhe që në urti dhe dashuri të mposhtni çdo vështirësi. Unë jam me ju dhe ndërmjetësoj për secilin prej jush para Jezusit. Faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime.” (25. maj 2000.)

49

MESHA NË JUAREZ

Atë ditë, një turmë e madhe njerëzish ishte tubuar në Juarez, në Meksikë, kurse disa apostuj të njohur udhëhiqnin lutjen e gjatë pas kungimit shenjt. Shenjat e mrekullitë shumoheshin para syve të njerëzve të tubuar.¹²⁴ Të çalët ecnin, të verbrit shihnin, të shurdhrit dëgjonin, kurse lirimet e brendshme dukeshin gjithandej. Se çfarë gëzimi! Krishti, konsekuent vetvetes, e ngjalli në fëmijët e tij atë prani për të cilën flasin Veprat e apostujve.

Briege McKenna, motër nderi e re, ishte në mesin e udhëheqësve.¹²⁵ E bekonte Zotin, me gjithë shpirt për shkak të fuqisë hyjnore dhe mëshirës së Tij. Vërtetë, zemrat ishin të hapura krejtësisht dhe të vëmendshme, kurse huret rridhnin pa pengesa. Bekimet derdeshin rrëke!

Atë mbrëmje motra Briege ishte tejet e lumtur! Shkoi në dhomën e sajë të hotelit ku Zotëria e befasoi. Kishte për të një porosi e cila do ta ndërronte rrjedhën e jetës së saj. Duke hyrë në kuvend si shumë e re, Briege gjithmonë u kushtonte vëmendje të veçantë pëshpëritjeve intime të Jezusit në zemrën e saj, por atë ditë zëri i Tij ishte më i qartë se kurrë:

„Të kam sjell këtu që të mësoj se ku gjendet forca e vërtetë e pranisë sime të gjallë. Misioni yt është të udhëtosh nëpër botë, t’u flasësh fëmijëve të mi, që t’i përkujtosh në praninë time të vërtetë në të gjithë altarët e botës dhe që t’u flasësh për eukaristinë dhe Sakramentin Tejetshenjt të Altarit.“

¹²⁴ Treguesit karakteristik të apostullatit janë, sipas Shën Palit, shenjat, mrekullitë dhe veprat e bindshme, të bëra me duresë (shih 2 Kor 12,12)

¹²⁵ www.intercessionforpriests.org . Për më shumë informata mbi motrën Briege McKenna shiko kapitullin 7.

Briege, po ashtu, kujton se si Jezusi kishte shprehur pikëllimin e thellë dhe se llogariste në të. Nëse Shën Frana i Asizit qante sepse “Dashuria nuk duhej”, kjo motër e re nderi u lëndua kur dëgjoji Jezusin – dashurinë e gjallë – që tha se si e kishin braktisur fëmijët e tij. Kështu më shkroi në shkurt të vitit 2006:

„Jezusi ma zbuloi se do të vijmë njerëz nga të gjitha anët e botës për të kërkuar shenja dhe mrekulli, do të udhëtojnë në të gjitha vendet e mundshme me shpresë se do të pranojnë porosinë e shërimit dhe të ngushëllimit. Do të kalojnë oqeanë dhe kontinente dhe do të jenë të gatshëm të shpenzojnë pasuritë për të gjetur ndihmë, shpeshherë më kot. Nuk e kanë njohur më të madhen dhe më të jashtëzakonshmen mrekulli nga të gjitha: praninë e lavdishme të Jezusit të Ngjallur në altarët dhe tabernakujt tanë! 'Unë jam burimi i të gjitha atyre bekimeve që u duhen', më tha Jezusi. 'E ata më lënë vetëm.'“

„Motra Emmanuel, prej se e dëgjova këtë urdhëresë që ta ndërmarr këtë mision dhe të udhëtoj në mbarë botën, vazhdimisht kam parë dhe dëgjuar për kthimet e mëdha dhe mrekullitë. Dje, derisa udhëhiqja ditën e lutjes në Florida, një njeri më tha se para katër vitesh ishte në stadet e fundit të karcinomit. Kishte shkuar në kungim pas të cilit kishte qenë adhurimi dhe lutja për shërim. Tha se në çastin kur atë Kevin mbante në dorë Jezusin në ostensor për të bekuar të pranishmit, kishte ndjerë se si nëpër tërë trupin po i kalonte një ngrohtësi. Të nesërmen, karcinomi ishte zhdukur.“

“Të dashur fëmijë! Unë jam Nëna juaj, andaj dëshiroj të ju çoj drejt shenjtërisë së plotë. Dëshiroj që secili prej jush të jetë i lumtur këtu në tokë dhe që secili prej jush të jetë me mua në Qiell. Ky është, të dashur fëmijë, qëllimi i ardhjes sime këtu dhe dëshira ime.” (25. maj 1987.)

50

QIELLI NË PËLLËMBË TË DORËS

Shkurt 1991.

Zonja Ischia e ftoi Vickën në Francë dhe më luti ta shoqëroj si përkthyes. Meqë na duhej të arrinim fluturimin nga Spliti në Paris, që ishte në ora shtatë të mëngjesit, e planifikova me kujdes kohën shtesë për udhëtim dhe një natë para i tërhoqa vërejtjen Vickës:

„Të jesh gati nesër në mëngjes në ora dy. Do vij të të marr me taksì.“

Vicka ishte e saktë dhe atë mëngjes nguteshim nëpër terrenin kodrinor hercegovas. Në pjesën e parë të programit në Paris, Vicka duhej tu dëshmonte disa meshtarëve. Gjatë udhëtimit e pyeta: “Si do të organizohemi për dëftimin që do të kesh në mbrëmje? A do të kërkosh të të falin që të mund të takohesh me Zojën vetëm për vetëm, apo do t’u lejosh meshtarëve që të lutën me ty?”

„Mos u brengos“, mu përgjigj, „tani më e pata dëftimin në mëngjes!“

„Sot në mëngjes... Mendon mbrëmje?“

„Po, kur udhëtoj, Zoja dëshiron të vijë herët në mëngjes. Kështu nuk më duhet të mendoj gjatë misionit si, ku dhe me kënd do ta kem dëftimin. Prandaj, Ajo një ditë më herët në mbrëmje më tregon se kur do të më dëftohet në mëngjes dhe kjo është e gjitha!“

„Nëse të kuptova mirë, mbrëmje të ka thënë se do të vijë sot në mëngjes para se të nisesh?“

„Po. Më tha: ‘Meqë motra Emmanuel do të vijë të të marrë në dy të mëngjesit, unë do të vij në ora një...’“

„Do të thuash se ka thënë pikërisht ‘motra Emmanuel’? Dhe se i është përshtatur orarit që kam caktuar unë? “

„Po! Sigurisht është kështu! Ajo gjithmonë e merr parasysh atë që ne vendosim!“

Për Vickën kjo ishte normale – gjërat kështu shkojnë në jetën e saj të përditshme, por për mua ky ishte një shok. Nëna e Zotit e ka përshtatur orarit që kisha caktuar (për më tepër, e kisha caktuar keq, sepse na u desh që të presim tri orë në aeroportin e zbrazët dhe të ftohtë!). Qëndrova gjatë në heshtje për t'i lejuar mendjes sime ta “përtyp” këtë risi sepse papritmas mu zbulua se si Qielli është në pëllëmbë të dorës. Pra, është e vërtetë – unë jam pjesë e familjes!

Sa të pavetëdijshëm jemi për Qiellin! Se çfarë verbërie! Se çfarë humbjeje! Se çfarë humbjeje e lumturisë!

Për shkaqe personale u ktheva me të dy këmbët në tokë, nëse mund ta them! Vërtetë, u zgjova nga kjo letargji vetëdijeje e cila bën që të jetojmë jashtë realitetit, ose thënë më mirë, e cila na ndan nga gjysma e realitetit, nga ajo pjesa e mahnitshme e jetës që është e jona në planin e Zotit. Ecim në këtë tokë të zhytur në realitetin e pamatshëm të qiellit dhe të jetës së ardhshme. Shenjtërit janë në të njëjtin nivel si ne! Por, meqë jemi të shtrënguar nga kufizimet tona të ngushta të kohës, hapësirës dhe dijes, ne shpejt e reduktojmë fatin tonë vetëm në atë që perceptojmë me shqisa.

Shën Gjoni i Kryqit ka thënë: „Shqisat tona na mashtrojnë.“ Dhe jo vetëm se na mashtrojnë por për më tepër ato na burgosin! Si edhe vënguesit tjerë të Megjugorjes, Vicka është shumë e vetëdijshme por botën tjetër e cila në të vërtetë është këtu.

„Të dashur fëmijë! Nëse më dorëzoheni mua, nuk do ta ndjeni aspak kalimin nga kjo jetë në jetën e ardhshme. Do të filloni të jetoni jetën qiellore në tokë.“ (Porosia Jelenës, në vitin 1986.)

51

VDEKJA SHENJTE, VDEKJA SHENJTE!

Si do të mund ta harroja ditën kur, rastësisht e takova Vickën në Bijakoviqi dhe i tregova se pak kohë më parë në Kaliforni kishte vdekur Marku, i ati i Denis Nolanit? Kërkova që të lutet për të, por, në befasinë time të madhe Vicka nuk tha asnjë fjalë ngushëllimi dhe as nuk u duk se po i vinte keq sadopak. Përkundrazi, fytyra e sajë rrezatoi me një gëzim të madh kur klithi:

„Vdekja shenjte, vdekja shenjte!“

Entuziazmi i sajë ishte aq i madh sa mezi munda të them ndonjë fjalë. Atëherë kuptova se Zoti kishte lejuar këtë takim me Vickën dhe humbjen e madhe të Markut për mua, që të më mësoi diçka. Se çfarë leksioni i mirë ishte ky!

„Kur Zoti vjen të na marrë“, shpjegoi Vicka, „është gëzim të vdesësh! Zoti është aq i mëshirshëm – përveç nëse ne nuk e duam mëshirën e tij! Zoti është aq, aq i mirë! Sikur këta njerëz vetëm ta dinin, nuk do të ishin aq të lidhur për gjërat e kësaj bote. Si mund të jenë të lidhur për to kur sot janë këtu e nesër nuk janë më? “

„Është lehtë për ty ta thuash këtë, Vicka“, i thashë, „Ti ke parë se si duket nga ana tjetër e perdes!“

„Ashtu është! Pikërisht pse e kam parë parrizit, i flas këto gjëra. Kam shpresë se të gjithë do ta njohin këtë. Dëshiroj t’u them të gjithëve se si Zoti është i mirë dhe se nuk do të duhej t’i frikoheshim! Nuk do të duhej t’i frikoheshim vdekjes! Nëse çdo mëngjes kur të zgjohesh do të vendosje të ndjekësh Zotin, jeta jote do të bëhej shumë e bukur. Çdo ditë do të rriteshe shpirtërisht dhe do të ishe përgjithmonë e lumtur. Përgjithmonë! Kjo është, thjeshtë, kështu!“

Atë mbrëmje i lajmërova Denisit mbi takimin tim me Vickën dhe ai m’u përgjigj me postë elektronike:

„Edhe unë pata rastin të shoh atë hir. E përjetova. Zoti vërtetë ishte aty që babait tim t’i ofroi dashurinë e Vet. Përpara ishte katolik si edhe shumë katolik që sot i shohim. Besonte se Zoti ekziston, por kurrë nuk e praktikonte fenë e vet. Kur ia jepnim rruzaren, në vend se të lutej me të ai e rrotullonte në ajër si helikë helikopteri. Natyrisht, ishte njeri i mirë, por nuk ishte shenjt – larg prej kësaj! Por, se çfarë hiri iu dhurua kur e thirri Maria! Po, Zoti vërtetë është në anën tonë! Fjalët e Vickës janë të vërteta. Nuk duhet të kemi frikë prej Zotit.“

Porosia në vazhdim është njëra nga porositë e jashtëzakonshme të Zojës në Megjugorje dhe njëra që ma ka thënë Vicka në kohën kur vdiq Negjo, kunati i sajë: „*Të dashur fëmijë, do të duhej të festoni vdekjen e të afërmeve tuaj me të njëjtin gëzim sikurse festoni lindjen e fëmijës.*”

Të kuptosh madhësitinë dhe shkëlqimin e “botës tjetër” dhe të jesh i vetëdijshëm për ekzistimin e sajë janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme.

Vdekja e prolonguar

Pra, si e thirri Zotëria të babën e Denisit, Markun, tek vetja dhe me çfarë mjetesh hyjnore e ndryshojë këtë “arrë të fortë” shumë?

Denisi shpjegon: „Një natë marsi të viti 1997. Familjen time e zgjoi, papritur, zilja e telefonit. Babai im, i cili atëherë kishte 85 vjet, gjendej në spitalin e Kalifornisë për shkak të inflamacionit të mushkërive. Mjekët e paralajmëruan nënën time se nuk do të mbijetonte atë ditë. Menjëherë u nisa me aeroplan nga Çikago dhe e gjeta në agoni – mezi merrte frymë. Ishte i rrethuar me anëtarët e familjes. Papritur, i hapi sytë, vërejti orën në murin përballë tij dhe pëshpëriti: ‘Është 9.40. Në Kaliforni, 9.40 h i përgjigjet kohës së dëftimit të Marisë në Megjugorje (18.40 h).’“

„I thash: 'Babi, tani Zoja dëftohet në Megjugorje! Thirre atë!' “

„Njëzet minuta e thirri nënën e vet, duke marrë frymë me shumë vështirësi: 'Mari, eja! Nënë, eja!' Kjo ishte, në të vërtetë, hera e parë që e ndjeva babën tim se si lutet me zë!’“

„Në atë moment filloi t’i kthehej fuqia. Të nesërmen ishte aq mirë sa dy infermieret që e çonin nga dhoma e kujdesit intensiv në dhomë të zakonshme të spitalit, kujtuan se është një pacient tjetër. Përsëri filloi me aktivitetet e tij të zakonshme dhe vazhdoi jetën normalisht. Por Zotëria dhe Nëna e tij e Lume kishin hyrë në jetën e tij. Qysh atëherë shkonte me nënën time në rrëfim dhe meshën shenjte kurse në mënyrë diskrete luste rruzaren. Tetëmbëdhjetë muaj më vonë, papritur vdiq nga sulmi në zemër në moshën 87 vjeçare.“

„Nuk dyshoj për asnjë sekondë: ata tetëmbëdhjetë muaj ishin dhuratë falas prej Qiellit dhe ndihmë babës tim që të përgatitet për vdekjen, dhe ky prolongim ishte fituar me ndërmjetësimin e Zojës, Nënës së tij, që e thirri për t’i ndihmuar.“

Bileta për parriz?

Shumica e njerëzve frikohen kur mendojnë për vdekjen e vet ose për vdekjen e të afërmeve. Por Zoja na mëson: „Vdekja nuk ekziston“! Është thjesht një perde që bie, si kurtina e tempullit që u nda dysh, duke zbuluar atë që ishte atje më parë, e fshehur dhe e padukshme – Shenjtëroren mbi Shenjtëroret.

Në mendje më erdhi fotografia e cila është e mangët sikurse çdo gjë tjetër krahasuar me këtë: ekzistojnë dritare me xhama që na mundësojnë të shohim nga brenda atë që ndodh jashtë, por,

nuk u lejojnë njerëzve nga jashtë të shohin brenda. Por, ta marrim me mend se xhamaxhiu i ka vendosur xhamat gabimisht dhe ata që janë brenda nuk mund të shohin jashtë! Kjo na ndodh neve! Këtu në tokë, ne jemi si njerëzit, nuk i shohim ata që na shohin! Këtu fillon tragjedia e mosbesimit sepse është vetëm një hap i vogël në mes të “të mos shohësh” dike dhe të mungesës së plotë të vetëdijes për ekzistimin e tij. „*Të dashur fëmijë*“, thotë Zoja, „*ju nuk jeni të vetëdijshëm.*“

Shenjtërit e kanë tejkaluar këtë mungesë qartësie dhe kanë jetuar sikur mund të shohin të padukshmen. Kjo u ka mundësuar t’i përqafojnë realitetet e padukshme, pa frikë nga dita kur xhami do të thyhet dhe kur perdja do të bie. Ata e kanë njohur Qiellin dhe e kanë shikuar kalimin nga lugina e vdekjes si në puthjen e pritur gjatë e cila pas përndjekjeve të tyre do t’i sjell përgjithmonë në shoqërinë e të zgjedhurve.

Toka është kohë dëshirash. Qielli është posedim për amshim. Këtu në tokë, nëse nuk e dëshiroj Qiellin, unë jam person në agoni i cili akoma mund të ngjallet. Nëse mundësinë time të dëshirimit e orientoj në botën materiale, atëherë jam kufomë dhe çasti i vdekjes sime, çasti kur do t’i humb të gjitha pasuritë e mia, të rreme më tmerron. Nëse jemi të lidhur më pak me gjëra materiale, kjo do të na mundësojë që “me gëzim të meditojmë për jetën e amshuar”.

Marisë (Pavllloviq) i janë zbuluar disa njohje në lidhje me këtë temë. Zoja i ka shpjeguar se në Qiell, secili nga të zgjedhurit e di saktësisht se çfarë kanë bërë të tjerët për ta dhe si, me lutjet e tyre, me flitë dhe me paraqitjet kanë marrë pjesë në rritjen e shkallës së lavdisë së tyre të amshuar. Nganjëherë të zgjedhurit kuptojnë se si lutjet e personit të caktuar kanë qenë shkaku që nuk janë të humbur! Në Qiell, secili prej nesh do t’u jetë mirënjohës për amshim atyre, dhe me ta do të kemi një raport shumë të veçantë dashurie. Ky realitet është i mrekullueshëm dhe inkurajues, sidomos kur në tokë nuk i shohim frytet e flive dhe të lutjeve për ata që i duam. Këtu Zoja na jep shpresën e cila mund të na shëron nga demoralizimi! Ajo na ndihmon që të investojmë në vlera të vërteta dhe kështu “të meditojmë me gëzim mbi jetën e amshuar”.

„Të dashur fëmijë! Sot gëzohem me mbrojtësin e juaj dhe ju ftoj që të jeni të hapur për vullnetin e Zotit ashtu që në ju dhe nëpërmes jush të rritet feja tek njerëzit që i takoni në jetën e përditshme. Fëmijëz, lutuni derisa lutja të ju bëhet gëzim. Kërkoni mbrojtësit tuaj të shenjtë që të ju ndihmojnë të rriteni në dashuri ndaj Zotit. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime.” (25. korrik 2002.)

52

O, SHËN JOZEFI I MIRË!

Shën Jozefi është kryetari qiellor i apostullatit tonë të Megjugorjes. Që të mund të drejtojmë mirë, na duhet shenjtë efikas që është plot dashuri dhe humor!

Macja

Kur isha në mision në Poloni në vitin 1998 miqtë më treguan këtë ngjarje:

„Gjatë luftës së dytë botërore motrat polake të nderit drejtonin jetimorën në Varshavë. Në atë regjion njerëzit ishin shumë të varfër dhe motrat mbijetonin me ndihmën e Provanisë Hyjnore. Një ditë mbetën pa qumësht për jetimët, gjë që mund të rrezikonte seriozisht shëndetin e fëmijëve. Çfarë mund të bënin? Në këtë vështirësi motra kryesore i tha kuzhinieres, motrës Ewa, që t’i shkruaj një lutje Shën Jozefit dhe që ta vendosi pas fotografisë së tij, ashtu si ishte zakon në bashkësinë e tyre. Por motra Ewa, duke shikuar letrën e bardhë para vetes, ishte e hutuar – si ta paraqiste qumështin që është i bardhë si letra? Megjithatë e bëri ashtu si diti më së miri.

Të nesërmen një njeri nga qyteti trokiti në derën e kuvendit. Donte vetëm t’i përshëndeste motrat dhe t’u jepte një dhuratë të vogël. Të gjitha motrat ishin të lumtura sepse kujtuan se arriti qumështi. Por, për befasinë e tyre të madhe dhe dëshpërimin, panë se vizitori u kishte sjellë një mace – një mace të thjeshtë! Çfarë dhurate e pazakontë! Njeriu duke parë se si në fytyrën e tyre po zbehet shprehja e ngazëllimit, i pyeti:

„A ju duhet diçka konkrete?“

„Po, vërtetë kemi nevojë për qumësht,“ u përgjigjën motrat njëzëri.

„Qumësht?“ klithi vizitori. „Kam me shumicë! Do t’ua sjell sa më parë që të mundem!“

Qumështi erdhi të njëjtën ditë. Mirëpo, motra kryesore ende çuditej me macen si dhuratë prandaj e luti kuzhinieren që t’ia tregoi lutjen që e kishte lënë për Shën Jozefin. Kur e pa vizatimin,

shpërtheu në gaz. Motra Ewa kishte vizatuar macen se si pinte qumësht në një enë! Shën Jozefi në mirësinë e tij e kishte plotësuar kërkesën e tyre. Së pari kishte sjellë macen, dhe pastaj si shtesë edhe qumështin!

Të bekuar me vaj

Kim nuk ishte besimtare praktike. Ishte 23 vjeçe dhe dukej se Zoti nuk e interesonte. Ishte vajzë e talentuar, e ndjeshme e vendosur dhe tërheqëse. Në marsin e vitit 2005., ajo pranoi propozimin e prindërve që të shoqëroi miqtë e familjes në Megjugorje, jo si shtegtare por që të kujdeset për tre fëmijët e tyre të mitur. Meqë e dinin se Kim ishte e çmendur pas fëmijëve, prindërit e sajë menduan se do të jetë kjo një mënyrë e mirë që ta shtyjnë të zhytet në huret e Megjugorjes, së paku për disa ditë. Në shtëpinë e tyre në Kaliforni, prindërit e sajë luteshin pa pra që kjo oazë paqeje ta prekte zemrën e bijës së tyre.

Ditën e fundit të shtegtimit në Megjugorje, me buzëqeshje joshëse, Kim u tha miqve të saj: „Kisha kënaqësinë të kujdesesha për fëmijët por do të doja, po ashtu, ta shfrytëzoj rastin që të jem pakëz vetëm në Megjugorje. A mund ta ndërroni datën e kthimit dhe të qëndroni edhe një ditë ose dy? Vërtetë do të doja të mësoj pak më shumë për këtë vend që duket disi i veçantë.“ Kim nuk kishte marrë pjesë në asgjë me miqtë e sajë. Nuk ishte në meshë, nuk kishte shkuar në kodra as nuk kishte vizituar veguesit – asgjë prej gjëje! Prandaj dukej çudi pse dëshironte të mbetej më gjatë. Por këtu vërejmë fshehtësinë e Zojës dhe aftësinë e nënës që din si t’i afrohet fëmijës edhe nëpër të çarat më të vogla. Davidi, udhëheqësi i grupit, më pyeti se a do të mund të rrinte Kim me ne disa ditë. Përgjigja ime ishte: „Në rregull!“.

Pas kësaj Kim kishte shtyrë tri herë datën e kthimit në shtëpi! Përfundimisht, një vit më vonë, mundësia e shtyrjes kishte skaduar! Kim kishte hyrë aq thellë në hirin e Megjugorjes sa nuk donte të shkonte, pa marrë një shenjë, të brendshme, shumë të qartë nga Zoja se është koha për t’u kthyer – Shenja e Zotit se duhet të shkoi. Zemra e sajë ishte e hapur shumë. Hap pas hapi, mahnitej me të gjitha, si nusja e re e cila i zbulon me gëzim cilësitë e reja të të dashurit dhe kënaqet në praninë e tij.

Njëra prej gjërave më të gëzueshme që Kim kishte zbuluar, ishte ndikimi i engjëjve dhe shenjtërve, aq të pranishëm në përditshmërinë tonë. Nuk do ta harroj kurrë rastin, kur për herë të parë butësia e Shën Jozefit e preku zemrën e saj. E pranoj se atë mëngjes Chrissey¹²⁶ dhe Kim nuk ishin të disponuara në lutjen e mëngjesit. Në shtëpinë tonë, disa artikuj nuk i blejmë kurrë sepse janë të shtrenjtë. Shën Jozefin e kemi obliguar që t’i siguroi vetë! Vaji virgin i ullirit është njëri nga artikujt dhe nuk kishte mbetur asnjë pikë për drekën solemne që planifikonim atë ditë për mysafirët tanë. Prandaj Chrissey dhe Kim provuan të më bindin që të bëjmë përjashtim vetëm për atë ditë dhe ta blejmë, por përgjigja ime i dëshpëroi: „Thoni se nuk ka vaj ulliri? S’ka

¹²⁶ Chrissey Zaums, ndihmësja ime amerikane në Megjugorje në këto pesë vitet e fundit

problem, do ta lusim Shën Jozefin. Ai kujdeset për të gjitha që na duhen!“ Për Kim kjo lidhje qiellore ishte joreale, por atë mëngjes, kur ia drejtuam kërkesën tonë Shën Jozefit për vajin dhe nevojat tjera e tha një „Amen!“ të guximshëm.

Pas lutjes, në kuzhinë na priste kafeja e nxehtë, por jo vetëm ajo! Tek dera e hyrjes gjendej një shishe e bukur me vaj ulliri “extra virgin” me porosinë e shkruar në shpejtësi: „Nuk dëshirojmë të ju pengojmë në lutjen e mëngjesit. Do të vijmë më vonë! Miqtë tuaj nga Verona.“

Kim ishte aq e shokuar sa ju desh të ulej! Luante me kokë, pa e ditur se a duhet të qaj apo të qesh. Më tha: „Në SHBA nuk dimë asgjë për këtë! Vetëm sikur njerëzit ta dinin! Ne fare nuk dimë se si është të jetosh me Zotin!“

Duhet pranuar se atë ditë Shën Jozefi e përvetësoi zemrën e sajë. I lejoj që të hedh një sy në misterin e mahnitshëm të bashkësisë së shenjtërve nëpërmes të një shisheje vaji të ullirit!

Zdrukthëtari në Varshavë

Shën Jozefi bën shumë vepra të mira dhe nuk mund ta injorojmë kurrsesi! Ja një dëshmi të mahnitshme që na e ka treguar Marysia, mikja ime nga Varshava, shumë e përkushtuar Megjugorjes.

„Para katër vitesh, motra Emmanuel ma dha figurën e Shën Jozefit dhe më tha: 'Nuk e lut kurrë! Pse? Ai është aq shenjt i mrekullueshëm! Le të jetë miku yt. Do të shohësh. Do të të ndihmoi shumë!' “

„Burri im Bogdani dhe unë, së bashku me dy fëmijët tanë, kishim nevojë për një shtëpi më të madhe sepse apostullati ynë për Zojën kërkonte përherë e më shumë hapësirë. Por nuk kishim para të mjaftueshme për ta blerë. Kështu, duke ndjekur këshillën e motrës Emmanuel, plot shpresë e besim, i shkrova një letër Shën Jozefit, e lash pas ikonës së tij dhe fillova nëntëshen. Kaluan muajt dhe nuk ndodhi asgjë!“

“Udhëheqësi im shpirtëror më tha: 'Shën Jozefi është zdrukthëtar i thjeshtë dhe njeri shumë praktik. Do duhej të ja vizatosh se çfarë shtëpie do.' Kështu unë vizatova, në mënyrë precize, se si duket shtëpia nga jashtë dhe atë vizatim e lash pas ikonës. Kaluan muaj dhe asgjë nuk ndodhi!”

„I thash shpirtërorit tim se si duket unë nuk i pëlqej Shën Jozefit. M’u përgjigj: 'Nëse Shën Jozefi nuk të është përgjigjur në lutje, kjo ka ndodhur sepse ai është baba dhe se në lidhje me këtë çështje ai dëshiron të merret vesh me babën tjetër. Kërko nga burri yt që ai t’ia përcjell kërkesën Shën Jozefit. Si baballarë familjesh, ata do të merren vesh!' “

„Bogdani të njëjtën ditë e bëri këtë dhe pas një jave e gjetëm shtëpinë! Padyshim Shën Jozefi ka dashur ta trimëroi Bogdanin në rolin e tij si kokë e familjes. Çmimi i shtëpisë ishte pikërisht aq sa kishim në disponim, por vlente shumë më tepër. Kishte të gjitha kthinat që kërkonim, madje edhe bodrumin dhe tavanin, kurse dukja e jashtme e shtëpisë ishte pikërisht si në vizatimin tim!

Si zdrukthëtar i mirë, Shën Jozefi kishte zgjedhur shtëpinë e punuar nga druri – dhe jo nga çfarëdo druri por nga druri i bungut! Kur shikuam dritaret dhe dyert vërejtëm me kënaqësi se ishin të punuara për mrekulli dhe ishin në gjendje të shkëlqyer.“

„Fotografitë e Zembrës Tejetshenjte të Jezusit dhe Zembrës së Pamëkat të Marisë gjendeshin në hyrje. Më vonë e mora vesh se Zoja në Megjugorje kishte kërkuar që t’i vendosim ato fotografi në shtëpiat tona. Aty ishte edhe fotografia e Shën Terezës së Jezusit fëmijë (Terezës së vogël), përkujtues për lidhjen tonë shpirtërore me Francën. Pronarja e mëparshme e kishte shfrytëzuar një dhomë për lutje për shumë vite. Kur e morëm, ne vetëm ndezëm qirinjtë! Në të vërtetë kjo zonjë, shumë e sëmure, ishte lutur me orë të tëra para fotografisë së Zojës nga Czestochowa, duke ia paraqitur ditë e natë vuajtjet e sajë.“

„Ishte aty edhe një përkujtues i cili nuk na linte që të harrojmë porositë e Zojës, të fejuarës së Jozefit, në lidhje me agjërimin. Shën Jozefi kishte siguruar edhe grurin. Buka e shijshme e shtëpisë ndihmon që të qëndrohet në agjërim dy ditë në javë!“

„Shtëpia ishte afër Varshavës, në mes të natyrës, kurse shkolla që ndjekin fëmijët ishte më e mirë se në Varshavë. Meshtari nga Jerusalemi na solli fotografinë e Shën Jozefit i cili vigjilon mbi Familjen Shenjte. Ajo ka vend nderi në hyrjen e shtëpisë sonë, sepse prej atëherë familja jonë është nën mbrojtjen e tij.“

Shën Jozefi arkitekt

Para dy mijë vitesh në Galile zdrukthëtarët ishin edhe arkitektë. Përkundër mungesës së kornizave metalike dhe teknologjisë moderne, zdrukthëtarët bënë plane të mira ashtu që konstruksionet e shtëpive ishin të forta. Mund ta marrim me mend Shën Jozefin se si bisedon me Jezusin për mënyrat e ndryshme si mund të ndërtohet shtëpia dhe si së bashku provojnë të bëjnë planin më të mirë që të kënaqin porositësin. Për më tepër, Shën Jozefi i pari i ka vu në shpinën e Jezusit të tij të vogël, trarët e rëndë që zdruktharëve u duhet t’i mbartin. Edhe pse nuk ishte i vetëdijshëm, ai në të vërtetë përgatiste të Birin për bartjen e trarëve të rëndë të Kryqit. Ati qiellor e ka paraparë këtë për Jezusin, duke vënë këtë zdrukthëtar të shkathtë për ‘drejtues’ gjatë shumë viteve të jetës së fshehur të Jezusit në Nazaret. Shpesh harrojmë se në mënyrë të padukshme Jozefi i ka ndihmuar Jezusit që të mund të kaloj rrugën e Kalvarit deri në fund.

Rrallë mendojmë për Shën Jozefin si për njeriun i cili është dashur të planifikoi. Kjo aftësi duhet të jetë trashëguar nga familja e Davidit, sepse e fejuara e tij, Zoja në Megjugorje, flet shpesh për planet e sajë për botën dhe kërkon ndihmën tonë për realizimin e tyre. Jezusi, po ashtu ka planin e vet për shpëtimin e njerëzimit. Si duket e gjithë Familja Shenjte është e specializuar për plane!

Çfarë planesh kemi ne për jetën tonë?

Shën Jozefi është shenjt i cili na duhet që të entuziazmohemi me jetën dhe me dhuratën e jetës. Si arkitekt i mirë i cili është i shkathtë, pedant dhe i guximshëm në punë, ai na ndihmon që përsëri ta rrumbullakojmë jetën tonë dhe t'ia përshtatim ëndrrës së Zotit për ne. Kjo sepse ai është i drejtë si askush tjetër, dhe që për hebrejtë e asaj kohe kjo do të thoshte se ishte njeri i cili gjithë jetën e ka harmonizuar me Zotin. Edhe sot ne duhet që jetën tonë, përsëri, ta harmonizojmë me Zotin!

Ati e ka zgjedhur këtë njohës të mirë të planeve të Zotit që ta shoqëroi të Birin e tij, Jezusin gjatë viteve të para të jetës së Tij, deri tek mosha e rritur. Shën Jozefi do të ishte shumë i lumtur nëse do të kishte mundësi ta vazhdonte atë detyrë me secilin prej nesh këtu në tokë, sidomos me ata që i marrin afër zemrës porositë e Myriam, të fejuarës së tij.

Tmerri i djajve

Shën Katarina Labouré po vdiste në rrugën du Bac, në Paris. Asaj Zoja i ka dhënë medaljen mrekullibërëse. Katarina është e njohur si „shenjtëresha e heshtjes“ dhe janë shënuar vetëm pak fjalë të sajë. Dihet se pak kohë para vdekjes nipërit dhe mbesat e sajë e kanë pyetur: „Teze, kujt duhet t'i lutemi në çastin e vdekjes sate?“

Duke cituar rreshtin nga Litanitë e Shën Jozefit, u përgjigj: “Tmerrit të djajve!” Dhe shtoi: “Kur shpirti i keq të mundohet të ju imponoi mendime të papastra, urrejtjeje, zilie, gënjeshtre, thoni këtë uratë: 'Shën Jozef, Tmerri i djajve, më mbro!' Dhe këtë thoni aq herë sa keni gishta në duar! Shën Jozefi atëherë do t'i ngrij ato mendime. Dhe kjo është e gjitha! Por, mendimet do të kthehen. Kur të kthehen, silluni me to njësoj duke thënë: 'Shën Jozef, Tmerri i djajve, më mbro!' Përsëritni aq herë sa keni gishta në duar. Kështu do të korni fitore në betejën kundër tij.“

Shën Jozefi i ngjan njeriut i cili rri në hyrjen e klubit të natës, shikon nga afër të ardhurit dhe vendos se cilin do ta lejoj të futet brenda. Të tillë e ka krijuar Zoti Atë! Kjo ka qenë e nevojshme që askush të mos i pengoi të Birin e Tij dhe bijën e Tij më të dashur Marinë, e cila ishte arma e Tij e fshehtë...

Ai ka një zemër të butë

Vicka përsërit shpesh: „Mos keni frikë. Vetëm duhet të kërkoni.“

Shën Jozefi i ka hiret me shumicë. Është shumë i lumtur të mbështet personin i cili e thërret në mënyrë miqësore dhe me besim, qoftë për të mbrojtur familjen nga shkatërrimi, për të ndihmuar në marrjen e vendimeve në situatë të vështirë, për të ngadhënjyer mbi sulmet e të keqit, për të mbrojtur fëmijët nga papastërtia, për të ndërtuar harmoninë në personin i cili ka qenë i lënduar në jetë ose për t'i ndihmuar që të mos e shtyjë “po”- në e tij Zotërisë dhe që të qëndroi në uratë

në mes të botës armiqësore¹²⁷. Shën Jozefi gjithashtu mund t'i ndihmoi personit që të fitojë për jetesë duke bërë punën e cila sjell paqe, duke iu dëshmuar të tjerëve mbi dashurinë dhe gëzimin e Zotit. Ose mund t'i ndihmoi dikujt që në qetësi ta dorëzoi vuajtjen e tij ose të ketë dashuri të madhe ndaj Zojës. Shkurt mund të na ndihmoi që të ecim në përvujtëri dhe siguri në rrugën drejt shenjtërisë!

Ajo që më bën, veçanërisht, përshtypje te Shën Jozefi është butësia e tij. Para zemrës që shpreson ai thuhet si fëmija. Një herë kam lutur një nëntëshe Shën Jozefit sepse më duhej automobili në Megjugorje. Ia shpjegova: "Me të do t'i shërbejmë më mirë të fejuarës sate atje ku dëftohet." A nuk ishte ky një argument i fortë?! Mendova se nga dashuria për të do të përgjigjet në lutjen time! Automobili erdhi ditën e nëntë të nëntëshes.

Kur një grua e re dëgjoji për këtë mendoi se edhe ajo mund të shfrytëzoi argumentin e njëjtë që ta bind Shën Jozefin. Ç'është e vërteta edhe asaj i duhej automobili, por vetëm për të shkuar në vendin e punës, në një firmë e cila nuk ishte veçanërisht e krishterë. Mirëpo vendosi të lut nëntëshen, duke llogaritur në mirësinë e Shën Jozefit. Nuk mund t'u besonte syve kur automobili arriti, dhe ishte pikërisht i madhësisë që donte! Atë ditë ajo zbuloi një aspekt të ri të personalitetit të Shën Jozefit – butësia e tij është dhuratë e vërtetë për ne!

Do të mund të shkruaja librin mbi butësinë e Shën Jozefit, por më me dëshirë do t'ju ofroj këtë lutje shumë të bukur të Shën Franës së Salezit. Në këtë mënyrë secili do të mund t'i falënderoi personalisht për zemërgjerësinë që ka treguar në jetën tonë!

¹²⁷ Meshtari anglez, i cili kalonte nëpër Megjugorje, ishte i interesuar për luftën shpirtërore. E Studionte jetën e shenjtërve që të mësonte se si kanë luftuar kundër tundimit. Mbretëresha e paqes me siguri ka buzëqeshur kur e ka dëgjuar se si ua shpjegon besimtarëve zbulimet personale të shenjtërve ashtu që edhe ata ta mundin tundimin, sepse asaj i pëlqen kur i marrim shenjtërit si shembuj. „Si i mundni shqetësimet?“ pyeti. „Shikoni shenjtën Bernarda. Ajo fliste vetëm dialektin e Lourdes-it, kurse Julie Garrow kishte për detyrë ta mësojë frëngjisht.

Julie pyeti Bernardën: 'A shqetësohesh në lutje?'

'Po', përgjigji Bernarda.

'A të pengon kjo?'

'O, jo! Unë ia përcjell Shën Jozefit dhe ai merret me to. Nuk ka problem.'"

O tejet i lavdishmi Shën Jozef, i fejuari i Marisë

Të lutemi për mbrojtjen tënde,

Nëpërmjet të Zemrës Tejetshenjte të Jezusit dhe Zemrës së Pamëkat të Marisë.

O ti, pushteti i të cilit i tejkalon të gjitha nevojat tona,

Dhe i cili din si t'i realizosh gjërat gati të pamundura,

Hapi sytë tu atëror për brengat e fëmijëve të tu.

Vijmë te ti me shpresë. Denjo ta marrësh këtë tundim të madh e të rëndë

Që është shkaku i ankthit tonë ... (thuaj nevojën tënde).

Le të jetë përfundimi i tij në lavdinë e Zotit dhe për të mirën e shërbëtorëve të Tij besnik.

O Shën Jozef i dashur, që kurrë nuk të lutën kot

Dhe ndaj të cilit dashamirësia e Zotit është e tillë sa që u tha:

„Në Qiell Shën Jozefi nuk lutet por urdhëron.“

Babë i ndjeshëm, lute Jezusin për ne. Lute Marinë për ne.

Bëhu mbrojtësi ynë tek Biri yt Hyjnor,

Për të cilin ishe këtu në tokë njerku më i dashur dhe më besnik.

Bëhu ndërmjetësi ynë tek Maria për të cilën ishe i fejuari i ndjeshëm dhe i dashur.

Shtoja lavdisë sate edhe lavdinë e plotësimit të përgjigjes së volitshme

Për problemin e rëndë që ta besojmë.

Vërtetë besojmë se mund të përgjigjesh në lutjet tona duke na shpëtuar

Prej pikëllimit që na pushton dhe hidhërimit që i vërshon zemrat tona.

Për më tepër, jemi të bindur

Se nuk do t'i lësh pas dore uratët e të pikëlluarve që të lusin për ndihmë.

Me përvujtëri gjunjëzohemi para këmbëve të tua, o Shën Jozef i mirë,

Të përbejmë që të kesh mëshirë për lutjet dhe lotët tona.

Na mbulo me mantelin e mëshirës sate dhe na beko. Amen.

(Shën Frana i Salezit)

SHËN JOZEFI – MBROJTËSI I KROACISË (vër.përk.kroat.)

Parlamenti kroat më 1687., e ka zgjedhur Shën Jozefin për mbrojtësin qiellor të Mbretërisë Kroate, gjegjësisht popullin kroat. Në protokollin e Kuvendit Kroat më 9. dhe 10. qershor. 1687. Shkruan në gjuhën latine:

„Shën Jozefi, ushqyesi besnik i Krishtit Shpëtimtar, i fejuari virgjër i Nënës Virgjër të Zotit, u zgjodh njëzëri nga shtresat dhe kastat për mbrojtës të veçantë të Mbretërisë Kroate në Kuvendin Shtetëror në vitin 1687.“

„Të dashur fëmijë! Edhe sot ju thërras në mënyrë të veçantë, që të jeni të hapur për Zotin Krijues dhe të jeni aktiv. Ju thërras, fëmijë, që në këtë kohë, të shikoni kujt i duhet ndihma juaj shpirtërore dhe materiale. Me shembullin e juaj, fëmijë, do të jeni duart e shtrira të Zotit, që i kërkon njerëzimi. Vetëm kështu do të kuptoni se jeni të ftuar të dëshmoni dhe të bëheni bartës të gëzueshëm të fjalës së Zotit. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime!“ (25. shkurt 1997.)

53

„DO TA SHKYÇIM PAJISJEN“

Në misionin tonë në Malezi, atë Tim Deeter më tregoi këtë ngjarje:

Si seminarist në verën e vitit 1977., ai përgatitej për t'u bërë kapelan në spitalin e Shën Jozefit në Milwaukee. I vizitonte të sëmurët, i ngushëllonte dhe ju sillte kungimin shenjt. Kur i shihte pacientët në komë, të lënë në vetmi të plotë, ndiqte nxitjen e zemrës dhe kalonte një kohë me ta. E dinte se, kur dikush është në komë, shqisa e fundit që dobësohet është të dëgjuarit. Prandaj u fliste me zë të lartë atyre pacientëve me shpresën se e dëgjojnë edhe pse nuk mund të përgjigjen. U thoshte disa fjalë të ëmbla dhe gati gjithherë fliste mbi ngjalljen e Jezusit.

Një ditë ai kujdesej për një nga ato paciente e cila ende ishte e re, dhe në jetë e mbante pajisja që siguronte punën e funksioneve të caktuara, kyçe, të trupit. Quhej Althea Turner dhe ishte një kohë të gjatë në komë. Atë Tim-it i thanë se për shkak të mungesës së shtretërve, kësaj gruaja do t'ia ndërpresin pajisjen që e mbante gjallë.

Kur e dëgjoji këtë lajm, shkoi te Althee dhe, duke vënë dorën e tij në të sajën, i tha: „Posa mora vesh se do ta ndërpresin pajisjen që ju mban në jetë. Nëse nuk dëshironi që jeta juaj të marrë fund, unë jam i gatshëm të ju ndihmoj, por kërkoj një shenjë prej jush. Nëse e shtrëngoni dorën time që gjendet në tuajën, do të kuptoj se dëshironi të vazhdoni jetën.“

Althea e kuptoi porosinë shpejt, madje aq mirë sa që menjëherë e shtrëngoi fort dorën e atë Tim-it, duke e mbajtur fort një minutë të tërë. Nuk ka kuptim të përshkruhet pesha e kësaj situate!

Ky i tha pastaj Althei: „Faleminderit. Tani jam i bindur se dëshiron të jetosh, por nuk jam i sigurt se do ta bind personelin e spitalit. Do ta thërras infermierën dhe dua që me dorën e sajë të bëni njësoj si me dorën time.“

Kur erdhi infermierja, Althea ia shtrëngoi dorën aq fuqishëm sa askush nuk mund të dyshonte se kjo grua luftonte për jetën e saj. Atë Tim shtoi se Althea, dhjetë ditë më vonë u largua nga spitali në këmbë të veta dhe filloi përsëri me aktivitetet e zakonshme.

Kjo vetëm tregon se komat e vërteta për të cilat duhet të brengosemi, përnjëmend, janë ato që i përjetojnë njerëzit të cilët nuk kujdesen për jetën e vet!

“Të dashur fëmijë! Kur keni person të sëmurë, lutuni për qëllimet e mia dhe paraqitni sakrificat për qëllimet e mia dhe unë do të kujdesem për të.” (Marisë, pa datë)

54

PRANË SHTRATIT TË TË SËMURIT

Secili vegues ka marrë nga Zoja detyrë të veçantë, lutjen për qëllim të caktuar. Nga Vicka kërkohet që të lutet për të sëmurë. Duket se të sëmurët e tërheqin ashtu si magneti metalin. Nuk e kam parë kurrë se lodhet ose humb durimin kur lutet për ta, madje edhe kur presin me qindra nën shkallët e vogla të saj në Bijakoviqi. Ndaj të njëqindtit vizitues sillet si edhe ndaj të parit dhe i kushton të njëjtën kohë lutjeje dhe të njëjtën buzëqeshje plot entuziazëm. Një pjesë të madhe të kohës së saj të lirë e shpenzon në vizitat të sëmurëve në shtëpiat e tyre ose në spitale. Ajo e di se Zoja është e pranishme pranë shtratit të të sëmurit, ashtu si ishte e pranishme në rrëzë të Kryqit, pranë Birit të saj Jezusit. Asgjë më pak!

Vicka kurrë nuk lutet me zë për njerëzit. Zoja ia ka mësuar uratën që ajo e thotë në heshtje. Kjo uratë është goxha e gjatë, dhe sipas Vickës, Zoja do të lejoi një ditë që të na zbulohet.

Një mëngjes, papritmas, më luti që ta dërgoj në spital në Mostar sepse donte të vizitoi një person të sëmurë. Bëmë një numër të konsiderueshëm vizitash duke më shfrytëzuar si vozitëse. Rrugës Vicka gjente vizita të tjera që duhej bërë – fshati me fëmijë të braktisur, shtëpinë e vëzhguesve italian – vetëm disa nga to, dhe në kthim edhe disa familje afër Megjugorjes.

Si kur lutet për fëmijë dhe i përqafon ata, si kur lutet gjatë për të sëmurë ose kur familjeve në vështirësi ua përcjell të rehat nga Bijakoviqi, ajo të gjithëve u sjell ngushëllim. Rrezaton një lumturi të tillë sa njerëzit në praninë e saj ndiejnë një pjesë të qiellit. Nuk mund të mos mendoja: „Sikur kritikuesit e Megjugorjes të mund të shihnin dhe dëgjonin, vetëm për dy minuta, atë që unë po shoh dhe po dëgjoj tani, do të ndryshonin mendje!“ Bindja e zemrës do të mënjante çdo kritikë. Qielli nuk mund të manipulohet – sidomos pas njëzet e gjashtë vitesh – mundet, vetëm të jetohej!“

Në kthim e pyeta Vickën: „Të dielën kishe temperaturën 40°C, kurse të hënën të pashë në shkallë me shtegtarët. Si e bën këtë?“

„Natyrisht! Nuk mund të lejosh që shtegtarët të presin kot. Vijnë nga larg për të dëgjuar porositë. Nuk mund të rri në shtrat kur e di se janë përjashta dhe presin! Nuk brengosesh për temperaturën. Ngrihesh dhe thua: 'Ndihmo, Zojë!' Shkon te ta, mendon se do të rrëzohesh, mbahesh për gardhi, por ata t'i bëjnë një mijë pyetje. Ata i kanë vuajtjet e tyre dhe qëllimet e tyre. Të përqafojnë, ta shtrëngojnë dorën, kurse ti - ke terr para syve, të turbullohet shikimi dhe i thua vetit: 'Jo, nuk guxoj të rrëzohem, edhe pse i kam 40°!' Atëherë Zoja të ndihmon. Ajo nuk

mundet të mos ndihmojë! Dhe kalon... Pas dy minutash është më mirë dhe shtegtarët marrin porositë! E sheh, kështu shkon kjo punë! Askush nuk pyet si je dhe a të duhet diçka – jo, për ta, ti je 'veguese' dhe duhet t'ua japësh atë që ke marrë nga Virgjëra e Lume!“

Kur Zoja themeloi grupin e saj të lutjes, insistoi gjithsesi në nevojën që të rinjtë të kujdesen për të sëmurët dhe të luten për ta. Ajo i tha Marisë: „Kur ke ndonjë person të sëmurë për të cilin duhet lutur, lutu për qëllimet e mia dhe paraqiti sakrificat për qëllimet e mia e unë do të kujdesem për të sëmurin.“

Mirëpo ekziston mënyrë e gabuar e lutjes, e kjo është kur përqendrohemi vetëm në shërim dhe përsërisim vazhdimisht: 'Zotëri, shëroje, shëroje!'

Zoja ka thënë: „Jo – mos u lutni ashtu, të dashur fëmijë, sepse zemrat tuaja nuk janë të hapura për Zotin dhe për vullnetin e Zotit.“

Në vitin 1985. Zoja i ka diktuar vegueses Jelena Vasil uratën për të sëmurë dhe ka theksuar: „Kjo është urata më e mirë që mund ta lutni për të sëmurë.“ Është lehtë ta njohësh dorën e Zojës sepse Zoti është në qendër të uratës:

Urata për personin e sëmurë (E diktuar Jelenës)

(Thuani tri herë *Lavdi Atit*¹²⁸ dhe pastaj këtë uratë)

O, Zoti im,

Shiko këtë person të sëmurë që qëndron para Teje..

Erdhi të kërkojë prej teje atë që dëshiron dhe

Atë që mendon se është më e rëndësishmja për të.

Ti, O Zoti im, bën që këto fjalë të hyjnë në shpirtin e tij:

„Më e rëndësishmja është shëndeti i shpirtit.“

Zotëri, le të bëhet vullneti yt në çdo gjë lidhur me të,

Nëse do që të shërohet, le të shërohet;

Por nëse vullneti yt është diçka tjetër, le të vazhdoi ta bart Kryqin e vet.

¹²⁸ Lavdi Atit, e Birit e Shpirtit Shenjt! – Si ka qenë në fillim, ashtu tash e përgjithmonë e jetës. Amen!

Të lutem edhe për ne, që ndërmjetësojmë për të;

Pastro zemrat tona që të jemi të denjë për Mëshirën Tënde shenjte.

Mbroje dhe zbutja dhembjet. Le të bëhet mbi të vullneti Yt shenjt,

Që nëpër të, të mund të shpallet emri Yt shenjt.

Ndihmoji që me guxim ta bart Kryqin e vet.

Kur veguesit e kanë pyetur Zojën se a do ta shëroji ndonjë person të sëmurë, ajo shpesh përgjigjej: „Unë nuk mund të shëroj, vetëm Zoti mundet. Por lutuni, fëmijëz, dhe unë do të lutem me ju. Besoni fort, agjëroni dhe bëni vepra pendese. Zoti u ndihmon të gjithëve. Unë nuk jam Zot. Mua më duhen sakrificat dhe lutjet tuaja.”

“Të dashur fëmijë! Sot ju thërras në mënyrë të veçantë që ta merrni në dorë kryqin dhe ti kundroni plagët e Jezusit. Kërkoni prej Jezusit që t’i shëroi plagët tuaja, të cilat, fëmijë të dashur, i keni fituar gjatë jetës suaj për shkak të mëkateve tuaja dhe të prindërve tuaj. Vetëm kështu, fëmijë të dashur, do të kuptoni se botës i duhet shërimi i besimit në Zotin Krijues. Me mundimin dhe vdekjen e Jezusit në kryq do të kuptoni, se vetëm me lutje mund të bëheni edhe ju, apostuj të vërtetë të besimit, kur në thjeshtësi dhe në lutje jetoni fenë që është dhuratë. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime!” (25. mars 1997.)

55

MIGRENA E BILLIT

Në maj të vitit 2005., gjatë misionit në krahinat veriperëndimore të Kanadasë, qëndrova disa ditë te çifti i cili punonte për ipeshkëvinë e Mackenzie-Fort Smith. Një ditë, derisa hanim kafjall, Billi më tha se dikur vuante dhembjet nga migrena, por që ishte shëruar në mënyrë të mrekullueshme. Një grua që po kalonte nëpër Yellowknife, u ndal te shtëpia e tyre. Kishte “dhuratën e shërimit” dhe i ofroi Billit shërbimet e veta. Ekzekutoi një metodë shërimi që ishte e panjohur për të. Bënte disa lëvizje me dorë dhe fliste për rrjedhjen e energjisë. Kur seanca përfundoi, migrena e Billit u zhduk.

Posa Billi përfundoi tregimin, e shoqja Linda e shtyu lehtë dhe i tha: „Shpjegoja të gjitha motrës Emmanuel dhe thuaji se si ndjehesh prej se ka ndodhur ai shërim.“

„Uh... Po! Migrena ime vërtetë u zhduk, por tani kam herpes zoster (fruth rreth ijëve) dhe, më duhet të pranoj, nuk ndjehem mirë nga brenda. Të them të vërtetën, e kam humbur paqen e zemrës.“

„Thuaja të gjitha, Bill!“ , insistonte e shoqja.

Kur dëgjova se e ka humbur paqen e brendshme, i propozova që problemin ta shikojmë më thellë. E pyeta:

„Bill, kush është ajo grua?“

„Nuk e di, motër. Është katolike praktike. Është shumë e sjellshme dhe më propozoi që të lutet për shëndetin tim.“

„A të tregoi se cilën metodë e shfrytëzoi kur aplikoi atë ‘dhuratë’?“

„Prit të kujtohem – e kam në maje të gjuhës! Po – tha se është trajnuar të praktikoi Reiki.“

„Reiki? Bill, a e di çfarë është ajo?“

„Tingëllonte mirë! Zonja na tha se kishte takuar shumë njerëz të sëmurë dhe duket se ju ndihmon njerëzve të ndryshëm, madje edhe atyre që nuk janë të sëmurë.“

„Kuptoj. Bill, dëgjo! Meqë e ke humbur paqen e brendshme në kohën e njëjtë kur ka pushuar migrena, kam një pyetje për ty. Sikur të mund të zgjidhje, a do të doje ta kthesh ndjenjën e paqes, me kushtin që të kthehet migrena, apo nuk do të doje, as migrenën as paqen, ashtu si je tani?“

„O, pa dilemë, do të zgjidhja paqen e brendshme, me ose pa migrenë! Kjo është gjëja më e rëndësishme për mua, aq më tepër, sepse ajo do të më ndihmonte të përtërij raportet e mira me Lindën! Dhe ta dish, migrenën e kisha me vite dhe u mësova me të. Ia paraqisja Jezusit për qëllimet e Tij dhe jam i gatshëm ta bëj edhe më tutje!“

E kisha të qartë se Billi kishte zemër të mirë. Ishte zemërgjerë. E donte Zotërinë dhe dëshironte të ecte me të dhe të bënte diçka të mirë për Të. Përgjigja e tij më preku dhe isha e bindur se Zoti do t'i ndihmoi.

„Dëgjo, Bill. Shpjegimi është i thjeshtë. Ndoshta ajo grua që ka shfrytëzuar Reiki për migrenën tënde ishte e sinqertë. Por, e sinqertë ose jo, Reiki është kurth e dorës së parë e cila sjell gjëra të rreme dhe në fund do të paguash çmim shumë të lartë për shëndetin tënd fizik dhe moral.¹²⁹ Propozoj që sonte para se të flesh t'i lutesh Jezusit që të ndriçoi mbi atë se çka ke pranuar në të vërtetë. Për shembull, do të mund T'i thuash: 'Zotëri, nëse ky shërim vjen prej Teje, bën që ta kem dhe më ndihmo të kthej paqen e zemrës. Por nëse ky shërim nuk vjen prej Teje dhe nëse ajo grua më ka bërë dëm, atëherë të përbej, merre dhe ma kthe paqen. Jam i gatshëm që përsëri ta pranoj migrenën time.'“

¹²⁹ Reiki po shpërndahe shpejt nëpër botë, i promovuar nga lëvizja New Age. Është një lloj terapie për të cilën thuhet se shfrytëzon energjinë vitale universale dhe aftësinë e caktuar që vjen nga „shpirti transcendent“ (sigurisht jo nga Shpirti Shenjt!). Teknika bazohet në thirrjen e energjisë universale mbi personin e sëmurë me bërjen e simboleve arketipe mbi të. Terapeuti pastaj vizuelizon energjinë se si vjen nëpër majën e kokës së tij, e mbush atë dhe pastaj energjia nëpër duart e tij hyn në pacientin. Reiki, në të vërtetë i hap derën fuqive okultiste. Mund të ndodh, përkohësisht, përmirësimi i shëndetit në disa raste, por pastaj, shpejt, paraqiten simptomat që zakonisht lajmërohen në kontekstin e praktikave okultiste, madje dhe të spiritizmit. Praktika përbëhet nga tingujt jo verbal që bazohen në “nijetin” e Reiki mjeshtrit. Ashtu si edhe praktikat që promovon New Age, Reiki mohon gjithëpushtetësinë e Zotit personal, Krijues dhe ka të bëjmë me energjitë në frymën panteistike. „Dhurata“ e rreme e shërimit përcillet në sesionet inicuese (e kundërta e Shpirtit Shenjt, i cili nuk bartet automatikisht nga personi në person, por pranohen nga lart sipas zgjedhjes së Zotit). Kjo praktikë nuk mund të ekzistoi së bashku me fenë tonë të krishterë. Me Jezusin, çdo gjë është e qartë! Fakti se disa meshtar dhe motra të nderit e praktikojnë nuk do të thotë se është e pranueshme. Kurthet e sajë janë suptile, kurse hulumtimet në atë kahe nuk janë të njohura për publikun e gjerë. Për më shumë informata vizitoni faqen e atë Verlindë: <http://www.fsinfo.net> ose <http://www.final.age.net> (Familja e Shën Jozefit, 69380, Chasselay, Francë. Tel.:04 78 47 35 26 - Faks: 04 78 47 36 78).

Të nesërmen, gjatë kohës së kafjallit, Linda më dha një shenjë të vogël se ka ndodhur diçka e re. Billi erdhi dhe u ul pranë tavolinës. Derisa pinte kafënë na tregoi:

„Motër Emmanuel, kam lajm të mirë për ty! Kur u zgjova në mëngjes, migrena, si bashkudhëtar i vjetër, më priste! Se çfarë gëzimi ndjeva! E falënderova Zotërinë menjëherë për këtë shenjë, sidomos për faktin se paqja ime u kthye! Mendoj se tani, migrenën time do të ja paraqes Jezusit me më shumë zjarr!“ Ishte kënaqësi të shikosh gëzimin e Billit.

Nuk dyshoj aspak se flija e përditshme e përvujt e Billit do t'i ndihmoi Jezusit që ta shtrijë mbretërinë e Dashurisë së Tij në mbarë botën¹³⁰ dhe që shumë njerëz t'i shëroi nga *carditisi*, gjendje e zemrës që pengon zhvillimin e dashurisë. Sidoqoftë, Billi është shëruar, dhe tani edhe vaksinuar kundër naivitetit në lidhje me disa New Age viruse të cilët, nën maskën e shërimit, shkaktojnë pasoja katastrofave për shpirtin.

Lajmet më të reja nga familja e Billit thonë se dhurata e Jezusit qëndroi, dhe se për Billin kryqi i migrenës së tij u bë rrugë gëzimi.

Ç'vendosja e sëmundjes

Keni kujdes. Sot shumë njerëz shkojnë te shëruesit, dhe nuk dinë se prej nga i marrin ata 'dhuratat' e tyre. Për shembull, nëse dikujt i dhemb shpina dhe shkon te shëruesi, ndoshta shpina e tij do të shërohet por ai nuk e di se dhembja është ç'vendosur diku tjetër. Problemi apo sëmundja vetëm sa ka ndërruar vend. Atëherë do të ndikojë në një pjesë tjetër të trupit, ndoshta në një organ më vital ose në vet bërthamën e qenies së tij. Pastaj ai përsëri kthehet te shëruesi i cili ndoshta e shëron nga kjo sëmundja e dytë, por atëherë lajmërohet treta, shumë më e rëndë. Në fund do të gjendet në ankthin që nuk mund ta kontrolloi, e ndoshta edhe me mendimet për vetëvrasje. Pse një i ri do të varej pa ndonjë arsye të dukshme? Shpesh zbulojmë se në të kaluarën i ka vizituar shëruesit e tillë.

Shëruesit shpesh e marrin dhuratën nga personi tjetër i cili e ka marrë nga një i tretë. Duke ndjekur këtë varg, zbulojmë se çdo gjë ka filluar nga shtriga ose shtrigani i cili dhuratën e vet e ka marrë nga demonët! Si duket djalli shëron, por, si na thotë Jezusi në Bibël: „Do të paraqiten mesit të rrejshëm e profetë të rrejshëm dhe do të tregojnë shenja të mëdha e të çuditshme, aq sa t'i gënjejnë, po të ishte e mundur, edhe të zgjedhurit.“ (Mt 24,24)

Djajtë nuk japin dhurata, por janë shumë të shkathtë në imitimim e asaj që bën Zoti! Duke ç'vendosur sëmundjen për të krijuar iluzionin e shërimit, ata, në të vërtetë, vetëm sa i vështirësojnë gjërat. Njerëzit shpesh e lusin bashkësinë time që të përmirësoi dëmet e shkaktuara nga këto të ashtuquajtura shërime që i kanë bërë shëruesit. Kur Zotëria Jezus shëron, shërimet e

¹³⁰ Jezusi i ka thënë motrës Faustinë: „Bashkoja vuajtjet tua të vogla Mundimit Tim të Pikëlluar që ta kenë vlerën e paskajshme para Madhërisë sime.“ (Ditari §1511)

Tija janë reale dhe nuk kanë në vete kurrfarë mashtrimi. Asgjë në lidhje me to nuk është e rrejshme. Jezusi nuk i shëron vetëm trupat tanë, por bekon edhe zemrat tona, shpirtrat dhe mendjet. Ai e gjallëron krejt qenien.

Pse ndodh shpesh që ata të cilët shkojnë te shëruesit janë vazhdimisht të sëmurë? Kjo ndodh për shkak se sëmundja kalon nga trupi në zemër dhe nga zemra në shpirt. Ne mendojmë të kujdesemi për sëmundjen trupore, kurse atëherë gjejmë simptomat më të thella, si për shembull urrejtje të pazakonta, alergji etj. Sa shumë dëshmi kemi dëgjuar! Papritmas, për shembull, nuk mund të durojmë burrin ose gruan tonë. Nuk mund të durojmë mënyrën si flet ose si ecë. Papritmas, nuk mund të lutemi, jemi të bllokuar dhe nuk ndjejmë gëzimin e jetës. Zgjohehi pa dëshirë në mëngjes ose nuk kemi vullnet për punën themelore. Papritmas kemi dhembje nga migrena dhe bëhemi depresiv. Mos e sakrifikoni shëndetin tuaj ose vuajtjen tuaj për asnjë çmim! Mos e lëshoni veten në duar të sharlatanëve për të përfunduar në gjendje më të keqe! Zoja na ka këshilluar disa herë që të këshillohemi me mjekun, por kurrë me shëruesin. Ajo e di mirë pse!

Shëruesit shkaktojnë shumë depresione dhe vetëvrasje, për të mos përmendur sëmundjet shpirtërore. E kam për detyrë ta them. Mos u këshilloni me ta, madje edhe nëse ofrojnë shërim pa pagesë, madje edhe nëse e kanë truporen e Zojës së Lurdit në dhomën e ditës që t'i tërheqin katolikët naiv.

Nëse keni shkuar ndonjëherë te shëruesi, fallxhorja, shëruesi me prekje ose refleksologu, për vete ose për dikë në rrethin e familjes suaj, ju sugjeroj që të gjeni një meshtar me përvojë dhe ta lusni Jezusin për falje, madje edhe nëse kjo është bërë me qëllim të mirë nga padituria. Kërkoni nga meshtari që mbi ju të thotë uratën e lirimit që të liroheni nga të gjitha lidhjet që do të mund të ju shkaktonin dëm dhe të cilat janë rezultat i fjalëve të vdekjes që shëruesi i ka thënë mbi ju.

Vërtetë, shumë shpesh, e gjitha që duhet është rrëfimi i mirë që të ndërpritet ky zinxhir i së keqes. Sakramenti i pajtimit është shumë i fuqishëm sepse nëpërmes të tij na pastron gjaku i Krishtit që rrjedh mbi ne. Megjithatë, ai nuk është magji. Duhet që në liri të heqim dorë nga mëkati dhe të gjitha veprat e territ. Kur të kthehemi në shtëpi është mirë që të bëjmë përsëritjen e premtimeve të pagëzimit. (Lexoni kapitullin 71, “O, çfarë rrene!”) për ta refuzuar çdo ndikim të dëmshëm. Agjërimi dhe lutja janë të nevojshëm. Ata mund të shërojnë.

A do ta akuzojmë Zotin?

Si do të mund të heshtja tregimin e ardhshëm që e kam dëgjuar në Megjugorje dhe ka aq shumë kuptim?

Një njeri shëtiste në fushë në rrëzë të kodrës, dhe takoi një bari që maltretonte një qengj nga kopeja e tij. Njeriu klithi nga tmerrri kur bariu, pa asnjë arsye të dukshme, ia theu këmbën qengjit të pafajshëm dhe shtaza e shkretë tani çalonte duke rënkuar nga dhembja.

„Përse e mundoni atë qengj të vogël e të pambrojtur?“ Njeriu ishte i gatshëm të kërcente mbi bariun dhe t’i bënte një tretman të njëjtë! Se çfarë vrazhdësie! „Kjo është e domosdoshme“, ia ktheu, qetë, bariu. „E domosdoshme? Si mundët ta sakatoni shtazën?“ „Është e domosdoshme“, përsëriti bariu. „Ky qengj ka ikur tri herë në mal, dhe ky vend është shumë i rrezikshëm për shkak të ujëve. Prej tash nuk do të ikë më! Do ta bart në krah derisa t’i shërohet këmba, dhe ashtu do të mësohet me mua. Në të ardhmen do të përgjigjet në zërin tim. Kjo do t’ia shpëtoi jetën!“ „O, kuptoj...“

Zoti nuk e ka krijuar sëmundjen, por, kur e lejon, Ai ka planin e vet. Zoti ka vetëm një motiv – një motiv të vetëm për atë që bën me ne – e ky është Shpëtimi ynë i amshuar. Me fjalë tjera, Ai na jep garanci të sigurt se do të jemi të lumtur me Të, së pari në këtë botë e pastaj edhe në botën tjetër. Nuk do ta ndërrojmë Zotin, dhe kjo është gjë e mirë sepse cilësia e Tij më e madhe është mëshira. Në anën tjetër, mund t’i ndërrojmë syzet tona personale për ta përmirësuar shikimin dhe për të parë më mirë pse Ai lejon vuajtjen në jetën tonë.

* Teksti nga Vatikani mbi Reikin mund të gjendet në faqen në vazhdim:

[http://www.vatican.va/roman_curia/pontifical_councils/interelg/documents/rc_pc_interelg_doc_20030203_newage_en.html#Documents%2001%2002theCatholicChurch'smagisterium.](http://www.vatican.va/roman_curia/pontifical_councils/interelg/documents/rc_pc_interelg_doc_20030203_newage_en.html#Documents%2001%2002theCatholicChurch'smagisterium)

“Të dashur fëmijë! Ju thërras të ndihmoni që të tjerët të shohin dhe të kërkojnë paqen. Ju, të dashur fëmijë, jeni në Paqe dhe nuk mund të kuptoni shqetësimin. Prandaj ju thërras që me lutje dhe jetë të ndihmoni që tek njerëzit të shkatërrohet çdo gjë e keqe dhe të zbuloni mashtrimin me të cilin shërbehet djalli. Lutuni që e vërteta të mbisundoi në të gjitha zemrat. Ju faleminderit që ju përgjigjet thirrjes sime!” (25. shtator 1986.)

56

PLAGA E HAPUR

Vuajtja, natyrisht, mund të shkaktoi rebelimin madje edhe mbylljen e zemrës për Zotin. Kur përjetojmë goditjen, plaga e cila shkaktohet mund të na bëjë të lëndueshëm dhe mund t’u nënshtrohemi llojeve të ndryshme të infeksionit. Ajo është plagë e hapur që rrjedh gjak, dhe djalli me pabesinë e tij është i lumtur nëse mund ta shfrytëzojë lëndimin tonë. Do ta presë rastin dhe do të provoi të injektoi helmin në plagët tona të hapura. E thënë thjeshtë, do t’i propozoi ndërgjegjes sonë mendime dhe ndjenja të cilat ai i nxjerr nga burimi i vet ashtu që ta infektoi plagën. E ne do të mendojmë se këto propozime vijnë nga zemra jonë. Ja disa shembuj:

Dëshpërimi: „Shiko sa ke vuajtur në të kaluarën!“ Djalli i pëshpërit vetëdijes sonë. „Kjo goditja e fundit e mbushi kupën. Është tepër! Çfarë kuptimi ka të vazhdosh jetën kur gjithmonë je në dhembje? Mund të bësh vetëvrasje menjëherë. Dhembja do merrte fund brenda disa minutash. Pse të presësh? “

Urrejtja: „Shiko çfarë të bëri ai person! Kjo është e pafalshme! Hakmerru gjithsesi. Përpiqu t’ia shkatërrosh reputacionin, jetën familjare, punën. Ai duhet të paguaj për këtë! “

Rebelimi kundër Zotit dhe dyshimi: „Cili është ai Zot që lejon të ndodh kjo e keqe? E ti ke menduar se Ai të do? Tani e sheh? Ai nuk ka kohë për ty. A thua vërtetë beson se pranë miliarda njerëzve, që janë të tij, në botë, Ai interesohet pikërisht për rastin tënd? Pse, të dielën, të humbësh kohë në meshë? Hiq asaj pune! Përveç kësaj, a ekziston Zoti?“

Kurrë mos i dëgjoni këta zëra pervers që kundërmojnë sulfur! Refuzoni ato helme të dhunshme madje edhe nëse ju prekin dhe nëse duket që qëllojnë në mënyrë precize. Çfarë do të fitonim nëse u dorëzohemi? Vetëm vuajtje të tjera dhe humbjen e paqes! Kundërvihuni me çdo çmim madje edhe nëse për shkak të infektimit ose tërbimit, nuk mund t’i largoni menjëherë prej kokës! Nëse jetojmë jetën e lutjes, do të jetë lehtë ta njohim burimin e dërdëllitjeve të tilla. Nëse jemi nën dritën e Biblës, nuk do t’i pranojmë këto sugjerime. Ato u drejtohen prirjeve tona të këqija dhe janë të kundërta me mësimin e Lumturive. A do të na thoshte Jezusi: „Nuk do të kesh sukses. Kjo është tepër! Është më mirë ta përfundosh jetën!“ Edhe këtu na shpëton Fjala e Zotit.

Fatmirësisht, Jezusi është gjithmonë pranë plagës sonë të hapur. Jezusi është më shumë se afër. Kur vuajmë, Ai është një me ne, i bashkuar me ne. Edhe Ai dëshiron të na flasë, por sa është e ndryshme biseda me Të! Zëri i Tij i butë, i përvujtë, i matur ndaj lirisë sonë, lejon që ta njohim në lutje.

„Mos ki frikë, Unë jam! Më shiko! Shiko duart e mia, Këmbët e mia, Kraharorin tim. Shiko, edhe unë kam vuajtur! Mos ki frikë nga asgjë. Unë jam me ty. Së bashku do ta kalojmë dhe do ta mposhtim këtë tundim.“

Pikërisht këtu Jezusi do të kërkojë shërbimin prej meje. „A do të ma kishe dhuruar vuajtjen tënde? A do të ma japësh plagën tënde?“¹³¹ Pse kjo kërkesë? Sepse Jezusi e bën hyjnore çdo gjë që i jap, çdo gjë që i lejoj ta marrë. Ai shkon edhe më tej. Duke marrë atë që ia jap, Ai e integron atë në veten e Tij – në trupin e Tij. Plaga ime atëherë bëhet e Tij, kurse ai aq njëjtësohet me të sa, kur Ati na shikon, sheh vetëm një plagë – timen të bashkuar me të Tijën.

Dhe çfarë doli prej plagëve të Jezusit në Kryq? A ishte dëshpërim apo urrejtje? Hidhërim apo rebelim?

„Me vërragën e Tij ne u shëruam“, na thotë Isaia.¹³² Të zhytura në vrragët e Jezusit, plagët e mia personale, gjithashtu do të bëhen plagë dashurie dhe burim mëshire, ngushëllimi dhe paqeje. Ç’është e vërteta, dhembja nuk do të zhduket, edhe nëse do të zbutet, por kushtimi dashurisë që e përcjell, do ta shndërroi në rrugë gëzimi.

Tereza e vogël, që ka duruar vuajtje të madhe fizike dhe morale, ka shkruar në *Historinë e një shpirti*: „Kur të shkoj në Qiell do të mund t’i kundroj plagët e mia personale në trupin e Lavdishëm të Jezusit.“

Plagët e saj personale, plagët e Terezës së vogël? Çfarë flet ajo?! Kjo mësuese e madhe e Kishës ka të drejtë: Çdo goditje që mori kur ishte në tokë, u ngut të ja jepte Jezusit. E dinte se Ai do t’i shfrytëzoi për ndonjë të mirë, për rastet dhe nevojat e Tij të ngutshme: për të kthyer mëkatarin, për të liruar shpirtin nga Purgatori, për t’i sjellë lehtësim personit të sëmurë, për të përforcuar meshtarit ose ngushëlluar fëmijën.

¹³¹ “ E jani tek unë të gjithë ju që jeni të lodhur prej barrës së rëndë e unë do t’ju çlodh... “ (Mt 11,28); “E pra, Ai i mori mbi vete vuajtjet tona, mbi shpatulla të veta i ngarkoi dhimbjet tona! E ne ishim të bindur se ishte i ndëshkuar, i munduar prej Hyjit e i nënçmuar! Kurse Ai ishte i plagosur për shkak të paudhësive tona, i ndrydhur për shkak të fajeve tona; ndëshkimi, peng paqeje për ne, peshoi mbi Të: me vërragën e tij ne u shëruam.” (Iz 53,4-5)

¹³² Is 53,5

E dinte se me sakrificën e saj ka mundur të shuaj etjen e Jezusit në Kryq. Duke vepruar ashtu, i lejoi që, thjeshtë, Ai të bëjë punën e tij si Shpëtimtar, duke shndërruar të keqen tonë në hir ose duke shndërruar plagët tona të mjera në burime uji të gjallë.

Nëse vuajmë me djallin marrim pjesë në veprën e tij të shkatërrimit, bëhemi negativ dhe të hidhëruar. Vuajtja me Jezusin na bën bashkëshelbues, me Marinë dhe në Marinë, bashkëshelbuesen e shkëlqyer. Kështu mund të bëhemi engjëj ngushëllimi dhe paqeje për të tjerët!

Ashtu si edhe vuajtja morale, sëmundja është realitet me dy presa: mund të na dëmtoi ose mund të na lavdëroi, varësisht nga ajo se cilin zë vendosim ta dëgjojmë ose cilit mik vendosim t'ia dhurojmë.

Një ditë Vicka kishte kallje të fytit. Kishte shumë dhembje prandaj e pyeta: „A je lutur për shërim?“

„Jo! Kurrë nuk kërkoj shërim personal. Zoja e di se çfarë është e rëndësishme për mua dhe nuk kam nevojë ta pyes, por lutem për shërimin e të tjerëve. Do të doja të ju them të gjithë të sëmurëve që, kur të vijë Zoja, veçanërisht lutem për ta, pastaj për të tjerët. “(Kjo padyshim sqaron pse dëftimet e Vickës zgjasin më shumë se sa të veguesve të tjerë!)

„Vicka, shoh se je e gëzuar madje edhe në sëmundje. Kjo është mrekulli! Shumë njerëz do të donin të jenë ashtu. Ku është fshehtësia jote?“

„Për mua vuajtjet e dhembja janë dhurata dhe jam e lumtur që mund t'i bart. E falënderoj Zotin me gjithë zemër për ato dhurata. Do të doja t'i nxis të sëmurët që të luten kështu: 'O, Zotëri, më lejo të mund të dhuroj diçka nëpër vuajtjen time! E gjitha që kërkoj tani, është forca dhe guximi ta bart kryqin tim me gjithë dashurinë dhe gëzimin e zemrës!“

„A lutesh ti ashtu, Vicka?“

„Ashtu më ka mësuar Zoja. Unë jam personalisht e gëzuar që kam vuajtur dhe që kam mundur vuajtjen t'ia paraqes Jezusit sepse e di se i ndihmoj nëse vuajtjen time ia paraqes në këtë mënyrë. Zoja më tha: 'Janë shumë pak njerëz sot që vuajtjen e tyre e pranojnë si dhuratë!' Prandaj dëshiroj të them me gjithë zemër se vuajtja është dhuratë e madhe. Flas kështu sepse edhe vetë e kam përjetuar gëzimin në vuajtje. Është dhuratë sepse nëpër të plotësohen planet e Zotit për ata që i kemi afër. Por edhe për ata që i janë larg. Flia më e mirë që mund t'ia paraqesim Zotit është vuajtja jonë, sëmundja jonë.“¹³³

¹³³ Shën Tereza e Jezusit Fëmijë ka thënë „Vuajtja kalon, [për amshim] mbetet fakti se kemi vuajtur.“

“Të dashur fëmijë! Edhe sot ju thërras në kthim të plotë, që është i vështirë për ata që nuk janë përcaktuar për Zotin. Unë ju thërras, të dashur fëmijë, për kthim të plotë në Zotin. Zoti mund t’ju japë çdo gjë që kërkonte prej tij. Por ju kërkonte Zotin vetëm kur t’ju vijnë sëmundjet, problemet e vështirësitë, dhe mendoni se Zoti është larg prej jush, që nuk ju ndien dhe nuk i dëgjon lutjet tuaja. Jo, të dashur fëmijë, kjo nuk është e vërtetë! Kur jeni larg prej Zotit, nuk mund t’i pranoni huret, sepse nuk i kërkonte me fe të fortë. Unë lutem për ju prej ditës në ditë dhe dëshiroj që t’ju afrojnë te Zoti përherë më shumë, por nuk mundem nëse ju nuk dëshironi. Prandaj, fëmijë të dashur, vëni jetën tuaj në dorë të Zotit. Unë ju bekoj. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime!” (25. janar 1988.)

57

SHËRIMI I MATTEOS

Vicka dëshiron të tregoi për një familje italiane. Matteo dhe Greta kishin dy fëmijë, djalin dhe vajzën. Në familje kishte mjaft para por mungonte lutja. Kalonin muaj dhe vite, kurse Zotin edhe më tej nuk e pranonin në shtëpinë e tyre.

Pas një fatkeqësie komunikacioni me motor, djali i tyre ra në komë të thellë e të gjatë. Një ditë, fqinja e tyre, Luciana, e cila shkonte shpesh në Megjugorje, e takoi Gretën në rrugë dhe u tronditi kur e pa në atë gjendje të mjerueshme. Greta nuk mund ti ndalte lotët. Dukej se asgjë nuk mund ta nxirrte nga depresioni. Ia zbrazti zemrën Lucianës, duke i shpjeguar se çfarë kishte ndodhur. Familja e saj u shkatërrua. Humbën çdo gjë. Pak kohë më parë përgatiteshin ta dërgojnë djalin në një spital të posaçëm në Amerikë, por tani mjekët ishin kundër udhëtimit, sepse kjo mund të ishte fatale kur merret parasysh gjendja e tij. Shpresat e fundit i kishin në atë spital në Amerikë! Tani dukej se çdo gjë po shembej.

„Shkoni në Megjugorke!“ klithi Luciana. „Zoja dëftohet atje. Ajo është nënë dhe do të kujdeset për ju.“ Kështu Matteo dhe Greta, me të bijën, iu bashkuan Lucianës për në Megjugorje.

Meqenëse ishin të dëshpëruar, qysh ditën e parë e pyetën Vickën se a mund t’ua kushtoi pesë minuta nga koha e saj. „OK, mirë! Kur të përfundoj bisedën me shtegtarët, do të vij te ju. Vetëm prisni në fund të oborrit.“

Por Matteo i tha: „Vicka, kam vetëm një dëshirë – ta lusësh Zojën që ta shëroi djalin tonë – dhe, po ashtu, ta pyesësh, sa para duhet të japim.“

Vicka nuk deshi t'ia prish qefin dhe as ta korrigoj për atë që tha në lidhje me paratë. „Do të bëj çfarë të mundem,“ tha. „Do të lutem për djalin tuaj të sëmurë. Ejani nesër përsëri, kurse në ndërkohë do të flas me Zojën.“

Në dëftim Zoja i tha Vickës: „Thuaju se unë nuk kërkoj para. Unë kërkoj jetën e tyre. Unë i thërras që të më afrohen mua dhe Birit tim.“

Të nesërmen, në ora 10.15, djali i tyre, në Itali, u zgjua nga koma dhe filloi të ecë!

Kjo familje vazhdon të lutet dhe të vizitohet Megjugorjen. Zoti ua mundësoi të kuptojnë se Ai edhe më parë pa problem ka mundur të shëroj djalën e tyre, por ka dashur që me gjithë zemër t'i afrohen. Sot, lutja është në vend të parë në atë familje, dhe çdo gjë tjetër në vend të dytë. Në të vërtetë, mrekullia më e madhe është shërimi i zemrës së babës së këtij fëmije, Matteos. Të gjitha bekimet tjera, që pasuan, ishin shtesë!

„Paq dhe gëzimi do të kthehen në familjet tuaja....“

Zoja në Podbrdo më 5. maj 2006., u dërgoi, përsëri, thirrjen e saj familje. Të gjitha familjet që janë në buzë të shkatërrimit ose me dëshpërim kërkojnë paqen në vende tjera, dhe jo nëpër Zotin, le ta pranojnë, dëgjojnë dhe jetojnë këtë porosi themelore.

„Të dashur fëmijë, ju thërras që në familjet tuaja të jetoni shenjtërinë. Nuk mund të jeni të shenjtë pa lutje. Të dashur fëmijë, filloni të luteni në familjet tuaja! Paqja dhe gëzimi do të kthehen në familjet tuaja kur aty të kthehet lutja!“

„Të dashur fëmijë! Gjatë këtyre ditëve, kur festoni kryqin me gëzim, dëshiroj që edhe për ju kryqi të jetë gëzim. Sidomos, të dashur fëmijë, lutuni që të mund të pranoni sëmundjen dhe vuajtjen me dashuri, ashtu si i ka pranuar Jezusi. Vetëm ashtu do të mund të ju ndaj me gëzim hirin dhe shërimet që mi lejon Jezusi. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime!“ (11. Shtator 1986.)

58

DOROTA

Megjugorje, verë 2005.

Chrissey, asistentja ime, hyri me vrap në zyrën time: „Shpejt! Eja në kuzhinë! Nuk do t’u besosh syve të tu!“

„Çfarë ka ndodhur?“

„Dorota! Eja e shih!“

Dorota erdhi me familje që me ne të kaloi katër ditë në Megjugorje.¹³⁴ Atë të premtë në mëngjes ishin të pavendosur: a duhet të provojnë të ngjiten në kodrën Krizhevac apo ndoshta është më mirë që ta lusin Udhën e Kryqit pas kishës në teren të rrafshët?

„Zoti im!“, mendova. „Nuk është dashur ta lejoj Dorotën që në atë gjendje të shkojë në Krizhevac. Ishte marrëzi! Shpresoj se nuk i ka ndodhur gjë!“

Zbrita shpejt shkallët dhe tre sekonda më vonë hapa derën e kuzhinës. „Dorota! O, Dorota, ti vallëzon? Dhe qan?“

Dukej se Marek, i shoqi, ishte ngjitur për muri që t’i japë më shumë hapësirë Dorotës e cila vallëzonte. Dukej se edhe ai qante – prej gëzimit!

Një kujtim i shkurtë

Varshavë, pranverë 1994.

Zbritëm nga tramvaji, kurse era e ftohtë që frynte në avenynë e gjerë na frushkullonte fytyrën. U ngutëm drejt shtëpisë së Dorotës. Ishte misioni im i parë në Poloni, kurse Zotëria më kishte illsuar. Më kishte vënë në duar të Dorotës, një grua e re e mrekullueshme e cila me vite ishte nxënëse e Tij.

¹³⁴ Shiko pjesën me fotografi.

Dorota kishte një zemër të dashur, sidomos për të varfër. I donte me butësi dhe i kuptonte.¹³⁵ Pa ndërpre kujdesej për nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore dhe u kushtohej me gjithë qenien e saj sepse në ta shihte pamjen e Jezusit – Atë që e donte aq shumë!

Në Poloni më 1986., zbuloi Bashkësinë L'Arche për persona me aftësi të kufizuar që e kishte themeluar Jean Vanier dhe vendosi t'i bashkohej „shtëpisë së nënës“ në Francë. Në atë Bashkësi Dorota e takoi Marekun i cili më vonë do të bëhej burri i saj. Kur u kthye në Varshavë, derisa Mareku jepte matematikën, Dorota u sprovua në aftësitë e saj të mëdha letrare (baba i saj ishte i famshëm në teatrin e Varshavës) dhe u bë një nga shtyllat kryesore të një shtëpie botuese. Përktheu librin tim të parë në polonisht. Ashtu u takuam për herë të parë dhe u bëmë mike të mira.

Por, të kthehemi në Vrashavë. Atë mbrëmje, Dorota më përbujti në banesën e saj të vogël dhe, derisa rrinim pranë enës me supë të nxehtë, më udhëzoi, me gëzim, në shpirtin e Polonisë, për të cilën as tani nuk di shumë. Po ashtu, ma besoi edhe pikëllimin e vet se nuk kishte fëmijë – i humbte gjatë shtatzënisë. „Në rregull“, i thashë. „Eja në Megjugorje.“ Veguesja, Maria, thotë shpesh se janë të rralla rastet e çifteve pa fëmijë, që nuk u plotësohet lutja në disa muaj të ardhshëm nëse ata së bashku, e lusin Zojën për fëmijë, në maje të kodrës Krizhevac,“

Maria kishte të drejtë. Saktësisht një vit pas shtegtimit të Dorotës dhe Marekut në Megjugorje, lindi Agata, mrekullia e tyre e parë e vogël. Gëzimi i këtij çifti ishte në kulm. Ishte ky një peshqesh i pastër i Zojës dhe i thanë njëri tjetrit, „Po sikur të na dhurohej edhe një fëmijë mrekullie – kur do të fitonim vëllanë e vogël për Agatën? “ Por Zotëria kishte për Dorotën të tjera plane. Tani ia lë asaj pendën që me fjalët e saja të përshkruaj atë që i ka paraprirë fillimit të këtij tregimi:

„Kur Agata kishte një vit e gjysmë, fitova një sëmundje të pazakontë. Isha e lodhur tërë kohën, kurse duart e mia ishin aq të dobëta sa nuk mund ta mbaja vajzën time. Ecja gjithnjë më vështirë. Pas një viti hulumtimesh dhe pasigurie, u caktua diagnoza – multiplex skleroza, sëmundje neurologjike, progresive dhe e pashërueshme. Edhe pse kjo duket e pazakontë: nuk e kisha të vështirë ta pranoj këtë tundim. Ia kisha dhënë Zotit jetën time disa vite më parë dhe vendosa që ta pranoj atë sëmundje të rëndë, meqë Ai e kishte lejuar. Megjithatë, qava tri ditë sepse e dija se më nuk do të mund të skijoj apo të shkoj në bjeshkë, që e doja aq shumë!“

„Miqtë e mi u befasuan kur panë se unë nuk isha e demoralizuar. Mirëpo, në vete e dija se isha shkatërruar dhe u bëra tmerrësisht e vetëdijshme se gjendja ime keqësohej. Në të vërtetë, dhembja bëhej çdo muaj më e fortë. Mezi ecja dhe nuk mund të ngjisja shkallët. Kur arrita në pikën që mund të ecja vetëm njëqind metra në ditë – deri te makina – vendosëm që për shëtitje më të gjata të blejmë karrocën për njerëz me aftësi të kufizuar.“

¹³⁵ “I lumi ai që e kujton nevojtarin, në ditë të vështirë Zoti do ta shpëtoi. ” (Ps 41,1)

„Qysh më parë, me lindjen e fëmijës, e kisha provuar fuqinë shëruese të Zotit. E dija se shërimi ishte i mundur në çdo çast dhe besoja me gjithë zemër në këtë. Përkundër të gjithave, muajt kalonin dhe paaftësia ime rritej përherë e më shumë. Mareku lutej me mua për shërim dhe agjëronte me vite! Të gjitha meshët tona i paraqisnim për këtë qëllim. Edhe miqtë e mi luteshin. Në të njëjtën kohë lutesha për qëllimet e Zojës, dhe duke shfrytëzuar sëmundjen time, nëpërmes të sajë ia kushtoja Zotit dobësinë time. E ndjeja se kjo është ‘puna’ që mund të bëj për kishën dhe isha e lumtur për këtë. Por, nuk mund të injoroja faktin se përparimi i sëmundjes kishte filluar të shkatërroi familjen time. Burri im ishte tejet i ngarkuar. Pranë ligjëratave që kishte në shkollë, kujdesej për shtëpinë dhe për fëmijën tonë. E kisha përherë e më të vështirë të përballoj vetminë dhe mungesën e aktivitetit në paraburgimin e shtëpisë sime.“

„Në të njëjtën kohë e ndjeja thirrjen e butë të Zojës që të kthehem në Megjugorje dhe atje të lutem për shërimin tim. Por, si mund të realizohej kjo? Gjatë verës, nxehtësia është e rrezikshme për ata që vuajnë nga kjo sëmundje, kurse gjatë vitit shkollor, burri im nuk ka pushim vjetor. Përfundimisht shkuam në fillim të majit të vitit 2005. U nisëm me makinë, burri im dhe unë, së bashku me vëllanë tim dhe vajzën time, Agatën, e cila atëherë kishte tetë vjet dhe për të cilën donim ta falënderojmë Zojën. Shtegtimi ynë filloi në Varshavë, ku shkuam në rrëfim që zemrat tona të jenë krejtësisht të hapura. Meshtari më përgatiti për udhëtim në mënyrë të mrekullueshme: ‘Ju shkoni në burimin e jetës’, më tha. U largova nga Polonia plot me besim! Diçka e mirë do të më ndodhë.“

„U vendosëm afër kishës, në shtëpinë e motrës Emmanuel. Ditën e parë burri më çojë në shpinë në Kodrën e dëftimit. Qëndruam gjatë atje, në heshtje, para trupores së Zojës. Ishte bukur. Në mbrëmje shkoja me karrocë në programin e mbrëmjes. Se çfarë gëzimi ndjeja! Kisha përshtypjen se jam kthyer në shtëpi, se isha zhytur në lutjen e Megjugorjes e cila është më e fuqishme se kudo tjetër në botë. Paqe... “

„Ditën e dytë motra Emmanuel na shoqëroi deri në shtëpinë e Vickës. Premtoi se do të flasë me Vickën dhe se do ta lusë të zbresë prej shkallëve të sajë për t’u lutur për mua. Por si do të afrohem me karrocë deri te ato shkallë të famshme? Para nesh ishte muri i pakalueshëm me shtegtarë. Se sa shumë këmbë kemi shkelur duke kaluar nëpër turmën e njerëzve! Përparonim centimetër për centimetër. Ishte si në një tragjikomedi! Më vinin në mendje disa skena nga Bibla. Ishte pikërisht ashtu në kohën e Jezusit. Njerëzit shtypeshin dhe shtyheshin që Ta shihnin, dhe ja, edhe unë isha në situatë të njëjtë. Doja që, me çdo çmim, së paku të më prekte Vicka. Nuk kisha turp. Si fëmija, doja që të më afrohet. Përfundimisht, Vicka u lut gjatë mbi mua duke mbajtur duart e saj mbi kokën time. Nuk do ta harroj kurrë buzëqeshjen e sajë të jashtëzakonshme! Mirëpo, isha pak e dekurajuar kur u largua, sepse pas të gjitha tendosjeve për shkak të pritjes dhe shpresës se diçka do të ndodh, nuk ndodhi asgjë.“

„Të nesërmen në Shiroki Brijeg fra Jozo më vërejti duke ardhur me karrocë dhe me vajzën time. U afrua dhe ai u lut gjatë mbi mua. Kur u largua, në mua hyri një PAQE e papërshtueshme. U zhdukën të gjitha brengat dhe tendosjet.“

„Dita jonë e fundit në Megjugorje ishte e premtë. Shkuam me makinë, pa ndonjë plan, në rrëzë të kodrës Krizhevac. Nuk e kisha idenë se çfarë do të bënim. Burri nuk ishte në gjendje të më bart deri në majë sepse Krizhevac ishte shumë më i lartë se Podbërdo. Ndoshta dikush do të mund të më çonte deri në skaj të rrugës që vetëm të mund të ulesha në atë vend të shenjtë? Kur parkuam makinën, fillova të ecë pak, atëherë fillojë të ndodh diçka. Vazhdova të ec. Përparova më tej, më tej, më tej. Eca. Eca! Zoti im! Po! Eca! Burri dhe vajza erdhën te unë. Ishin të hutuar. Nuk kuptonin se çfarë po ndodh. Sa më takon mua, unë qeshja dhe ecja sepse një forcë më shtynte përpara. Nga brenda më shtynte një forcë që ishte edhe fizike edhe shpirtërore. Atëherë m'u kujtuan veguesit të cilët në kohën e dëftimeve të para, sikur ishin të ngritur në kodër. Ata kishin lëvizur me një shpejtësi të pabesueshme shpateve të kodrës që ishin përplot me shkurre ferrash. U ngjita deri te ndalesa e katërt dhe pasi ndjeva se këmbët më ishin lodhur shumë, u ula. Burri dhe vajza u frikuan sepse më kishte ndodhur që kur, ndonjëherë, kisha ecur tepër, më është dashur të qëndroj shtrirë për disa ditë.“

„U përpoqa të përqendrohem dhe të lutem – pyetsha a jam e shëruar. Në zemrën time përgjigja ishte 'po', edhe pse këmbët i kisha shumë të lodhura. Burri më barti përsëri në shpinë. Ndaleshim në secilën ndalesë. Edhe sa do të mund të qëndroi Mareku? E dija se nuk do të heq dorë lehtë, por shpina po i këputej. Arritëm deri te pjesa më e pjerrët. Mareku më tha: 'Më prit këtu. Po shkoj të shoh se a ka shumë rrugë deri në majë.' U ula në një gur dhe prita. Papritmas ndjeva se këmbët i kisha të çlodhura pastaj u ngrita dhe fillova të ngjitem. Përsëri forca e pashpjegueshme më shtynte përpara. Fillova të ngjitem nëpër shtegun guror shpejt dhe pa vështirësi. Shikova lart. Maja ishte shumë afër dhe vëllai më thërriste nga lart: “Dorota, nëse tani ndalon, vërtetë do të dukesh qesharake! Vazhdova të ngjitem.“¹³⁶

„Në rrëzë të kryqit burri erdhi te unë. Më përqafoi dhe filloi të qante. Qëndruam ashtu gjatë në heshtje të plotë. Gjatë zbritjes, në gjysmë të rrugës, Mareku më mori për dore dhe u mbështeta pak në të. Vazhdimisht i lutesha Zotit dhe e adhuroja, por luftoja, po ashtu, me frikën time. Kisha frikë se nesër do të zgjohem e paralizuar, frikë se diçka e keqe do të më ndodh. Fatmirësisht, m'u kujtuan shërimet nga Bibla. Për shembull, se si Pjetri ecën mbi ujë. Nëse dyshoj do të më ndodh si atij – do të fundosem. Në brendi luftoja me veten që të besoj. Me gjithë forcën mbahesha për besimin tim.“

„Sot, pas tetëmbëdhjetë muajsh mund të them se kam pranuar shërim të pjesshëm.¹³⁷ –
përmirësim i madh i shëndetit tim. Është e pashpjegueshme sepse shkenca mjekësore, deri më

¹³⁶ Shiko pjesën me fotografi.

¹³⁷ Shërimet që pranojmë në këtë tokë gjithmonë janë të pjesore dhe të përkohshme sepse një ditë të gjithëve do të na duhet ta braktisim këta trupa prej mishi dhe të kalojmë nga kjo jetë në jetën tjetër. Vetëm atëherë do të marrim atë trup të lavdishëm dhe të pakalbshëm, të veshur me amshim, i cili nuk do të na shkaktoj probleme. Natyrisht, Dorota ka mundë të marrë shërimin i cili do t'i mundësonte që të ecë jo vetëm një kilometër por dhjetë. Përse ka marrë vetëm për një kilometër? Vetëm Zoti e di, dhe ne i përkulemi vullnetit të Tij hyjnor. Atë Daniel Ange nga Franca ka

sot, mundet vetëm ta shtyjë përparimin e kësaj sëmundjeje dhe të ngadalësoi procesin e shkatërrimit, por kjo është e gjitha. E thënë shkurt, nuk mund të bëjë asgjë.“

„Tani mund të ec së paku një kilometër në ditë në vend të njëqind metrave. Ngjis dhe zbres shkallët. Dhe jam shumë më e fortë, kurse karroca ime ka përfunduar në bodrum. Jeta jonë është ndërruar plotësisht. Familjes sonë i është kthyer stabiliteti. Mund të marr mbi vete më shumë punë dhe çfarë është më me rëndësi, mund të kujdesem për vajzën time. E shoqëroj deri në shkollë ose deri në shtëpi të miqve të saj. Fryti i parë i këtij shërimit është se mund të shkoj çdo ditë në meshën shenjte. Në eukaristi gjej të njëjtën forcë e cila më shtynte në Krizhevac – gjatë javës së parë pas kthimit tim, e ndjeja fizikisht në kohën e kungimit. Tani e ndjej në mënyrë të fshehtë, por edhe tani mund të më ngrit prej toke. Kjo është diçka si një pjesë lavdie.“

„Së paku gjysma e njerëzve që vuajnë nga kjo sëmundje, vuajnë edhe nga depresioni. Mund t’ua zbuloi fshehtësinë që më ka ruajtur mua nga depresioni. Kjo është lutja: 'Zotëri, u bëftë Vullneti yt, u bëftë ajo që do Ti.' Kjo lutje, e thënë me plot besim, ka fuqi të madhe.“

„Ditët e para në shtëpi, pas shërimit, më kanë mbetur të gjalla në kujtesë. Telefoni cingëronte tërë kohën. Gjatë atyre bisedave disa njerëz qanin. Pa pushim e ritregonim ngjarjen për katër ditët në mes të Qiellit e Tokës, në Megjugorje. Një mike imja klithi: ‘Por kjo është e pamundur. Kjo nuk ndodh kurrë! Më duhet të shoh. Si mund të takohemi?’ Iu përgjigja: ‘Eja të shëtisim në parkun para shtëpisë sate.’ Ishte parku në të cilin këmbët e mia nuk mundën të më çojnë gjatë pesë viteve. Detyrat më të thjeshta ditore u bënë ngjarje të mëdha, si për shembull, daljet e mia të para në dyqanin më të afërt, ku kisha shkuar shumë herë me karrocën e njerëzve ma aftësi të kufizuar. Tani mund të vendosja vetë se çfarë do të qes në shportën time. E ulur në karrocë i shikoja gjërat nga perspektiva e ulët sa që gati nuk shihja asgjë! Ndjehesha si gjësend. Sa i takon Agatës e cila, nga natyra, nuk flet shumë, shkëlqente prej gëzimit, dhe miqve të sajë u tregoi çdo gjë në lidhje me këtë ngjarje. Ishte aq e lumtur se ditët e karrocës sime kishin marrë fund.“

„Eci dhe marr frymë! Përpara më dukej se po ngulfatesha nga mungesa e lëvizjes. Më mungonte oksigjeni. Natyrisht edhe më tej jam e hendikepuar, por e di se Zoti më ka prekur dhe e dua. Nëse më përfshin dëshpërimi për një kohë të shkurtë, e lejoj Zotin që të disponoi me mua ashtu si do – e di se Ai ka për mua edhe shumë befasi dhe do të doja të kem kohë që të mund të punoj edhe pak për Të.“

Dorota ka një fshehtësi. Si do të mund ta fshihja? „Kur Zotit ia dorëzon jetën“, më tha pak kohë më parë, „të ofron liri të madhe dhe një ndjenjë sigurie. Kjo gjithashtu ndërron shkallën tënde të vlerave. Pse duhet që me çdo kusht të kapemi për shëndetin dhe jetën tokësore?“

gjetur një shprehje të mirë, duke e ditur se plani i madh i Zotit është që të rritemi në dashuri. Prandaj ka thënë: „Zoti na shëron mjaftueshëm që të jemi të aftë të duam, dhe nuk na shëron plotësisht për të qenë të aftë të duam.“

Të gjitha këto e humbin rëndësinë kur Zotin e vëmë në vendin e parë. Zoti nuk e do vuajtjen tonë. Ai do besimin tonë. Çastet apo vitet e tundimeve na mundësojnë t'ia dëshmojmë besimin tonë se, me të vërtetë çdo ditë lëshohemi në duart e Tij. Në këtë mënyrë mund të gjejmë gëzimin në vuajtje. Gjithmonë kemi diçka që mund t'i japim Zotit, kurse Jezusi ka thënë: „Më i lum është ai që jep se ai që merr. “ (Vap 20,35).

„Të dashur fëmijë! Sot ju thërras në lutje. Unë jam me ju dhe ju dua të gjithëve. Unë jam nëna juaj dhe dëshiroj që zemrat tuaj të jenë të ngjashme me zemrën time. Fëmijëz, pa lutje nuk mund të jetoni dhe të thoni se jeni të mitë. Lutja është gëzim. Lutja është ajo që dëshiron zemra e njeriut. Prandaj, afrohuni, fëmijëz, zemrës sime të pa mëkat dhe do ta zbuloni Zotin. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime!“ (25. nëntor 1994.)

59

A VONOHET ZOTI?

Atë Sllavkos nuk i mungonin fjalë ngushëlluese për zemrat e pikëlluara. Shumë nëna vinin dhe ankoreshin në Zotin: „Atë, Zotëria nuk më dëgjon. Kjo është e tmerrshme! Më se tri vite lutem për djalin tim që drogohet dhe nuk pashë asnjë përmirësim. Çfarë duhet të bëj që Zoti të më dëgjoj?“

Ishte i njohur për përgjigje të tilla: „Zonjë, Zoti gjithmonë i dëgjon lutjet tua – madje edhe ato më të voglat. Por Zoti nuk i shikon gjërat ashtu si ne. Ai sheh shumë më larg! Shiko çfarë ka bërë me shenjtën Monikë. Ajo ka qarë dhe është lutur më shumë se njëzet vjet për djalin e sajë Shën Augustinin, i cili sillej keq, dhe asgjë nuk ndryshonte. Por, nuk demoralizohej. Ajo qëndroi në lutje. Kjo është mirë për ne sepse, sikur lutjet e sajë të ishin dëgjuar menjëherë, do ta fitonim Shën Augustinin, por me që ajo ka qëndruar aq gjatë në besim, tani kemi edhe Shën Augustinin edhe Shën Monikën. Nuk është keq apo jo? Motër e dashur, mos u demoralizo. Ende nuk i ke kaluar njëzet vite me lot!“

Qindra gra vinin tek dera e tij duke qarë e vajtuar, dhe shkonin të trimëruara. Frustrimi në zemrat e tyre ndërrohej me gëzimin e ecjes në shenjtëri.

Në kohën e duhur, do ta bëj këtë.

Kur jetoja në Nazaret, Bashkësia ime kërkoi nga unë që ta kaloj shtëpinë tonë në Jerusalem. Kështu mu desh ta gjej vendbanimin, dhe kjo është gati e pamundur në qytetin Shenjt, sidomos nëse nuk keni të ardhura të vazhdueshme. Prandaj jemi lutur shumë dhe kemi nxitur Shën Jozefin, ekspertin e madh për shtëpia, si e dinë të gjithë! Mirëpo, muajt kalonin dhe asgjë nuk shihej në horizont. Në kohën e njëres nga këto lutje, hapëm Biblën dhe Zotëria na dha këtë rresht: „Në kohën e duhur, do ta bëj këtë!“ (Is 60,22)

Dhe, me të vërtetë, pasi që shikuam disa muaj në Qiellin e mbyllur, në vjeshtën e vitit 1981., u rreshtua një varg i tillë ngjarjesh sa që në më pak se 24 orë u bëmë pronarë të një shtëpie të vogël

private në zemër të Jerusalemit! Vendasit ende nuk e kuptojnë si ndodhi kjo. Pse pikërisht atë ditë dhe pse aq shpejt? Vetëm Zoti e di. Ai zgjodhi këtë shtëpi të thjeshtë e modeste për ne dhe me kujdes e përgatiti lëvizjen e tij! Sikur të vepronte ndryshe, duke marrë parasysh njerëzit që ishin përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe rrethanat tjera, kurrë nuk do ta fitonim shtëpinë.

Natën e parë që u vendosëm në shtëpi, u shikuam mes vete plot vrull për shkak të dashamirësisë që na kishte dhuruar Qielli. Muri i një kopshti të vogël na ndante me tridhjetë centimetra nga lagja Mea Shearim¹³⁸. Prej të gjitha sinagogave dhe yeshivotave¹³⁹ rreth e përqark dëgjohej vajtimi i gjatë dhe pikëllues, meloditë që shqyenin zemrën të cilat në mol i këndonin zërat e thellë të meshkujve. Bijtë e Izraelit kremtonin kujtimin e shkatërrimit të Tempullit. Atë ditë ishte Tisha Be Av¹⁴⁰. Këtë e kishim harruar. Këndoheshin në hebraishte vajtimet e Jeremisë profet, ose më mirë të themi qaheshin, duke mbushur ajrin dhe duke depërtuar në zemrat tona dhe shpirtrat tanë. Atë mbrëmje, në mes të pikëllimit të kësaj ngjarje të bukur, Zoti erdhi dhe vulosi thirrjen e shtëpisë sonë dhe jetëve tona.

„Në kohën e duhur, do ta bëj këtë!“ Po, është dashur të vijmë atë ditë, pikërisht në atë kohë dhe pikërisht në atë vend që plani i Zotit për praninë tonë në Jerusalem të jetë i vulosur në ne. ‘Vonesat’ e Zotit janë shumë interesante. Gjithmonë fshehin një plan shumë më të mirë se i yni.

Ia vleme të presësh!

Gjyshja ime, Annie Templier, nuk kishte shoqe në mesin e punëtorëve të Zotit në çastet e fundit. Me 15. janar të vitit 2006., kaloi në amshim. Përkundër moshës 103 vjeçare, truri i saj mbeti i mprehtë deri në fund. Ajo kurrë nuk harronte të thotë ndonjë fjalë falënderimi dhe ngushëllimi atyre që i ndihmonin. Për t’iu ndihmuar atyre që i frikohen plakjes, do ta tregoj një ngjarje nga jeta e saj shpirtërore, që është për mua shumë ngushëlluese. Atëherë ajo kishte 101 vjet.

Një ditë, në kalim nëpër Paris, në mes dy misionesh, pata me të një nga bisedat e paharrueshme. Ma hapì zemrën dhe më tregoi diçka që ishte për të brengë e madhe:

„Shiko e dashur, më mundon një trishtim – trishtim i madh! Mungon diçka në raportin tim me Zotin dhe nuk më le të qetë. Kur shikoj ty, nënën tënde, vëllezërit tu dhe të gjithë Maillarde-t e vegjël, shihet qartë se keni dëshirë të luteni. Ju gjeni gëzim në lutje, madje edhe në lutje të gjata, por për mua, nuk është kështu. Dhe kurrë nuk ka qenë. Natyrisht, unë çdo ditë i them lutjet e mia, si dhe rruzaren dhe gjithë ato “gjëra”, madje mendoj për Zotin edhe para gjumit, por, të them

¹³⁸ *Mea Shearim* është lagje në të cilën jetojnë hebrenjtë e devotshëm në Jerusalem.

¹³⁹ Shkollat për mësimin e Torës.

¹⁴⁰ *Tisha Be Av*: dita e nëntë e muajit Ava, dita e shkatërrimit të Tempullit.

sinqerisht, gëzohem kur ato lutje kryhen.¹⁴¹ E pra, ka një kohë të gjatë që i them vetes se kjo nuk është normale. Zoti është i mirë, aq i madh, do të duhej të gjeja gëzim në lutje.“

Personalisht nuk isha shumë e brengosur për gjyshen sepse gjithmonë kishte një zemër të mrekullueshme, dhe gjithmonë ishte e gatshme të na dëgjoi, ngushëlloi dhe trimëroi. Ishte shumë afër Zotit, dhe këtë as nuk e dinte. Unë i thashë: „Gjyshe, më e rëndësishmja në jetë është dashuria dhe ti e ke atë. Mos u brengos! Mirëpo, do të lutem për ty në Megjugorje dhe bashkë do të kërkojmë prej Zotit që të të lejoj ta shijosh gëzimin e lutjes që dëshiron. Është aq thjeshtë. Në Megjugorje Zoja na thotë ‘të lutemi derisa lutja të na bëhet gëzim’. Nëse ajo e kërkon këtë, kjo është sepse fitohen hire. Ne duhet ta lusim Zotin si fëmijë, me besim të plotë. Kjo është ajo që më së shumti ka sukses.“

„Pajtohem, shpirt! Ti lutu atje, kurse unë do të provoj këtu njësoj. Do të jemi të bashkuara.“

E vizitova përsëri pas gjashtë muajsh dhe menjëherë më tha: „A të kujtohet biseda jonë e fundit? E pra, shpirt, u rregullua! Tani e ndjej gëzimin e lutjes!“

Dukej si fëmijë i habitur me dhuratën e mrekullueshme, më të jashtëzakonshme se çdo gjë që mund të ëndërrohet. „Tani e kuptoj përse Zoti ka bërë që aq gjatë të pres në tokë. A kupton? Është dashur të jetoj 102 vjet që të pranoj këtë hir! Dhe nuk më vjen keq. Ia vلente të presësh!“

Menjëherë pas kësaj, kaloi në Bashkësinë time ku jetoj edhe tetëmbëdhjetë muaj. Të gjithë kishin dëshirë të kalonin kohë me të. Zoti i dhuroi “lutjen e zemrës” dhe në të njëjtën pako futi edhe pak humor. Tani nuk frikohej më nga vdekja. „Do të hidhem në duart e Zotit“, i thoshte vëllait tim. U largua nga kjo tokë e mbushur me paqe.

Se çfarë vepra të mrekullueshme bën Zoti në ata që shoqëria e sotme “e të arriturave të mëdha” i gjykon, ngutshëm, si të “padobishëm”. Këta „të padobishëm“ janë në të vërtetë ata me të arriturat më të mëdha sepse bukuria e tyre e padukshme do të jetë margaritar i amshuar për Kishën Qiellore kurse kjo botë dhe pasuritë e sajë kalimtare do të zhduken.

¹⁴¹ Më 1976., menjëherë pasi u futa në Bashkësi, kërkoi t’ia përshkruaj një ditë tonën. Kur dëgjoi programin tonë, e llogariti se duke përfshirë meshën, lutemi më shumë se pesë orë në ditë. Atëherë tha me vendosmëri: „Shiko, e dashur, kjo është tepër!“

„Të dashur fëmijë! Vërtetë është gjë e madhe se si Zoti i thërret njerëzit. Mendoni sa e dhimbshme do të ishte të refuzohen këto raste që i jep Zoti. Prandaj mos prisni të nesërmen ose të pasnesërmen. Tani thoni Jezusit 'po'! Dhe kjo 'po' le të jetë përgjithmonë.“ (16. maj 1987.)

60

VETËM SOT MUND TË DUA

Të rinjtë që vizitojnë Megjugorjen shpesh janë të prekur thellë me përvojën e atë Mike nga Kanadaja.

U shugurua për meshtar në moshën 26 vjeçare. Gjashtë muaj më pas ishte viktimë e një aksidenti të tmerrshëm komunikacioni. Pas ndeshjes u gjend nën tunelin e dritës për të cilin e dinte se është dera e parrizit. Pastaj përjetoi gëzimin dhe përsosmërinë intensive të cilat nuk i njihte më parë. Kur qe pranë Jezusit ishte i mbushur me paqen e pamasë. Por atëherë u vetëdijesua për thirrjen që të kthehet në jetën në tokë sepse puna e tij ende nuk ishte kryer. Ai tha se gjatë “kthimit në tokë” kishte një dëshirë të papërmbajtshme që të gjithëve që do t’i takonte t’u thotë se jeta është e shkurtë, se Zoti është real dhe se nuk do të guxonim të humbim asnjë çast në diçka që është më pak se Zoti. Pastaj u zgjua në spital.

Gjatë periudhës së shërimit e cila zgjati afër një vit, atë Mike nuk i foli askujt për përjetimin e tij. Gjatë tërë kohës ndjehej i humbur dhe i papërqendruar. Vuante për Qiellin. Atëherë një anëtar i famullisë e ftoi për të shkuar në Megjugorje. Nuk ishte i interesuar, por nga mirësjellja e kontrolloi orarin e tij. Kur pa se në atë kohë ishte i lirë, vendosi të shkoi. Mbi të gjitha, ishte një udhëtim pa pagesë në Evropë! Pse jo?

Duke u folur një grupi shtegtarësh që kishin ardhur për t’ia kushtuar Zojës jetën dhe thirrjet e tyre, i luste: „Mos e shtyni të jetuarit e jetës për Jezusin. Mos thoni: 'Kur ta përfundoj fakultetin, do të ja jap jetën time Zotit dhe do t’i shërbej. Kur të martohem, atëherë do të mund t’i shërbej Zotit. Kur ta përfundoj shkollën e mesme, atëherë do të jem i gatshëm të bëj vullnetin e Zotit.' Jo! Tash, menjëherë vendosni të jetoni jetën tuaj për Jezusin! Duke filluar nga tash, lëshohuni në dorën e Zotit. Mos prisni asnjë sekondë! Më besoni, nuk e dini edhe sa kohë do të jetoni. Isha meshtar i ri kur e shmanga vdekjen për një fije. Nëse do të kisha vdekur në atë çast, jeta ime do të ishte e humbur. Kur të vij fundi, vetëm një gjë është me rëndësi – jeta e jetuar për Zotin. Nuk e dini çastin. Mos prisni! Jetoni për Zotin, kërkoni Zotin, doni Zotin. Bëjeni këtë tani, jo nesër. Nuk e dini se a do ta jetoni ditën e nesërme!“

Fjalët e Armikut janë goxha të ndryshme dhe shumë njerëz bien në grackën e tij: „Prit“, na propozon. „Më vonë do ta bësh këtë vepër të mirë. Tani nuk je ende i gatshëm.“

Ajo dëshiron të vozisë

„Çfarë do duhej bërë?“ „Cilës rrugë do duhej shkuar?“ „Cilën kahe do duhej zgjedhur?“ Aq shumë të rinj, por edhe ata që nuk janë aq të rinj, i mundojnë këto pyetje serioze për ardhmërinë e tyre.

Francezja e re Clothilde ishte e brengosur në Megjugorje sepse nuk e dinte planin e Zotit për jetën e sajë. Përfundimisht e gjeti paqen duke iu falënderuar një meshtari shenjt i cili i tha: „Kur vozit gjatë natës nga Avignon deri në Marseilles, dritat nuk ndriçojnë të gjithë njëqind kilometrat e rrugës sate. Ndriçojnë vetëm atë pjesë të rrugës që të duhet. E pra, Zoja bën të njëjtën gjë kur të prin! Të prin në qiell, por në vend se të ndriçoi gjithë rrugën, ajo ndriçon vetëm atë pjesë të rrugës që duhet ta shohësh. As mos provo të shohësh një kilometër më tutje. Nuk do rrezikosh nëse e kalon- kthesën e ndriçuar para teje, dhe as nuk të duhet t’i kesh sytë e fiksuar për retrovizor. Mos shiko prapa se do të mund të godasësh ndonjë pemë. Jeto në të tashmen. Ki besim në Zojën.“

Katër vjet më vonë Clothilde deklaroi: „Ajo këshillë ma ndryshoi jetën. Ardhmërinë time e lashë në duar të Nënës së Zotit dhe atëherë të gjitha brengat dhe frikët e mia i zëvendësoi gëzimi i thellë në sigurinë me të.“

„Disa muaj pas takimit me këtë meshtar, Jezusi kërkoi prej meje të bëj një kthesë radikale. Fatmirësisht isha në gjendje të duhur mendore, përndryshe do ta kisha më të thjeshtë të mos dëgjoj ose të mos pranoj thirrjen e Tij apo ta lëshoj rastin t’i them ‘po’. Tani lutem për të rinjtë, që t’ia dorëzojnë të ardhmen Marisë dhe të mos mundohen, sepse t’i dorëzohesh Marisë do të thotë të zgjedhësh sigurinë. Kur t’i ndizni dritat e automobilin, përsëritni ‘po-në’ tuaj Marisë, ashtu që të mund të jetoni në çastin e tashëm.“

„Duhet të pranoj se Nëna jonë Qiellore, me mënyrën se si na prin, shpesh tregohet si vozitëse shumë e shkathtë për shkak të së cilës të famshmit Michael dhe Ralph Schumaker të kësaj bote pas drejtuesit të Ferrarijëve të tyre, do të zverdheshin në fytyrë nga zilia!

Të më bësh meshtar!

Atë Joseph Quinn udhëtonte nga Irlanda në Megjugorje për t'iu falënderuar Nënës së Zotit. Në moshë shumë të re filloi “t’i ndez dritat e veta” nën drejtimin e Zojës. Joseph i vogël kishte vetëm nëntë vjet kur daja i tij, i cili lëngonte nga kanceri, përgatitej për shtegtim në Lourdes.¹⁴² Joseph ishte i befasuar kur shihte miqtë dhe fqinjët që vinin në shtëpinë e tij që dajës t’ia dorëzojnë zarfet misterioze. Nëna i shpjegoi se ata njerëz i dërgojnë qëllimet e tyre Zojës së Lourdes-it, e cila do t’i lexoi dhe do t’u përgjigjet në to, sipas vullnetit të Zotit.

Atëherë një ide u rrënjos në mendjen e fëmijës. Pa i treguar askujt vrapoi në dhomën e vet dhe i shkroi këto fjalë me dorëshkrimin e tij më të bukur: „E dashur Mari, të lutem, më bën meshtar. Biri yt, *Joseph*“. Në atë kohë Joseph-i luste rruzaren, dhe nuk mendonte shumë për të, por me gëzim e vazhdonte zakonin familjar. Sipas asaj që i kishte thënë e ëma, e dinte se Maria është një grua e mrekullueshme.

Zoja e mbajti për fjale Joseph-in. U shugurua meshtar në vitin 1995.

Sot atë Joseph rrezaton me gëzim të dukshëm që është meshtar. „Çdo herë e përjetoj shumë thellë çastin kur në duart e mia ndodh shndërrimi i bukës në Trupin e Krishtit dhe i verës në Gjakun e Krishtit” – thotë atë. Joseph.

¹⁴² Ashtu si atë Sllavko thoshte, me mahi: „Zoja e Lourdes-it dhe Zoja e Megjugorjes janë diçka si kushërira – nuk i kundërshtojnë njëra tjetrës!“

„Të dashur fëmijë! Nëse dëshironi të jeni shumë të lumtur, jetoni jetë të thjeshtë, të përvujtë. Lutuni shumë dhe mos u ndalni në problemet tuaja por lejoni Zotin të ju prijë. Zgjidhni rrugën e thjeshtë.“ (E diela e pashkëve, 1984.)

61

SOT DO TI HUDHËSH MBETURINAT

Maud e shoqëronte të shoqin në ordinancën mjekësore. Pas vizitës, mjeku e tërhoqi anash Maud dhe i tha: „Duhet të flas me ty.“ Kjo ftesë dukej serioze dhe Maud, në vete, ndjeu kambanat e alarmit. Mjeku i tha thjeshtë: „Nëse nuk i bëni këto gjëra, burri juaj do të jetë i gjykuar për vdekje.“

Maud ishte e befasuar. „Mirë, cilat gjëra?“ - pyeti.

Mjeku u përgjigj: „Së pari, çdo mëngjes i përgatitni kafjall të mirë e të ngrohtë – pa kafe të ngutshme... Çdo ditë le të vijë në shtëpi pas punës e ju përgatitni ushqim të mirë, të balancuar dhe të ushqyeshëm. Kujdesuni që çdo mbrëmje të ketë darkë të mirë, por pa porositje ushqimi nga restoranti, pa ushqim të shpejtë dhe pa mikrovalë që ua shkatërrojnë shëndetin. E dyta, mos e ngarkoni me punë të shtëpisë. E treta, le të jetë shtëpia përsosmërisht e pastër dhe të mos ketë baktere në afërsi.“

Rrugës për në shtëpi, i shoqi i Maud u kthye kah ajo dhe e pyeti: „E di që mjeku ka biseduar me ty. Çfarë të tha?“

„Se do të vdesësh, i dashur“ – ia ktheu.

Ndoshta edhe ne jemi si Maud. E kemi marrë recetën për shëndetin dhe shenjtërinë e kësaj bote. Kjo recetë është e thjeshtë, por kurrsesi nuk po mund t’i përmbahemi ashtu si ka urdhëruar mjeku. Më shumë na interesojnë porositë që i janë dhënë një numri të vogël njerëzish se sa porositë që i janë dedikuar mbarë botës. Porositë që u janë dhënë disave nuk duhet ti dinë të gjithë. Por porositë e dedikuar mbarë botës do të duhej ti dimë, por megjithatë ne nuk u përmbahemi. I injorojmë! Shumë katolikë e bëjnë këtë gabim!

Kështu, në vend që të obligohemi se do të lusim rruzaren çdo ditë, ne lexojmë libra dhe lajme për Fatimën. Kemi vendosur të marrim vesh se çfarë shkruan në zarfin e mbyllur në arkivin e Vatikanit. Në vend të agjërimit dhe penesës, kalojmë kohën duke spekuluar se çfarë do të mund

të ketë në dhjetë fshehtësitë nga Megjugorja. Kalojnë muaj dhe vite para se të shkojmë në rrëfimin e rrallës, por nuk vonohemi për të lexuar *Tri ditë terri*.¹⁴³ Nuk na interesojnë enciklikat e Papës, por vërtetë na intereson a thua Papa ia ka kushtuar Rusinë Zemrës së Pamëkat të Marisë. Lejojmë që raportet tona personale në shtëpi të vuajnë nga mungesa e lutjes dhe interesimit. Shpenzojmë sasi të madhe kohe duke u përpjekur të parashohim kur do të pushojnë dëftimet e Megjugorjes. Dhe për çdo vit gjejmë arsye të re, ta shpallim se koha është afër.

Asgjë nga këto nuk duhet të dimë. Prandaj janë fshehtësi. Puna jonë është të bëjmë si duhet atë që duhet ta bëjmë sot – e kjo është, të rritemi në shenjtëri!

Jezusi zbriti te Maria dhe Jozefi dhe ishte i dëgjueshëm. Nëna e Tij i ruante të gjitha në zemër. Jezusi nuk tha: „Unë do të bëhem Mesia. Unë do ta shpëtoj botën.“ Jo.

Maria tha: „Jezus, sot, ti do ta shtrosh tavolinën për darkë dhe kështu do të rritesh në shenjtëri. Pastaj mund t’i hedhësh mbeturinat.“ Jezusi u bë trup dhe na tregoi se si të jemi të shenjtë në jetën e përditshme. Ka ngrënë dhe ka fjetur, ka kryer detyra. Ka mësuar dhe është lutur si të gjithë ne. Por, ishte Shenjt. Besoj se Maria i ka ruajtur këto gjëra të thjeshta, si kujtimi për fjalën e parë të Jezusit, qoftë ajo Ima (nënë) ose Abba (babë). Duhet të mësohemi të jemi të shenjtë në jetën e përditshme, por edhe në krizat shkatërruese që mund të na godasin në jetë.

I lumturuari Pier Giorgio Frassati

Disa njerëz janë të bekuar prej Zotit, madje edhe në mes të begatisë dhe suksesit. Mendoj këtu në italianin e ri, të lumturuarin Pier Giorgio Frassati. Jetoj në Torino, në Itali, prej 1901. deri 1925. Ishte biri i prindërve shumë të pasur. I ati, senator dhe ambasador në Gjermani, ishte pronar i gazetës ditore *La Stampa*. Pier Giorgio u rrit në vilën në mes të shërbyeseve, shërbëtorëve dhe vozitësve. Fshehurazi ua jepte të hollat e tij të varfërve dhe të sëmurëve, dhe madje as nuk e shfrytëzonte emrin e vet. Kur ishte 21 vjeçar, i nxitur nga besimi i madh, siguroi ushqimin, veshmbathjen dhe mësimin për 125 nëna mbajtëse të familjes dhe për fëmijët e tyre. Jetonte në shoqëri të lartë dhe ishte shumë i pashëm. Ishte i pari në të skijuar por ishte edhe malor. Çdo gjë i shkonte përdore. Por, gjithashtu ndante kohën për Zotin dhe çdo mëngjes shkonte në meshë. Thoshte lutjen e mëngjesit dhe të mbrëmjes, rruzaren në mbrëmje dhe çdo natë kishte orën shenjte. Nganjëherë kalonte tërë natën në adhurim para Sakramentit Tejetshenjt të Altarit. Shkonte në shkollë dhe kishte miq, luante bilardo dhe notonte, i bënte të gjitha.

¹⁴³ Profetizime të dyshimta me të cilat pasurohen tregtarët me qirinj!

Por një ditë, kur vizitoi të sëmurët, u infektua me paralizën e fëmijëve. Në atë kohë nuk kishte ilaç për këtë sëmundje. Vdiq pas gjashtë ditësh në moshën 24 vjeçare. Në mbrëmjen, para vdekjes, edhe pse i paralizuar, shkarraviti porosinë për njërin nga miqtë e tij. Në të shkruante: „Është një varfanjak që quhet Converso. Në xhep kam recetën për gjilpëra dhe injeksione. Harrova ta plotësoj në barnatore. Merre recetën dhe çoje n barnatore, plotësoje dhe vene në llogarinë time.“ Kjo ishte vepra e tij e fundit në tokë. Mund të jemi edhe të pasur dhe të shenjtë. Të pasurit e të varfërit, të gjithë jemi të thirrur për shenjtëri.

Shenjtë Filip Neri

Ishte njëri nga meshtarët më të mëdhenj në historinë e Romës. Jetoj në fillim të shek. 16. Nuk e thirrnin vetëm meshtari më i mirë i Romës por edhe kllouni romak. Ishte i njohur si për mahitë dhe gjallërinë ashtu edhe për predikimet e tij. I tërhiqte edhe fëmijët edhe të rriturit, por e tradhtuan për shkak të zilisë. Kolegët meshtar dhe ipeshkvijtë e bindën Papën se ky meshtar është turp dhe kloun, është palaço. E akuzuan për veprime të pamoralshme sepse thoshin, se njeriu, nuk mund të argëtohet aq shumë si meshtar. Sigurisht bën diçka të keqe. Filipi u përjashtua nga meshtaria. Nuk guxonte më që publikisht të kremtonte meshën, të rrëfente dhe as të predikonte.

Përkundër gjithë kësaj, Filipi e ruajti fenë. Lutej, agjëronte dhe shkonte në rrëfim. I fali përsekutuesit e tij. I ktheu zemrat e tyre dhe u shenjtërua nëpër vuajtje. Me zjarr e dëshironte shenjtërinë për gjithë popullin e tij. U predikonte me afsh se duhet të shkojnë në meshë dhe në rrëfim, por askush nuk i dëgjonte predikimet pos grave të moshuara. Në mbrëmje të gjithë shkonin në salla vallëzimi dhe gosti.

Për këtë shkak, për pesë vjet rresht, agjëroi me patate të ziera dhe me ujë, për t'i kthyer njerëzit. Disa pjesëtarëve të famullisë së tij nuk u pëlqente ashpërsia e tij dhe thirrjet në kthim. Disa djelmosha shkruanin grafitë në muret e rektoratit dhe këndonin këngë të shëmtuara për të, duke e akuzuar për raporte jashtëligjore. Të gjitha këto iu paraqitën ipeshkvit dhe u hetua për periudhën tri vjeçare. Për shkak të këtij tundimi, u rrit shpirtërisht dhe tha se ky ishte një hir. Vlen të përmendet rezultati - agjërimi i tij me patate dhe ujë shkaktoi jo vetëm kthimin e famullisë por kthimin e ipeshkvit dhe të gjithë kolegëve të tij meshtarë!

Shën Gjon Bosco

Jetoj në Torino, në Itali në shek. 19. Është i njohur për shtëpiat e tij të lutjes. Brengosej për numrin e madh të të rinjve që ishin viktimat të shfrytëzimit dhe bridhnin rrugëve. Të rinjtë shërbenin në fabrika si fuqi punëtore fëmijërore e pastaj u shiteshin shtëpive publike si robër seksi. Në lidhje me këtë kisha nuk ndërmerre asgjë. Hapi shtëpi të vogla lutjeje për fëmijë të varfër ku mund të mësonin ndonjë zeje, të arsimoheshin dhe të formësoheshin në fe. Do të mund

të prisnim se Kisha dhe shteti kanë qenë mirënjohës por pikërisht e kundërta, ishin xheloz. Karikaturat redaksionale së shpejti filluan ta përqeshin Gjonin, shkruanin artikuj për të në gazetat ditore, sugjeronin se dikush aq i mirë duhet të jetë shumë i keq! E braktisi Kisha e tij. Gjon Bosko qeshte shumë, luante shumë lodra por edhe vuante.

Secili prej këtyre shenjtërve i jetonte porositë. Luteshin, agjëronin, rrëfenin mëkatet e tyre, i falnin ata që kishin mëkatuar kundër tyre dhe ashtu gjenin paqen. Edhe para se të ekzistonte Megjugorja, ekzistonin porositë sepse janë të rrënjosura në Ungjill! Duhet t'i jetojnë të gjithë të krishterët, gjithandej dhe gjithmonë. Këto porosi i ka menduar Shpirti Shenjt në zemrën dhe në kraharorin e Virgjërës Mari. Nëse do t'i jetojmë porositë do të bëhemi të shenjtë dhe do të jemi pjesë e Triumfit të sajë. Kur do të filloi ai Triumf? Sot, pikërisht tani, derisa na lind dhe derisa na ushqen me qumështin e vet – neve, Trupin Mistik të Krishtit.¹⁴⁴

Mos pritni! Ashtu si ka thënë Maria: „*Të dashur fëmijë, le të jetë sot dita kur do të filloni të doni!*“

¹⁴⁴ Ky kapitull e ka frymëzuar predikimin e atë Tim Deeter në Irvine, në Kaliforni (SHBA).

“Ju thërras që ti ftoni të gjithë në lutjen e rruzares. Me rruzare do të ngadhënjoni mbi të gjitha fatkeqësitë që djalli tani dëshiron t’ia shkaktoi Kishës katolike! Të gjithë meshtarët lutni rruzaren! Kushtoni kohë rruzares.” (25. qershor 1985.)

62

BETEJA QË UDHËHEQIN MESHTARËT

Viti 1984.

Motra e nderit Briega McKenna e ka zbuluar Megjugorjen për herë të parë në vitin 1984.¹⁴⁵ Posa kishte arritur, e kishte njohur kishën e famshme të cilën Zotëria ia kishte treguar në qershorin e vitit 1981., vetëm një muaj para se Zoja të dëftohej në Megjugorje. Briega e dinte se këmbët e sajë po ecnin në truall të shenjtë, në tokën e zjarrit, tokën shenjte. Entuziazmi e sajë ishte i madh. Ndjehej pjesë e planit të Zojës për Megjugorjen.

U ul në mesin e njerëzve, në kishën e Shën Jakobit, të mbushur përplot, me miken e sajë Claire – në mesin e miqve që kishin ardhur nga të gjitha anët e Jugosllavisë së atëherëshme. Këndonin me gjithë forcën që ta nderojnë Zojën e tyre. Atë Tomislav Pervan, famullitar në atë kohë, mbajti një predikim të gjatë në gjuhën kroate. Claire nuk kuptoi asgjë, por vërejti se Briega qante. Kishte dëshirë të dinte „Përse lotët?“, por ishte tepër e preokupuar me përvojën e gjithëmbarshme që ta pyeste aty për aty. Në të vërtetë Jezusi i fliste zemrës së motrës Briega dhe ia përkthente gjithë predikimin. Atëherë ia tregoi skenën e cila do ti mbetej e skalitur në kujtesë deri në fund të jetës.

„Edhe tani e kam të gjallë“, tha. „E pashë një re të madhe e të zezë që po zbriste si mjegull, re e dendur dhe e zezë, dhe gjithë meshtarët rrinin para meje në kohën kur mjegulla futej në qytete dhe fshatra. Isha e dëshpëruar dhe iu thosha: 'Meshtarë, ndaloni këtë, ju lutem, ju jeni të autorizuar.' E dija se ajo ishte një e keqe që përfshinte jetën e njerëzve. U lutesha atyre meshtarëve që ta njohin pushtetin e vet kundër forcave të së keqes, pushtetin që ua ka dhënë Zoti.“

Tek skena tjetër Briega kishte parë se shumë nga ata meshtarë kishin lejuar që t’i përfshijë ajo re terri e cila i kishte verbuar. Zotëria Jezus pastaj i tha motrës Briega:

„Duhet të ju thuash meshtarëve se e vetmja mënyrë me të cilën mund t’i mundin fuqitë e së keqes është shenjtëria e jetës së tyre, kushtimi i tyre dhe gatishmëria e tyre që të jenë të zhytur në dritën e Krishtit.“

¹⁴⁵ Lexoni fusnotat në kapitullin 7., mbi motrën e nderit Briega McKenna

Atë ditë Zotëria i zbuloi motrës Briega shumë gjëra që edhe sot e mbajnë për të kryer shërbimin e sajë krejt të veçantë për meshtarët, ipeshkvijtë dhe kardinajt.¹⁴⁶

Në fund të kësaj meshe plot ngjarje, shkoi në sakristi për ta takuar atë Tomisllavin i cili flet anglisht për mrekulli. Kuptoi se pikat kyçe të predikimit të tij në kroatisht kishin qenë:

- fuqia e meshtarisë
- nevoja që besimtarët të lutën për meshtarë
- nevoja e njohjes së faktit se jetojmë në kohën e luftës shpirtërore, kur janë në pyetje shpirtat e popullit të Zotit dhe se kleri është ushtria që Zoti i ka dhënë fuqinë e vet.

¹⁴⁶ Prej motrës Briega kërkohet shpesh që të dëshmoi dhe të lutet personalisht me meshtarë, ipeshkvij dhe kardinaj. Shpesh herë merr pjesë, në Romë, në seminarët për shërim, lirim dhe tema të ngjashme ku, me shqyrtimet e sajë, jep kontributin e vet të vyer.

„Të dashur fëmijë! Dëshiroj të ju thërras në përjetimin e meshës shenjte. Shumë prej jush e kanë ndjerë bukurinë e meshës shenjte, por ka edhe të tillë që vijnë pa dëshirë. Unë ju kam zgjedhë, të dashur fëmijë, kurse Jezusi ju jep hiret e veta në meshë. Prandaj përjetoni me vetëdije meshën shenjte dhe le të jetë ardhja juaj me gëzim. Ejani me dashuri dhe pranoni meshën shenjte. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime! “ (3. prill 1986.)

63

MESHA E SIGURUAR ME VËSHTIRËSI

Francis është një prej njerëzve të cilët kanë jetë aventuriere. Është i ngjashëm me ata miqtë të cilët nuk do të donit ti lëshoni kurrë të largohen sepse tregimet e tyre janë kënaqësi e vërtetë. Në mes të dy detyrave zyrtare, ishte truproje e politikanëve të rëndësishëm. Nuk mund të pushoi së foluri për rastet në të cilat kishte shfrytëzuar pozitën e vet për të bekuar “personin e rëndësishëm” i cili kalonte nëpër periudhë të vështirë. Ai provonte ti udhëhiqte dhe t’u propozonte zgjedhje. Kur kishte mundësi, i pëshpëriste ndonjë fjalë keqbërësit ose e qiste medaljen çudibërëse në xhepin e kriminelit.

Ky nxënës i Krishtit është i patrembur, dhe Zotit i duhen njerëz si ai që të mund të depërtoi deri tek disa fëmijë të tij të cilëve nuk u bie ndërmend të shkojnë në kishë. Tregimi mbi atë se si ai është lidhur për Megjugorjen, në të nëntëdhjetat, meriton një kapitull të veçantë. Mirëpo, këtu do të doja të tregoj ngjarjen nga jeta e tij në Liban, që në të vërtetë ishte fryt i hireve të fituara në Megjugorje. Ajo po ashtu ilustron fjalët nxitëse të Jezusit: „Gjithçka është e mundshme për atë që beson!“ (Mk 9,23). Ja tregimi i tij:

„Si oficer isha i ngarkuar për sigurinë. Më duhej të mbroja ambasadën amerikane në Bejrut, si dhe vetë ambasadorin. Kur arrita më njoftuan se nuk guxoj të largohem nga ambasada, madje as për shkak të meshës. E vetmja mundësi hyrjeje dhe daljeje nga kompleksi ishte me helikopter. Dera e hyrjes ishte e bllokuar, dhe kjo duhej të zgjaste një vit! Kjo ma prishi qefin shumë, edhe pse shkaqet ishin të arsyeshme. Pak kohë më parë, në kishë, ishte hedhur bomba dhe kishin vdekur shumë njerëz. “

„Mirëpo, si shtegtar besnik i Megjugorjes, kisha fituar shprehinë që çdo ditë të shkoj në kishë dhe ajo ishte për mua gjëja më e rëndësishme në jetë. Vetëm mendimi se më duhet të heq dorë prej meshës ishte i tmerrshëm. Kështu, e thirra Marinë, Nënë time dhe i thashë: 'Mari, më ndihmo. Si do ta duroj këtë lloj privimi? Më duhet mesha!' ¹⁴⁷ Dhe çfarë pashë kur shikova nëpër gardhin me tela gjemborë? Truporen e bardhë, të mrekullueshme të Nënës së Zotit! Kur e pashë këtë, m'u kthye shpresa.“

„Ndodhi që njëri prej kapitenëve ishte meshtar i cili kishte dëgjuar për nevojën time për meshë. Prandaj më thirri dhe biseduam. Qysh atëherë vinte në apartamentin tim që të kremtonte meshën vetëm për mua. Kur përgatisja ujin dhe verën, shikoja nëpër dritare dhe shihja truporen e Zojës. Edhe më tepër e falënderoja për shkak të këtij meshtari sepse ky nuk ishte cilido meshtar. Nëna e Zotit kujdesej që të kuptoj se pikërisht ajo e bënte këtë për mua. Ky meshtar, në të vërtetë, ishte rritur në Nazaret, kurse në Liban kishte ardhur para dy muajsh. E kisha të qartë se vetë Maria, nga fshati i sajë, ma kishte dërguar këtë meshtar! Po, kjo dhuratë sigurisht ishte prej saj.“

„Shumë shpejt pas kësaj, erdhi edhe një meshtar dhe iu bashkua të parit në kremtimin e meshës në apartamentin tim, dhe pak nga pak, edhe besimtarët tjerë filluan të vijnë dhe të na bashkohen. Kah fundi i ndërrimit tim, e luta meshtarin për meshën në nder të Shën. Franës të Asizit (4. Tetor), pastaj meshën për Gjithë shenjtërit dhe meshën për Purgatorët. Meshtari u përgjigj: 'Do ta sjell mbarë kishën!' Me të vërtetë, në kompleks e solli gjithë famullinë. Njerëzve u është dashur të kalojnë nëpër të gjitha kontrollet e sigurisë, dhe ishin pothuaj dyqind vetë, duke përfshirë ipeshkvin, të gjithë françeskanët, kapucinët, seminaristët - dhe shumë të rinj. Shkurt, të gjithë ishin atje. Ishin madje edhe disa myslimanë dhe druzë. Në meshë, të gjithë së bashku qëndronim rreth altarit.“

„Pra, mund të them se Zoja do të na përgjigjet nëse vërtetë e lusim për meshë. Si do të mund të na linte pa Birin e saj? “

„Më vonë e mora vesh se dikush i kishte urdhëruar meshtarit që kurrsesi të mos më zhgënjeji dhe të kremtoi meshën edhe për mua.“ Këtu Francis filloi të qeshë dhe shtoi: „Kurrë nuk e kuptova se kush e kishte kërkuar këtë...“

¹⁴⁷ Meshtari shenjt i Arsit ka thënë: „Të gjitha veprat tona të mira nuk mund të krahasohen me flinë e meshës sepse ato janë vepra njerëzish, kurse mesha është vepër e Zotit. Martirizimi nuk është asgjë në krahasim me të. Njeriu i flijon Zotit flinë e jetës së Tij. Ndërsa mesha është fli ku Zoti i ofron njeriut Trupin dhe Gjakun e Vet...“ Dhe ka shtuar: „Pas kushtimit, Zoti është aty, ashtu si edhe në Qiell. Sikur njeriu ta kuptonte këtë mister do të vdiste. Zoti na kursen për shkak të dobësisë sonë.“

„Të dashur fëmijë! Do duhej që meshtarët t'i vizitojnë familjet, sidomos ato që, më nuk e praktikojnë fenë dhe që e kanë harruar Zotin. Do duhej që meshtarët t'u sjellin njerëzve ungjillin e Jezusit dhe t'i mësojnë si të luten. Kurse vetë meshtarët do duhej të agjërojnë dhe të luten më shumë. Të varfërve do duhej t'u japin atë që nuk u duhet.“ (30. maj 1984.)

64

FRA JOZO, NJERIU I BEFASIVE

Fra Jozo Zovko është njeri plot befasi. A thua këtë cilësi e ka fituar prej Zojës apo kjo është e natyrshme te ai? Në kohën e konflikteve më të rënda kroato-serbe, në pranverën e vitit 1992., shkova të takohem me të në kuvendin e tij në Shiroki Brijeg, 35 km larg Megjugorjes, që në atë kohë nuk ishte gjë e lehtë!

Ndërsa rrinim ulur në murin e vogël në kopsht, filloi të më flasë mbi guximin e disa ushtarëve kroat, për miqtë e tij, që në vende të ndryshme, pa dijen e askujt, kishin provuar të ndërmarrin aksione të shpëtimit. E mahnitur, i thashë se do duhej shkruar një libër që gjithë kjo bukuri të mos harrohej.

„Unë të shkruaj libër!? Unë jam analfabet, dhe as Zoja nuk ka nevojë për libër. Ajo na e ka dhënë librin!“ Dhe filloi të qeshet. „Eja“ – më tha - „do ta tregoj shtëpinë time të lindjes.“

Nëpër labirintin e rrugicave, që automobili i tij, si duket, i njihte mirë, më çoi në tokën e etërve të tij, disa kilometra larg. Ma tregoi shtëpinë e lindjes dhe më pyeti: „Po ti, ku ke lindë?“ Pyetja e tij në çast e shkëputi dhe fshiu shikimin tim të qetë në vreshta. Kujtimet më çuan në rrugët e Parisit, shumë të pastra, të ndërtuara bukur, me arkitekturë harmonike. Shikoja shumë njerëz se si vrapojnë në të gjitha drejtimet, tepër shpejt, si të ishin të drejtuar kah fatamorgana personale e materializmit në mes të shkretëtirës. Të gjithë dukeshin në ankth, sepse përkundër vrapimit dhe kërkimit, mund të kapnin vetëm disa kokrra rëre, dhe dukeshin krejt të shkëputur nga krijimi. Iu përgjigja: „U linda në një qytet të madh...“

Fra Jozo më ndërpreu në të njëjtin çast dhe më pyeti: „Domethënë, kurrë në fëmijërinë tënde nuk ke punuar në vresht? Atëherë nuk mund të kuptosh asgjë nga Eukaristia! Ti nuk mund ta kuptosh Ungjillin!“

Qetë vazhduam shëtitjen, thua se fakti se dikush nuk e kupton Ungjillin nuk e pengonte.

Në kthim më foli për gjashtë fëmijët që Zoja i kishte zgjedhë në Megjugorje. „Në vendin e sajë unë nuk do t’i zgjidhja pikërisht ata.“

Më foli se si ai vetë kishte filluar të besoi në dëftime, se si ata fëmijë ishin bërë të dashur për të, sidomos me heroizmin e qetë që kanë treguar në kundërshtitë e asaj kohe.

Isha e pasuruar me besimin që më tregoi. Kur u ndamë, thellë në mua mbetën të shkruara fjalët: „Ti nuk mund të kuptosh asgjë nga Eukaristia!“

Kishte të drejtë, plotësisht! Nëse ndonjë ditë do të kuptoja vetëm një përqind të misterit eukaristik, do të isha gruaja më e lumtur në botë. Por Zoja nuk dekurajohet, për më tepër ajo edhe më shumë na mëson që ta jetojmë atë mister, dhe të mos e kuptojmë. Kush mund ta kuptoi?

Zoja shpesh përdor fjalët kroate, kuptimi i të cilave është i shumëfishtë. Ata që i përkthejnë porosinë e sajë ballafaqohen me vështirësi të mëdha kur iu duhet të zgjedhin një fjalë, sepse gjuha kroate ofron disa kuptime të mundshme. Të përkthesh, nganjëherë, do të thotë të tradhtosh kuptimin e vërtetë. Përkthyesve u duhet të gjykojnë dhe të zgjedhin ndonjë kuptim më të varfër. Për shembull, në porosinë: „Të dashur fëmijë, ju thërras të jetoni Meshën Shenjte..“ – Përkthyesit kanë depërtuar në kuptimin e gjuhës kroate që ka zgjedhur Virgjëra dhe kanë kuptuar se është e papërkthyeshme. Në të vërtetë, fjala në vete përmban disa nivele të ndryshme të kuptimit me të cilat Nëna jonë na thërret që vetë të bëhemi Meshë, që të hyjmë në Mundim, të jetojmë Mundimin dhe kjo është aq shumëkuptimëshe sa që, çdo përkthim njëkuptimësh i kësaj porosie mund të jetë tradhti e madhe.

Kush do të mund të kuptonte, ndonjëherë, shkëlqimin e Eukaristisë dhe flisë së meshës!? Kush do të mund të kuptonte se çfarë përjeton Nëna e Eukaristisë kur ne marrim Trupin e Birit të saj në Kungimin Shenjt. Trupin i cili gjithashtu nënkupton zemrën e saj, shpirtin e saj dhe hyjninë e saj? Kush do ta kuptonte madhësinë e meshtarisë dhe, pse Jezusi në meshtari thërret këtë apo atë? Sa e madhe është befasia jonë para zgjedhjeve dhe thirrjeve të Zotit! Meshtari i cili kremton Misterin shenjt është Krishti i dytë. Sjellja më e mirë e zemrës para thirrjes së tillë është thjeshtësia e besueshme e fëmijës. Maria na jep shembull të bukur në këtë. E thirrur për t’u bërë Nëna e Zotit ajo nuk pyeti: „Pse pikërisht unë?“ Në vend të pyetjes „si“ me qëllimin që sa më e përgatitur të marrë pjesë në planin e Zotit, ajo tha në mënyrë të thjeshtë: „Më ndodhtë siç the ti.“

Jeta në Megjugorje ia mundëson njeriut t’i vërejë të gjitha mënyrat – të ndryshme dhe origjinale, me të cilat Zoti i thërret meshtarët të kryejnë shërbimin e Tij.

Morris dëshiron të dijë se çfarë të bëjë me jetën e vet

Më kujtohet se një ditë atë Tim Deeter (me të cilin isha disa herë në misione) takoi Amerikanin e ri para kishës së Shën Jakobit. Ai njeri i ri, Morris, i bëri një mijë pyetje dhe dukej nga pak i humbur... Erdhi si shtegtar me shpresën se do të fitoi shndritje hyjnore për jetën e tij. Në botë kishte pasur një jetë shumë të suksesshme, fitonte shumë para dhe mund të shpresonte për një karrierë brilante. Por ai kërkonte kuptimin e jetës së vet. Atë Tim filloi të bisedoi me të dhe ia bëri me dije se po atë pasdite duhet të shkoi te fra Jozo. Djaloshi e shfrytëzoi rastin menjëherë.

„Super!“ - tha. „Ju lutem, pyeteni se çfarë do të duhej të bëj unë me jetën time!“

Atë Tim mori taksinë e parë dhe menjëherë u nis drejt Tihalina, famullisë së vogël në të cilën fra Jozo ishte meshtar në atë kohë. Në befasinë e tij të madhe, fra Jozo e priste para kishës (zakonisht vizitorët ishin ata që e prisnin, gjatë, atë). Posa (atë Tim) doli nga taksia, fra Jozo iu drejtua dhe pa kurrfarë hyrjeje i tha: „Domethënë, Morris dëshiron të dijë se çfarë të bëjë me jetën e vet. Thuaj se Zoti e thërret të bëhet meshtar. Por duhet që menjëherë të hyjë në seminar, sepse Zoti mund ta marrë thirrjen shpejt ashtu si mund ta japë. Le të mos e lëshoi këtë hir!“

Më 7. dhjetor 1996. Morris Harrigan u shugurua meshtar në ipeshkëvinë Los Angeles.

Dëshiroja të bëhem mekanik...

Në një rast tjetër, udhëtoja me aeroplan me atë Svetozar Kraljeviq, françeskan nga Megjugorja. Shkonim në Pittsburg (Pennsylvania) në konferencat Mariane mbi Megjugorjen. Orët e gjata që i kaluam së bashku na mundësuan që të bisedojmë hapur, që ishte shumë më e vështirë në Megjugorje, ku jemi të zënë nga mënçjesi në mbrëmje.

E pyeta: „Atë, nuk dua të jem shumë kureshtar, megjithatë, më tregoni si u ka thirrur Zotëria në meshtari? Si e keni ndier ju thirrjen?“

„Zotëria kurrë nuk më ka thirrur në meshtari!“

U shtanga dhe ia ngula sytë. Ai është njëri prej meshtarëve më të mirë që njoh. Shpërndan paqe dhe butësi kah do që shkon. Besoj se jeton një jetë të thellë mistike. Por, meqë e njoh fra Svetën dhe shikimin e tij të veçantë të jetës, njerëzve dhe situatave, fillova të qesh. Pastaj provova të kuptoj diçka më tepër:

„Megjithatë u bëtë meshtar. Atëherë, si ndodhi kjo?“

Dhe fra Sveto më shpjegoi se si djalosh kishte një plan krejt të ndryshëm për jetën e vet. E mahnitnin pajisjet dhe makinat. Dëshironte të bëhej mekanik i thjeshtë, të martohej dhe të themelonte familje të krishterë... Por, në çastin e fundit, para se të nisej për shkollimin i cili do a orientonte në zgjedhjen përfundimtare, ai pyeti veten: „Po ashtu do të mund të zgjedhja dhe të bëhem meshtar?“

„Atëherë mendova“, dhe më fliste me aq shumë thjeshtësi si të ishte diçka krejt e natyrshme. „Kemi vetëm një jetë në tokë, pse të mos jetohet për Zotin?“ E ndërrova kahen dhe menjëherë hyra në seminarin françeskan. Deri sot, pas tridhjetë vitesh meshtarie, ende nuk e kam pranuar thirrjen për meshtar!¹⁴⁸!

¹⁴⁸ Këtu duhet cekur se Svetozari, si i ri u dallua me ndjenjën e thellë për përgjegjësi. Bartte në vete nderimin e lartë për meshtarinë dhe për vlerat e krishtera, ashtu si pjesa më e madhe e kroatëve katolikë, përkundër shumë të rinjve nga Perëndimi. E dinte se meshtari duhet të jetë i gatshëm për derdhjen e gjakut të vet dhe nuk u përcaktua lehtë për këtë. Në këtë fushë, të përgatitur mirë nga ana e hirit, mendimi mbi meshtarinë ka vluar në të si frymëzimi i Shpirtit Shenjt. Duket se Zoti nuk kishte nevojë ti jepte porosi të ndryshme nga ajo e cila e bëri të kuptoi se është i thirrur në meshtari.

„Të dashur fëmijë! Sot ju thërras që të kuptoni se pa dashuri nuk mund ta dini se Zoti duhet të jetë në vend të parë në jetën tuaj. Prandaj, fëmijë, ju thërras të gjithëve që të doni jo me dashuri njerëzore por Hyjnore. Ashtu jeta juaj do të jetë më e bukur dhe pa interesa. Do të kuptoni se Zoti ju jepet, në mënyrën më të thjeshtë, nga dashuria. Fëmijë, që të kuptoni fjalët e mia, që ua jap nga dashuria, lutuni, lutuni, lutuni dhe do të mund t’i pranoni të tjerët nga dashuria dhe t’i falni të gjithë që ju kanë shkaktuar dëm. Kthejuani me lutje, e lutja është fryt i dashurisë ndaj Zotit Krijues. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime.“ (25. shtator 1997.)

65

DASHURIA E JULISË NUK NJEH KUFIJ

Afër Marseille gjendet kështjella e vogël Saint-André në mes të kodrinave me erë të këndshme fshehtësinë e të cilave e ruan krahina e Provansës. Familja Porta jeton atje në ritmin e qetë të natyrës. Julija e vogël, katërmëdhjetë vjeçare, dëshiron të luaj 'shkollash' në sheshin kryesor. Askujt nuk i shpëton pa e parë bukurinë e saj. Flokët e sajë të gjatë vallëzojnë dhe valojnë në ritëm me kërcimet e vogla, të shpejta dhe të gjalla që i bën mbi katrorët e vizatuar, kujdesshëm me shkumës.

Gastoni shtatëmbëdhjetë vjeçar, nuk e largon shikimin prej saj. „Sa e bukur është! Sa e këndshme është!“ Dëshiron të miqësohet me të. Provon t’i afrohet, i ofron bonbone. I përpiloi edhe rreshtat e parë të asaj që quhet tregim i mrekullueshëm dashurie. Së shpejti do t’i premtohen njëri tjetrit.

Në Francë para luftës së parë botërore adoleshentët kanë mundur ngadalë t’i harmonizojnë zemrat e veta, në ritmin e ngadaltë dhe të thellë të natyrës njerëzore. Në atë kohë në mesin e tyre nuk ekzistonte ankthi se do të jesh “i marrur dhe i braktisur”, madje edhe para se të njihet personaliteti i tjetrit. Julija e kishte e kishte entuziazmuar zemrën e Gastonit, por me 14 dhe 17 vjet ishin tepër të rinj. Duhej të bëhen më të pjekur dhe atë ndjenjë t’ia paraqesin tundimit të kohës. Me kërkesën e prindërve të saj, Julija do të presë moshën madhore – atëherë 21 vjet – para se ta thotë “po-në” e sajë para prefektit dhe Zotit, atë “po” që do ta bënte bashkëshorten e Gastonit.

Zdrukthëtar i mrekullueshëm, me duar të shkathëta, Gaston di të punojë gjëra të ndryshme. Ai me gëzim udhëheq anijen familjare. Në mbrëmje ka dëshirë të luaj në harmonikë dhe të gëzojë familjarët dhe miqtë e tubuar, në oborrin, para shtëpisë. U lindën dy fëmijë në rrezatimin e thjeshtë dhe të shëndoshë të asaj vatre në të cilën mbretëron dashuria. Bashkëshortët e rinj e marrin jetën ashtu si u vjen. Kush mund ta merrte me mend, atëherë, se në një skaj të qiellit të tyre të kaltër duket një re e zezë e pamëshirshme?

Shpërtheu lufta e Parë botërore. Ushtria mobilizon të rinjtë nga rrethina që me mijëra marshojnë tatëpjetë luginës së lumit Rhône që në kufirin francezo-gjerman të ballafaqohen me armikun. Gaston është në mesin e të thirrurve. Ai përgjigjet: si ta lë gruan dhe dy fëmijët, familje e thurur me aq ndjenja fisnike?!

Por, lufta nuk fal. Erdhën një ditë ta arrestojnë, e prangosën. U akuzua si dezertor! Fëmijët bërtasin. Julija – që do t'u kundërvihet – merr një goditje aq të fortë me këmbë sa u fërfëllua dhe u përplas për muri, e gjitha në lot. Atëherë, pa fjalë, të gjithë u zhdukën! Lumturia e Julisë u ndërpre në çast. Ajo kurrë më nuk do të jetë e njëjtë.

Në zemrën e kësaj familje të gëzuar u krijua një zbrazësi, mungesa që dhemb. Julia u ngrit, dy qenie të vogla ishin të mbërthyera për tokë. I merren mendtë, por ç'është më keq zemra e saj vuan. A është kjo një ëndërr e keqe, pyetet ajo, a do të zgjohem me puthjen e Gastonit dhe të fillojmë përsëri jetën tonë të përbashkët? Si të mos kishte ndodhur asgjë, ora në sallon shënon kohën që u bë agoni. Gastoni nuk kthehet. Nuk ka ndihmë sociale, Julija duhet të punësohet. Gjen vend tek disa qytetarë të pasur që i japin punë poshtëruese. Ajo familje e maltreton, urren, provon ta shfrytëzojë kurse asaj i duhet të durojë dhunën që të mbijetojë: nuk ka tjetër zgjidhje!

Gastoni nuk thërret, nuk shkruan, nuk dihet as ku është. Ndoshta në betejat e tmerrshme në Lorenë? Julija u shndërrua në roje, ajo i orienton të gjitha shqisat jashtë, dëshiron të kap edhe informatën më të vogël nga fronti... Llogoret?

Fatkeqësisht, gjendja është më se e keqe: me qindra njerëz vdesin! Situata është e bllokuar, furnizimi me ushqim i vështirësuar, dhe shumë ushtarë tanë janë të detyruar të qëndrojnë në ato gropa të neveritshme. E dimri është i vështirë!

Çdo lajm i keq e shpon si thikë zemrën e Julisë, por përkundër kësaj drame, bashkësia me Gastonin është më reale se kurrë më parë. Në pamundësi që t'i ndihmoi materialisht, në pamundësi që madje me klithmë t'ia tregoi dashurinë e saj, për ta trimëruar, ajo, në thjeshtësinë e saj do ta mendojë mënyrën që t'i bashkohet përtej fjalëve, përtej kufizimeve tokësore. Oh sa është dashuria imagjinative! Nuk njeh kufij!

Një natë dimri, kur veriu rrihte xhamat e shtëpisë së drunjtë dhe dridhte derën e hyrjes, Julija vendosi të shtrihet në dysheën e ftoftë e të fortë prej guri, të dhomës së saj të fjetjes. Po, ajo në të ardhmen, deri në kthimin e Gastonit, do të flejë aty pranë shtratit të saj të butë! A thua ai nuk mërdhin në llogore, nën borë? Edhe ajo do të mërdhijë me të, për të! A thua se ai nuk dridhet nga të ftohtit tërë natën? A nuk i mungojnë shumë gjëra? Nuk është i uritur? Vendosi që t'i mohoi të gjitha me të, për të. Një trup, një zemër!

Por kjo nuk u shpëton dy të vegjëleve. „Nënë....çfarë bën?“ – e pyesin, të brengosur nga ajo sjellje e çuditshme.

Julija nuk është prej atyre që flasin shumë. Me pak fjalë, me përvujtëri, i qetëson fëmijët. Fëmijët nuk janë shumë të vegjël që të mos kuptojnë – fëmijët janë enigmatikë, dhe këtë as nuk e dinë – ata e kuptojnë menjëherë barrën e dashurisë e të flijimit, dhe në mënyrë spontane vendosin të bëjnë si nëna e tyre.

„Ta bëjmë këtë për babin“ – ia shpjegojnë njëri tjetrit, para se të shtrihen në dyshtemenë e fortë. Pllakat e gurit me të cilat janë të shtruara dhomat e tyre të fjetjes u bënë altar në të cilin çdo natë kremtohet një meshë e re dashurie, altar në të cilin paraqitet flija dhuruese. Por, nuk ishin të vetëdijshëm për flinë, sepse ishte akt dashurie, e ku ka dashuri, nuk ka fli.

Me 11. nëntor 1918. U nënshkrua paqja dhe lufta përfundoi! Ata pak ushtarë që kishin mbetur nga Provansa u kthyen në shtëpi. Por kjo ishte paqe gjaku. Nga gjithë vatrat e pikëlluara në Saint-Andréu, dëgjohet gjëma dhe vaji. Baba, djali, vëllai... nuk u kthyen! Lajmëtari i shpall „Të zhdukur“.

Në një rën nga mbrëmjet e atij nëntori, Julia hap dollapin e madh në dhomën e saj, duke u ngulfatur nga dënesët. Duart i dridhen nga shqetësimi. Dëshiron të gjejë ciloren e madhe prej liri për tavolinë dhe mbulesën e bukur të shtratit që gjyshja e saj e kishte qëndisur për martesën e tyre. Do t’i hekurosë me kujdes, sepse ajo mbrëmje nuk do të jetë si të tjerat. Gastoni u kthye! Një nga të rrallët që mbijetoi nga njëësia e tij. Gastoni iu kthye shtëpisë së vet, ai është këtu, luan me fëmijët në oborr.

Mesha e gjatë e Julisë i solli frytet, flija e sajë e përvujtë ditore ishte pranuar në Qiell. Zoti e mbrojti dashurinë e tyre. Gastoni u kthye!

“Të dashur fëmijë! Ju nuk e kremtoni eukaristinë si duhet. Vetëm sikur ta dinit se sa hire dhe çfarë dhuratash pranoni, do të shkonit në meshë çdo ditë dhe do të përgatiteshit për të së paku një orë para se të fillonte.” (1985.)

66

KLITHJA NGA CIBORIUMI!

Tepër shpesh harrojmë se Jezusi në Eukaristi është më njerëzor se cilido nga ne. Ai ndjen çdo gjë me sensibilitetin nga i cili ne do të iknim. Ai është vetëm zemër, gjithmonë pret dashuri dhe është më i lëndueshëm se sa i porsalinduri. Kur marrim kungimin, e dimë se çfarë ndjejmë. Por çfarë dimë për atë që Jezusi ndjen në zemrat tona?

Një mbrëmje kur e zgjata pak kohën e adhurimit në kapelën e Bashkësisë sime, iu afrova tabernakullin që ta mbyll dhe t’i fik qirinjtë rreth tij. Në Francë anëtarët e kushtuar të Bashkësisë së lumturive mund ta ekspozojnë Sakramentin Tejetshenjt por pa e prekur atë. Duhet që vetëm ta hapin derën e tabernakullit ku është i ekspozuar ostensori i vogël. Drita e orientuar e ndriçon hosten ndërsa dritat tjera janë të fikura. Kjo na mundëson që ta përqendrojmë vëmendjen në Trupin e Jezusit.

Kur isha vetëm në kapelë, i dhashë vetes kohë që t’i kryej këto detyra të vogla të sakristisë rreth Jezusit, duke biseduar me të. Në fund të fundit, a nuk jam unë e fejuara e tij? Isha, pra, pranë tij, me çelës në dorë, e gatshme që Ta mbyll Atë deri mëngjesin e ardhshëm. Mirëpo zemra ime e ndjeu brejtjen e ndërgjegjes: Sa shumë të krishterë munden vetëm të imagjinojnë adhurimin, së paku për një orë, madje edhe në mesnatë, kurse ja, unë e mbylla derën! Në atë çast një detaj i vogël tërhoqi vëmendjen time: një pikë dylli prej qiriut kishte ra në kornizën e drunjtë të derës. Kështu fillova të largoj çdo gjurmë dylli kur më trembi diçka si klithje. Nuk vinte nga ostensori, por nga ciboriumi ku kishte shumë hostie, dhe ishte pas tabernakullit. Klithjen nuk e dëgjova me veshët e mi trupor, por ajo jehonte më fort në zemrën time – zemrat tona kanë antenat më të forta.

Jezusi donte të më thotë diçka. Vërtetë jetonte në secilën nga hostet, edhe pse nuk ishin 337 Krishta në këtë ciborium. Jezusi ishte një por i shumëuar¹⁴⁹

¹⁴⁹ Në Lanciano, qytetin e vogël italian në Abruzzi, një rregulltar bazilian dyshonte në praninë e vërtetë të Krishtit në eukaristi. Lutej me zjarr që të ndriçohet në lidhje me këtë. Në vitin 1750., gjatë meshës, pasi që i kishte thënë fjalët e kushtimit, u befasua kur pa se hostja u shndërrua në mish, kurse vera në gjak. Gjaku u paraqit në formën e pesë pikave të koaguluara me madhësi të ndryshme. U frikua nga kjo mrekulli dhe ftoi besimtarët që të jenë dëshmitarë të ngjarjes. Pastaj ftoi ipeshkvin.

Ishte sikur secila hostie më shpjegon çastin kyç që përgatitet ta përjetoi në ditët e ardhshme. Më dukej se secila hostie e dinte se për cilit shpirt, cilin person është e dedikuar. Për secilën hostie ishte e dedikuar aventura e papërsëritshme e dashurisë, kurse paleta e mundësive ishte e mahnitshme! Disa hostie do të duhej të hynin në zemra që për to ishin Qielli, kurse për disa të tjera, ishte zbritja në ferr. Klithja që jehonte në zemrën time ishte në të vërtetë klithja e ankthit.

Shumë hostie janë në agoni. E dinë se do të jenë të pranuar në banesa të padenja ku mbretërojnë mëkatet që çojnë në vdekje. Qëndroja aty e shokuar dhe e gozhuar në dysheme. Disa nga këto hostie ishin të tmerruara derisa prisnin që të hahen.¹⁵⁰ Jezusi thërriste në ndihmë! Ishte kjo klithje e qetë, i ngjashëm më klithjen e embrionit – fëmijë i cili e ndjen vdekjen që po afrohet e që në mënyrë instiktive fshihet në kraharorin e nënës para ardhjes së instrumentit i cili do ta nxjerr me dhunë. Ishte klithja e qetë e të pafajshmit, i cili nuk mund të mbrohet në trupin e tij të vockël, nëse ajo e cila e bart, nuk e do. Ishte kjo klithja e qetë e Zotit i cili atë trup të vogël e të palëvizshëm, më të lehtë se kokrra e drithit, deshi ta besoi në duart e njerëzve, me të gjitha rreziqet e mundshme.

Rregulltarët i kanë ruajtur reliket e këtij Trupi dhe këtij Gjaku deri më sot. Për ta penguar zvogëlimin e kësaj cope mishi për shkak të tharjes, e mbërthyen në dru, por megjithatë u zvogëlua dhe për shkak të kësaj u krijua zbrazësia në mes copës së mishit.

Janë bërë shumë analiza shkencore në këta ekzemplarë, prej të cilave më e rëndësishmja ka zgjatur dhjetë vite, në mes të viteve 1971. dhe 1981., nën udhëheqjen e profesor Linolit (Universiteti Arezzo) dhe Bartelli (Universiteti Sienna). Rezultatet tregojnë se në ekzemplarë nuk ka materie konservuese. Dihet se mishi dhe gjaku i njeriut, bëhet pluhur pas disa vitesh. Këta ekzemplarë kanë mbetur të tërë. Mishi është copë e barkushes së majtë të zemrës njerëzore, që në çastin e mrekullisë ishte e gjallë. Gjaku është i grupit AB. Në të mund të gjendet serum i gjakut të freskët. Profili i gjakut nga Lanciano ishte normal, të gjithë elementët e proteinës ishin të pranishëm dhe ishin në sasi të njëjta sikurse gjenden tek ekzemplarët e shëndoshë.

Fakti që më së shumti na intereson është se, përkundër madhësive të ndryshme të tyre, secila prej piksjeve të gjakut peshon 15,85 g, dhe të gjitha së bashku peshojnë, gjithashtu, 15,85 g! Ky fenomen na përkujton se Krishti është njësoj i pranishëm në secilën hostie, dhe Ai, i pandarë, na dhurohet në çdo kungim shenjt.

Edhe një fakt interesant: analiza e pëlhurës së Torinos tregon se grupi i gjakut të njeriut të kryqëzuar ishte AB. I të njëjtit grup ishin edhe lotët e gjakut me të cilat qau truporja e Zojës së Megjugorjes e çuar në Civitavecchi, para dyerve të Romës më 1997.. Për informata shtesë mbi Lancianon, shih Ave Maria Center of Peace, C.P. 489. Station U. Toronto, On. M8Z 5Y8. Canada. Artikulli, *Trupi i vërtetë dhe Gjaku i vërtetë* i publikuar në revistën 30 Days (Nr. 2, më 1997.)

¹⁵⁰ Motra Faustina në *Ditarin* e sajë ka shkruar këtë ngjarje: "Kungimin Shenjt e mora lart sepse nuk mund të bëhej fjalë për të shkuar në kapelë. Isha shumë e dobët dhe e djersitur. Kur pushoi djersitja, më kapluan ethet dhe temperatura. Ndjehesha krejtësisht e dobësuar. Sot, njëri nga etërit na solli kungimin shenjt. Tri motrave ua solli Zotërinë pastaj mua duke menduar, me atë rast, se jam e fundit. Mua mi dha dy hostie, dhe kështu një rishtare, që ishte e shtrirë në qelinë tjetër mbeti e pa kunguar. Meshtari shkoi edhe një herë për t'ia sjellë Zotërinë, por Jezusi më tha: 'Pa dëshirë hyj në atë zemër. Për këtë shkak ti i more dy hostie, sepse doja ta shtyj ardhjen Time në atë shpirt që i kundërvihet mëshirës Sime. Atë shpirt nuk e vizitohet me dëshirë.' " (Ditari §1658)

Secila hostie po ashtu e di ditën dhe orën se kurë do të hyjë në zemrën e personit që do ta hajë. Jam e mahnitur me vetëdijen e Jezusit. Ai di çdo gjë, sheh çdo gjë, parasheh çdo gjë, dhe përsëri lejon të trajtohet si qengj. Fatmirësisht, shumica e hosteve gëzohet paraprakisht se do të mund të bashkohet me marrësin e sajë.¹⁵¹

Atë mbrëmje, kur e mbylla tabernakullin, u përpoqa që ta ruaj në vete porosinë që Jezusi ma dha – porosinë që ende nuk e kam marrë të tërën sepse vetëm në Qiell, kur të gjendem me Zotin faqe-faqas, do ta kuptoj klithjen e tij për ndihmë. Tani për tani, një gjë është e qartë: Jezusi më thërret që ta adhuroj në shpirt, jo vetëm në të gjithë tabernakujt e botës, por në zemrën e të gjithë atyre që kungohen, si të mirëve ashtu edhe të këqijve, ashtu që kur të ketë vuajtur përsëri derisa do ta vrasin, Jezusi do të ketë një vizitë të vogël dashurie, një pjesë të vogël vuajtjeje që do Ta ngushëlloi.¹⁵²

Hostet e vjedhura

Nëna Yvonne-Aimée është mistike e madhe franceze e cila ka vdekur në vitin 1951. Në moshën 49 vjeçare. Ajo kishte shumë karizma. Në mes tjerash, nganjëherë ndodhte se Krishti t'i tërheq vërejtjen se hostet ishin të dhunuara. Sot ka të tillë që konsiderojnë se Prania e Vërtetë nuk ekziston jashtë kremtimit të meshës shenjte. Ky është gabim i madh. Ja letra që Yvonne-Aimée i shkroi atë Crété më 31. mars 1923. në Paris.

„I dashur atë, po ju shkruaj derisa e kam Jezusin në vete. Natën e kaluar, i Dashuri im më tha që të shkoj ta kërkoj në shtëpinë e personit e cila që nga e shtuna e ruante hosten të cilën e kishte marrë në mënyrë të padenjë pranë Tryezës Shenjte. Posa u kthye në vendin e vet, ky shpirt i shkretë e nxori prej gojës dhe e vendosi në facoletë që ta çonte në shtëpi dhe ta dhunonte. Për këtë arsye e luta Jezusin që të ma dhuroi këtë shpirt dhe ju fola për këtë miqve të mi në rrugën Monsieur (Paris) që edhe ata të mund të luten për këtë shpirt të mjerë të humbur.“

„Atë natë, sipas udhëzimeve të Zotërisë Jezus, shkova në shtëpinë e kësaj Zonje shumë elegante. Ajo vetë erdhi dhe e hapi derën. I thash menjëherë se kisha ardhur për të marrë hosten. Kur më tha që ta ndiqja u zbeh në fytyrë. Më çojë në dhomën e saj të ditës dhe hapi kutinë e vogël që ishte në tavolinë. Brenda ishte hostja!“

¹⁵¹ Jezusi i tha motrës Faustine: „Shkruaj për të gjithë shpirtat rregulltar, se është gëzimi im të vij në kungimin Shenjt në zemrat e tyre.“ (Ditari §1683)

¹⁵² „Trinia Shenjte, Atë, Bir dhe Shpirt Shenjt, të përkulem thellë dhe ta kushtoj Tejet të çmueshmin Trup e Gjak, Shpirtin dhe Hyjninë të Zotërisë sonë Jezu Krishtit, që është i pranishëm në të gjithë tabernakujt e botës – si kompensim për fyerjet, blasfemitë dhe pakujdesinë me të cilën është fyer Ai dhe të lutem që me meritime të Zembrës Tejetshenjte të Jezusit dhe me ndërmjetësinë e Zembrës së Pamëkat të Marisë, ktheji mëkatarët e shkretë!“ (Lutja që engjëlli i Portugalisë ua mësoi fëmijëve vegues në Fatima.)

„E mora atëherë, dhe duke ndjekur frymëzimin e Zotërisë, i fola kësaj gruaje të mjerë e cila derdhte lotët e pendimit të sinqertë.“

„U ktheva në banesën time me Visarin tim të Dashur në zemër. Ishte ora një e tridhjetë e mëngjesit. I dashuri im më foli rrugës. ‘Më ruaj’, më tha, ‘derisa të të them të veprosh dhe deri sa ta zbuloj Vullnetin tim.’“ (Shpirtërori i tha Yvonnës që ta hajë hosten që e bartte me vete dhe që në raste të ngjashme gjithmonë të bënte ashtu!)

Yvonne vazhdoi letrën e saj: „Po atë mbrëmje, Jezusi më tha se pikërisht atë natë duhet ta marr nga një shtëpi tjetër ku gjithashtu kishte qenë i çnderuar. O, Jezus i mjerë, I Dashuri im, si nuk të duan disa!”

Në hulumtimet e saj të mëvonshme, Yvonne kthehej nganjëherë e lënduar, me hosten të cilën e kishte grabitur nga blasfemuesit që e kishin rrahur. Yvonne vuante tepër shumë për shkak të shpirtrave që dhunonin hostet dhe e luste Zotërinë për kthimin e tyre. Shpesh Jezusi, gjatë netëve që vinin pas gjetjes së hostes, e bashkonte atë me mundimin e vet që të ofronte satisfacion për blasfeminë e shkaktuar. Kur kanë ndodhur këto, Yvonne-Aimée ende nuk ishte motër nderi. Ajo ishte vetëm nja njëzet vjeçe. Më vonë hyri në kuvendin augustin në Malestroit, në Francë.¹⁵³

¹⁵³Vetëm në Qiell do të zbulojmë intervenimet që shenjtërit i kanë bërë në Tokë që të pajtojnë njeriun me Zotin si dhe ndikimin e shenjtërve në histori. Zoti dërgon miqtë e tij në shtëpinë e personit të caktuar, ashtu si strategu dërgon me mijëra njerëz nga më të mirët që ka për t’u takuar me armikun dhe për t’u marrë vesh për ndërrimin kahes së luftës. Në mesin e atyre të dërguarve të Zotit, nëna Yvonne-Aimée është prijëse, aq më tepër se ajo kishte dhuratën e bilokacionit që i mundësonte takimin me njerëzit më të pamundshëm në cilën do pjesë të botës. Në çdo çast ajo mund të fliste rrjedhshëm gjuhën e atyre tek të cilët e kishte dërguar Zoti, madje edhe të lexonte gazetat e tyre!

Disa vjet para vdekjes në vitin 2002., atë Labutte, i cili ishte edhe shpirtëror i Yvonne-Aimée, e vizitoi bashkësinë time në Iffendic në Bretanjë dhe tregoi shumë ngjarje nga jeta e sajë. Njëra prej tyre më la përshtypje sepse pjesërisht e zbulonte se si Ati ynë në Qiell fshehtazi i kishte shumëzuar përpjekjet e që fëmijët e Tij t’ia kthente Birit të Vet.

Kah fundi i luftës së dytë botërore, nëna Yvonne-Aimée ishte në Malestroit, në Francë. Që nga aty u bilokua dhe u gjend në Gjermani, në zyrën e Hitlerit. Ky njeri me pushtet, i befasuar që para vetes shihte rregulltaren që nuk e kishte thirrur, hapi sirtarin, nxori revolen dhe shtiu drejt saj. Si duket në rastet e bilokacionit, trupat nuk janë të lëndueshëm sepse nëna Yvonne-Aimée nuk ra për tokë. Hitleri shtiu edhe një herë, por motra qëndroi gjakftohtë përsëri. Hitleri ia nguli sytë, i ngurtësuar. Ajo ia përcolli porosinë që i kishte sjellë prej Zotit e cila përmbante kërkesë eksplicite (atë Labutte na e zbuloi). Hitler refuzoi, së paku atë ditë. Nëna Yvonne-Aimée atëherë iu afrua hartës së madhe të Evropës që mbulonte murin e dhomës. Me gishtin e saj tregoi qytetin dhe i tha Hitlerit: „Kur të vish këtu, do të mbarosh“ Dhe kjo ndodhi.

O, liri e llahtarshme e njeriut, para intervenimeve këmbëngulëse të Zotit!

“Të dashur fëmijë! Ju thërras që, nën këtë kryq, ta merrni kryqin tuaj si vullnet të Zotit. Ashtu si Biri im e mori kryqin e Vet, ashtu edhe ju duhet t’i bartni tuajt, kurse Biri im nëpërmes kryqeve tuaj do të jetë i lavdëruar. Ju faleminderit, të dashur fëmijë, se ju përgjigjët thirrjes sime dhe që bartni kryqin tuaj.” (E premtja e madhe, 29. mars 1991.)

67

FËMIJA QË GJAKDERDH

Andrew ndizte zjarrin. Emily, gruaja e tij, nuk e kishte idenë se çfarë do të ndodhte pastaj. Shikonte, e shokuar dhe pa zë, deri sa Andrew prej çantës së tij të madhe nxirrte dhjetëra kryqe që i kishte mbledhur në vende të ndryshme. Duke u zgërdhirë, ai dhe shoku i tij, filluan që t’i hedhin në zjarr, një nga një. Atëherë, e rrëbmeu të shoqen për flokësh dhe i tha:

“Shko, kape atë Krishtin tënd nëse guxon! Hajde! Nxjerre nga aty!”

Andrew kishte pasur lidhje me gra të ndryshme, duke lënë Emily në agoni. Ajo çdo herë kishte përjetuar një goditje të re për martesën e tyre. Plus kësaj, urrente Jezusin. Kurse Emily, e donte Jezusin pa masë. Në fund Andrew përjashtoi Emily dhe të bijën e tyre nga shtëpia dhe e mbylli derën. Një grua tjetër e zuri vendin e saj në shtratin e tyre.

Emily gjeti strehim në shtëpinë e lutjes ku punonte gjatë ditës, dhe qante gjatë natës. Fatmirësisht, një meshtar i dha udhëheqjen shpirtërore dhe i ndihmoi që ta duroi tundimin. Tepër e lodhur për të vazhduar ritmin e punës, ajo as nuk mund të flinte, ishte e detyruar që të strehohet në makinën e saj. Tre muaj priti atje, në lutje dhe vetmi, që të shihte se si Zotëria do t’i bashkoi grimcat e jetës së saj të thyer.

Afrohej çasti i shkuarjes në shtegtim, në Megjugorje. Në majin e vitit 1982. Atje e dërgoi shpirtërori i saj jezuit. Fra Slavko e afroi dhe me shumë kujdes i ndihmoi për të organizuar shtegtime nga Kanadaja. Në mes të shpirtrave të tyre u zhvillua një bashkësi e bukur.

Në majin e vitit 2002. Gjatë kohës së shtegtimimit, Emily përjetoi simptomat e para të rrjedhjes së gjakut, por pa kurrfarë dhembje. Kur u kthye në Kanada, iu drejtua tre mjekëve, por asnjëri nuk mundi të zgjedh problemin e saj. Disa fotografi rëntgeni treguan se ajo kishte katër veshka ose, më mirë të thuhet, dy veshka të dyfishta, që ishin si shpuza! Në muajt e ardhshëm kishte edhe më shumë gjak në urinën e saj. Emily u vajua. Mbeti e qetë, përkundër resës së zezë që, si duket, e kishte errësuar ardhmërinë e saj.

Në të vërtetë, derisa mjekët dështonin, Emily i lejoi Zotit që ta përshkoi qenien e saj me përvojë shumë të thellë eukaristike. Çdo kungim në meshë, për të, u bë fitore e re e dashurisë, e dashurisë e cila e tejkalonte dhe e shndërronte gjithë mjerimin e trupit të saj të vdeqshëm.

„Trupi im shkatërrohej“, tha ajo, „por eukaristia më jepte fuqi nga brenda! Mund ta ndjeja derdhjen e gjakut Hyjnor që hynte në mua dhe kjo ma mundësonte të vazhdoj. Asnjë kremtim eukaristik nuk ishte monoton. Ishte si ngrënie Hyjnore që e ndaja me Krishtin. Më duhej fuqia hyjnore që të mund të kaloj nëpër ato mundime. Mund ta ndjeja Zojën se si i vente duart rreth meje duke thënë: 'Me ty jam. Mos ki frikë për shëndetin tënd!' “

Me këtë forcë prej së larti, Emily ishte në gjendje të vazhdoi shërbesën e saj nëpër shtegtimet dhe grupet e lutjes së Zojës. Jepte një pjesë të madhe të vetes dhe të gjithë mahnitëshin me sasinë misterioze të energjisë që kishte për punët e përditshme!

Për Krishtlindje në vitin 2002., shoqja e saj Terri e thirri që të kaloi dy muaj në Megjugorje dhe ajo tha menjëherë: „Po!“ Por Emily gaboi. Pranoi barërat natyrore të një terapeuti pa kontrolluar përmbajtjen e tyre. Sa ishte në Megjugorje, çdo ditë e më shumë gjakderdhte. Emily gjendej në tjetër kontinent, larg nga shtëpia dhe pa ndihmë të mirëfilltë mjekësore. E kapi paniku. Një mbrëmje, ndërsa shikonte trupin e vet duke humbur gjak, lutej, përkundër ankthit që e mbante: „Zotëri, Nëse kjo është ajo që Ti do, le të bëhet ashtu. Mari, shpresoj në ty! Ti je siguria ime, ti mund të bësh diçka!“

Emily fjeti qetë. Të nesërmen, posa u zgjua, ndjeu se e thërret varri i fra Sllavkos. Përkundër të ftohtit dhe erës së fortë të janarit të vitit 2002, dhe përkundër lodhjes së skajshme të trupit të saj pa gjak të mjaftueshëm, Emily ia zbrazi zemrën mikut të vet, Sllavko. Me thjeshtësi fëmijërore ia tha të gjitha dhe, për herë të parë, mori guximin të lutet për shëndet.

Kush mund ta thotë se si shenjtërit prej Qiellit i organizojnë punët tona tokësore? Cili është orari i tyre, pse kjo ose ajo zgjedhje? Këtë do ta kuptojmë kur, përfundimisht të kalojmë në anën tjetër të perdes. Por një gjë është e sigurt: fjalët tona të varfra kurrë nuk do të mund ta shprehin shijen e vërtetë të intervenimeve të tyre qiellore në çastet e caktuara kryesore në jetën tonë dhe gjithë lumturinë që ato intervenime bartin me vete.

Fjalët e Emily provojnë të shprehin vizitën e mahnitshme të hirit që i kishte ndodhë më 30 janar:

“Rreth orës 3 pasdite, pasi që së bashku me Terrin, lutëm rruzaren e Mëshirës Hyjnore, u drejtuam kah dhoma jonë, kur një forcë e papërmbajtshme më shtyri të shikoj në drejtim të Krizhevacit. Aty, në rrëzë të kryqit, pashë një dritë verbuese. Kjo dritë vinte duke u rritur deri sa u bë impulsive. E luta Terrin ta shikoi kryqin, por nuk ia përshkrova detajet sepse nuk desha të ndikoj në të. Klithi se po shihte dritën! Vinte duke u rritur, dhe në të, ne pamë figurën të ngjashme me Zojën: lëvizte nga e majtas - djathtas, por gjithmonë kthehej në rrëzë të kryqit. Vendosa të shkoj në dhomë për fotoaparatur, por diçka në mua më thoshte: 'Mos shko!'“

„Sa më vjen keq se nuk isha e dëgjueshme dhe që, megjithatë, shkova! U ktheva nga dhoma dhe bëra dy fotografi katastrofale, dhe zemra ime u shtrëngua nga pikëllimi. Drita, pak nga pak u zbeh deri sa u zhduk. Atëherë kuptova se drita mbinatyrore ishte aktive. E mbushi çdo qelizë të trupit tim, gjithë qenien time. Më vërshoi. Jam aq e pikëlluar që iu nënshtrova tundimit që ta fotografoj atë dritë! Ndoshta drita do të zgjaste më shumë sikur të mos e kisha bërë atë. Për më pak se një orë e konstatova se nuk ka më gjak në urinën time. Ashtu edhe në mbrëmje, edhe të nesërmen. Gjakderdhja kishte pushuar! Dhe kështu është deri në ditën e sotme! Jam plotësisht e bindur se fra Sllavko ka ndërmjetësuar në shërimin tim.“

„Më 25. tetor të vitit 2000., një muaj para vdekjes, pas adhurimit të mbrëmjes ai erdhi te unë dhe Terri e na bekoj. Në rrëfyestore më tha me pikëllim të thellë: ‘Nuk e di a do të të shoh më!’ Atëherë mbështeti kokën në duar dhe pashë se vuante. Më vonë e kuptova se ai e dinte që i kishte mbetur vetëm pak kohë në Megjugorje.“

Jezusi nuk zgjedh më të mirët

Jezusi, i fejuari im, shpesh më ka dhënë hirin – dhe sa i bukur është ai hir – që t’i takoj disa nga miqtë e tij të cilët i ka aq për zemër, miqtë që Ai i shfrytëzon si instrumente për shpërndarjen e ngushëllimit të Tij hyjnor. Ky ngushëllim mund të jetë shembull i shërimit fizik, psikologjik dhe moral, mund të jetë lirim apo ndonjë frymëzim në lidhje me zgjedhjen që duhet bërë. Vërej se Jezusi nuk i zgjedh gjithmonë njerëzit e botës. Më me dëshirë shfrytëzon zemrat që kanë vuajtur shumë. Vuajtja është libri më i mirë për të mësuar mbi Zotin dhe mbi misteret e Tij, sidomos kur jetojmë përvojën e vuajtjes me Marinë.¹⁵⁴ Kjo është shkolla më e mirë për mësimin e bashkëndërjes për vuajtjen e të tjerëve, deri në pikën e dorëzimit të jetës personale për lehtësimin e të tjerëve. Vuajtja që ofrohet si fli është shugurimi më i mirë për shërimin e plagëve të njerëzimit tonë të thyer. „Guri, që e qitën jashtë përdorimit ndërtuesit, erdhi e u bë guri i këndit;“ (Ps 118,22)

Emily është njëra nga këto mike. Posa u shërua nga rrjedhja e çrregullt e gjakut, Emily shkoi në mision sa të madh aq të papritur. Nuk mund ta përshkruaj këtu aventurën e saj, sepse kjo do ta zinte pjesën e mbetur të këtij libri, por dua të ju tregoj vetëm faktin e pabesueshëm: Në Kanada dhe SHBA, me mijëra njerëz, përmes punës së saj, ia ka kushtuar vendin e vet dhe vetveten Zembrës së Pamëkat të Marisë, në pajtim me kërkesën e Qiellit në Fatima. Kush mund ta vlerësoi efektin e këtij akti në veprën e Shëlbimit? Që ta fillonte këtë, Zoti mori fëmijën e vogël që gjakderdhte, dhe që ishte i braktisur në rrugët e Montrealit e që kishte vetëm një ulëse automobili në të cilën mund të mbështeste kokën.

¹⁵⁴ Shiko kapitullin 56 „Plaga e hapur“

„*Të dashur fëmijë, edhe sonte ju jam mirënjohëse në mënyrë të veçantë që jeni këtu. Adhuroni, pa pushim, Sakramentin Tejetshenjt të Altarit. Unë jam gjithmonë e pranishme kur besimtarët adhurojnë. Atëherë merren hire të veçanta.*“ (15. mars 1984.)

68

KËRKO ÇFARË TË DUASH!

Një natë të ngrohtë vere, Maria Torrasa depërton nëpër turmën e cila ngutet në drejtim të rotondës pas kishës së shën Jakobit, duke shpresuar se do të gjejë tri vende të lira për tu ulur. Është katër gushti i vitit 2002. Është e lodhur sepse së bashku me dy shoqet e saja - Sonia dhe Beatrizë – po kthehet nga procesioni që u mbajt rrugëve të Megjugorjes, si është traditë për Festivalin e të rinjve. Shoqet i kishin thënë se kremtimi i mbylljes do të mbahet rreth rotondës, altarit të jashtëm, dhe kurrsesi nuk donin që ta lëshojnë atë pjesë të programit. Maria në të vërtetë nuk e di se çfarë do të ndodh saktësisht, por i përcjellë të gjitha me radhë.

Dëgjohet zëri i violinës¹⁵⁵, pastaj vazhdojnë këngët e mrekullueshme tingujt e të cilave arrijnë deri te rotonda. Në hapësirën e altarit vallëzojnë flakët e qirinjve, si të paralajmëronin vazhdimin misterioz të procesionit. Do të shohim se çfarë do të ndodhë, i thotë Maria vetes, duke mos marrë guximin që para shoqeve të saj ta zbulojë mosdijen e vet në lëmin e fesë. Pastaj violina ndërron tingullin, kurse kori fillon këngën *Benedictus qui venit*. Një meshtar i afrohet altarit, dhe në mënyrë solemne e përcjellin dy të tjerë që bartin pishtarët. Bart diçka që e vendos në mes të altarit. Do të thosha dielli në pedestal?!

„Çfarë është ajo?“ - pyet Maria Beatriz-en.

„Ai është ostensor e në mes është Jezusi. A e sheh atë rrethin e bardhë? Ja, aty është Jezusi...“

„Jezusi“, mendon Maria. „A do të thotë Zoti? Ajo më thotë se Zoti është në atë diell.“ Maria e njeh mirë miken e vet Beatriz, ajo gjithmonë ka qenë e baraspeshuar dhe me të dy këmbët në tokë... E gjithë kjo është, megjithatë, e çuditshme, i thotë vetes.

Maria erdhi në Megjugorje, deri diku nga kureshtja, duke mos pritur asgjë. Përqesh shoqet e saj dhe interesimin e tyre për të gjitha që kanë lidhje me fenë. Ajo moti e kishte braktisur kishën dhe nuk i kujtohet se është lutur ndonjëherë me zemër. Ndoshta Zoti ekziston por, ajo nuk e sheh se çfarë lidhje ka kjo me të. Ajo bën atë që i pëlqen më së shumti dhe ndjek ndjenjat e saja.

¹⁵⁵ Është violina e Melinde Dumitrescu, e cila jeton në Megjugorje prej disa vitesh si pjesëtare e Bashkësisë Figli del Divino Amore. Kjo muzikante, virtuozë e vërtetë, luan violinën gjatë kohës së adhurimit në kishën e shën Jakobit.

Për Marinë, të gjitha filluan para disa javësh në Las Parejas, vend i vogël në Argjentinë ku jeton. Pas punës, shkoi për të vizituar famullin e saj njëvjeçar Felipe dhe atëherë iu besua nënës së saj të re Beatriz: „Nuk ndihem mirë por nuk e di pse.“

Beatriz e dëgjoi dhe nuk tha asgjë, por kur Maria këtë e përsëriti një javë më vonë, ajo i dha një figure. Në të shkruante: „Mbretëresha e paqes“. Maria u befasua, e mori dhe me të shpejtë e futi në çantë. E nxori në mbrëmje dhe filloi të lexoi porositë që ishin të shkruara në anën e pasme të saj. Çdo mbrëmje, duart e sajë në mënyrë instiktive e kërkonin atë figure dhe Marinë e kaplonin ato fjalë paqeje dhe butësie. Edhe pse nuk donte, porositë pak nga pak shtresoheshin në të dhe ajo më në fund mundi t’i thotë Beatriz-ës shkakun e mërzhisë: „Nuk kam paqe!“

Fjalët i dolën papritur. I tha në mënyrë spontane. Po, është pikërisht kjo, ajo nuk ka paqe dhe kurrë nuk ka dashur të ballafaqohet me këtë realitet. E pse do të ballafaqohet me të, kur paraprakisht e dinte se nuk do të mund ta zotëronte? E luti të shoqin që ti blinte disa kasete për relaksim të tipit “bëje vetë”, por ai kishte një tjetër ide: „Pse të mos shkosh në një udhëtim të shkurtë në Evropë, në brigjet e Adriatikut. Ja, pikërisht Sonia dhe Beatriz do të shkojnë atje së shpejti. Kurse ti do të mund ta shfrytëzoje atë udhëtim që përsëri t’i gjesh rrënjët e familjes sate?“

I pëlqeu ideja që të jetë me dy shoqet e saja dhe të ndërroi vend. Pranoi për të shkuar. Por shoqet, përveç se duan të kërkojnë të parët, kanë në mendje edhe një gjë – duan patjetër të shkojnë në Megjugorje. „S’prish punë“ – i thotë Maria vetes – „duhet të jetë vend i bukur, dhe është verë. Po vij!“ Sa për t’u përgatitur, e lexoi, në shpejtësi, paraqitjen e shkurtë të ngjarjeve të Megjugorjes. Disa shpirtra të mirë iu gëzuan shkuarjes së saj atje.

„Sa je me fat! Atje të thërret Virgjëra Tejetshenjte!“

„Jo“, përgjigjet Maria, „mua më thirrën Sonia dhe Beatriz!“

Përkundër të gjitha pritjeve, Maria në Megjugorje kaloi ditë të paharrueshme. „Në zemrën time ishte ajo paqe e mrekullueshme, aq e veçantë në Megjugorje, e cila ndjehet vetëm aty.“ Tha ajo më vonë.

Një mbrëmje, udhëheqësi u dha të tri shoqeve nga një fotografi, kurse Maria mori fra Sllavkon¹⁵⁶ që mbante Sakramentin Tejetshenjtë. Qartë, Maria nuk e njeh atë meshtar dhe ajo fotografi nuk do të thotë asgjë për të.

Ndjehet si të ishte në festë dhe me kënaqësi zbulon një lloj të ri të marrëdhënieve njerëzore dhe atë komunikim të thjeshtë dhe të gëzueshëm mes njerëzish. Mirëpo, një veçanti e rëndësishme i pengon në ato ditë plot hir. Linjat telefonike nga Megjugorja për Amerikën e Jugut nuk

¹⁵⁶ Atë Sllavko Barbariq, françeskan i famshëm, erdhi në Megjugorje më 1982., një vit pas fillimit të dëftimeve. Ishte i ngarkuar për shtegtarët. Vdiq në nëntor të vitit 2000.

funksionojnë, dhe nuk dihet se kur do të riparohen. Maria atje kishte lënë babanë e moshuar, tetëdhjetëvjeçar, të shoqin, dhe fëmijët në moshën njëzetënjë, tetëmbëdhjetë dhe katërmëdhjetë vjeçare. Paqen e saj e tronditin mendimet e ankthit të brendshëm dhe shqetësimin. Pos kësaj, është edhe Matiasi! Matias është çarja, Matias është plaga, Matias është mossuksesi i amësisë... Që nga moshë pesëmbëdhjetëvjeçare, refuzon të bisedoi me të ëmën. Tri vite vuajtje intime për Marinë me pyetje aq tipike për nënën e cila rënkon: çfarë kam bërë që më urren aq shumë? Çfarë bën ai tani? Si do të dali nga ajo situatë? A do ta braktis shtëpinë? Çfarë duhet të bëj për të vendosur kontaktin përsëri dhe të mos më refuzoi?

Atë ditë, pranë rotondës, Maria për të parën herë në jetën e saj u gjet para Sakramentit Tejetshenj. Pa kërkuar që të kuptoi fjalët e rralla, deri diku të çuditshme të cilat Beatriz ia thotë, u gjunjëzua para “diellit të artë” të vendosur në altar, dhe priste. Ajo nuk di të lutet dhe shpirti saj bredh. Atëherë Beatriz i pëshpëriti në vesh diçka, si të ishte fjala për fshehtësi të rezervuar vetëm për të zgjedhurit e rrallë: „Shiko, aty është Jezusi! Tani e adhurojnë. Ky është një rast krejt i veçantë. Kërko prej tij çfarë të duash, ai do të dëgjoj.“

Maria nuk është e sigurt në asgjë, ajo kurrë nuk ka biseduar me Jezusin, kurse tani i thonë se është këtu dhe se prej tij mund të kërkojë çfarë të dojë, ashtu si kërkohet prej komshiut ose mikut. Më në fund, edhe nëse kjo nuk është e vërtetë, nuk ka çfarë të humbasë. Pos kësaj, ajo nuk duhet as të mendoi se çfarë do më së shumti:... Matiasi!

„O Jezus, nëse vërtetë je këtu, nëse më dëgjon, atëherë bën që biri im Matias dhe unë të mund të jetojmë përsëri në paqe!“

Të parën herë në jetën e vet, ajo lutej me gjithë zemër, nga thellësia e barkut ajo e shkarkoi barrën në Zembrën e Zotit dhe shikonte në atë hostie të bardhë si në një pikë në terr. Ajo shikon... për kul fytyrën e saj të përplotur drejt hostes dhe ... po pra, ai është! Matiasi!!! Në diellin e praruar është fytyra e Matiasit! Duket se është e vizatuar në hostie, sikurse del nga hostja, si të rrinte pezull para hostes! Maria ka harruar Beatriz-en, turmën dhe trupin e saj. Është e habitur me atë që shohin sytë e saj. Atëherë në vete e thërret të birin – se çfarë befasie! Ai i përgjigjet në zemër, sikur në mes dy tyre të ishte vendosur njëfarë linje.

„A po më duket?“ Maria e sheh Matiasin si atë ditë kur janë ndarë. Edhe pse në gjendje shoku, Maria fliste me Matiasin. Ai i përgjigjet në pyetje. Kështu biseduan një kohë, në mes zemrash. Më në fund, kur Maria u vetëdijësua për ambientin rreth vetes, Beatriz e përqafoi me butësi. Ato qanë së bashku, prej gëzimit!

„Beatriz, Sonia, e pashë birin tim, e pashë Matiasin!“

Prej atij momenti Maria nuk është e njëjtë, Jezusi hyri në jetën e saj, ajo e pa në veprim, ai u përgjigj në thirrjen e saj. Ajo e pranoi.

Gjatë kohës së qëndrimit në Megjugorje, Maria mori edhe shenja të tjera, në mesin e tyre shenja me linjat telefonike të cilat ishin në ndërprerje kronike. Ajo e vetmja e mori linjën. Një mbrëmje, ajo së bashku me shoqet dëshironte të thërrasë familjen së saj, por pa e ditur se si, gishtat e saj sjellin numrin e Matiasit¹⁵⁷. Ai lajmërohet. Ai është atje, në anën tjetër, i qetë... Prej të gjithë shtegtarëve, ajo, e vetmja mundi të marrë Argjentinën!

Në kthim, i shoqi, Juan Marcos, e priti në aeroport. Maria nga Megjugorja solli atë gëzim të ri dhe filloi tregimin më të pabesueshëm. Juan Marcos e dëgjoji vetëm sipërfaqësisht dhe e ndërpreu shumë shpejt, sepse edhe ai kishte një lajm për të.

„Maria nuk e di se çfarë po ndodh me Matiasin, ai vazhdimisht pyet kur do të kthehesh, si je, etj. Çudi! Kurrë nuk e kam parë të tillë, ai të pret me padurim, si të ishit miqtë më të mirë në botë!”

„Vërtetë? Kur i ngjau kjo?”

„Kjo i ngjau... prit, ah po, më 4. Gusht pasdite... Papritmas pyeti për ty dhe që prej asaj dite me padurim të pret.”

„Çfarë mrekullie! Po... sa ishte ora?”

„Diku rreth katër pasdite.”

Në këtë çast zemra e Marisë u ndryshua krejtësisht. E kuptoi. Për disa çaste nuk bëzani. Në një pjesë të sekondës e llogariti dallimin e kohës në mes të Hercegovinës dhe Argjentinës. Në Megjugorje atëherë ishte ora nëntë e mbrëmjes. Atëherë fillon adhurimi... Pikërisht në atë çast ajo iu drejtua Jezusit dhe e pa Matiasin në hostie... Murmuriti duke i përmbajtur lotët: „Juan Marcos, a the se ishte ora katër pasdite?”

„Po, Mari, katër pasdite!”

„Të dashur fëmijë! Lexoni shkrimin Shenjt, jetoni atë dhe lutuni që t'i kuptoni shenjat e kësaj kohe. Kjo është kohë e veçantë. Prandaj jam me ju që të ju afrojmë pranë zemrës sime dhe zemrës së

¹⁵⁷ Matias ishte atëherë në fakultet në Rosario, ku jetonte në banesën e familjes. Te prindërit në Las Parejas vinte për fundjavë.

Birit tim Jezusit. Të dashur fëmijëz, dëshiroj të jeni fëmijë të dritës, dhe jo të territ. “ (më 25. Gusht 1993.)

69

BIBLA IME PO DIGJET

Në Hercegovinë pushteti komunist shikonte pa miratim praninë e Biblës në shtëpia. Për besimtarët kroat, të kesh Biblën do të thoshte të kesh një pasuri të paçmueshme, por ajo pasuri duhej fshehur mirë! Përndjekjet ishin aq brutale sa shumica e familjeve i digjte Biblat e veta. Së paku një herë në vit, në fshehtësi të madhe ata rrezikonin, nxirrnin Biblat nga vendet ku i kishin fshehur dhe lexonin disa pjesë me nderim të madh. Nganjëherë personi që dinte të lexoi dhe të shkruaj, në shpejtësi i përshkruante disa rreshta me të cilët do të ushqehesh gjatë muajve të gjatë që do të vijnë.

Pushteti kërkonte që të dorëzohen Biblat. Kush refuzonte plotësimin e kësaj kërkese rrezikonte të burgosej. Njerëzit qanin kur milicët komunistë, duke sharë, digjnin publikisht Biblat e tyre.

Besimtarëve u mbetej vetëm dëgjimi i Fjalës në meshën e së dielës. Kjo i shpëtoi. Françeskanët dinin se si në predikimet e gjata t’i afrojnë Fjalën e Gjallë njerëzve guximtarë që vinin në meshë. Kurse ata që patën kurajon ta mbajnë Biblën përkundër rregullave komuniste, e konsideronin atë si pasurinë më të madhe, si lidhjen personale në mes të familjes së tyre dhe gjërave të Zotit, trashëgiminë qiellore që ua mundësoi të qëndrojnë në shpresë.

Më 1981., kur filluan dëftimet, regjimi edhe më tej sillej ashpër ndaj këtyre njerëzve.

Mbretëresha e paqes atëherë hodhi granatën e saj personale: „*Të dashur fëmijë, e keni harruar Biblën! Vendosi Biblën në vend të dukshëm në shtëpiat tuaja. Lexoni çdo ditë disa pjesë dhe jetoni ato gjatë ditës. Le ta shohin Biblën njerëzit që vijnë në shtëpiat tuaja dhe le të lexojnë me ju pjesë prej saj. Kështu do të mund të bisedoni së bashku për Zotin...*”¹⁵⁸

Duhet pranuar se askush prej nesh që ishim ‘të huaj’ nuk e kuptoi rëndësinë revolucionare të kësaj porosie. Nuk e dinim kontekstin e saj! Sipas fra Jozo Zovkos, i cili mund të konsiderohet dëshmitar i shtatë i Megjugorjes, Zoja ia ka përcjellë këtë porosi duke qarë dhe e ka përsëritur pesë herë.¹⁵⁹

¹⁵⁸ Rënia e komunizmit ndodhi në Jugosllavi në vitin 1991.

¹⁵⁹ Atë Jozo, françeskan, ishte meshtar i famullisë së Megjugorjes në fillim të dëftimeve.

Fra Jozo dëshmon se fytyra e Zojës shprehte pikëllim të thellë: „Kam parë shumë nëna duke qarë për shkak të vdekjes së fëmijës, por kurrë nuk kam parë pikëllim aq të thellë si të Zojës kur tha: 'E keni harruar Biblën!'“

Fra Jozo shtoi: „Babai i familje, çdo ditë, para darkës, le t’u lexoi fëmijëve një pjesë nga Ungjilli. Kur ta përfundoi, le ta mbyll Librin dhe le ta puth. Sepse kur puth Ungjillin, puth Jezusin.“

Jezusi është Fjala e Gjallë. Ai është Fjalë nëpërmes të cilit u krijua çdo gjë. Nëna e Hyjit nuk bën dallim në mes të Jezusit dhe Biblës, ajo e di identitetin e tyre. Të harrosh Biblën do të thotë të lësh Jezusin mënjanë, Ta përbuzësh. Ta harrosh Biblën do të thotë të lejosh që në ndërgjegjet tona të banojnë fjalët të cilat nuk na japin jetën Hyjnore dhe të cilat shpesh na helmojnë. Personi i cili thith Fjalën e Jetës është i pasuruar me ‘antitropa’ të cilët dinë si të refuzojnë fjalën e vdekjes që e prodhojnë zotat tanë të rremë, të vënë në lëvizje nga ana e medimeve që të mund të luftojnë kundër shpirtit të njeriut. Nëpërmjet të medimeve moderne vazhdimisht futen në banesat tona dhe vendosen në vende të dukshme: opsioni me të holla, dhuna, perversioni, vrapimi pas pushtetit, satanizmi ose përdhosja seksuale (Zoja flet për “pasionet e çrregullta”)! Të gjithë mysafirët tanë mund ta shohin këtë, të dëgjojnë ose lexojnë për këtë! E ne kemi harruar Jezusin. Kemi harruar Biblën!

Në qershorin e vitit 1973., tri vite para se të hyja në bashkësinë time, dy ngjarje të mëdha e hapën zemrën time për fuqinë mbinatyrore të Biblës. E falënderoj Zotin për këtë sepse deri atëherë isha e pavetëdijshme dhe e humbur. Vetëm tri ditë pas kthimit tim, u gjenda në shtëpinë e një çifti i cili sipas masës njerëzore, ishte shumë i varfër, por shumë i pasur me besnikërinë e jashtëzakonshme – gati organike – ndaj Jezusit.¹⁶⁰ I takonin kishës Pentakostale dhe e dinin Biblën gati përmendsh.

Duke parë Biblën time, nëna Andrée më luti që të kërkoj një pjesë të caktuar nga Ungjilli. Kjo zgjedhje nuk ishte e rastësishme. Posa e hapa librin, sytë e mi filluan menjëherë të përpijnë çdo fjalë që ishte në ato dy faqe të hapura. Nuk munda, madje as të ndërroj faqe sepse zjarri gufonte prej secili rresht! Jo zjarr material si ai që njohim, por flakë që shndriste çdo rresht, por që nuk e ndiznin letrën. Flakët kërcenin në drejtim të syve të mi dhe më ushqenin. Si mund ta ushqejë “zjarri” shpirtin? Nuk e di, por kjo ndodhi. Gëlltisja Ungjillin me babëzinë e personit të uritur i cili ka gjetur ushqimin e shijshëm, dhe i cili ndien derisa han se si çdo faqe e gjallëron!

Pasi vërejti se u ndala mbi faqen që ajo nuk e kishte kërkuar, Andrée deshi të më ndihmoi dhe tërhoqi Biblën kah vetja, por unë e shtrëngoja edhe më tej, e paaftë për t’i ndarë sytë nga ai zjarr. E pashë Jezusin e gjallë se si del prej atyre rreshtave, si nga ana tjetër e perdes. Ishte sikur të më kishin rënë luspat prej syve dhe prej zemrës sime të bllokuar ashtu që përfundimisht mund ta shihja Fjalën e Zotit ashtu si ishte në të vërtetë: ushqimi hyjnor i cili bartte Jetën!

¹⁶⁰ Lexoni kapitullin katër, me titull „Fati im në planete“

Prej nga vinte kjo uri? Edhe kjo ishte dhuratë e Shpirtit Shenjt! Ai bëri që të kuptoi se kush isha në të vërtetë dhe se çfarë dëshire të madhe për Zotin fshihte shpirti im. Ajo fshehtësi ishte e ngulfatur dhe e heshtur në mesin e masës së dendur të interesave të mia të mjera tokësore.

Zotëria nganjëherë, në mëshirën e vet, i lejon këto manifestime të realitetit të padukshëm. Ai e bën këtë që të na përqendroi përsëri në qëllimin e vërtetë të jetës sonë. Pas kësaj përvoje mu desh që të jem e qëndrueshme, si gjithë të tjerët, në Lectio Divina, që nganjëherë ishte e thatë, e nganjëherë e lakmueshme.

Ngjarja tjetër ndodhi afërsisht në të njëjtën kohë, në verën e vitit 1973. Supozoj se për të ripërtërirë shëndetin e shpirtit tim, Zotërisë i është dashur të punoi jashtë orarit! Ngjarja u zhvillua në Paris, në kapelën e vogël të Motrave të ngjiturit të Zojës në qiell. Ishim nja tridhjetë vetë në takimin e lutjes. Rinim të ulur në rreth. E gjithë ajo për mua ishte e re – ndjehesha sikur të isha në një botë tjetër – nuk e kisha idenë se si duhet të shkonte puna. Prandaj nuk merrja guximin ta hapja gojën pos për të kënduar disa këngë që i dija deri diku. Por njerëzit më mahnitën me fenë e tyre, me gëzimin e tyre dhe me afërsinë e pabesueshme që tregonin ndaj Jezusit. Ndaj Tij silleshin si ndaj mikut më të mirë! Isha si e porsalindur që i duhej të mësoi çdo gjë dhe që mundohet të kuptoi të gjitha, por që të mos humb asgjë.

Në anën time të djathë ishte Martine Lafitte, mjeke e cila kishte asistuar themeluesit të grupit, Pierre Goursat. Në grup shpërthenin eksplozimet e falënderimit për Zotin. Por, përnjëherë më erdhi ideja që më frikësoi: këtu është gëzimi, qielli i bashkësisë vëllazërore, paqja – po nëse kthehet makthi im i brendshëm? Po nëse kthehet tmerrri i ferrit tim të brendshëm? Do vdisja! Atëherë, nga thellësia, lëshova një klithje të qetë drejt Zotit, si ai që është duke u mbytur, e që ka kapur skajin e litarit, por që ende i frikohet mbytjes: „O, Zotëri, Të lutem! Bën që Fjala Jote të mos më lër më! Bën që kurrë më të mos largohem nga Fjala Jote! O, Zotëri, më premt, më premt!“

Posa ia drejtova këtë klithje të qetë Zotit, Martine, e cila, natyrisht, ishte krejtësisht e pavetëdijshme për lutjen time, hapi Biblën, dhe me një qetësi madhështore, dhe vendosmëri lexoi këtë pjesë:

„Sa për mua - thotë Zoti - ja besëlidhja ime me ta: “Shpirti im që është mbi ty fjalët e mia që i vura në gojë tënde, s’do të largohen nga goja jote, as nga goja e farës sate, as nga goja e farës së farës sate - thotë Zoti - që tani e deri në amshim.”“ (Iz 59,21)

Dyshoj se ndokush nga grupi kuptonte pse aq shumë lot rrëshqitën nëpër fytyrën time. Zoti u shërbye me fjalët e profetit që të përgjigjet në lutjen time! Por gati tetë vite më vonë kur Zoja, e pikëlluar, tha se e kemi harruar Biblën, e dinte se Parisienja e vogël do të qante tërë jetën nga gëzimi duke kujtuar puthjen e dashurisë që Jezusi ia dhuroi një mbrëmje në rrugën e të ngjiturit të Zojës në qiell, thjeshtë, sepse Martine e hapi librin e saj të preferuar, Biblën!

Do të kërkojnë, por nuk do të gjejnë

Këto shenja janë dëshmi e prekshme të realitetit shumë të thellë, të drejtuara shpirtit nga Zoti në çastin kur Ai gjykon se është e nevojshme. Mirëpo, këto shenja vetvetiu nuk mund të krijojnë palcën e raportit tonë me Fjalën e Zotit. Ky raport duhet të ndërtohet çdo ditë, në mënyrën se si personi i gjallë, pak nga pak, lejon që të jetë i zbutur. Secili prej nesh bart thellë në vete një etje gërryese për Fjalën e Zotit. Si është e mundur që të mos e ndjejmë, ose e ndjejmë shumë rrallë? Bartim të njëjtën uri edhe për Eukaristinë. Pse jemi, atëherë aq indiferent? Kjo është sepse jemi larg, tragjikisht larg, për t'i hulumtuar dimensionet e hapësirës sonë personale të jetës, të tablosë përrallore të shpirtit njerëzor.

Kjo është si të jetosh në një banesë të vogël, dydhomëshe me pamjen në rrugë. Jemi të burgosur aty për pesëdhjetë, gjashtëdhjetë ose madje tetëdhjetë vjet si të ishim në kthinat e mbikëqyrësit, dhe që kurrë, për as një çast të vetëm, nuk dyshojmë se, në anën e pasme të murit, shtrihet pjesa tjetër e pasurisë sonë – po, vërtetë e pasurisë sonë! Një kështjellë madhështore! Kjo kështjellë e shpirtit është e pajisur që të mund të jetojmë me dashuri të zjarrtë në të. Është e menduar ashtu që të mund ta shijojmë lumturinë në sasi gjithnjë e më të mëdha dhe që të mund të banojmë atje në mes të hapësirave të mahnitshme, ashtu si shenjtit që ende nuk i kemi takuar. Shpirti njerëzor, i krijuar në përngjasimin e Zotit, është fjalë në vetvete, aq e pamatshme dhe aq madhështore sa që do të vallëzonim nga gëzimi sikur të mund të merrnim me mend një të dhjetën e tij!

Gjithkush e di se e kemi trupin. E ndjejmë, e prekim. Është një realitet i prekshëm. Kujdesemi për të dhe e mirëmbajmë sipas parimeve tona. Secili e di se ka zemër – zemër të ndjeshme, sidomos kur vuan. Është reale, edhe pse e padukshme. Përpiqemi t'i kënaqim zemrat tona, por ato ligje personale të zemrës i kemi të panjohura. Secili e di se ka tru; mund të mendojmë dhe të krahasojmë kapacitetin tonë intelektual me kapacitetin e trurit të tjerëve. Përpiqemi ta pasurojmë me dije të ndryshme, në harmoni me atë që na tërheq ose që na duhet.

Por si është puna me shpirtin? Kush, vërtet, e di se e ka shpirtin? Kush e ndjen shpirtin e vet? Kush e vëren urinë, etjen, nevojat dhe dëshirat e shpirtit të vet? Kush e kupton se këto dëshira janë shumë më të forta dhe më të rëndësishme se dëshirat e trupit të tij, inteligjencës së tij dhe zemrës së tij? Pse kemi këtë pandjeshmëri ndaj shpirtit tanë, këtë pandjeshmëri guri, me një fjalë, padituri?

Po, ekziston një kështjellë e stërmadhe, e mrekullueshme, pas atij dollapi të rëndë në dhomën e banesës sonë, ku përkundër televizorit, DVD-ve dhe jetës sonë shoqërore, përjetimeve tona romantike dhe dëfrimeve, përkundër asaj që jemi mirë dhe kemi përshtypjen se i kemi “të gjitha”, ekziston një pjesë e jona, thellë në ne që po vdes nga mërzia. Kurse ne nuk afrohem buzë kësaj mërzie nga frika se mos na merren mendët.

A më merren mendtë nga zbrazësia? Para mungesës së padurueshme të kuptimit të jetës sime? Këtu duhet të ndalem, ta mbështes kokën në duar dhe me guxim të pyes veten: „Çfarë dua nga

jeta ime?” Sepse ajo që vendos sot, është ajo që do të jem në fund të udhëtimit dhe për gjithë amshimin.

Opsioni i parë: Të mbetem si jam! Do të jetoj e kufizuar në botën time të vogël, të prekshme dhe kalimtare. Do të provoj të marr prej sajë të gjitha shkëlqimet e gëzimit që do të jenë në rrugën time. Dhe kur koha dhe mosha ta bëjnë të veten dhe kur të më merren të gjitha, po... Nuk dua të di... Do ta shoh pastaj!

Opsioni i dytë: Ndjej se jam më e madhe se bota konkrete dhe kalimtare. Përpiqem të jetoj dashurinë besnike dhe të amshuar, dhe, nëse jam e aftë ta dëshiroj, ajo duhet edhe të ekzistoi! Prandaj do ta kërkoj, dhe atëherë edhe do ta gjej!

Bibla është çelësi im për opsionin e dytë, opsionin e jetës. Me ndihmën e Biblës do ta “hulumtoj Zotin”, dhe nëpërmes saj, në të njëjtën kohë, edhe thellësitë personale, dimensionet e mia misterioze. Do ti zbuloj miqtë e mi (dhe armiqtë) dhe do ta di sa jam e dashur.

Në mënyrë të përvujtë filloj të bredh nëpër këtë Libër misterioz sepse unë u takova me të si gjysmë e verbër, gjysmë e shurdhër, gjysmë e paralizuar. Hulumtoj Biblën time me metodën “provo dhe gabo”. Nganjëherë jam e bllokuar, nganjëherë e dekurajuar, por aty këtu, fjala më prek, fjala më ushqen, edhe një dhomë në shtëpinë time të fshehtë ndriçohet! Se çfarë bukurie zbuloj! E nuk e dija që ekziston. Vazhdoj hulumtimin tim duke shkuar nga bukuria në bukuri. Atëherë shpirti im fillon të vihet në lëvizje. Ha, pi, thith manën qiellore dhe hapet në harmoninë e tij. Shpirti im më zbulohet. Ai ekziston dhe ai është shpirti im! Se çfarë zbulimi! Duke lexuar Biblën e ndjej shpirtin tim se si kërcet si zjarr thellë në mua. Se çfarë mrekullie! Pra, është e vërtetë. Përnjëmend jam e krijuar në përngjasimin e Zotit. Ky shpirt-foshnje, që vallëzon në thellësitë e mia si zjarr që digjet, është qenia ime e vërtetë – ajo që nuk mund të vdesë!

Bibla është ushqimi kryesor për shpirtin tim. Dua t’i jap vendin e nderit dhe, prej sot, ushqimin tjetër dua ta kthej atje ku e ka vendin.

„Ja, po vijnë ditët - është fjala e Zotit - kur mbi vend do të çoj urinë; jo uri buke e etje uji, por të dëgjimit të fjalës së Zotit. Do të enden prej detit në det, prej veriut në lindje do të përshkohen duke e kërkuar fjalën e Zotit e s’do ta gjejnë!” (Am 8,11-12)

Po, Nënë, e kam harruar Biblën. Nuk kam lënë për të aspak vend, as kohë, në ekzistencën time. Duke u sjellë kështu, e kam gjykuar shpirtin tim të vdesë nga uria dhe kjo është arsyeja pse ti ke qarë me qa pikëllim. Kam mënjanuar çdo shpresë se do ta njoh Birin tënd dhe se do të shkoj rrugës së Tij, pas zërit të Tij. Isha e mundur që në fillim, në gëzimin e madh të armiqve të mi, sepse në fushën e betejës të kësaj bote, shkova pa shpatën time, Biblën!

„Të dashur fëmijë! Mos u frikoni prej djallit. Nuk ia vlen, sepse me lutje të përvujtë dhe dashuri të zjarritë, njeriu mund ta çarmatosë.“ (gusht 1985.)

70

OPERACIONI JERIKU

U Nicë erdhi pranvera. Më të bukurat lehe me lule në avenytë e sajë ishin si në ekspozitë. Bukuria e bollshme e luleve shumëngjyrëshe mbushte shikimin e kalimtarëve, sidomos të turistëve të cilët mblihdeshin rreth tyre me shumicë. Dhe numri i tyre nuk zvogëlohej!

Florence ngutej për shkuar në një aktivitet bamirës kur, papritmas u ndal. Ajo pa pllakatin e stërmadh që mbulonte vitrinën e hotelit, dhe aty me shkronja fluoreshente ishte i shkruar titulli i cili nuk mund të mos shihej nga kalimtari: „Festivali i profetëve“. Zemra i rrihte me shpejtësi. Me shikim e studioi çdo detal të pllakatit. Ishte e qartë se e kishte punuar profesionalisti në mënyrë brilante me qëllimin për të tërhequr kalimtarët, për të nxitur mahnitjen dhe dëshirën. Nuk ishte e mundur t’i shmangeshe atij pllakati as t’i rezistojë porosisë së tij. Vetëm brenda një vikendi do të mund ta dini gjithë ardhmërinë tuaj dhe mendimet më të fshehura të njerëzve rreth jush: miqve tuaj, armiqve tuaj dhe të ashtuquajturve miq tuaj! Dhe natyrisht, do të mund të mësoni mbi dashurinë e vërtetë të jetës suaj, si dhe mbi ardhmërinë financiare, emocionale dhe seksuale.

Kush ishin oratorët e atij festivali? Natyrisht, dijetarët prestigjioz me emra misterioz prejardhjeje aiatike. Ata, dhuratat e tyre të veçanta, do t’ua bëjnë të arritshme të gjithëve! Premtimi i mrekullive, zbulësive të jashtëzakonshme, diçka që Franca kurrë nuk kishte përjetuar më parë!

Kurse, sytë e Florence-s janë mësuar të shikojnë Jezusin – Dritën e botës – në orët e gjata të adhurimit që i planifikonte gjatë javës, para se të merrej me aktivitete tjera. Shikimi në atë pllakat ia digjte zemrën, prandaj filloi menjëherë të lutej: „Jo, Zotëri, jo! Ti nuk do të lejosh që fëmijët tu të helmohen në këtë mënyrë!“

Florence u kujtua se, ai hotel që konsiderohej i përshtatshëm dhe në rregull, edhe më parë kishte ekspozuar afishe bizare të cilat ajo i kishte injoruar. Ishte e vetëdijshme se në Nica vinin shumë vizitorë, dhe jo vetëm nxënës të Krishtit, por një festival si ky, vërtetë, ishte tepër. Ishte kjo lëmishtja e fundit. Duhet të ekzistoi mënyra që të pengohet goditja e armikut.

Florence filloi të lutet me plot shpresë. E dinte se për secilin plan të anës së errët, ekziston plani i fitores i fshehur në zemrën e Zotit. Po ashtu, e dinte se, nëse dëshiron ta mësoi se çfarë është ai, duhet të gjunjëzohet e të lutet. Dhe pastaj të ngrihet dhe me guxim ta realizoi!

Së shpejti u tregua se Florence e gjeti, në Bibël, çelësin që hap derën e mëshirës. Jeriku! Por, natyrisht! Si ndodhi rënia e kështjellës së Jerikut para ushtrisë shumë më të madhe të armikut dhe ushtrisë së Hebrenjve të armatosur dobët?¹⁶¹

I ra në mend një plan i thjeshtë dhe menjëherë mori telefonin. „A do të më bashkohesh?“ – e pyeti ndihmësin e besueshëm të grupit të lutjes. „Ja plani: A të kujtohet si u mposht Jeriku, si u rrënuan muret e tij? Të veprojmë ashtu! Do të sillemi rreth bllokut të ndërtesave ku gjendet hoteli, do të lutemi dhe do ta lavdërojmë Zotin tërë kohën. Mund të lusim edhe rruzaren. Secili nga ne, një orë në ditë. Do të punojmë në ndërrime. Shtatë ditë rresht.“

Vullnetarisht u paraqitën dhjetë anëtarë të grupit të lutjes. Ky numër përkujton dhjetë të drejtët që Abrahami ia përmendi Zotërisë kur ndërmjetësonte për Sodomën.¹⁶² Të dhjetët i quajti *minyān*. Deri në ditën e sotme është e ndaluar zhdukja e sinagogës nëse dhjetë hebrenj bashkohen aty për t’u lutur.

Pra, kjo dhjetëshe kryente detyrën e vet në pjesën ku jetonte klasa e lartë e qytetit Nice. Lutja zgjati shtatë ditë. Me rruzare në duar dhe libra lutjesh në xhep, lutësit ecnin dhe harxhonin këpucët e tyre. Por, më e rëndësishmja ishte zjarri i zemrave të tyre.

Pas një kohe, Florence-s i cingëroi telefoni: „Me që ra fjala, a vërejte diçka në hotelin Humphrey?“

„Jo, pse?“

„E kanë hequr pllakatin.“

„E festivali?“

„Nuk mbahet!“

„Çfarë mendon me atë 'nuk mbahet'?"

„Mendoj ‘nuk mbahet’! Caput! U krye, u zhduk me erën!“

¹⁶¹ Joz 6,1-21

¹⁶² Zan 18,17-32

Ishte kjo para trembëdhjetë vitesh. Në hotelin Humphrey kurrë më nuk u mbajtën aktivitete të dëmshme. Në atë hapësirë tani fryn një erë e freskët. A thua engjëjt e mirë të Jerikut, marrë parasysht klimën e butë të Nice-s, kanë vendosur të banojnë aty?

Kjo nuk është e gjitha!

Sa herë më thotë dikush se ka problem me djallin, dhe shoh se është e pamundur që atë situatë ta ndaloj me ndonjë aksion, gjithmonë përgjigjem njësoj: „Vetëm provoni 'Operacionin Jeriku'! Do të shihni. Funksionon!“¹⁶³

Florence kujton kohën kur në një qytezë të provansës, disa familje të krishtera ishin brengosur për koncertin që duhej të mbante një grup i njohur ‘heavy metal’ me reputacion të dyshimtë. Lidhja me drogën, e anëtarëve të grupit, dhe me një varg të këqijash të tjera që shkojnë së bashku, ishin të mjaftueshme që te familjet e atij lokaliteti të nxisin frikën më të keqe. Paralajmërimi i „rave party“ duhej të shtonte tërheqjen e mijëra të rinjve në koncert.

„Le ta ekzekutojmë operacionin Jeriku“ – tha njëra nga familjet. „E dimë se ku do ta bëjnë skenën e koncertit. Me ndërrime do ta vizitojmë atë rajon dhe do të lutemi shtatë ditë pa ndërpre.“

Dh, bënë ashtu. Në ditën e caktuar për koncert, një ditë e mrekullueshme korriku, kamionët arritën me gjithë pajisjen e duhur. Jehuan çekiçët në pjesën jugore të qytezës dhe sa çel e mbyll sytë skena u ngrit. U nxorën instrumentet nga valixhet mbrojtëse. U kyç zërimi, dhe akordet disonance filluan të përhapen rrugëve. Grupe të rinjsh filluan të tubohen rreth teknikëve duke u bërë mijëra pyetje. Do të jetë natë e zjarrtë! Eksplozim i vërtetë! Por, edhe grupi i lutjes ishte atje. Në heshtje shikonte.

„Zotëri, të falënderojmë për atë që do të bësh për të mbrojtur fëmijët tu! Shpresojmë në ty!“

U vendosën mikrofonat, timpanet dhe zërimi i gjithëmbarshtëm. Koha nuk mund të ishte më e mirë. Qielli ishte i kaltër dhe ajri i nxehtë që do të freskohej në mbrëmje. Ishin kushte ideale për mbajtjen e koncertit në natyrë! U vendosën gjithandej tezga të tregtarëve udhëtarë. Ata ekspozuan mallin e tyre. Ishin të sigurt se do të bëjnë një qarkullim të mirë. Dilerët e drogave vëzhgonin me kujdes, kurse njerëzit që kërkonin aventurë ishin të gatshëm për aksion.¹⁶⁴ Disa autobusë dhe automobila privat zunë këndin e vendparkimit të madh.

¹⁶³ Bashkësia *Lidhja e Mëshirës*, në Brazil, e cila shpëton fëmijët e rrugës nga bandat vrasëse, shpesh aplikon “*Operacioni Jerihon*” me rezultate të pabesueshme!

¹⁶⁴ Sidomos disa grupe janë të tmerrshme duke promovuar përdorimin e drogës, promiskuitetin, dhunën, madje edhe vetëvrasjen e njerëzve të cilët i tërheqin me ‘muzikën’ e vet. Por, nuk janë të gjitha grupet e tilla.

„Zotëri, mëshira jote është e pafund! Shiko fëmijët tu, gjithë ata të rinj. Të faleminderit për të gjitha planet e zemrës sate atërore që do t’i realizosh për t’i shpëtuar.“

Dielli ishte ende shumë lart kur një djalosh i grupit të lutjes të Jeriku e pyeti shokun afër tij: „A e sheh atë re?“

„Re? Çfarë reje?“

„Shiko! Atje...!“

„Ke të drejtë! Çudi. Duket se nuk ka të bëjë me ne... Qielli është i kaltër gjithandej.“

„Prit pak. Do të shohësh!“

Pamja përkujtonte skenën Biblike të Elisë profet. Qielli mbi Izraelin ishte mbyllur për më se tri vjet dhe toka kalonte një thatësi të tmerrshme, deri në çastin kur profeti u lut për shi.¹⁶⁵ Dhe vërtetë, ajo re e vogël rritej gjithnjë, dhe në një kohë rekorde u shndërrua në një masë të madhe e të zezë. Teknikët dhe yjet e rokut tundnin kokën. I përfshiu ankthi. Ishte arsye e mirë për brengosje sepse në çast rrebeshi i shiut u lëshua mbi qytezë. Ndodhi një vërshim i pa paraparë. Parashikimi i motit ishte i qartë: diell - tërë ditën. Një panik i përgjithshëm e kaploi skenën. Ishte e pamundur që të paketohen të gjitha gjërat aq shpejt. E gjithë pajisja dhe instrumentet u lagën në shi. Se çfarë dëmi për ta...

Shumë vite më vonë, disa anëtarë të grupit të Jerikut, kujtojnë episodin e “koncertit të vërshuar”. Kjo na jep forcë për betejë, sepse Armiku është gjithandej dhe përpiqet të mashtroni ose të shkatërroi të rinjtë. Armiku nuk heq dorë. Por, atë mbrëmje Zotëria veprroi dhe shpëtoi me mijëra të rinj, kurse ai grup roku nuk u duk kurrë më në atë rajon.

¹⁶⁵ 1 Mbr 18,41-46

„Të dashur fëmijë, kushtoni nëntëshe si fli për atë që ndjeni se jeni të lidhur më së shumti. Dëshiroj që jeta juaj të jetë e lidhur për mua. Unë jam nëna juaj dhe dëshiroj, fëmijëz, që djalli të mos ju mashtroni, sepse ai dëshiron të ju çojë në rrugë të gabuar, por nuk mundet nëse ju nuk ia lejoni. Prandaj, fëmijëz, përtërinini lutjen në zemrat tuaja dhe atëherë do ta kuptoni thirrjen time dhe dëshirën time të madhe që të ju ndihmoj.“

(25. korrik 1993.)

71

O, ÇFARË RRENE!

Louis ndërtoi karrierë të suksesshme. Anëtarësia e tij në lozhën masonerie i siguroi përparim të dukshëm. Ai dinte t’i ruaj fshehtësitë që ishin shumë.

Nga jashtë Louis dukej njeri krejtësisht i zakonshëm, por në të vërtetë ishte zyrtar i lart masonerik. Si fëmijë mori edukim të krishterë, por shpesh e qiti pas shpine, dike përfshirë këtu edhe premtimin e dhënë në pagëzim.

Kur i kishte nja 60 vjet, papritmas u sëmur nga një sëmundje e cila – po të mos ndodhte çudia – pas shumë muajsh vuajtjeje poshtëruese do të përfundonte me vdekje. Së bashku me sëmundjen e kaploi edhe ankthi. Kishte ndjenjën se nga brendia e tij ngrihej një re e cila bëhej përherë e më e errët. Nga kjo e mbulonte një djersë e ftohtë. Asnjë mjet qetësimi nuk i ndihmonte në pushimin e dhembjeve.

Një ditë u nis në një udhëtim me anije. Me që nuk kishte se me çka t’i mbushte orët e gjata të udhëtimit, pranoi që të merrte një pije me udhëtarin i cili, po ashtu, ishte vetëm dhe, quhej Martin. Martini ishte mendjemprehtë dhe psikolog i zoti. Ajo që më vonë tregoi në lidhje me bisedën që kishte pasur në anijeje, tingëllonte goxha interesante. Louis shpejt e kuptoi se po bisedonte me një njeri jashtëzakonisht të kulturuar por njëkohësisht shumë human dhe të ngrohtë. Prania dhe buzëqeshja e Martinit ishin të mjaftueshme që ta ngushëllojnë Louis-in, dhe ai filloi të flasë për jetën e tij, titujt, çastet e mëdha të tij, por edhe për mashtrimet. Martini, shumë shpejt e vërejti dëshpërimin në bashkudhëtarin e tij, prandaj me aq shkathtësi dhe kujdes e nxiti të flasë për atë që kurrë më parë nuk i kishte treguar askujt.

„Jam i shkatërruar. Kam bërë gjëra të këqija – njëren pas tjetrës. Tani më tmerron vdekja. Sidomos më mundon ajo që vjen pas vdekjes.“

Louis-i pastaj i zbuloi Martinit paktin që kishte bërë dhe nënshkruar me gjakun e tij duke i

dorëzuar shpirtin e tij djallit si ndërrim për disa suksese sipërfaqësore.¹⁶⁶

Kjo nuk e shqetësoi Martinin. „Unë jam prift katolik,“ i tha ai. „Nuk bart kryq, por jam misionar.“

„O, Unë i kam braktisur të gjitha këto shumë kohë më parë, shumë kohë më parë...!“

„Zoti nuk është kurrë larg. Ai gjithmonë pret kthimin e fëmijëve të vet. Louis, pret edhe për ty – mund të kthehesh.“

„Jo, nuk mundem. Tani më shpirti im nuk më takon mua. E mori djalli. U mora vesh me të.“

„Mund ta anulosh paktin që ke bërë me të. Ende mund të pajtohesh me Zotërinë!¹⁶⁷ Unë jam këtu dhe jam i gatshëm të dëgjoj rrëfimin tënd.“

„Nuk mund të shkoj në rrëfim!“

„Pse nuk mundesh?“

„Sepse djalli ma ka tërhequr vërejtjen se pas marrëveshjes kurrë nuk mund të shkoj në rrëfim.“

„O, çfarë rrene! Dhe ti i besove? A nuk e di ti se ai është rrenës dhe babai i rrenës?“ (Gjn 8,44)

Kjo informatë e goditi cakun. Renë? Rrenë? Louis u tmerrua. Mendimet e tij rrjedhin me shpejtësi marramendëse. Si mund të isha aq mendjelehtë? Dalëngadalë drita e dobët filloi të depërtoj në zemrën e tij, për të cilën mendonte se është prej guri. Një dritë e vogël që mund t'i ngjante shpresës!

„Po, dëgjo rrëfimin tim“, tha më në fund me një zë që mezi dëgjohej.

Disa orë më vonë, para se anija të arrinte në breg, Louis e zhyti tërë jetën e tij të mjerë në Mëshirën Hyjnore. Në lima u përshëndetën dhe shkuan secili në punë të vet. Louis drejt fatit të tij, kurse Martini në punën e vet misionare me zemër të gëzuar. I erdhën në mend fjalët e Jezusit: „vëllai yt - pati vdekur e u ngjall, pati humbur e u gjet. !“ (Lk 15,32). Njëkohësisht, një pyetje e

¹⁶⁶ Katolikëve u ndalohet të anëtarësohen në shoqatat masonerike. Shiko: www.vatican.va

¹⁶⁷ Jezusi i tha Vanit të vogël nga Vietnami: “Një shikim i thjeshtë besimi drejt meje është i mjaftueshëm që ta nxjerr shpirtin mëkatar nga pushteti i djallit. Madje edhe nëse shpirti në grahmat e vdekjes gjendet te dera e ferrit, para se të hedhet në të, tregon një grimë besimi në Dashurinë time të Paskajshme, asaj Dashurie të Pakufishme i mjafton që atë shpirt ta tërheq në përfaqimin e Trinisë Tejetshenjte... Van, dobësitë tua janë larg nga ajo që ta zvogëlojnë vlerën tënde. Përkundrazi, vetëm do ta rrisin atë, sepse ato janë shenjë e besimit më të madh në Mua, dhe kështu bashkimi ynë është më afër! Por fatkeqësisht, është tragjedi se njerëzit nuk kanë besim në Dashurinë Time. O, mëkat, mëkat! Mëkati kurrë nuk e fyen dashurinë Time. Absolutisht, asgjë nuk e fyen dashurinë Time pos mungesës së besimit në atë dashuri.”

mundonte Martinin: Sa njerëz të tillë ka në qytet? A thua sa njerëz, në hapësirën që mund të arrij, kanë rënë në grackën e tij të poshtër? Dhe zemra e tij misionare, mori zjarr.

Zoja u tërheq vërejtjen veguesve

Që në ditët e para të dëftimit në vitin 1981., Zojës i është dashur t'i mësoi veguesit e rinj mbi këtë temë. E dinte se do t'u vijë shumë njerëz dhe duhet t'ua tërheq vërejtjen mbi atë që ndodh në botë. Sikur kjo informatë të mos vinte prej saj, ata kurrë nuk do të besonin në të. Ishin të ngurtësuar. Ata që kanë vuajtur nën pushtetin komunist dhe të cilët hap pas hapi luftonin për ta ruajtur lirinë e brendshme, si do të mund të mendonin që të rinjtë e shteteve të pasura, që ishin të lirë të bëjnë çfarë të duan, ia dorëzojnë jetën djallit vullnetarisht dhe të zgjedhin të jenë shërbëtorët e tij? Zoja e mënjanoi naivitetin e tyre, i cili më vonë u shndërrua në lutje të zjarrtë. Zoja u tha veguesve: *“Ata që kanë bërë marrëveshje me djallin, ende mund ta prishin atë marrëveshje dhe t'i kthehen Zotit deri në fund të jetës. Duhet lutur për ta që të fitojnë forcën e përcaktimit për Zotin.”* (Nga të tetëdhjetat e hershme, nuk është e shënuar data).

Pas kësaj vërejtje, për ta filloi puna praktike. Shumë njerëz që i kishte lidhur djalli, e mësynë Megjugorjen dhe trokitën në dyert e veguesve. Pasojat e kësaj për secilin do të mbesin fshehtësi të Zotit, por rrjedha e ngjarjeve është shumë e thjeshtë: Mbretëresha e paqes tregoi edhe një herë se është Streha e mëkatarëve!

SHENIM: Që të mbrohem nga shtypja e të Keqit, si dhe që të lirohemi prej tij, të kujtojmë premtimet e pagëzimit, njëra nga lutjet më të thjeshta që mund ta thonë edhe laikët. Premtimet e pagëzimit mund t'i përsërisim shpesh, sidomos kur i Keqi bredh dhe na nxit në mëkat. Para së gjithash, nuk guxojmë të jemi të pavendosur. Zoja na thërret *“të përcaktohem për Zotin, e kundër djallit.”*

Teksti i premtimeve të pagëzimit

I dashur mik, nëpër misterin e pashkëve jemi varrosur me Krishtin, ashtu që të mundemi me Të, ngjallemi në jetën e re. Le t'i përsërisim premtimet tona që i kemi dhënë në pagëzim kur kemi mohuar djallin dhe të gjitha veprat e tij.

A i bini mohit mëkatit, që të jetoni në lirinë e fëmijëve të Zotit?

- Po. I biem.

A i bini mohit mashtrimit të të Keqit, që mëkati të mos ju mbisundojë?

- Po. I biem.

A i bini mohit Djallit, autorit dhe shkaktarit të mëkatit?

- Po. I biem.

A besoni në Zotin Atin e gjithëpushtetshëm, krijuesin e qiellit e të tokës?

- Besojmë.

A besoni në Jezu Krishtin, Një të vetmin Birin e Tij, Zotin tonë, të lindur nga Virgjëra Mari, që vuajti dhe u varros, u ngjall së vdekuri dhe rri në të djathtën e Atit?

- Besojmë.

A besoni në Shpirtin Shenjt, Kishën e shenjtë Katolike, bashkësinë e engjëjve, faljen e mëkateve, ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e pasosur?

- Besojmë.

- Amen.

„Të dashur fëmijë! Sot ju thërras, që me lutje dhe me flijime të përgatiteni për ardhjen e Shpirtit Shenjt. Fëmijëz, kjo është kohë hireshe dhe ju thërras rishtas, që të përcaktoheni për Zotin Krijues. Lejoni Atij që të ju transformoi dhe ndryshoi. Le të jenë zemrat tuaja të gatshme të dëgjojnë dhe të jetojnë të gjitha që Shpirti shenjt ka në plan për secilin prej jush. Fëmijëz, lejoni Shpirtit Shenjt që të ju prij rrugës së të vërtetës dhe shpëtimit drejt jetës së pasosur. Ju faleminderit që ju përgjigjet thirrjes sime. “ (25. Maj 1998.)

72

LUTJA E RREZIKSHME

U gëzuan të gjithë kur Laurent erdhi në Bashkësi. Si ri i ri që ishte, i këndshëm, i pashëm, fort i mbështetur në Zotërinë, fillimisht dukej vëlla ideal. Në atë kohë unë udhëhiqja me kuvendin tonë në Jerusalem, dhe si të tjerët, vërtetë isha mirënjohëse për thirrjen e tij në mesin tonë. Por, së shpejti bisedat tona u bënë intensive dhe të thella.

Vazhdimisht kthehej në temën e vet, që ishte edhe lajtmotivi i cili dilte nga thellësia e zezës së tij: “Çfarë bëjmë për t’ju ndihmuar të varfërve? Ndjem i thirrur për t’ju ndihmuar të varfërve.”

„Nëse Zoti e ka vu këtë në zemrën tënde, Ai e di edhe si do të ta mundësoi që këtë ta realizosh. Ki besim në të!“ iu përgjigja, Por, në këtë moment, ndoshta dëshiron të të zbuloi edhe një dimension të varfërisë.“

„Vërtetë? Cilin?“

„Tënden, personalen, varfërinë e thellë, atë që do të ta mundësoi ta lusësh Zotin ashtu si skamnorët në rrugë, të cilëve ti dëshiron t’u ndihmosh, për shembull“

„Hm...Por unë...unë i kam të gjitha! Pai, kam shumë, madje tepër! Pse do duhej që unë të brengosesha për 'varfërinë time personale? A nuk është kjo pak si egoiste?“

„Lejo Zotërinë të veproi kur të dojë ai. Do të shohësh!“ Ai e di si do t’ia arrijë që ti të kuptosh atë që do prej teje. Në ndërkohë, nëse do që, pakëz, t’i shpejtosh gjërat, gjithmonë mund ta lusësh Zotërinë të ta tregoi varfërinë e tij personale, pastaj nisur nga kjo ...“

„Në rregull,“ u përgjigj Laurent. Ishte pak i befusuar, por meqë ishte i butë si zakonisht, nuk kundërshtoi.

Pas disa javësh, qëndrimi i Laurent-it u ndërrua. Nuk fliste më aq shumë. Vërenim se ishte i humbur në mendimet e tija, pa dyshim luftonte me disa tendosje të brendshme. Me që ishte i përvujtë nuk u desh të prisja shumë që të ma hapë zemrën:

„Po luftoj, po luftoj!“ – filloi, e sytë iu përplotën.

„Unë luftoj me ty. Të gjithë jemi në anijen e njëjtë,“ ia ktheva, duke dashur ta trimëroj.

„Lutja që ma dhatë para disa ditësh...E di, ma keni tërhequr vërejtjen, por ...! Është diçka e fuqishme! Mendova se Zotëria do të ma ‘tregoi’ varfërinë time personale. Isha tepër naiv. Mendoja se do të ma tregoi ashtu si ia tregoni dikujt hartën gjeografike, ndonjë fotografi rëntgeni ose të skanuar. Por më tregoi shumë më tepër! E futi hundën time krejtësisht në të, dhe fare nuk është erë e mirë. Fare!“

Zotëria nuk humbi kohë që ta përgatisë atë bir, për të cilin – në planin e tij hyjnor – e dinte se do të bëhej ngushëllim i gjallë për aq shumë fëmijë të cilët gati deri në vdekje ishin të dërmuar me vrazhdësitë e kësaj bote.

„Laurent, do të doja të mund të them që kjo do të thotë se do të shkosh dhe do të kthehesh atje ku ishe. Por Zoti kurrë nuk kthehet kur fillon diçka, dhe nuk do të befasohesha nëse do të dëshironte që të shkosh edhe më tej. Nëse është ashtu, ky është vetëm fillimi. Përgatitu dhe falëndero Zotërinë! Tani që je dorëzuar plotësisht në duart e tij, duke i dhënë gjithë pushtetin mbi ty, Krijuesi yt do të jetë në gjendje që nëpërmes teje të realizoi gjithë planin e vet. Shiko vetëm në Të!“

Kaluan disa javë dhe mund të them se Laurent kalonte nëpër pastrimet e brendshme që bëheshin përherë e më të dhimbshme. Për më tepër, çdo gjë që fillonte, ashtu si rastësisht, nuk shkonte mirë. Poshtërimet shumoheshin. E përndiqnin mendimet më të tmerrshme dhe ndjehej i turpëruar! Nuk mund ta njihje më. Ngadalë, por sigurt, drita e Zotit depërtonte në të, duke ndriçuar çdo lëmi të veçantë të qenies së tij, dhe ato lëmi ishin të thella dhe as që e kishte ditur se ato ekzistojnë. Duhej të kujdeseshim për të si për fëmijën, sepse i kishte humbur mbështetjet e tij. Ky proces zgjati disa muaj. Ndjehej aq i papastër përbrenda sa ‘filloi të ndërroi shikimin e tij’ mbi jetën.

Pastaj i dukej se çdo person rreth tij është i pajisur me kualitete të mrekullueshme. Madje edhe mjeranët më të mëdhenj në sytë e botës nxisnin tek ai mahnitje të thellë. E përjetonte veten si më të mjerin nga më të mjerët, si masë e amorfe i vuajtjeve të pakufishme dhe të neveritshme, ku secila është më e tmerrshme se ajo para saj. Më me dëshirë do të zhdukej në gropë se të rrinte me ne pranë tavolinës, sepse mendonte se vetë prania e tij e prish atmosferën

Zgjedhja e momentit dhe zgjatja e intervenimeve të vullnetit të Zotit, për ne gjithmonë do të mbetet mister, por si duket bindja e përvujtë e Laurentit ndaj ngjarjeve ia shkurtoi sprovat e tij. Kur Zotëria, më në fund, e liroi nga intervenimi i Tij, nga zemra e Laurentit shpërtheu një gëzim i

madh i jetës, aq i ri dhe aq këndshëm! E kaploi një paqe shumë e thellë dhe u bë i vetëdijshëm – së paku pjesërisht – se çfarë Zotëria ka bërë në të. „Unë jam ai që jam“, i ka thënë Jezusi Katarinës së Sienës, “kurse ti je ajo që nuk je.” Se çfarë çlirimi sjellë ky vetëdijësim! Çfarë paqe! Dhe nuk është, më, me rëndësi, që jemi ajo që nuk jemi, kur Ai i cili është, na dashuron marrëzisht dhe kënaqet duke na shfaqur veten në të gjitha dimensionet e tij!

Laurenti, nga thellësia e qenies së tij i kuptoi fjalët: „*Lum skamnorët në shpirt sepse e tyre është Mbretëria e qiejve!*“ (Mt 5,3) Ndoshta do të ishte më i drejtë përkthimi: „*Lum ata shpirti i të cilëve është i zhveshur nga të gjitha sepse e tyre është Mbretëria e qiejve!*” Zbritja e Laurentit në thellësitë e mjerimit personal, dhe përvoja se, përkundër kësaj është i dashur, e pasuroi shpirtin e tij deri në një shkallë të jashtëzakonshme. Por është e vërtetë se për t’u arritur thellësia dhe për t’u prekur themeli i mjerimit, duhet të kalojmë nëpër përvojën prej të cilës na merren mendët dhe e cila na bën të ankthshëm. Por, edhe më thellë në ne është e fshehur kthina martesore në të cilën vjen vetë Jezusi për t’u bërë i fejuari ynë. Dhe atëherë i kemi të gjitha sepse “gjithçka kam - është e jotja” (Lk 15,31).

Laurenti zhvilloi një karizmë të pabesueshme për tinxherët dhe të rinjtë që i ka plagosur jeta. I tërhiqte si magnet butësia e tij, gëzimi i tij, e sidomos miqësia e tij. Bekimi i Zotit rrjedh në raportet që ka me ata të rinj, me “varfanjakët” e vërtetë të gjeneratës sonë, me ata për të cilët Zoja qan. Para pastrimit të tij, Laurenti donte të “kujdesej për të varfëritë”, si njeri zemërgjerë i cili do t’i dëgjonte ankimet e tyre dhe do të ndante pasurinë e tij me ta. Tani, nuk duhet më të kujdeset për ta sepse u bë njëri prej tyre. Edhe vetë është i varfër, i njeh ata që janë të barabartë me të dhe jeton me ta, qeshet dhe lutet me ta.

„Zotëri, ma trego varfërinë time!“

Kjo është njëra nga lutjet më të rrezikshme, sepse - duhet ta dini këtë – Zoti i përgjigjet gjithmonë! A nuk është kjo dera për lumturinë dhe për gëzimin? Zoti, gjithmonë jep më tepër se e lusim. Ai tejkalon, Ai shumëzon, Ai të zhyt... Ne jemi aq cikërrimtarë dhe koprracë në kërkesat tona! Zoti nuk është i interesuar të na i tregoi gjërat. Ai ka për ne diçka më të mirë se sa tregimi i fotografive të lëvizshme. Mundimi i tij duhet të na transformoi dhe të na e mundësoi ta arrijmë identitetin tonë të vërtetë. Si të gjithë ne, pa përjashtim, Laurenti ishte i varfër, por nuk e dinte këtë. Me qëllimin për ta mësuar që të bëhet apostull i skamnorëve, Jezusi e vuri në sprovë. Dhe pikërisht në atë sprovë Laurenti e gjeti identitetin e vet të vërtetë – identitetin e skamnorit.

Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar, të rinjtë nga rruga, viktimat e dhunës seksuale dhe ata që kanë përjetuar anijethyerjen në dashuri: e kuptojnë aty për aty se janë varfëruar – por atë varfëri e lidhin shpesh me rebelim, sidomos nëse janë varfëruar për shkak të tjerëve. (Mbreti David kishte të drejtë: 2 Sam 24,14).

Apostulli është person i cili i dorëzohet vullnetarisht formësimit të Zotit dhe transformimit intensiv, të gjitha ndërmarrjeve të Krijuesit – artist. Është mirë që me Zotin ta keni gjithmonë të shtrënguar mirë rripin e sigurisë e jo vetëm gjatë ngritjes dhe aterimit – kështu veproi Laurenti duke e ndjekur. Kjo është në kundërshtim me ata që tejkalojnë ose ikin. Ata kanë frikë të zhyten thellë, kanë frikë ta braktisin sigurinë komode dhe të rrejtshme të peizazheve të njohura ose ta humbin kontrollin e rremë mbi jetë e të tjerëve. O, Sa bukur është ta shikosh Jezusin se si e modelon apostullin!

Apostulli, si nxënës, me liri të plotë, zgjedh që të hyjë në atë mister të veçantë të njëjtësimit me Krishtin. Për dallim nga fëmijët prej rruge, ai e pranon varfërinë e vet nga dashuria, e jo nga detyrimi. Pastaj humb kontrollin mbi jetën e tij. Çfarë lirimi! Loja më e dashur e Jezusit quhet *Kush humb, fiton* (Mt 19,30). Ai na fton të gjithëve të marrim pjesë në këtë lojë, sepse sa më shumë që jemi, aq më interesante është. Pse shenjtërve u pëlqen shumë kjo lojë me Jezusin? Sepse kanë kuptuar se fitojnë visare të paçmueshme dhe të amshuara, dhe e gjitha që mund të humbin janë mbeturina të panevojshme! Shenjtërit janë fitimtarët e amshuar të kësaj bote. Dhe secili që lidhet me atë që ka dhe jeton me frikë se do ta humb, tanimë e ka humbur.

Marta Robin, njëra nga gratë më të lumtura që kam takuar, sigurisht i ka humbur të gjitha që i ka pasur, por për Jezusin. Ka jetuar me aq njëjtësim intensiv me më skamnorin nga skamnorët sa një ditë i tha një mikes së saj: “O, sa do të dëshiroja të shkoj në qiell në përcjelljen e atyre rrugaçëve leckamanë!”

„Të dashur fëmijë! Mos keni frikë të keni fëmijë. Sa më shumë fëmijë të keni, aq më mirë. Duhet të frikoheni nëse nuk i keni.“ (Mirjanës, nuk është e shënuar data)

73

RRËFIMI QË VLEN TË MBAHET MEND

Mary Elizabeth, arsimtare dyzetepesëvjeçare në një shkollë të mesme në SHBA, dëshmon se për Zotin asgjë nuk është e pamundur për ata që në lutje i hapin zemrat dhe lejojnë të jenë të udhëhequr nga Shpirti Shenjt:

„Kur në vitin 1990., shkova në shtegtim në Megjugorje, më duhej mbështetja e tim shoqi. Duhej që të fluturoja mbi Atlantikun për të ardhur në një vend komunist, të siguroj të hollat që nuk i kisha, të gjej një grua e cila do të rrinte me fëmijët. Por thirrja ishte aq e fuqishme. Thjesht, duhet të shkoja atje, prandaj burri im pranoi që të kujdeset për fëmijët. Pyetsha se çfarë pres që të gjej atje. E dija se do të më bënte mirë largimi nga të gjitha kërkesat e katër fëmijëve të mi të vegjël. Në kohën e fundit mendoja se jam nënë e keqe, sepse aq shpesh më duhej pushimi që të marr frymë. E dija se ai udhëtim do të më ndihmoi që të ndalem dhe të shqyrtoj mirë se çfarë raporti kam me familjen time, me aktivitetet e mia dhe ardhmërinë time.“

„Diku kah mesi i qëndrimit tim, ia thash meshtarit listën e zakonshme të mëkateve të mia dhe vazhdova me Sakramentin e rrëfimit. Mbrëmjen e fundit, e frustruar se nuk po kuptoja asnjë fjalë nga predikimi në gjuhën kroate, e mora me vete librin e predikimeve në gjuhën angleze. Posa e hapa librin, e gjeta predikimin i cili fliste për zemrën time. Kuptova se Zotëria më fton që të rrëfhem përsëri, sepse duhej ta zgjidhja situatën që më pengonte të jem në raport më të afërt me Të.“

„Kur dola prej kishës, nuk ndjehej asnjë zë. Ishte terr, u bë ftohtë, kurse sheshi i zbrazët para kishë dukej edhe më i zbrazët. Vëreja dy drita të ndezura në rrallët e rrëfimit. Dëshiroja të kthehem në banesën time, por ndjeja se Zotëria po më thërret drejt rrëfyestores, Rezistojta, por i thash vetes: ‘Nëse njëra prej dritave tregon se atje flitet anglisht atëherë, do të shkoj’. Shenja e parë ishte: ‘polonisht’. 'Uh', mendova, 'e shmanga'. Por shenja tjetër ishte: 'anglisht'. Mora frymë thellë dhe hapa derën.“

„Kur u gjunjëzova, fillimisht meshtari më vuri një kryq në dorë. Fillova të flas. Dukej se meshtari e dinte pse jam aty. Perdja ra. Kontracesioni. Kjo ishte tema me të cilën më duhej të

ballafaqohem. Si shumë katolikë, im shoq dhe unë shfrytëzovim kontracepsionin. Nuk ishim në gjendje që ta kuptojmë mësimin e Kishës mbi këtë temë, prandaj nuk i kishim kushtuar shumë kujdes. Ishim persona të arsimuar dhe të përgjegjshëm. Në të vërtetë qëndrimi ynë ishte goxha arrogant. Por, me fuqinë e Shpirtit Shenjt, kuptova se burri im dhe unë, plotësisht e kemi mënjanuar Zotërinë nga kjo pjesë e veçantë e martesës sonë. Lidhja jonë do duhej që të bazohet në Sakramentin e martesës, megjithatë, ne jemi dorëzuar njëri tjetrit në të gjitha pos në aktin i cili mund të krijojë jetën. Lidhja jonë i ngjante litarit me tri fije (ne të dy dhe Zotëria), por Zotëria është ajo fije që e mbështet Sakramentin e martesës. Përjashtimi i Zotërisë nga lidhja jonë bëri që litari të mos jetë i plotë dhe rrezikonte të shpërblyej.

„Gjatë rrëfimit, zemra ime u ndryshua plotësisht dhe e dija se edhe jeta ime do të ndërroi në tërësi. Zotëria më tha se duhet të kemi edhe të tjerë fëmijë, edhe pse ne i kishim katër dhe nganjëherë ishte vështirë t’ia dalësh me ta, por Ai donte që t’i hapemi atij në Lidhjen tonë. “

„Nuk e di sa kohë kalova në rrëfyestore, por kur dola e dija se Zotëria kërkonte prej meje gjëra për të cilat mendoja se janë të pamundura. Gjatë kthimit në shtëpi kisha përshtypjen se po e ndjeja atë parajsë. Kur arrita, m’u desh që t’ia shpjegoj burrit ndërrimin e planeve. Isha e brengosur pak për shkak të reaksionit të tij të mundshëm me që e dija se çfarë gjendje financiare kemi në atë kohë. Kur i tregova se çfarë më ndodhi dhe se jemi të thirrur që në martesë sinqerisht t’i hapemi Zotërisë, e dha pëlqimin e tij të plotë. Natyrisht, u desh që të mësojmë shumë, që edhe e bëmë. “

„Pikërisht kremtojmë 23 vjetorin e martesës dhe pas shtegtimit më 1990 patëm edhe katër fëmijë të tjerë. Edhe pse kohë pas kohë kjo kërkonte shumë përpjekje, na duhet të pranojmë se plani i lumturive të Zotërisë për familjen tonë ishte më i madh se mund ta imagjinoja ndonjë herë. Dhe deri sa çerdhet e fqinjëve tanë zbrazeshin, shtëpia jonë gjithmonë ishte plot. Natyrisht, kohë pas kohe e dëshiroja vetminë, por gëzimi i madh që sollën fëmijët në mesin e asaj zhurme, ngatërrese dhe përgjegjësie, është dhuratë e vërtetë e Zotit. E morëm rrezikun që të hapemi, që të jemi zemërgjerë ndaj Zotit dhe zbuluam ndërrimin në të cilin Zotëria kurrë nuk lejon që t’ia kalojmë me zemërgjerësi. Secilën herë kur duhej ushqyer edhe një gojë, Zotëria kujdesej në mënyrë të paimagjinueshme. Natyrisht se është dashur të jemi drejtues të mirë të dhuratave të fituara, nuk na mungonte asgjë, dhe u shpërblyem njëqind fish.“

„Kur u ktheva nga Megjugorja, më kaploi një etje e madhe për të mësuar dhe burri im m’u bashkua në kërkim. Sot jam nënë e tetë fëmijëve të mrekullueshëm nga 21 deri në 4 vjet, e ndonjëri nga ata, kam shpresë se, ka thirrjen për meshtar ose motër nderi. Para dy vitesh magjistrova në temën e teologjisë së trupit. Tani i mësoj të rinjtë mbi teologjinë e trupit e jo mbi kontabilitetin, sepse ata janë të etshëm të dinë për Zotin, dhe mësimi mbi Të është pasioni im.¹⁶⁸

¹⁶⁸ Teologjia e trupit, që e ka shkruar papa Gjon Pali II., është vizion i integruar i qenies njerëzore – trupit, mendjes dhe shpirtit. Kjo vepër shumë inspiruese i nxiti dhe i pasuron shumë të rinj që janë në kërkim për kuptimin e thellë

Digjem nga dëshira që t'u flas për ungjillin të gjithë atyre që duan të dëgjojnë. Momentalisht jam në magistraturën mbi bioetikën. Po, edhe unë i kam betejat e mia. Jam mëkatore dhe më duhet Shpërblyesi im. Por, e di se mund të bëj çdo gjë në Atë që jeton në mua.”

Xavier dëshmon për Megjugorjen

„Një herë më është dhënë rasti që me të vërtetë të kuptoj Sakramentin e pajtimit. Nuk është fjala për rrëfimin e mëkateve, por për pranimin e mëshirës së Zotit.

E takova shpirtërorin tim dhe i thashë: 'Do të isha e lumtur që të vij tek ju në rrëfim por dje jam rrëfyer në ushtrimet shpirtërore. Pra, nuk kam mëkat që do duhej ta rrëfej dhe ndjej se shkuarja e sërishme në rrëfim do të ishte grykësi shpirtërore.'

Shpirtërori im e ndjeu se kisha shikim të gabuar për atë Sakrament, dhe më tha diçka që do ta mbaj mend për tërë jetën: 'Nuk është e domosdoshme që të kemi diçka për të thënë, sepse të shkosh në rrëfim, para së gjithash, do të thotë të qëndrosh në rrëzë të kryqit të Jezusit që të mund të marrim mëshirën që rrjedh nga Zemra e tij.'

Prandaj e luta që të dëgjoj rrëfimi tim, edhe pse nuk e dija se çfarë do t'i them.

'Nëse ndjeni nevojën që të bëni diçka të tillë, pse jo?' – ma ktheu. Isha e lumtur se mund ta bëj këtë, e që me atë rast të mos e përgatis listën e gjatë të mëkateve të mia. Aty, e gjunjëzuar, e ndjeva se do të përjetoj diçka të fuqishme.

Thash: „Zotëri, po vij në rrëzë të kryqit tënd. Të lus për faljen e mëkateve të mia dhe vij të pranoj mëshirën tënde! Atëherë më përfshiu dashuria e Zotit deri në thellësi të qenies sime dhe ndjeva se si po them diçka që kurrë as nuk do ta mendoja: 'Të lutem më fal se nuk pata besim në ty.'“

dhe të qartë të jetës njerëzore mbi tokë, kuptimin që kërkon të jetë në harmoni me planin e krijuesit të tij. Meqenëse sot i mbështjell terri jo vetëm ligjet e Zoti, por edhe ligjet e natyrës, teologjia e trupit paraqet shpresën në betejën për kulturën e jetës! Gjon Pali II., shpjegon se si trupi fizik njerëzor ka një kuptim specifik dhe është në gjendje që të zbuloi përgjigjet mbi raportin tonë me vetë neve, si dhe me personat tjerë. Duke na ndihmuar që të kuptojmë lidhjen e ndërsjellë në mes të gjinive dhe misterin e krishterë të dashurisë, teologjia e trupit e Gjon Palit II., jo vetëm se ia hap rrugën martesës dhe familjes, por ia mundëson secilit që përsëri ta zbuloi kuptimin e ekzistimit të gjithëmbarshtëm dhe domethënien e jetës.

Instituti për teologjinë e trupit, Tel: 215-302-8200, (SHBA).

Për më shumë informata shikoni tobinstitute.org ose christopherwest.com/theologyofthebody

Duke i thënë këto fjalë, e kuptova menjëherë se me çfarë e kam lënduar më së shumti zemrën e Zotit. Gjithmonë, me kujdes i kam numëruar mëkatet e mia, një nga një, por tani kur e fitova të drejtën të mos them asgjë, në zemrën time u paraqit, një kuptim i papritur dhe i thellë e asaj që e ka pikëlluar Zotërinë. Dhe kjo është pikërisht ajo që e ka shkaktuar plagën e tij: vërtetë nuk kisha pasur besim në Të. Sa për gjëra të tjera Ai mërzitet më pak. Atë ditë e përjetova atë që njerëzit e quajnë pendim, dhe kjo është vuajtja që e kemi plagosur zemrën e Jezusit. Mëkatin tim e ndjeva në thellësinë më të madhe të vetes. Dhe ky ishte, pa dyshim, rrëfimi më i thellë në jetën time. Që t'ia tregoj mëkatin tim, Jezusi më thirri në rrëzë të kryqit të vet, pikërisht në atë vend ku mëkati ia ka shpuar zemrën, pikërisht në atë vend nga i cili Ai e derdh faljen e tij.“

„Të dashur fëmijë! Në lutje do të njihni gëzimin më të madh dhe daljen nga çdo peripeci pa rrugëdalje.“ (28. mars 1985.)

74

DHITË PA KUFÏ

Zoja i do barinj të e vegjël, dhe atë dashuri kurrë nuk e ka fshehur, nëse e marrim parasysht numrin e barinjve të cilëve u është shfaqur gjatë historisë.

Në kohën e regjistrimit të mbretit August, kur Jezusi lindi në Jude, pjesa më e urryer e popullsisë ishin barinj të që flinin jashtë. Zoti vërtetë i zgjodhi më të vegjlit ndër më të vegjël që të jenë dëshmitarë të lindjes së Birit të Tij. Njerëzit me siguri do të zgjidhnin persona me famë nga Betlehemi, persona që të gjithë i nderojnë. O, çfarë misteri i mrekullueshëm i lirisë së Zotit!

Pse barinj të? Në mesin e dhuratave që posedojnë, më duket se dallojnë ato të të jetuarit e udhëzimeve misterioze që Krishti u ka dhënë apostujve të vet kur i ka dërguar në mision: „Jini, prandaj, të mençur porsì gjarpërinj të dhe të thjeshtë porsì pëllumbat! (Mt 10,16) Që ta mbrojnë jetën e deleve dhe më këtë edhe ushqimin e njerëzve, kalonin orë të gjata, ditë e natë në 'shkollën e natyrës'. Shpirti i tyre ishte i pajisur me antena të posaçme, të afta për të zënë porosinë më të fshehura të Krijuesit. Bariu ishte njeri i jetës, ai i cili mbijeton, njeriu që të shpëton në çastin kur planet e të tjerëve, sado të përpunuara qofshin ato, nuk kanë sukses.

Më 1993., ishte luftë në Bosnje e Hercegovinë. Fshatra të tëra vuanin nga uria, e bombardimet ndiqnin njëra tjetrën. Serbët kishin shkelur gjithë territorin afër Konjicës, duke ndezur shtëpitë dhe vrrarë gjithë bagëtinë. Njerëzit që vinin nga SHBA në Megjugorje, kishin dëgjuar se fëmijët nuk kanë qumësht. Prandaj kishin vendosur që të rrisin numrin e bagëtive në atë regjion. Ofruan sasi të madhe parash për blerjen e dhive.¹⁶⁹ Por kush mund të gjente madje edhe tri dhi të vetme në tokën e shkretuar me zjarr e gjak? Kroacia fqinje ofronte dhinë me çmimin modest prej \$160 për copë! Amerikanët lokal, iu gëzuan blerjes së dhive dhe huazuan kamionët për bartjen e tyre, nga pesëdhjetë në kamion. Me qindra dhi duheshin shpërndarë në disa fshatra në Bosnje e Hercegovinë. Por, natyrisht, duhet të ekzistoi ndonjë 'pengesë' – ujku priste për dhinë. Në mes të Kroacisë dhe Bosnjë e Hercegovinës duhej kaluar nëpër kontrollin doganor dhe aty u ndal kamioni i parë. Doganierët nuk lejonin kalimin e bagëtive nëse nuk paguhet dogana. Dhe, dogana do të rriste çmimin e dhive gati për dy herë. A do të lejonte Zotëria që fshatarët në Bosnje e Hercegovinë të mbeten pa gjysmën e dhive?

¹⁶⁹ Dhia jep tri të katërtat e litrit qumësht ditë, por ai qumësht është më i shëndoshë se i lopës.

Bariu, që ishte në afërsi, dëgjoi se çfarë po ndodhte. Edhe ai vetë ishte nga Hercegovina. Pasi që i kishte vuajtur vështirësitë e jetës në atë regjion shterp pranë kufirit, nuk ishte më njëzetvjeçari i naiv. Ai qeshi. Para se shenja e alarmit të arrinte në SHBA, duke shkaktuar ankth e hutë, bariu vlerësoi situatën në mënyrë precize dhe pa bujë të madhe ofroi ndihmë. U bëri me shenjë vozitësve që të kthehen dhe ta përcillnin në rrugën e ngushtë e të rrezikshme. Pamja ishte madhështore. Kodrat e egra tregonin gurët e zhveshur me shkurret e tyre dhe paralajmëronin skutat misterioze. Kjo tokë ishte parajsë për dhinë. Bariu buzëqeshte. Krejtësisht i qetë, ai kishte planin e vet. U tha Amerikanëve se do të shkoj përpara dhe do të jetë në kodër përballë tyre. Posa ta shohin në kodër, duhet, që vetëm, ta hapin derën e kamionit.

Kështu miqtë tanë, të dalë nga universitetet më të mira amerikane, panë skenën e jetës së tyre.¹⁷⁰ Nga larg, bariu filloi të vërshëllejë, kurse dhinë, në harmoni të përsosur kërcenin nga kamioni, pesë nga pesë, dhe vraponin drejt tij, duke kaluar në Hercegovinë! S'ka dyshim se kufijtë janë për njerëz e jo për dhi.

Atë ditë fshatrat patën festë. Arritën dhinë! Do të mund të mbijetohet, fëmijët do të kenë qumësht.

Dua mëshirën

Për shkak të skrupullave të zbrazëta, hezitaja ta tregoj anekdotën e sipërme, por skrupullat nuk më mundën. Vërtetë, më kujtohet një ndodhi e ngjashme. Një të shtunë, kur nxënësit e Jezusit ecnin fushave, këpusnin kallinj. Ishin të uritur! Misioni është në vendin e parë për Jezusin: zjarri për shpirtrat i tejkalon nevojat e stomakut. Hahet kur lejon koha, e kur koha nuk lejon, misioni vazhdon pa ushqim. Kësaj rralle kishin rastin të hanë 'kalimthi', por ishte e ndaluar korrja të shtunën. Farisenjtë, tejet të lumtur se e zunë Jezusin në këtë pikë të Ligjit, e qortuan se u lejoi nxënësve që ta prishin të shtunën. Sa i mrekullueshëm është Jezusi sepse, pikërisht si bariu i dhive tona, i vendos gjërat në perspektivën e duhur, para syve të gjithë atyre ekspertëve të drejtësisë që janë aq të hendikepuar në zemrën e tyre: „Ta kishit kuptuar se ç'do të thotë fjala: *'Dua mëshirën e jo flinë'*, nuk i kishit dënuar këta njerëz që s'po bëjnë faj. Biri i njeriut është me të vërtetë i zoti i të shtunës!“ (Mt 12:1-8)¹⁷¹

Faleminderit Zotit, ligji është për njeriun e jo njeriu për ligjin. Ligji, në kohë lufte dhe në mes të bombardimit, është ligji i mbijetesës!

¹⁷⁰ Kjo më përkujton anekdotën që e ka treguar msgr. MacDonald, ipeshkvi nga Kanadaja, në kohën e shtegimit të tij, këtu në Megjugorje, në shtatorin e vitit 2005. Shpirtërori i tij, në seminar, kishte pesë doktoratura: nga teologjia, nga literatura, nga ligji kishtar, nga filozofia dhe nga Shkrimi shenjt, plus dy magjistratura. Prindërit e tij kishin prejardhje shumë të thjeshtë. Mezi dinin të lexojnë e shkruajnë, dhe jetonin në fermën e tyre të vogël. Mirëpo, ky shkencëtar iu besua një ditë MacDonald-it: „Mezi pres të shkoj në pushim te familja ime. Më duhet ta dëgjoj babën tim, ai është i urtë!“

¹⁷¹ Lexoni tregimin për Davidin i cili për trupat e tij të uritura mori bukët e kushtuara që vetëm priftërinjtë guxonin t'i hanin (1 Sam 21,1-6) — tregimi për të cilin Jezusi u tërhoqi vërejtjen farisenjve (Mt 12,3-4).

„Të dashur fëmijë! Edhe sot ju thërras në lutje. Fëmijëz, besoni se me lutje të thjeshtë mund të bëhen çudira. Me lutjen tuaj ju i hapni zemrën Zotit dhe Ai bën mrekulli në jetën tuaj. Duke parë frytet zemra juaj mbushet me gëzim dhe falënderim ndaj Zotit për të gjitha që i bën në jetën tuaj, nëpërmjet jush dhe nëpërmjet të tjerëve. Lutuni dhe besoni fëmijëz, Zoti ju jep hire e ju nuk i shihni. Lutuni dhe do t' i shihni. Le të jetë e mbushur dita juaj me lutje dhe falënderim për të gjitha që ua jep Zoti. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime.“ (25. tetor 2002.)

75

ZOTI QË SHUMON

Megjugorje, Krishtlindjet e vitit 2003.

Ishte goxha vonë. Numri i mysafirëve që vinin për darkë filloi të zvogëlohet. Chrissey më shtyri me bërryl dhe më pëshpëriti: „A e sheh atë enë me mish zogu?“

E shikova me kujdes enën, duke thithur erën e këndshme që zgjerohej prej sajë. Era që vinte nga zogu i pjekur në mënyrë të përsosur me erëza të ndryshme.

„Po ky është zogu më i shijshëm që kam ngrënë ndonjë herë. Ata sigurisht nuk i kanë kursyer erëzat. Si të ishim në Indi!“

„Shiko edhe një herë, motër Emmanuel! A nuk e vërejte?“

Chrissey, ndihmësja ime në Megjugorje, Atë pasdite erdhi më herët që t' i ndihmoi familjes së miqve tanë në përgatitjen e ushqimit festiv për nja tridhjetë vetë. Ushqime të shumta: perime të freskëta, mish, perime të ziera dhe ëmbëlsira të ndryshme. Kurse mish zogu kishte mjaft për dyzet njerëz të uritur. Mirëpo, në Megjugorje është mirë të merret parasysht një dukuri që ndodh kur thirren pjesëtarët e komunitetit vendas. Ata nganjëherë vijnë me miq të tjerë të cilët sjellin me vete mysafirët që nuk mund t' i lënë vetëm në shtëpi. Si do që të jetë, në këtë kremtim feste erdhën tridhjetë mysafir të ftuar, dhe së bashku me ta më së paku edhe dyzet të tjerë të paftuar!

Chrissey shikonte me dyshim, jo mysafirët por, ushqimin që servohej.

„Do të mungoi ushqimi! Do jetë katastrofë – çfarë turpi, për Krishtlindje!“

Për befasinë e saj vërejtë se zonja e shtëpisë nuk ishte e shqetësuar dhe secilin e pranonte me mirëseardhje të ngrohtë. Pastaj i çonte te pijet dhe u thoshte që të shërbehen aq sa kanë dëshirë! Duke u përgjigjur në pyetjen brengosëse të Chrissey, ajo thjeshtë i ngriti duart drejt qiellit, rrudhi me krahë dhe u përgjigj e shkujdesur: „Ky është problem i Zojës jo imi! Ajo i fton sonte!“ Ajo gjithmonë mendon me shumicë dhe kjo e bën të lavdishme! Por, ashtu si i Biri, Jezusi, ajo jep

ashtu si ka planifikuar. Kjo është, po ashtu, me rëndësi. E gjitha që duhet të bëni është t'i lëshoni gjërat të shkojnë ashtu si shkojnë. Por vetëm atëherë kur me dashuri të keni bërë çdo gjë që është në mundësitë tuaja. Kjo është e qartë!

Atë mbrëmje – duke iu falënderuar Zojës dhe fëmijës së vogël Jezusit – gëzimi i Krishtlindjes shpërthente në të gjitha bisedat, këngët, dëshmitë. Të gjitha këto shkonin mirë. *Askush madje as nuk e vërejtë se si u shumua mishi, patatet e pjekura. Grosha, dhe gjitha ushqimet tjera.* Ashtu si shkruan në ungjill, të gjithë u nginë. Ndoshta ngrënë pak më shumë se deri sa u nginë – sepse ishte Krishtlindje! Edhe pse nuk tepruan disa shporta me ushqim, megjithatë teproi mjaft që të mbushen strajcat e atyre më të varfërve. Vetëm ata që i kanë përgatitur të gjitha e dinin se çfarë bëri Zotëria, kurse ne e dimë nga ungjilli se Ai do ta bëjë këtë edhe në të ardhmen, deri sa të kthehet me lavdi në tokë.

Kur Elia profet, papritmas, hyri në shtëpinë e vejushës në Sareptë dhe kërkoi që ajo t'i përgatisë diçka për të ngrënë, ajo kishte pikërisht aq vaj dhe miell për vete dhe për të birin. Nuk kishte më për ditët që vinin. Megjithatë ajo nuk e privoi nga kulaçi që ai kërkonte. Vërtetë, u desh që profeti ta bind sepse mendonte se do të vdiste me të birin kur të harxhohet ata pak ushqim që kishte.¹⁷² Në këtë pikë ajo nuk kishte të drejtë. Megjithatë, ne mund ta kuptojmë – Jezusi ende nuk kishte ardhur dhe predikuar. Ai do të thoshte më vonë: „Jepni e do t'ju jepet: masë e mirë, e dendur, e tundur, me grumbull do t'ju jepet nën sqetullën tuaj: sepse me atë masë që të matni, do t'ju matet edhe juve në kthim.“¹⁷³

Do ta ndaj me ta!

Më kujtohet një rast i vështirë në Megjugorje në pranverën e vitit 1992., që e kam regjistruar atëherë. Posa lufta kishte filluar ta shkatërronte Hercegovinën, dhe i gjithë fshati ishte pa rrymë elektrike, pa ujë, dhe pa gjëra të tjera që ne, përndryshe, i marrim si diçka që duhet të jetë.

Një ditë më telefonoi miku ynë i dashur Josipi nga fshati Sivriq dhe më tha: „Motër, ju lutem, ma huazoni gjeneratorin tuaj. Kam në frigorifer disa ushqime, që do të prishen!“

E dija se, pikërisht para konfliktit, Josipi e kishte prerë viçin që të ushqejë familjen e vet gjashtë anëtarëshe, prej tyre dy të moshuar. Ai mish duhej të zgjasë disa javë, prandaj me të shpejtë ia dhashë gjeneratorin që të shërbehet me të.

¹⁷² 1 Mbr 17,7-16.

¹⁷³ Lk 6,38. (Po ashtu shikoni shumimin e vajit te Elia: 2 Mbr 4,1-7.)

Një muaj më vonë, kur na mungonte ushqimi, shkova tek Josipi dhe familja e tij. Më ftuan që të rri për darkë. I thash: „Do të rri! Nuk është mirë për shkak të orës policore por sonte është hëna e plotë dhe nuk do t’i ndez dritat e makinës kur të kthehem në shtëpi.“ Në darkë, nuk munda t’iu besoja syve – në tavolinë sollën mish!

„Josip,“ klitha, „duhet të jesh i vetmi në fshat që ende ka mish! Si është e mundur?“

Josipi u përgjigj me butësinë dhe përvujtërinë që kurrë nuk do ta harroj: „Motër, a ju kujtohet ai viçi që e preva para lufte?“

„Po! Absolutisht!“

„Pra, prej se i mora refugjatët në shtëpinë time, çdo mbrëmje shkoja te frigoriferi që të marr mish për nesër dhe...“

Shtriu duart, si të donte të thoshte: „Nuk mund ta shpjegoj!“

„Pasi që merrja një copë, herën tjetër aty gjeja të njëjtën sasi mishi! Nuk kuptoj. Ja kështu është.“

Rrija aty, haja mish të shijshëm dhe shkruaja atë që Josipi pikërisht tha, duke u përpjekur që t’i përmbaja lotët, mendoja për atë se si është ushqyer familja e tij, dhe si ushqehen të varfëritë. Atmosfera ishte serioze por jo e rëndë. Kur i futa nën kontroll ndjenjat e mia, duke pëshpëritur e pyeta Josipin: „Po ti, a han shumë nga ky mish?“

„Motër, kur i takova këta refugjat në rrugë, pa asgjë – shtëpia e tyre në Bijelo Pole ishte djegur deri në themel – i solla në shtëpi dhe i thash vetes: 'Këta njerëz kanë humbur çdo gjë'¹⁷⁴, kurse unë ende e kam shtëpinë time. Nuk do të ndaj asgjë për familjen time. Të gjitha që i kam do t’i ndaj me ta. Kur t’i humbim të gjitha askush nuk do të ketë asgjë! Tani më, ka kaluar një muaj dhe unë, edhe për drekë edhe për darkë, me atë mish ushqej edhe familjen time edhe refugjatët. Ne jemi gjashtë, kurse ata shtatë. Krejtësisht trembëdhjetë. Por, janë edhe fqinjët, motër... Ata e dinë se e kam gjeneratorin, dhe vijnë me qese në dorë. Nuk mund t’i lëshoj pa asgjë. Edhe ata kanë fëmijë. E të gjithë ne jemi besimtarë! Pra edhe atyre ju jap pak mish. Motër, nuk mund ta merrni me mend se sa mish kemi marrë nga frigoriferi që kur ka filluar lufta. Disa lopë nuk do të mjaftonin për të na furnizuar me këtë sasi mishi. *Kështu është, motër!*«

Dhe Josipi i shtoi kësaj lutje – diçka që është themelore për të gjithë besimtarët kroatë – që në mënyrë aq të mirë e zbulon themelin e kësaj dashurie heroike në kohën e asaj mungese ushqimi: *Ruaje Zot!*

¹⁷⁴ Në kohën e bombardimeve, kur fshati i tyre u rrafshua me tokë, ata mundën të ikin vetëm me rrobat që kishin në trup. Pas vitesh të tmerrshme vuajtjeje, fshati i tyre u rindërtua dhe, përfundimisht, ata u kthyen në shtëpi.

„Të dashur fëmijë! Edhe këtë herë ju thërras në lutje. Lutuni që të mund të kuptoni se çfarë do të ju thotë Zoti nëpërmes të pranisë sime dhe nëpërmes të porosive që ju drejtoj. Dua që të gjithëve të ju afrojmë sa më tepër Jezusit dhe zemrës së tij të plagosur, që të mund ta kuptoni dashurinë e pamasë që u dhurua për secilin nga ju. Prandaj, fëmijë të dashur, lutuni që nga zemrat tuaja të rrjedh burimi i dashurisë në secilin njeri, edhe në atë që ju urren e përbuz. Kështu, me dashurinë e Jezusit, do të mund ta mposhtni gjithë mjerimin e kësaj bote të pikëlluar, që është pa shpresë për ata që nuk e njohin Jezusin. Ju faleminderit për të gjitha flitë dhe lutjet. Lutuni që të mund të ju ndihmoj. Më duhen lutjet tuaja.“ (25. nëntor 1991.)

76

MARTA ROBIN, ENGJËLLI KUNDËR VETËVRASJES

Kisha privilegjin që personalisht të takohem me Marta Robin. Herën e fundit që e pashë, atë Finet më çojë që të jem e pranishme kur Marta merr kungimin e saj javor. Me ne ishte edhe një anëtar i bashkësisë Foyer de Charité. Në intimitetin e kësaj ngjarje madhështore, e lutëm me të një rruzare. Pasi që thamë disa qëllime kryesore për Kishën dhe botën, Marta në adhurim të heshtur mori kungimin shenjt, dhe ne u larguam. Mund të thuhet se posa Marta mori kungimin, kaloi në ekstazë. Ishte e ndaluar që të luten me të misteret e mundimit sepse kjo do të shkaktonte që ajo menjëherë të kalonte në ekstazë me dhimbje.

Atë ditë Marta më ndihmoi që të prek realitetin tjetër. Kjo ishte diçka që më vonë, në Megjugorje, do bëhej ushqimi im i përditshëm: kuptimi se mbinatyrorja është vërtetë natyrore për të gjithë ata që e duan Zotin!

Nganjëherë Jezusi i tregonte Atë Finet-it mungesën e durimit të tij. Plot dashuri për Martën, nuk priste që të përfundoi lutja „O Zot, nuk jam e denjë që të hysh nën pullazin tim, por thuaje vetëm një fjalë e shpirti im do të shërohet“, por do të fluturonte nga dora e meshtarit të tij, deri te goja e Martës!

Marta e shihte Zotin dhe shpirtrat në mënyrë të mahnitshme.

Një ditë një grua shumë e pasur hyri në dhomën e Martës. Kjo grua ishte shumë e pashme dhe fliste bukur. Me shumë sukses sillej në rrethet kulturore. Posa shkeli në dhomën e saj Marta

bërtiti: „Oh, zonjë, keni shpirt aq të tmerrshëm!“¹⁷⁵ Qartë, kjo zonjë u shokua si kurrë më parë në jetë! Mirëpo, duke iu falënderuar lutjeve të Martës, ajo më vonë filloi të kthehet.

Një herë tjetër, një mike imja e vizitoi Martën për herë të parë. Në çastin kur ishte te dera, Marta u gëzua singërisht dhe klithi: „Chantal, eja shpejt e më puth!“ (Duhet ditur se u desh të ishim shumë të kujdesshme sepse goditja më e vogël e shtratit të saj i rriste dhembjet e saj.)

Marta kishte një vend të veçantë në zemër për Chantal dhe në mes tyre u zhvillua një miqësi shumë e afërt. Pse pikërisht ajo? Ky është mister i Mbretit. Në të vërtetë Chantal ishte shumë mëshirshme ndaj të braktisurve, ashtu si edhe ndaj më të pasurve – ndoshta ky mund të jetë shkaku.

Një ditë atë Finet-it iu desh të udhëtoi me aeroplan një tjetër kontinent dhe e angazhoi një meshtar tjetër që Martës të ja japë kungimin shenjt. Ai meshtar u ul pranë Martës. Filloi të lusë rruzaren me të kur ajo e ndërpreu: „Atë, Jezusi nuk është këtu!“ Meshtari filloi ta bind: „Po, Marte, Jezusi është këtu. E kam sjellë bartësin me kungim.“

„Jezusi nuk është këtu“, insistonte Marta.

Kështu meshtari hoqi bartësin që e kishte varë në qafë dhe e hapi. „Oh, Marta, ke të drejtë! Zoti im, kam harruar që në mëngjes ta marr hosten!“

Ky perceptim i pranisë së vërtetë të Krishtit në hosten shenjte për mua ka qenë gjithmonë diçka e mahnitshme. Fatkeqësisht, satanistët, po ashtu, mund të dinë se a është e shuguruar hostja. Por atyre iu flet djalli. Ai i ka ruajtur karakteristikat engjëjlore. Engjëjt, të mirë ose të këqij, e dinë ku është Jezusi. Djalli do ta përqueshte satanistin i cili do të ja sillte hosten e pa shuguruar që ta

¹⁷⁵ Kjo na përkujton shën Katarinën e Sienës. Një ditë ajo takoi një zonjë nga shoqëria e lartë që të gjithë mahnitëshin pas saj në Itali. Zonja arriti e veshur në mënyrë luksoze, shumë e parfumosur, e gjitha mbuluar me stoli. Posa hyri në dhomë, Katarinës i erdhi për të vjellë dhe i ra të fikët para asaj gruaje. Më vonë Katarina kishte shkruar se nuk kishte mundur të durojë kundërmimin e papastërtisë së shpirtit të asaj gruaje! Shën Katarina shpesh ka mundur të shohë gjendjen e shpirtit të personit, dhe nganjëherë, nëse shpirti nuk ka qenë në gjendjen e hirit, kundërmonte tmerrshëm. Jezusi i ka dhënë Katarinës këtë karizmë të veçantë që t’ia mundësojë asaj për ti ndihmuar atij shpirti për t’u kthyer, për të ndërruar jetën dhe vijë te Zotit. Dhe përsëri, atje ku bota i mahnitet aq shumë ndonjë rrugë vdekjeprurëse, shenjtëresha e madhe i lejon Jezusit që nëpërmes saj të tregoi dhimbjen e tij për humbjen e jetës.

Edhe Padre Pio ishte shumë i vrazhdë ndaj njerëzve të cilët të lumtur kanë notuar në mëkate. Njeriu i cili me ndërmjetësimin e atë Pios më vonë u shërua plotësisht, kurse ishte në fazën e fundit të karcinomit, ka treguar se me rastin e takimit të parë me atë Pion, ai i kishte thënë se është ‘shumë i papastër’ dhe se duhet të shkojë e të përgatitet për vdekje!

Lexoni librin: John A. Schug, OFM, Cap, *A Padre Pio Profile*, 146-47 (St. Bede's Publications 1987).

përdhos. Marta ishte në gjendje që t'i shohë këto realitete të fshehura që ne nuk i shohim. Në çdo çast zemra e saj është përpjekur që ta 'shpëtoi' Jezusin eukaristik me flijim dhe adhurim.

Sa më takon mua, unë, shpesh, ia kam zënë për të madhe Jezusit dhe i kem thënë: „Zotëri, më ke marrë për të fejuarën tënde e unë as nuk jam në gjendje të dalloj a gjendesh apo jo në tabernakull! A thua se e fejuara nuk e njeh trupin e të fejuarit të saj? Çfarë e fejuare jam unë, Jezus, nëse nuk mund ta dalloj a është ai trupi yt apo një copë buke?“

E di se nuk jam e vetmuar në këtë pikë. Njoh shumë meshtarë dhe rregulltarë të shenjtë që nuk qëndrojnë më mirë se unë në njohjen e hostes së shuguruar. Megjithatë jam e pikëlluar se nuk s di ku gjendet i Fejuari im. Por, është e sigurt se nuk më duhet ky pikëllim. Jezusi e lejon këtë që të më mbaj në përvujtëri sepse do të isha plotësisht e aftë për ta keqpërdorur atë dhuratë dhe të bija në mëkatën e mendjemadhësisë. I mjeri Jezus! Ai e privon veten duke mos na e dhënë këtë. Ai na kursen nga terreni i rrëshqitshëm!

Ti, Spanjolle!

Marta bashkë ndjente thellë me personat që vuanin! Ajo, nga largësia mund të ndjente vuajtjen e tyre dhe të vuante me ta, të ndërmjetësonte ditë e natë për më të rrezikuarit. Kjo vlen sidomos për ata që ishin në buzë të ferrit. Ajo madje e kishte lutur Jezusin që t'i lejonte të rrijë në derën e ferrit, që të mund t'i bindte ata shpirtra që të mos shkojnë atje. Kur dikush ia besonte personin në vështirësi ajo kurrë nuk e braktiste. Nëse do të ktheheshit njëzet vite më vonë te ajo, do të ju pyeste me zërin e hollë si të fëmijës: „Po filan fisheku, si është tani?“

Sidomos ishte e dhënë pas fëmijëve dhe të varfërve. I shihte të thyer nën peshën e vrazhdësisë së botës, të ligësisë dhe ftohtësisë njerëzore që është tipike për shoqërinë tonë materialiste. Në mënyrë mistike ishte e aftë të shohë me mijëra vetëvrasje që ndodhin. Sidomos shihte se si të rinjtë i mundon zbrastësia e brendshme. I shoqëronte në agoninë e tyre dhe ndërmjetësonte për ta.

Një ditë, mikes sonë të mirë Estelle Sabatin dhe atë Mantea Bonamy, që janë shumë të afërt me bashkësinë time, u kishte thënë diçka që vërtetë do të ishte e pabesueshme po të mos ishte karizma e Padre Pios. Marta tha: „Nëse shihni dikë që dëshiron të bëjë vetëvrasje, i thoni të më thërrasë në zemrën e vet dhe unë do të vij e do t'i ndihmoj!“ Estelle nuk lejoi që ky margaritar të zhytet në harresë.

Disa vjet më vonë një grua e re dhe e dëshpëruar u shemb në duart e Estelles. Pa familje, e hedhur nga një institucion në tjetrin në rrethinat e Parisit. Zemra e mjerë e Lorettës rridhte gjak që nga lindja. Pasi e kishte dëgjuar fjalën familje, kishte ëndërruar se edhe ajo e ka të sajën, por dukej se çdo gjë ishte kurdisur kundër saj. E thyer nga frustrimi, sepse për shkak të mjerimit të saj, të gjitha dyert i mbylleshin para syve, nuk shihte arsye të vazhdojë jetën. Estelle bëri çdo gjë që diti për ta ngushëlluar dhe ndihmuar. I foli për Zotërinë dhe ia zbuloi margaritarin e saj të

çmueshëm. Marta duhet të intervenojë! I tha: „Kam një mike të mirë, afër Valencës, dhe quhet Marta. Ajo është shumë e afërt me Zotin. Është shenjtëreshë e vërtetë dhe Zoti i ka dhënë një dhuratë shumë të rrallë – kur dikush vendos të bëjë vetëvrasje, mund ta thërras në ndihmë. Ajo ndjen zërin e tij në zemër dhe i vjen në ndihmë. Pra, mbaje në mend këtë, në rregull? Nëse sheh se je afër për të bërë ndonjë punë budallaqe, thirre, dhe ajo do të vij!“

Ajo grua nuk kishte asnjë arsimim fetar, por si të mjerët e vërtetë, zemra e saj e pa robëruar dinte si të përgjigjej në vetitë e Zotit: mirësinë, bukurinë, dëshirën për t’i ndihmuar dikujt në vështirësi. Në mënyrën e vet ajo, diku thellë në vete, e bartte atë informatë dhe me pak më shumë guxim vazhdoi udhëtimin e saj të vështirë në jetë. Por një ditë, e mashtruar nga një njeri i cili mezi qëndronte pak më mirë se ajo, mbeti shtatzënë dhe e braktisur. Mirëpo, luftonte ta mbajë fëmijën e saj përkundër të gjitha presioneve që mund t’i marrim me mend të cilat ishin lëshuar mbi të sepse, mendonte, se ky do të ishte fillimi i familjes së saj të vërtetë, ajo krijesë e vogël – fëmija i saj! Por kjo ishte edhe një goditje e re! Shërbimet përgjegjëse gjykuan s është shumë e varfër për ta ngritur fëmijën. Ia morën vajzën e saj të vogël dhe e vendosën në institucionin në rrethinën e Oise. Kishte të drejta shumë të kufizuar për vizita. “Vogëlushen” e saj do ta edukojnë të huajt por, jo mirë.

Kaluan dy vite. Lorette kishte shpresë se do t’ia kthenin vajzën, por papunësia e saj kronike dhe mungesa e adresës së caktuar e pamundësonin këtë.

Pasi që përsëri qiti kërkesë për ta marrë vajzën, i thanë se ka shumë pak shpresë për këtë. Çka është tepër, është tepër dhe Lorette plasi. Natën nuk mund të flinte e ditën bridhte rrugëve pa cak. Ndjehej e shqyer, e copëtuar dhe e dëshpëruar. Një mëngjes herët u nis, si robot, drejt urës Pont des Arts. Parisi ende flinte. Nuk kishte njeri në horizont. Lorette filloi të ngjitej në gardhin e urës për t’u hedhur në lumin Seine. Pa e ngritur këmbën tjetër dhe papritmas, si rrufeja, i erdhi në mendje biseda me Estelle.

„Oh, zonja e Estellës,“ mendoi. „Shenjtëresha. Pse mos ta thërras?“ Por Lorette e kishte harruar emrin e saj. E tradhtoi pagjumësia. Megjithatë iu kujtua një hollësi. Ajo zonjë jetonte pranë Valencës! Duke ndërruar qytezën e vogël franceze me qytetin e Spanjës, Lorette bërtiti me sa zë që kishte: „Ti, Spanjolle nga Valenca, eja më ndihmo!“

Në çast Marta ishte aty! Edhe pse e padukshme për Lorettën, Marta me kujdes amënor bëri që Loretta të qëndroi në të dy këmbët dhe të ulet. Lorette u qetësua. Papritmas i erdhi në kujtesë pamja e fëmijës së saj. „Të vdesësh? Jo, kjo nuk është zgjedhje,“ mendoi. „Mirë, pse nuk shkoj në Compiègne për të vizituar vajzën time? Sot është e shtunë. Kështu nuk do të mendoj në gjëra të tjera.“

Lorette nuk kishte asnjë para në xhep. Si do qoftë, hekurudha nëntokësore për të ishte tepër e shtrenjtë. Filloi të ecë. Shkonte kah veriu i Parisit dhe sa më shumë që ecte aq më shumë i

kthehej forca. „Po“, mendoj me një qetësi të pazakontë, „është ide e mirë ta vizitoj vogëlushen time!“

Kur arriti në buzë të Parisit, provojë të ndaloj makinat. Një prej tyre u ndal. i buzëqeshi njeriut dhe e pyeti: „A shkoni në Compiègne?“

„Po! Hyni!“

Në automobil ishte heshtje e tmerrshme por njeriu dukej i butë, nuk ndikonte në të prania e saj, nuk i pengonte. Pas një kohe, e pyeti: „Shkoni në qendër të Compiègne?“

„O... jo, edhe ndonjë kilometër më tutje, por mund të zbres në Compiègne. Është në rregull për mua. Do të gjendem!“

„Unë shkoj në Mortefontaine.“

„Mortefontaine? Po edhe unë shkoj aty afër!“

„Mirë. Atëherë do të çoj atje. Nuk ka problem fare.“

Dhe kështu Lorette ia besoi fshehtësinë e saj këtij njeriu. Kishte ndërmend të kaloi ditën me vogëlushen e saj që ia kishin marrë. Jeta ishte e vështirë por, vajza ishte çdo gjë për të.

„A kthehesh sonte në Paris?“, e pyeti njeriu.

„Sonte? Po, në mënyrë të njëjtë. Do ta ndaloj ndonjë makinë para muzgut. Jam mësuar me këtë!“

„Jo, jo! Edhe mua më duhet të kthehem kah ora shtatë në Paris. Do vij t’ju marr. Kjo do të jetë më thjeshtë“

Pas disa vitesh Estelle rastësisht takoi Loretten në bulevardin e Parisit. Kjo ishte një prej atyre ditëve të hirit kur vetëm Qielli di si të planifikoi diçka. Lorette i tregoi për atë udhëtim dhe për ato që pasuan.

„Pra“, tha Estelle. „Atë mbrëmje, zonjusha Lorette e pati madje vozitësin që e çoi në shtëpi! Dhe çfarë ndodhi pastaj?“

„Pastaj ... kaluam mirë së bashku. Edhe ai e kishte jetën e vështirë. Ishte vërtetë i mirë për mua.“

„Po pastaj...?“

„Pastaj u kurorëzuam. Dhe Munda ta marr vajzën time. Ja, shiko, kam disa fotografi.“

Disa muaj më vonë Estelle vizitoi Martën dhe i tregoi historinë e Loretës. Martës iu kujtua saktësisht ai mëngjes në urën Pont des Arts. Iu kujtua ajo dele që gjakderdhte dhe thërriste në ndihmë për shkak të peshës së rëndë të jetës, dhe e cila ishte në gjendje të bënte punë shumë më të mira në jetë se të jetë e përpirë në lumin Seine!

Ka me mijëra Loretta në këtë botë, sidomos në fazën para suidale. Por ka aq pak Marta! Kush prej nesh do të çohet e të punoi me Martën dhe të ndihmoi, ashtu që të rritet numri i atyre që mbijetojnë gjendjen e dëshpërimit!¹⁷⁶

¹⁷⁶ Pas vdekjes së Martës kanë arritur me mijëra dëshmi që vërtetojnë ndërmjetësimin e pabesueshëm të saj nga qielli. Ky është shiu i mëshirës që bie!

„Të dashur fëmijë! Edhe sot falënderoj Zotërinë për të gjitha që mi bën, sidomos për dhuratën që edhe sot të mund të jem me ju. Të dashur fëmijë, këto janë ditët në të cilat Ati u jep hire të posaçme të gjithëve që e hapin zemrën. Unë ju bekoj dhe dëshiroj që edhe ju, të dashur fëmijë, t'i njihni hiret dhe të vëni çdo gjë në dorë të Zotit, që të lavdërohet nëpërmes jush. Zemra ime përcjell me kujdes çdo hap tuajin. “ (25. dhjetor 1986.)

77

HAPI I FUNDIT

Kathleen kishte shtrydhur edhe pikën e fundit të energjisë nga trupi. Ishte çudi se si ende qëndronte në këmbë! Duke shkuar në programin e mbrëmjes në kishën e Shën Jakobit, shtonte lutjet e saj, citonte akte feje, shprese dhe dashurie sepse shikuar nga perspektiva njerëzore, e kishte të pamundur të vazhdonte tutje. E dinte se atë mbrëmje nuk kishte forcën e duhur të shkonte në kodrën Krizhevac me Bashkësinë e atë Lucianit. Po ashtu e dinte se “Zoti na jep çdo gjë që na duhet që ta kryejmë vullnetin e Tij”¹⁷⁷ Prandaj edhe iu dorëzua që të mos rrëzohet.

Ishte dimri i vitit 1991., dhe në ora 20 përfundoi rruzarja e fundit, kurse kisha filloi të zbrazet. Kathleen dhe vëllezërit nga Bashkësia u tubuan rreth atë Lucianit të palodhshëm. Dhe një herë do të shkojnë si zakonisht në udhën e tyre të kryqit që e bënë natën. Ajo ngjitje ishte e njohur mirë për ta. Ishte pjesë e formimit të tyre. E dinin se nuk do të shkonin në shtrat para orës një të mëngjesit. Pastaj në ora gjashtë do të bie zilja për lutje. Atëherë – mrekullisht – atë Luciani iu drejtua Kathleen e i tha: „Ti sonte nuk duhet të vish në kodër. E di se je e lodhur! Nëse do, mund të shkosh në shtrat më herët!“

Zemra e Kathleen u shkri nga lehtësimi. Jo vetëm se mund të shkonte në shtrat, por mund ta bënte këtë me bekimin e dëgjësës! Më në fund mund të ketë pak më shumë kohë për vete, vetëm në shtëpi! Kjo ishte për të një ëndërr e realizuar!

Kathleen jetonte në hotelin e vogël familjar të Anka Jerkoviq-it që e kishte marrë me qira atë Luciano. Ky françeskan shumë i gëzuar nga Italia, përgatiste bashkësinë e djelmoshave duke iu ofruar akomodim gjashtë mujor në Megjugorje ku ata mendonin dhe luteshin për të zbuluar thirrjen e tyre në jetë. Disa ndjenin se janë të thirrur në martesë, disa në meshtari, e të tjerët në thirrje të ndryshme. Kathleen ishte në rolin e ‘nënës së shtëpisë’ për këtë bashkësi.

¹⁷⁷ Shën Gjoni i Kryqit

„Çfarë bën nëna e dhjetë ose njëzet djelmohave të rritur?“ – e pyeta një ditë. Duket se para „punës“ duhet të ofroi praninë e zemrës – një zemre të kujdesshme që mund t’i qasesh lehtë sepse shumë nga këta djelmoha kanë nevojë që dikush t’i dëgjojë, t’i ngushëllojë dhe t’i trimërojë. Kathleen kujdesej që punët e përditshme të shtëpisë, nga aspekti ekonomik, të kryhen lehtësisht që në kohën e pushtetit komunist, shpesh krijonte kokë dhimbje të vërtetë. Për disa muaj rresht Kathleen mund të flinte vetëm tre katër orë në natë, por përpiquej të mos numëronte!

Atë mbrëmje Kathleen arriti në hotelin e Jerkoviqëve që ishte tre katesh. Bashkësia zinte dy katet e para, dhoma e saj ishte në të dytin. Kapela ishte në të tretin, së bashku me dhomat tjera të rezervuara për shtegtarët.

“A thua mendimi për shtratin po e qet gjithë lodhjen në sipërfaqe?“ pyetej Kathleen. Zvarritej shkallëve. Çdo hap dukej si një gur i madh që duhej mposhtur dhe deshi të heq dorë. Vetëm mendimi në shtratin e saj të dashur i jepte fuqi që të ngjitej në katin e parë. Me lodhjen e saj tejet të madhe, ajo zvarriste trupin shkallëve. Ajo vazhdoi të ngjiste shkallët që e çonin në dhomën e saj. Kur i mbetën vetëm disa sosh, një mendim i kaloi nëpër kokë. Ishin fjalët që Zoja i kishte drejtuar grupit të lutjes: „Kur jeni të sflitur dhe nuk mund të bëni më asgjë, gjunjëzohuni dhe lutni Atin Qiellor që t’ju krijoj përsëri. Ai do ta bëjë këtë.“

Kur këto fjalë ju imponuan zemrës së saj, ajo filloi të diskutoi me Zojën: „Nënë! Unë vërtetë besoj në këto fjalë, por, shih, sonte nuk kanë të bëjnë me mua! Më pret shtrati dhe po shkoj të shtrihem!“

Kathleen provojë të largojë porosinë nga mendja dhe të përqendrohet në shtrat. Por porosia nuk donte të largohej prej zemrës së saj. Kishte bërë çerdhen aty! Kathleen atëherë filloi të lusë Zojën: „Nënë, vërtetë dëshiroj të shkoj në shtrat! Dua të fle. Do të shohim nesër!“

Sado që bëhej e shurdhër Kathleen, e ndjente, në zemër, se Zoja po e thërret. A do të mund ta refuzojë për kohë të gjatë me ‘Jo- në’ e saj? Dialogu nxehej sepse Zoja nuk është grua që dorëzohet lehtë dhe na lejon që të bëjmë ashtu si duam vetë. Ajo na do tepër shumë që të mund të na e zvogëlojë planin e mrekullueshëm që Zoti ka për ne. Duke kuptuar insistimin e saj të fortë, Kathleen, lëshoi pe, më në fund, nga dashuria për të. Vendosi që të zvarritet edhe për një krah shkallësh deri te kapela dhe atje e luti Atin Qiellor që ta krijoj përsëri, ashtu si thoshte porosia – por duke shtuar: „Atë nëse nuk do që sonte të më krijosh përsëri, në rregull. Shtrati im ende më pret!“

Kathleen u shemb para të Shenjtërueshmit Sakrament dhe kuptoi menjëherë që Ati do ta përtërij forcën e saj. Po! Donte të përtërijë forcën e saj! Ishte e mjaftueshme lutja e saj e vockël, me gjithë zemër, me sinqeritet të plotë. Duke thënë çdo fjalë shumë ngadalë, i shtynte dëshirat e saj larg vetes ashtu si shtyn njeriu një derë të rëndë dhe i tha Atit të vet: „Atë Qiellor, Ti e di se mu lejua që sonte të shkoj në shtrat më herët, por në zemër vazhdimisht më kthehen fjalët e nënës në lidhje

me atë që duhet të bëj kur ndjem e lodhur dhe nuk mund të vazhdoj më tutje. Prandaj, jam në gjunjë Atë, dhe të lutem përvujtërisht, nëse është vullneti yt, më krijo përsëri!“

Ende pa e përfunduar lutjen lodhja e Kathleen u zhduk si mjegulla në diell! U mbush me jetë të re! Të nesërmen, në gjashtë të mëngjesit, kur ra zilja për lutje në të gjitha katet e shtëpisë, kujdestarja jonë e vogël ende ishte aty duke u lutur për botën para Jezusit eukaristik, plot mirënjohje, këngë dhe energji! Nata kaloi pa farë mundimi. Ndjehej si të kishte fjetur dhjetë orë pa ndërprerje! Disa ditë më vonë nuk e ndjente madje as peshën e trupit të vet as kurrfarë dobësie. Hirin që pranoi atë natë i tejkaloi të gjitha pritjet e saj!

Ishte dashur të rrëzohej!

Kjo episode më sjell në mendje disa ecje të tjera, sidomos udhën e kryqit të Jezu Krishtit në rrugët e Jerusalemit, të cilën Jezusi është dashur ta kaloi në gjendje të sflitjes së papërshkrueshme, pas rrahjes me kamxhik. Shikuar nga perspektiva njerëzore, ishte dashur të rrëzohej – dhe të vdesë – shumë kohë para se të arrijë në golgotë. Si është e mundur që ishte në gjendje të vazhdoi? U lëshua në duar të Atit të Tij i cili i dërgoi engjëjt dhe fuqinë mbinatyrore për të ndërmarrë hapin e ardhshëm. Ky infuzion i fuqisë mbinatyrore në çastet e dobësisë sonë më të madhe, nuk është automatik. Është hir! Kërkohet që të dorëzohemi në duart e Atit Qiellor i cili gjithmonë na jep mjetet që të plotësojmë atë që pret prej nesh në planin e Tij të dashurisë. Atë natë, pa dyshim, Atit i është dashur ndërmjetësimi i Kathleen për fëmijët e Tij! Po ta themelonte vendimin vetëm në forcën e saj, Kathleen nuk do ta merrte këtë dhuratë tejet të mrekullueshme! Shenjtërit e dinë se si të mos humbin asnjë nga këto dhurata. Kjo është fshehtësia e tyre!

„Të dashur fëmijë! Edhe sot ju thërras në dorëzim të plotë Zotit. Ju, të dashur fëmijë, nuk jeni të vetëdijshëm se sa e madhe është dashuria me të cilën ju do Zoti. Prandaj, më lejon që të jem me ju, që të ju mësoj dhe ndihmoj të gjeni rrugën e paqes. Kurse atë rrugë nuk mund ta zbuloni nëse nuk luteni. Për këtë arsye, fëmijë të dashur, lëni të gjitha dhe Zotit kushtoni kohën, e Zoti atëherë do të ju pajis dhe bekojë. Fëmijëz! Mos harroni se jeta juaj është kalimtare si lulja pranverore që sot është e mahnitshme kurse nesër harrohet. Prandaj lutuni në atë mënyrë që lutja dhe dorëzimi juaj të bëhen si udhëtragues për Zotin. Kështu dëshmia juaj nuk do të vlejë vetëm për ju por për gjithë amshimin.“ (25. mars 1988.)

78

DEPOTË E PROVANISË HYJNORE

Kur jetoja në Paris, merresha me importin e gjësendeve punëdore nga India, Nepali dhe vendet tjera aziatike. Këto udhëtime shpesh më lejonin të kënaqem në thjeshtësinë, shumë të dukshme, të jetës në lindje e cila ma pushonte shpirtin dhe ma mundësonte ikjen nga presionet materialiste të Parisit. Vetëm tri ditë pas ‘kthimit’ tim më 1973., derisa rrija pezull e bartur nga valët e gëzimit shpirtëror nga vetëdija se e kisha marrë Jezusin e gjallë në vete, Ia drejtova një lutje shumë të singertë: „Zotëri, nëse diçka në jetën time nuk është në harmoni me vullnetin Tënd, ma thuaj në mënyrë të qartë dhe unë do ta mënjanoj!“

Atëherë isha naive në gjërat e Zotit, përkundër njëzet e pesë viteve të mia, dhe nuk isha e vetëdijshme se Zoti i dëshiron lutjet e tilla dhe gjithmonë përgjigjet në to. Madje mund të themi me guxim se Ai vetë i nxit këto lloj lutjesh kur në ne ka diçka që e pengon. Në këtë mënyrë Ai lejon që të mendojmë se ne vetë kemi kërkuar që dega e kalbur të pritet. Sa është i mirë Jezusi dhe si diti të më mbajë për fjale! Nuk e mori parasysh mendjemadhësinë time dhe më bëri diçka të mirë!

Nuk prita gjatë në përgjigjen e tij. Që të nesërmen, motra ime Marie-Pia, më përkujtoi. Posa hyri në dhomën e ditës, vërejtí disa gjëra të varura në mure dhe bërtiti: „Nuk e kuptoj si mund t’i shesësh këta zota të rremë dhe në të njëjtën kohë t’u sjellësh dritën e Jezusit të tjerëve! Sikur të isha në vendin tënd, menjëherë do t’i largoja!“

„Por... këtë duhet ta kuptosh...“

Tepër vonë! Kjo më goditi fort, edhe murmuritjet e mia për tu mbrojtur se si duhet të fitoj për jetesë dukeshin qesharake. Kishte të drejtë. Ato të dyja nuk shkonin së bashku.

Edhe ajo vetë, e kthyer disa javë më parë, motra ime e vogël ishte disa hapa para meje në dijen për drejtimin konkret të kthimit dhe shihte qartë se kompromisi nuk ishte i mundur. Apostulli nuk guxon të thyej kurorën, por duhet të jetë krejtësisht i pastër.

Kur ajo shkoi, u ula në dhomën e ditës me kokën mes duarsh, duke u ndjerë krejtësisht jashtë vetes. Posa isha kthyer nga Katmandu dhe New Delhi dhe isha e ngazëllyer që kisha gjetur aq gjëra të bukura dhe origjinale që askush tjetër nuk i shiste në Francë. Me që ra fjala, më duhet të pranoj se më kishte pickuar edhe snobizmi parisien! A thua ‘zbulimet’ e mia të vlefshme duhet të hedhen, si barra prej anijes? Zhvillohej në mua lufta e brendshme. Intensivisht mundohesha të gjej mënyrën që do të ma mundësonte të bashkoj dy gjëra të papajtueshme: të propagandoj maskat e zotave të rremë dhe afishet e mrekullueshme të tantrizmit tibetian, e në të njëjtën kohë t’ua sjell dritën e Krishtit atyre rreth meje. Ndjeva një shtrengim kur mu kujtua lutja e djeshme. Ishte e qartë se Zotëria ma kishte dërguar Marie-Piu si përgjigje në atë lutje, që të më tregoi se çfarë nuk i pëlqen dhe çfarë duhet ta përjashtoj nga jeta ime.

U fundos çdo gjë! Vendosa të shkatërroj koleksionin që kisha blerë në Indi. Sendet ishin në rrugën për në aeroportin Orly dhe duhej të kalojnë doganën gjatë disa ditëve të ardhshme. Kështu, unë kontaktova doganierin që ishte i ngarkuar për koleksionin dhe kërkova prej tij që ta digjte mallin para se të kalonte doganën. E dija se humbja financiare, që do të rezultonte nga ky aksion, do të jetë fatal për punën time të vogël dhe se kjo fli do të varroste shpresat për mbijetesën time. Disa orë i kalova duke provuar të llogaris se si mund ta kontrolloj dëmin, por përfundimi ishte i qartë. Nga pikëpamja financiare po shkoja drejt e në shkatërrim.

Atë mbrëmje, e thyer shpirtërisht shkova në kishën e Shën Sulpicit dhe u takova me grupin tim të lutjes – me ata vëllezër e motra të mrekullueshëm që ishin instrument në kthimin tim. Martine Lafitte¹⁷⁸ më përshëndeti me një buzëqeshje të madhe, por u brengos kur pa qëndrimin tim të mërzitur.

„Gjendem në një situatë shumë të rëndë,“ ia shpjegova. „Zotëria më ka treguar se duhet të lirohem nga diçka, dhe...“ Ende nuk e kisha përfunduar përshkrimin e problemit tim kur ajo filloi të qesh.

„Por, Emmanuelle, si mund ta humbësh paqen për shkak të kësaj gjëje! Zotëria nuk do të braktis! Ti e bën këtë për shkak të Tij. Tani topi është në terrenin e tij dhe Ai do të ndihmojë! Ku është besimi yt? A nuk është në Zotin?“

¹⁷⁸ Bashkëthemeluesja e grupit të lutjes Emmanuel në vitin 1972., në Paris. Grupi i lutjes më 1977., u bë bashkësi katolike laike.

Fjala 'besim' më goditi fort dhe kuptova se, për turpin tim të madh, kisha harruar këtë pikë themelore të jetës me Zotin. Atëherë, mora frymë thellë dhe i thash Jezusit: „Në rregull, Jezus. Në emrin Tënd i dogja sendet e mia dhe fati im është në duart Tua. Ti e di se mua më duhet të fitoj për jetesë. Pres që të angazhohesh për mua! Dhe të falënderoj paraprakisht!“

Qysh atëherë më nuk më bënte presion ndjenja e ankthit dhe përsëri e gjeta paqen dhe gëzimin. Sa i ëmbël është besimi për zemrën! Nga ana e Tij, Jezusi priste pikërisht këtë që të mund të vepronte në mënyrë hyjnore. Në dy ditët e ardhshme, pranova aq kërkesa dyqanesh për disa sende tjera, për të cilat kujtoja më parë se janë gjëra sekondare, sa që humbja mu kompensua trefish.

Me fjalë tjera, prerja e degës së kalbur, për mua ishte fitesë e pastër! Me bekimin e Zotit vazhdova punën time, deri kur Jezusi, tre vite më vonë, më thirri që ta ndjek në mënyrë radikale. Atëherë e braktisa Parisin dhe hyra në Bashkësinë e Lumturive.

Jezusi i ka thënë Shën Katarinës së Sienës: „Kujdesu për mua dhe unë do të kujdesem për ty!“ Ky zbulim i fuqisë së Zotit, nëpërmes të Provanisë Hyjnore, bëri përshtypje të madhe në mua. Meqë unë e ndaj me të tjerët nderimin për fuqinë e Zotit, kjo shkaktoi një reaktion zinxhiror. Më vonë shumë njerëz e provuan se si Zoti i gjallë vepron fuqishëm në jetën e tyre. Zbuluan se në depot qiellore presin shumë visare që të rrëshqasin në zemrat e tyre, mendjet e tyre, raportet e tyre, madje edhe në xhepat e tyre – kurse çelësi i këtyre depove është BESIMI.

Themelorja është dëshira e sinqertë që ta kënaqim Zotin në të gjitha dhe bërja e vullnetit të Tij, por nuk mjafton gjithmonë që vetëm ta çrrënjosim ankthin i cili nganjëherë na kaplon në ballafaqim me jetën. Prandaj besimi në mirësinë e Zotit është mjete më i mirë për qetësim!

O, sikur bota ta bënte këtë hap besimi në Zotin! Kjo është thjeshtësi fëmijërore!

Do kishte shumë më pak të atillë që do qëndronin në rrallë para zyrave psikiatrike, duke shikuar dyshemenë të pikëlluar dhe duke mos pritur më asgjë. Shumë prej tyre do të mund të vallëzonin nga lumturia!

„Të dashur fëmijë! Të gjitha këto shenja janë të dedikuara forcimit të fesë suaj deri kur të ju lë shenjën e përhershme.“ (22. Tetor 1981.)

79

SFERA E NGROHTË NË KRIZHEVAC

Në mes të dimrit nata bie shpejt pas orës katër të pasdites. Meqë ka më pak shtegtarë, Zoja e shfrytëzon mirë këtë kohë.

Një ditë, në të tetëdhjetat e hershme, kur Kathleen dilte prej kishe pas lutjes së mbrëmjes, pyetej se a do të ketë mjaft kohë të shkojë në shtëpi e të marrë ndonjë veshje më shumë para ngjitjes në Krizhevac. Ishte e premtë dhe Zoja e kishte ftuar grupin e lutjes në majë të kodrës, duke ju premtuar se do të dëftohet atje gjysmë ore para mesnate. Por, grupit iu desh që të jetë atje dy orë më parë që të përgatitej për ardhjen e saj. Kathleen-ës i kishte hyrë të ftohtit deri në palcë. Mërdhinte e tëra. Rrobat i kishte të lagura, dhe era e frushkullonte me shiun e ftohtë që e shtyn njeriun të dëshirojë një zjarr të mirë vatre shtëpiake dhe një mot të qetë. Por, sonte për Kathleen nuk do të ketë as zjarr, as vatër, as mot të qetë. Por do të ketë diçka më të mirë. Shumë më të mirë!

Kathleen e donte Zojën me gjithë qenien dhe fshehurazi, në zemër, ushqente mendimin se më vonë, atë mbrëmje, Zoja vërtetë do të jetë atje në kodër. Po, Nëna do të zbresë prej Qiellit që të jetë me fëmijët e saj, për t'i bekuar, shndërruar dhe udhëhequr. Kathleen ngutej për në shtëpinë e Pavloviqëve ku jetonte. Maria ecte para saj në heshtje. Dy gratë e reja kaluan fushat në errësirë. E dinin çdo gur dhe çdo gropë të rrugës.

Kur arritën në shtëpi, Maria përshëndeti prindërit dhe doli menjëherë me Kathleen për të shkuar në Krizhevac.¹⁷⁹ Mezi patën kohë të marrin një copë bukë. Nuk kishin ngrënë asgjë që nga mëngjesi – nuk u kishte premtuar koha! Grupe shtegtarësh nuk pushonin së vizituarit shtëpinë e familjes, që ishte gjithmonë e hapur, sepse për secilin nga ta , “të shkosh e të shohësh Marinë” ishte si të prekësh Zojën dhe të ndjesh erën e parfumit të saj. Rrobat e tyre ende ishin krejtësisht të lagura dhe të ftohta prej shiut dhe erës që sulmonte hove-hove. Kjo ishte një nga ato net kur askujt nuk do t'i binte në mend të dilte prej shtëpisë, pos në rast urgjence.

¹⁷⁹ Në Megjugorje ende ka shumë shtëpi si e Pavloviqëve, të thjeshta por të pasura me shpirtin e lutjes dhe të dashurisë që e tërheq Zojën. Meqë këto shtëpi fshatare, nuk janë në listën e agjencive turistike (nuk kanë banjo për çdo dhomë dhe as pajisje klimatike), për të banuar në to, së pari duhet t'i zbuloni në shtegtimin tuaj!

Provania Hyjnore u ofroi pak ndihmë. Ivani, Veguesi, kaloi andej me makinën e vet dhe i ftoi për t'i afruar deri në rrëzë të kodrës. Grupi filloi të ngjitet me lutjen e udhës së Kryqit. Moti vazhdoi të keqësohej më tej dhe tani shtresën e akullit filloi ta mbuloi bora e freskët. Në hapat e tyre kërcëllonte nën këmbë. Së shpejti filloi të binte edhe breshër. Përkundër kësaj, qëndronin në çdo ndalesë dhe këndonin sikur kënaqeshin në natën më të mrekullueshme verore. E dinin se Nëna e Zotit i pret në majë të kodrës. Në praninë e saj kishte diçka që i ndryshonte aq shumë nga brenda sa që dëshironin vetëm që të jenë me të. Si mund të jetë e rëndësishme çfarëdo gjëje tjetër? Si mund të jetë e rëndësishme se çfarë çmimi paguan trupi?

Kur arritën në majë, afër ndalesës së katërbëdhjetë, era frynte aq fort sa asnjëri nuk mund të shkonte tutje pa u rrëzuar. Dhe kështu grupi luftonte kundër shiut dhe erës së fortë, ecnin këmba doras nëpër gurë, rrëzë kryqit të madh të betonit ku, më në fund, u ulen duke u mbajtur njëri për tjetrin. Lutjet dhe himnet e tyre nuk pushonin kur dukej se tërbimi i fuqive të natyrës, në çdo minutë sa vinin e bëheshin më të ashpra sa më shumë që afrohej koha e dëftimit. Kathleen e kishte fshehur fytyrën mes gjunjëve që ta mbronte nga breshëri. Por gëzimi i saj i kundërshtonte erës: „Nënë, pas disa çastesh do të jesh këtu!“

Kur u dëftua Zoja atë natë, era, që rrihte kodrën, filloi të bënte xhiro rreth grupit, si të ndeshej me një mur të pakalueshëm. Sillej rrotull tyre, kurse të rinjtë u gjenden brenda sferës së ngrohtë. Ishte sikur manteli i padukshëm i Zojës i mbronte. Aty ishte një vatër e butë, intime dhe e ngrohtë. Dhe kjo ndodhi këtu, në majë të kodrës ku rrihnin erërat e tërbuara të dhjetorit dhe jo nën strehën e një shtëpie komode. Papritur të gjitha rrobat u terën. Të rinjtë mezi e besonin!

Kjo ndodhi sa çel e mbyll sytë. Se çfarë paqe! Kënga pushoi. Të gjithë lejuan që të mbështillen, nga jashtë dhe nga brenda, nga kjo prekje e papërshkrueshme që i takon vetëm Mbretëreshës së paqes dhe e cila bën që të ndjehemi - së paku për një çast – sikur të gjitha armiqtë e botës janë asgjë, absolutisht asgjë krahasuar me atë zjarr dashurie.

Maria rrezatonte e gjitha kur e dorëzoi porosinë që dha Zoja atë mbrëmje: „Kur Zoja erdhi, ishte plot gëzim. I hapi duart dhe dukej se të gjithë u përfshimë në sferën e dritës. Ajo tha: 'Të dashur fëmijë, ju falënderoj për dashurinë me të cilën keni pranuar t'i bëni këto fli. Me gëzimin tuaj dhe me dashurinë tuaj munda të realizoj një pjesë të planit tim!' “

Atëherë Zoja u dha si dhuratë: gëzimin e saj. Kështu këta të rinj kuptuan se pse gjatë kohës së dëftimit ndjenin atë lloj lidhjeje me të. Kur u gjendën brenda asaj sfere drite që i ngrohi dhe i teri, ishte sikur të përqafoheshin nga brenda. Paqja nga lart zbriti mbi ta dhe ata kërcisnin nga gëzimi! U lëshuan kodrës tatëpjetë pa i kushtuar kujdes as erës as borës e akullit!

Kathleen-ës zakonisht i duheshin dy orë të zbriste sepse në errësirë nuk e shihte mirë terrenin kodrinor. Atë natë nuk kishte hënë, as yje, as dritë! Por Maria i propozoi Kathleen-ës: „Nëse nuk di si të lëshohesh, më mbaj për dore dhe unë do të tregoj si. Vetëm hidhe një këmbë para tjetrës!“

Atëherë Maria filloi të vrapoi, kurse Kathleen vetëm mund të vraponte me të, duke harruar frikën nga terri dhe vështirësitë e saj. Arritën në rrëzë të kodrës për më pak se nëntëmbëdhjetë minuta. Ka raste në jetë kur vetëm dorëzimi mund të shpëtoi. Për Kathleen, ky ishte njëra nga zbritjet më të gëzueshme në jetë, i kryer në kohë rekorde! Ndoshta engjëlli i rojës kishte gisht në këtë – sepse nuk kishte tjetër zgjedhje!

Kathleen edhe sot i sheh të gjitha këto hollësi të jetës në Megjugorjen e viteve të '80-ta si të ishin dje: „Zoja na ka mësuar me leksionet si kjo“, më tha. „Me Të kurrë nuk kishim përshtypjen se po flijojme. Kuptuam se ato kushte ishin shumë të ashpra vetëm kur menduam më vonë për këtë. Natyrisht, kishte vështirësi, por mund të them sinqerisht se, atëherë, nuk i kam përjetuar si vështirësi. Përjetonim atë që Zoja kërkonte prej nesh, atë që kërkonte të jetojmë. Na mbështeste sepse të gjithë ne kishim vendosur që të ndjekim shkollën e saj dhe të bëjmë të gjitha ato që kërkonte. Ishim të gatshëm që të bëjmë çdo gjë për Të, kështu është edhe sot!“

„Të dashur fëmijë! Sot dëshiroj të ju them se ju dua. Ju dua me dashurinë time amnore dhe ju thërras që të më hapeni plotësisht ashtu që, nëpërmes secilit prej jush, të mund ta kthej dhe shpëtoj botën e cila është plot mëkat dhe plot me çdo gjë tjetër që nuk është e mirë. Prandaj, fëmijëzit e mi të dashur, hapuni për mua që të mund t'ua zbuloj dhe tregoj Zotin që ju do. Ju faleminderit që ju përgjigjet thirrjes sime! (25. gusht 1992.)

80

PYETJE PERSONALE PËR ZOJËN

Makina jonë, përplot njerëz, kërcente rrugës gungaçe drejt çadrës së blertë në Çenakolo. Për më pak se gjysmë ore Zoja do t'i dëftohet vegueses Mirjana Soldo, kurse ne do të lutemi me të për të gjithë ata që nuk e kanë njohur dashurinë e Zotit, si përherë, me datën dy të muajit.

Në mesin e Amerikanëve të rinj që shtyheshin në pjesën e pasme të makinës, ishte edhe njëzetepesëvjeçarja Helen, e ndjeshme, me një mendje brilante, e bukur, por e infektuar me materializmin e përhapur i cili ka mbisunduar në SHBA. Megjithatë, ajo nuk ishte dorëzuar krejtësisht asaj jete materiale. Në fshehtësi i dëshironte horizontet më të thella dhe më të gjëra. Kishte filluar java e tretë e qëndrimit të saj në shtëpinë tonë në Megjugorje. Pikëllimi të cilin e solli me vete u zhduk dhe u zëvendësua me paqen e brendshme. Prej saj kërkohet duresë – për t'u pjekur në Zotin duhet kohë.

Derisa ishim rrëzë Podbërdos, për një çast lakuam drejt fshatit Bijakoviqi. Edhe pse ishte herët në mëngjes, dielli i korrikut përvëlonte. Na rrethonte një qetësi e thellë.

„Hej! Shoqja ime Dina martohet nesër“, deklaroi papritur Helen. „Martohet me shoqen. Janë disa vite bashkë.“

„Martohet me shoqen?“ - pyetëm të tmerruar.

„Po mirë, Kjo është rruga e saj. Unë nuk do ta bëja një gjë të tillë, por kjo është zgjedhja e saj. Është e lirë të zgjedh. Dhe unë e respektoj zgjedhjen e saj.“

„Ti e respekton zgjedhjen e saj?“ - pyeta.

„Po.“

„Zoti im!“ mendova. „Për dy minuta duhet të parkoj makinën, dhe bomba eksplodoi në sekondën e fundit.“

Edhe pse e hutuar, e pyeta: „Si mund ta respektosh zgjedhjen e saj kur e di prej Biblës se Zoti na krijoi si ‘burrë e grua’ dhe se praktika homoseksuale nuk është në planin e tij për njerëzimin?”¹⁸⁰

„Por motër, ti e njeh Biblën. E gjitha varet nga ajo se si dëshiron ta lexosh dhe interpretosh. Mund të mbrosh cilin qëndrim të duash.“

„Uuuh!“ - mendova. „Këtu, vërtet, jemi në teren të rrëshqitshëm. Më kanë mbetur vetëm tridhjetë sekonda të dal nga kjo situatë. Nuk mund t’i lejoja ata të rinj të shkojnë në Çenakollo me këtë lloj mendimi të helmuar.“

Për fat, Chrissey u ngut të më ndihmoi. „Dëgjoni“, tha ajo, „më vonë do flasim për Biblën, por në ndërkohë, kam një ide. Zoja, tani, do të dëftohet. Do të jetë me ne për disa minuta. Edhe pse sytë tanë nuk mund ta shohim, ne mund të flasim me të! Mund t’ia themi të gjitha! Ajo është nëna jonë! Pse atëherë nuk e pyesim se çfarë mendon ajo në lidhje me këtë. Për shembull mund ta pyesësh: „Nëna, a do ta aprovoje ti këtë zgjedhje, këtë lloj kurore 'homoseksuale'?“

„OK, kjo është ide e mirë!“

Dhe kështu dolëm nga makina. Ngadalë depërtonim nëpër turmën e larmishme që këndonte Ave Maria derisa prisnin Nënë e tyre. E përshëndetëm Zojën dhe u lutëm me të, të përqendruar. Pastaj u kthyem në shtëpi. Mbretëronte një qetësi e plotë. Helen ishte e zhytur në mendime. Nuk e zënte në gojë pyetjen e saj. Mëngjesin e ardhshëm Helen u zgjua herët dhe më gjeti në Kuzhinë. Kur ziem kafënë, dolëm në diellin e mëngjesit, para se të lutemi.

„Zoja mu përgjigj dje, dhe tani e kam shumë të qartë!“

„Çfarë ke të qartë?“ – e pyeta.

„Pra, në kohën e dëftimit dje, diçka ngjau, dhe unë e ndjeja se diçka nuk është në rregull me homoseksualitetin. Papritmas kjo mu bë disi e çuditshme.“

„Do me thënë, Zoja të tha diçka?“

„Nuk e di! Nuk pash as nuk ndjeva gjë – por kur dola prej çadrës së blertë, isha disi e bindur se ai nuk është plani i Zotit për njerëzimin. Qartësia është e kristaltë! Për herë të parë po e kuptoj pse. Sepse mund të jenë të bashkuar por jo të bashkuar që të mund të kenë fëmijë. Dhe çfarë kuptimi

¹⁸⁰ Në mesin e citateve Biblike për këtë temë është edhe Lev 20,13. Mësimi katolik thotë se akti homoseksual në vetvete është jo i rregullt e në kundërshtim me ligjin natyror, dhe nuk mund të arsyetohet në asnjë rrethanë. Shiko Katekizmin e Kishë Katolike §2357. Kisha është përpjekur shumë që të sqarojë jo vetëm këtë qëndrim, por edhe dy mendime pastorale të lidhura të cilat i ka pranuar Konferenca e ipeshkvijve katolik të Amerikës: «Ministry to Persons With a Homosexual Inclination: Guidelines for Pastoral Care» (Origins, fletorja 36, nr. 24, 23.11.2006.)

ka ajo lidhje në të cilën nuk mund të keni fëmijë dhe t'i ktheni Zotit njerëzimin që e ka krijuar? Nëse bashkohen dy të një gjinie, nuk mund të marrim pjesë në planin e Tij si çift bashkëshortor. Dy trupa të njëjtë nuk janë të përshtatshëm për këtë.“

Sot Helen ka një punë të rëndësishme në Politikë, ku ajo ka rastin të shohë gjithçka – mirë e keq. Ajo e ka thelluar jetën e saj të lutjes. Përpiqet t'i shohë gjërat ashtu si i sheh Krishti, duke e pranuar gati çdo ditë në eukaristi. Gjykimi i saj u ndërrua në mënyrë radikale, si dhe qëndrimet e bindjet e saj. Nga fytyra e saj rrezaton paqe. Është si fener deti në mes të ujërave të shqetësuara të jetës intelektuale amerikane. Helen u mësua të dëgjojë. Pas kësaj episode me kurorë homoseksuale, Helen e di se kë të pyes, kur ka ndonjë pyetje me rëndësi.

„Të dashur fëmijë! Në këtë kohë hiri ju thërras në lutje. Fëmijëz, ju punoni shumë por pa bekimin e Zotit. Bekoni dhe kërkoni urtinë e Shpirtit Shenjt që të ju prij në këtë kohë që të mund të kuptoni dhe të jetoni në hirin e kësaj kohe. Kthehuni, fëmijëz, dhe gjuhëzohuni në qetësinë e zemrës suaj. Veni Zotin në qendrën e qenies suaj që ashtu të mund të dëshmoni bukuritë që Zoti i jep vazhdimisht në jetën tuaj. Ju faleminderit që ju përgjigjët thirrjes sime.“

(25. maj 2001.)

81

PROFETI NGA FSHATI BIJAKOVIQ?

Mate Shego u lind në vitin 1901. Jetoj në rrëzë të Podrbdos, shumë afër familjes së Vickës dhe familjes Ivankoviq në fshatin Bijakoviq, ku lindën të gjithë veguesit. Ai kurrë nuk shkoi në shkollë dhe nuk dinte shkrim-lexim. Gjithë jetën punoi me mund një copë të vogël toke të trashëguar nga prindërit. Ishte një tokë gurore dhe frytin e kishte të pakët. Shumë shokë dhe komshi të tij, kryesisht fitonte nga vreshtat dhe duhani, nga lopa dhe disa dhi. Në vend se të shkonte në Gjermani, si kishin vendosur vendësit e tjerët të tij, ai zgjodhi të qëndronte në fshatin e vet. „Është më mirë të jesh i varfër dhe të ruash familjen,“ mendonte.

Kur iu rritën fëmijët, Mate mundi t’i lejoj vetes që pa brenga të presë largimin e tij të madh. Si të gjithë prodhuesit e verës, kishte dëshirë që miqtë t’i qerasë me verë, dhe si bëhej më i vjetër dhe më i dobët kjo i jepte rast që t’i plotësonte orët e gjata para se të errej. Shtëpia e tij e vogël nuk kishte as ujë as rrymë dhe banorët e saj e përcillnin rrjedhën e jetës së tyre duke shikuar lëvizjen e diellit dhe ndërrimin e stinëve të vitit. Ballafaqoheshin me jetën ashtu si u vinte. Askush nuk e dinte a do të ketë bukë nesër në tavolinë. Ishte e zakonshme që të gjithë të flenë njëri pranë tjetrit në dyshtenë e fortë. Atëherë, askush as që kishte dëgjuar për krevatin! Edhe pse për të as që kishte vend në shtëpi. Çdo mëngjes, e shoqja, Marta, i paloste batanijet në qoshe e asaj dhome që për gjithë familjen ishte e vetmja hapësirë jetësore.

Mate Shego! Njeriu me tregime aq intriguese dhe fantastike! Nganjëherë i binte kryq e tërthor luginës së Megjugorjes duke përhapur tregime pa lidhej për katër erërat. Disa mendonin se e kishte nga vera. Disa qeshnin kur kalonte pranë tyre, disa të tjerë e përqeshnin zëshëm botën e tij të vizioneve!

„Nuk jam i pashëm,“ thoshte shpesh. „Por, më duan të gjithë! Secili më pranon me gëzim!“

Mate kishte të drejtë. Ishte i mirëseardhur kudo që të shkonte. Banorëve të Megjugorjes u duhej prania e një njeriu kaq të gëzuar dhe me kohë u lidhën me të. Shpesh thoshin në mahi: „Nëse shkojmë në dasmë të dikujt dhe Mate nuk është aty, nuk ka gëzim, nuk ka cirkus, nuk ka këngë.“

Në vjeshtë kur ishte koha për të bërë rakinë, Mate duhej të jetë aty. Përndryshe të gjithë do t'i mbyste mërzia – ngrohtësia dhe gëzimi i Mates ishin aq tërheqës dhe infektues. Atëherë nuk kishte kinema, as radio, por Mate i kompensonte të gjitha këto. Ai ishte gëzimi i të gjitha tubimeve të mbrëmjes. Ai dinte t'i disponoi zemrat e pikëlluara të miqve të vet, të ngarkuara me mungesën e lirisë. Në praninë e tij kur njerëzit ia dëgjonin tregimet, harronin çdo gjë. Duke pyetur për të në mes të banorëve të fshatit, kuptova se të gjithë e kujtojnë si shakaxhi të mirë.

Kur Mate fliste për ardhmërinë e fshatit, për atë botë të rrethuar prej së cilës kurrë nuk kishte dalë, nuk mund të ndihmonte njeri. Kurrsesi nuk mund të ndalonte! „Një ditë pas shtëpisë sime do të jenë shkallët, që do të shkojnë deri në majë të kodrës dhe do të jenë aq shkallë sa ka ditë brenda vitit!” u premtonte të gjithëve që donin ta dëgjonin.

„Vazhdo, gjysh, të ëndërrosh edhe më tej. Nuk ka asgjë të keqe të shohësh ëndrra,“ ia kthenin.

„Më dëgjoni! Më dëgjoni, fëmijët e mi! Megjugorje do të bëhet shumë e rëndësishme! Me mijëra e mijëra njerëz do të vijnë këtu nga të gjitha anët e botës. Njerëz me të gjitha ngjyrat e lëkurës. Do të shihni njerëz të racës së zezë, të verdhë e të bardhë. Do të vijnë këtu për t'u lutur. Nuk do të jetë më kjo kishë e vogël me të cilën jam rritur. Do të ndërtohet një e re shumë më e madhe dhe do të jetë plot. Në të as nuk do të mund të hyjnë të gjithë ata që do të vijnë! Kishën e vjetër të fëmijërisë sime do ta rrënojnë me dinamit. Do të ndodh kjo në ditën e vdekjes sime.

(Është për t'u habitur se çdo gjë ndodhi pikërisht kështu. Kambanorja e kishës së vjetër në të cilën lutej Mate u rrëzua nga tërmeti. Kisha u rrënua me dinamit në vitin 1978, pikërisht në ditën kur vdiq Mate. Kisha e sotme u ndërtua në vitin 1979, dy vite para se të fillonin dëftimet.)

Duke injoruar përqeshjet, Mate vazhdonte: „Zoja ime do të vijë – të lumët ata që besojnë dhe luten! Tani ua them këtë! Unë këto nuk do t'i përjetoj por ju po, fëmijët e mijë! Do të ketë shumë rrugë, shumë ndërtesa, jo si këto kasolle që kemi sot – disa ndërtesa do të jenë shumë të mëdha.“

Në këtë pjesë të tregimit, Maten e kaplonte nostalgjia dhe pikëllimi, sikur shikonte zhdukjen e vendit të dashur. „Njerëzit tanë do t'ia shesin tokën e tyre të huajve që do të ndërtojnë hotele. Megjugorje dhe kodrat përreth do bëhen vend i shenjtë. Do të ketë aq shumë njerëz në Cërnice¹⁸¹ time, sa që natën nuk do të mund të flini. Të gjithë ata do të vijnë për shkak të Zojës sime! Fëmijët e mi, do t'i shihni këto. Jini të sjellshëm dhe mikpritës me ta dhe çdo gjë do të jetë mirë për ju.“

„Gjysh, sonte ke pirë tepër raki. A s'mendon se është koha për të fjetur?“

¹⁸¹ Crnica ose Podbrdo. Sot quhet edhe Kodra e dëftimit.

„Kini kujdes! Mos e harroni traditën! Lutni Zotin për të gjithë edhe për vete.“¹⁸²

Natyrisht, gjithandej kishte shumë përqeshje dhe komente. „Gjithë ajo vuajtje la gjurmë në kokën e tij, këtu nuk ndihmon as rakia,“ pëshpëriste dikush.

Mate e dinte shumë mirë se asnjë nga miqtë e tij nuk e beson asnjë fjalë nga tregimet e tij.

Vërente se po e përqeshnin, por asgjë nuk mund ta ndalonte. Me shikim të rreptë i qortonte: „Mos më bëni ta thërras Jezusin!“

Komentet e tyre dashakëqija binin në vesh të shurdhër sepse ai kurrë nuk ishte prej atyre njerëzve i cili do ta zbuste porosinë e vet vetëm që t’i pëlqejë shumicës. Kishte arealin e shenjtit, shikimin e shqiponjës dhe qëndrimin që nuk e zbulonte realitetin që e shikonte normalisht ashtu si ne shikojmë se si dielli ngritët! Kishte qëndrimin e njeriut të Zotit. Zemra e tij ishte e drejtë dhe e lirë. Nuk ndjehej i rrezikuar nga ajo që njerëzit mendojnë për të. Kur kishte për të thënë diçka, atë edhe e thoshte. Nuk dinte të lexonte as të shkruante por kishte qasje në planet e fshehura të Zotit për fshatin e vet dhe nëpërmes të fshatit të vet për mbarë botën!

Shoku i tij ishte Jozo Ivankoviq, që ishte më i ri se ai dhe i cili përmbahej parimisht nga pirja e alkoolit. Me që Mate herë pas here çonte nga një gotë, Jozo ia përkujtonte rrezikun nga pirja e verës, dhe e këshillonte që për shkak të shëndetit të hiqte dorë nga pija. Por Mate dinte diçka që Jozo nuk e dinte.

„Jozo, unë do të jem në varrimin tënd!“

„Ki kujdes Mate, ti do të mund të rrëzoheshe dhe të lëndoheshe para meje!“

„Vetëm ti fol Jozo, por unë do të jem në varrimin tënd!“

Edhe një herë, Jozo, që ishte shumë më i ri, mendoi se Mate është në kllapi, por u pa se parashikimi i tij ishte i drejtë. Mate vërtetë shkoi në varrimin e Jozos!

Mirëpo, disa nga fjalët e Mates, akoma janë të paqarta. „Dëgjoni, dëgjoni fëmijët e mi!“ – tha një herë „Këtu diku do të paraqitet burimi. Burimi me plot ujë! Aq shumë ujë sa do të krijohet liqeni dhe populli ynë do të ketë varkat e veta që do t’i lidh për shkëmbin e madh. “

¹⁸² Mbi këto tregime më kanë folur disa të moshuar që e kujtojnë mirë komshiun e tyre Mate. Dëshmitë e tyre vërtetohen mes veti. Një prej atyre miqve është edhe Ivan Ivankoviq që e njihnte Maten pesëdhjetë vjet para vdekjes së tij në vitin 1978., pastaj Nada Qiliq dhe Pavica. Mate jetoi nga 1901. deri më 1978.. U varros në varret e fshatit Bijakoviq.

Aq sa njerëzit mbajnë mend, mungesa e ujit gjithmonë ka qenë problemi më i madh për fshatarët e varfër të Megjugorjes, dhe mjetet e tyre për kërkimin e ujit nuk janë përmirësuar thuaja nga shekulli i Mesëm. Bënin gjithë çka ishte e mundur që ta gjejnë ujin nëntokësor. Shponin vrima në disa vende në fshat, por pa dobi. Vetëm gurë dhe më shumë gurë! Në luginë nuk kishte asnjë burim, prandaj familjet ishin të detyruara të hapnin gropa për të mbledhur ujin e shiut. Por valët e të nxehtit veror ishin të rënda dhe të gjata dhe ato gropa nuk mund të siguronin ujë të mjaftueshëm për bagëtitë në mëngjes ose për ujitjen e të mbjellave të duhanit në mbrëmje. Kështu fshatarët me qerre e kuaj shkonin gjer në Çitluk, Lubushki madje edhe deri në Mostar për të gjetur ujë! Kush nga fshati do të mund të mendonte që ajo barrë e rëndë e shkaktuar me mungesën e ujit, një ditë të hapte rrugën për bekimin e burimit të madh?

„Lere Mate, çfarë thua? Ujë në Megjugorje? Ti me siguri po mahitesh!“

Fytyrat e tyre vareshin kur dëgjonin fantazi të tilla. „Sikur të ishte e vërtetë! O Zot, na ruaj!“

Por Mate nuk lëshonte pe. Vizionet e tij e kishin përshkuar ashtu si i dielli përshkon qiellin!

Shën Pali i kishte porositur Korintasit që t’i dëshirojnë dhuratat e Shpirtit Shenjt, sidomos atë të profecisë, por po ashtu ka thënë se “profecia jonë është e kufizuar.”¹⁸³

A është profecia e Mate Shegos mbi burimin e madh si këto profecitë e pashmangshme për të cilat na e tërheq vërejtjen Shën Pali? Të gjitha u treguan të vërteta në dhjetë vitet e para të dëftimeve. Apo ndoshta ky element ruhet për ndonjë datë të panjohur në të ardhmen? A ka të bëjë vizioni i tij me rrjetin e ndërtuar të ujësjellësit i cili tani furnizon me miliona hektolitra shtegtarët e Megjugorjes? A mundet ngjarja sizmike natyrore të shkaktoi që në sipërfaqe të paraqitet një burim i tillë uji në një tokë gjithmonë të thatë, apo do të jemi dëshmitarë të një dukurie mbinatyrore e cila nuk do të ishte e para për këtë tokë të bekuar të Megjugorjes? A nuk e kanë parë njerëzit e Lurdit me sytë e tyre burimin e ujit të rrjedhshëm kur vogëlushja Bernardica Soubirous grithi tokën buzë shpellës ashtu si i tha Zoja?

Por, a nuk është gjëja më e rëndësishme se Zoti drejton çdo gjë – dhe që vërtetë do të shohim! Në ndërkohë Mate, person i jashtëzakonshëm, na e zbuloi atë dimension të mrekullueshëm të dijes Hyjnore. Më lejoni ta përfundoj këtë kapitull me një lutje të thjeshtë me të cilën dua t’i drejtohem vëllait tim të ndjerë, Mate Shego, i cili mu bë aq i dashur sa mezi e pres ditën kur do të mund të ulem pranë tij në Qiell dhe të dëgjoj versionet e tij të ngjarjeve në Megjugorje – në dashtë Zoti!

¹⁸³ 1 Kor 13,9

I dashur Mate, PAQA me ty!

Çdo ditë e falënderoj Zotin për ty Mate. Këtu në tokë, kur ishe nën të gjitha llojet e tundimeve, ndoshta nuk ishe i vetëdijshëm për të gjitha bekimet tua dhe në çfarë mase ishe nën mbrojtjen e Qiellit.

Linde disa metra larg nga vendi kua *Zoja jote* do të dëftohej, i përgatite mendjet e miqve të tu e këtë as që e dije. Kur ajo vërtetë u dëftua, ushtarët komunistë filluan me sulmin e tmerrshëm si kundër besimtarëve ashtu edhe kundër veguesëve. Atëherë të gjithë kujtuan tregimet tua dhe ti i ngushëlloje nga e kaluara.

Për shkak të qetësisë dhe guximit të vazhdueshëm që të prinë të tregosh vizionet tua, vetëm më vonë njerëzit u denjuan që të kuptojnë se ai ishte plani i Zojës për fshatin e tyre. Ishin të denjë të bashkëpunojnë me të përkundër presioneve, kërcënimeve dhe keqtrajttimeve që vinin nga ana e armikut. Ata kujtuan fjalët tua: „Jini të sjellshëm dhe mikpritës me të gjithë që do të vijnë. Ata do të vijnë për t’u lutur.“

Mate, dua të falënderoj se e ka bartur kryqin tënd pa ankesa, sepse sytë i kishe të drejtuar në botën e ardhshme. Për më tepër, falënderoj Zotin që të thirri tek Vetja para se ato ngjarje të fillojnë të ndodhin. Ai deshi të mbrojë që misionin tënd ta kryeje në thjeshtësi të plotë. Madje mendoj se as që ke qenë i vetëdijshëm se ishe profet. A jam gabim? Më duket se shkarazi i ke përcjellë vizionet tua ashtu si njerëzit i thonë mendimet. Ke folur me një spontanitet të fuqishëm të zemrës së pastër dhe nuk ke ndalur të analizosh reagimet „për“ dhe „kundër.“

Bisedova me miqtë tu, me ata që janë ende në jetë dhe të cilët e kujtojnë kohën tënde. Çdo herë, takimi me ta më mbush me gëzim më të madh. Besoj se Zoti të ka mbjellë në rrëzë të kësaj kodre si drurin e vogël, tepër modest që njerëzit ta vërejnë, por të paracaktuar që një ditë të japë fruta të ëmbla për Të. Të mbajti në aq kushte të vrazhda dhe të ashpra sa as rregulltarët dhe rregulltaret më kontemplativë nuk do të mund të qëndronin!

Përkundër dobësisë sate, Ai të lejoi të mbetesh i pavetëdijshëm për rëndësinë tënde, e ndoshta edhe për shenjtërinë tënde. Ai lejoi që ajo të mbijë dhe lulëzojë në fshehtësi, e mbrojtur nga rrebeshi i lajkave njerëzore dhe materializmit të përgjithshëm. Ishe i mbrojtur nga të gjitha këto. Se çfarë bekimi! A ke ide se çfarë ka mundur të ndodh? Çka do të ishte sikur turma e njerëzve të vinte në shtëpinë tënde për të prekur, fotografuar, intervistuar, për të bërë me mijëra pyetje mbi ardhmërinë tënde dhe ardhmërinë e mbarë botës? Merre me mend veten në kopertinat e gjithë revistave dhe gazetave në Megjugorje, me trajtim mbretëror në të gjitha kontinentet, dhe që njëkohësisht je i ballafaquar me të gjitha llojet e lajkave, tërheqjes së vëmendjes dhe tundimeve! Merre me mend! Mate, nuk e ke idenë se çfarë ankthi nate do të ishte për ty! Është një bekim i madh që ke mbetur i fshehur në jetën tënde modeste, si Nëna e Zotit në shtëpinë e thjeshtë të familjes së Ben Davidit në Nazaret.

Mate, lutu për fshatin tënd, Bijakoviqi, sepse nuk do ta njihje më! Ndërmjetëso për popullin tënd! Janë infektuar me virusin e Perëndimit. Janë të sulmuar nga të gjitha llojet e tundimeve, të panjohura për kohën tënde. E gjitha kjo i ka befasuar. Nuk ishin të gatshëm për këtë! Lute *Zojën tënde* për mbrojtjen e tyre, ashtu që ajo të mundet në plotësi ta realizojë planin e saj, nëpërmes tyre.

Shkallët që ke përmendur ende nuk janë ndërtuar. Mirëpo, pjesa e poshtme e rrugës së shkelur është shtruar me pllaka dhe fqinjët tu nuk pushojnë së foluri për ty. Je bërë krenaria e tyre! E sa më takon mua, të lutem thuaj një lutje për çdo pllakë guri që vendoset pas shtëpisë sate, ashtu që secili që shkel në ato shkallë guri – qoftë shtegtar, tregtar ose shpirt kureshtari – të pranojë një nga hiret për të cilat ishe i njohur në jetën tënde: hirin që të jetë njeri i thjeshtë dhe të ketë fenë e fëmijës, hirin që të qëndroi me Zotin përkundër erërave të tmerrshme dhe baticave të forta! A mund të ja dorëzosh këtë lutje asaj që me plot dashuri i ke thënë *Zoja ime*? Të faleminderit shumë!

„Të dashur fëmijë! Sot ju thërras që ta kuptoni thirrjen tuaj të krishterë. Fëmijëz, unë ju kam prirë dhe ju prij nëpër këtë kohë hires, që të bëheni të vetëdijshëm për thirrjen tuaj të krishterë. Martirët e shenjtë kanë vdekur duke dëshmuar: Unë jam i krishterë dhe e dua Zotin mbi të gjitha! Fëmijëz, edhe sot ju thërras që të gëzoheni dhe të jeni të krishterë të gëzuar, të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm se Zoti ju ka thirrur, që në mënyrë të posaçme të jeni duar të shtrira me gëzim ndaj atyre që nuk besojnë dhe me shembullin tuaj të jetës të fitojnë besimin dhe dashurinë ndaj Zotit. Prandaj, lutuni, lutuni, lutuni, që zemrat tuaja të hapet dhe të bëhet të ndjeshme për fjalën e Zotit. Ju faleminderit se ju përgjigjët thirrjes sime.“ (25. nëntor 1997.)

82

VOGËLUSHJA LI

Kur në vitin 1979. Zoti e thirri tek vetja shërbëtorin e vet Fulton Sheen, me miliona Amerikanë vajtuan për vdekjen e tij. Ata u ndien të braktisur si jetimë.¹⁸⁴ Ai me vite shfrytëzoi të gjitha mjetet e mundshme që nëpërmes mediesh të arrinte deri tek zemrat e njerëzve të cilët i fascinonte çdo fjalë e tij. I pajisur me karizëm të rrallë, ishte përzjerje e elokuencës natyrore dhe e fuqisë së Shpirtit Shenjt. Nëpërmes dëshmisë së tij njerëzit kuptuan se Zoti është i gjallë, i madhërishtëm dhe i dëshiruar. Arkipeshkëvi Sheen shkëlqente me një shkëlqim të tillë sa kanalet televizive luftonin për të, duke ditur se emisionet e tij do ti tejkalonin të gjitha rekordet e shikueshmërisë. Emisioni i tij i popullarizuar „Jeta vlen të jetohet“ çdo javë tërhiqte rreth 30 milionë shikues.¹⁸⁵

Ky Arkipeshkëvi i madh, mjeshtër i ungjillëzimit, kishte misterin. Ashtu si njerëzit e mëdhenj të Zotit, Fulton në fshehtësi ushqente atë që rastësisht e kishte zbuluar më herët në jetë. E preku ngjarja nëpërmes të cilës mbi të u derdhën shumë hire dhe e drejtuan në rrugën nga e cila nuk desh të largohet për asgjë në botë. Që ta kuptojmë këtë përvojë të tij duhet të ç’vendosemi në Kinë, në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar, kur komunizmi me gjithë forcë u lëshua mbi regjimin e vjetër...

Hapat e vegjël të fëmijës

¹⁸⁴ Shikoni foto-albumin.

¹⁸⁵ Ai thoshte: “Nëse besoni në të pabesueshmen, në fund do të bëni të pamundurën.”

Në shkollën e famullisë, fëmijët e vyeshëm recitonin lutjet e tyre. Motra Eufrazija ishte e kënaqur, sepse para dy muajsh shumë fëmijë e kishin marrë kungimin e parë. Në thellësinë e zemrës së tyre të vogël, e kishin kuptuar shumë seriozisht. Ajo qeshi me vogëlushen dhjetëvjeçare Li e cila e pyeti: „Pse Jezusi nuk na ka mësuar të themi: 'Orizin tonë të përditshëm, na e jep sot'“ Në këtë pyetje ishte shumë vështirë të përgjigjeshe sepse ata fëmijë hanin oriz në mëngjes, në drekë e në darkë.

„Pai, sepse 'buka' do të thotë 'eukaristia',“ u përgjigj motra Eufrazija, zemra e së cilës shkëlqente shumë më tepër se teologjia e saj. „Ti e lut Jezusin e mirë për kungim të përditshëm. Është e vërtetë se trupit tënd i duhet orizi. Por shpirtit tënd që është shumë më i vlefshëm se trupi, i duhet buka. Ajo është buka e jetës!“

Në majin e viti 1953., kur Li mori kungimin e parë shenjt, në zemrën e saj e luti Jezusin: „Gjithmonë ma jep bukën e përditshme ashtu që shpirti im të mund të jetojë dhe të jetë i shëndoshë!“ Qysh atëherë Li merrte kungimin shenjt çdo ditë. Ajo ishte e vetëdijshme goxha mirë për faktin se „njerëzit e këqij“ (komunistët e pa fe) mund ta pengojnë në çdo kohë që ta marrë Krishtin. Prandaj lutej me zjarr që kjo mos të ndodh kurrë.

Ajo nuk do ta harrojë ditën kur policët u bërtitën fëmijëve në hyrje të klasës: „Na i dorëzoni të gjithë idhujt tuaj – momentalisht!“ Li e kuptonte shumë mirë se çfarë do të thotë kjo.. Të frikësuar, fëmijët i dorëzuan të gjitha figurat e tyre të devotshme, të Jezusit, Marisë dhe shenjtërve, të ngjyrosura me kujdes. Pastaj në kulmin e hidhërimit, kapiteni me një lëvizje të shpejtë mori kryqin e varur në mur, e hodhi në dysheme duke bërtitur: „Kina e re nuk do të tolerojë këto sende të shëmtuara besëtytnie!“

Vogëlushja Li, e cila e donte shumë figurën e Bariut të Mirë, provojë ta fshehë në bluzën e saj. Ishte kjo një figurë e veçantë që ia kishin dhënë për kujtim me rastin e kungimit të parë. Por, një shuplakë e rëndë e rrëzojë në dysheme. Kapiteni e thirri të atin e vogëlushes Li, dhe para saj e poshtëroi duke e lidhur me litar.

Atë ditë policia kontrolloi mbarë fshatin. Të gjithë banorët që i gjetën, i futën në kishën e vogël. Kapiteni edhe më tutje, me fjalë fyese, bërtiste njëfarë lloj “predikimi” duke përqeshur misionarët si “agjentë të imperializmit amerikan”. Pastaj me zë të lartë u urdhërojë ushtarëve që të shtinë me armë në tabernakull. Në atë moment e gjithë bashkësia u shtang dhe rriti intensitetin e lutjes.

Kapiteni iu drejtua turmës duke bërtitur: „Të shoh se si Krishti juaj mund të mbrohet vetë – ja çfarë mendoj unë për 'Praninë e vërtetë' – lojën e Vatikanit për eksploatimin e njerëzve!“ Duke thënë këtë, kapi ciboriumin dhe hodhi të gjitha hostet në dyshemenë me pllaka. Besimtarët e tmerruar mënjanonin shikim e tij dhe ngulfatnin klithmat e tyre. Vogëlushja Li ngriu nga tmerrri.

„O, jo, shihni çfarë i ndodhi bukës!“ Zemra e saj e pastër dhe e drejtë, ndjente dhembje për hostet që u shpërndanë në dysheme. „A do t’i ndihmojë kush Jezusit?“ pyetej e tmerruar. Kapiteni vazhdoi me një varg fyerjesh, duke ndërprerë blasfeminë e tij vetëm për t’u zgërdheshur nga thellësia e fytit. Li qante në heshtje.

„E tani, të gjithë jashtë!“ – çirrej kapiteni - „dhe mjerë ai i cili guxon të kthehet në këtë pleh besëtytnie! Ai do të ketë punë me mua!“

Kisha u zbraz menjëherë. Por pos engjëjve që gjithmonë janë të pranishëm në adhurim të Jezusit në Sakramentin Tejet shenjt të altarit, atje ishte edhe një dëshmitar, të cilit nuk i shpëtoi asnjë çast i asaj drame. Ishe atë Lluka nga misioni i të huajve. Një muaj më parë, duke parashikuar se fshati do të okupohej, besimtarët e kishin fshehur në një gropë muri në kor, prej nga mund të shihte gjithë kishën. Lutej dhe vuante shumë pse nuk mund të mbronte Jezusin. Një lëvizje e gabuar e tij do të mjaftonte që besimtarët të cilët e kishin fshehur të arrestohen për shkak të tradhtisë.

„Zotëri, ki mëshirë ndaj Vetes,“ lutej në ankth. „Ndalo këtë përdhosje! Zotëri Jezus, ndihmo!“

Pas pak krikëllima e derës ndërpreu heshtjen e rëndë në kishë. Ngadalë dhe me butësi, u hap dera. Ishte Li! Kinezja e vogël posa i kishte mbushur dhjetë vjet. U afrua te altari me hapat e saj të vegjël. Atë Lluka u dridh. Në çdo çast do të mund të vritej! Në pamundësi që të komunikojë me të, vetëm mund ta shikonte dhe të luste të gjithë engjëjt në Qiell që ta ruajnë këtë fëmijë. Vogëlushja, për një çast u përkul në heshtje, pikërisht ashtu si e kishte mësuar motra Eufrazija. E dinte se duhet ta përgatisë zemrën para se të marrë Jezusin. Me duar të bashkuara, i pëshpëriti lutjen e fshehtë Jezusit të saj të dashur – të keqtrajtuar dhe të braktisur asisoj. Atë Lluka pa se si ajo u ul në duar e në gjunjë dhe se si me gjuhë e mori një nga hostet. Qëndrojë në gjunjë, me sy të mbyllur dhe në vete u takua me mikun e saj Qiellor.

Atë Llukës çdo sekondë iu duk si amshim i vërtetë. Frikohej nga më e keqja. Sikur, së paku, të mund të fliste me të! Por, fëmija doli së shpejti ashtu qetë sikurse hyri, por gati duke kërcyer.

Brigada komuniste kontrolloi gjithë fshatin dhe rrethinën. Ky lloj terrori ndodh shpesh në Kinën e Re. “Fshatarët nuk morën guximin as të lëviznin. Të fshehur në banesat e tyre nga bambusi, nuk dinin se çfarë i pret në të ardhmen dhe a do ta presin ditën e nesërme. Megjithatë, vogëlushja jonë Li, vinte çdo mëngjes fshehurazi që të gjente Bukën e Gjallë në kishë. Duke përsëritur të njëjtin skenar nga dita e kaluar, secilën herë, merrte me gjuhë një hoste dhe zhdukej në qetësi. Atë Lluka nervozohet: „Pse nuk i merr të gjitha përnjëherë?“ E dinte sa hoste janë saktësisht: pikërisht 32! „A thua ajo nuk e di se mund të marrë më shumë njëherazi?“ – pyetej ai.

Jo, ajo nuk e dinte këtë. Motra Eufrazija ishte shumë e qartë në këtë pikë. „Mjafton një hoste në ditë. Dhe kurrë mos e prekni hosten. Ne e marrim në gjuhë!“ Vogëlushja ndiqte udhëzimet në mënyrë të përsosur.

Një ditë mbeti vetëm një hoste. Me të aguar vogëlushja erdhi në kishë si zakonisht dhe iu afrua altarit. U gjuhëzua që të lutet, shumë afër hostes. Atë Llukës iu desh të ngufasë klithmën kur pa ushtarin se si qëndronte në derë, duke drejtuar pushën drejt fëmijës. U dëgjua një krismë e përcjellë me të qeshur. Fëmija u rrëzua në të njëjtin çast. Atë lluka mendoi se është e vdekur por jo! Ai vërejti se si ajo zvarritet barkas nëpër dysheme për të arritur gjer te hostja. E pa se si e mori me gjuhë. Pastaj trupi i saj u tkurr disa herë para se të qetësohej përfundimisht.

Vogëlushja Li vdiq – por vetëm pasi i shpëtoi të gjitha hostet!¹⁸⁶

Ora shenjte, çdo ditë

Arkipeshkëvi Fulton Sheen vdiq në moshën 84. vjeçare. Fshehtësinë e vet e zbuloi në një intervistë në televizionin nacional dy muaj para vdekjes.

„Ekselencia juaj,“ filloi udhëheqësi, „keni inspiruar me miliona njerëz në mbarë botën. Po ju? Kush ju ka inspiruar? A ishte papa?“

„Nuk ishte as papë, as kardinal, asnjë ipeshkëv, madje as meshtar, as motër nderi! Personi i cili më ka inspiruar ka qenë vogëlushja dhjetëvjeçare.“

Dhe vetëm atëherë arkipeshkëvi Sheen e zbuloi fshehtësinë e tij dhe rrëfeu tregimin mbi vogëlushen Li. Shpjegoi se dashuria që ai fëmije i vogël e ka treguar ndaj Jezusit në eukaristi e ka impresionuar aq shumë sa ditën kur e ka dëgjuar atë tregim, i ka premtuar Jezusit që çdo ditë të jetës së tij deri në vdekje, pa marrë para sysh kur do të jetë kjo, do ta kaloj një orë, në adhurim, para Sakramentit Shenjt.

Arkipeshkëvi jo vetëm se e mbajti premtimin, por kurrë nuk e lëshoi rastin pa e popullarizuar dashurinë e Jezusit në eukaristi. Ai i thërriste besimtarët, pa u lodhur, çdo ditë, të vijnë dhe të kalojnë orën e shenjtë para Sakramentit Shenjt. Për të nuk kishte asnjë dyshim. Pikërisht ajo vajzë, e vogël, e shkretë, nga Kina e largët, rurale, ishte ajo shkëndija e së cilës e ndezi apostullatin shumë të frytshëm.

¹⁸⁶ Tregimin e vogëlushes kineze e rrëfeu Maria Winowska në librin me titull *The Thieves of God* (“Vjedhësit e Zotit”) Me që ishte e lidhur ngushtë me shërbimet sekrete ruse, polake, dhe kineze gjatë viteve më të tmerrshme të përndjekjes. Marija ishte në situatë të kuptoi, ruaj dhe të shpëtoi nga harresa dëshmitë e vlefshme nga jeta e shenjtërve polakë (atë Albertit, motrës Faustinë, atë Maximilian Kolbes) .

Atë ditë e gjithë Amerika para TV ekraneve të tyre kuptoi se me miliona zemra të cilat i kishte prekur predikuesi i madh po ashtu i ka prekur edhe vogëlushja Li. Ai fëmijë i pafajshëm qëndronte pas kthimeve të shumta! Me 32 vizitat heroike Jezusit, të shpërndarë në dysheme i hapi rrugën ipeshkvit për udhëheqjen e miliona njerëzve në adhurim para Sakramentit Shenjt. Në prapavijën e lulëzimit të vërtetë të kushtimeve të shumta, kushteve dhe thirrjeve të frymëzuara nga prelati më i popullarizuar amerikan, ishte martirja e vogël kineze dhe bashkimi i saj, në gjak, me Qengjin.

Më e dashura vogëlushja Li, ta kushtoj këtë libër, sepse ti je heroina ime më e dashur! Por, duhet ta pranoj se kam një interes të vogël për këtë. Ti ende nuk e ke kryer punën tënde! Shiko, në dysheme nuk janë vetëm 32 hoste, por me mijëra dhe me miliona!

Çdo ditë e vrasin Jezusin, e përqeshin, e shkelin. Numri i sekteve që e profanizojnë eukaristinë shumohet vazhdimisht. Gati në çdo famulli, çdo të diel, ka katolikë që e marrin kungimin Shenjt dhe jetojnë në mëkat të rëndë. Për këto mëkate në Bibël flitet si për “neveri” që vrasin shpirtin. Vogëlushe Li, Jezusin e mendojnë sot si kurrë më parë. Duhet të përmendim edhe shumë të “zgjedhur” që janë okupuar aq shumë me gjërat e kësaj toke sa kanë harruar dashurinë e madhe që Jezusi ka për ta. Në Francë janë braktisur aq shumë tabernakujt sa i ka mbuluar pluhuri. Në Angli, nëse dikush dëshiron të kalojë një kohë para Sakramentit Shenjt, shumë shpesh do të gjejë derën e kishës të mbyllur. Në Amerikë tabernakujt shpesh janë të ndjekur në një qoshe kisha, madje edhe në sakristi. Nganjëherë nuk mund të gjejnë as bankën për t’u gjunjëzuar, dhe mjerë ai që merr guximin të gjunjëzohet në çastin e kushtimit. Gjunjëzimi është i papranueshëm dhe mund të jetë shkak për largim nga kishat e caktuara.

Sa *Eufrazija shenjte* ka sot të cilat mësojnë katekizëm? Shumica e fëmijëve nuk është e përgatitur si duhet për ta njohur dhe dashur Jezusin. Kështu, rrallë mund të dëgjohen prindër që hapur flasin në familje për Jezusin si për mikun e tyre më të madh. Përkundrazi, ata e injorojnë, prandaj fëmijët besojnë se ai vërtetë nuk ekziston dhe humben në ateizëm.

Do të mund të vazhdoja, por ti nga Qielli sheh shumë më mirë se unë. Ti ende nuk e ke përfunduar, vogëlushja Li! E vërteta është se ti me martirizimin tënd në Kinë vetëm sa ke filluar thirrjen tënde! Eja na ndihmo. Ashtu si ke qëndruar me arkipeshkvin Sheen, eja e qëndro me çdo meshtar të sotëm, me çdo ipeshkëv, çdo rregulltar, çdo të krishterë. Na e zbulo Fëmijën e fshehur, mikun tënd të madh! Na e përcjell dashurinë tënde të sinqertë për Jezusin, atë dashuri radikale dhe të ndjeshme të zemrës sate të pafajshme.

Megjugorje, festa e Zojës së Fatimes, 13. maj 2006.

SHTOJCA 1

PËR AUTOREN

Motra Emmanuel Maillard u lind në Paris më 1947. Studioi teologjinë, kurse njëri nga profesorët e saj ishte kardinali në zë Daniélou. Në vitin 1970. Në universitetin e Prisit, Sorbonne diplomoi historinë e artit. Bashkësisë së lumturive iu bashkëngjit në vitin 1976., kurse në Megjugorje jeton që nga viti 1989. Për të ndihmuar realizimin e planeve të Zojës për paqe, në vitin 1990 në Francë, themeloi apostullatin „Les Enfants de Medjugorje“ (Fëmijt e Megjugorjes), kurse pastaj, në vitin 1994. Degën në SHBA me emër „Children of Medjugorje“.

„Dua të falënderoj të gjithë njerëzit që më kanë dhënë dëshmitë që Zoja të jetë më e dashur në zemrat e njerëzve. Por tregimi vazhdon, prandaj ua drejtoj thirrjen të gjithëve që do ta kenë dëshminë e vet, sepse asgjë nuk i prek zemrat ashtu si tregimet e thjeshta dhe të vërteta ku vërehet gishti i Zotit. Hiri që ndajmë me njerëzit, i tërheq shumë të tjerë!“

Shkruaj në adresë: Sestra Emmanuel, Box 8, 88266 Međugorje, Bosna i Hercegovina

Nëse dëshironio ti bashkoheni familjes sonë, kërkoni informata në adresë:

Children of Medjugorje, P.O. Box 18430, Denver, CO 80218-0430; Telefon: 877-647-6335 (877-MIR-MEDJ)

Web faqja: www.childrenofmedjugorje.com

SI TË MERRET POROSIA ME DATËN 25. TË MUAJIT?

Nëpërmes të telefonit automatik nga ora 0-24: 060 325 325

Nëpërmes të radios në Dalmacinë e Mesme (nga Šibeniku deri në Dubrovnik) në frekvencën: 101,5 MgH, në fillim të programit në ora 13.

Nëpërmes të gazetës së famullisë: „GLASNIK MIRA.“ Tel. I zyrës famullitare: 00 (387) 36 651 333 / Adresa: Župni ured, 88 266 MEĐUGORJE, BiH

Internet :

Qendra informative MIR (famullia): <http://www.medjugorje.hr>

QË TË MERRNI KOMUNIKATAT MUJORE TË MOTRËS EMMANUEL,

Mund të paraqiteni në këto adresa:

në kroatishte : rsilic@yahoo.com

në anglishte: pray@childrenofmedjugorje.com

në frengjishte: wmmedjugorje@childrenofmedjugorje.com

në spanjishte: gisele_riverti@mensajerosdelareinadelapaz.org

në italishte: info@vocepiu.it

në gjermanishte: : pray@childrenofmedjugorje.com

në portugeze: medjugorjeport@yahoo.com

Web faqja <http://www.childrenofmedjugorje.com> publikon këto komunikata edhe në gjuhë tjera.

KY LIBËR MUND TË GJËNDET EDHE NË GJUHË TJERA

Në frengjishte :

Në Francë: [Edit. des Béatitudes](mailto:Edit.des.Béatitudes), Burtin, 41600 Nouan-le-Fuzelier - Tel: (33) 254 88 2118, ed.beatitudes@wanadoo.fr or edb.serviceclients@wanadoo.fr

Në Kanada: Mediaspaul, Montreal -Tel (514) 322 7341 - www.editions-beatitudes.fr

Në spanjishte :

Në Argjentinë: Paulinas, Larrea 44/50 - 1430 Buenos Aires - Tel: (54) 11.4952 5924 - editorial@paulinas.org.ar www.paulinas.org.ar

Në Meksiko: [Comunidad de las Bienaventuranzas](mailto:Comunidad.de.las.Bienaventuranzas), Atlixco - atlixco@beatitudes.org

Në Ekuador : Jesus de la Misericordia, POBox 6252, CCD - Tel: (593) 2.564.519.528.519 - jesusmi@quik.com.ec

Në spanjishte : Hijos de Medjugorje, Tarragona. Tel: (34) 676-05-95-94 - gsba15@yahoo.es

Në Çile: Foyer de Caridad Nuestra Señora del Carmen, Tel (56) 41 651 332 - foyer@entelchile.net

Në anglishte:

1. Në SHBA. Queenship Publishing; Box 42028, Santa Barbara, CA 93140-2028 - Tel: (800) 647-9882 - qship@impulse.net

2. Në SHBA. Children of Medjugorje-USA, PO Box 18430, Denver, CO 80218-0430 - Tel: 877-647-6335 (877-MIR-MEDJ) pray@childrenofmedjugorje.com - www.childrenofmedjugorje.com

3. Në Indi. The Ark, Cochin, Kerela - Tel: (91) 484 392 667 - eddy@vsnl.com

Në italishte: Editrice Shalom - Tel. (39) 071 7450 440 - ordina@editriceshalom.it - www.editriceshalom.it

Në polonishte: Wydawnictwo Marianow, Warsaw; Tel: (48) 22 651 9970, wkm@marianie.pol.pl

Në Holandeze:

1. Holandë. Noelle Imkamp - Tel: (31) 70.355.3943 - n.imkamp@tele2.nl

2. Curacao. San Vicente de Paul - Tel: (599) 9869 5382 - hcampman@cur.net or hcampman@interneeds.net

Në portugeze:

1. Portugali: medjugorjeport@yahoo.com

2. Brazil: Aleanza Misericordia - pe.enrico@misericordia.com.br

Në rumanishte: Janine, Copiii Medjugorje, copmedj@rdslink.ro or copmedj@atnr.ro

Në gjermanishte: Parvis Verlag, Switzerland, Tel: (41) 269 159 393 - book@parvis.ch

Në libaneze: Amis de Marie Reine de la Paix -Tel: (961) 125 9593 - office@medugorjeliban.org

Në koreane: Charles Kim, Fax: (60) 82.425.724 - cskimian@hotmail.com

Në kinezishte: Michele Yau, COM-Hong Kong - com.hongkong@gmail.com

Në lituaneze: Shablovskis, Latvia, Lettony - Tel: (371) 7324 230 - ei@lanet.lv

Në ruse: Piotr Cheltsov, Moscow - pcheltsov@mail.ru or srtamara@free.fr

Në sllovene: Fr. Miran Spelic, Ljubljana, Slovenia - miran.spelic@rkc.si

Përkthimet në gjuhët sllovaqe, çeke, japoneze, hungareze e shqipe janë në zhvillim e sipër.

SHTOJCA 2

Kjo është deklarata e fundit zyrtare e Vatikanit për Megjugorjen.

KONGREGATA PËR MËSIMIN E FESË MBI MEGJUGORJEN

Kongregata e fesë i ka dërguar letër (shih poshtë) Msgr. Gilbert Aubry, ipeshkvit të ujdhesës la Réunion, duke u shprehur qartë mbi Megjugorjen. Ai e ka pranuar letrën më 24. qershor, kurse më 25. qershor ua ka dërguar të gjithë meshtarëve dhe bashkësive fetare të ipeshkëvisë së tij (qarkorja nr. C003), që të mund ta kenë qëndrimin e fundit të Romës, dhe nëse është e nevojshme, t'i njoftojnë besimtarët mbi këtë çështje.

KONGREGATA PËR MËSIMIN E FESË

VATIKAN, PALLATI I SHËN. UFICIT

Pr. nr. 154/81-06419 (përshkrim i origjinalit)

Datë 26. qershor 1998.

Ekselencës së tij Msgr. Gilbert Aubry,

Ipeshkvit të Saint-Denis de la Reunion

Ekselencë,

Në letrën tuaj të datës 1. janar 1998., i keni bërë këtij Dikasteri pyetje të ndryshme që kanë të bëjnë me qëndrimin e Selisë Shenjte dhe ipeshkvit të Mostarit lidhur me të ashtuquajturat „dëftime“ në Megjugorje, të shtegttimeve private dhe kujdesit pastoral të besimtarëve që vijnë në këtë vend.

Lidhur me këtë – duke marrë para sysh se e kam të pamundur që të përgjigjem në çdo pyetje që Ju, Ekselencë, keni bërë – para së gjithash konsideroj se duhet theksuar se nuk është praktikë e Selisë Shenjte që të ketë qëndrim në nivelin e parë të përgjegjësisë, qëndrimin personal ndaj dukurive mbinatyrore të përmendura. Për këtë arsye ky Dikaster, lidhur me besueshmërinë e „dëftimeve“, thjeshtë, i mbahet qëndrimit të asaj që kanë thënë ipeshkvijtë e ish Jugosllavisë në deklaratën në Zarë më 10 prill 1991: „...Në bazë të hulumtimeve të deritashme nuk mund të konstatohet se kemi të bëjmë me dëftime dhe shfaqje të mbinatyrshme.“ Pas ndarjes së Jugosllavisë në shtete të ndryshme të pavarura, u takon tani anëtarëve të konferencës Ipeshkëvore të Bosnje e Hercegovinës që, eventualisht, të hulumtojnë përsëri këtë rast dhe në fund të japin të tjera deklarata.

Sa i takon asaj që ka deklaruar ekselencën e Tij msgr. Periq në një letër sekretarit gjeneral të „Kršćanska obitelj,“ në të cilën deklaroi: „Bindja dhe qëndrimi im nuk janë vetëm 'nuk mund të

vërtetohet se kemi të bëjmë me të mbinatyrshmen' por po ashtu 'vërtetohet se nuk kemi të bëjmë me dëftime ose shfaqje të mbinatyrshme në Megjugorje'" duhet kuptuar si bindje personale e ipeshkvit të Mostarit, i cili pasi që është ipeshkëv vendas, gjithmonë, ka të drejtën që të shpreh atë që është dhe mbetet mendimi i tij personal.

Përfundimisht lidhur me shtegtimet në Megjugorje që janë të natyrës private, kjo Kongregatë konsideron se janë të lejuara me kushtin që ato nuk konsiderohen si pranim i ngjarjeve që janë ende në zhvillim dhe të cilat kanë nevojë për hulumtime të Kishës.

Me shpresën se kam dhënë përgjigje të kënaqshme së paku në pyetjet kryesore që Ju i keni bërë këtij Dikasteri, unë ju lus, Ekselencë, pranoni shprehjet e nderimit tim më të thellë.

Msgr. Tarcisio Bertone

(sekretari i Kongregatës për mësimin e fesë të cilën në atë kohë e udhëhiqte kardinali Ratzinger)

Nga kjo shkresë, pra, rrjedh:

Deklaratat e ipeshkvit të Mostarit nuk shprehin asgjë tjetër pos mendimit të tij personal. Kjo do të thotë se ai nuk është qëndrimi zyrtar dhe as i fundit i Kishës i cili do të kërkonte pranim dhe dëgjese.

Padyshim, komisioni i ri do të emërohet.

Derisa të mos bëhen hulumtimet e mëtutjeshme, Kisha i ka lejuar shtegtimet private me përcjellje pastorale të besimtarëve. Të gjithë shtegtarët mund të shkojnë në Megjugorje dhe kjo është në harmoni me dëgjuesën e plotë ndaj Kishës. Vetëm shtegtimet zyrtare nuk janë të lejuara.

Kardinali Schönborn komenton:

Letra e arkipeshkëvit Bertone ipeshkëvit Réuniona në mënyrë të kënaqshme ndriçon qëndrimin zyrtar të hierarkisë kishtarë mbi Megjugorjen këto vitet e fundit: dmth çështjen e len të hapur. Nëse në formulimin e konferencës së dikurshme (më 1991, në Zarë) ishte: nuk është vërtetuar karakteri mbinatyror, atëherë, në mënyrë të vetëdijshme, ai është një formulim i hapur, nuk thotë se nuk ekziston, pra se është vërtetuar ose mohuar, por as nuk është përjashtuar mundësia që fenomenet mund të jenë të karakterit mbinatyror. Sigurisht, magjisteri i kishës nuk do të deklarohet përfundimisht në lidhje me këtë deri sa vazhdojnë këto fenomene në formën e dëftimeve ose në forma tjera. Por detyra e barinjve është që të nxisin atë që i kontribuon rritjes, që ti mbështesin frytet që duken, dhe nëse është e nevojshme të mbrojnë nga rreziqet që janë gjithandej. Edhe në Lourdes duhet qëndruar zgjuar vazhdimisht që dhurata e tij fillestare mos të

ngulfatet me ndonjë zhvillim në kahe të gabuar. As Megjugorje nuk është e palëndueshme në këtë pikë. Prandaj është dhe do të jetë shumë e rëndësishme që edhe ipeshkvijtë, fare hapur të marrin nën mbrojtjen e vet pastoralin në Megjugorje ashtu që frytet të cilat janë dukur në atë vend të mbrohen nga çfarëdo zhvillimi të mundshëm në kahen e gabuar.

Besoj se fjalët e Marisë në Kanë “Bëni ashtu si t’ju thotë!” paraqesin bërthamën e asaj që ajo flet nëpër shekuj. Maria na ndihmon që ta dëgjojmë Jezusin, dhe me gjithë zemrën dhe gjithë forcat e saj dëshiron që të bëjmë atë që Ai na thotë.

Këtë edhe unë ju dëshiroj bashkësive të lutjes që kanë dalë nga Megjugorja, këtë ia dëshiroj ipeshkëvisë sonë dhe Kishës në Austri, e kësaj sigurisht do t’i kontribuojë aksioni i lutjes - Maria Mbretëresha e Paqes.

Personalisht nuk e kam vizituar Megjugorjen, por kam qenë atje nëpërmes të njerëzve që i njoh ose që i kam takuar, dhe të cilët e kanë vizituar Megjugorjen. Dhe i shoh frytet e mira në jetën e tyre. Do të gënjeja po të thosha se ato fryte nuk ekzistojnë.

Këto fryte janë të prekshme dhe të dukshme. Edhe në ipeshkëvinë tonë, por edhe në shumë vende të tjera vërej huret e kthimit, huret e të jetuarit të fesë mbinatyrore, thirrje, shërime, zbulimit të sërishëm të sakramenteve, rrëfimet. Të gjitha këto janë gjëra që nuk mund të çojnë në mendim të gabuar.

Ky është shkaku pse mund të them se këto fryte ma mundësojnë që si ipeshkëv të shprehi vlerësimin moral. Sepse nëse Jezusi ka thënë se pema njihet prej fryteve, kam obligim të them se kjo pemë është e mirë.

Kardinali Schönborn

Kardinali Christoph Schönborn, arkipeshkëv i Vjenës, në vitin 1998., për Atin Shenjt dhe shtëpinë e tij Papnore ka mbajtur ushtrimet shpirtërore të kreshmëve. Është autori kryesor i „Katekizmit të Kishës Katolike,“ kurse dëshminë e mësipërme e ka dhënë në Lourdes më 18.7.1998. Dëshmia e kardinalit është publikuar në „Medjugorje Gebetsaktion,“ #50, „Stella Maris,“ #343, pp. 19, 20. (*Përkthimin e sjellim me lejen e kardinalit*).

Nota Bene: 12. janar 1999. arkipeshëvi Bertone pranoi eprorët e *Communité des Béatitudes* (Bashkësia e Lumturive) dhe ju tha: „Jo vetëm se ju jap lejen të jeni të pranishëm në Megjugorje, por këtë e kërkoj prej jush. Duhet përcjellë shtegtimet.“ Me atë rast sekretari i Kongregatës për mësimin e fesë ju ka thënë diçka që është pak e njohur: „Tani për tani Megjugorja duhet nderuar si shenjtërore mariane, njësoj si Czestochowa (Poloni).

LISTË E LIBRAVE TË ZGJEDHUR PËR MEGJUGORJEN:

Poruke kraljice mira, Međugorje, 1996.

Fra Slavko Barbarić, „Slijedi me srcem“, Informativni centar MIR Međugorje, Međugorje 1997.

Fra Slavko Barbarić, „Biseri ranjena srca“, Informativni centar MIR Međugorje, Međugorje 1997.

Fra Slavko Barbarić, „Molite srcem“, Župni ured Međugorje, Međugorje, 1994.

Fra Slavko Barbarić, „Klanjajte se srcem mome Sinu“, Župni ured Međugorje, Međugorje

Fra Slavko Barbarić, „Daj mi svoje ranjeno srce“, Župni ured Međugorje, Međugorje

Fra Slavko Barbarić, „Molite zajedno radosna srca“, Informativni centar MIR Međugorje, Međugorje 1999.

Fra Slavko Barbarić, „Postite srcem“, Informativni centar MIR Međugorje, Međugorje 2000.

Fra Janko Bubalo, „Tisuću susreta s Gospom u Međugorju“, Jelsa, 1985.

Krešimir Šego, „Međugorje vrijeme milosti“, Mostar, 1997.

René Laurentin, „18 godina ukazanja“, Kruh sv. Ante, Sarajevo

SHTOJCA 3

Letra private të papës Gjon Pali II, që kanë të bëjnë me Megjugorjen

Papa Gjon Pali II., nganjëherë në letrat e drejtuara Marekut dhe Zofisë Skwarnicki, miqve të tij në Krakov, ka përmendur Megjugorjen. I kujdesshëm në nderimin e punës së Komisionit mbi Megjugorjen, nuk ka shpallur publikisht ndonjë deklaratë zyrtare, por tani jemi të vetëdijshëm se Gjon Pali II., aty-këtu privatisht u ka pëshpëritur ipeshkvijve, meshtarëve dhe laikëve – dhe i ka nxitur me fjalë – që të shkojnë në Megjugorje dhe të luten atje. Sot i kemi letrat e tij të drejtuara Marek Skwarnickit, si dokumente private që i ka nënshkruar personalisht.

Marek, poet e njohur polak, ka bashkëpunuar me kardinalin Karol Wojtylën para se ai të ngrihej në fronin e Pjetrit. Ai dhe e shoqja Zofia ndërtuan me të një miqësi të thellë (Gjon Pali II. i takonte ata gjithmonë sa herë që vizitonte Krakovën) dhe ata kanë këmbyer letra deri në vdekjen e tij në vitin 2005. Unë pata privilegjin të takoj Marekun dhe Zofinë në shtëpinë e tyre në Krakov gjatë misionit tim në vitin 1995., dhe ata më lejuan t'i lexoj ato letra të vlefshme. Mirëpo, gjatë jetës së papës, konsideronin se nuk do të ishte mirë të publikohen ato letra. Por sot, të gjithë mund të kënaqemi me ato vlera të vërteta. Megjugorje përmendet në gjashtë letra. Këto dokumente na pasqyrojnë besnikërinë e Gjon Palit II ndaj Megjugorjes.

Marek të parën herë i publikojë këto letra në Poloni në tetorin e viti 2005.¹⁸⁷

I dashur Zotëri,

(...) dhe që çdo gjë të shkojë mirë sa i takon udhëtimit Megjugorje-Romë.

Bekim të përzemërt,

Gjon Pali II. Vatikan, 30. mars, 1991.

Mareku shkruan. „Fjalja – 'në udhëtimin nga Megjugorja në Romë' Nuk ishte aluzion në çfarëdo udhëtimi. Vërtetë, ajo shënonte lidhjen në mes të shenjtërores në Megjugorje dhe Vatikanit. Në të vërtetë, kontraverzet lidhur me dëftimet e Megjugorjes ende ekzistonin sepse mbretëronin mospajtimet në mes të françeskanëve të Megjugorjes dhe ipeshkvit të Mostarit. Kjo ishte në kohën kur çështja e Megjugorjes iu drejtua në shqyrtim Konferencës Ipeshkëvore të Jugosllavisë.“

¹⁸⁷ (Libri i zotëri. Skwarnickit: “Gjon Pali II: Të përshëndes dhe të bekoj – letra private të papës” u publikua në tetor të vitit 2006., nga botuesi Swiat Ksiazki-Bertelsman Media, Warszawa, Poloni)

2. Fragmente të këtyre letrave ka botuar edhe kardinali Dziwisz, sekretari i dikurshëm personal i Gjon Palit II., kurse tani kardinal i Krakovës, me lejen e Marek Skwarnickit (27. maj 2006.)

(...) e tani çdo ditë kthehem në Megjugorje, në lutje.

Gjon Pali II., Vatikan, 28. maj 1992.

Sipas Marekut „ajo referencë për Megjugorjen është shenjë e ndjenjave të thella të Atit Shenjt lidhur me luftërat vëllavrasëse ballkanike dhe sepse sa vinte e shtohet besimi i tij në shenjtërinë e shenjtërores së Megjugorjes.“

Të dashur Marek dhe Zofia,

(...) Falënderoj Zofinë për të gjitha lidhur me Megjugorjen. Edhe unë si shtegtar çdo ditë në lutjet e mia, shkoj atje. Në lutjet e mia bashkohem me të gjithë ata që luten atje ose pranojnë thirrjen për lutje prej andej. Sot e kam kuptuar më mirë atë thirrje. Gëzohem që në kohën tonë nuk mungojnë njerëzit e lutjes dhe të apostullimit.

Sipas Marekut „të gjitha që papa shkruan këtu për Megjugorjen kanë një vlerë të madhe. Nuk ka të bëjë me kontaverzet e gjata lidhur me besueshmërinë e dëftimeve. Përveç kësaj, papa merr pjesë në besimin e popullit të Zotit, si Meshtari më i Lartë i Kishës, dhe iu bashkëngjitet të varfërve të Megjugorjes nëpërmes lutjes, pasi që është bindur në planin e veçantë të Zotit për atë vend për sa i përket nderimit përherë e më të madh të Nënës së Zotit. Pasi që në porositë e Megjugorjes brenga kryesore janë vërejtjet e Nënës për kaosin dhe luftën që po vjen, papa në vitin 1992., derisa ende vazhdonte lufta në Ballkan, shkroi: 'Sot e kam kuptuar më mirë atë thirrje.'“

I dashur Marek,

„(...) E di se Zonja Zofi i gëzohet shumë Megjugorjes, dhe në kohë të fundit edhe Ostra Brama për shkak të gjithë të kaluarës së saj. E pranoj, isha në Ostra Brama, madje atje citova edhe Mickiewiczin. Mirëpo, nuk isha në Megjugorje, por shikoj edhe në atë drejtim. Të lutem thuaj gruas sate për këtë. Shikoj në atë drejtim dhe më duket se njeriu nuk mund t'i kuptojë ngjarjet e sotme të tmerrshme në Ballkan pa Megjugorjen. (...)“

Gjon Pali II., 6. dhjetor 1993.

Mareku komenton: „Dhe përsëri për Megjugorjen. ' Më duket se njeriu nuk mund t'i kuptojë ngjarjet e sotme të tmerrshme në Ballkan pa Megjugorjen.,' shkruan Ati Shenjt në kohën kur lufta në Ballkan merrte hov... Me vite Nëna e Lume paralajmëronte për urrejtjen dhe mëkatet e njerëzve që çojnë në katastrofë.“ (faqe. 117)

Vatikan, 25. shkurt 1994.

Të dashur Zotëri dhe Zonjë,

Ju falënderoj shumë për letrat. Zofia më shkruan për Ballkanin. Supozoj se sot Megjugorja mund të kuptohet më mirë. Sot mund të kuptojmë më mirë atë lloj „insistimi“ të Nënës sonë kur me sytë tanë vërejmë madhësinë e rrezikut. Njëkohësisht, reagimi në formën e lutjes së veçantë – dhe fakti se ajo vjen nga njerëzit prej mbarë botës – na mbush me shpresë se edhe këtu do të mbizotërojnë e mira. Paqja është e mundur – ky ishte moto i ditës së Lutjes të 23. Janarit e cila u përgatit në mënyrë të veçantë në mbledhjen e Vatikanit, ku merrte pjesë edhe zotëri T. Mazowiecki.

Ndoshta duke iu falënderuar edhe kësaj Evropa do të kuptojë. Populli në Poloni po i kthehet mendjes së vet, si shihet prej letrave tuaja. Ndoshta do të jetë më lehtë për ta që të pajtohen me papën i cili nuk predikon “fitoren e demokracisë,” por në vend të kësaj i përkujton në dhjetë urdhërimet e Zotit.

(...) Me bekimin tim.

Gjon Pali II., 25. shkurt 1994.

Të dashur Zotëri dhe Zonjë,

(...) Pjesa e dytë e letrës sjell shumë informata të vlefshme mbi shtegtimin në Megjugorje më 25 gusht ku ka qenë Zofia. Kemi të bëjmë, pra, me përshtypjet e dëshmitarit nga dora e parë, ashtu të them, dhe janë të besueshme në çdo aspekt. Le të ju shpërblejë Zoti! Është shumë vështirë të lexohen ato fjalë pa bashkëndjerje të thellë me atë jetimë dhe gjithë banorët lokalë të atij vendi. S’është për t’u çuditur se njerëzit e atjeshëm mbështeten vetëm në Zotin, sepse nuk marrin kurrfarë mbështetje nga bashkësia më e afërt e tyre.

Ia porosis Nënës së Zotit Zofinë, Marekun dhe mbarë familjen. Dëshiroj që të jeni shëndosh. Ju bekoj nga zemra,

Gjon Pali II., Castelgandolfo, 3. shtator, 1994.

Vatikan, 26. shkurt 1997.

Të dashur Zotëri dhe Zonjë,

Ju falënderoj shumë për letrat, si dhe botimin e 10. polak të Udhës së Kryqit nga koloseumi. Nëse Zotëria lejon, kushtimi i ndërtesës do të jetë pjesë e programit në vizitën time Krakovës. Me hapa të shpejtë po u afrohem atyre ditëve. Është mirë se ato janë caku i lutjeve së vendasve të mi, sikurse edhe vizita ime Sarajevës, së shpejti, e cila, në mënyrë të veçantë e kyç zonzjën Zofi dhe lutjet e saj, për sa i takon Megjugorjes. Është mirë që e ka shkruar recensionin për librin e motrës Emily mbi apokalipsin, ndoshta do të rritet interesimi për librin.

Me që jemi në kreshme, ju dëshiroj mëshirë hyjnore për këtë periudhë aq ngushtë të lidhur me Misterin e vuajtjes së Shpëtimtarit Tonë.

Përshëndes nga zemra zonzjën Zofi, zotëri Marekun dhe „fëmijët“ së bashku me Palin e vogël.

Bekim,

Gjon Pali II.

Mareku komenton: „... (Ati Shenjt) planifikonte udhëtimin në Sarajevë. Megjugorje, edhe pse afër, nuk përfshihej në orarin e tij gjatë vizitës Bosnje dhe Hercegovinës.“ (faqe. 146, rreshti 6 dhe 7)

Vatikan, 15. prill 1986.

E dashur zonzjë Zofi dhe zotëri Marek,

Ju falënderoj që keni ndarë me mua vërejtjet tuaja të nxitura me botimin e librecit që e ka përkthyer zonzja Zofi, dhe të cilën ma ka dërguar si dhuratë. E falënderoj me gjithë zemër për këtë si edhe Ju, Marek për shtojcat në fund të letrës së saj. Është ngushëlluese të dëgjosh lajme nga reagimi i Popullit të Zotit – dhe për implementimin e asaj që është më e rëndësishmja në gjithë atë ngjarje, çka nxit zjarrin, pajtimin e zemrave, lutjet drejtuar Atit të Mëshirshëm, hapjen e zemrave për pranimin e Mëshirës Hyjnore ...

GjP II

Bariu i Mirë u ngjall, aleluja!

Me bekim,

Gjon Pali II., papa, Pashkë1986.

Mareku komenton: „*'Libreci'* që përmend papa është publikimi i parë polak mbi dëftimet e Megjugorjes. Mikja jonë Maria Balewicz e ka përkthyer nga gjermanishtja në polonishte. Pasi që papa e ka marrë nga gruaja ime, është gabim të supozohet se e ka përkthyer Zofia. Është interesante shtjellimi i dëftimeve që e bën papa. Në fillim kishte kontroversa të dukshme në vetë Kishën. Për më tepër, interesimi përherë e më i madh për ngjarjet e Megjugorjes, si në mes të

besimtarëve në ish Jugosllavinë, ashtu edhe në vendet tjera, ishte problem për pushtetin lokal, sepse Jugosllavia ishte vend i komunizmit ateist. Meshtari i Megjugorjes u arrestua. Ispeshkvi i Mostarit, që paraqiste pushtetin kishtar në atë zonë, ishte kundër pranimin të besueshmërisë së dëftimeve. Françeskanët lokalë kishin tjetër mendim... kështu që kontroverset sa vinin e shtoheshin... Ata që besonin në dëftime (duke mos bërë asgjë, me këtë, kundër mësimit të Kishës) mbështesnin françeskanët lokalë. Gjon Pali II. shkruan pikërisht në atë periudhë përgjigjen në letrën e gruas sime dhe shënimet e mia në fund të letrës... Ai nuk shpreh mendimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, por është e qartë se pajtohej me përmbajtjen e atyre dëftimeve. Më në fund ato janë të përqendruara në thirrjen për paqe, për pajtimi në botën e trazuar dhe në Ballkan, për dashuri ndaj Krishtit, për pendesë dhe lutje ndërmjetësuese .“ (faqe. 43)

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

PËRMBLEDHJE E SHKURTË E HISTORISË SË MEGJUGORJES

- 1 KUSH ËSHTË FËMIJA I FSHEHUR?
- 2 SYTË E KALTËRT TË VERONIKËS
- 3 KTHEJANI MBRETIT KURORËN!
- 4 FATI IM NË PLANETE?
- 5 FËMIJA DO TË JU PRIJË
- 6 JEZUSI FËMIJË, ZOTI IM, FËMIJA IM!
- 7 PATËR PIO NË MEĐUGORJE?
- 8 SË PARI, PAQA NË ZEMRËN TIME
- 9 FJALËT E URTA TË FRA SLAVKOS
- 10 GRABITJA E THIRRJES
- 11 KAFETERI APO KISHË?
- 12 JAM PA MËKAT, NUK KAM ÇFARË TË RRËFEJ
- 13 EJANI TA VIZITIJMË ATË PLAKË TË ÇMENDUR!
- 14 GJUHA E PANJOHUR
- 15 ENDACAKU NGA CHÂTEAUNEUF
- 16 KUSHTIMI NË TOKËN E MAFISË
- 17 VICKA NË SHKALLËT E SAJË
- 18 POSA KALOVA ANDEJ
- 19 I VIZITOVA TË GJITHË TEMPUJT NË SINGAPOR
- 20 RRUZARJA APO SOVJETIKËT?
- 21 KUTIA QË KRIJON ZBRAZTËSI

- 22 KUSH E KA MËSUAR TË LUTET ATË PION?
- 23 A KE MENDUAR NDONJËHERË TË BËHESH MESHTAR?
- 24 VETËVRSJET TË SHTUNDEN MBRËMA
- 25 PAULINE!
- 26 BUTËSIA FËMINORE
- 27 FJALËT E VICKËS PLOT URTI
- 28 E TMERRONTE MENDIMI PËR AGJËRIM
- 29 RECETAT PËR AGJËRIM
- 30 SA KUSHTON SARI YT?
- 31 ÇFARË TË BËJ TANI?
- 32 ÇFARË TË BËJ TANI?
- 33 FTESA E MREKULLUESHME
- 34 LLOGARITË LEGJENDARE TË FLORENCËS
- 35 PAQA JUAJ DO TË RRJEDH SI LUM
- 36 BEKIMI NË HEKURUDHËN NËNTOKËSORE
- 37 FEDERICO: FËMIU KATËRVJEÇAR DHE GJASHTË TUMORËT
- 38 ENGJËJT E BETLEHEMIT
- 39 KATASTROFA ME TRËNDAFILAT
- 40 NUK KE KOHË PËR LUTJE?
- 41 TRI NIVELE TË LUTJES
- 42 BUTËSIA E MARISË
- 43 DIAMANTI I PAPËRPUNUAR
- 44 FSHEHTËSIA E RRËFIMIT
- 45 KËMBËT E GJATA TË FRA SLLAVKOS
- 46 GJETJA E FËMIUT
- 47 SCOTT, OSE SHOK TERAPIA

48 WEB FAQJA PËR ADHURUESIT
49 MESHJA NË JUAREZ
50 QIELLI NË PËLLËMBË TË DORËS
51 VDEKJA SHENJTE, VDEKJA SHENJTE!
52 O, SHËN JOZEFI I MIRË!
53 „DO TA SHKYÇIM PAJISJEN“
54 PRANË SHTRATIT TË TË SËMURIT
55 MIGRENAT E BILLIT
56 PLAGA E HAPUR
57 SHËRIMI I MATTEOS
58 DOROTA
59 A VONOHET ZOTI?
60 VETËM SOT MUND TË DUA
61 SOT DO TI HUDHËSH MBETURINAT
62 BETEJA QË UDHËHEQIN MESHTARËT
63 MESHJA E SIGURUAR ME VËSHTIRËSI
64 FRA JOZO, NJERIU I BEFASIVE
65 DASHURIA E JULISË NUK NJEH KUFIJ
66 KLITHJA NGA CIBORIUMI!
67 FËMIJA QË GJAKDERDH
68 KËRKO ÇFARË TË DUASH!
69 BIBLA IME PO DIGJET
70 OPERACIONI JERIKU
71 O, ÇFARË RRENE!
72 LUTJA E RREZIKSHME
73 RRËFIMI QË VLEN TË MBAHET MEND

- 74 DHITË PA KUFI
- 75 ZOTI QË SHUMON
- 76 MARTA ROBIN, ENGJËLLI KUNDËR VETËVRASJES
- 77 HAPI I FUNDIT
- 78 DEPOTË E PROVANISË HYJNORE
- 79 SFERA E NGROHTË NË KRIZHEVAC
- 80 PYETJE PERSONALE PËR ZOJËN
- 81 PROFETI NGA FSHATI BIJAKOVIQ?
- 82 VOGËLUSHJA LI

SHTOJCA 1

SHTOJCA 2

SHTOJCA 2